

# ENVER HOXHA

VEPRA

7



**PROLETARË TË TË GJITHA VENDEVE, BASHKOHUNI!**

# **ENVER HOXHA**

**VEPRA**

**BOTOHET ME VENDIM TE KOMITETIT  
QENDROR TE PARTISE SE PUNES TE  
SHQIPERISE**



**ENVER HOXHA**



INSTITUTI I STUDIMEVE MARKSISTE - LENINISTE  
PRANË KQ TË PPSH

# ENVER HOXHA

VËLLIMI

7

JANAR-DHJETOR 1950

SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»  
TIRANË, 1971



## PARATHËNJE PËR VËLLIMIN 7

*Në vëllimin e 7-të të Veprave të shokut Enver Hoxha përfshihen raporte, fjalime, diskutime, letra, artikuj e materiale të tjera, të shkruara në vitin 1950. Në këto vepra pasqyrohet vazhdimi i luftës për të vënë në jetë vendimet historike të Kongresit I të PKSH.*

*Viti 1950 ka qenë karakterizuar nga ashpërsimi i luftës klasore në shkallë kombëtare e ndërkombëtare. Armiqtë imperialistë me imperializmin amerikan në krye, në bashkërendim planesh e veprimtarish me monarko-fashistët grekë dhe revizionistët jugosllavë, shtonin nga dita në ditë presionin kundër Republikës Popullore të Shqipërisë, të rrethuar gjeografikisht anembanë. Goditjet e imperializmit u intensifikuan pa masë kundër Bashkimit Sovjetik dhe kundër gjithë kampit socialist. Për këtë qëllim u krijua bloku agresiv i NATO-s (Pakti i Atlantikut të Veriut). Trupat amerikane u hodhën në sulm të armatosur kundër Republikës Demokratike Popullore të Koresë. Presioni imperialist kundër Shqipërisë dhe kundër socializmit botëror në tërësi ndikoi në gjallërimin e armiqve të brendshëm të klasës, solli gjithashtu edhe gjunjëzimin e një numri, sado të vogël, anëtarësh të Partisë, edhe të ndonjë anëtari të Komitetit Qendror të saj.*

*Synimi i Partisë së Punës të Shqipërisë në këtë gjendje ishte: të shkatërroheshin pengesat dhe të kapërceheshin vështirësitë e shumta, sidomos në lëmin ekonomik, për të siguruar zbatimin e programit të ndërtimit socialist të vendit, për të plotësuar me sukses planin dyvjeçar 1949—1950, për të ruajtur lirinë e pavarësinë kombëtare, për të prishur planet agresive të imperiaлизmit drejtuar kundër kampit socialist dhe pavarësisë kombëtare të popujve të botës, për të mbrojtur paqen botërore.*

*Karakteristikat e gjendjes së brendshme e të jashtme dhe synimi i Partisë në atë kohë analizohen mbi baza shkencore revolucionare në veprat e këtij vëllimi.*

*Të gjitha këto vepra flasin për parimësinë marksiste-leniniste të PPSH, për vendosmërinë e saj të patundur në zbatimin e vijës së vet politike revolucionare, për pjekurinë dhe largpamjen e saj në atë situatë aq të ndërlikuar.*

*Materialet tregojnë se si PPSH, për të kryer me sukses detyrat e saja të mëdha në ato rrethana e quante të domosdoshme dhe luftonte:*

— për ruajtjen e forcimin e bashkimit të masave popullore rreth Partisë, të aleancës së klasës punëtore me fshatarësinë nën udhëheqjen e klasës punëtore;

— për sqarimin politik të popullit mbi rreziqet që e kanosnin vendin, mbi vështirësitë e pengesat e shumta që duheshin kapërcyer, mbi mungesat që ishte e nevojshme të përballoheshin, mbi luftën e ashpër kundër armiqve të brendshëm e të jashtëm të klasës që duhej zhvilluar, mbi vigjilencën e lartë politike që kërkohej nga gjithë masat punonjëse;

— për mobilizimin e gjithë forcave dhe burimeve të brendshme në dobi të plotësimit të planeve ekonomike;

— për forcimin e pushtetit popullor, që ai, si diktaturë e proletariatit, të shkatërronte çdo plan e çdo veprimtari të armiqve të klasës e njëkohësisht të drejtonte e të organizonte me zotësi ndërtimin socialist të vendit, plotësimin e planeve të zhvillimit ekonomik e kultural;

— për forcimin e drejtimit politik të ekonomisë nga organet udhëheqëse dhe organizatat e Partisë;

— për përmirësimin në përgjithësi të metodës së punës drejtuese të Partisë e të pushtetit popullor, për të luftuar burokratizmin nëpërmjet një kritike të shëndoshë me pjesëmarrjen e masave punonjëse;

— për demaskimin e planeve dhe të veprimtarisë armiqësore të imperialistëve amerikanë e të tjerë, si edhe të revizionistëve jugosllavë;

— për ruajtjen dhe forcimin e unitetit të vendeve socialiste me Bashkimin Sovjetik në krye, i cili në atë kohë nën udhëheqjen e J. V. Stalinit kryente një rol pararojë në luftën për socializëm dhe për mbrojtjen e të drejtave të popujve;

— për sigurimin e një paqeje botërore të shëndoshë mbi bazën e luftës së papajtueshme kundër imperializmit dhe kundër gjithë shërbëtorëve të tij të çdo kallëpi.

Në mënyrë të veçantë materialet e vëllimit përqëndrohen në ruajtjen dhe forcimin e unitetit ideologjik dhe organizativ të Partisë, në ruajtjen e vijës politike dhe të veprimtarisë praktike të saj nga shtrembërimet dhe nga shkeljet me përmbajtje oportuniste ose sektare,

*për asgjësimin e çdo gjunjëzimi përpara presionit të fortë të armiqve të brendshëm e të jashtëm të klasës.*

*Ndër veprat që botohen në këtë libër një vend të veçantë zënë: Fjala në Plenumin V të KQ të PPSH (shkurt 1950) dhe Raporti në Konferencën II Nacionale të PPSH.*

FJALA PARA NXËNËSVE TË SHKOLLËS SË  
BASHKUAR «ENVER HOXHA» ME RASTIN  
E MBYLLJES SË KURSIT TË VITIT  
SHKOLLOR 1949

9 janar 1950

Shokë oficerë,

Me rastin e mbylljes së kursit të këtij viti shkollor ju përshëndes dhe ju uroj për përpjekjet që keni bërë dhe për zellin që keni treguar në mësim. Përpjekjet dhe zelli juaj pasqyrohen në rezultatet e kënaqshme që keni arritur. Përshëndes dhe përgëzoj njëkohësisht instruktorët dhe pedagogët tuaj, të cilët janë përpjekur dhe kanë kryer detyrat e tyre të rëndësishme dhe janë pjesëtarë të pandarë të këtyre sukseseve të arritura.

Sot, ju me plot të drejtë duhet ta ndjeni veten shumë të gëzuar, jo vetëm se e mbaruat me sukses këtë kurs, por sidomos se tani jeni në gjendje t'i shërbeni më mirë ushtrisë, popullit, Partisë, kampit të socializmit dhe të paqes, pse u armatosët me njohuritë më të gjera të shkencës dhe të artit të lavdishëm ushtarak stalinian, gjë që do t'ju shërbejë për të zgjeruar edhe më tej njohuritë tuaja në këtë fushë që e keni përqafuar

me gjithë shpirt dhe që e keni kuptuar se është një nga detyrat më të shenjta dhe një nga nderet më të mëdha të bësh pjesë në Ushtrinë tonë heroike Popullore dhe veçanërisht me qenë oficer i denjë i saj.

Misioni i oficerit të Ushtrisë sonë Popullore është i lartë, por detyrat dhe përgjegjësia janë të mëdha dhe të dyja shkojnë krahas. Të mendoni gjithnjë se ç'luftë të përgjakshme bëri populli ynë për të fituar lirinë e tij dhe për të thyer armiqtë e jashtëm dhe të brendshëm që shekuj me radhë e mbanin të skllavëruar. Populli ynë i mundi armiqtë dhe vendosi ligjin e tij, diktaturën e tij të demokracisë popullore. U arrit fitorja e madhe e popullit dhe këtë ja detyrojmë Partisë sonë heroike, që besnike e patundur e marksizëm-leninizmit, e Partisë Bolshevike dhe e Stalinit të madh, e ngriti në këmbë popullin tonë, i ndriçoi mendjen, i forcoi zemrën dhe besimin në vetëvete, e edukoi, e bashkoi dhe e udhëhoqi në rrugën e lavdishme të çlirimit dhe të socializmit; këtë fitore ja detyrojmë edhe ndihmës së Bashkimit Sovjetik, Stalinit të madh dhe fitores mbi hordhitë naziste të Ushtrisë së lavdishme Sovjetike, në shembullin dhe në gjurmat e së cilës eci me besnikëri të madhe Ushtria jonë Popullore.

Ushtria jonë është pjella e revolucionit popullor. Populli e krijoi atë, e rriti, e forcoi në beteja, ai e forcon dhe e modernizon dita-ditës dhe e konsideron si pjellën e tij më të dashur dhe më të mirë, pse e lindi dhe e rriti në kohën më të tmerrshme të shtërngatës dhe asaj i besoi misionin e rëndë që shpresat dhe aspiratat e popullit të realizoheshin. Dhe këto u realizuan. Ushtria është arma e fortë në duart e popullit dhe ajo çelënikoset

e modernizohet për të mbrojtur jetën e popullit tonë, fitoret e tija të tanishme dhe të ardhshme, për të mbrojtur paqen që kërcënohet nga luftëdashësit imperialistë amerikano-anglezë dhe neofashistët. Këtej rrjedh misioni i lartë i Ushtrisë sonë Popullore, detyrat e mëdha që ka çdo qytetar i Republikës sonë Popullore që kryen shërbimin ushtarak dhe përgjegjësia e kuadrove oficerë dhe nënoficerë që kanë për detyrë të drejtojnë, të mësojnë, të edukojnë, të modernizojnë Ushtrinë Popullore. Që t'i kryejnë si duhet këto detyra të rënda nënoficerët dhe oficerët duhet të duan ushtarin dhe ushtrinë si shpirtin e tyre dhe profesioni i tyre të bëhet për ta një pasion i madh. Ushtria duhet të jetë një vatrë e zjarritë patriotizmi.

Të gjithë ushtarakët tanë duhet të jenë vigjilentë për ta mbrojtur ushtrinë nga të gjitha tentativat e armikut që synojnë ta dobësojnë fuqinë e saj mbrojtëse. Ushtria jonë duhet të jetë vigjilente dhe kurdoherë e gatshme për të mbrojtur pavarësinë, lirinë dhe kufitë e vendit tonë. Imperialistët amerikano-anglezë dhe shërbëtorët e tyre rreth kufive tanë nuk i kanë hedhur armët dhe përgatitin një luftë të re botërore. Tradhëtarët e Beogradit, vegla të imperializmit, e kanë halë në sy popullin tonë dhe ushtrinë e tij. Prandaj duhet të forcojmë vigjilencën revolucionare kundër trockistëve të Beogradit, kundër monarko-fashistëve grekë dhe armiqve të tjerë, me qëllim që të godasim dhe të likuiojmë çdo përpjekje dhe tentativë të tyre për të dëmtuar interesat e popullit tonë, të kampit të socializmit dhe të paqes. Kudo dhe në çdo formë që të shfaqen tentativat e punës armiqësore të trockistëve e naciona-

listëve të Beogradit, Ushtria jonë Popullore duhet t'i dërmojë pa mëshirë.

Ushtria dhe sekretet e saj duhet të ruhen me vigjilencën më të madhe. Për këtë gjë duhet të forcohet puna politike në ushtri, të ngrihet niveli ideologjik i ushtarit, nënoficerit dhe oficerit, të zhvillohet dhe të forcohet kritika dhe autokritika bolshevike, të zbulohen dhe të goditen ku janë gabimet dhe të metat, të luftohet dhe të zhduket nga njerëzit e ushtrisë çdo shfaqje arrogance dhe mendjemadhësie, pse atje ku ekzistojnë këto, thotë shoku Stalin, atje ekziston hipokrizia, atje numërohet në vend dhe nuk ecet përpara. Shumë të këqia e kanë burimin në këto shfaqje. Të tilla shfaqje janë dukur në disa oficerë dhe nënoficerë, të cilët kanë hyrë kontrabandë në ushtrinë tonë. Këta njerëz janë tërhequr nga morali borgjez, si në jetën e tyre private ashtu dhe ushtarake, këta nuk kanë konceptin e vërtetë dhe të drejtë të nderit që karakterizon popullin tonë, të nderit dhe të respektit për tjetrin, për familjen dhe shoqërinë, nuk kanë të qartë konceptin mbi moralin proletar. Këta njerëz janë të huaj për ushtrinë dhe për shoqërinë socialiste që ndërtohet në vendin tonë, ata me qëndrime të tilla të dobëta nuk mund t'i shërbejnë atdheut dhe popullit, çdo gjëje të shenjtë të tyre. Në këta njerëz dhe në këto dobësi do të kapet me siguri armiku i jashtëm dhe armiku i klasës për të na dëmtuar dhe për të bërë punën e tij. Të jemi, pra, vigjilentë, për t'i zbuluar këto të meta dhe këta njerëz dhe të jemi të ashpër kundër tyre.

Armiku trembet si bisha nga zjarri përpara njerëzve të vendosur për çështjen e popullit, përpara njerëzve



të urtë dhe patriotë, përpara njerëzve të pastër dhe të thjeshtë. Armiku do të thyejë hundët përpara disiplinës së hekurt dhe të ndërgjegjshme që ekziston në ushtrinë tonë dhe që çdo ushtar, nënoficer dhe oficer duhet ta çelnikosë atë çdo ditë e në çdo veprim të tij.

Thesarët e moralit të lartë të popullit tonë duhet të ruhen të pastër në ushtrinë tonë. Duhet të ruhen dhe të zhvillohen traditat e lavdishme të Luftës nacional-çlirimtare të popullit tonë.

Për edukimin e shëndoshë dhe të plotë të ushtrisë sonë, është e nevojshme që oficerët e nënoficerët të pajisen vetë në radhë të parë me shkencën marksiste-leniniste dhe me artin e lavdishëm ushtarak stalinian. Ajo ushtri që përvetëson këtë shkencë dhe këtë art ushtarak është ushtri e shëndoshë dhe e pamposhtur. Shkencat marksiste-leniniste dhe arti ushtarak stalinian janë vënë në dispozicion të ushtrisë sonë dhe kjo i përvetëson ato me etje. Kjo është arsyeja që ushtria jonë është e fortë dhe ecën përpara në rrugën e modernizimit. Një gjë e tillë tregon nga ana tjetër dashurinë e madhe që ushqen ushtari, nënoficeri dhe oficeri i Ushtrisë sonë Popullore për Bashkimin e lavdishëm Sovjetik dhe Stalinin e madh. Me emrin e Stalinit në gojë luftuan heroikisht partizanët tanë, me emrin e Stalinit dhe me mësimet e tij po çelnikoset dhe modernizohet ushtria e Republikës sonë Popullore.

Ushtria jonë Popullore, e udhëhequr nga Partia jonë heroike e Punës dhe e mburjtur prej saj me ndjenja të thella të dashurisë për popull e atdhe dhe të internacionalizmit proletar, do të ecë me siguri përpara.

Ju përgëzoj edhe një herë shokë oficerë dhe ju uroj  
suksese në kryerjen e detyrave tuaja që ju presin.

Rroftë populli ynë dhe udhëheqësja e tij heroike  
Partia e Punës!

Rroftë ushtria jonë heroike!

*Botuar për herë të parë  
në revistën «Propagandist  
dhe agjikator»,  
Nr. 1, 1950*

*Botohet sipas revistës  
«Propagandist dhe agjikator»,  
Nr. 1, 1950, me ndonjë shkurtim*

## MBI ANALIZËN E PUNËS VJETORE TË ORGANIZATËS SË PARTISË TË TIRANËS

*Nga diskutimi në mbledhjen e Sekretariatit të  
KQ të PPSH<sup>1</sup>*

9 janar 1950

Shokëf folën mjaft për organizatën e Partisë të Tiranës. Tani edhe unë dëshiroj të theksoj se ajo duhet të forcohet më tej, mbasi këtu ka mundësi të mëdha dhe kuadro të lartë, të shumtë e të ngritur nga çdo pikëpamje, që kanë kaluar nga shkolla e luftës, si dhe nga ajo e rindërtimit dhe e ndërtimit të vendit. Në Tiranë ku, përveç zgjerimit të mëtejshëm të industrisë ekzistuese, shtrohet detyra për ngritjen e fabrikave të reja, të mos kemi frikë të pranojmë në Parti elementë punëtorë jo vetëm nga emri, po të jenë dhe të vendosur deri në fund për çështjen e Partisë, të ngrihen në përgjegjësi elementë të rinj, të cilëve t'u jepet më shumë përgjegjësi dhe besim. Kjo të mos mbetet një gjë for-

---

<sup>1</sup> Në këtë mbledhje u shqyrtua «Raporti vjetor mbi organizatën e Partisë të Tiranës», paraqitur nga Komiteti i Partisë të Tiranës.

male, po të vihet konkretisht në jetë. Prandaj, të marrë fund praktika jonë e deritanishme që, kur është çështja për të vendosur në një vend një kuadër, për shembull për të udhëhequr punën e Komitetit të Rinisë për Tiranën, i vihet rrotull një njeriu, në vend që të bëhen përpjekje për të ngritur njerëz nga masat, sidomos nga radhët e punëtorëve. Të metën që u vijmë rrotull disa njerëzve dhe nuk kemi sa duhet besim në të rinjtë, e kemi mjaft të theksuar. Kjo përbën një pengesë të madhe për forcimin e Partisë. Prandaj këtë çështje ta kemi kujdes jo vetëm në drejtim të pranimeve për në Parti, por edhe në ngritjen në përgjegjësi të elementit të ri të shëndoshë.

Vigjilenca e Partisë në çështjet politike duhet të jetë e madhe. Në organizatën e Partisë të Tiranës ka përparime në këtë drejtim, por duke pasur parasysh se në Tiranë ka kuadro të një niveli më të ngritur nga ata të rretheve të tjera, vigjilenca e kësaj organizate duhej të ishte në një shkallë më të lartë kundër elementit sabotator dhe armik, si jashtë ashtu edhe brenda Partisë dhe organizata duhet të jetë më e gjallë e më luftarake. Të kemi kurdoherë parasysh se elementi armik brenda Partisë nuk fle. Në Plenumin XI të KQ të PPSH ne i goditëm disa njerëz, por për disa të tjerë, si kurdoherë, nuk vepruam «me sopatë», po u mjaftuam vetëm me këshillime. Me një pjesë të elementëve të kësaj kategorie kemi pasur rezultate, gjë që vërtetohet me faktin se mjaft prej tyre gjatë kësaj kohe janë ndrequr. Ndaj elementit të sëmurë që në momentet e para duhet zbatuar taktika e diferencimit të tyre, duke goditur të pashërueshmit, kurse të tjerët të ndihmohen që të ecin

në rrugën e Partisë, mirëpo kur shihet se në mes tyre ka nga ata që, me gjithë ndihmën e dhënë nuk duan të vënë mend, po qëndrojnë në pozitat e vjetra, atëhere të goditen edhe këta. Duhet pasur parasysh se të tillë elementë, siç i keni parë vetë, janë aktivë, prandaj vigjilenca e organizatës së Tiranës të shtohet akoma më shumë në drejtim të tyre. Organizata e Tiranës duhet të thellohet më shumë në njohjen e gjendjes.

Ka nga këta njerëz të sëmurë që mund të bëjnë një autokritikë të përciptë, sa për të na hedhur hi syve, por që në fakt përkrahin njëri-tjetrin në baza jo të shëndosha. Ç'karakter ka grupi i vogël i atyre 5-6 vetëve që janë në Ministrinë e Shëndetësisë duhet të dihet mirë nga byroja e Komitetit të Partisë e rrethit të Tiranës. Nuk është gjë e rastit që këta njerëz janë mbledhur në këtë dikaster pas Kongresit I të PKSH. Aty ka edhe elementë të tjerë të vjetër të sëmurë, të cilët tani mund të na hiqen si të persekutuar, po që janë në opozitë me Partinë. Këta elementë e fshehin veprimtarinë e tyre, mirëpo me zhvillimin e luftës së klasave, ata nxjerrin herë pas here kokën. Prandaj të mos merren të shkëputura faktet. Drejtuesit e Komitetit të Partisë të rrethit të Tiranës, të mbledhin dhe të shohin me kujdesin më të madh gjithë veprimtarinë e këtyre njerëzve, për të parë nëse gabimet dhe shfaqjet e tyre janë të rastit, kanë një vazhdimësi, apo rrjedhin nga disa të meta që ekzistojnë te ata, të ndiqet me kujdes nëse mendimet e tyre janë të izoluar, apo shfaqen edhe te njerëz të tjerë. Qëllimi i gjithë këtij kujdesi është që t'i shërojmë ata që janë për t'u shëruar nga pikëpamjet dhe gabimet që kanë dhe të spastrojmë

Partinë nga elementët që s'duhet të qëndrojnë në radhët e saja.

Në Tiranë ka shfaqje të tilla, prandaj, siç tha edhe shoku Mehmet, Komiteti i Partisë i rrethit të Tiranës duhet të bëjë përpjekje për ta drejtuar mirë politikisht këtë punë dhe për ta përmbushur plotësisht detyrën, duhet të forcojë akoma më shumë punën organizative, pse duke e ndarë dhe duke e organizuar më mirë atë, ai do t'i kryejë si duhet të gjitha detyrat që i janë ngarkuar.

Duhet bërë përpjekje që vendimet e Partisë sonë të vihen në jetë dhe organizatat bazë të bëhen luftëtare të paepura në këtë drejtim. Ne nuk duhet të mjaftohemi që atje të çohet vetëm opinioni i udhëheqjes, por për zgjidhjen e problemeve të ndryshme që dalin përpara, është e domosdoshme të merret parasysh e të inkurajohet edhe opinioni i organizatës bazë. Ne duhet të na preokupojë fakti që në organizatat tona bazë diskutohet pak, atje flasin gjithnjë më shumë shokët që kanë poste drejtuese në Parti dhe në pushtet. Duhet kuptuar mirë se në organizatën bazë të gjithë pa përjashtim janë njëlloj përpara Partisë, kanë të drejtë të flasin, të japin mendime dhe të kritikojnë.

Në organizatat tona bazë duhet të ashpërsohet lufta kundër elementit të sëmurë që shfaq pikëpamje të gabuara. Format e punës së organizatës bazë nuk duhet të jenë shumë të prera. Vërtet rregulli është rregull, por kur shihet se njëri cënon vijën e Partisë, anëtari i thjeshtë i Partisë, kur është nevoja, përse të mos lejohet të flasë qoftë edhe jashtë rregullit? Na intereson shumë të inkurajohet e të zhvillohet mendimi e inisiativa e bazës, sepse sa e njohin komunistët e organizatës

bazë një element të sëmurë, nuk mund ta njohin drejtuesit. Anëtarët e thjeshtë të Partisë e njohin mirë njëri-tjetrin, si në jetë edhe në punë, prandaj ata duhet të inkurajohen që të thonë përpara organizatës të gjitha ato që dinë, pse kështu ndihmojnë Partinë. Duhet të punohet që të zhvillohet një luftë e fortë kundër elementit jo të mirë, ndryshe mbledhjet e organizatave bazë do të jenë të fjetura. Pa këtë luftë, qoftë udhëheqja qoftë sekretari i organizatës bazë nuk do ta bëjnë dot punën. Jashtë organizatave bazë pëshpëritet mjaft, kjo ndodh për arsye se ka organizatë ku anëtarët e Partisë nuk gjejnë terrenin e përshtatshëm për të shprehur lirisht mendimet e tyre që kanë për punën. Në këtë drejtim, në punën me njerëzit, drejtuesit duhet të kenë takt, të jenë të zgjuar dhe në gjendje të kuptojnë shpejt se kush punon drejt e kush shtërmbër, kush me qëllime të mira dhe kush me qëllime të këqia. E them këtë se ka njerëz në organizatat bazë që përpiqen të krijojnë përshtypjen sikur janë më të mirët nga të gjithë. Mirëpo nuk është kështu, sepse kur arrin që ndonjë njeri i tillë të zbulohet si njeri jo i mirë, po të mos kenë qenë vigjilentë ndaj tij të gjithë anëtarët e organizatës bazë, mund të çuditen si ky njeri paska qenë kështu. Kjo ndodh atje ku nuk bëhet një punë e mirë partie që më përpara. Prandaj drejtuesit të kenë kujdes që ta forcojnë organizatën bazë, të inkurajohet e të zhvillohet atje kritika dhe autokritika dhe në këto drejtime të jemi ne në radhë të parë që të japim shembullin kur kemi gabime, duke mos pasur frikë të bëjmë kritikë dhe autokritikë të hapët. Kur kritika është me vend, të vlerësohet drejt, përkundrazi, kur është pa vend, të korrigohet. Në jetë

mund të ndodhë shumë herë që edhe një anëtar i Komitetit Qendror, bile edhe një forum, mund të gabojë. Në këtë rast kritika duhet të inkurajohet, po kritika e bërë duhet parë dhe analizuar objektivisht.

Për çdo gabim që bën një anëtar partie, organizata duhet të ndalet për ta sqaruar mirë atë shok dhe pastaj ta ndjekë në punë e sipër nëse ky shok po përmirësohet. Kritika dhe autokritika të konkretizohen si duhet. Në organizatën bazë të bëhen diskutime të forta, të shpartallohen miqësitë dhe simpatitë e sëmura dhe çdo gjë të vihet në rrugën e drejtë të Partisë, pse ato janë burim grupesh edhe fraksionesh. Shfaqje të tilla në organizatën e Tiranës nuk janë akoma të konkretizuara, por detyra e saj është që ta njohë dhe ta sqarojë situatën. Prandaj edhe zgjedhjet për komitetin e ri është e domosdoshme të bëhen mbasi të sqarohen çështjet e të gjitha dobësitë që u vunë në dukje. Po nuk u bë i qartë qëndrimi i këtyre njerëzve që hiqen si të zot dhe të zgjuar, por që me punën e tyre, në rast se nuk do të njihen nga Partia, mund të arrijnë të dalin deri në udhëheqje, zgjedhjet nuk mund të bëhen në nivelin e duhur.

Prandaj mendoj se është e nevojshme të bëhet një punë më e madhe agjitative, më shumë konferenca me elementin intelektual, sidomos me ata që kanë kulturë borgjeze. Por nga Partia duhet të tregohet kujdes edhe për shokun që do të zhvillojë konferencën. Ky jo vetëm që duhet të përgatitet sa më mirë, por duhet të ketë edhe një farë kulture, që të mos mbetet në baltë, kur t'i drejtohen pyetje nga intelektualët. Përveç kësaj, duhet pasur parasysh se ka elementë intelektualë, që nuk janë armiq, por ngaqë janë të brumosur me pikë-



pamje të gabuara, diskutojnë çështje që janë në kundërshtim me vijën e Partisë. Prandaj, shokët që do të punojnë me ta, të përgatiten mirë për temën që do të trajtojnë dhe për këtë është mirë të zgjidhen nga ata që kanë një shkallë kulture pak a shumë të mjaftueshme për të qenë në gjendje t'ua konkretizojnë çështjet më mirë. Partia të mos kufizohet duke bërë vetëm konferenca teorike me ta, po edhe konferenca letrare, shkencore, mbi artin etj. që të ngjallin interesim. Në këtë drejtim të përfitohet sa më shumë nga eksperiencia e mirë që kemi fituar. Me këtë eksperiencë dhe me ideologjinë e shkencës marksiste-leniniste duhet t'i pajisim ne intelektualët tanë. Për këtë është e domosdoshme të bëjmë edhe ne vetë, në radhë të parë, një luftë të vazhdueshme për t'u pajisur sa më shumë me shkencën marksiste-leniniste.

Një problem tjetër me shumë rëndësi që duhet ta studjojmë mirë është edukimi i rinisë. Lidhur me këtë, del nevoja të vëmë në rrugë çështjen që shokët e Komitetit Qendror të Rinisë të kenë kontakte të rregullta me Komitetin Qendror të Partisë. Rinia është shpresa dhe mbështetja kryesore e Partisë, prandaj edukimin e saj ta shohim me shumë kujdes dhe të mos lejojmë që organizata e saj të ketë dobësi në punën për edukimin e brezit të ri.

*Botohet për herë të parë sipas  
tekstit të nxjerrë nga proces-  
verbali i mbledhjes së  
Sekretariatit të KQ  
të PPSH që gjendet  
në AQP*

## MBI RAJONIZIMIN E KULTURAVE BUJQËSORE

*Nga diskutimi në mbledhjen e përbashkët të Byrosë  
Politike të KQ të PPSH dhe të Qeverisë së RPSH<sup>1</sup>*

2 shkurt 1950

Një problem me rëndësi për ne tani është çështja e rajonizimit të kulturave bujqësore. Për këtë qëllim është e domosdoshme që organet shtetërore përkatëse të studjojnë mirë shifrat e kulturave që do të mbillen, çmimet e grumbullimit të tyre dhe stimulacionet që ne do të japim për to, sidomos për pambukun dhe panxharin e sheqerit, të cilat janë dy nga kulturat më të rëndësishme për industrinë tonë të ardhshme. Mbjelljen e tyre ne duhet ta favorizojmë dhe ta inkurajojmë, duke ju siguruar prodhuesve bukën. Këto favorizime duhet të jenë më të mëdha sidomos tani në fillim derisa fshatarët të kuptojnë mirë nga eksperiencia e tyre përfitimet që do të kenë nga mbjellja e këtyre kulturave. Prandaj çështjen e kontratave që do të përfundojmë me

---

<sup>1</sup> Në këtë mbledhje u diskutua mbi mbjelljet e pranverës të vitit 1950. Duke folur për këtë problem, shoku Enver Hoxha u ndal edhe në çështjen e rajonizimit të kulturave bujqësore.

fshatarët, të cilët do të mbjellin këto dy kultura, duhet ta rishikojmë me kujdesin më të madh.

Është e vërtetë se agjitacioni dhe propaganda për ta bindur fshatarin në mbjelljen e këtyre kulturave janë shumë të rëndësishme, por kjo punë do të vazhdojë duke u shoqëruar me favorizime konkrete për fshatarët, pse neve na duhet që t'i mbjellim patjetër këto kultura. Prandaj në urdhëresën «Mbi zhvillimin e mbjelljeve dhe sistemin e grumbullimeve të bimëve industriale për vitin 1950» të parashihen diçka më shumë stimulacione ose favorizime të tjera për mbjelljen e pambukut dhe të panxharit të sheqerit e të lihet të kuptohet se këto dy kultura në rajonet më bujqësore do të favorizohen nga shteti. Gjithashtu të nxiten fshatarët, që të punojnë tokat me traktorë duke u bërë edhe favorizime në lidhje me çmimet e punimeve. Edhe banka mund të japë më tepër kredi për mbjelljen e këtyre bimëve. Partia të bëjë përpjekje që të shtohet sipërfaqja që do të mbillet me këto bimë. Të përdoret plehu kimik në sasi të mjaftueshme, pse pa të nuk rritet pambuku dhe panxhari i sheqerit.

Përsa i përket ndjekjes së realizimit të planit që nga mbjelljet deri në korrjet, duhet të interesohen teknikët e bujqësisë dhe jo punonjësit e grumbullimit. Këta të fundit mund dhe duhet të shkojnë në fshat, t'u flasin fshatarëve dhe t'i nxitin ata që të punojnë, pse sa më shumë prodhime që të marrin nga këto kultura, aq më tepër favorizime do të kenë nga shteti, aq më mirë do të jetë për jetesën e tyre. Teknikët e bujqësisë në këtë drejtim duhet të ndjejnë përgjegjësinë që kanë në tërë procesin e punës, që nga punimet për mbje-

Llje e shërbimet e deri-te marrja e prodhimeve të larta. Gjithkush ta kryejë mirë detyrën e tij. Edhe Komiteti Qendror po mendon të dërgojë të deleguar, pse ashtu si grumbullimet e prodhimeve bujqësore e blegtorale edhe mbjelljet kanë shumë rëndësi. Në mbledhjet që zhvillohen, sidomos me fshatarët, të venë e të flasin edhe anëtarë të KQ e të qeverisë, të cilët duhet të sqarrojnë politikën e Partisë dhe të qeverisë në sektorin e bujqësisë. Kulaku do të përpiqet të na pengojë që kjo politikë të mos zbatohet, që mbjelljet e bimëve industriale sipas rajonizimit të mos realizohen, prandaj ne duhet të jemi vigjilentë, t'i zbulojmë parullat e tija armiqësore e të zhvillojmë si duhet luftën e klasave në fshat. Përgjegjja më e mirë, që do t'i japim armikut të klasës, është që të realizojmë planin në të gjitha kulturat industriale, po në radhë të parë në pambuk e në panxhar sheqeri.

*Botohet për herë të parë sipas  
tekstit të nxjerrë nga proces-  
verbali i mbledhjes së për-  
bashkët të Byrosë Politike  
të KQ të PPSH dhe të  
Qeverisë së RPSH që  
gjendet në AQP*

## **MBI FORCIMIN E MËTEJSHËM TË PARTISË DHE TË LIDHJEVE TË SAJA ME MASAT**

*Nga diskutimi në mbledhjen e Byrosë Politike të  
KQ të PPSH<sup>1</sup>*

**13 shkurt. 1950**

Në këtë mbledhje të Byrosë Politike u ngritën mjaft probleme, të cilat kërkojnë zgjidhje. Unë do të theksoja këtu dy çështje: forcimin e mëtejshëm të Partisë sonë dhe të lidhjeve të saja me masat. Këto janë dy gjëra kryesore, nga të cilat varet shumë gjithë sukcesi i punës sonë. Po të çalojë puna e Partisë dhe të dobësohen lidhjet e saja me masat, atëhere do të çalojnë të gjithë sektorët e jetës sonë.

Partia jonë po forcohet dita-ditës, po jo ashtu siç dëshirojmë. Jeta e saj e brendshme nuk është akoma në

---

<sup>1</sup> Ky diskutim u mbajt në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të PPSH ku u analizua aktiviteti i Partisë gjatë vitit 1949 në të gjithë sektorët e saj sipas raporteve të paraqitura nga drejtoritë e Komitetit Qendror. U konstatua se kthcsa e Partisë pas Kongresit I po realizohej me sukses, megjithatë u shtruan detyra të rëndësishme për ta forcuar më tej kudo punën e Partisë.

lartësinë e duhur, nuk respektohen me rigorozitet të madh rregullat e Statutit të Partisë. Këto rregulla nuk zbatohen dhe nuk janë kuptuar si duhet, si armë të shëndosha për ta forcuar Partinë, për të zhdukur sëmundjet që ekzistojnë aty-këtu në njerëzit e saj, sëmundje të cilat i vijnë nga shtresat që e përbëjnë Partinë si dhe nga presioni i borgjezisë mbi të. Pa i përdorur mirë këto armë nuk mund të forcohet Partia.

Me gjithë përparimet që janë bërë, jeta e brendshme e Partisë në disa organizata është akoma e fjetur, mbledhjet bëhen sa për të kaluar radhën, disiplina, kritika dhe autokritika nuk janë në lartësinë e duhur, po ashtu edhe konspiracioni e ruajtja e sekreteve të Partisë e të shtetit. Në këto shkaqe e kanë burimin të gjitha të metat që vihen re, si lëshime, abuzime, vjedhje, mungesë kontrolli etj., që shfaqen ku më shumë e ku më pak e sidomos në disa sektorë ekonomikë. Në rast se organizatat e Partisë të këtyre sektorëve vihen në pozita më luftarake për t'i luftuar këto të meta, atëhere këto do të zhduken.

Përsa i përket punës së Partisë në fshat, nuk është çështja të përcaktojmë vetëm se kush është kulak. Kryesore është të forcojmë dhe të zhvillojmë luftën e klasave. Pa e kuptuar mirë Partia këtë çështje, lufta kundër kulakut nuk mund të bëhet si duhet. Po të zhvillohet si duhet kjo luftë, do të dalë në shesh edhe kush është kulaku. Prandaj të mos e kërkojmë të keqen në përcaktimin e kulakut, pse këtë gjë e ka bërë gjeniu i revolucionit proletar, Lenini, por ne duhet të kuptojmë drejt zhvillimin e luftës së klasave. Këtëj del se duhet të përforcohet lufta e klasave në fshat. Në rast se Partia

në fshat nuk mobilizohet për të zhvilluar luftën e klasave, nuk ka si bëhet përcaktimi i kulakut në praktikë. Pa i bërë këto nuk kemi kryer as detyrën për forcimin e Partisë dhe ekziston rreziku që në radhët e saja të hyjnë edhe njerëz që janë të shtresave borgjeze. Elementët borgjezë, kulakë, agjentë dhe spiunë kanë për qëllim dhe kërkojnë të futen në Parti për ta goditur këtë nga brenda. Këta njerëz duhet të luftohen e të demaskohen dhe kjo bëhet vetëm kur ta bëjmë Partinë sa më luftarake. Eksperiënca jonë dhe shembujt që kemi, tregojnë se disa njerëz, të cilët punojnë në vende me rëndësi, kur venë poshtë për të shtruar çështjet e Partisë duke mos i kuptuar mirë problemet që ka baza, bëjnë gabime. Kështu kanë vepruar ata që ka kritikuar Partia në letrat e ndryshme të saja, drejtuar organizatave. Njerëz të tillë, të sëmurë, shohin qimen në syrin e tjetrit, po nuk vënë re trafirin në sytë e tyre. Kundër këtyre sëmundjeve ne duhet të luftojmë dhe të mos na zërë në asnjë moment gjumi, pse Partia vërtet është forcuar, por duhet forcuar akoma më shumë që të bëhet më luftarake dhe më revolucionare.

Partia nuk mund t'i realizojë kurrë si duhet detyrat e saja të mëdha si udhëheqëse, në rast se nuk është e fortë dhe në qoftë se, për këtë, nuk punojnë të gjithë. Por ka mjaft shokë, të cilët janë bërë specialistë për çështjet e grumbullimit e të prodhimeve bujqësore e blegtorale. Sigurisht, me këtë çështje, do të merret i madh dhe i vogël, por shoku Mehmet Shehu, duke diskutuar këtu, tha me të drejtë se për grumbullimin janë të ngarkuar njerëz që veprojnë në rrugë shtetërore. Këta duhet të punojnë dhjetë herë më shumë dhe jo ta

bëjë këtë punë Partia. Tendencia, që për çdo gjë dhe në çdo moment të mobilizohet Partia, duket mjaft e theksuar, sidomos për grumbullimet. Prandaj duhet të kuptohen mirë funksionet e Partisë dhe të shtetit, pse këtej rrjedhin gabime të mëdha parimore. Ky problem duhet të kuptohet mirë, si nga anëtarët e Partisë, ashtu dhe nga njerëzit pa parti. Të gjithë duhet të kuptojnë rolin drejtues të Partisë, pse ka raste që disa shokë, bile edhe me funksione drejtuese në pushtet, nuk e mbajnë mirë parasysh rolin e Partisë. Një njeri i tillë nuk është komunist i mirë. Të kuptohet mirë se Partia do të kontrollojë çdo gjë, por kjo nuk do të thotë që ajo të bëjë punët që u takojnë organeve shtetërore. Për hartimin e planit në një ndërmarrje ose në një kombinat, Partia duhet ta thotë fjalën e saj, sepse kur vendoset për planin, Partia do të udhëheqë zbatimin e tij. Kjo ka mjaft rëndësi. Po të japë Partia shembullin e keq në këtë drejtim edhe masa do të bjerë në ato pozita dhe nuk do të shpëtojë nga gabimet. Të metat që vihen re në punën e pushtetit e kanë burimin në dobësitë e drejtimit nga ana e Partisë. Le të marrim një nga këto të meta që mund të bëhet një sëmundje e rrezikshme. A ka te ne burokratizëm? Po, ka, bile, në gjithë Partinë duke filluar nga baza dhe deri në drejtoritë e aparatit të KQ. Këtu u tha se nga qendra venë shumë letra dhe udhëzime poshtë, disa prej atyre flasin dhe për burokratizmin, po në praktikë nuk bëhet sa duhet për t'i luftuar shfaqjet e tija, prandaj duhet të luftohet kundër këtyre shfaqjeve, të cilat e fishkin Partinë, e pengojnë atë që të jetë e fortë, e gjallë, revolucionare.

Një çështje tjetër me rëndësi është forcimi i lidhje-



ve të Partisë me masat. Në këtë çështje të mos harrojmë kurrë mësimet e Leninit e të Stalinit. Dhe nëse ne nuk jemi akoma aq të fortë nga pikëpamja organizative, për të cilën fola më sipër, kjo vjen edhe nga mungesa e kujdesit tonë për të çelnikosur lidhjet me masat.

Në punën për forcimin e pushtetit ne akoma kemi mjaft dobësi. Atë ne nuk e kemi demokratizuar akoma sa duhet. Kontrolli i masave të popullit mbi organet e pushtetit nuk është akoma në lartësinë e nevojshme. Kjo bën që organe të pushtetit të konsiderohen nga populli vetëm ata persona që punojnë në organet ekzekutive dhe që marrin rrogë. Duke u nisur nga ky mendim i gabuar, këshillat popullore të fshatit, ato të lokalitetit ose ato të rretheve kanë mbetur gati formale. Edhe në rast se tani kanë filluar të bëhen disa mbledhje, në të shumtën e rasteve ato janë karakterizuar nga një formalizëm i theksuar. Që të luftohet në praktikë ky formalizëm, këshillat duhet të dalin përpara masës së popullit dhe të japin llogari. Popullit t'i lihet e drejta e fjalës dhe e kritikës dhe në këto mbledhje anëtarët e Partisë që punojnë në këshillat popullore, të bëjnë kritikën e punës së tyre, të njohin gabimet dhe të thonë çfarë kanë kryer e çfarë nuk kanë kryer; këto populli duhet t'i dijë dhe të mos lëmë rast që armiku të spekulojë me dobësitë e disa njerëzve të pushtetit për të bërë propagandën e tij helmuese. Kjo do të bëjë që populli të lidhet më shumë me pushtetin e tij. Po nuk u bë një gjë e tillë, atëherë ekziston rreziku që pushteti ynë të kthehet nga një pushtet popullor, në një pushtet burokratik, i ndarë nga populli.

Një tendencë e rrezikshme burokratike është edhe

shkëputja e lidhjeve të Partisë me organizatën e Frontit; të cilën disa shokë nuk e aktivizojnë sa duhet. Si duket, këta shokë nuk e ndjejnë nevojën e mobilizimit të masave të gjera të popullit për zgjidhjen e problemeve të ndryshme. Ata shohin vetëm çështjet e zyrës, shkresat dhe qëndrojnë larg nga populli. Organizata e Frontit që ka krijuar Partia, ka një kuptim të madh. Ne jemi akoma larg nga puna që kërkohet të bëhet për forcimin e kësaj organizate dhe kjo duhet të na merakosë. Duke aktivizuar organizatën e madhe të Frontit, ne forcojmë lidhjet e Partisë me masat e gjera të popullit. Po kështu duhet të na preokupojë edhe çështja e forcimit të organizatave të tjera të masave siç është ajo e gruas, e bashkimeve profesionale dhe sidomos ajo e rinisë. Unë jam i mendimit se puna në organizatën e rinisë duhet të përmirësohet akoma më shumë. Organizata e rinisë ka disa dobësi në udhëheqjen e vet dhe në drejtimin e saj nga Partia. Rinia është po ajo që ka qenë, bile ajo ka ecur më përpara, por vrullit të saj nuk po i përgjigjen si duhet organet që e drejtojnë. Prandaj këtë ne duhet ta analizojmë mirë, pse është një çështje e rëndësishme. Në organet e rinisë ka mjaft burokratizëm, kundër të cilit ne duhet të luftojmë që të mos frenohet gjallëria e rinisë, sepse rinia është shpresa e Partisë, burimi i forcave të saja.

Problemi i forcimit të organizatës së bashkimeve profesionale është gjithashtu me shumë rëndësi, pse ka lidhje me edukimin e klasës sonë punëtore dhe me zhvillimin ekonomik të vendit tonë. Tani duhet të interesohe mi më shumë për këtë organizatë luftarake të klasës punëtore, që ajo të veprojë si duhet për eduki-

min dhe mobilizimin e klasës punëtore në realizimin e planit të shtetit. Ne kemi akoma vështirësi në punën me këtë organizatë, të cilat me një punë më të mirë mund t'i kapërcejmë. Prandaj problemet dhe detyrat e bashkimeve profesionale duhet t'i shohim me një sy më objektiv dhe po të jetë e nevojshme t'i shqyrtojmë edhe në Byronë Politike. Të gjithë shokët e Byrosë Politike dhe të qeverisë të ndihmojnë për zgjidhjen e problemeve që i dalin kësaj organizate. Që tani të mendojmë se si do t'i kalojnë punëtorët lejet vjetore, pse sa më mirë të pushojnë ata, aq më të fortë do të bëhen për të realizuar detyrat e mëdha të planit që kemi përpara. Ministria e Industrisë të marrë masa që të rinjve, që venë për të punuar, t'u sigurojë kondita të përshtatshme pune e jetese e jo t'i lëjë të flenë jashtë siç ngjau me ata të tunelit të Bishqemit.

Puna në sektorin e agjitacionit e të propagandës ka shkuar përpara, po ka edhe mjaft të meta. Por mendoj se dhe Byroja Politike nuk është preokupuar sa duhet që ta ndihmojë me vërejtje e këshilla këtë sektor, prandaj këtu kemi gabime e duhet të bëjmë autokritikë.

Të marrim çështjen e letërsisë dhe të shkrimtarëve. Nuk është e mjaftueshme që ne vetëm të bisdojmë me ta. Problemi nuk duhet të mbetet me kaq. Kjo kërkon që të shtrohet dhe të analizohet mirë, sepse shkrimtarët nuk shkruajnë sa duhet. Kjo nuk rrjedh vetëm pse ata përtojnë ose s'gjejnë kohë të shkruajnë dhe ne në këtë rast të rrimë e t'u qajmë hallin, por të mendojmë që t'i frymëzojmë, t'i orientojmë e t'i ndihmojmë konkretisht derisa ata të shkruajnë, kështu letërsia jonë do të futet edhe më mirë në rrugë të mbarë.

Në Drejtorinë e bujqësisë të aparatit të Komitetit Qendror duhet të punohet më shumë dhe më mirë. Këtu duhet të ndryshojë metoda e punës, drejtoria të mos kthehet në një zyrë statistikash, por ajo të studjojë probleme dhe të kontrollojë zbatimin e vendimeve të Komitetit Qendror për bujqësinë.

Këtu doli edhe çështja e praktikizmit që mbisundon në punën e shokëve që drejtojnë punën e Partisë. Shokët tanë nuk arrijnë dot të nxjerrin konkluzione nga puna e tyre. Ata nuk dallojnë dot se cilat janë problemet më të rëndësishme që duhen ndjekur. Për këtë gjë ne duhet t'i bëjmë ata të mësohen t'i zgjidhin mirë problemet dhe t'i propozohen Komitetit Qendror çështje që kërkojnë zgjidhje. Prandaj t'i orientojmë shokët të nxjerrin konkluzione nga puna dhe eksperiencia e tyre. Kjo kërkon që të përmirësojmë punën e Partisë me kuadrin, për edukimin dhe ngritjen e nivelit të tyre. Për këtë qëllim ne do të krijojmë edhe kurse për përgatitjen e kuadrove. Por për këtë duhet të mendojnë vetë edhe ndërmarrjet, dikasteret dhe organizatat e masave. Çështja e përgatitjes, e edukimit dhe e ngritjes së nivelit të kuadrove është çështje e të gjithëve dhe organizatat e Partisë të sektorëve të ndryshëm të mos presin vetëm nga Komiteti Qendror.

*Botohet për herë të parë sipas  
tekstit të nxjerrë nga proces-  
verbali i mbledhjes së Byrosë  
Politike të KQ të PPSH  
që gjendet në AQP*

# FJALA NË PLENUMIN V TË KOMITETIT QENDROR TË PARTISË SË PUNËS TË SHQIPËRISË MBI DISA ÇËSHTJE ORGANIZATIVE TË PARTISË

20 shkurt 1950

Jam i ngarkuar nga ana e Byrosë Politike të Komitetit Qendror që t'i parashtoj Plenumit V të Komitetit Qendror dy çështje me rëndësi të madhe organizative për Partinë tonë. Çështja e parë ka të bëjë me ekzistencën brenda në Parti të një grupi që ka zhvilluar një veprimtari shumë të sëmurë prej grupazhi, në të cilin kanë marrë pjesë edhe tre shokë të Komitetit Qendror, shokët Niazi Islami, Abedin Shehu dhe Shyqri Këllezi. Çështja e dytë ka të bëjë me shokun Nexhip Vinçani.

## I. — MBI VEPRIMTARINË E GRUPIT ANTIPARTI

Në fillim do të flas se si është zhvilluar veprimtaria e grupit antiparti që u diktua nga ana jonë dhe cilat janë faktet që disponon për këtë çështje Byroja Politike. Patjetër, unë nuk do të hyj në hollësira të mëdha, pse do të na duhej shumë kohë. Pas ekspozesë që do të bëj, propozoj që, më parë vetë këta shokë që përmenda, të

japin shpjegime për këtë veprimtari prapa shpinës së Partisë, pastaj të diskutojnë e të shfaqin mendimin e tyre gjithë anëtarët e plenumit.

Partia jonë ka kaluar situata të vështira gjatë gjithë jetës së saj. Ajo është kërcënuar vazhdimisht nga elementë armiq e të dyshimtë, nga elementë grupashë dhe më së fundi nga trockistët jugosllavë dhe agjentët e tyre në Partinë tonë si Koçi Xoxe etj. Por Partia jonë ka qenë gjithnjë në gjendje t'i mposhtë armiqtë e saj, të forcohet dhe të ecë kurdoherë përpara. Të gjitha ato që kanë ngjarë brenda Partisë duhej të ishin bërë mësim jo vetëm për anëtarët e Komitetit Qendror, po deri edhe për anëtarin më të thjeshtë të Partisë.

Partia jonë dhe Komiteti i saj Qendror kurdoherë kanë porositur se Partia duhet të mbrohet e të forcohet nga anëtarët e saj. Por që të jetë e fortë, Partia jonë duhet të spastrohet nga elementët e dyshimtë, karricristë e megalomanë, që janë futur në radhët e saja. Është e domosdoshme dhe jetike të rrënjosen thellë parimet e shëndosha të Partisë, të forcohet centralizmi demokratik, disiplina, konspiracioni, të shtohet gjithnjë e më tepër vigjilencë revolucionare, të ruhet Partia nga çdo armik dhe të zbatohen rregullat e Statutit të Partisë sonë, pse vetëm me këtë mënyrë ajo do të realizojë programin e vet dhe do të jetë në gjendje t'u bëjë ballë me sukses armiqtë e saj dhe të popullit tonë. Duke punuar kështu do të mundet që populli dhe atdheu ynë t'u shpëtojnë kërcënimeve dhe intrigave të imperialistëve si dhe të agjentëve të tyre, trockistëve jugosllavë e monarko-fashistëve grekë, kështu do të mbrohet Partia edhe nga presioni i borgjezisë së vendit që kërkon shka-

tërrimin e saj. Të gjitha këto detyra kanë qenë kurdoherë në plan të parë të Partisë sonë. Megjithatë në Partinë tonë janë shfaqur tendenca të sëmura, të cilat Komiteti Qendror i ka diktuar me kohë dhe ja ka bërë të ditur gjithë Partisë, me qëllim që ajo të spastrohej prej tyre, të mos përsëriteshin, përkundrazi kudo që të shiheshin shfaqje të tilla të luftoheshin me rreptësi. Këto përpjekje kanë bërë efektin e tyre te ata njerëz që kanë pasur kurdoherë dhe e kanë të patundur besimin dhe dashurinë për Partinë, kurse nuk kanë bërë efekt te ata pak njerëz që nuk kanë koncept të drejtë marksist-leninist për Partinë. Është edhe më e rrezikshme kur këto përpjekje nuk kanë bërë efekt te disa nga anëtarët e Komitetit Qendror. Kështu ka ngjarë edhe në lidhje me këtë grup që është krijuar në Partinë tonë.

Tani le të flasim pak se si u diktua kjo çështje.

Këtë punë grupazhi e diktoi vigjilenca e anëtarëve të Partisë sonë, nga poshtë deri lart, vigjilenca e atyre që kanë ndjekur kurdoherë me kujdes mësimet e saj, që kanë hequr vuajtjet, e Partisë, që asnjëherë s'i ka zënë gjumi dhe, kur ka qenë puna për të mbrojtur interesat e Partisë, e kanë sinjalizuar atë herë pas here për disa qëndrime që u janë dukur jo të rregullta. Shenjat e para të kësaj pune kanë qenë të dyshimta, por jo të dënueshme, pse udhëheqja ka synuar kurdoherë me urtësi të madhe që të mbrojë kuadrot, duke marrë parasysh sidomos nivelin e tyre të ulët ideologjik, mungesë kjo që disa njerëz i çon në gabime që mund të jenë të ndreqshme. Por në këtë drejtim nuk duhet me qenë aspak liberal. Kur vërtetohen gabime duhet të

kritikohen këto dhe, kur gabimet e shokëve nuk kritikohen, lihen në harresë, në këtë rast ka liberalizëm.

Kur ndodh që gabimet përsëriten, ato nuk mund të konsiderohen më të rastit; atëhere duhet të hapet defteri dhe të shihen të gjitha veprimet e vjetra të atij që vazhdon të gabojë. Defteri mund të mbyllet vetëm për ata që, mbasi e kanë bërë gabimin dhe e kanë kuptuar atë, vihen në rrugën e drejtë të Partisë.

Përshtypjet tona të para nga veprimtaria e këtij grupi lidhen me disa qëndrime që shikonim se nuk ishin në rregull. Le t'i marrim tani një nga një këto dhe t'i analizojmë.

Te Abedin Shehu kishim vënë re se delte kurdoherë me shprehjen «unë këtë do ta flas haptas», «po e them açik përpara Partisë» etj. Këto, po të merren vetëm si shprehje, janë në rregull. Po shprehje të tilla neve nuk na tingëllonin mirë, sidomos në mbledhjet e Komitetit Qendror. Pse thoshte shoku Abedin «do të flas haptas», a e kishte ndaluar vallë njeri, ndonjëherë, të mos fliste kështu? Kjo tregon, pra, se në ndërgjegjen e tij ka pasur diçka jo të shëndoshë që e mundonte e që nuk e thoshte dot ose donte të linte përshtypjen se vetëm ai fliste haptas, kurse të tjerët s'kishin «guximin» të flisnin si ai. Këtë përshtypje ne nuk e kemi lënë pa ja thënë shokut Abedin. Njëri prej sekretarëve të KQ të Partisë i ka thënë qartë atij se shprehje të tilla janë mbeturina të grupeve të vjetra.

Një çështje tjetër ka lidhje me mënyrën e shtrimit të problemeve në Komitetin Qendror nga ana e shokut Abedin. Në ato që ka shtruar ai në udhëheqje nuk ka pasur ndonjë gjë të theksuar të shtrembër. Të marrim



për shembull problemin e fuqisë punëtore që, siç e ka shtruar drejt dhe shoku Abedin, ka qenë një problem preokupant. Por në mënyrën e të shtruarit kishte diçka që në esencë nuk ishte aspak e drojtë. Të gjithë e dimë se Partia për vite të tëra e ka shtruar vazhdimisht problemin e fuqisë punëtore dhe ka bërë çmos për zgjidhjen e tij, ndërsa Abedini këtë çështje e ngriti sikur e shtroi ai për herë të parë në Parti, sikur ishte ai i pari që e vuri drejt këtë problem. Këto mënyra të stërholluara në shtrimin e këtij problemi nga ana e tij nuk mund të mos binin në sy. Por këto ishin çështje të veçuara e pa rëndësi, sa të arrihej në përfundimin për t'i bërë vërejtje për to. Edhe shokë të tjerë mundet të kenë të tilla të meta, po atyre nuk u bëhet vazhdimisht për çdo rast vërejtje. Por kur u shqyrtua gjithë veprimtaria e këtij shoku, u gjët se vërejtjet që i ishin bërë për mënyrën e shtrimit të problemeve kishin qenë të arësyeshme.

Shoku Niazi Islami ka dhënë më shumë shenja të sëmura e më të rrezikshme. Ai, megjithëse nga ana zyrtare ishte ndihmësministër, në fakt kryente funksionet e ministrit të komunikacioneve dhe ne ja kishim komunikuar këtë, prandaj edhe merrte pjesë në mbledhjet e Këshillit të Ministrave. Puna e Ministrisë së Komunikacioneve është ndjekur me kujdes nga ne dhe është parë se nuk ka shkuar mirë, bile sa më tepër kalonte koha, aq më shumë të meta të rënda konstatoheshin, të meta që atij i ishin vënë vazhdimisht në dukje. Por te shoku Niazi Islami vihej re një megalomani e jashtzakonshme, një kokëfortësi e çuditshme, si dhe mungesë e theksuar në respektimin e disiplinës

shtëtërore. Shoku Niazi Islami ka shkelur ligjet dhe urdhëresat e qeverisë; urdhërat e dërguara nga lart dhe të firmuara nga kryeministri ai i ka hedhur në shportë dhe ka vepruar sipas kokës së vet. Në mbledhjet që janë bërë për të diskutuar çështjen e organizimit të Portit të Durrësit, Niaziu jo vetëm ka dalë me pikëpamje të kundërta nga të gjithë shokët e tjerë, po ka mashtruar me plot kuptimin e fjalës dhe ka qenë shkaktar i një konflikti në mes tij dhe ministrit të tregëtisë, shokut Kiço Ngjela. Në këtë çështje mund të ketë edhe shumë gjëra të vogla, por pas shumë diskutimesh ky problem erdhi në qeveri për t'u zgjidhur. Kur u hap çështja e komisionit të portit, unë gjykova se atje ishte bërë një punë e sëmurë, pse kisha ndjekur me kujdes si ishte zhvilluar kjo çështje, sidomos nga ana e Niaziut. Duke parë se problemi nuk ishte zgjidhur, vendosëm që të shihej edhe një herë tjetër nga të dy palët. Mirëpo Niaziu u ngrit menjëherë dhe ju përgjegj kryeministrit se ai nuk bisedon më me Kiço Ngjelën. T'i përgjigjesh kryeministrit në këtë mënyrë nuk është një çështje temperamenti, prandaj në çast unë e vura në vend shokun Niazi Islami, te i cili në këtë rast u dukën qartë idetë dhe pikëpamjet e tija anarkiste ndaj udhëheqjes së Partisë dhe të shtetit. Këtu nuk ishte çështja se nuk merrej dot vesh me këtë ose atë njeri, po diçka tjetër me rëndësi politike dhe organizative duhej të ishte. Këtu s'ishte vetëm diskutimi i problemit të organizimit të portit dhe qëndrimi joshoqëror i tij ndaj shokut Kiço Ngjela, por moszbatimi i urdhërit të kryeministrit.

Ishte vënë re se në hekurudhë kishte punë armiqësore. Për këtë shoku Niazi ishte sinjalizuar. Por ai nuk

e kishte fare mendjen te puna e armikut, përkundrazi ishte shumë i gjerë ndaj veprimeve jo të rregullta që ndodhnin atje. Në vend që ai t'i shikonte mirë këto çështje, në hekurudhë lavdëroheshin ose dekoroheshin njerëz që s'meritonin. Për të gjitha ato që ndodhnin atje e për këto lëshime përgjegjësia i binte shokut Niazi Islami.

Për të gjitha këto Byroja Politike e mori në shqyrtim çështjen e Ministrisë së Komunikacioneve dhe të udhëheqjes së saj dhe çdo gjë që kishte ja tha përpara syve shokut Niazi Islami. Por ai, që të fshihte gabimet e tij, ndoqi shumë taktika, hiqej konfuz, mbahej pas faktit se nuk ishte i ngritur, na tha se «ne» e kishim zgjedhur në kongres etj. Patjetër, Byroja Politike mendoi dhe gjykoi se këto gabime mund të rridhnin edhe nga injoranca e tij, apo nga mungesa e eksperiencës, po ka mundësi që gabimet të bëhen edhe me qëllim. Më në fund Niaziu pranoi se ka pasur gabime në punë.

Ne patëm shpresë se këto gabime ai i pa drejt dhe se do t'i ndreqte, prandaj e dërguam të punonte në një post me shumë rëndësi, në Bashkimet Profesionale të Shqipërisë. Për një kohë ne bile i bëmë edhe pyetjen vetes: këtë njeri që ka këto të meta si e dërgojmë nën-president të Këshillit Qendror të Bashkimeve Profesionale? Megjithatë, prapë menduam se atje, në kontakt me punëtorët, ndoshta do të ndreqet. Mirëpo edhe atje ai filloi punën e tij jo të shëndoshë dhe të mos mbajë marrëdhënje të drejta me shokët. Ai, së pari, nuk ka shkuar mirë me shokun Pilo Peristeri. Duhet të jesh njeri me huqe që të mos shkosh me Pilon, që është njeri

i dashur e i urtë. Unë mendoj se ai që është i drejtë s'ka se si të mos bashkëpunojë mirë me Pilon.

Veç kësaj Byroja Politike konstatoi disa qëndrime të tjera jo të drejta te shoku Niazi Islami. Pas këtyre që ndodhën me të, në mbledhjet vinim re se ai mbante qëndrim prej frikacaku, nuk sillej si një njeri që vërtet ka bërë gabime, por këto me përpjekje është duke i ndrequr dhe po pastrohet. Përshtypja jonë ishte se Niaziu nuk ishte i qetë.

Vitin e kaluar na ngjau edhe një çështje tjetër: në hotel «Dajti» Niaziu dhe disa shokë të tjerë si Abedin Shehu, Muharrem Çorati etj. kishin marrë në diskutim sekrete me rëndësi të madhe shtetërore në lidhje me marrëdhënjet e ndryshme që zhvillon shteti ynë me vendet e demokracisë popullore dhe BRSS. Këto biseda në vende jo të përshtatshme nuk kalonin pa u vënë re nga ana e shokëve të shëndoshë e këto gjëra e bënë Byronë Politike të ishte më vigjilente, pse, si thotë populli, «tym pa zjarr nuk ka», prandaj çështjen e tyre e ndiqte me shumë kujdes. Ndërsa njerëzit e shëndoshë të Partisë e kanë vënë në dijeni Komitetin Qendror për çështje të tilla të rëndësishme, anëtarët e Komitetit Qendror si Niaziu, ashtu edhe Abedin Shehu dhe Shyqri Këllezi, nuk e kanë bërë një gjë të tillë. Për këtë arsye i thirra vetë, u vura në dukje gabimin dhe u tërhoqa vëmendjen që herë tjetër të jenë shumë të kujdesshëm e të mos përsëritin më gabime të tilla. Që të tre formalisht e njohën gabimin dhe dhanë fjalën se nuk do ta përsëritnin më.

Më vonë ndodhi diçka tjetër, shumë e rëndësishme, me Hamit Keçin. Ky ishte oficer i lartë në një nga

drejtoritë më me rëndësi të Komandës së Përgjithshme. Në një lojë që bënte ushtria, ky kundërshtoi urdhërat eprore duke akuzuar shtabin se ndodhej në duart e agjenturës së armikut. Meqë ky nuk zbatoi urdhërat e Komandës, kjo u detyrua ta përjashtonte Hamit Keçin nga loja. Të njëjtën ditë ky më mori në telefon dhe më njoftoi se kishte diçka me shumë rëndësi për të më thënë. Mua më tërhoqi vërejtjen gjendja e tij shpirtërore fort e alarmuar. E pyeta mos kishte gjë me rëndësi nga kufiri, pse ishte edhe koha e provokacioneve të mëdha, po m'u përgjegj se nga kufiri nuk kishte asgjë, se donte të më fliste për çështjen e lojës, duke ngulur këmbë se shtabi paskësh rënë në duart e agjenturës armike. Pak më vonë mësuam nga Abedini se Hamiti i kishte shkuar atij në zyrë dhe i kishte thënë se dëshironte të shkonte të Komandanti, i kishte kërkuar numrin e telefonit, të cilin ai ja kishte dhënë dhe, ngaqë kishte vënë re se ishte në gjendje jonormale, i kishte premtuar t'i jepte automobilin. Por meqenëse automobili nuk ishte në gjendje për udhëtim, Hamiti e paska sharë Abedinin si sabotator që e pengonte të shkonte te Komandanti. Vetëm kaq tha Abedini për çështjen e Hamit Keçit, kurse të tjerët që kanë ndenjor kaq kohë me këtë jo vetëm nuk kanë thënë asnjë fjalë, po kur u thirrën në Komitetin Qendror për t'u pyetur mbi këto çështje, deklaruan se nuk dinë gjësendi. Që kur u arrestua Hamiti, këta njerëz «asnjëherë nuk janë interesuar më për të», bile thonë se as shoku-shokun nuk e kanë pyetur. Ky është një qëndrim i çuditshëm nga këta shokë, të cilët për 12 muaj me radhë hanin, pinin, kërcenin dhe bënë gjithfarë muhabetesh në shtëpinë e

Hamitit. Atë që nuk e bënë këta, e kreu drejtësia popullore që shqyrtoi punën e Hamit Kecit.

Pas gjithë këtyre ngjarjeve na ndodhi një gjë tjetër me Niazinë; ai kërkoi me këmbëngulje të bisedojë me shokun Mehmet Shehu dhe ky e priti. Niaziu i tha Mehmetit se kishte shkuar për një çështje që e preokuponte shumë. Kur kishte vajtur në kinema, Xhakua<sup>1</sup> e kishte pyetur nëse kishte biletë dhe, kur i qe përgjigjur se jo, ai i pat thënë me shaka se do ta nxirrnin jashtë kinemasë, pasi nuk pranonin pa biletë. «Kjo më bëri përshtypje — tha Niaziu — dhe erdha t'ju pyes se mos ka ndonjë gjë për mua Komiteti Qendror». Shoku Mehmet i tha se nuk kishte përse ta merrte kështu këtë çështje, se po të kishte gjësendi Komiteti Qendror, çdo gjë do t'i thuhej drejtpërdrejt në sy. «Jo, po dua të di përse ma tha Xhakua këtë gjë?» Atëhere Mehmeti i shpjegoi se ai nuk kishte si ta dinte atë që kishte pasur ndër mend Xhakua dhe po të donte të sqarohej më tej, le të shkonte ta pyeste vetë. Sido që në pamjen e parë këto shfaqje shqetësimi për çështje të tilla duken si të thjeshta, nuk mund t'i kalonin Byrosë Politike pa i tërhequr vëmendjen.

Kur isha një ditë në aparatin e Komitetit Qendror, takova rastësisht Niaziun në zyrën e njërit prej sekretarëve. E pyeta si shkonte me punë dhe nëse po i realizonte gabimet e ai m'u përgjigj: «Po, i kam realizuar». Ju, shokë, e mbani mend se edhe në mbledhjen e Komitetit Qendror Niaziu bëri autokritikë, pohoi se kishte

---

<sup>1</sup> Kështu e thërrisnin shokun Ramadan Xhangolli, në atë kohë, kandidat i KQ të PPSH.

gabuar, se i kishte realizuar gabimet, vetëm për një çështje nuk ishte i bindur në kritikën që i qe bërë, se ai nuk qënka megaloman. «Kjo është e pakuptueshme për mua», tha ai. Ne u munduam një orë të tërë për t'i sqaruar kuptimin e fjalës megaloman; por nga kjo kuptuam njëkohësisht se ai nuk kishte marrë vesh asgjë dhe se «autokritika» e tij nuk ishte bërë me sinjeritet. Bile Niaziu arriti derisa të heqë dorë e të mohojë rolin e tij si komunist. Ai na tha vetë se, pas shqyrtimit që i bëri Byroja Politike punës në Ministrinë e Komunikacioneve, kishte vendosur të mbyllej në shtëpi dhe të mos merrte pjesë në asnjë aktivitet shoqëror. Ky qëndrim i tij është një gabim i rëndë parimor, pse ai që bën pjesë në Parti duhet të jetë militant, të mos shkëputet kurrë as nga shokët, as nga masat e popullit, ndryshe nuk mund të jetë komunist. Ishte hapët kundër parimeve të Partisë ajo që mendonte të bënte ai, duke u mbyllur brenda dhe duke u shkëputur në realitet nga puna e Partisë, por jo e grupit, pse karakteristikë kryesore e njerëzve të grupit janë moskënaqësitë dhe moszbatimi i vijës së Partisë.

Kur shoku Niazi na tha se kishte vendosur të shkëputej nga çdo aktivitet shoqëror, ne i vumë qartë në dukje se edhe sikur të mos merreshin parasysh fare gabimet e tij të tjera, vetëm ky qëndrim tregonte plotësisht se ai ishte një megaloman i madh. Le t'i lëmë këtu mënjane çështjet e tjera dhe konsideratat politike, pse kërkon ai të mbyllet brenda? Ai na tha se nuk duronte dot kur ta shihnin shokët dhe se, sipas tij, ata do t'i binin me bërryl. Vazhduam t'i shpjegojmë se një komunist, kur i njej gabimet, nuk ka përse të ketë turp,

se të kesh turp është një sëmundje borgjeze, prandaj s'duhet të kesh turp, derisa vetë i ke njohur gabimet. Por ai ka turp të dalë në shoqëri, pse mendon që shokët do ta shohin me sy të keq dhe kjo është një formë megalomanie që tregon gjithashtu se ai është në kundërshtim me Partinë, gjë që do t'u linte të kuptohej si të mirëve, edhe të ligjve se midis Niaziut dhe Partisë ka diçka dhe të ligjtë do të përpiqeshin t'i hidhnin ganxhat, ndërsa të mirët do të thoshnin përse nuk na e thotë edhe neve Partia këtë çështje. Kjo gjithashtu tregon pikëpamjet e tija të gabuara mbi Partinë.

Kur u pa se nuk shkonte mirë me punë në Këshillin Qendror të Bashkimeve Profesionale, Niaziu kërkoi të shkonte drejtor në një fermë, meqenëse «nuk po kuptoheshim» me të. Ne i thamë se po ta bënte këtë kërkesë për shkak se e ndjente veten të pazotin, kjo është pozitive, po ne mendojmë se ai e bëri atë që të largohej nga puna e Partisë, e bëri nga megalomania e tij dhe ngaqë mendon se ai ka të drejtë, kurse Partia nuk ka të drejtë. Këtë besoj se Niaziu do ta thotë vetë në këtë mbledhje. Duke shkuar në një fermë, ai donte të linte të kuptohej se është i persekutuar e se do të shihej më vonë kush kishte të drejtë, Komiteti Qendror e Byroja Politike, apo Niazi Islami. Më vonë ai pohoi se ndërkohë punonte për të mbledhur fakte dhe statistika për të provuar se ishte Byroja Politike që kishte pasur gabime ndaj Niazi Islamit dhe jo ai. Këtë kishte ai në planin e tij.

Këtu ka shumë gjëra, të cilat të japin të kuptosh se Niaziu nuk është në rregull, ai është në kundërshtim me Byronë Politike. Prandaj gjithë ato që ka thënë



kanë qenë fals. Kur e thërrita në zyrë, në Komitetin Qendror, folëm 4 orë bashkë dhe m'u krijua bindja se me këto pikëpamje nuk mund ta binim në rrugë, megjithëse na tha se i kuptonte të gjitha. Mirëpo kishte edhe gjëra të tjera që duhej t'ja thosnim.

Të nësërmen e thirrëm prapë dhe e pyetëm për çështjen e Hamit Keçit, për të cilën na u përgjegj se nuk dinte gjë. Na tha se vetëm kur kishte ardhur nga Lushnja kishte shkuar te Abedini, po gjoja dhe ky nuk dinte gjë. «Me Isuf Keçin që e ke kunat do të kesh biseduar patjetër», i thamë, po edhe këtë e mohoi. Dua të shtoj se, pasi u kritikua nga Byroja Politike, ku na u shpreh se ishte i qartë, me të dalë nga mbledhja, shkoi drejt e te Abedini, të cilit ja bëri të ditur të gjitha. Kur e pyeta për Abedinin, ai më tha se i paskësh folur që t'i pranonte gabimet, se Byroja Politike i kishte treguar rrugën. Me këtë vërtetohet se, derisa vajti të qante hallin te Abedini, ishte me të vërtetë i pakënaqur, se autokritika e tij nuk ishte e sinqertë.

Përsa i përket Hamit Keçit, Niaziu na tha se nuk dinte gjë për të. Edhe kur e pyeta nëse mblidheshin dhe çfarë bisedonin, u përgjegj se në mbledhjet e tyre bënë vetëm muhabetë të zakonshme. Edhe një herë e pyeta nëse bisedonin për çështje që ishin në kundërshtim me Partinë, ai u përgjegj se kishin biseduar për çështje ekonomike, po nuk kishin kundërshtuar asgjë. Si e nxita edhe ca, na tregoi se midis tyre kishte kundërshtuar vetëm Hamiti, por, sipas tij, të tjerët ja paskëshin goditur pikëpamjet. E pyeta pastaj nëse kishte gjë tjetër për të thënë, pse dukej që përtypej e nuk thoshte të vërtetën. Ja vura në dukje këtë, pse vetë Niaziu, kur

Komiteti Qendror dhe qeveria nxuarën urdhëresat ekonomike lidhur me çështjen e tregëtisë dhe të furnizimit të popullit erdhi te unë dhe më tha se nuk ishte dakord me të, pse gjoja u jepej mundësi që të blejnë njerëzit e pasur, megjithëse këtë e kishim vendosur në qeveri dhe në mbledhje të Komitetit Qendror. Kjo ishte në kundërshtim me qëndrimin e tij të mëparshëm. Kur ja vura këtë në dukje, pranoi se ishte e vërtetë dhe pohoi se për këtë e kishte bindur Isuf Keçi. Më pas, vetë ai si komunist, nuk tha asgjë, pse çdo gjë si atij, ashtu edhe të tjerëve ua nxuarëm pyetje pas pyetjesh. Është karakteristik qëndrimi i këtyre shokëve, të cilët janë munduar të mohojnë çdo gjë, të mos i thonë të vërtetën Partisë. Nga përgjegjet e tyre, shpesh të drojtura e kontradiktore, nga faktet që ne i njihnim doli që në grup, ku kryesorë kanë qenë Abedini, Niaziu, Shyqriu, Hamiti dhe Isufi, janë kritikuar ministra, institucione qeveritare etj.

Kur bisedova me Niazinë në Komitetin Qendror dhe e pyeta përse e lidhi në kokën e tij shakanë që i bëri Xhakua në kinema me mendimin e udhëheqjes për të, ai na u përgjegj «për arsye se ishte akuzuar për frymë jugosllave», pasi një ditë, kur kishte shkuar për një punë te shoku Spiro Koleka, ky i kishte bërë vërejtjen se organizimi në komunikacion është tamam si i jugosllavëve, pastaj se dhe shoku sovjetik e kishte pyetur nëse është marrë atje eksperiencë nga jugosllavët, nga këto ai dyshonte se mos Komiteti Qendror mendonte diçka për të.

Të gjithë pjesëtarët e këtij grupi kanë përdorur këtë taktikë: bënin bisedime të rregullta nga një herë në javë, bile në një nga këto mbledhje kishin marrë në

diskutim çështje të dikastereve, si atij të bujqësisë dhe të kuadrove të tyre.

E pyeta më së fundi Niazinë nëse ishin të drejta gjithë këto gjëra që kishin bërë jashtë normave të Partisë dhe përse nuk kishin ardhur në Komitetin Qendror t'i thonë këto shkelje që bënte ky ose ai derisa ata e dinin se janë të palejueshme, pasi unë u kisha hequr edhe një herë tjetër vërejtjen për çështje të kësaj natyre. Ai u përgjegj se nuk dinte çfarë të thoshte, nuk e pañdehnin se ku do të dilte kjo punë. «Ta pranojmë — i thashë — se më përpara s'e kuptonit, po kur ua kam vënë unë vetë në dukje këto çështje, përse keni vazhduar të veproni në kundërshtim me Partinë?» Taktika e Niaziut ishte të mbrohej. Megjithatë, pas shumë pyetjeve, ai pohoi me gënjën e vet se kanë thyer rregullat organizative, duke mos vënë në dijeni Partinë, prandaj veprimet e kryera janë të gabuara. Ai na tregoi pastaj se Hamit Keçi u kishte folur edhe për zhvillimin e gjithë lojës ushtarake, që përbën një shkelje të rëndë të sekretit shtetëror. Ky ishte i vetmi nga pjesëtarët e grupit që na e tha këtë përpara nga të tjerët, po shtoi se pañdehnin që kjo nuk ishte ndonjë gjë me rëndësi, se e gjenin si diçka të natyrshme t'u thuhej, prandaj nuk u kishte bërë fare përshtypje.

I tillë ka qenë qëndrimi i Niaziut në bisedimet që kam bërë me të, të tillë kanë qenë argumentat që përdori ai përpara Byrosë Politike, prandaj menduam se puna e këtyre njerëzve nuk ishte aspak e qartë, kështu që kërkua t'i thërrisnim përpara Byrosë Politike. Niazinë ne e kemi ndihmuar më shumë nga të gjithë, po siç del, shokë, ai është në pozita më të rënda antiparti.

Thirrëm pastaj shokun Abedin Shehu, i treguam gjithë punën, si dhe dyshimet e Byrosë Politike për veprimtarinë e këtij grupi, i treguam edhe ku e kanë origjinën dhe pse bëhen këto gjëra. I folëm gjithashtu për personat mbi të cilët dyshonim ne dhe i kërkuam të fliste «haptas» përpara Partisë, ashtu si e ka zakon të thotë Abedini, pa druajtje e frikë dhe me qëllim që të mbrojë Partinë. Ky ka qenë pjesëtari i grupit që më shumë nga të tjerët është përpjekur të jetë jashtëzakonisht i rezervuar, t'i maste mirë fjalët që thoshte dhe të prekte çështje në përgjithësi, pa komprometuar njeri, ose edhe po të komprometonte, kjo të bëhej në një rrugë që të gjendej një arsye faljeje. Abedini na tregoi se ishte e vërtetë që mblidheshin, po bënë bisedime me karakter të përgjithshëm ekonomik, se ai nuk kishte vënë re që të bëheshin bisedime jashtë vijës së Partisë dhe shtoi pastaj se, që kur u pata bërë unë vërejtjen për bisedat në hotel «Dajti», Abedini paskësh filluar të largohej nga kjo shoqëri, sidomos nga Isuf Keçi. Kjo kishte ndodhur që në mars.

E pyeta më pas Abedinin se çfarë mendonte për Isuf Keçin dhe u përgjegj se është anarkist, ka pakënaqësi, është njeri me gjykim të përciptë. Për Hamitin tregoi vetëm se i kishte shkuar në zyrë ditën përpara se të arrestohej dhe se nuk dinte tjetër gjë. Shtoi pastaj se nuk ja kishte prerë mendja që Hamiti të shkonte deri në atë shkallë. Pastaj na tha se kur Hamiti kishte nënën në banjat e Elbasanit kishte sharë ministrin e shëndetësisë, po në këtë rast e kishte kundërshtuar Shyqriu. «Unë, vazhdoi Abedini, kam biseduar dhe kam mbajtur lidhje më shumë me Shyqrinë, kurse me Niazinë

kam pasur vetëm lidhje pune». Shyqriu na ka folur, shtoi ai, edhe për ndonjë kuadër që nuk bën, po për çështje të tilla i ka sugjeruar t'ja thoshte Komandantit, po t'i gjente rastin. Për Niazinë pohoi vetëm se ky i kishte shkuar për t'i treguar mbi kritikën që i pat bërë Byroja Politike dhe në këtë rast Abedini e paska këshilluar dhe i paska thënë se kritika ishte e drejtë. Dëshiroj të sqaroj se gjatë këtij takimi më shumë fola unë se sa Abedini, i cili qëndroi shumë i rezervuar, gjë që, sipas pikëpamjes sime, ishte paramenduar nga ana e tij.

Më vonë thirra shokun Shyqri Këllezi, i cili u përpoq të manevronte. Unë mendoj se ai ishte në dijeni të qëllimit të thirrjes pse, porsa erdhi, filloi të më tregojë për punën e naftës. Kur i thashë se nuk e kisha thirrur për këtë problem, po për një çështje partie me rëndësi të madhe organizative, pa i thënë gjë fare unë për se ishte fjala, ai nisi të më fliste për Hamit Keçin. Kur e pyeta çfarë dinte për të, m'u përgjegj se ka pasur pikëpamje të gabuara. Po megjithëse ngula këmbë të thoshte çfarë dinte tjetër, ai nuk më tha asgjë.

I kërkova të më tregonte pastaj çfarë dinte për Isuf Keçin dhe më tha se ky është anarkist, se në kohën e Koçit paska bërë kritika për Vashë Kolecin dhe për një tjetër se qenë graduar në mënyrë të parregullt. «Folë drejt — i tërhoqa vëmendjen — se ke hyrë shtrembër në këtë çështje, pse akoma pa të pyetur unë, ti fillove të na përrallisësh me «sqarimet» e tua për anarkizmin e Isuf Keçit. Si është e mundur që u hape vetë këtu, apo mos ke biseduar me ndonjë tjetër njeri mbi këto çështje?». Unë jam i sigurtë se para se të vinte te unë, Shyqriu kishte biseduar me Abedinin. Kur e

pyeta kush është anarkist, tha: «ai që është në kundërshtim me vijën e Partisë». «Po me këtë që na the ti — e pyeta përsëri — ku është Isufi në kundërshtim me Partinë»? Atëhere Shyqriu nuk diti ç'të thotë dhe ajo që pohoi ishte një formulë e mësuar.

Pastaj e pyeta çfarë dinte për Hamit Keçin. Edhe kësaj pyetjeje ai ju shmang, duke përsëritur se nuk dinte gjë. I përmenda se pat shitur shtëpinë për të ndenjtur bashkë me Hamit Keçin, kurse tani që u arrestua ky shok i tij i ngushtë, si është e mundur të mos jetë interesuar? Më tha vetëm se Abedini i kishte thënë që Hamiti i pat shkuar në zyrë ditën që do të arrestohej. E pyeta për lojën e ushtrisë, po edhe për këtë më tha se nuk dinte gjë. Ai tregoi se vetëm me Abedinin kishte pasur lidhje të ngushta dhe me të kishte biseduar çdo gjë dhe haptas, kurse me Niazinë paskësh qenë në kundërshtim, po kur u largua nga komunikacioni ky i paska thënë që nuk kishin punuar keq kur ishin atje. Kur e pyeta çfarë kanë biseduar për çështjet ekonomike në grupin e tyre, më tha se nuk mbante gjë mend, nuk dinte gjë, nuk i kujtohej. Me një fjalë Shyqriu nuk ka dashur t'i thotë asgjë Partisë. Përgjegjet e tija janë shumë të ngjashme me ato të Abedinit. Të njëjtat çështje preku edhe Abedini dhe asgjë tjetër.

E këshillova Shyqrinë se ishte në pozita të dobëta, prandaj duhej të bënte përpjekje të hiqte dorë nga ky qëndrim, i tregova se Komiteti Qendror dhe Byroja Politike kanë mjaft fakte që nuk mund të mohohen, prandaj i kërkohet të bënte një autokritikë të shëndoshë. Ai u mundua të thotë më së fundi se puna e tyre ka qenë një vijë e sëmure, po gjithshka kanë bërë, ka

qenë për gjëra të rastit, tregoi se i lidhi shoqëria, se të gjithëve u pëlqenin dëfrimet dhe muhabetet, prandaj megjithëse nuk është një gjë e rregullt, pranoi ai, ky është një familjaritet, karakteristikë kjo e përbashkët në të gjithë këta shokë. Në autokritikë Shyqriu tregoi përse nuk foli dot për çështjen e anarkizmit të Isufit dhe u përpoq të jepte gjoja disa shpjegime, pastaj tha se kishte biseduar me këta shokë dhe kishte gabuar që nuk ja kishte thënë Partisë, mirëpo asgjë nuk tregoi për çështjen e Hamit Keçit. Me Abedin Shehun, sipas tij, «i lidhte natyra e përbashkët». Që në kohën e Keçit, Abedini i paska thënë Shyqriut të mos fliste, se pësonin ndonjë gjë të keqe. Pra, Shyqriu vazhdon të mbajë rezerva edhe sot për çështje kaq të rëndësishme që edhe vetë ai i ka kuptuar, po fryma e grupit është rrënjësorë aq thellë të këta njerëz, sa që nuk i lejon të flasin hapët dhe të shohin në radhë të parë interesin e Partisë.

Sa për Isuf Keçin duhet vënë në dukje se ky është thirrur shumë herë nga sekretarët e Komitetit të Partisë të Tiranës për të dhënë sqarime mbi gabimet e tij. Shokët e Tiranës kanë qenë vigjilentë për shumë nga këta njerëz, ata u kanë bërë kritika dhe kanë njoftuar edhe Komitetin Qendror. Kjo është një meritë e tyre dhe me këtë ata e kanë ndihmuar Byronë Politike për zbërthimin e veprimtarisë së këtij grupi. Për çështjen e Hamitit të njëjtën taktikë ka ndjekur edhe Isufi; të mos tregojë asgjë. Autokritika e tij ka më tepër formën e një kritike, pse ai akoma dyshon përse është arrestuar Hamiti, ndërsa të gjithë shokët e tjerë të grupit pohojnë se janë të bindur për fajësinë e tij. Arësytet që nuk është i qartë për këtë çështje Isufi i lidh me grin-

djet që paska pasur Hamiti me disa shokë kur studjohnin në Moskë, si me Nexhip Vinçanin, Gjin Markun etj. Po kjo është një çështje që e dinë të gjithë. Isufi ka treguar një interesim të madh për çështjen e Hamitit, këtë ai jo vetëm që u mundua ta mohojë, por tha se po kurdisej një plan për ta futur edhe atë vetë në këtë kurth. Ky ka biseduar në Parti dhe jashtë Partisë se për arrestimin e Hamitit ka një intrigë, megjithëse ai dhe të gjithë shokët e këtij grupi e dinë mirë se në çështjen e lojës nuk ka të bëjë as Nexhipi, as Gjini, po kërkojnë në këtë mes të gjejnë një alibi, për të vërtetuar sikur Hamiti qenka futur kot në burg.

E thirra përsëri Isufin dhe i thashë haptas se gjëra të tilla nuk shkojnë në Partinë tonë, prandaj të flasë më qartë si qëndrojnë punët e grupit. Herën e dytë mund të themi se ai foli më hapët, tregoi shumë gjëra që të tjerët i mbanin të fshehta, megjithëse ne i dinim nga ato që na kishte treguar Hamiti. Isufi na tregoi se në grupin e tyre janë biseduar plot gjëra me karakter sekret shtetëror, ushtarak dhe ekonomik dhe më kuriozi i të gjithëve, ai që i bënte më shumë pyetje Hamitit, saqë ky arriti t'i quante provokacione, tha ai, ishte Abedini. Hamiti na e shpjegoi lojën, pohoi Isufi, gjerë e gjatë në hartë. Në lidhje me terrenin, ai na foli për forcat dhe variantet. Në këtë kohë Abedini kishte ndërhyrë me pyetjen nëse kishte ndonjë variant tjetër, në rast të një sulmi që mund të na vinte nga Jugosllavia. «Kur na është shpjeguar loja — vazhdoi Isufi — kanë qenë të tërë, bile Abedin Shehu bënte pyetje provokuese që s'kishin të bënin fare me vendin tonë». Abedini ishte interesuar gjithashtu për gatishmërinë e ushtrisë sonë



dhe Hamiti i kishte folur pozitivisht, duke marrë parasysh forcat tona, armatimet dhe terrenin. Mirëpo Abedini i kundërshtonte ato që tregonte ai, duke thënë se armiku mund të na sulmonte me forca më të mëdha. Kur Abedini i kishte kërkuar Hamitit sekrete të tjera ushtarake, ky i kishte thënë se këto gjëra i di vetëm Enver Hoxhaj; atëhere ai e kishte sharë, duke i thënë se ishte i poshtër dhe budalla. Këto pohoi Isufi, kurse gjithë të tjerët i mohuan.

Të tërë pjesëtarët e këtij grupi tregojnë se kanë biseduar edhe për çështje ushtarake, për të cilat ka qenë në kundërshtim vetëm Abedini. Kur bisedohej çështja e disiplinës dhe zbatimit të urdhërave, Hamiti, në kundërshtim me Abedinin që i thoshte se në rast tradhëtie të Komandës, urdhëri nuk duhet të zbatohet nga inferiorët, mbronte pikëpamjen se ai duhet zbatuar, se në Ushtrinë Sovjetike dhe tonën puna është organizuar në mënyrë të tillë që nuk mund të ndodhë asnjë tradhëti. Këto janë dy çështje me rëndësi të madhe parimore.

Pastaj Isuf Keçi na foli edhe për shumë gjëra të tjera që janë biseduar në grup, jo në formë muhabeti, si thonë këta, po me shifra në dorë, të cilat i zotëronin vetëm ministrat përkatës, kurse këta i kishin hedhur në tavolinë në mbledhjet e tyre, sikur të ishin në Komitetin Qendror. Isufi vazhdoi të tregojë se ishin marrë në diskutim çështje të Ministrisë së Bujqësisë dhe të ministrive të tjera, si asaj të industrisë që nuk kishte realizuar planin. Kur e pyeta ku i dinte ai derisa të gjitha këto gjëra janë biseduar vetëm në Komitetin Qendror, Isufi pohoi se edhe këtë ja kishte thënë Abedini. Me një fjalë, Isufi hodhi ca dritë më shumë për

punën e grupit, megjithatë u përpoq të fshihte edhe ai si shokët shumë çështje të tjera. Në këtë rreth janë thënë edhe sekrete të tjera, me rëndësi të madhe ushtarake, që ua ka treguar Hamiti dhe për të cilat ne jemi në dijeni, prandaj këta shokë duhet të na i thonë haptas këtu, ç'kanë thënë dhe ç'nuk kanë thënë.

Arrestimi i Hamitit i ka frikësuar shumë këta shokë, pse e ndjejnë që janë implikuar në çështjen e tij. Për këtë arsye që nga ajo kohë mbledhjet, sikur t'u ketë thënë dikush, i kanë rralluar dhe janë shpërndarë. Për këtë, të gjithë i mbahen një versioni për Hamitin, që «nuk dinë gjë». Po Hamiti, për fat të keq të tyre, di shumë gjëra dhe i ka pohuar.

Ai në fillim bëri një autokritikë ku shpjegoi pse e kundërshtoi urdhërin dhe pohoi vetë se këtu nuk kishte të bënte fare grindja me Nexhip Vinçanin e Gjini Markun në Moskë, prandaj këta shokë duhet të jenë të bindur mirë se moszbatimin e urdhërit Hamiti nuk e bëri për atë shkak. Ky pohoi se që në fillim kishte qenë në kundërshtim me Partinë, pse është infektuar me frymën e vjetër të grupit dhe këtu flet drejt. Ai thotë se është një megaloman dhe hipokrit, nuk ka asnjë konsideracion për Komandën, po as për çështje ushtarake nuk ka haber, megjithëse hiqet sikur di shumë. Nga loja Hamit Keçi nuk merrte vesh aspak dhe, që të mbulonte pazotësinë e tij, kundërshtoi urdhërin e Komandës dhe tha të gjitha ato që u thanë. Këto paskëshin qenë shkaqet, sipas tij: Mirëpo Byroja Politike nuk u mjaftua me kaq, prandaj i kërkoi që ta zgjeronte autokritikën, gjë që premtoi ta bëjë, duke thënë se po realizonte që kishte gabuar.

Në autokritikën e dytë dhe të tretë Hamit Keçi del me fytyrën e tij të vërtetë dhe aty duket qartë çfarë njeriu është, Ai pohon vetë: «unë jam tamam si një thes me miell që, sa t'i biesh, del tym mielli». Ai tregon se në luftë ka qenë një frikacak i madh, se në tërë aksionet, ku ka marrë pjesë, është përpjekur si e si të mos vritet ose të mos plagoset dhe se po të kishte vazhduar lufta, më tej, do të kishte tradhëtuar. Pastaj tregon se ka dekonspiruar sekrete të mëdha ushtarake të shokët e këtij grupi. Ai bën fjalë edhe për një çështje tjetër me rëndësi, tregon se, kur ishte në internim në Itali, i ka bërë një deklaratë qeverisë së Romës në kohën e Musolinit dhe pohon se këtë ja ka fshehur Partisë, por deri tani, sipas tij, armiku nuk e paska shtërnguar t'i japë gjë. Pasi flet edhe për sjelljet e tija imorale e të ulëta, tregon se deri edhe aty në burg ai qenka përpjekur të marrë lidhje me kriminelët, duke u shkruar letra që i janë kapur. Të gjitha këto, pohon Hamit Keçi, i ka bërë se nuk ka pasur besim të Partia dhe e ka dëmtuar Partinë. Në autokritikat e tija ai zbulon gjithashtu të gjitha bisedimet që kanë bërë me njëri-tjetrin pjesëtarët e këtij grupi, si dhe karakterin e secilit prej tyre.

Kështu janë zhvilluar çështjet derisa këta shokë u thirrën përpara Byrosë Politike, e cila kishte ngarkuar Sekretariatit për ta sqaruar këtë punë. Ne mendojmë se Byroja Politike u ka dhënë këtyre shokëve gjithë ndihmën e nevojshme për t'i sqaruar dhe për të parë rrugën e gabuar në të cilën ishin zhytur dhe këtej pastaj këta të ndihmonin Partinë dhe veten e tyre me një autokritikë të shëndoshë. Deri tani Byroja Politike

ka konstatuar se këta, megjithëse nuk arritën të fshihnin gjënë kryesore, janë përpjekur të mos tregojnë shumë gjëra përpara Partisë, sidomos ato që janë më të rrezikshmet, gjë që do të thotë se janë të ndërgjegjshëm në rrugën e tyre.

Thirrja përpara Byrosë Politike duhej të ishte për ta një ndihmë edhe më e madhe. Atyre me kohë u është bërë e qartë rruga e gabuar që ndiqnin, prandaj duhet t'i kishin prerë gjithë këto marrëdhënje të sëmura që kishin me njëri-tjetrin dhe të reflektonin thellë, secili për vete, t'i kujtonin të gjitha ato që thoshin se nuk i dinin, ose që pretendonin se nuk i mbanin mend dhe të dilnin përpara Partisë me një autokritikë të sinqertë. Në mbledhjen e Byrosë Politike u konstatua se këta jo vetëm nuk donin të realizonin si duhet të gjitha këto veprime kaq të dëmshme për Partinë, por kanë mbajtur edhe një qëndrim aspak komunist.

Qëndrimi i Shyqriut nuk ishte aspak i mirë. Ai nguli këmbë dhe qëndroi në ato çështje që tha në autokritikën e tij, pa bërë përpjekje t'i zhvillonte dhe të arësyetonte të paktën ato që kishte thënë. Ai ka pasur mjaft kohë për të gjetur shkaqet përse ndodhën të gjitha ato ngjarje. Ai thotë vetëm se ka bërë gabim dhe për këtë Partia le ta dënojë. Të gjithë këta e presin dënimin e Partisë. Dhe, natyrisht, Partia dënon sipas rastit dhe madhësisë së fajit, po këta shokë, duke thënë «të na dënojë Partia», kanë menduar të qëndrojnë në të njëjtat pozita, të mos bëjnë asnjë hap përpara. Kjo nuk është e drejtë dhe analiza e tyre nuk është aspak marksiste. Shyqriu pohoi se kjo është një punë familjariteti dhe grupazhi, po nuk ka ditur ta zhvillojë më

tutje këtë çështje. Përveç kësaj, të tërë këta ndaj Partisë nuk kanë mbajtur qëndrim komunist për këtë çështje dhe ne nuk mendojmë që të mos kenë biseduar me njëri-tjetrin, sidomos me Abedinin. Këtë e them se, kur e thirra Shyqrinë për të bërë një autokritikë këtu në Tiranë (ku kishte tri ditë që kishte ardhur të bisedonte për të zgjidhur disa probleme të naftës), ai hezitoi një herë dhe ia të kuptohej se nuk i pëlqente ta bënte këtë me shkrim. I kërkova të rrinte në Tiranë ta bënte, po ai s'ja vuri veshin urdhërit tim, e shkeli atë, vajti në Patos dhe e vonoi autokritikën për 24 orë. Pse e bëri këtë? Ai na nxori disa arsye: duhej gjoja të çonte ca shokë, të cilët i kishte marrë që andej dhe duhej t'i kthente, pastaj duhej të ishte më i qetë, pse këtu, sipas tij, nuk kishte ku rrinte. Po ky argument rrëzohet, pse as në Patos nuk mbeti i qetë, mbasi atje vajti Abedin Shehu dhe kanë ndenjor bashkë tërë atë natë. Përse shkoi Abedini në Patos, këtë nuk na e thonë, po shtiren sikur kanë biseduar për naftën. I thashë se përgjegjja e tij nuk duhet të jetë e vërtetë, pse këta biseduan këtu për naftën dhe për këtë Shyqriu kishte pohuar se ishte sqaruar, prandaj thënjet e tija nuk ka si të qëndrojnë në këmbë. Të gjithë shokët e Byrosë Politike bënë shumë përpjekje për ta ndihmuar Shyqrinë që të fliste më qartë, më sinqerisht dhe të mos kishte frikë nga Partia.

Përpara Byrosë Politike Abedini mbajti një qëndrim shumë negativ. Ai tha aty të njëjtat gjëra që kishte prekur edhe më parë, duke mos bërë asnjë hap përpara, bile gjithshka aty e tha në mënyrë të errët. Jo vetëm kaq, po në çështjet më delikate u tregua shumë i rezervuar. Kështu Abedini mohoi që Hamiti t'i kishte

vënë në dijeni për lojën e ushtrisë dhe me këtë gënjente Byronë Politike të KQ të Partisë. Pas shumë diskutimesh pohoi më së fundi se akti i Hamitit, që ka dekonspiruar sekretet ushtarake dhe nuk ka zbatuar urdhërat e Komandës, të cilat nuk mund të diskutohen, përkundrazi duhet të zbatohen menjëherë, është një tradhëti. Këtu Abedini nuk foli drejt, ashtu si mendonte, pse sigurisht ai mendonte krejt ndryshe. U detyrua Byroja Politike t'ja nxirrte me grep, si të thuash, çështjet e lojës dhe vetëm përpara fakteve u detyrua të pohonte. Por për të mbuluar përgjegjësitë e tija, këtë e kishte marrë si një çështje teorike. Në fakt, ajo ashtu ishte, nuk ishte një luftë e vërtetë, po një lojë, por këtë ai nuk e thotë, pse e vlerëson gabimin e madh që ka bërë, duke mos vënë në dijeni Komitetin Qendror për faktin shumë të rëndësishëm që një oficer i lartë i ushtrisë dekonspiron sekrete të mëdha ushtarake. Karakteristikë te Abedini është se ai ja fsheh deri në fund Partisë gabimet e tij dhe kjo, kuptohet ngaqë ai është plotësisht i ndërgjegjshëm se këto janë gabime shumë të rënda dhe të dënueshme. Por, më në fund, i mundur nga faktet, ai nuk mundi dot t'i fshihte, me gjithë përpjekjet që bëri.

Këta shokë janë recidivistë, prandaj fjalët që thonë se nuk dinin që bënë gabime nuk kanë asnjë bazë. Abedini vetë është anëtar i Komitetit Qendror, prandaj këtë duhet ta thoshte vetë, duke marrë parasysh se të tërë këtyre u është hequr edhe më parë vërejtja për çështje të rrezikshme të kësaj natyre. Abedini tha se pas vërejtjes është rezervuar dhe tërhequr, po as kjo nuk është e vërtetë, pse ai ka vazhduar veprimtarinë

e tij në këtë drejtim, bile edhe për çështje më të rrezikshme, prandaj thënjet e tija rrëzohen.

Po Abedini ka dhe një gabim tjetër më të rëndë në çështjen e moszbatimit të urdhërave, për të cilën nuk fliste drejt; në këtë çështje ai ishte në kundërshtim me Hamit Keçin dhe këtë ja fsheh Partisë, pse e gjykon me ndërgjegje që është e rrezikshme, bile dhe shumë, pse më pas ndodhi ngjarja me Hamit Keçin që zbatoi urdhërat e grupit dhe kundërshtoi urdhërin e Komandës. Kur Byroja Politike e vuri përpara fakteve, Abedini u detyrua të pohonte, megjithëse më përpara u orvat t'u shmangej këtyre gjërave. Prandaj, të tërë këta kanë pjesë në gabimin që ka bërë Hamit Keçi, gjë që nuk ka të bëjë fare me ngjarjen që ka ndodhur në Moskë me Nexhip Vinçanin, Gjin Markun etj., që ata e kishin marrë si argument. Edhe ata vetë e dinin këtë, po qëllimi ishte të mbulonin punën e tyre.

Më pas Byroja Politike konstatoi se shoku Abedin Shehu nuk qëndroi më në pozitë fillestare dhe mund të themi se hyri në një rrugë të drejtë, ai pohoi se kanë bërë gabime dhe po realizojnë sa të rënda janë. Duke kaluar në çështjet ekonomike ai pohoi gjithashtu se nga ana e tyre puna që kanë bërë është e dënueshme dhe kundër Partisë.

Të tërheq vëmendjen edhe një çështje tjetër që i shkau, sidomos Abedinit, i cili ishte shumë i rezervuar. Ky tregoi se diskutimet me njerëzit e grupit i bënin pa të keq dhe kishin arritur ta shihnin shoqërinë e tyre si një forum dhe në fakt bisedonin tamam si një forum. Ju kërkuan shpjegime shokut Abedin për këtë, po e pa se shkeli në dhogë të kalbur, prandaj filloi të

luante me fjalë. Mirëpo kur ju numëruan të gjitha këto që kishte pohuar edhe vetë, pranoi dhe pohoi se kështu del, ato mbledhje ata të gjithë i quanin si një forum. «Këto i realizoj, na tha ai, vetëm më duhet të bëj një analizë të thellë për shumë çështje të të gjithë punës dhe të pikëpamjeve të mia tani dhe përpara, por sonte këtë nuk jam në gjendje ta bëj dot, po premtoj se do të përpigem ta zgjeroj më shumë». Këto ishin për Abedinin.

Ndërsa Niazi Islami ka mbajtur një qëndrim armiqësor. Të tillë e ka cilësuar atë e gjithë Byroja Politike, me të cilën isha i një mendimi edhe unë dhe shtoj se qëndrimi i tij është antiparti dhe trockist që nga fillimi dhe deri në fund. Niaziut ne ja thamë të gjitha gjërat që në fillim, po ai nuk njohu asgjë, të gjitha i fuste në diskutim gabim. Ne u përpoqëm ta ndihmonim, por ai na tha se kot po humbet kohën me të Byroja Politike për këto gjëra. Pra, marrjen me të gjitha këto gjëra shumë të rëndësishme për Partinë, që ju shokë po i dëgjoni sot këtu për herë të parë, ai e quan një kohë të humbur të Byrosë Politike. Ky është një qëndrim antikomunist. Ne ju përgjegjëm atij se Byroja Politike e di përse e humbet kohën dhe këtë do ta gjykojë Komiteti Qendror nëse është e humbur kot apo jo.

Asnjë reflektim nuk pamë nga ana e tij përpara këtyre gabimeve të rënda. I tillë ishte gjithë qëndrimi i tij para kësaj çështjeje, me gjithë vërejtjet që i bënë shokët. Niaziu arriti të thotë «ju, shokët e Sekretariatit, më keni zgjedhur për në Komitetin Qendror megjithëse unë nuk vlej», kurse atë e zgjodhi kongresi dhe jo një e dy persona. Megjithatë ne mendojmë se ai është i bindur në vetëvete se është më i zoti nga shumë shokë



të tjerë, prandaj as kjo që thotë nuk është e vërtetë dhe ai del kështu kundër Partisë, kundër kongresit. Pastaj këto faje të rënda nuk mbulohen me thënjen «ju më zgjodhët», pse mund të jetë bërë edhe gabim, po qëllimi i kongresit të Partisë që e ka zgjedhur ka qenë i drejtë, kurse ai ka shkelur besimin e Partisë, prandaj për këtë do të japë llogari përpara Partisë.

I vumë në dukje Niazi Islamit se një njeri që mban një qëndrim të tillë tregon se nuk është më në pozita grupazhi, po në pozita fraksioni, pse të gjitha këto veprime lidhen, prandaj nuk kemi të bëjmë me çështje temperamenti, pse të insultosh kryeministrin apo sekretarët e Partisë nuk është çështje nervoziteti. Ka edhe njerëz nervozë, po te njeriu sundon logjika. Aq në pozita të gabuara ishte ky njeri, saqë edhe dalja e tij nga mbledhja ishte tipike, as përshëndeti, as e mbylli derën e dhomës ku ishte mbledhur Byroja Politike. Me këto qëndrime armiqësore pozita e Niaziut u vështirësua shumë më tepër. Ai jo vetëm nuk i tha gjë Komitetit Qendror, po në të kundërtën kërkonte që Komiteti Qendror t'i tregonte atij përse u bënë gjithë këto gjëra. Këtu nuk kishte bërë ndonjë faj Byroja që të jepte llogari, faje kishte bërë ai dhe të rënda, kurse Byroja Politike mendimin e vet për veprimtarinë e tij do ta thoshte ku duhej, këtu, përpara këtij plenumi. I tillë ishte qëndrimi i shokut Niazi Islami. Ne jemi të bindur se nuk është e vërtetë se ai nuk di, prandaj në qoftë se dëshiron të shërohet, duhet t'ja thotë Partisë ato që ka në zemër dhe po të mos dojë t'i pohojë, këto do t'ja thotë Komiteti Qendror, pse Partia jonë dhe Komiteti Qendror udhëhiqen nga një ideologji e shëndoshë, nga teoria marksiste-

-leniniste, që me forcën e logjikës zbërthen drejt si çdo problem edhe këto që kanë ndodhur me njerëzit e këtij grupi, prandaj nuk ka rëndësi që nuk i pranon ai. Faktet janë fakte dhe ato analizohen. Partia jonë i ka të gjitha këto armë, pastaj ajo ka në radhë të parë anëtarët e saj me ndërgjegje të lartë që do t'i thonë edhe gjëra të tjera që Partia akoma nuk i di.

## II. — MBI PUNËN E SËMURË TË NEXHIP VINÇANIT

Komanda edhe Partia i patën dhënë shokut Nexhip Vinçani një post me rëndësi. Mendimi i Byrosë Politike është se në ato kushte dhe për aq sa njihej Nexhipi e kishte mjaft atë vend. Gjatë punës Partia, me sa di unë si Sekretar i saj i Përgjithshëm, kurdoherë e ka kritikuar drejt Nexhipin në çdo rast kur ai ka bërë gabime dhe e ka lartësuar e vlerësuar kur ka punuar mirë, duke e ngritur deri si kandidat të KQ të Partisë. Sipas mendimit të Byrosë Politike dhe timit nuk ka pasur, pra, asnjë arsye që Nexhipi të ishte i pakënaqur. Mund të ketë edhe ndonjë që të jetë i pakënaqur, por rregullat e Partisë e duan që çdo gjë të thuhet në format dhe sipas rregullave që ka Partia. Por na del se te Nexhipi paska pasur një pakënaqësi të madhe, saqë kjo mori te ai një formë të rrezikshme. Kjo ndodhi në festën e 7 Nëntorit.

Shoku Nexhip Vinçani, kur ishte në pritjen që dha Legata Sovjetike, zuri shokun Mehmet dhe i tha si me padurim: «Kur do të vish në Komandën e Përgjithshme që të shpëtosh ushtrinë, pse të presin të

gjithë me gëzim të madh», duke shprehur me këtë haptas një ndjenjë përcmimi ndaj shokëve të tjerë të Komandës së Përgjithshme. Shoku Mehmet u çudit fort nga një sjellje e tillë dhe ju përgjegj aty për aty se nuk janë aspak të drejta këto gjëra që po i thoshte. Por Nexhipi vazhdoi në të tijën. Të njëjtën pyetje atë mbrëmje ja bëri Mehmetit edhe Gjin Marku. Ai menjëherë e kuptoi se të dy këta nuk ishin në rregull, se diçka të sëmure kishte në këtë mes nga ana e tyre. Me rëndësi ishte tani të gjendej se ku e kishin rrënjën këto shfaqje, sepse ato do të kishin patjetër një shkak, një burim. Shokut Mehmet i bënë përshtypje me të drejtë mënyra dhe termat që përdori Nexhipi dhe mendoi se diçka duhet të kishte në këtë mes. Prandaj, na vuri menjëherë në dijeni dhe ne e ngarkuam ta thërriste Nexhipin sa më parë dhe të bisedonte me të. Për këtë qëllim ai e thirrri Nexhipin në shtëpinë e tij po atë natë. Ky përsëriti po ato gjëra, po në formë më të zgjeruar. Pastaj e solli fjalën për punën në Komandën e Përgjithshme, duke u përpjekur të denigronte disa nga kuadrot kryesorë të saj. Mehmeti e pyeti nëse ja kishte vënë në dukje këto gjëra Komandantit të Përgjithshëm, po Nexhipi u përgjegj se kishte pritur rastin ta njoftonte për këto të meta e gabime që ishin atje, po s'kishte mundur, megjithatë disa herë ato ua kishte vënë në dukje shokëve të Komandës. Pastaj ai shtoi se Partia nuk e sheh me sy të mirë për disa «shpifje të poshtra» që qenkan bërë kundër tij. Çështja është për disa shkelje të moralit komunist nga ana e tij.

Në përgjithësi, pra, këto çështje kishim për Nexhipin. Duket qartë se te ky kanë ekzistuar pikëpamje jo

të shëndosha dhe shumë të rrezikshme si për çështje partie, ashtu edhe për çështje ushtarake, të cilat shfaqeshin në mënyrë të çuditshme dhe në momente jo të përshtatshme. Kur na i raportoi shoku Mehmet të gjitha këto gjëra, kuptuam se punët nuk shkonin mirë midis kuadrove të aparatit të Shtatmadhorisë dhe shokut Nexhip Vinçani. Dhe ajo që është shqetësuese, kjo çështje nuk kishte mbetur e veçuar, vetëm te Nexhipi, pse ky i kishte biseduar këto edhe me njerëz të tjerë. Për këtë arsye urdhërova Shefin e Shtatmadhorisë, gjeneral Beqir Ballukun, që të kërkonte nga Nexhipi një raport mbi të gjitha këto çështje, duke i caktuar edhe afatin. Ai e përgatiti këtë raport, po me këto dy të meta:

E para, se raporti nuk ishte adresuar në rrugën e hierarkisë ushtarake. Urdhëri Nexhipit i qe dhënë nga Komandanti i Përgjithshëm i Ushtrisë, kurse letrën ai ja drejtonte Sekretarit të Përgjithshëm të Partisë dhe këtë e bëri me qëllim, se ai i dinte mirë rregullat ushtarake.

E dyta, se në këtë raport ai nuk thoshte asgjë nga ato që kishte biseduar me shokun Mehmet atë natë, qoftë herën e parë, qoftë të dytën. Letra pastaj ishte përgatitur në formën e një raporti, sikur Komandanti i Përgjithshëm të mos kishte fare dijeni për punën që bëhej në Komandën e Përgjithshme të Ushtrisë dhe për të metat që ekzistonin atje. Në këtë letër ai ngre disa probleme për kuadrin e Shtatmadhorisë, por për çështjet që i foli shokut Mehmet që ky të shkonte në ushtri «për të shpëtuar situatën» etj., ai nuk thotë asgjë në këtë letër. Prandaj, ja ktheva atë dhe e porosita t'ja drejtonte Komandantit të Përgjithshëm dhe me këtë rast,

po të kishte harruar ndonjë send nga bisedimi që kishte pasur me shokun Mehmet, ta shtonte. Kjo ishte një ndihmë që i jepej Nexhipit, por ky përveç drejtimit nuk i bëri letrës asnjë ndryshim tjetër apo shtesë.

Duhet vënë në dukje se që kur e thirri Mehmeti për t'u shpjeguar, Nexhipi ishte me mendje të kthjellët dhe aspak i pirë. Ai ishte fare në rregull sidomos të nesërmen, prandaj nuk mund të gjejë asnjë arsye përse të harronte në raport çështjet që ishin më delikate. Por kjo është bërë me qëllim. Gjithashtu me qëllim është bërë edhe drejtimi i letrës, e cila në vend që t'i adresohet Komandantit të Përgjithshëm të Ushtrisë, i drejtohej Sekretarit të Përgjithshëm të Partisë, pse rruga e parë e çonte atë në masa ushtarake, gjëra këto që i kuptonte Nexhipi.

Unë vetë nuk kisha mundësi ta thërrisja shpejt Nexhipin për të biseduar, prandaj kaluan disa kohë. Kjo duhej të ishte për të një mundësi që do ta ndihmonte për ta realizuar gabimin e tij. Kështu vetëm pas disa javësh munda ta thërrisja për ta sqaruar dhe ndihmuar. Por kur e thirra, ai nuk mbajti një qëndrim komunist përpara meje dhe shokëve të Komandës. I kërkova të shpjegohej më thellë dhe me zemër të hapur, përse ngjau kjo gjë me të, por Nexhipi nuk tha gjë. Kur i kërkova të jepte shpjegime për disa gjëra, sidomos nga se do ta shpëtonte shoku Mehmet ushtrinë, ai tha se nuk është e vërtetë që ta ketë shprehur atë mendim. Kur e pyetëm pse i tha shokut Mehmet që ky të vinte në ushtri, u përgjegj se këtë e bëri, sepse kështu kishte dëgjuar të thuhet tre-katër muaj më parë. Kur unë e pyeta se përse nuk kishte ardhur me kohë te unë

për të bërë vërejtjet që kishte ose për t'u sqaruar, ai u përgjegj se kishte pritur të gjente rastin ose kur të shtrohej plani operativ. Këtu ka çështje të tjera — i thashë përsëri — ka çështje pakënaqësie nga ana jote. Ai mohoi gjithashtu të ketë folur për çështje kuadri. I thashë, më në fund, përse mendonte që Partia nuk e kishte parë me sy të mirë? «Kjo gjë as që më ka shkuar ndër mend», përfundoi ai. Këto tha dhe iku.

Nga e gjithë puna e tij del se Nexhipi ka pasur pakënaqësi dhe nuk tregoi asnjë fije sinqeriteti për të sqaruar qëndrimin e tij ndaj Komandës dhe si anëtar i një forumi të lartë të Partisë. Nga ana ushtarake Byroja Politike mori masat e saja, por menduam t'i jepnim edhe një herë mundësinë dhe rastin Nexhipit të shpjegohej më qartë. Për këtë qëllim e thirrëm përpara Byrosë Politike, po ai mbajti edhe aty një qëndrim borgjez. Është e vërtetë se në raport Nexhipi kishte shkruar edhe disa gjëra të drejta, si për disa të meta në punën e Shtatmadhorisë, ashtu edhe për disa çështje kuadri, të cilat, po të ishin shtruar në rrugën e drejtë të Partisë, do të ishin zgjidhur me kohë. Po ai nuk veptoi kështu, pse disa gabime që janë vërtetuar atje, ai, i shtyrë nga megalomania e tij, i ka përdorur për qëllime të tjera, karrieriste, duke përdorur forma të dënueshme nga Partia dhe nga Komanda ushtarake. Edhe përpara Byrosë Politike ai i mohoi prapë këto gjëra. «Këto mund të jenë, meqenëse thotë shoku Mehmet», «u duk puna ime» etj., të tilla ishin shprehjet e tija përpara udhëheqjes së Partisë. Me këto ai donte të na thoshte «e ç'bisedojmë kot këtu, çdo gjë është paravendosur për mua». Kur i kërkoi Byroja Politike shpjegime

për këto shprehje, ai dha disa sqarime pa kripë. Shprehje të tilla Nexhipi i ka lëshuar edhe dy herë të tjera, edhe ditën që ju komunikua shkarkimi.

Nexhipi ka kryer edhe akte të tjera të rënda, duke bërë përpjekje për të pregatitur opinionin sikur nuk është ai fajtori, po ka në Parti diçka që nuk shkon mirë, pse, sa për Nexhipin, ai është besnik i BRSS. Edhe Nexhipi si Niaziu, i cili kërkon të vejë drejtor ferme dhe ka vendosur të shkojë vetëm në festën e Legatës së BRSS, kurse refuzon të marrë pjesë në çdo veprimtari që organizon Partia jonë, përpiqet të tregohet se është besnik i BRSS dhe deklaroi se do të qëndrojë kurdoherë kështu. Unë u them atyre se kush nuk është besnik i Partisë së Punës të Shqipërisë, nuk mund të jetë kurrë besnik i BRSS. Por këto nuk janë shfaqje të izoluara të këtij njeriu. Nexhipi nuk ka bërë kurrë përpjekje për t'i zhdukur të metat e tija të theksuara mikroborgjeze dhe as këtu nuk na i tha shkaqet. Gjatë kësaj kohe ai ka pasur shumë herë takime me shokë të Komandës, po nuk ka bërë asnjë çap përpara për të korrigjuar pikëpamjet e tija të gabuara. Ai na ka bërë dhe një letër tjetër, por edhe në këtë qëndron në të njëjtat pozita. Shkeljet e normave të moralit proletar nga ana e tij ai përpiqet gjithashtu t'i minimizojë.

Nexhipi në çdo rast ka mbajtur një qëndrim këmbëngulës, është përpjekur t'i mohojë ato që i kishte thënë shokut Mehmet nga të cilat del, midis të tjerash, se ai nuk ka pasur asnjë konsideracion ndaj disa kuadrove me përgjegjësi në Parti dhe në ushtri. Ai nuk ka thënë përse kanë ngjarë kështu këto gjëra. Edhe Nexhipit ne i kemi dhënë një ndihmë të madhe që të spastro-

hej dhe të shërohej, por ai nuk ka dashur ta bëjë një gjë të tillë.

Kjo është me pak fjalë çështja e Nexhipit që mendojmë gjithashtu se është me shumë rëndësi. Tani, mbasi të flasim këta shokë, anëtarët e Komitetit Qendror le të shprehin mendimin e tyre dhe le të gjykojmë së bashku për punën e sëmurë e prej grupazhi të këtyre katër shokëve.

*Botohet për herë të parë sipas  
procesverbalit të mbledhjes  
së Plenumit V të KQ  
të PPSH që gjendet  
në AQP, me disa  
shkurtime*



## FJALA E MBYLLJES NË PLENUMIN V TË KOMITETIT QENDROR TË PARTISË SË PUNËS TË SHQIPËRISË

22 shkurt 1950

Sipas mendimit tim, plenumi ynë e analizoi dhe e gjykoi drejt veprimtarinë prej grupazhi, që kanë zhvilluar disa anëtarë partie, me disa shokë të Komitetit Qendror në krye. Siç theksuan edhe shokët e tjerë që diskutuan këtu, puna e këtij grupi e ka dëmtuar rëndë Partinë dhe shtetin tonë. Anëtarët e tij, sipas mendimit tim, që pajtohet plotësisht me diskutimet e të gjithë shokëve të Komitetit Qendror, jo vetëm janë zhytur në një veprimtari të errët grupazhi, por gradualisht do të kalonin edhe në fraksion e komplot kundër Partisë, gjë që do ta dëmtonte atë edhe më shumë. Por kjo nuk ndodhi, sepse Partia, që nga baza dhe deri në Komitetin Qendror, ka vërgjiluar në mënyrë revolucionare. Në këtë çështje me rëndësi të madhe për unitetin e Partisë dhe vijën e saj të drejtë kanë ndihmuar të gjithë shokët, në radhë të parë anëtarët e Plenumit të Komitetit Qendror.

Patjetër, çdo pesim bëhet një mësim, por Partia dhe udhëheqja e saj, që kanë një përgjegjësi të madhe për-

para popullit, veprime të tilla që kurdisen prapa shpine duhet t'i nuhasin me kohë, t'i diktojnë që në embrion, kur ato porsa fillojnë të shfaqen, me qëllim që të zhduken shpejt e të ketë sa më pak dëme politike dhe ekonomike, si dhe sa më pak dëme në kuadro e, po të jetë e mundur, të mos ketë fare, sepse kuadrot janë një thesar i madh për Partinë.

Ne e dimë se Partia jonë i dënon grupet dhe fraksionet. Grupe dhe fraksione kurdisin vetëm njerëzit që nuk janë komunistë të shëndoshë e të ndërgjegjshëm. Komunist nuk mund të quhet ai që di diçka, ose që hiqet sikur di shumë nga teoria marksiste-leniniste, por që nuk punon e nuk lufton për zbatimin e vijës së Partisë. Komunist i vërtetë është ai që e do me gjithë zemër Partinë dhe lufton për të zbatuar me besnikëri vijën e drejtë të saj, që mbron interesat e klasës punëtore dhe punon për të mirën e popullit. Një njeri, që nuk është besnik dhe i denjë për Partinë, në rrethana dhe momente të caktuara, mund të arrijë të pranohet edhe në radhët e saja, por më në fund vjen dita që ai shkon në një rrugë të kundërt me atë të Partisë. Kjo nuk do të thotë aspak që Partia të mos luftojë për t'i ndrequr ata elementë që kanë të meta, por që qëndrojnë afër Partisë. Kështu vepron Partia jonë dhe Komiteti Qendror i saj me ata që gabojnë, por që i njohin gabimet e tyre dhe bëjnë përpjekje të korrigjohen dhe nuk mbajnë qëndrim si të pandreqshmit, që janë të destinuar të shkojnë deri në fund në rrugën e tyre të gabuar.

Në Partinë tonë dhe në vetë Komitetin e saj Qendror kanë ndodhur edhe më parë ngjarje si këto që po analizojmë, të cilat kanë arritur deri në veprimtari

armiqësore. Ato na kanë mësuar të gjithëve se si të gjykojmë me pjekuri dhe drejtësi mbi çështjet dhe mbi njerëzit. Duke u nisur nga eksperiencia që ka tashmë Partia jonë, ne i pyetëm shokët, për të cilët diskutojmë në këtë plenum, se cila është veprimtaria e tyre dhe a kanë shkarë ata nga pozitat e shëndosha të Partisë. Ne i ndihnuam ata t'i analizojnë mirë pikëpamjet dhe qëndrimet e tyre të gabuara, të nxirrnin shkaqet, si dhe përse u zhvillua kjo frymë grupazhi, kjo punë armiqësore. Por ata u përpoqën të mbajnë shumë rezerva ndaj Partisë dhe Komitetit Qendror, bile u munduan të fshehin gjithshka. Po a mund të bënin këta një autokritikë të shëndoshë përpara Partisë? Unë mendoj se jo, pse shokët e këtij grupi janë shumë të sëmurë. Megjithkëtë, për ne doli e qartë se cila ishte puna e tyre, cilat janë qëllimet e tyre. Do të gabonim po të mos i shihnim çështjet siç janë, në rast se nuk do të gjykonim mirë dëshirat dhe qëllimet e shokëve që kanë gabuar.

Nuk dëshiroj të bëj krahasime, po eksperiencia e Partisë, te e cila ne duhet të mbështetemi patjetër, është e tillë që na jep mundësinë për të bërë edhe ndonjë krahasim. Duke analizuar të gjithë punën dhe metodat e këtyre shokëve, mund të themi se ato u ngjajnë shumë atyre të Koçi Xoxes, megjithëse veprimtaria e tyre nuk arriti në atë shkallë armiqësore. Çfarë bëri Koçi Xoxe me punën e tij prej armiku? Ai deri në fund përsëriti shumë herë se gjoja ishte besnik i Partisë, bile në fillim nisi të bëjë në forma të përgjithshme edhe «autokritikë», por çështjet që ishin shumë komprometuese për të, nuk i pohoi asnjëherë. Koçi Xoxe premtoi vazhdimisht përpara Komitetit Qendror dhe aktiveve

të Partisë se në mbledhjen e ardhshme «do të hapej» më tepër, pse ato që i thuheshin i kishin bërë shumë përshtypje etj., por në realitet asgjë nuk i kishte bërë përshtypje dhe në çdo mbledhje të re që zhvillohej ai mblidhte më shumë këmbët, në vend që të përparonte dhe asgjë nuk i tha Partisë. Edhe pjesëtarët e këtij grupazi pikërisht kështu veprojnë, përdorin të njëjtat metoda dhe procedura.

Këtu u tha drejt se këta shokë, në vend që të përfitonin nga ndihma që po u jepte Partia dhe të merrnin eksperiencën e mirë për ta zbatuar në jetë, vepruan ndryshe, përvetësuan metodat e njerëzve që nuk kanë ecur në rrugën e Partisë. Në një gabim të tillë ata kanë rënë, pse nuk ishin të pastër.

Duhet vënë në dukje se, ndërsa Koçi Xoxe ishte i lidhur me trockistët jugosllavë, këta nuk kanë të bëjnë me ta ose me armiq të tjerë, brenda apo jashtë vendit. Megjithatë, kjo nuk do të thotë se nesër edhe këta nuk do të lidheshin me ta. Spiunët e imperializmit i mbajnë veshët ngritur për të mësuar ku ka ndonjë të çarë apo pakënaqësi, ku nuk shkojnë mirë punët që të lëshojnë pastaj me marifet grepin, së pari te elementët që janë më të dobët, pastaj duke praktikuar të njëjtat metoda, për të komprometuar keqazi të tjerët dhe në atë shkallë sa të mos ishin në gjendje të delnin dot nga zinxhiri i tyre. Këto synime e veprime të armikut është mirë t'i dinë të gjithë shokët, si ne, edhe ata që kanë gabuar, por që akoma nuk kanë vajtur deri atje sa t'i shtjerë në dorë armiku, megjithëse rreziqet akoma nuk janë mënjanuar. Ne në asnjë mënyrë nuk duam që shokët e këtij grupi, qoftë edhe një prej tyre, të ndjekin më

tej rrugën armiqësore dhe nesër të kapen nga armiku, përkundrazi, dëshirojmë dhe përpiqemi deri në fund t'i shpëtojmë dhe kemi bindje se Partia do t'i fitojë ata, veç në mos daçin vetë të hyjnë përsëri në rrugën e saj të drejtë. Këto rreziqe, pra, ekzistojnë, prandaj të mbahen mirë parasysh prej tyre.

Sëmundja e formimit të grupeve në Partinë tonë ka ekzistuar dhe këtë e kemi thënë edhe herë të tjera. Megjithatë, këtë gjë ne duhet ta theksojmë e ta analizojmë përsëri dhe të mos e harrojmë për asnjë çast. Historia e Partisë sonë na mëson se grupet, ku më shumë e ku më pak, kanë pasur gjithmonë tendenca shumë të rrezikshme. Abedin Shehu e preku pak këtë, por kur erdhi çështja për të pohuar nëse konkretisht ai vetë ishte apo jo në grup, e kaloi me shpejtësi këtë çështje dhe duke e mohuar tha: «Unë nuk kam qenë anëtar i grupit». Por pikërisht te grupi duhet të gjejë Abedin Shehu origjinën e formimit të tij ideologjik, që e solli në kundërshtim me Partinë. Ai ka qenë josimpatizant i grupit të «Të Rinjve», po anëtar i këtij grupi. Pas formimit të Partisë, disa njerëz të grupit të «Të Rinjve» u përpoqën vazhdimisht të marrin pozita në Parti, të jenë në udhëheqje të saj. Këtë frymë u kishin dhënë atyre Anastas Lula dhe Sadik Premtja. Megjithatë, një numër i madh shokësh të këtij grupi, me formimin e Partisë, u shëruan, ndërsa ata që vazhduan dhe mbetën të shëmurë, e gjetën vendin. Pjesa tjetër, që në dukje tregonte se u shëndosh, por që në të vërtetë akoma nuk qe shëruar plotësisht, u afrua me Partinë, por qe e pamundur ta ndiqte atë deri në fund.

Tendenca e grupit të «Të Rinjve» ka qenë megallo-

mania e sëmurë. Në radhët e tija bëheshin përpjekje të krijohej opinioni se pjesëtarët e këtij grupi ishin njerëzit më të zot, më të ditur, më aktivë, më të hedhur, më trima etj. Kjo megalomani është shfaqur më vonë edhe në ish-anëtarë të grupit të «Të Rinjve» sidomos te Abedin Shehu; në kokën e tij dhe të disa të tjerëve, në mënyrë të ndërgjegjshme ose jo, ekzistonte pikëpamja e sëmurë se «janë njerëz të kualifikuar, të guximshëm dhe organizatorë», prandaj kundrejt tyre na qenkësh bërë një padrejtësi nga ana e Partisë, e cila duhej t'i vlerësonte më shumë. Edhe rrethanat kanë ndihmuar që këto tendenca të zhvilloheshin më shumë në kokën e tyre. Është për këtë arsye që këta në shumë drejtime kanë qenë në kundërshtim me Partinë në mënyrë të mbuluar dhe në çdo moment kanë punuar kundër vijës së saj.

Abedin Shehu dhe disa shokë të tjerë me prejardhje nga grupi i «Të Rinjve» i kanë ruajtur lidhjet gjatë gjithë luftës, natyrisht, jo në mënyrë të rregullt organizative, por në formë bisedash. Lidhje të tilla ata i vazhduan edhe pas luftës. Kur takoheshin njëri me tjetrin këta ish-anëtarë të grupit të «Të Rinjve» sikur u hahej më shumë muhabeti, si i thonë, u pajtohej gjaku. Kur doli sheshit tradhëtia e trockistëve jugosllavë, unë mendoj se ata e pritën këtë edhe me gëzim, edhe me habi, po edhe me frikë. E pritën me gëzim, sepse janë njerëz që duan të përfitojnë nga zhvillimi i ngjarjeve, pse nuk kanë besim te Partia, prandaj duan të ndryshojë gjendja. Pra, këta janë njerëz që presin të ndryshojë situata. Këta nuk kanë qenë të implikuar drejtpërdrejt në organizimin e punës armiqësore të trockis-

tëve jugosllavë kundër Partisë dhe vendit tonë, po duke menduar se «do të ndërrojë situata» u gëzuan. Pra, si të tillë nuk janë të vendosur të luftojnë si revolucionarë për të mos ndodhur asgjë në dëm të Partisë sonë, për të mos u krijuar situata të vështira në vendin tonë. Duke pritur se do të ndodhin ndryshime, këta njerëz të pakënaqur menduan se kur u bë Plenumi VIII, «këtu diçka do të bëhet». Por këta kanë pasur edhe frikë, se Partinë e kanë parë-te personi i Koçi Xoxes. Në të vërtetë ky as i ka ndjekur ndonjëherë, as i ka persekutuar, por ata i ndiqte vigjilenca e Partisë, e cila me gjithë punën e poshtër të Koçi Xoxes, nuk ishte shuar. Partia nuk harronte kurrë kush ishte Isuf Keçi dhe disa elementë të tjerë të grupeve, që akoma nuk qenë shëruar. Megjithatë, në të njëjtën kohë, ajo përpiqej t'i riedukonte, t'i shëronte. Por sa më shumë që forcohej puna e trockistëve jugosllavë kundër Partisë sonë, aq më shumë edhe vigjilenca e saj shndërrohej nga një vigjilencë revolucionare, në një vigjilencë policore. Këta clementë të sëmurë, që i shikonin metodat e huaja të futura me qëllim në Partinë tonë nga trockistët jugosllavë, i merrnin ato si persekutime ndaj tyre, prandaj kishin edhe frikë nga Koçi Xoxe, duke kujtuar se ai do të fillonte t'i luftonte. Mendime të tilla, pra, kanë pasur në kokën e tyre këta njerëz të sëmurë, prandaj vepronin në kundërshtim me vijën e Partisë duke bërëtitur pas Plenumit VIII më shumë se kushdo «rraftë Koçi Xoxe që shpëtoi Partinë»!

Unë nuk mendoj që të jenë gënjyer këta njerëz dhe këtë e vërteton fakti se Koçi Xoxe nuk i goditi, siç mendonin, pse nuk e kishte syrin te ata. Qëllimi i troc-

kistëve jugosllavë dhe i Koçi Xoxes ishte të goditeshin njerëzit e shëndoshë të Partisë. Realiteti është se Koçi nuk e goditi Abedin Shehun, bile ai e ngriti atë në përgjegjësi. Po a puqeshin vallë këta njerëz me Koçi Xoxen? Me siguri ata do të puqeshin në rast se trockistët jugosllavë, me agjentin Koçi Xoxe dhe shokët e tij, do të triumfonin në Partinë tonë. Po kjo nuk ngjau, pse Partia Bolshevike, me Stalinin në krye, e zbuloi me kohë punën armiqësore të trockistëve jugosllavë, ashtu siç e kishte nuhatur edhe Partia jonë punën armiqësore të trockistëve jugosllavë në Shqipëri dhe të Koçi Xoxes me shokë. Në këto momente të reja këta elementë e kthyen përsëri pllakën, me qëllim që të përfitonin nga situata e re e krijuar. Ato që thanë vetë se, pas zbulimit të punës armiqësore të trockistëve jugosllavë në Parti filluan të flisnin nga të katër anët, ishin të drejta. Me këto mënyra dhe frymë të sëmurë kërkuan të përfitonin ata. Por komunistët e shëndoshë nuk menduan dhe nuk vepruan ashtu, pse, duke e kuptuar krejt ndryshe gjendjen e re, filluan t'ja thoshin hapur Partisë gabimet e tyre të rënda, me qëllim që të spastroheshin dhe në të vërtetë njerëzit e shëndoshë, që kishin bërë gabime, u spastruan nga to.

Ndryshe ndodhi me njerëzit e këtij grupi antiparti. Këta nuk reflektuan fare në këtë drejtim, përkundrazi u munduan të fshehin gabimet e tyre dhe të sulmojnë të tjerët. Autokritikën e shumë komunistëve filluan ta shfrytëzojnë për t'i futur edhe më poshtë nën dhé, ndërsa veten u përpoqën ta nxjerrin si të persekutuar, duke propaganduar njëkohësisht sikur gjoja këta i kishin parë drejt çështjet. Për këtë manevër të tyre ata ishin edhe



vetë të bindur. Abedin Shehu ishte nga ata që mendonte se i paskësh parë drejt çështjet dhe se pikëpamjet e tija paskëshin qenë vazhdimisht të drejta. Duke menduar e vepruar në këtë mënyrë, thellohej opozicioni i tij kundër Partisë. .

Po vallë ishin në gjendje këta njerëz ta mposhtnin Partinë? Jo, nuk ishin. Me gjithë momentet e vështira që po kalonte Partia, ata nuk qenë në gjendje të merrnin frenat e Partisë në duart e tyre, prandaj u mbeteshin dy rrugë: ose me Koçi Xoxen dhe jugosllavët, ose të rrinin në Parti dhe të ndiqnin rrugën e saj të drejtë. Por edhe brenda në Parti këtyre u mbeteshin përsëri dy rrugë: ose të spastroheshin nga të gjitha të këqijat që kishin deri atëhere, ose të ndiqnin rrugën e dytë, të rrinin në Parti, po të punonin për qëllimet e tyre të kundërta me ato të Partisë. Nuk kishte momente më të përshtatshme se këto, që Abedin Shehu të spastrohej, por ai nuk e bëri këtë. Sipas mendimit tim, Abedini përfitoi nga situatat, për arsye se, pas gjithë atyre padrejtësive që qenë bërë, kishte ardhur koha që Komiteti Qendror i Partisë të rishikonte të gjitha gabimet dhe dënimet që ishin dhënë dhe të ndërronte opinionet pa baza ndaj kuadrit, që ekzistonin në kokën e disave. Mirëpo këta, dhe në radhë të parë Abedin Shehu, e mashtruan udhëheqjen e Partisë dhe, siç e thanë me të drejtë gjithë shokët që diskutuan në këtë plenum, këto qëndrime mbahen prej tyre pas Kongresit I të Partisë, duke shkelur mirëbesimin e tij.

Bëhet pyetja: përse ngjasin këto gjëra nga shokë që kanë pozita të larta në Parti dhe në shtet? Unë mendoj se që nga Kongresi I i Partisë, në kokën e Abedin She-

hut dhe të shokëve të tjerë të këtij grupi ekzistonin pikëpamje të sëmura, se nga ana e tyre u bënë përpjekje për të gënjyer Partinë e për të zënë pozita të rëndësishme në forumet e saj dhe të shtetit. Një qëllim të tillë ndjekin njerëzit e sëmurë të grupeve. Mbasi të merrnin pozita me rëndësi, mendohej pastaj të fillonte rigrupimi i tyre, pse e dinin mirë që fuqia nuk mund të merret në dorë pa krijuar forcën e domosdoshme, që do t'u shërbente për të realizuar qëllimet e tyre.

Pas Kongresit I këta njerëz zunë të rigrupohen dhe të nisin nga puna konkrete. Ashtu si u zhvilluan vetë ngjarjet, ata filluan, së pari, nga miqësitë e sëmura. Faktet tregojnë se pjesëtarët e këtij grupi ruajnë po ato tipare organizative, politike dhe morale të grupit të «Të Rinjve»: ata nuk kanë besim te Partia (dhe po të rikujtojmë të kaluarën, karakteristikë e anëtarëve të grupit të «Të Rinjve» ishte mosbesimi te Partia), nuk i binden udhëheqjes së Partisë dhe të shtetit (udhëheqësit e grupit të «Të Rinjve», gjithashtu, jo vetëm nuk e deshën formimin e Partisë, por pas krijimit të saj e luftuan atë me të gjitha mënyrat). Pra, te këta shokë nuk ekziston as besimi te Partia dhe udhëheqja e saj dhe as i binden asaj dhe për këtë provat janë të gjalla.

U ngritën këtu edhe nga disa shokë çështje që kanë të bëjnë me moralin e njerëzve të këtij grupi. Unë dua të theksoj se normat morale të pjesëtarëve të grupit janë po ato të grupit të «Të Rinjve». Jeta e çrregullt e pjesëtarëve të këtij grupi dhe qëndrimet imorale të disave, sidomos të Hamit Keçit e Isuf Keçit, janë karakteristike të moralit të grupit të «Të Rinjve» e të kuptimit të shtrembër të familjes dhe në kundërshtim

të plotë me moralin e shëndoshë komunist që ushqen Partia jonë për qëndrimin ndaj familjes e shoqërisë.

Edhe Niazi Islami, megjithëse erdhi nga grupi i Korçës, nuk ka pasur asnjëherë besim te Partia dhe udhëheqja e saj. Lidhur me këtë çështje, nuk dëshiroj të numëroj këtu të gjitha faktet që u vunë në dukje në plenumin tonë, por dua të them se çdo gjë tregon qartë se Niazi Islami ka qenë në opozicion flagrant me Partinë, me udhëheqjen dhe vijën e saj. Këtij, ashtu si edhe Isuf Keçit pas kongresit, me gjithë të metat, gabimet, karakterin e dobët dhe pikëpamjet e tija të sëmura që ka pasur, Partia i dha përsëri dorën dhe mundësinë të ndreqej.

Byroja Politike mendoi se ishin momentet që këta njerëz, duke u ndihmuar nga Partia, të mund të punonin dhe njëkohësisht të pastroheshin nga mbeturinat e shumta që kanë pasur e të përmirësoheshin. Po fakti është se Isuf Keçi, i cili kurrë nuk ka pasur besim te Partia dhe udhëheqja e saj, ka qenë një tip anarkist dhe trockist dhe i tillë vazhdon të jetë akoma. Këtë e vërteton më së miri edhe fakti, se ky njeri ka qenë në dijeni të të gjitha poshtërsive të vëllait të tij, Hamit Keçit, por asgjë nuk i ka treguar Partisë. Jo vetëm kaq, por kalon edhe në aksion, ai bën propagandë kundër Partisë dhe shtetit tonë, duke u përpjekur të krijojë mendimin se po bëhen «padrejtësi» kundër të vëllait të tij. Një gjë të tillë ai e bën si në radhët e njerëzve të Partisë, ashtu edhe me njerëz pa parti, që janë miq të Partisë. Ai nuk u tregon atyre të vërtetën, për të cilën është mirë në dijeni, por u thotë se «Hamit Keçi arrestohet për arësye grindjesh personale me disa shokë». Që-

llimi i Isuf Keçit, që vepron kështu, është që të gënjejë të tjerët, t'i armiqësojë ata me organet shtetërore dhe me Partinë dhe t'i shkëputë në favor të grupit të tij. Kështu ka menduar Isuf Keçi, kurse ata që ai kujton se do t'i bëjë me vete janë njerëz të ndershëm që s'bien në kurthë të tilla, por e vënë menjëherë në dijeni Partinë.

Por tendenca e njerëzve të sëmurë si Isuf Keçi, që gjërat i thonë sa andej-këtej me qëllime të caktuara, Partia i ndjek me vëmendje dhe u del atyre me kohë përpara. Prandaj, njerëzit e këtij grupi duhet ta lënë një herë e mirë rrugën e tyre të gabuar dhe të mos shkelin më në dhogë të kalbur, pse, po vepruan edhe një herë, Partia nuk do t'i falë më. Partia është e gjerë, ajo fal një herë, dy, tri, po pastaj thotë «Ndal!»

Shoku Shyqri Këllezi nuk është zhytur aq thellë sa pjesëtarët e tjerë të këtij grupazhi, pse te ai ka qenë e fortë dashuria për Partinë, por nga puna e zhvilluar në këtë shoqëri elementësh të sëmurë, kjo dashuri atij i është errësuar. Unë mendoj se këtë njeri e ka marrë më qafë, në radhë të parë, Abedin Shehu. Shyqriu ka qenë një shok i ri, punëtor, por është pak si kalama, siç e cilësoi një shok këtu, prandaj ai ka shumë nevojë që të piqet akoma. Eçhe këtij i ka pëlqyer mënyra e jetesës së grupit, ka qenë mbërthyer prej tij, saqë ka filluar të dyshojë për Partinë dhe të luftojë kundër saj. Veprimet e tij të përcmimit të organizatës së Partisë në Kuçovë janë hapat e parë të një lufte me Partinë. Megjithatë, unë besoj se Shyqri Këllezi nuk ka arritur deri atje sa të mendojë që të rrëzohet ky ose ai shok i udhëheqjes, ai është në atë fazë që ka akoma

vetëm mendimin e gabuar se «pas Komandantit, Abedin Shehu i sheh më mirë se kushdo çështjet», se ky «ua hedh gjithë të tjerëve». Komandantin këta njerëz nuk e preknin dot, pse nuk kishin aq fuqi dhe, po të flisnin kundër tij, do të binin në sy, prandaj u duhej ta fillonin luftën ndryshe, të goditnin Partinë me pikëpamjet e metodat e tyre të shtrembra, të cilat filluan t'i pëlqenin edhe Shyqri Këllezit.

Shyqri Këllezin, si punëtor, e kanë përpunuar me idetë e tyre të gabuara shokët e tij të grupit, të cilët nuk kanë pikëpamje të drejta për klasën punëtore dhe ideologjinë e saj. Në trurin e tyre ekzistojnë gjithfarë konceptesh mikroborgjeze, prandaj është vështirë që ata të durojnë rregullat e Partisë sonë marksiste-leniniste. Me pikëpamjet e tyre të shtrembra këta elementë ja dërmuan edhe Shyqriut ndërgjegjen dhe në këtë rast me këtë ndodhi tamam si në vendet kapitaliste, ku ka edhe punëtorë që degjenerojnë. Këta punëtorë, të dalë nga radhët e klasës së tyre, lëvizjen e fillojnë me mbrojtjen e të drejtave të klasës punëtore, dallohen, po, duke mos qenë konsequentë në rrugën revolucionare, më në fund e tradhëtojnë klasën, u nënshtrohen dollarëve të kapitalistëve dhe u shërbejnë atyre, kthehen kështu në aristokratë të klasës punëtore. Edhe te ne, borgjezia përpiqet t'i degjenerojë ata elementë që nuk e kanë të fortë ndjenjën e klasës punëtore dhe besimin e patundur të Partia e saj. Pra, ne ndeshemi me një fenomen, që duhet të na preokupojë, armiku përpiqet të na deklasojë punëtorët tanë. Në rastin konkret mund të themi se edhe Shyqriu u shndërrua në një punëtor aristokrat. Ai, meqenëse erdhi deri në Komitetin Qendror të

Partisë, duhej të mbetej gjithnjë një punëtor i thjeshtë. Po njerëzit e këtij grupi, me pikëpamjet e tyre trociste, e bënë atë t'i rritej mendja dhe ky njeri, që vjen nga radhët punëtoresh, shan shokët e tij punëtorë, i diskrediton ata, sikur të ishte padroni i tyre, siç bën edhe N.M. që nuk ka ndryshuar aspak nga e kaluara dhe vazhdon të ruajë të gjitha veset e të metat e grupit të «Të Rinjve», të jetë llafazan dhe të sillet në mënyrë të pahijshme me punëtorët. Shyqri Këllezi arrin deri atje sa të mos përfillë as organizatën e Partisë në Kuçovë etj. Ai harron se Partia i kërkon llogari jo vetëm atij, po edhe gjithë Komitetit Qendror. Partia në Kuçovë, duke dyshuar për punë të keqe në pusë, kërkoi të bëhej një kontroll, ndërsa Shyqri Këllezi thotë: «mos doni të kontrolloni dhe drejtorinë e kombinatit?» Po, Partia edhe drejtorinë e kombinatit mund ta kontrollojë dhe ta vëjë para përgjegjësisë për dobësitë që ekzistojnë.

Siç e pamë të gjithë, në ballë të këtij grupi na del Abedin Shehu. Ky diti t'i grumbullojë këta elementë të sëmurë, t'i njohë dhe t'i lidhë si duhet e, duke qenë më i zgjuar se të tjerët, u përpoq të fshihte dorën, po u tradhëtua nga Niazi Islami dhe Hamit Keçi, që nuk u treguan të matur, duke kujtuar se zunë kokën e peshkut. Nga të gjitha sa u thanë, del se këta njerëz nuk janë të qartë ideologjikisht, veç kësaj atyre u ka munguar edhe dashuria e komunistit për popullin.

Abedin Shehu e ka gënjyer Komitetin Qendror të Partisë, duke shkruar në biografinë e tij se është njeri i masave. Mirëpo provat vërtetojnë të kundërtën, as ai as shokët e tij nuk janë të tillë. Ka qenë një nga taktikat

e Abedinit ajo që për çdo gjë thoshte se do ta bisedojë «në mënyrë popullore», pse kështu mendonte ta zbatonte qëllimin e tij dhe të grupit dhe të kishte kështu mundësi të gënjente njerëzit.

Duhet thënë se Niazi Islami nga ana e tij ka dëmtuar rëndë interesat e shtetit. Sipas mendimit tim, ai ka sabotuar punën në Ministrinë e Komunikacioneve, ka punuar atje sikur të kishte ecur symbyllur, pse një njeri, që e do me gjithë zemër Partinë dhe është vigjilent, nuk mund të lejonte kurrë të ndodhnin sabotime në hekurudhë. Ai nuk ka pasur asnjë lidhje me popullin. Kështu mund të themi edhe për Isuf Keçin. Ky dhe vëllai i tij kanë lidhje vetëm me kulakët. Në shtëpinë e tij vinin vetëm kulakë, atje diskutohej vetëm për «padrejtësitë» që u bëheshin kulakëve. Të tillë njerëz vinin te ai. Kjo ka qenë pikërisht një nga karakteristikat e grupit të «Të Rinjve» që është trashëguar prej tyre.

Grupi i Abedin Shehut nuk ka bërë vetëm muhabetë, po merrte edhe vendime, sikur të ishte qeveri, pse për pjesëtarët e tij qeveri dhe Komitet Qendror të Partisë nuk kishte. Këta vetë ishin si një forum dhe pak nga pak po shkonin larg. Në kokën e tyre, në radhë të parë te Abedin Shehu e pastaj te të tjerët, kishin filluar të kristalizoheshin shumë gjëra të shtrembra.

A mund ne të pranojmë lehtë se në industri nuk ka pasur një punë të organizuar armiqësore nga ana e këtij grupi? Unë mund të them se jo vetëm tani që atje ka vajtur Abedin Shehu, por edhe më parë ka pasur punë armiqësore, sepse kanë vepruar njerëzit e këtij grupi. Atje ka pasur sabotim nga ky grup, pse kudo ku kanë punuar këta është vënë re që punët nuk kanë

vajtur mirë. Punëtorët nuk shkojnë në Krrabë, nga qendrat e tjera ata largohen prej pune, në Kuçovë nuk realizohet plani dhe për të gjitha këto, sipas njerëzve të këtij grupi, fajin e paska Partia. Kjo nuk është e vërtetë, pse anëtarët e Partisë po shkrihen në punë, por çështja është se në ndërmarrjet shtetërore punëtorët nuk kanë as minimumin e kushteve të jetesës.

Duke marrë parasysh gjithë këto që u thanë, kush na siguron se grupi nuk ka punuar me qëllim në këto drejtime? Përse Shyqri Këllezi nuk u bindej urdhërave të ministrit të industrisë, shokut Gogo Nushi? Përse nuk vete puna mirë në Patos? Përse sillet ai si padron me punëtorët dhe nuk ka ndërtuar akoma dushet për ta, megjithëse unë vetë i kam tërhequr vëmendjen dy herë për këto gjëra? Kështu do t'i lëmë ne të shkojnë këto gjëra? Jo, këtë nuk mund ta lejojmë, pse punët pastaj do të na ecin keq edhe populli ka të drejtë të na zëjë me gurë. Por nga kush presim t'u krijohen këto kushte punëtorëve, nga Dali Ndreu?<sup>1</sup> Apo mos vallë kanë munguar fondet për këtë qëllim? As kjo nuk mund të pranohet. Të gjitha këto sabotime dhe intriga, përveç të tjerave, kishin për qëllim të dobësonin pozitat e shokëve të shëndoshë të Partisë në sektorin e industrisë e minierave, si dhe në disa dikastere të tjera, për të pasur pjesëtarët e këtij grupi duart e lira në veprimtarinë e tyre antiparti e prej arrivistësh të sëmurë. Ata duket

---

<sup>1</sup> Në tetor 1947 Dali Ndreu u përjashtua si anëtar i KQ të PKSH dhe pas shkarkimit nga funksionet që kishte në ushtri, u ngarkua me punë në Ministrinë e Industrisë. Më vonë u përjashtua nga Partia për tradhëti të lartë ndaj atdheut, u gjykua dhe mori dënimin e merituar.



se nuk janë të masave, nuk duan të punojnë në bashkimet profesionale. Një njeri me profesion shofer si Niazi Islami, që duhet të ndjente kënaqësinë më të madhe për të punuar në bashkimet profesionale me punëtorët, kërkoi të ikte që andej, pse, ashtu si të gjithë shokët e grupit të tij, as ai nuk ishte me pikëpamjet e klases punëtore.

Synimi më i rrezikshëm i veprimtarisë së grupit ishte që të goditej sektori ekonomik. Për këtë qëllim duhej filluar nga puna, të ziheshin pozitat kyçe, duke rrëzuar njerëz të tjerë dhe për të vënë në vend të tyre shokët e grupit. Kështu e filluan punën në vendin tonë edhe trockistët jugosllavë, ata kishin për qëllim ta hidhnin vendin tonë në dorë më parë ekonomikisht, pastaj t'i hidhnin lakun Partisë. Për t'ua arritur qëllimeve të tyre, ata punuan me një plan të studjuar mirë, duke synuar të vënë në zbatim metodat e tyre trockiste, që ngjajnë shumë me punën e këtij grupi.

Ne e vumë Abedin Shehun të punonte në sektorin e industrisë me bindje se do ta kryente detyrën mirë. Por ai nuk u mjaftua me kaq, po përpiqej të shkonte më tutje dhe në këto përpjekje të tija shohim të konkretizohet edhe vija e grupit. Para Kongresit I, njerëzit e këtij grupi ishin të shpërndarë, ndërsa tani arritën të bëjnë një farë qendre, arritën të krijojnë lidhje me njerëz të tjerë, të cilët do të merrnin pozita nga ky grup, do të hiqeshin drejtorë e nëndrejtorë e në vend të tyre do të viheshin disa të tjerë. Por Partia nuk e fjeti mendjen dhe as që lejoi të merren njerëz më qafë. Grupi u përpoq t'i realizojë këto qëllime, po Partia eci më shpejt se këta njerëz, të cilët, ashtu si Anastas Lula në

kohën e tij, prisnin të gjenin përkrahës. Kësaj ata nuk ja arritën dot, pse Partia i ka sytë hapët kudo, ajo ka besim, po ka dhe vigjilencë.

Në sektorin e industrisë puna është sabotuar sidomos në degën e naftës dhe kjo nuk është e thjeshtë, po një çështje mjaft e ndërlikuar.

Abedin Shehu, megjithëse i ka bërë këto, nguron të pranojë ekzistencën e grupit dhe herë thotë se ky është grup, herë nuk pranon se është grup. Ky është një grup me plot kuptimin e fjalës, shokë, që ka punuar kundër Partisë me metoda trockiste armiqësore. Një nga karakteristikat negative të këtij grupi është antisovjetizmi i tij i theksuar. Në këtë drejtim Abedin Shehu ka qenë më i kujdesshmi për t'u fshehur, por do të vinte patjetër momenti siç erdhi, që dhe ky të shfaqej, se nuk mund të rrinte më i fshehur. Në një mbledhje të qeverisë na ka bërë përshtypje qëndrimi i Abedinit, kur ju bë një vërejtje së cilës ju përgjegj shpejt: «të kuptohemi, unë nuk jam antisovjetik». Kjo ndodhi në një kohë që askush nuk e akuzonte shokun Abedin Shehu për antisovjetizëm, megjithëse në këtë grup, siç del, mbilleshin vazhdimisht ndjenjat e antisovjetizmit. Hamit Keçi kishte pikëpamje se «në vendin tonë sundojnë sovjetikët» dhe këtë e thoshte haptas. E njëjta pikëpamje ka ekzistuar edhe te Niazi Islami. Ai ka arritur deri aty sa të qeshë me ironi e tallje me shokë sovjetikë, që kanë shfaqur ndonjë mendim, duke thënë: «kështu e kemi ne, ju bëni si t'u duket më mirë». Sipas Niazi Islamit, po tha një fjalë shoku sovjetik, mbaron puna, është gjë e vendosur. Këto ndjenja te Niaziu nuk ka si të mos jenë ushqyer prej një kohe të gjatë. Prandaj,

gjeste të tilla përpara shokëve sovjetikë flasin qartë për antisovjetizmin e tij. Një njeri i tillë nuk është në rrugën e Partisë. Po ashtu vepron dhe Shyqri Këllezi ndaj inxhinierit sovjetik që ka vajtur atje, duke thënë poshtë e lart se «nuk di të punojë me plan». Po mos vallë di të punojë me plan Shyqri Këllezi? Këto nuk janë qëndrime të rastit, por lidhen me vijën e grupit, që është në kundërshtim me vijën e drejtë të Partisë.

Të gjitha këto gjëra për ne janë fare të qarta dhe nuk i lot as topi, prandaj grupi nuk ka si e mbulon dot veprimtarinë e tij, nga shqyrtimi i së cilës dalin mirë në dukje ndjenjat antisovjetike, sabotimi në sektorin ekonomik, si dhe të gjitha çështjet e tjera që u vunë në dukje e që s'ka si të mohohen. Prandaj, pjesëtarët e këtij grupi është e domosdoshme t'i realizojnë thellë të gjitha këto, ndryshe do të shkojnë më tej. E gjithë puna që bëri ky plenum duhet t'u shërbejë atyre për mirë, mbasi përpara interesit të lartë të Partisë nuk vlejnë as pesë as dhjetë as njëqind veta. Megjithatë, Partia kujdeset herë pas here dhe bën ç'është e mundur që njerëzit që gabojnë të ndihmohen të shpëtojnë. Kështu do të bëjë Partia edhe me këta, ajo do të kujdeset sidomos për njerëzit që janë shumë të sëmurë, do të bëjë përpjekje të mëdha që t'i shërojë e të mos i lëjë të shkojnë në rrugën e armikut. Por nga ana e tyre duhet të jenë edhe ata në rregull me Partinë.

Nuk kishte si të ndodhte ndryshe me shokët e plenumit, të cilët me të drejtë janë revoltuar nga këto qëndrime antiparti dhe antikomuniste të njerëzve të këtij grupi. Deri edhe Koçi Xoxe kishte një farë respekti

të maskuar ndaj udhëheqjes, ndërsa te këta ky respekt mungon në një shkallë të madhe. Më e keqja është se asnjë nga ky grup nuk tha se do të mundohej t'i realizonte gabimet e tij të rënda. Këtë e tregon më së miri sidomos qëndrimi i Niazi Islamit. Atë sjellje që tregoi ai përpara udhëheqjes nuk e ka mbajtur asnjë armik i Partisë.

Këto në Parti po na ngjasin për herë të dytë, prandaj të hapim mirë sytë, shokë, dhe të mos harrojmë në asnjë rast punën e armikut, brenda Partisë dhe jashtë saj, njëkohësisht të kemi shumë kujdes që të mos shkojmë as në anën tjetër të gabuar, po të veprojmë si na mëson shoku Stalin, që njerëzve edhe besim t'u japim, por dhe vigjilentë të jemi ndaj tyre, të besojmë e të kontrollojmë. Metodrat që kanë përdorur të ne trockistët jugosllavë, trockisti Koçi Xoxe dhe pjesëtarët e këtij grupi t'i kuptojmë mirë, të ruhem i prej tyre në jetën praktike dhe ta shtojmë luftën e Partisë kundër tyre. Ne duhet të mësojmë shumë edhe nga gabimet e këtij grupi.

Duke u kufizuar vetëm në pesë anëtarët kryesorë të këtij grupi, mund të themi se shkakun numër një, që i ka shtyrë ata në këtë rrugë, është fryma e vjetër e grupit të «Të Rinjve», që ka qenë e gjallë te Isuf Keçi dhe Hamit Keçi, e, deri në një farë shkalle, edhe te Abedin Shehu, te i cili kjo frymë, po të kemi parasysh të gjitha rrethanat dhe procesin e ngjarjeve, ka shkuar duke u zmadhuar. Ky përfundim del nga të gjitha të dhënat që u përmendën më sipër dhe, sipas mendimit tim, këta të tre janë kryesorët e këtij grupi. Ata pastaj tërhoqën në rrethin e tyre dy shokët e tjerë, Niazi

Islamin dhe Shyqri Këllezin. Niazi Islami është një element i predispozuar të bjerë në gabime, për arsye të pikëpamjeve të tija shumë konfuze, të tipareve të tij mikroborgjeze si inatçi, mendjemadh, egoist dhe shumë i ulët nga ana ideologjike e kulture. Shyqri Këllezi ishte gjithashtu i predispozuar edhe ky të binte në rrethin e këtyre shokëve, pse i ka pëlqyer mënyra e jetesës me muhabetet e dëfrimet që bënin Isufi dhe Hamit Keçi. Abedin Shehu rastësisht, mendoj unë, ka marrë kontakt me Shyqri Këllezin në rrethin e Hamitit dhe të Isuf Keçit dhe është përpjekur dhe ka mundur fare lehtë t'i imponohet Shyqri Këllezit, me qëllim që ta drejtojë këtë pa vështirësi atje ku ka dashur. Duke qenë me një nivel të ulët ideologjik, megjithëse është punëtor, në kontakt me këta elementë Shyqri Këllezit, i është rritur mendja, i është formuar bindja dhe ka kujtuar se edhe ai ka mundësi të luajë një rol me rëndësi. Këto pikëpamje janë zmadhuar në rrugë të shtrembër te ai sidomos pas Kongresit I, kur u zgjodh kandidat i Komitetit Qendror.

Elementët e këtij grupi, për të fshehur rrugën e tyre të gabuar, thonë se «këto i kemi bërë, pse na ka lidhur puna si ministra që jemi» etj. Por ne nuk dënojmë lidhjet që kanë me njëri-tjetrin shokët për të shpурë përpara punën e Partisë. E them këtë për të qenë të qartë që nesër të mos ngjasë që dy ministra të mos e shohin me sy njëri-tjetrin, të mos bashkëpunojnë për të mirën e punës ose të ruhen se mos zënë në gojë ndonjë çështje shtetërore. Këtë e theksoj edhe për shokët e Plenumit të Komitetit Qendror të Partisë. Të gjithë shokët e qeverisë apo të plenumit tonë duhet dhe

kanë të drejtë të interesohen për çdo gjë, për të gjitha çështjet e Partisë dhe të shtetit, po kurdoherë duke respektuar rregullat e Partisë dhe në këtë drejtim të jenë të kujdesshëm. Në rast se një anëtar i Komitetit Qëndror është në dijeni për një çështje, të cilën nuk duhet ta dijë tjetri edhe kur është anëtar i Komitetit Qendror, s'ka nevojë t'ja thotë, por edhe në qoftë se ja thotë, nuk bën ndonjë krim, ndërsa nuk është aspak e nevojshme t'ja thotë një tjetri që s'është anëtar i Komitetit Qendror. E theksoj këtë, pse në praktikë bëhen gabime, prandaj kjo çështje të kuptohet drejt, pse armiku kërkon të shfrytëzojë e të gjejë çdo mundësi për t'u informuar e për të dëmtuar punën e Partisë e të shtetit tonë.

Dëshiroj të vë tani në dukje ç'rëndësi të madhe ka që ndërmjet komunistëve të ketë një dashuri të shëndoshë jo vetëm me njëri-tjetrin, po edhe midis familjeve të tyre dhe jo vetëm rrallë, në dy javë një herë, por kur ka mundësi shokët pas pune le të mblidhen edhe dy herë në javë dhe brenda normave të Partisë të diskutojnë, të dëfrenjë, po të duan edhe të këndojnë, pse njerëzit e punës kanë nevojë edhe të çlodhen. Por lidhje të tilla midis shokëve dhe familjeve të tyre nuk duhet lejuar të marrin rrugë të shtrembër, nuk duhet lejuar të shfrytëzohen nga njerëzit e sëmurë për qëllimet e tyre, që janë të kundërta me ato të Partisë, prandaj në këtë drejtim të tregohet kujdes dhe vigjilencë.

Unë mendoj se nga të gjitha mbledhjet e Plenumit të Komitetit Qendror të Partisë që kemi bërë deri tani, mbledhja e sotme ka qenë e nivelit më të lartë. Kjo

tregon se anëtarët e Plenumit të Komitetit Qendror kanë bërë mjaft përparime dhe, kur vjen çështja për mbrojtjen e interesave të Partisë, e bëjnë këtë si duhet, nuk u mbahet goja, qofshin edhe ata shokë që akoma kanë druajtje ose turp për të folur. Kjo është një çështje me shumë rëndësi.

Eksperiencën që muarëm këtu duhet të çohet në gjithë Partinë, pse në mjaft nga organizatat tona nuk bëhet sa duhet luftë kundër çdo shfaqjeje të huaj në radhët e tyre dhe nuk ka një jetë aq të gjallë e dinamike. Kritika dhe autokritika nuk janë bërë akoma sa duhet armë të fuqishme revolucionare të mbarë Partisë. Poshtë, në shumë raste, gjërat thuhën prapa krahëve dhe pikërisht këtë duan armiqtë e Partisë. Prandaj, në radhë të parë, ne vetë të japim shembullin e mirë, të përpqemi ta revolucionarizojmë gjithnjë e më shumë jetën e Partisë në bazë të eksperiencës së kësaj mbledhjeje të Komitetit Qendror, ta bëjmë këtë një mësim të madh për të gjithë Partinë. Kurdoherë që anëtarët e Komitetit Qendror kanë rast, të jenë këta që ta futin këtë frymë revolucionare në organizatat bazë, me qëllim që të arrihet deri aty, sa edhe sekretari i një organizate bazë t'ja tregojë grushtin një anëtari të Plenumit të Komitetit Qendror; kur sheh që ky punon në kundërshtim me vijën e Partisë, siç ka bërë Niazi Islami. Po të zhvillohet një luftë e tillë, atëhere do të shohim se si do të forcohet e do të revolucionarizohet gjithnjë e më shumë Partia jonë. Që të zhvillohet si duhet kritika dhe autokritika, anëtarët e Partisë nuk duhet të frikësohen nga autoriteti i udhëheqjes. Nuk duhet lejuar të shpërdorohet autoriteti i Partisë, apo të shfrytëzohet ai

në rrugë të shtrembër për të mbytur kritikën. Derisa je në organizatën bazë dhe ke bërë faj, cilido qofsh, atje duhet të japësh llogari. Nëse je anëtar i Komitetit Qendror, mundohu të punosh sa më mirë dhe të bësh sa më pak gabime, po kur konstaton këto, merr masa dhe ndreqi menjëherë. E them këtë sepse poshtë ka mjaft të meta e dobësi në këtë drejtim.

Unë mendoj se masat që mori Plenumi i Komitetit Qendror të Partisë janë të drejta. Shokët e këtij grupi nuk mund të jenë më anëtarë të Plenumit të Komitetit Qendror, prandaj Abedin Shehu, Niazi Islami e Shyqri Këllezi duhet të përjashtohen që të tre nga Plenumi i Komitetit Qendror. Por, ashtu sikurse tha ndonjë shok këtu, edhe unë jam i mendimit të bëjmë një dallim përsa i përket Shyqri Këllezit, i cili më duket nuk është në një shkallë me të tjerët përsa i përket fajit. Megjithatë, po të kemi parasysh qëndrimin e tij të fundit, as ai nuk e meriton të jetë në Komitetin Qendror të Partisë. Shyqri Këllezi nuk është fajtor në shkallën e Abedin Shehut dhe të Niazi Islamit, se nuk është as i ngritur si i pari, as nuk ka pasur mosbesim ndaj Partisë sa i dyti. Këto anë negative ai nuk i ka si ata, por qëndrimi që mbajti mbrëmë para plenumit tregon se, pas dy ditë pune intensive në këtë mbledhje, ky njeri asgjë nuk ka realizuar nga gabimet e tij, përkundrazi vazhdon të jetë po aq megaloman dhe të ketë po ato pikëpamje anarkiste në kokën e tij, që me të drejtë ne ja kritikuum. Me ato që tha Shyqriu në diskutimin e tij deshte të shiste mend përpara Plenumit të Komitetit Qendror. Ai nuk la që punën e tij ta gjykonte Komiteti Qendror, por donte të tregohej sikur i ka kuptuar gabimet e tij të rën-



da, ndërsa në fakt ai nuk është akoma i qartë. Shyqriu sikur u fye kur u cilësua si kalama dhe menjëherë kundërshtoi; me këtë donte të jepte të kuptohej që plenumi të mos ketë mëshirë për të, po ai duhet ta ketë të qartë se në Parti nuk ka mëshirë, po ka drejtësi. Prandaj, mendoj që edhe Shyqri Këllezi ka shumë nevojë të shërohet dhe duke qenë jashtë Plenumit të Komitetit Qendror, të bëjë përpjekje të mëdha që të përmirësohet.

Edhe Niazi Islami duhet të reflektojë thellë për punën e tij. Ai duhet të dalë këtej i bindur mirë për të metat dhe gabimet e tij të mëdha. E them këtë, se kam përshtypjen që Niazi Islamit i duket sikur në këtu po flasim kot, po bluajmë si mulliri pa kokrra. Me qëndrimin që ka mbajtur deri tani, ai tregon se nuk është ashtu si themi ne, por ashtu si mendon ai. Kjo do të thotë që në kokën e tij ai vërtet akoma gjithfarë pikëpamjesh në kundërshtim me Partinë. Te Niazi Islami rëndon edhe një faj tjetër, kur thotë se «i peshon mirë gjërat» dhe «e di çfarë bën». Prandaj, mendoj që në rast se nuk e realizon esencën e këtyre gabimeve, ai do të mbetet në pozita shumë të rrezikshme.

Më shumë nga të gjithë është Abedin Shehu ai që ka nevojë të bëjë përpjekje të mëdha për të kuptuar gabimet e tij dhe dëmin që i ka shkaktuar Partisë.

Që të tre duhet t'i mendojnë mirë këto që u thanë, t'i kuptojnë thellë dhe jo sa për sy e faqe. Ata me fakte dhe punë të palodhur duhet ta provojnë se i kanë kuptuar gabimet. Partia atyre do t'u japë dorën të shërohen, por sa i kanë kuptuar të gjitha këto që u thanë në mbledhjen e këtij plenumi, ajo do t'i shohë në luftën dhe në punën e tyre.

Nexhip Vinçani u dënua nga Komanda e Përgjithshme e Ushtrisë, njëkohësisht ai u njoftua se çështja e tij do t'i referohej edhe KQ të Partisë, pse qëndrimet e tij përbëjnë një çështje partie dhe kanë të bëjnë me një shok që është kandidat i Komitetit Qendror. Ne e ndihmuam shokun Nexhip Vinçani, që t'i njihte gabimet e veta, por edhe ai asgjë nuk njohu. Evolucionin i pikëpamjeve të tija është i çuditshëm. Ai ka menduar dhe vazhdon të mendojë se duhet të ishte gjeneral dhe jo kolonel, se duhet të ishte shef i Shtatmadhorisë dhe jo nënshef, siç e kishte caktuar Partia. Ai mendonte që të gjitha drejtoritë e Komandës së Përgjithshme të Ushtrisë të mos vepronin për asgjë pa pyetur Nexhip Vinçanin, si nënshef i Shtatmadhorisë. Të gjitha këto pikëpamje kanë ekzistuar në kokën e tij, prandaj prej tyre duhet të kishte filluar ai për të analizuar gabimet e veta.

Ne duhet të kemi parasysh dhe veprimtarinë e Nexhip Vinçanit edhe gjatë Luftës nacional-çlirimtare. E vërteta është se Nexhipi ka luftuar më mirë nga Hamit Keçi, por këtë vlerësim për luftën që ka bërë dhe për aftësitë që ka, të cilat s'ka pse t'i zmadhojë, nuk duhet ta bëjë ai vetë, pse ka kush e bën, e bëjnë të tjerët, e bën Partia. Partia i dha atij mundësi të mëson-te, e dërgoi në shkollë, prandaj duhet të mendojë kurdoherë drejt dhe të ketë besim te Partia.

Në punë dhe në jetë njeriu mund të bëjë gabime, por ato ndreqen në rrugën e drejtë të Partisë dhe jo ashtu si ka vepruar Nexhipi. Kur njeriu është i pirë, thotë edhe gjëra të mira edhe të liga, për njërin ose për tjetrin, por me Nexhip Vinçanin është interesant ras-

ti që atë natë që kishte pirë, nuk tha asnjë fjalë të mirë. Duke qenë në qejf, ai i nxori të gjitha ç'kishte në bark, si i thonë fjalës «ç'kish barku, i tha bardhaku». Ato që ja tha shokut Mehmet, ai i ka pasur në kokë që kur ka qenë esëll, i papirë. Nexhip Vinçani ka dashur që shoku Mehmet Shehu dhe jo njeri tjetër të ishte shefi i Shtatmadhorisë. Po përse vallë? Ai e donte një gjë të tillë për të mbufuar sedrën e tij mikroborgjeze që t'u thoshte të tjerëve se «unë jam vërtet nënshef, po kam mbi kokë Mehmet Shehun, që është njeri i zoti nga ana ushtarake dhe me përgjegjësi më të madhe në Parti». Ky njeri ka një mospërfillje të plotë për shokët e tjerë, bile edhe për shokun Beqir Balluku, të cilin Partia e ka vënë në atë detyrë të rëndësishme, jo rastësisht, por për meritat dhe aftësitë e tija, që Nexhip Vinçani nuk i ka fare parasysh. Pikërisht për këtë edhe ne i kemi dhënë gjithë ndihmën, por ai ka menduar dhe ka vendosur të mos i thotë asgjë Partisë.

Gjatë gjithë kësaj kohe Nexhip Vinçani ka bërë një luftë të madhe të brendshme dhe më së fundi vendosi t'ja mohojë Partisë gabimet e tij. Dhe kur ato që ka bërë i ngrihen nga Partia, ai nuk i quan të vërteta. Në Byronë Politike Nexhipi na erdhi me një version tjetër nga ky që tregoi këtu. Atje na tha se i gjithë gabimi i tij ishte se bësoi lajmin e transferimit në ushtri të shokut Mehmet Shehu, që ja tha një major i ushtrisë. Kjo është qesharake. Ne ja thamë Nexhipit: se ku qëndron sëmundja e tij, por në fund ai u shpreh: «E po, u duk puna ime», që me fjalë të tjera do të thotë: «kot më pyesni, çështja ime është paravendosur nga ju». Ne i vumë në dukje se këto mendime janë shumë

të gabuara, prandaj, përpara se të vinte në Komitetin Qendror ai duhetj të reflektonte më mirë. Por përpara plenumit ai hoqi dorë nga versioni i parë, dha përgjegje jo të sakta, përdori fjalë evazive dhe shprehje të tilla si «mundet», «ndofta», «më duket» etj. Tani për të nuk qenka kryesor lajmi që dëgjoi nga majori që përmenda, por qëndrimet morale që ju vunë në dukje. E çfarë autokritike është kjo? Ai jo vetëm nuk u ka bërë një analizë gabimeve të tij, nuk bën autokritikë të shëndoshë, po kërkon t'i hedhë hi syve Komitetit Qendror të Partisë. Faji i tij nuk ishte aq shumë i rëndë, po duke marrë parasysh qëndrimin negativ që vazhdon të mbajë ai, e rëndon veten shumë më tepër, gjë që ja kemi vënë në dukje dy-tri herë.

Me gjithë këto mendime e qëndrime të tij as Nexhip Vinçani nuk mund të qëndrojë kurrsesi në forumin më të lartë udhëheqës të Partisë, si kandidat i Plenumit të Komitetit Qendror, ku duhet të ketë vetëm komunistë të shëndoshë, të qartë, të thjeshtë dhe jo me faje e gabime të tilla. Nexhip Vinçani kryen dy faje: nga njëra anë dëmton ushtrinë, nga ana tjetër nuk i thotë Partisë përse e bëri dhe çfarë e shtyu në këtë faj. Po ta kishte realizuar këtë, ai do të ishte spastruar. Këtë metodë Partia e përdor që t'i ndihmojë dhe jo t'i dëmtojë shokët. Për një komunist që nuk bën autokritikë kur kryen faje, edhe organizata bazë merr masa e jo më Komiteti Qendror, të cilit i duhet të zgjidhë probleme të mëdha të shtetit dhe të Partisë, prandaj ai nuk duhet të ketë në gjirin e tij njerëz me pikëpamje të tilla si Nexhip Vinçani që ta pengojnë. Prandaj, edhe unë jam dakord me propozimet e shokëve që ai të përjashtohet nga

Komiteti Qendror. Ne i themi Nexhipit të bëhet ca më burrë për të njohur gabimet, të luftojë në veten e tij oportunitizmin, mëndjemadhësinë dhe veset e sëmura, mbeturina të edukatës borgjeze. Këto çështje Nexhipit ja kemi thënë e përsëritur shumë herë, po ai nuk ka nxjerrë mësim.

Një sëmundje e vjetër e Nexhipit është edhe qëndrimi i tij i ulët moral. Për këtë i kanë ardhur shumë herë sinjalizime Komitetit Qendror dhe njerëzit që na informonin nuk janë nga ata që i duan Nexhipit të keqen. Partia preokupohet shumë për rrënjosjen e normave të moralit të lartë në radhët e oficerëve të ushtrisë sonë dhe për forcimin e marrëdhënjeve të shëndosha familjare të tyre. Por nga shoku Nexhip Vinçani nuk shikojmë të zbatohen ato norma të shëndosha morale që kërkon Partia nga komunistët dhe oficerët, përkundrazi ai ka dhënë kështu një shembull negativ. A mund të bëjë efekt puna e tij me vartësit, në rast se nesër i japim urdhër Nexhipit të vejë të punojë një qarkore me oficerët për çështje të moralit komunist? Sigurisht jo dhe shokët do të kenë të drejtë të na thonë: «Përse na e keni dërguar këtë njeri?» Çdo komunist duhet të jetë shembull për moralin e tij të lartë. Kjo është në rrugën e shëndoshë të Partisë. Çdo veprim jashtë kësaj rruge është i dënueshëm nga Partia.

Unë mendoj dhe besoj se të gjithë anëtarët e kandidatët e plenumit janë dakord që si ne, ashtu dhe gjithë Partia, t'i ndihmojmë këta shokë, por edhe ata vetë duhet të bëjnë përpjekje që të shërohen. Ndihmën e saj Partia do t'ua japë sinqerisht, vetëm është detyra e tyre të realizojnë mirë gabimet që kanë. Të mos mendojnë

në asnjë mënyrë për të vënë shenjën e barazisë midis vigjilencës së Partisë dhe kontrollit policor. Po të mendojnë kështu, atëhere do të gabohen akoma më rëndë. Vigjilenca e Partisë është dhe do të jetë kurdoherë një vigjilencë revolucionare. Ju vetë bile duhet ta kërkonti një vigjilencë të tillë nga Partia, e cila e ka për detyrë që ta forcojë atë më shumë dhe me anën e saj të ndihmojë që të shërohen njerëzit e sëmurë. Kjo do të jetë e vetmja ndihmë e madhe për ju, pse nuk do t'ju lejojë të shkoni më tej në rrugë të gabuar, po në rrugën e drejtë të Partisë. Dhe në këtë drejtim nuk do të jenë vetëm anëtarët dhe kandidatët e Komitetit Qendror që do t'ju ndihmojnë, po të gjithë anëtarët e Partisë. Njerëzit gabojnë kush më shumë e kush më pak, prandaj gjithë Partia e ka për detyrë t'i ndihmojë në këto raste.

Në jetë ndodh që të ketë edhe nga ata njerëz të sëmurë, të cilët mund të përdorin ndaj jush të njëjtat metoda që keni përdorur ju vetë ndaj të tjerëve, me qëllim që të shtojnë pakënaqësitë tuaja. Këtë jua them, pse Partia nuk është pastruar akoma nga elementë të tillë. Prandaj ruhuni nga provokacionet e njerëzve të tillë, përpiquni t'i dalloni ata dhe mos bluani në kokën tuaj mendime të sëmura për Partinë. Është e domosdoshme që ju të rrënjosni mirë në mendjen tuaj gjënë kryesore: të keni besim të plotë te Partia. Në rrugën tuaj ju mundet dhe do të hasni edhe vështirësi si këto që u thanë në plenumin tonë, por prej tyre kurrë të mos ju lëkundet besimi te Partia. Ju këshilloj të keni kujdes, të mos kaloni në gabime të tjera, të keni të qartë se një gabim që mund të bëjë një njeri i sëmurë

kundër jush, në qoftë se Partia nuk e sheh sot, do ta shohë nesër, prandaj e përsërit të keni besimin më të madh te Partia. Me këtë nuk dua të them që për çdo qëndrim ose veprim jo të drejtë të ndonjërit ndaj jush, të cilin nuk e quani të drejtë, të mbyllni gojën, të mos flisni. Jo, në qoftë se shikoni që ju bëhet ndonjë padrejtësi, thuajani hapët Partisë mendimin, e cila do të gjykojë nëse ai që mendoni se ju godit ka vepruar mirë apo keq. Por kini parasysh se një organizatë e tërë e Partisë nuk mund të bjerë lehtë në gabim. Prandaj, luftoni në radhë të parë pikëpamjet dhe mbeturinat në veten tuaj, të cilat janë akoma të forta te ju, luftoni edhe vetë kundër metodave trockiste të punës suaj. Partia nga ana e saj do të jetë gjithnjë afër jush, do t'ju ndihmojë dhe nuk do t'ju lejë të bini në gabime të tjera më të rënda. Këtë ajo do ta bëjë, pse ju keni nevojë të ndreqni gabimet dhe të metat tuaja, do ta bëjë edhe për arsye se ju, në jetën tuaj, keni edhe një aktiv luftë dhe punë.

Siç tha edhe shoku Mehmet, në rast se ju do të shkonit në greminë, s'ka dyshim që edhe e kaluara juaj do të errësohej, prandaj kini kujdes në rrugën tuaj, se ekzistojnë plot rreziqe. Lufta me armiqtë është e ashpër, ata do të përpiqen t'i shfrytëzojnë dobësitë tuaja, prandaj të jeni të zgjuar, të shkundeni nga pikëpamjet e vjetra dhe të ngjisni përpjetë rrugën e Partisë. Ecnit me Partinë, të çliruar nga pikëpamjet e huaja. Komiteti Qendror është i ndërgegjeshëm dhe i bindur për këtë dënim që po ju jep juve, por ai mendon kurdoherë që kuadrot t'i ndihmojë deri në fund dhe t'i shpëtojë jo duke i përkëdhelur, por duke dënuar haptazi gabimet

që bëjnë dhe të gjitha këto përpara syve, asgjë prapa krahëve, pse kjo nuk është metodë partie. Po të ecni në rrugën e Partisë, do ta kuptoni se ajo nuk u hedh gurin atyre që kanë gabuar, por i ndihmon të gjithë ata që bëjnë me të vërtetë përpjekje të vijnë në rrugën e saj të drejtë<sup>1</sup>.

*Botohet për herë të parë sipas  
procesverbalit të mbledhjes  
së Plenumit V të KQ të  
PPSH që gjendet në AQP,  
me disa shkurtime*

---

<sup>1</sup> Abedin Shehu duke pasur parasysh këto këshilla të shokut Enver Hoxha dhe duke u mbështetur në ndihmën që i dha Partia, u bind për gabimet e tij dhe punoi për t'i korrigjuar ato. Më 1965, duke parë punën e mirë dhe vendosmërinë e tij në rrugën e drejtë të Partisë, u ripranua në radhët e saja. Gjithashtu edhe Shyqri Këllezi u ripranua në Parti më 1966.



## PËR NJË ORGANIZIM MË TË MIRË TË PUNËS NË INSTITUTIN E SHKENCAVE

*Nga diskutimi në mbledhjen e Sekretariatit të  
KQ të PPSH<sup>1</sup>*

24 shkurt 1950

Instituti i shkencave ka një rëndësi të madhe për Partinë tonë. Megjithatë unë mund të them se ai nuk është vlerësuar e çmuar sa duhet dhe për këtë ne kemi përgjegjësi. Ishte e nevojshme të diskutonim edhe më parë mbi probleme të tilla që shqyrtojmë sot, të vihehim herë pas here në dijeni për punët e institutit, por siç duket, akoma nuk është krijuar si duhet një mendim i drejtë për punën e këtij instituti, pra, ai është nënvleftësuar. Prandaj në të ardhshmen duhet të ndjekim, të shqyrtojmë e të orientojmë më seriozisht punën e këtij institucioni shkencor.

Të kemi kujdes se instituti nuk është vetëm për kuadrot e vjetër, për të cilët ne duhet të përpiqemi dhe

---

<sup>1</sup> Në këtë mbledhje u muar në shqyrtim raporti «Mbi aktivitetin e Institutit të shkencave për vitin 1949 dhe mbi problemet e projektplanit të tij për vitin 1950».

t'i bëjmë që të punojnë akoma më shumë, por njëkohësisht të kujdesemi që të përgatitim edhe kuadro të tjerë. Për këtë gjë të mendojmë në radhë të parë vetë instituti. Megjithatë në këtë institut ka vetëm dy-tre anëtarë partie, nuk duhet humbur besimi në kuadrot e vjetër, përkundrazi duhet me i ndihmë ata. Po të kishte pasur më shumë interesim nga ana jonë, ne do të arrinim më tepër rezultate.

Të studjohen nevojat që paraqiten për krijime të reja dhe të caktohet se cilët kuadro të ministrive mundet të bashkëpunojnë me institutin dhe në këtë mënyrë të bëhen studime. Ju, shokët e Drejtorisë së agjitacionit e të propagandës të Komitetit Qendror, nuk keni të bëni as me rroba ose me maqina as me materiale të tjera e as me kuadro që i duhen institutit; ju të interesoheni që të zbatohet vija e Partisë në Institutin e shkencave. Për çështjen e kuadrove duhet të interesohet drejtoria përkatëse e aparatit të Komitetit Qendror. Ajo mundet t'i thotë edhe Kryeministrit që këta ose ata kuadro të dikastereve të urdhërohen të bashkëpunojnë me Institutin e shkencave. Kështu do të vihen njerëzit edhe përpara përgjegjësisë. Këto gjëra duhet të kontrollohen mirë që të gjërnë zbatim.

Nga ana e Institutit të shkencave duhet të mbahet parasysh gjendja jonë, prandaj të kërkohen gjërat më të nevojshme. Sa për kuadrot që duhen dërguar jashtë, të bëhen propozimet përkatëse nga Drejtoria e kuadrit dhe ata të shihen me kujdes që të sigurojmë më të nevojshmit e më të rëndësishmit. Po kështu, t'i rekomandojmë Kryeministrit që të merren masa për të plotësuar nevojat e tjera më të ngutshme të institutit

qoftë edhe duke i sjellë nga jashtë, siç janë mjetet dhe librat më të domosdoshme etj. Të shfrytëzohen edhe librat që ka Biblioteka kombëtare, të sigurohen edhe lokalet që i nevojiten institutit.

Të krijohen lidhje të rregullta me dikasteret, në radhë të parë me ato ekonomiket. Gjithashtu të mendohet se si të shpërblehen edhe bashkëpunëtorët duke u krijuar atyre kushte më të përshtatshme pune e jete-se, sepse deri tani për njerëzit e shkencave nuk është bërë asnjë dallim. Situata jonë ekonomike po përmirësohet dita-ditës, prandaj mendoj se tani ka ardhur koha dhe janë krijuar mundësitë që njerëzit e shkencave, që s'i kemi të shumtë e të tepërt, të ndihmohen diçka më mirë.

*Botohet për herë të parë sipas  
tekstit të nxjerrë nga proces-  
verbali i mbledhjes së  
Sekretariatit të KQ  
të PPSH që gjendet  
në AQP*

## MBI PËRMIRËSIMIN E PUNËS ME KUADRIN

*Nga diskutimi në mbledhjen e Byrosë Politike të  
KQ të PPSH<sup>1</sup>*

27 shkurt 1950

.....  
Kam edhe disa vërejtje për Drejtorinë e kuadrit të aparatit të Komitetit Qendror. Në përgjithësi jam i mendimit që ne të ndryshojmë krejt sistemin e punës me kuadrin. Shokët që punojnë në këtë sektor, me sa duket, kanë frikë të ngrënë kuadro në përgjegjësi. Pse të mos merren edhe kuadro që nuk dinë shumë, të ngrihen me kurajë e të mësojnë në punë e sipër? Për shembull, në miniera përse të mos bëhen drejtorë punëtorë të kualifikuar, që janë plot dinamizëm dhe besnikë? Mundet që puna e tyre të çalojë pak në fillim, po do të forcohet me siguri në të ardhshmen.

Çështja e kuadrit duhet parë edhe nga një anë tjetër: aty-këtu është krijuar një mendim i gabuar që «nevojat për kuadro do të na i plotësojë Komiteti

---

<sup>1</sup> Në këtë mbledhje Byroja Politike e KQ të PPSH diskutoi mbi disa kuadro të nomenklaturës së vet.

Qendror». Kjo pikëpamje nuk është e drejtë. Njerëzit e thjeshtë të luftës e të punës i njeh vetë dhe i di organizata e Partisë, i njohin shokët që drejtojnë dhe prandaj zgjedhjen e tyre nuk duhet ta presin nga Komiteti Qendror, por ta bëjnë ata vetë. Dhe krahas tyre, do parë edhe ai numër i madh njerëzish, të cilët dallohen e do të dallohen në luftën e madhe që bëhet sot për zbatimin e vijës së Partisë, të zgjedhim edhe nga këta e t'i vëmë në vende me përgjegjësi.

Problemi i kuadrit është një problem kyç për Partinë. Në këtë drejtim ne kemi arritur rezultate, por jemi akoma prapa. Kemi shumë mundësi që ta përmirësojmë gjithnjë e më tepër punën në këtë sektor të rëndësishëm të Partisë.

*Botohet për herë të parë sipas  
tekstit të nxjerrë nga proces-  
verbali i mbledhjes së Byrosë  
Politike të KQ të PPSH  
që gjendet në AQP*

## MBI FORCIMIN E MËTEJSHËM TË PUNËS ME RININË

*Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike të  
KQ të PPSH<sup>1</sup>*

1 mars 1950

Me rëndësi është që të kuptohen mirë lidhjet midis rinisë dhe Partisë, ashtu sikurse i përcakton Statuti i Partisë. Unë nuk jam dakord me disa propozime që bëhen këtu, sepse ato nuk janë të përshtatshme për situatën tonë. U tha këtu për disa gjëra që ka komsomoli, të cilat t'i marrim edhe ne. Komsomoli mundet t'i ketë ashtu, po ne jemi në kushte të tjera. Të mos biem në shablonizëm, por të marrim nga eksperiencia e punës së komsomolit atë që është racionale.

Përsa u përket formave të edukimit të rinisë të kemi për bazë ato të komsomolit, po duke ua përshtatur konditave tona. Këtu duhet të kuptohet mirë ndryshimi midis nivelit të rinisë sonë dhe rinisë sovjetike, prandaj format e punës edukative me rininë ne duhet

---

<sup>1</sup> Në këtë mbledhje u analizua veprimtaria e BRPSH për vitin 1949.

t'ua përshtatim konditave tona dhe të mos kërkojmë të zbatojmë po ato forma në një terren që është i ndryshëm nga ai i Bashkimit Sovjetik. Të rinjtë tanë janë me nivel arësimor më të ulët, prandaj drejtuesit e rinisë duhet të punojnë më shumë dhe më me kujdes për edukimin dhe ngritjen ideologjike të rinisë.

Nuk është i drejtë edhe mendimi që Komiteti Qendror i Partisë të mos mbahet në korrent për punët e rinisë, pse pastaj ka një rrezik: me dashje ose pa dashje shkohet në shkëputjen e rinisë nga Partia, nga kontrolli dhe drejtimi i saj. Lidhjet për problemet e përgjithshme duhet të mbahen me të gjitha seksionet e aparatit të Komitetit Qendror, përveç lidhjeve që duhet të mbahen me sekretarët e KQ të Partisë, që punojnë në aparat, të cilët duhet të vihen në korrent për të gjitha problemet e rinisë. Duhet gjithashtu që sekretarët e KQ të BRPSH të mbajnë kontakte të rregullta me Komitetin Qendror të Partisë dhe të venë vetë te sekretarët e tij për të shtruar problemet më të rëndësishme. Edhe vetë sekretarët e Komitetit Qendror të Partisë duhet të thërresin herë pas here ata të rinisë. Po të ketë gjëra me karakter politik dhe vije, ata mund të thërrihen bile edhe nga unë e Byroja Politike. Kjo përsa i përket udhëheqjes. Edhe seksionet e tjera të aparatit të Komitetit Qendror të Partisë duhet të interesohen mirë për punën me rininë dhe për këto çështje të jenë përgjegjëse përpara Byrosë Politike, ashtu siç janë edhe për çështjet ideologjike, organizative etj. Problemet që dalin të mos na vijnë me vonesë, po të vijnë në kohën e duhur që të mund të ndihmojmë në zgjidhjen e tyre.

dhe duhet të mbahet parasysh se ata janë të rinj. Por për udhëheqjen e rinisë me rëndësi është çështja e përbërjes, aty duhet të jenë njerëzit e klasës.

Udhëheqja e rinisë të ketë parasysh që të mos mjaftohet duke bërë punë nga zyra, po të marrë kontakt me masën e rinisë, të shkojë poshtë jo vetëm sa për të bërë ndonjë konferencë, po të shohë se si punon dhe edukohet rinia.

Edukimit të rinisë t'i kushtojmë kujdes të veçantë dhe për këtë të mos merret për bazë gjendja e njerëzve që kanë shkollë, pse me këta njerëz është më lehtë për të bërë punë edukative, por të merren për bazë elementi punëtor e fshatar. Prandaj kur të bëhen mbledhje edukative të mbahet parasysh që ato të kombinohen dhe me aktivitete si sport dhe dëfrime të tjera dhe çdo gjë të bëhet në forma sa më të kuptueshme për ata. Kjo gjë do një punë të madhe, po kjo punë do të jetë më e frutshme. Që t'i nxitim të rinjtë të ecin në rrugën e Partisë duhet t'i edukojmë ata me forma pune që i përshtaten moshës së tyre. Në fshat është më e zorshme puna e edukimit, prandaj drejtuesit e rinisë duhet të mendojnë mirë se si të punohet atje.

Edukimi politik duhet të bëhet i vazhdueshëm dhe për këtë çështje drejtuesit e rinisë të mbahen mirë në korrent të ngjarjeve. Të rinjtë të vihen në korrent për çdo gjë, të demaskohet puna e armikut, për këto mund të bëhen edhe mbledhje të shkurtëra prej disa minutash. Situatën politike të rinjtë duhet ta njohin mirë që ata të jenë në ballë të luftës së Partisë sonë.

Për shtypin e rinisë duhet të ketë më shumë interesim, të përmirësohet dhe t'i përshtatet asaj, të ketë



më shumë fotografi, karikatura etj., që e tërheqin dhe e edukojnë.

Në shkolla organizata e rinisë duhet të punojë më mirë. Çështja e parë atje duhet të jetë mësimi dhe, po të punohet mirë edhe mësimin ata do ta kuptojnë më mirë. Prandaj, kjo detyrë të kuptohet mirë politikisht, të mbahet gjallë entuziazmi dhe për këtë gjë të kombinohet puna me arësimin, pse më duket se ka mjaft të meta edhe nga organet e arësimit në këtë drejtim. Nga arësimi të punohet me plan për edukimin e arësimitarëve, të bëhen nga ana e tyre diskutime politike dhe ata të mbahen sa më afër, ndërsa ndaj atyre që janë armiq të mbahet qëndrim. Pra, me arësimitarët duhet të bëhet një punë e tillë që të ekzistojë harmonia midis tyre e nxënësve. Unë them se po nuk u forcua më shumë bashkëpunimi midis arësimitarëve dhe rinisë, puna në shkolla nuk ka për të shkuar mirë.

Edhe përsa i përket dëfrimit të rinisë duhet të preokupohet në radhë të parë organizata e saj, por edhe nga ana shtetërore ne duhet të bëjmë më shumë dhe të mos qëndrohet më në këto shuma të hollash që janë dhënë deri tani. Një nga shokët tanë të shohë se çfarë fonde mund të japë shteti ynë dhe kjo gjë të vihet në rrugë, se ndryshe nuk ecet. Ne nuk mund të sjellim nga jashtë të gjitha materialet, prandaj të shihet se çfarë mundet të bëjmë këtu në vend. Kjo punë të organizohet nga vetë ne dhe të mos themi se ka gjëra që na pengojnë. Në rast se duhen fonde, t'i vëmë në dispozicion për këtë qëllim.

Lidhur me çështjen e pionierëve, organizata e rinisë të kujdeset më shumë dhe puna e saj të mos jetë

kaq e kufizuar, pse ata janë të vegjël dhe ne duhet t'i edukojmë. Edhe sikur babai i ndonjërit të jetë i lig, pionierin ne ta bëjmë për vete. Edhe çështja e vagabondazhit në disa fëmijë këtu e ka burimin. Format e punës me fëmijët kanë shumë rëndësi. Për shtëpitë e pionierëve duhet të interesohet një nga shokët tanë dhe shokët e rinisë të zgjedhin disa nga lokalet më të bukura, të cilat t'u jepen fëmijëve, të caktohen edhe fonde dhe këto shtëpi të organizohen mirë që të tërheqin sa më shumë pionierë. Të krijojmë ambiente ku ata të luajnë. Këto gjëra duhet të bëhen, ndryshe nuk ka se si t'i tërheqim të vegjëlit. Në shtëpitë e pionierit të organizohet kori, teatri, orkestra etj. Të dërgohen atje baza materiale për rrethet e ndryshme të teknikës dhe të financohen ato rregullisht. Edhe shënjat e tyre simbolike — shamitë e kuqe, distinktivat etj., kanë rëndësi dhe të mos lejohet që ato t'i vëjë çdo njeri, po këto shënja të bëhen si gjëra me rëndësi dhe të përdoren rigorozisht në bazë të rregullores së pionierëve. Pranimi i pionierëve të bëhet me ceremoni, përndryshe nuk mund të tërhiqen të gjithë kalamanët në këtë organizatë dhe aty të edukohen.

Edhe unë jam i mendimit që ndonjë nxënës dhe mësues që zhvillon veprimtari armiqësore të përjashtohet nga shkollat tona, por nuk mund t'i shpëtojme punës së armikut në shkolla vetëm duke i përjashtuar, prandaj nga ana e organizatës së rinisë të bëhet një punë e gjerë politike dhe të forcohet lufta kundër elementit armik në shkollë. Këto gjëra duhet të rregullohen nga organet kompetente dhe të mos na vijnë deri këtu te ne. Unë mendoj se nuk mund të zgjidhen pro-

blemet e ndryshme shtetërore në rast se çdo ministri nuk merr përgjegjësitë që i takojnë. Për shkollat dhe konviktet Ministria e Arësimit i ka fondet dhe është përgjegjëse që gjërat e parashikuara të zbatohen në rregull, kurse Ministria e Tregëtisë ka përgjegjësi për furnizimin e tyre me materialin e duhur. Këtu duhet bërë një luftë e madhe që të kalohen të gjitha vështirësitë që na dalin. Shokët udhëheqës kur venë në rrethe duhet të vizitojnë edhe shkollat, t'u flasin nxënësve, pse kjo u jep atyre kurajë dhe vetë arësimitarët do të shohin se si udhëheqësit e Partisë dhe të shtetit tonë interesohen për çështjet e shkollës. Prandaj kjo gjë duhet të praktikohet.

Përsa i përket mobilizimit të rinisë për realizimin e planit të shtetit, ka preokupacion dhe kjo është një gjë pozitive, por nga ana shtetërore duhet të merren mirë masa që të rinjtë të mos mbeten nëpër aksionet pa bukë, pa transport, pa veshje. Pa plotësuar këto nevoja nuk mund të ketë mobilizim dhe entuziazëm në të rinjtë. Shoku Spiro Koleka duhet të japë urdhër kategorik që gjithë forcave vullnetare të rinisë që janë në aksione t'u sigurohet minimumi i konditave. Përgjegjëse për këtë është Ministria e Industrisë dhe e Botores e në rast se pas një kontrolli duken gjëra që nuk shkojnë mirë, të merren masa, pse me vullnetarët nuk mund të luhet.

*Botohet për herë të parë sipas  
tekstit të nxjerrë nga proces-  
verbali i mbledhjes së Byrosë  
Politike të KQ të PPSH  
që gjendet në AQP*

## **MBI REALIZIMIN E PLANIT TË GRUMBULLIMIT PËR DRITHËRAT E BUKËS**

*Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike të  
KQ të PPSH<sup>1</sup>*

**29 mars 1950**

Çështja e bukës te ne është përmirësuar. Bukë shitet dhe populli ka bukë në mënyrë të mjaftueshme. Kjo është arritur në bazë të sistemit të grumbullimit që kemi vendosur. Por, ne do të kishim më shumë suksese, në qoftë se nuk do të ekzistonin akoma çrregullime e të meta të mëdha në çështjen e regjistrimit të tokave, gjëra këto që kanë vazhduar 4 vjet dhe do të vazhdojnë edhe 4 vjet të tjera po të mos punohet si duhet. Ne bëjmë çmos që të hapen toka të reja, kurse në Fier ka toka pa zot dhe nuk shkon njeri nga komiteti ekzekutiv për t'i regjistruar e për t'ua dhënë fshatarëve. Kështu si po veprohet ne detyrohemi që nga viti në vit të ulim planin, domethënë grumbullimi i drithit në vend

---

<sup>1</sup> Në këtë mbledhje u muar në analizë gjendja e grumbullimeve për vitin 1949 dhe plani i grumbullimeve për vitin 1950.

që të rritet, po ulet. Në bazë të propozimeve të rretheve ne duhet të zbresim 73 000 kv. drithëra. Ky është një problem i madh e me shumë rëndësi që duhet të studjohet seriozisht, pse kështu si po ecën puna, ne nuk do ta heqim kurrë triskën e bukës dhe çdo vit do të importojmë drithë nga jashtë. Ne mund të flasim sa të duam për planin, por ai nuk është bërë në baza të drejta.

Në rast se do të kishte një shtesë të madhe në prodhimin e bimëve industriale ose në prodhimin e jonxhës me anën e së cilës do të përmirësohej gjendja e ushqimit të kafshëve, atëhere mund të ishim dakord që plani të ulej për drithërat. Po këtu plani i drithërave të bukës zbrit, jonxhë nuk ka, pambuk nuk grumbullohet, atëhere ku vemi?

Kyçi i gjithë këtij problemi është mobilizimi më i madh i vetë Ministrisë së Bujqësisë dhe jo i sekretarëve politikë të komiteteve të Partisë në rrethe, sepse ata nuk merren me çështjet e tokave nëse janë djerrë ose punohen, ky është një problem i organeve të bujqësisë. Ne këtu jemi përpara një problemi shumë të madh, me të cilin po ndeshemi çdo vit dhe jemi duke numëruar në vend.

Do studjuar mirë edhe çështja e rendimenteve dhe t'i thuhet Byrosë Politike në bazë të eksperiencës të vitit të kaluar se çfarë rendimente kanë dhënë kategoritë e ndryshme të tokave. Byroja Politike ju ka ngarkuar ju, shokë të bujqësisë, që këto çështje t'i shikoni më mirë. Po ta kishit bërë këtë gjë, atëhere Partia do t'u thoshte fshatarëve që të mos bënin ankime të kota në rast se llogaritë nga ju do të ishin bërë mirë. Problemet e bukës janë të mëdha. Ne duhet të ecim në

crugën tonë ashtu si na mëson Stalini dhe jo ashtu siç ecim nganjëherë, që lëmë Partinë të merret me gjëra të vogla dhe harrojmë punët e saja me rëndësi të madhe politike.

Ku bazohen angazhimet që marrin fshatarët? Pse nuk rregullohet kjo çështje që të punohet me baza të shëndosha duke u mbajtur shënime për çdo vit për angazhimet që merr çdo ekonomi e në rast se vjet ka marrë angazhim për dy ha. e gjysmë misër dhe sivjet thotë se do të mbjellë dy hektarë, të mos e lejojmë, por t'i kërkojmë arësytën. Angazhimet nuk janë një gjë e thjeshtë, ato duhen zbatuar.

Tani ne kemi kadastrën dhe klasifikimin si probleme të mëdha. Këto gjëra do t'i caktojmë se kush do të punojë në bazë të klasifikimit e kush në bazë të kadastrës dhe angazhimet do të merren mbi këto baza. Ndryshe të gjitha janë të kota, pse merren angazhime pa asnjë provë dhe ashtu si punohet tani është një punë formale.

Vjet ne muarëm një vendim që ugaret të taksohen. Çfarë rendimenti dhanë ato dhe sa i drejtë ishte taksimi akoma nuk e dimë. Këtë gjë duhej ta kishte studjuar Drejtoria e bujqësisë që ne të nxirrnim konkluzione për këtë vit. Po ta dinim këtë, atëhere ne do të mund të merrnim një vendim konkret. Po të dinim se ugaret kanë dhënë rezultate, atëhere nuk do t'i linim fshatarët që të mbillnin koçkulla. Kështu do të kishim të dhëna më të sakta.

Taksimi është taksim dhe angazhimet duhen bërë në bazë të planit dhe jo ashtu si do fshatari. Këto angazhime merren që të zbatohet plani dhe ne nuk

mund t'i lëmë fshatarët që të mbjellin ato që nuk i kap detyrimi edhe ato që nuk u nevojiten atyre. Foragjeret për shembull ne mund t'i lëmë të mbillen ku ka kafshë të trasha. Ata që duan të mbjellin atje ku nuk ka të tilla, ne nuk duhet t'i lejojmë. Këto, pra, janë probleme kryesore për organet e bujqësisë.

Çështja e jonxhës ka shumë rëndësi dhe ky problem është ngritur vjet, por na kanë raportuar se fshatarët nuk pranojnë ta mbjellin, kurse tani na thonë se ata janë dakord. Edhe po të jetë kështu ata nuk mund të mbjellin shumë sipërfaqe pse nuk ka farë, të cilën ne e japim atje ku parashikon plani.

Këtu ka një qeveri. Rretheve duhet t'u thuhet se në cilën rrugë duhet të ecin dhe të mos veprohet si të duan ato. Ju keñi bërë planin tuaj në bazë të një vendimi dhe të dhënave të Ministrisë së Bujqësisë. Atëhere përse ndryshojnë në rrethe këto gjëra? Mua më duket se roli i grumbullimit është që të bëjë kontraktimet dhe të grumbullojë. Të gjitha gjërat e tjera duhet t'i bëjë Ministria e Bujqësisë.

Partia dhe pushteti duhet të ndihmojnë organet e grumbullimit, por dhe ato duhet të punojnë. Kjo çështje të na paraqitet edhe një herë për shqyrtim mbas 5 ditësh. Njëkohësisht të fillojë që-tani studimi i grumbullimit të misrit kalli, pse kështu ai bëhet më shpejt dhe kursejmë energji të mëdha që venë kot. Neve duhet të na paraqitet plani i detajuar, ndryshimet që janë bërë në rrethe. Pastaj a ka mbajtur shënime ministria nga eksperiencia e grumbullimit të grurit të këtij viti për të na vërtetuar ato që janë në planin e 1950-s? Sa është përfituar nga eksperiencia e 1949-s, të na thuhet

edhe kundërshtimet e rretheve, jo me fjalë, por të bazuara në fakte.

Këto gjëra duhet të marrin fund qysh sivjet dhe të merren të gjitha masat për të realizuar planin e grumbullimeve.

*Botohet për herë të parë sipas  
tekstit të nxjerrë nga proces-  
verballi i mbledhjes së Byrosë  
Politike të KQ të PPSH  
që gjendet në AQP*



## TË FORCOJMË ME TEJ ORGANIZATËN E FRONTIT

*Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike të  
KQ të PPSH<sup>1</sup>*

5 prill 1950

Unë mendoj se nuk duhet që t'i bëjmë ndryshime Frontit. Atë ta aktivizojë Partia për të mobilizuar masat punonjëse në fshat dhe në qytet, si organizata më e madhe e tyre. Poshtë ne kemi këshillat e Frontit, të cilat në bazë të Statutit të Frontit edhe ato duhet të zgjidhen në mënyrë demokratike.

Fronti është një organizatë masash dhe në rreth, kjo organizatë nuk duhet të bëjë mbledhje duke u komanduar nga lart, nga qendra. Përkundrazi, rrethi të ketë inisiativë e të vetëveprojë. Ndërsa me urdhër nga lart mund të organizohet ndonjë mbledhje fronti, që ka rëndësi në shkallë nacionale. Mbledhjet e Frontit në rrethe t'i drejtojë Partia dhe për probleme që ajo e

---

<sup>1</sup> Në këtë mbledhje u shqyrtuan masat përgatitore për Kongresin e dytë të Frontit Demokratik të Shqipërisë.

sheh të nevojshme. Të marrim një shembull: Një lagje e preokupon papastërtia, sepse atje ka pisllek. Partia e konstaton këtë dhe porosit këshillin e Frontit të lagjes për të marrë masat e duhura. Këshilli i Frontit thërret mbledhjen e organizatës në lagje, së cilës i shtron problemin. Anëtarët e Frontit, të cilët janë të interesuar, mobilizohen në punë dhe pastrojnë lagjen. Partia njëkohësisht kërkon nga anëtarët e saj që janë në atë lagje, të ndihmojnë Frontin dhe të mobilizohen duke qenë shembull të parët për këtë çështje. Kështu duhet të punohet, pse, duke i caktuar mbledhjet për shembull një herë në javë, kjo do të jetë një gjë fare formale. Prandaj, unë them se nuk do të jetë e nevojshme që mbledhjet e këshillave të Frontit të bëhen kudo në kohë të caktuar, por të bëhen për probleme të caktuara.

Në raste fushatash Fronti u drejton thirrje masave, por nuk duhet kurrsesi të caktohet që mbledhja e Frontit të bëhet medocmos një herë në muaj. Kur fushatat janë me karakter nacional atëhere në bazë të udhëzimeve të Komitetit Qendror të Partisë, Këshilli i Përgjithshëm i Frontit bën thirrjen përkatëse.

Partia duhet ta përdorë mirë këtë levë, prandaj nuk duhet të krijojmë burokratizëm në organizatën e Frontit. Përsa i përket Këshillit të Përgjithshëm të Frontit këtu në qendër, atë e udhëzon Komiteti Qendror në lidhje me problemet që dalin herë pas here e që kanë karakter nacional. Kur të ketë nga këto probleme vendosim ne si Parti dhe pastaj ja themi Frontit që dhe ai të bëjë punën e tij.

Organizata e Frontit ka disa rregulla organizative, ka këshillat në fshatra, në lagje si dhe në rrethe, ndërsa

këtu në qendër ka Këshillin e Përgjithshëm, domethënë ekziston centralizmi demokratik.

Por Këshilli i Përgjithshëm ose Kryesia e tij në qendër nuk mund të japë direktiva përditë si Partia, por mund të japë në disa raste të rëndësishme. Në lagjet dhe në fshatrat tona si Frontin kemi edhe organizata të tjera të masave, këshillat e të cilave, për probleme të rëndësishme mund të mblidhen nën drejtimin e Partisë dhe të diskutojnë së bashku. Por, Frontin Partia duhet ta mobilizojë për të gjitha problemet që ka baza, lagjja ose fshati, papritur urdhër nga lart, pse po të presë atëhere bëhet tamam një organizatë si dhe të tjerat, kurse Fronti është një organizatë më e gjerë. Vendimet që merren nga Partia mund të shkojnë në Front me anën e atij anëtari të byrosë së komitetit të Partisë të rrethit që është edhe në këshillin e Frontit. Në këtë mënyrë, Fronti merr masa për mobilizimin e popullit. Në rast se nuk do të veprohet kështu, atëhere këshillat e kësaj organizate do të mbeten formale. Fronti është një organizatë me shumë rëndësi, prandaj duhet të ketë edhe një statut më të thjeshtë, pse ai që ka sot duhet parë, më duket se është shumë i komplikuar.

Mendoj se nuk është nevoja që të ketë njerëz me pagesë që të punojnë për Frontin, se punët shoqërore të kësaj organizate duhet të kryhen me anë të aktivistëve.

*Botohet për herë të parë sipas  
tekstit të nxjerrë nga proces-  
verbali i mbledhjes së Byrosë  
Politike të KQ të PPSH  
që gjendet në AQP*

## R A P O R T

### «MBI SITUATËN POLITIKE DHE PROBLEMET EKONOMIKE»

*Mbajtur në Konferencën II Nacionale të PPSH*

**10 prill 1950**

Shokë dhe shoqe,

Konferenca II Nacionale e Partisë sonë që mbahet sot do të marrë në studim problemet më të rëndësishme aktuale. Një vend të rëndësishëm në këtë raport do të zënë shqyrtimi i situatës ndërkombëtare dhe i asaj të brendshme të vendit tonë në dritën e ngjarjeve që janë rrokullisur gjatë kohës që na ndan nga Kongresi I i Partisë sonë, çështjet ekonomike të vendit dhe detyrat që na dalin përpara për realizimin me sukses të planit dyvjeçar të shtetit, si dhe problemet që kanë të bëjnë me vetë jetën e Partisë, me forcimin dhe bolshevizimin e saj. Vendimet që do të marrë konferenca në lidhje me këto probleme do të jenë detyra të mëdha dhe të shenjta për të gjithë anëtarët e Partisë dhe për popullin punonjës të vendit tonë dhe duhet të bëhen një çështje nderi dhe një detyrë e lartë patriotike që ato të zbatohen në jetë me rigorozitetin dhe drejtësinë e

madhe bolshevike, për të mirën dhe lulëzimin e jetës së masave punonjëse dhe për fuqizimin e ndërtimit të bazave të socializmit në vendin tonë.

## I

### SITUATA POLITIKE E JASHTME DHE E BRENDSHME

Partia ka qenë vazhdimisht dhe në mënyrë konkrete në korrent të zhvillimit të situatës ndërkombëtare. Si udhëheqëse besnike e popullit dhe përgjegjëse për mbrojtjen e interesave jetësore të lirisë e të pavarësisë së Republikës sonë Popullore, në krye të të gjithë popullit shqiptar, Partia ka luftuar me vendosmërinë më të madhe për mbrojtjen e politikës paqësore të BS në botë, pse kjo është një nga faktorët e fitoreve të popullit tonë gjatë luftës çlirimtare dhe pas çlirimit të popullit tonë.

Është e qartë për çdo njeri të thjeshtë në botë se imperializmi amerikan, anglez dhe satelitët e tyre kërkojnë dhe përgatitin një luftë të re për të hedhur botën dhe njerëzimin në një kasaphanë të tmerrshme. Këtë gjë ata e bëjnë për t'i shpëtuar krizës së madhe, që po zhvillohet dhe po merr përpjesëtime të mëdha në gjirin e kapitalizmit, për shkak të përpjekjeve të tyre për të vendosur në botë hegjemoninë e imperializmit amerikan dhe «mënyrën e jetesës amerikane», domethënë regjimin fashist të plumbit, të litarit, të skllavërimit të popujve. Politika agresive e imperializmit

amerikan dhe e satelitëve të tjerë të tij është kundër një rregullimi paqësor, demokratik dhe të ndershëm të bashkëpunimit ndërkombëtar. Në kundërshtim të hapët me këto parime, mbi të cilat mund të ndërtohet një paqe e vazhdueshme dhe e drejtë, imperializmi amerikano-anglez ka marrë përsipër detyrën kriminale të përgatitë një luftë të re, shumë më të tmerrshme se Lufta e dytë botërore.

Imperialistët agresivë, me në krye ata amerikanë dhe anglezë, shkelën një nga një dhe në mënyrë flagrante marrëveshjet e Jaltës dhe të Potsdamit, mbi të cilat duhej të ndërtohej paqja e vërtetë në Evropë dhe në botë, ata kanë bërë të tyren politikën agresive të hitlerianëve, politikën antisovjetike, e cila, sikundër e dimë, dështoi dhe çoi në një katastrofë totale Gjermaninë hitleriane dhe ndihmësit e saj të hapët dhe të fshehtë. Si pasardhës të drejtëpërdrejtë të Hitlerit dhe të hitlerianëve imperialistët amerikanë, duke ngritur lart flamurin e antisovjetizmit, përpiqen të izolojnë Bashkimin Sovjetik me traktate dhe marrëveshje të ndryshme. Me parulla të rreme ata përpiqen të mbulojnë politikën aventuriere e kriminale të monopoleve amerikane dhe angleze dhe gjithë aktivitetin e vet ata e drejtojnë në një armatim kolosal të vendeve të tyre dhe të satelitëve të tyre. Këtë aktivitet kriminal ata përpiqen ta mbulojnë me fraza dhe fjalime demagogjike për paqen, por të gjitha këto përpjekje nuk mund të fshehin përpara masave të mbarë botës fytyrën e vërtetë të këtyre luftëdashësve, që janë armiq të betuar të popujve dhe të bashkëpunimit ndërkombëtar.

Lufta heroike dhe e lavdishme e popujve sovjetikë,

e udhëhequr nga gjenia e Stalinit të madh, çliroi përgjithmonë nga kthetrat e kapitalizmit një numër të madh popujsh në Evropë dhe në Azi. Popujt e demokracive popullore në Evropë dhe në Azi muarën fuqinë në duart e tyre dhe vendosën në vendet e tyre diktaturën e demokracisë popullore. Nga ana tjetër në të gjitha vendet e botës, fitoret e shkëlqyera të BS ngjallën dhe forcuan ndjenjat për çlirim të popujve të shtypur. Një zhvillim i jashtëzakonshëm po shihet në botë pas Luftës së dytë botërore në hovin e madh dhe të papërshekrueshëm të forcave luftarake demokratike popullore, të popujve që vuajnë nën zgjedhën koloniale e gjysmëkoloniale, të cilët janë hedhur në luftë kundër imperializmit gjakatar dhe satelitëve të tij për të fituar lirinë dhe pavarësinë e tyre. Përpara kësaj vale të madhe dhe të fuqishme të forcave përparimtare, që udhëhiqen nga Bashkimi Sovjetik dhe që kanë bërë si mishin dhe gjakun e tyre politikën çlirimtare dhe paqësore staliniane, tmerrohen imperialistët amerikano-anglezë dhe shërbëtorët e tyre në Evropën Perëndimore e gjetkë. Kjo gjë i shtyn imperialistët amerikano-anglezë të pregatiten me ethe për një luftë të re botërore, pse ata shohin që u shket toka nën këmbë dhe u afrohet fundi i sundimit të tyre, të cilin ata përpiqen me shpirt në dhëmbë ta zgjatin, në pamundësi absolute ta përjetësojnë. Kjo gjë i bën imperialistët të sabotojnë të gjitha përpjekjet e Bashkimit Sovjetik, i cili lufton për të sqaruar dhe përmirësuar situatën ndërkombëtare dhe për të siguruar paqen e qëndrueshme e demokratike në botë. Për këtë qëllim imperialistët amerikano-anglezë i sabotojnë sistematikisht të gjitha propozimet e

Bashkimit Sovjetik për pakësimin e armatimeve dhe për ndalimin e bombës atomike, si armë lufte nga më kriminalet. Shoku Stalin ka thënë:

*«Politika e drejtuesve të sotëm të SHBA dhe të Anglisë është politikë agresioni, politikë e shpërthimit të një lufte të re».*<sup>1</sup>

Çdo gjë dhe çdo ditë vërteton saktësinë e fjalëve të Stalinit të madh.

Politika agresive e udhëheqësve të tanishëm të Amerikës dhe të Anglisë i shqelmoi marrëveshjet bazë, që ishin firmosur në mes aleatëve dhe Bashkimit Sovjetik gjatë luftës. Shkelja e këtyre marrëveshjeve nga ana e imperialistëve amerikanë dhe anglezë ka pasur qëllime kriminale, që ata i vunë përnjëherë në zbatim, duke mos pranuar të përfundohej traktati i paqes me Gjermaninë dhe me Japoninë ngaqë synojnë të mbajnë të pushtuar me forcat e tyre Gjermaninë Perëndimore dhe Japoninë. Në këtë mënyrë u vërtetuan fjalët e shokut Mollotov, i cili ka thënë se vetëm ata, që dëshirojnë ta zgjatin pa kufi pushtimin e Gjermanisë dhe të Japonisë, duke përbuzur dhe shkelur interesat legjitime të popujve të këtyre vendeve, mundet të evitojnë zbatimin e marrëveshjeve ndërkombëtare në fjalë.

Si rrjedhim i shkeljes së këtyre marrëveshjeve, Gjermania Perëndimore është transformuar nga imperialistët luftëdashës në një çerdhe shumë të rrezikshme të fashizmit dhe të agresionit, ku po mëkëmbet

---

<sup>1</sup> J. V. Stalin. Intervistë dhënë korrespondentit të gazetës «Pravda». «Pravda» Nr. 303 (11044), 29 tetor 1948.



hitlerizmi dhe kjo pjesë e Gjermanisë po transformohet në një arsenal lufte dhe agresioni kundër Bashkimit Sovjetik dhe demokracive popullore në Evropë. Nga ana tjetër, Japonia po transformohet në një koloni të vërtetë të imperializmit amerikan, i cili po mëkëmb kriminelët fashistë dhe militaristë japonezë me kriminelin e luftës Hiro Hiton<sup>1</sup> në krye dhe po i organizon ata për një agresion të ri kundër Bashkimit Sovjetik, Kinës popullore dhe gjithë popujve të tjerë të Azisë, që luftojnë për të fituar pavarësinë dhe lirinë e tyre.

Imperialistët luftëdashës amerikanë po bredhin me urë të ndezur në dorë në Pacifik, në Azi e në Evropë për t'i vënë edhe një herë zjarrin botës. Plani Marshall, i hartuar prej tyre dhe i vënë në zbatim me ndihmën e qeverive kukulla dhe antipopullore të Evropës Perëndimore, po skllavëron ekonomikisht dhe politikisht vendet perëndimore të Evropës dhe po i varfëron këto duke i bërë bazë agresioni kundër Bashkimit Sovjetik dhe demokracive popullore. Imperialistët amerikanë kanë hartuar plane ushtarake e politike, që i kanë vënë në themel të traktateve agresive dhe të luftës, të nënshkruara në mes të Shteteve të Bashkuara, Anglisë, Francës, Italisë, si Bashkimi Evropian, Pakti i Atlantikut dhe PAM (programi i ndihmës ushtarake) që s'janë gjë tjetër veçse armë agresive dhe luftëdashëse në duart e imperialistëve për një konflikt agresiv të ri në botë dhe për të siguruar mish për top për këtë luftë në interes të monopoleve dhe të trusteve amerikane.

Imperializmi amerikan po krijon kudo, ku ai ka

---

<sup>1</sup> Perandor i Japonisë që nga viti 1926.

mundësi, baza ushtarake të panumërta, tokësore, detare e ajrore, si një kordon zjarri kundër Bashkimit Sovjetik dhe demokracive popullore, për të mbajtur gjallë psikozën e luftës dhe për ta përgatitur këtë luftë sa më shpejt. Imperializmi amerikan nxit dhe ndihmon me të gjitha forcat e tija qeveritë reaksionare dhe kukulla të Çan Kai Shisë, të Vietnamit të Jugut, të Indonezisë, të Greqisë monarko-fashiste, për të shuar dhe për të mbytur në gjak luftën çlirimtare të popujve të këtyre vendeve, për t'u hedhur atyre thonjtë në grykë, për t'i pasur këto vende të nënshtruara nën diktatin e vet dhe për t'i bërë baza për agresionin e ri që po përgatit. Imperializmi amerikano-anglez me agjenturat e tija, që përgatit dhe i lëshon në të katër anët e botës, përpiqet të hedhë çdo gjë në duart e tija. Ai, me grupin e spiunëve të tij të vjetër Tito dhe shokët e tij, u përpoq që të hidhte nën thundrën e tij demokracitë popullore, t'i shndërronte këto në koloni të tija dhe t'i bënte vende, nga ku të shpërthente agresionin e ri kundër atdheut të madh të socializmit dhe të komunizmit, Bashkimit Sovjetik.

Por imperializmi amerikano-anglez dhe satelitët e tij nuk mund të kthejnë kurrsesi prapa rrotën e historisë, e cila ecën kurdoherë përpara. Revolucioni i madh i Tetorit ishte fillimi i shkatërrimit të sistemit kapitalist. Pas Luftës së dytë botërore një sërë popujsh të Evropës Lindore dhe Juglindore u çliruan përgjithmonë nga thonjtë e kapitalizmit dhe hynë me vendosmëri në rrugën e socializmit.

Populli i madh kinez u çlirua përgjithmonë nga kthetrat e imperializmit janki dhe vendosi demokracinë

popullore. Në këtë mënyrë u krijua në Azi një kala e fuqishme e paqes dhe e demokracisë. Po kështu u krijua Republika Demokratike Popullore e Koresë, Republika Demokratike Popullore e Vietnamit. Lëvizja e fuqishme e çlirimit nacional po merr përpjesëtime të mëdha në të gjitha vendet e tjera të Azisë.

Lëvizja demokratike po forcohet dita-ditës në vendet kapitaliste dhe në vetë Shtetet e Bashkuara të Amerikës, që janë kreu i imperializmit të sotëm; në këto vende pjesa dërmuese e popullit është ngritur kundër qëllimeve agresive dhe luftëdashëse të drejtuesve të tij. U krijua Republika Demokratike Gjermane, e cila po forcohet dita-ditës në rrugën e demokracisë dhe të paqes dhe po bëhet një faktor i rëndësishëm për bashkimin e gjithë Gjermanisë dhe për dështimin e planeve të imperializmit në Gjermaninë Perëndimore. Populli gjerman ka përfituar edhe ai nga mësimet e Luftës së dytë botërore dhe do të bëjë që të dështojnë qëllimet e imperialistëve për copëtimin e Gjermanisë. Politika e aventurierëve monopolistë amerikano-anglezë do të dështojë siç kanë dështuar të gjitha manevrat e tyre, ashtu siç dështoi me turp plani Marshall; ashtu siç dështuan shpresat e imperialistëve mbi «monopolin» e bombës atomike dhe të «luftës atomike rrufe»; ashtu siç dështuan planet e tyre në Kinë dhe u vanë kot të 6 miliard dollarët, që ata shpenzuan për të financuar Çan Kai Shinë në veprën e tij kriminale; ashtu siç dështuan planet e tyre për të shtënë në dorë Ballkanin me anën e spiunëve të tyre Tito e shokët e tij; ashtu siç po dështon me turp edhe gjithë propaganda e tyre hysterike e luftës së ftohtë, e shantazheve dhe e kërcë-

nimeve të ndryshme ndaj Bashkimit Sovjetik dhe demokracive popullore.

Përballë luftëdashësve të kampit imperialist qëndron triumfues dhe i pamposhtur kampi antiimperialist i paqes e i demokracisë që përbëhet prej më shumë se 800 milion njerëzish. Në krye të këtij kampi qëndrojnë popujt e lavdishëm të Bashkimit Sovjetik, në të bëjnë pjesë popujt e demokracisë popullore, që në saje të luftës së tyre dhe të ndihmës së Bashkimit Sovjetik fituan lirinë, bën pjesë populli i madh kinez, që me luftën dhe fitoren e tij lëkundti nga themelet bazat e imperializmit, veçanërisht në Azi. Të gjithë këta popuj, që formojnë kampin e paqes, të demokracisë dhe të socializmit i kanë shtërnguar radhët e tyre dhe ecin të patrembur kurdoherë përpara me flamurin ngadhënjimtar dhe shpëtimtar të Stalinit të madh.

Sukseset e mëdha të Bashkimit Sovjetik në lëmin ekonomik, politik, kultural e gjetkë mbushin me gëzim zemrat e popujve dhe të qindra e qindra miliona njerëzve të thjeshtë në botë. Fitoret e Bashkimit Sovjetik janë fitoret e të gjithë popujve përparimtarë, janë prova e pashlyeshme e epërsisë së pakontestueshme të sistemit socialist mbi sistemin kapitalist. Popujt e mbarë botës përshëndetën me entuziazëm të madh nënshkrimin e aleancës në mes të Bashkimit Sovjetik dhe Kinës së Mao Ce Dunit, pse kjo aleancë shënon një datë të shënuar në historinë e popujve dhe përbën një faktor të rëndësishëm për konsolidimin e paqes në botë.

Zgjedhjet e fundit për deputetët në Sovjetin Suprem të Bashkimit Sovjetik treguan forcën e madhe të demokracisë së vërtetë socialiste sovjetike, treguan kom-

paktësinë e çelniktë të popujve sovjetikë, dashurinë e madhe dhe besnikërinë e pakufishme ndaj prijësit të madh Stalinit, ndaj Partisë Bolshevike të Lenin-Stalinit, ndaj kauzës së madhe të paqes, që frymëzon gjithë popujt e atdheut të socializmit.

Potenciali i ekonomisë socialiste sovjetike është kolosal. Komunikata e Zyrës Qendrore të Statistikave të Qeverisë Sovjetike për realizimin e planit të vitit 1949 është një provë madhështore që tregon forcën e madhe të rendit socialist sovjetik dhe epërsinë dërmuese mbi rendin kapitalist. Plani pesëvjeçar stalinian i pasluftës po realizohet në katër vjet gjë kjo që tregon fuqinë e pashterueshme të punonjësve sovjetikë që ndërtojnë komunizmin. Ne shohim se plani i vitit 1949, megjithëse ju bënë shtesa, është realizuar 103 për qind nga e gjithë industria, e cila i dha popullit sovjetik me shumicë të madhe prodhime industriale të ndryshme duke filluar që nga qymyrguri, nafta, automobilat, traktorët etj. dhe deri te sendet e konsumit të gjerë. Ne shohim gjithashtu se prodhimet bujqësore e trafiku i transporteve po shtohen dhe ndërtimet e ekonomisë kombëtare po zhvillohen në një vëllim të madh. Disa shembuj që theksohen në këto statistika vënë në dukje forcën e madhe të ekonomisë socialiste sovjetike. Në 1949 prodhimi industrial i Bashkimit Sovjetik u shtua 20 për qind në krahasim me 1948-n dhe 41 për qind në krahasim me 1940-n, me vitin para fillimit të luftës, ndërsa në fund të vitit 1949 prodhimi industrial i caktuar për vitin 1950 nga plani pesëvjeçar, e kapërceu nivelin.

Prodhimi global i vitit 1949 në bujqësi e kapërceu

nivelin e paraluftës, kurse drithërat jo vetëm që e kanë kapërcyer nivelin e paraluftës, por kanë arritur shifrat e caktuara nga plani pesëvjeçar për 1950-n. Shtimi i lopëve është 25 për qind, i derrave — 78 për qind, transportet e kanë kapërcyer shumë nivelin e paraluftës dhe vëllimi i ndërtimeve të mëdha në ekonominë kombëtare e ka kapërcyer planin 20 për qind. Vetëm në vitin 1949 shteti sovjetik i ka dhënë bujqësisë 150 000 traktorë, 29 000 maqina shirëse, 64 000 kamiona dhe më tepër se 1 600 000 maqina tërheqëse dhe maqina të tjera për bujqësinë. Në katër vitet e pasluftës, që nga viti 1946 deri në 1949, janë ndërtuar dhe janë vënë në veprim më tepër se 5 200 ndërmarrje industriale shtetërore, pa llogaritur ndërmarrjet shtetërore të vogla dhe ato të kooperativave bujqësore. Zhvillimi i teknikës në Bashkimin Sovjetik po arrin kulmin, metoda të reja pune kanë hyrë në veprim, mekanizma dhe maqina me rendiment të lartë kanë hyrë në shfrytëzim në industri dhe në ndërtim saqë pallate të mëdha prej 40 apartamentesh kanë arritur të ndërtohen që nga themelet dhe deri në dorëzimin e çelsave në një kohë rekord prej 30 ditësh. Në këtë vepër të madhe ndërtimore i gjithë populli sovjetik tregon një forcë dhe një vitalitet që s'ka shembull në botë dhe në historinë e popujve. Vetëm në vitin 1949, teknikë, inxhinierë etj. kanë paraqitur më tepër se 450 000 propozime për shpikje dhe racionalizime.

Jeta në vendin e lavdishëm të socializmit dhe të komunizmit po lulëzon. Ka vite që atje është harruar ç'do të thotë papunësi dhe prapambetja e injoranca janë zhdukur përgjithmonë. Numri i punëtorëve dhe i nëpunësve në Bashkimin Sovjetik në vitin 1949 është

shtuar në 1 800 000 vetë. 724 000 të rinj dhe të reja kanë mbaruar shkolla industriale dhe universitete dhe janë hedhur në të gjitha degët e aktivitetit ndërtimtar. Vetëm në një vit numri i njerëzve, që vazhdojnë shkollat dhe teknikumet, u shtua në 2 000 000 dhe ai i studentëve në shkollat e larta u shtua në 1 128 000 vetë. Ky bollëk, kjo mirëqenje, ky përparim kolosal ka bërë që në të katër anët e Bashkimit Sovjetik të ndërtohen një numër i madh shtëpish të reja banimi për popullin, shkolla, institute, spitale, të ndërtohen qytete, të shkojë elektriku në kolkoze dhe sovkoze, të shkojë kinemaja, teatri, të mekanizohet puna në fshat, që edhe ky të ketë komoditetet e qytetit.

Potenciali i madh ekonomik i Bashkimit Sovjetik, që tregon epërsinë e padiskutueshme të rendit shoqëror dhe politik të shtetit socialist sovjetik mbi regjimin kapitalist, ka bërë që mirëqenja e popujve sovjetikë të shkojë dita-ditës duke u shtuar. Lufta i shkatërroi Bashkimit Sovjetik 70 000 fshatra, 1 710 qytete, 6 000 000 banesa, 31 700 ndërmarrje industriale, 100 000 kolkoze, 65 000 km. hekurudha etj. Por me gjithë këto rrënime kolosale, forca e Bashkimit Sovjetik, e Partisë Bolshevike të Lenin-Stalinit është e tillë që, pa kaluar akoma pesë vjet nga mbarimi i luftës, bënë që populli sovjetik ta tejkalojë shumë nivelin e jetesës në krahasim me paraluftën.

Një gëzim i madh i përshkoi masat e gjera punonjëse të vendit tonë kur muarën vesh uljen e çmimeve në Bashkimin Sovjetik. Në më pak se dy vjet qeveria sovjetike ka ulur tri herë çmimet në tregëtinë e shtetit. Herën e parë kur u ulën çmimet, populli sovjetik në një

vit pati fitim 86 miliard rubla, herën e dytë pati një fitim tjetër prej më tepër se 70 miliard rublash dhe nga ulja e fundit e çmimeve pati një fitim prej 110 miliard rublash. Ç'tregojnë këto shifra kolosale? Këto tregojnë shtimin e fuqisë blerëse të rublës sovjetike, një ngritje të madhe të pagës reale të punëtorëve dhe të punonjësve sovjetikë, një ngritje të mirëqenjes së çdo familjeje dhe të çdo qytetari sovjetik; këto tregojnë zhvillimin dhe përparimin në BRSS, në ndërtimin e shoqërisë së parë socialiste e komuniste. Sukseset e mëdha të arritura në Bashkimin Sovjetik në tejkalimin e planeve dhe në realizimin e planit pesëvjeçar stalinian në katër vjet, na tregojnë se në ekonominë e planifikuar të Bashkimit Sovjetik nuk njihen krizat dhe çdo gjë zhvillohet sistematikisht sipas ligjit të prodhimit socialist dhe i gjithë ky zhvillim bëhet vetëm për lumturinë dhe mirëqenjen e masave të gjera punonjëse.

Krejt ndryshe nga ekonomia e fuqishme sovjetike, ekonomia e vendeve kapitaliste kalon një krizë të madhe. Shoku Stalin ka thënë:

*«... sistemi kapitalist i ekonomisë është i pathemeltë dhe i paqëndrueshëm, se tani ai po heq shpirt dhe duhet t'ja lëshojë vendin një sistemi tjetër, më të lartë, sistemit socialist sovjetik të ekonomisë, se i vetmi sistem ekonomie, që nuk ka frikë nga krizat dhe që mund t'i kapërcejë vështirësitë e pazgjdhshme për kapitalizmin, është sistemi sovjetik i ekonomisë»<sup>1</sup>.*

<sup>1</sup> J. V. Stalin. Veprat, vëll. 13, f. 206.



Ndërsa në Bashkimin Sovjetik ne shohim të fuqizohet kaq shumë ekonomia socialiste sovjetike, në Shtetet e Bashkuara të Amerikës vëllimi i prodhimit nga viti 1948 në vitin 1949 ulet në 22 për qind, investimet për vitin 1949 në krahasim me vitin 1948 në industri ulen në masën 15 për qind dhe në transportet — 27 për qind. Pagat reale të nëpunësve dhe të punëtorëve ulen nga një tremujor në tjetrin; gjithashtu edhe të ardhurat e bujqësisë, si ato globale, ashtu edhe të ardhurat neto pakësohen akoma më tepër. Varfëria e masave punonjëse në Shtetet e Bashkuara ka marrë përpjesëtime të tmerrshme. Numri i të papunëve në Shtetet e Bashkuara është ngritur në 64 për qind më shumë. Në vendet e tjera kapitaliste masat e gjera të popullit jetojnë në mjerim e pasiguri. Prodhimi në këto vende ulet nga viti në vit dhe ndërsa prodhimi industrial ka ngecur në nivelin e vitit 1929, Bashkimi Sovjetik në po këtë periudhë prej 20 vjetësh, megjithëse ka kaluar nëpërmjet gjithë këtyre luftërave të tmerrshme, e ka shtuar prodhimin e vet industrial 9 herë më shumë në krahasim me vitin 1929. Në vendet kapitaliste numri i të papunëve i kapërcen të 40 milion vetët, kurse në Bashkimin Sovjetik papunësia ka dhjetëra vjet që nuk ekziston fare. Kuptohet se në çfarë mjerimi të madh ndodhen masat punonjëse të vendeve kapitaliste dhe në ç'skllavëri të rëndë mbahen popujt e këtyre vendeve nga një grusht miliardësh gjakpirës. Që më 1918 i madhi Lenin duke folur për Shtetet e Bashkuara të Amerikës thoshte:

*«Amerika u bë në të njëjtën kohë një nga vendet e para, ku ekziston humnera më e thellë*

*midis një grushti miliardësh të paturpshëm, të zhytur në llum dhe në luks, nga njëra anë, dhe miliona punonjësve, që u troket gjithmonë në derë varfëria, nga ana tjetër»<sup>1</sup>.*

Ky hendek dhe kjo greminë e tmerrshme është thelluar jashtëzakonisht shumë midis pasurive përrallore që kanë vënë manjatët e trusteve e të monopoleve dhe mjerimit e pasigurisë së popullit amerikan në përgjithësi dhe në veçanti të më shumë se 15 milion të papunëve. Në vendet ku sundon thundra e gjakosur e kapitalit, rrogat e nëpunësve dhe të punëtorëve po ulen gjithmonë e më tepër dhe çmimet po ngrihen vazhdimisht. Ky është një fenomen i vazhdueshëm dhe i përgjithshëm në shtetet kapitaliste, kurse në rendin socialist ngjet krejtësisht e kundërta. Dhe ndërsa në Angli brenda dy vjetëve jeta u shtrenjtua 20-25 për qind, në Francë çmimet e sendeve ushqimore janë ngritur 20 herë më shumë në krahasim me nivelin e paraluftës dhe në Itali 60 herë më shumë, në Bashkimin Sovjetik shohim se, me zbritjen e fundit të çmimeve, buka është liruar 30 për qind, mishi — 35 për qind, gjalpi — 30 për qind, sheqeri — 15 për qind, basmet — 24 për qind, sapuni — 50 për qind e kështu me radhë. Ky fenomen i uljes së çmimeve dhe i ngritjes së mirëqenjes do të ndodhë nga viti në vit në vendet socialiste, kurse e kundërta do të ngjasë në vendet kapitaliste.

Në vendet e demokracisë popullore, të çliruara

<sup>1</sup> V. I. Lenin. Veprat, vëll. 28, f. 53.

përgjithmonë nga thundra e imperializmit amerikano-anglez dhe fashist, të ndihmuara vazhdimisht nga Bashkimi Sovjetik, po ndërtohen me sukses bazat e socializmit, jeta e lumtur, e lirë dhe e begatshme për masat e gjera të punonjësve. Ekonomia socialiste e vendeve të demokracisë popullore po përparon me hapa të mëdhenj dhe të sigurtë. Ekonomia e tyre po ecën me plan, sipas eksperiencës së ekonomisë së planifikuar socialiste të Bashkimit Sovjetik. Masat e gjera të popullit në demokracitë popullore po punojnë me një entuziazëm të papërshkruar, realizojnë planet e shteteve të tyre, i tejkalojnë këto dhe çdo ditë e çdo muaj ato gëzojnë frutet e punës së tyre të lirë dhe ndërtimtare. Të gjitha ekonomitë e vendeve të demokracisë popullore, të prapambetura dhe të dëmtuara nga regjimet kapitaliste dhe fashiste të së kaluarës, nga Lufta e dytë botërore dhe nga dëmet e mëdha që u kishte shkaktuar shkllavërimi i kapitalit të huaj imperialist, jo vetëm që korrin suksese të mëdha, por e kanë tejkaluar në një shkallë të gjerë nivelin e paraluftës. Në sektorët e ndryshëm të ekonomisë në vendet e demokracisë popullore po shënohen çdo vit suksese të reja si në industri, në miniera, në bujqësi, në arësim etj. Kjo ka bërë që të shtohen prodhimet dhe të ulen çmimet në interesin e masave të gjera punonjëse, të shtohen dhe të përmirësohen banesat e popullit, shkollat, spitalet, vendet e prehjes; arti, kultura e arësimi kanë marrë një hov të madh dhe po bëhen të masave. Ndërsa në demokracitë popullore po fuqizohet dhe po shtohet industria, e cila është prona e popullit, në vendet ku sundon kapitali, mbyllen fabrika, hidhen punëtorët jashtë dhe ato in-

dustri që mbeten, punojnë për manjatët amerikanë dhe satelitët e tyre, të cilët shfrytëzojnë pa mëshirë dhe deri në palcë proletariatin e atyre vendeve. Në vendet e demokracisë popullore po përparon bujqësia, pse toka është në duart e fshatarëve punonjës, të cilët shteti i ndihmon me të gjitha mjetet dhe metodat moderne të agroteknikës që të punojnë më mirë dhe të prodhojnë më shumë, ndryshe ndodh në vendet ku mbretëron ligji i kapitalit dhe i borgjezisë gjakpirëse. Atje toka është e beut, e latifondistit, e manjatëve gjakpirës, të cilët i shfrytëzojnë dhe i rjepin fshatarët pa mëshirë dhe prodhimet e tokës shërbejnë për të pasuruar xhepin e kapitalistëve e për të mbajtur në uri me miliona njerëz punonjës. Djersa e popullit punonjës në vendet kapitaliste shërben dhe përdoret për t'u sjellë më tepër fitime milionerëve të trusteve. Në Shtetet e Bashkuara, miliardë, për të mbajtur të larta çmimet e sendeve ushqimore e të konsumit dhe për të ruajtur fitimet e tyre kolosale i shkatërrojnë dhe i djegin në mënyrën më barbare këto sende dhe kjo ndodh kur me miliona njerëz vuajnë për sendet më të nevojshme të jetesës bile nuk kanë ç'të hanë.

Fjalët e Stalinit të madh në lidhje me barbarizmat e sistemit kapitalist, të thëna këtu e njëzet vjet më parë, janë më se aktuale:

*«Duhet pranuar se një sistem ekonomie, që nuk di ç't'i bëjë «tepricat» e prodhimit të tij dhe që është i detyruar t'i djegë ato, në një kohë kur ndër masat mbretërojnë mjerimi dhe papunësia, uria dhe rrënimi — një sistem i*

*tillë ekonomie e ka dënuar vetëveten me vdekje»<sup>1</sup>.*

Pra, për t'i shpëtuar kësaj krize të madhe që e kërçonon për vdekje, imperializmi po përgatit një luftë të re botërore. Prandaj, për të gjithë popujt e botës, lufta aktive për mbrojtjen e paqes dhe imponimi i paqes nxitësve të një lufte të re bëhet çështje kryesore. Për arritjen e këtij objektivi të madh janë mobilizuar me qindra miliona njerëz të thjeshtë në të katër anët e botës, të cilët janë inkuadruar në frontin e fuqishëm të partizanëve të paqes që udhëheq Bashkimi Sovjetik dhe Stalini i madh. Lufta e popujve për paqen merr çdo ditë përpjesëtime të jashtëzakonshme dhe forma konkrete e efektive. Këto masa bëjnë që nxitësit e një lufte të re të zbrapsen dhe të tmerrohen, të cilët me gjithë përpjekjet e panumërta, me gjithë buxhetet e tyre të luftës, jashtëzakonisht të fryra, prapavijat e tyre ata i kanë të pasigurta dhe në lëvizje e në kryengritje kundër planeve të tyre djallëzore dhe kriminale.

Popujt e mbarë botës e urrejnë luftën dhe luftojnë me të gjitha mundësitë që kjo të mos shpërthejë më. Lufta është armiku më i madh i popujve, ashtu sikundër janë armiqtë më të mëdhenj të tyre nxitësit e luftës, imperialistët amerikano-anglezë. Popujt në asnjë mënyrë nuk do të lejojnë të përsëriten tmerret e Luftës së dytë botërore, djegjet dhe shkatërrimet që ju kushtuan atyre aq gjak dhe sakrificë të panumërta dhe imperialistëve amerikanë aq fitime kolosale në kurrizin e gja-

---

<sup>1</sup> J. V. Stalin. Veprat, vëll. 12, f. 314.

kun e popujve. Vullneti i hekurt i popujve po u pret rrugën agresorëve dhe popujt e botës kanë bërë të tyren politikën e jashtme paqësore staliniane, e cila është bërë simboli dhe flamuri i masave të gjera popullore që luftojnë për paqen dhe për një bashkëpunim të ndershëm ndërkombëtar. Asnjë njeri i thjeshtë në botë nuk mund të qëndrojë indiferent përpara kësaj lëvizjeje të madhe botërore për mbrojtjen e paqes, pse të gjithë, pavarësisht nga pikëpamjet e ndryshme politike ose fetare, kanë interes të mbrojnë jetën e miliona njerëzve, fatin e qytetërimit dhe shpëtimin e vlerave materiale dhe kulturele të ndërtuara nga gjenerata të tëra për të mirën e gjithë njerëzimit. Për këtë arsye të madhe popujt e mbarë botës, të inkuadruar në frontin e partizanëve të paqes, po japin prova të shkëlqyera të një organizimi të shëndoshë dhe të një vigjilence të madhe para manevrave dhe planeve të imperialistëve. Dhe për ta organizuar e fuqizuar këtë front të madh të popujve dhe për t'i udhëhequr këta drejt fitores, si kurdoherë, në krye të popujve janë partitë komuniste në gjithë botën. Punëtorët e gjithë botës po shtërngojnë radhët e tyre dhe po demaskojnë përçarësit e tyre, klikat e socialistëve të djathtë, agjentë të imperializmit dhe të borgjezisë. Këto klika përpiqen të organizojnë në prapavijat e tyre luftën briganteske, të përçajnë bashkimin e punëtorëve dhe luftën që bëjnë këta për të fituar të drejtat demokratike dhe lirinë e tyre.

Rreziku i madh që kërcënon paqen nga ana e nxitësve të luftës ka bërë që të manifestohet kudo vullneti i popujve dhe forcat e paqes të ndjekin me besnikërinë më të madhe politikën e lavdishme paqësore staliniane,

e cila u përgjigjet plotësisht interesave të popujve të Bashkimit Sovjetik dhe interesave të të gjithë popujve të botës. Në Evropën Perëndimore po zhvillohet një luftë e ashpër dhe konkrete kundër imperialistëve dhe agjentëve të tyre, klikave borgjeze dhe tradhëtare. Masa të gjera të popullit në Francë, në Itali e gjetkë kërkojnë me këmbëngulje zhdukjen e bombës atomike. Punëtorët dhe hamejt e porteve nuk pranojnë të ngarkojnë armatimet amerikane për në Vietnam dhe Indonezi, nuk pranojnë të shkarkojnë armët amerikane në Francë e gjetkë, të cilat i shërbejnë imperializmit për të ndezur një luftë të re kundër Bashkimit Sovjetik dhe demokracive popullore; punëtorët e uzinave e të fabrikave të armatimeve bëjnë greva të mëdha dhe nuk pranojnë të prodhojnë material lufte. Komiteti i Përhershëm i Kongresit Botëror të Partizanëve të Paqes u bëri thirrje më 15 dhjetor të vitit të kaluar gjithë parlamenteve të botës për të shqyrtuar dhe aprovuar propozime me shumë rëndësi siç janë: të ndalohet kursi i armatimeve dhe i buxheteve të luftës, t'i jepet fund luftës dhe ndërhyrjes kundër popujve të Indonezisë, të Vietnamit dhe të Malezisë, të ndalohet ndjekja dhe shtypja e partizanëve të paqes, të mënjanohet rreziku i përdorimit të bombës atomike dhe i prodhimit të saj e t'i jepet fund luftës së nervave, të vendoset besimi dhe të nënshkruhet, në kuadrin e Kombeve të Bashkuara, një pakt i paqes në mes të fuqive të mëdha. Kësaj thirrjeje ju përgjegjën të gjitha ato parlamente që përfaqësojnë interesat e popujve të tyre.

Sesioni i fundit i Komitetit të Përhershëm të Kongresit Botëror të Partizanëve të Paqes, që u mbajt në

Stokholm<sup>1</sup>, mori vendime me rëndësi të jashtëzakonshme, në mes të të cilave atë të ndalimit të armës atomike. Sipas këtyre vendimeve popujt e mbarë botës do t'i konsiderojnë si kriminelë lufte atë qeveri dhe ata qeveritarë, që do të guxojnë të përdorin për herën e parë këtë armë për të vrarë e shkatërruar dhe këta njerëz do të pësojnë fatin e kriminelëve të luftës. Këto vendime të rëndësishme të Komitetit të Përherëshëm të Kongresit Botëror të Partizanëve të Paqes u përgjigjen aspiratave të qindra miliona njerëzve në botë, që do t'i mbrojnë këto vendime me forcë dhe do të bëjnë që të zhduket rreziku i një lufte të re. I gjithë populli ynë aprovon këto vendime të Komitetit të Përherëshëm të Kongresit Botëror të Partizanëve të Paqes dhe i tëri si një trup i vetëm do ta firmosë këtë thirrje e do ta mbrojë me të gjitha forcat e tija paqen.

Përpara kësaj detyre të dorës së parë dhe jetike, populli ynë, me në krye Partinë e tij, është mobilizuar i tëri si një trup i vetëm. Këtë e dëshmon vepra ndërtimtare dhe paqësore e popullit tonë, qëndrimi i tij besnik, i patundur dhe luftarak në kampin e paqes dhe të socializmit; këtë e dëshmon çdo ditë dashuria e pakufishme që ka ai për Bashkimin Sovjetik dhe Stalinin e madh, e tregon shpirti i tij i frymëzuar nga internacionalizmi proletar; këtë e dëshmon urrejtja e pakufishme që ushqen ai ndaj imperialistëve amerikano-anglezë dhe agjentëve të tyre të Beogradit, të Athinës e të vendeve të tjera; këtë e dëshmon aprovimi i propozimeve të Byrosë së Këshillit Botëror të Partizanëve të Paqes nga

---

<sup>1</sup> Ky sesion u mbajt më 15-19 mars 1950.



Kuvendi ynë Popullor<sup>1</sup>; këtë e tregon Kongresi kombëtar i partizanëve të paqes, që u mbajt këto kohët e fundit në Tiranë<sup>2</sup>; këtë e tregon hovi i të gjitha masave të popullit tonë, që lufton çdo ditë për mbrojtjen e paqes.

Partisë dhe popullit tonë u vihet për detyrë që ta forcojnë dita-ditës më tepër lëvizjen për mbrojtjen e paqes dhe kjo propagandë aktive dhe konkrete të çojë peshë të madh e të vogël në vendin tonë.

Detyra e madhe që na shtrohet të gjithëve përpara, për çështjen e mbrojtjes së paqes, është që ta çimentojmë organizativisht këtë lëvizje dhe të marrë pjesë në të pa përjashtim çdo njeri i ndershëm, pa marrë parasysh pikëpamjet e tija politike dhe fetare. Duhet të bëjmë një propagandë të gjerë, të vazhdueshme dhe konkrete për një paqe të fortë dhe të qëndrueshme; të denoncojmë pa u lodhur planet agresive të imperialistëve luftëdashës, aleancat e tyre ushtarake e sidomos atë të Atlantikut Verior. Të ngrihet zëri i fuqishëm i masave punonjëse të vendit tonë për ndalimin e bombës atomike, mjete më kriminal për shfarosjen e njerëzve në masë; të jemi kurdoherë dhe kudo vigjilentë ndaj armikut të jashtëm dhe të brendshëm dhe të godasim pa mëshirë këta armiq, nën çdo maskë që mund të fshihen, por këta janë ata që kërkojnë t'i bëjnë varrin popullit tonë dhe të ndezin luftën e re. Të godasim pa mëshirë dhe të demaskojmë agjentët e imperialistëve amerikanë

---

<sup>1</sup> Kuvendi Popullor i RPSH i aprovoi unanimisht këto propozime në sesionin e jashtëzakonshëm që u mbajt më 4 mars 1950.

<sup>2</sup> Ky kongres i zhvilloi punimet më 5 dhe 6 mars 1950.

Titon dhe shokët e tij, që e kanë shndërruar Jugosllavinë në çerdhe të agjenturave të imperializmit, për të shtypur popujt e Jugosllavisë. Populli ynë me Partinë e tij të Punës në krye do të luftojë me të gjitha forcat për të mbrojtur paqen, do të luftojë me vetëmohim që të triumfojë paqja.

Në përpjekjet që bën imperializmi për të përgatitur një luftë të re botërore, një vend të rëndësishëm zënë edhe qëllimet e tij për të dëmtuar Republikën tonë Popullore. Imperialistëve amerikanë, anglezë dhe satelitëve të tyre, tradhëtarëve të Beogradit, monarko-fashistëve grekë, fashistëve italianë dhe Vatikanit e agjentëve të tyre nuk u ka pëlqyer asnjëherë që populli ynë të jetë i lirë, të vetëqeveriset, të ecë në rrugën e socializmit dhe të bëjë pjesë në kampin e fuqishëm demokratik dhe antiimperialist. Për interesat e tyre ekonomike dhe strategjike ata kanë lakmuar kurdoherë, si në të kaluarën, ashtu edhe sot që Shqipërinë ta kishin nën pushtetin e tyre, ta shfrytëzonin dhe ta shtypnin, ta kishin një urë të sigurtë për të përgatitur goditje të reja në të ardhshmen kundër Bashkimit Sovjetik dhe demokracive të tjera popullore. Duke pasur një pozitë strategjike të rëndësishme në Ballkan dhe duke qenë një kështjellë e demokracisë në prapavijat e tyre, imperialistët amerikanë dhe anglezë u përpoqën që ta likuidonin me çdo kusht Republikën tonë Popullore dhe ta shndërronin në një koloni të tyre.

Plani djallëzor i imperialistëve dhe i shërbëtorëve të tyre ka qenë i qartë. Ata, pasi dështuan në tentativat për një zbarkim që në kohën e luftës ose në prakun e çlirimit, me anën e reaksionit të brendshëm, mbeturi-

nave të fashizmit, të «Ballit» dhe të «Legalitetit», u përpoqën të krijonin turbullira të brendshme në vendin tonë, duke financuar dhe organizuar drejtpërdrejt me anën e misioneve të tyre zyrtare amerikane dhe angleze akte sabotazhi dhe terrori në Shqipëri. Njëkohësisht për të nxitur këto përgatitje të brendshme, imperialistët amerikano-anglezë i bënë një luftë të poshtër popullit tonë në lëmin ndërkombëtar, duke shpifur kundër Shqipërisë. Ky presion i madh ndërkombëtar dhe këto akte shantazhi dhe frikësimi ndaj vendit tonë nga ana e qeverive reaksionare amerikane dhe angleze synonin shkeljen e të drejtave të popullit tonë, kërkonin njëkohësisht të diskreditonin në sytë e gjithë botës regjimin tonë popullor, ta paraqitnin atë si «agresor» kundër Greqisë monarko-fashiste dhe të mbulonin provokacionet e panumërta dhe të vazhdueshme që na bënë fashistët e Athinës. Nga ana tjetër, po në këtë kohë imperialistët amerikanë dhe anglezë organizonin, në kundërshtim flagrant me marrëveshjet ndërkombëtare, kriminelët shqiptarë të luftës, që ishin strehuar në Itali dhe gjetkë dhe i ruanin për çastin më të përshtatshëm për t'i sjellë në fuqi dhe kështu të rivendosnin regjimet e vjetra të shtypjes dhe të skllavërimit. Këto ishin kartërat e hapura të imperialistëve amerikano-anglezë kundër popullit tonë. Por këta kishin në dorë dhe një kartë, që e mbanin të fshehtë dhe e vinin në përdorim në mënyrë të mbuluar për të mbështetur të gjithë këtë aktivitet kriminal të tyre. Kjo kartë e fshehtë ishte agjentura e klikës së Beogradit.

Grupi Tito-Ranković, agjunkturë e vjetër e imperializmit amerikano-anglez, depërtoi në Partinë Komuniste

Jugosllave, arriti me dinakëri e me demagogji në krye të partisë, likuidoi gjatë gjithë luftës komunistët e vendosur internacionalistë, vuri në gjumë vigjilencën revolucionare të partisë, shkeli të gjitha parimet e shëndosha marksiste-leniniste, mbi të cilat është ndërtuar një parti komuniste e vërtetë, solli në poste komanduese agjentë dhe spiunë të anglo-amerikanëve, zuri të gjitha kyçet komanduese dhe e transformoi kështu Partinë Komuniste Jugosllave në një agjunkturë të imperializmit. Duke e hedhur kështu partinë në dorë, agjuntura e imperializmit amerikano-anglez, klika e Tito-Rankoviçit ja rrëmbeu të gjitha fitoret nga duart klasës punëtore jugosllave dhe gjithë popullit punonjës të Jugosllavisë dhe e shndërroi këtë në një koloni të amerikanëve. Klika nacionaliste e Titos, nën maskën e miqësisë dhe të aleancës në mes të popullit tonë dhe të popujve të Jugosllavisë, përpiquej në mënyrë të fshehtë dhe sistematike ta merrte kalanë nga brenda. Të gjitha këto ishin variantet e të njëjtit plan të hartuar në Uashington dhe në Londër dhe të ekzekutuar në lëmin ndërkombëtar nga përfaqësuesit zyrtarë të qeverive amerikane dhe angleze, nga funksionarët e tyre të pushtimit në Itali dhe gjetkë, nga zyrtarët e tyre që ishin me misione diplomatike në Shqipëri, nga agjentët e imperializmit amerikano-anglez, fashistët e Athinës dhe trockistët e Beogradit.

Klika tradhëtare e Beogradit, nën maskën e traktatit të aleancës dhe të miqësisë, kërkonte të robëronte ekonomikisht Shqipërinë, t'i rrëmbente kësaj të gjitha pasuritë e mbitokës dhe të nëntokës, ta detyronte popullin tonë të punonte dhe të robëtohej për interesat e

shovinistëve të Beogradit. Për ta robëruar Shqipërinë si ekonomikisht, ashtu edhe politikisht, për ta bërë një republikë të shtatë të Jugosllavisë, renegatët e Beogradit, me anën e agjunkturës së tyre në Shqipëri, të kryesuar nga Koçi Xoxe me shokët e tij, tentuan t'i dërmnin themelet rendit tonë popullor, duke sulmuar, në radhë të parë, Partinë Komuniste të Shqipërisë, duke u përpjekur ta shndërronin këtë në një vegël të tyre të verbër; ata filluan të sabotojnë duke mbjellë pasiguri dhe konfuzion në ekonominë tonë, duke sabotuar rindërtimin e vendit dhe të ekonomisë, duke grabitur pasurinë dhe djersën e punonjësve tanë, duke mos mbajtur premtimet në bazë të traktateve dhe të marrëveshjeve dhe duke futur në të gjitha aparatet e shtetit tonë agjentë të regjur, trockistë jugosllavë, të cilët organizonin fuqimisht punën e tyre të sabotimit e të shkatërrimit, duke grumbulluar rreth vetes agjentët trockistë shqiptarë, borgjezë dhe kulakë.

Një sabotim i tillë, në shkallë të gjerë, nga ana e tradhëtarëve jugosllavë dhe agjentëve të tyre shqiptarë u shoqërua me një propagandë të egër dhe konkrete antisovjetike, propagandë që ushqej dhe zmadhoj në shumë sektorë të jetës së vendit tonë nga trockistët jugosllavë dhe veglat e tyre shqiptarë. Në këtë mënyrë, ata kërkonin të minonin miqësinë dhe dashurinë e madhe të popullit tonë me Bashkimin Sovjetik, i cili ndihmoi popullin tonë të çlirohej përgjithmonë nga skllavërimi fashist dhe feudalo-borgjez dhe të sigurate të ardhshmen e tij më të mirë dhe të lumtur. Trockistët e Beogradit duke u përpjekur ta izolonin popullin tonë nga Bashkimi Sovjetik dhe demokracitë e tjera po-

pullore, synonin ta gjunjëzonin kështu Republikën tonë Popullore dhe udhëheqjen e saj — Partinë Komuniste të Shqipërisë, ta likuidonin përgjithmonë regjimin e demokracisë popullore në Shqipëri dhe të realizonin kështu planin e imperializmit amerikano-anglez në këtë pjesë të Ballkanit.

I tillë ka qenë plani i imperialistëve amerikano-anglezë në këtë periudhë. Siç e shihni, rrezik shumë i madh ka kërcënuar fatet e popullit tonë të vogël, po heroik. Partisë sonë heroike dhe popullit tonë u është dashur të grumbullojnë të gjitha energjitë e tyre për t'u bërë ballë zjarreve që u drejtoheshin nga të katër anët prej armiqve të betuar të tyre, imperialistëve amerikano-anglezë dhe shërbëtorëve të tyre.

Ka njerëz në botë që bëjnë pyetjen: «Si mundi një popull i vogël, siç është populli shqiptar, i rrethuar nga të katër anët me të tillë ujqër fashistë, që ju vërsulën për ta copëtuar dhe për ta mbytur, të rezistojë heroikisht, të luftojë në të gjitha frontet dhe të triumfojë?» Përgjegjja është e thjeshtë: populli shqiptar rezistoi, luftoi, triumfoi dhe do të triumfojë kurdoherë mbi armiqët e tij të jashtëm dhe të brendshëm, pse atë e udhëheq Partia e tij e lavdishme, pse ka dhe miq të mëdhenj, Bashkimin Sovjetik dhe Stalinin e madh. Populli ynë i ka nxjerrë konkluzionet me kohë nga historia e hidhur shekullore e tij. Populli ynë rilindi, rron dhe do të rrojë, lufton dhe triumfon, pse atij ja ndriti rrugën Revolucionin i madh i Tetorit, pse ai u mëkëmb, rron, lufton dhe përparon në saje të triumfit të ideve të Marksit, Engelsit, Leninit e Stalinit, pse Republika jonë Popullore lindi në saje të Luftës nacional-çlirimtare, që bëri popu-

lli ynë i udhëhequr nga Partia dhe të fitoreve të shkëlqyera të popujve sovjetikë kundër bishave fashiste dhe të reaksionit ndërkombëtar; ajo rron, forcohet dhe lulëzon, pse rron në epokën staliniane. Nuk është aq e lehtë tani të shtypet dhe të robërohet një popull, qoftë edhe shumë i vogël siç është populli ynë, qoftë dhe i rrethuar me armiq të tërbuar siç ndodhet populli ynë.

Ndihmën e Bashkimit Sovjetik populli ynë e sheh konkretisht nga çdo anë dhe kjo i jep kurajë në përballimin e çdo rreziku që kërcënon atdheun tonë.

Politika e vendosur staliniane në lëmin ndërkombëtar demaskoi të gjitha orvatjet e imperialistëve kundër vendit tonë. Qëndrimi i drejtë i Bashkimit Sovjetik gjatë luftës i detyroi ministrat e jashtëm të Anglisë dhe të Shteteve të Bashkuara të deklarojnë zyrtarisht njënjën e të drejtave të Shqipërisë si vend i lirë, i pavarur, sovran dhe pjesëmarrës me aleatët në luftën kundër nazizmit. Këto deklarata me rëndësi të madhe ndërkombëtare për vendin tonë të bëra nga Molotov, Hulli dhe Ideni, nuk mund të shkelen lehtë. Bashkimi Sovjetik bëri që vendi ynë të merrte pjesë në Konferencën e Paqes dhe të njihet si pjesëmarrës në Traktatin e Paqes me Italinë. Bashkimi Sovjetik udhëhoqi me lavdi luftën për demaskimin e imperialistëve dhe të monarko-fashistëve, që u përpoqën të copëtonin Shqipërinë dhe bëri të dështojnë me turp të gjitha orvatjet e tyre. Ai mbrojti me këmbëngulje dhe me sukses interesat e popullit tonë në të gjitha mbledhjet ndërkombëtare dhe bëri të respektohen të drejtat e popullit tonë. Armiqtë e popullit shqiptar në arenën ndërkombëtare u mbuluan me turp dhe u diskredituan, kurse pozitat e Shqipërisë u

forcyan. Nuk është vështirë të kuptohet se sa e kaliti popullin tonë kjo mbrojtje e fuqishme e Bashkimit Sovjetik në lëmin ndërkombëtar dhe sa shumë e forcoi situatën tonë të brendshme. Populli ynë në momentet më të rënda që ka kaluar dhe që përmenda më lart e ka ndjerë veten shumë të fortë, shumë të sigurtë në fitoren e çështjes së tij të drejtë, pse ai ishte më afër se kurrë me Bashkimin Sovjetik.

Si rezultat i vigjilencës së Partisë dhe të popullit tonë u zbuluan të gjitha komplotet e reaksionit të brendshëm, të kurdisura dhe të drejtuara nga diplomatët amerikanë dhe anglezë që ishin në Tiranë. Armiqtë e popullit e paguan shtrenjtë tradhëtinë e tyre. U zmbarsën dhe dështuan me turp provokacionet e panumërta të monarko-fashistëve në kufirin tonë të Jugut, dështoi provokacioni i kanalit të Korfuzit. Partia e lavdishme Bolshevike e Lenin-Stalinit zbuloi tradhëtinë e poshtër të Titos me shokë, agjentë të imperializmit, armiq të popullit tonë, të cilët kërkonin të merinin kalanë nga brenda. Zbulimi i agjunkturës së fshehtë amerikane me qendër në Beograd ndihmoi demokracitë popullore të shpëtonin nga një katastrofë, ndihmoi Shqipërinë tonë të shpëtonte nga një robëri e rëndë. Kjo ndihmë, që i erdhi nga Bashkimi Sovjetik, i dha Partisë dhe popullit tonë një forcë jashtëzakonisht të madhe për të dërmuar planet e titistëve e të Koçi Xoxes me shokë. Populli shqiptar edhe në këtë periudhë shumë të rrezikshme fitoi kundër imperialistëve, monarko-fashistëve dhe titistëve. Partia jonë e çelniktë bëri që populli ynë t'i kapërcejë me sukses të gjitha rreziqet dhe të dalë shumë më i fortë për të përballuar kurdoherë kërcënimet e



reja të imperialistëve, të monarko-fashistëve, të titistëve, të fashistëve italianë të kriminelëve shqiptarë, dhe të ndërtojë me sukses bazat e socializmit.

Pas Kongresit I imperialistët dhe agjentët e tyre, monarko-fashistët grekë, neofashistët italianë dhe grupi i nacionalistëve të Beogradit, na kanë bërë provokacione nga më të ndryshmet, por ne u kemi bërë ballë atyre dhe kemi dalë kurrdoherë fitimtarë.

Grupi trockist i Titos është bërë një nga armët më të egra të imperialistëve amerikanë kundër rendit të socializmit, kundër demokracive popullore dhe kundër vetë popullit martir të Jugosllavisë. Beogradi është bërë çerdhe e agjunkturës amerikane, ku kurdisen plane të reja djallëzore kundër kampit të socializmit dhe të paqes. Grupi i Titos e ka shndërruar Jugosllavinë në një koloni të vërtetë amerikane, ku sundon ligji i imperializmit janki. Ekonomia jugosllave është në duart e monopoleve amerikane, të cilat me anë të agjentëve të tyre Tito-Rankoviç etj., ja kanë asgjësuar fitoret popullit jugosllav, të cilin e shfrytëzojnë barbarisht. Në fakt, nuk ekziston më Parti Komuniste Jugosllave, ajo po shndërrohet në një parti fashiste ku ligjin e bëjnë njerëzit e UDB-së. Jugosllavia është shndërruar në një vend burgjesh dhe kampesh për qëndrimi për patriotët dhe marksistët e vërtetë. Në Jugosllavi, ku në fuqi është diktatura e borgjezisë, sundon një terror i pashembullt. Është e kuptueshme, pra, për të madh e të vogël në Shqipëri dhe për të gjithë patriotët dhe liridashësit e vendit tonë e në radhë të parë për anëtarët e Partisë së Punës se çfarë çerdhe e rrezikshme është krijuar në Jugosllavinë titiste për vendin tonë dhe për gjithë kam-

pin e socializmit e të paqes. Pra, imperializmi amerikan dhe anglez i ka besuar bandës Tito-Rankoviç rolin kryesor për të dëmtuar Republikën tonë Popullore.

Kur maska e Titos u gris, banda e trockistëve të Beogradit filloi luftën e hapët kundër popullit tonë, por pa sukses. Ajo vuri në lëvizje agjentët e saj, që kishte rekrutuar në Shqipëri dhe me anën e përfaqësisë së saj diplomatike filloi të organizojë sabotazhe në lëmin ekonomik dhe të rindërtimit si në ndërtimin e hekurudhës Durrës-Tiranë e gjetkë. Njëpërmjet parullash dhe fletushkash të përgatitura në oficinën e Gjilasit në Beograd dhe të shpërndara nga Legata jugosllave në Tiranë, trockistët e Beogradit menduan t'u mbushnin mendjen disa trushkulture për «parajsën titiste», t'i tërhiqnin këta në tokën e tyre dhe që andej t'i detyronin, me grykën e kobures, të bëheshin spiunë dhe diversantë kundër atdheut dhe popullit të tyre.

Trockistët e Beogradit dhe agjentët e tyre u përpoqën të merrnin dhe muarën lidhje me disa banditë, që ndodheshin të arratisur në mal, me anën e të cilëve shpresonin të krijonin turbullira të brendshme, duke bërë disa atentate ose duke organizuar vjedhje në disa kooperativa të izoluara të malësive, veçanërisht duke tentuar të terrorizonin popullin. Por kësaj veprimtarie spiunazhi dhe diversioni të titistëve ju dha një grusht i rëndë nga Partia jonë, nga populli ynë, nga pushteti ynë popullor, nga rojet tona heroike të kufirit dhe nga Arma heroike e Sigurimit të Shtetit. Spiunët e Beogradit u kapën me presh në dorë. Forca e madhe e Partisë sonë e mobilizoi totalisht popullin kundër armiqve të betuar të tij. Propaganda e Gjilasit dhe e Rankoviçit

dështoi. Fletushkat e hedhura nga agjentët e Gjilasit u kalbën rrëzë ferrave të ndonjë pylli afër kufirit. Nga ata të paktë mendjelehtë, që u gënjyen në fillim dhe shkuan në «parajsën titiste», një pjesë u rikthyen në atdhe, ndërsa të tjerët lanë lëkurën në kufirin tonë ose disa vuajnë në burgjet e në kampet e përqëndrimit të Titos. Edhe kriminelët që ndodheshin në male e gjetën vendin. Të goditur rëndë dhe të ndjekur këmba-këmbës nga populli dhe nga forcat tona të mbrojtjes, të zhveshur dhe të uritur, ata u hodhën te aleati i tyre Tito, sepse në Shqipëri u digjte toka nën këmbë. Këto përpjekje të dëshpëruara të tradhëtarëve të Beogradit ishin pjesë e pandarë e një plani të kombinuar me monarko-fashistët grekë, me fashistët italianë dhe me kriminelët e luftës, që ndodheshin në Itali e gjetkë. Imperialistët amerikanë dhe anglezë u kishin diktuar gjithsecilit rolet e tyre për të dëmtuar Republikën tonë Popullore.

Në një kohë kur banda e Beogradit përpiquej të krijonte situata të vështira në vendin tonë, kur grumbullonte forca ushtarake në rajonin e Strugës dhe të Ohrit për të na frikësuar, monarko-fashistët filluan në shkallë të gjerë provokacionet e tyre në kufirin tonë të Jugut, me qëllim që të shpërthenin në tokën tonë dhe të krijonin incidente të rënda ndërkombëtare. Këtë qëllim kishin incidentet në stil të gjerë, që provokuan në muajin gusht të vitit të kaluar monarko-fashistët në kufirin e Korçës dhe të Devollit, ku ushtria jonë heroike u dha dërmën dhe mësimin e merituar agresorëve që cënonin tokën e shenjtë të atdheut. Këto provokime nga ana e monarko-fashistëve grekë, të mbështetura

fuqimisht nga klika tradhëtare e Titos, shoqëroheshin nga një propagandë shurdhuese dhe shpifëse kundër Shqipërisë në lidhje me ndihmën tonë partizanëve grekë në luftën e tyre heroike që bënin kundër barbarëve monarko-fashistë dhe imperialistëve amerikano-anglezë që kishin shkelur atdheun e tyre. Nga ana tjetër imperialistët amerikano-anglezë vunë në lëvizje në të njëjtën kohë tradhëtarët e popullit tonë, kriminelët e luftës, nga ishin e ku s'ishin dhe me bujë të madhe organizuan komitetin famëkeq «Shqipëria e lirë», të cilit, si thotë populli ynë, «katër vjet në Hundëkuq i vajti mundi mi huq». Edhe titistët krijuan komitetin e tyre në Kosovë, me agentin e vjetër të anglezëve Gani Kryezinë dhe me disa kriminelë të luftës të ardhur nga Greqia dhe të shpartalluar nga forcat tona të ndjekjes. Fashistët italianë s'qëndruan pas. Ata me anën e detit dhe të ajrit dërguan kriminelë luftime si diversantë dhe sabotatorë për të organizuar akte sabotazhi dhe çeta balliste, por edhe atyre, si thotë populli ynë «ja u zumë kokën me derë si miut në dhokan».

Shpejt populli shqiptar dhe opinioni ndërkombëtar do të informohet se ç'fat u rezervohet nga Arma heroike e Sigurimit të Shtetit tonë këtyre banditëve, që fashistët italianë, titistët, monarko-fashistët grekë dhe padronët e tyre tentojnë t'i hedhin në vendin tonë me anë parashutash e mjetesh të tjera. Do të shohin dhe do t'i vënë gishtin kokës edhe ata kriminelë shqiptarë që, të gënjyer nga disa dollarë o lireta italiane si dhe nga pallavrat e kriminelëve Hasan Dosti, Abaz Kupi etj., vënë kokën e tyre në torbë dhe vijnë në Shqipëri. Do të shohin se ç'fat u rezervon atyre populli shqiptar dhe

drejtësia e tij, do të shohin «sa bukur i pret populli shqiptar» posa bien me parashutë mbi tokë ose zbresin në buzë të detit tonë dhe, në rast se u shijon kjo pritje, le ta përsëritin edhe herë tjetër!

Si kurdoherë, edhe në këto çaste të vështira, që kaloi vendi ynë, populli ishte i ndërgjegjshëm për rrezikun që e kërcënonte atdheun e tij, por njëkohësisht ishte i patrembës dhe i palëkundur, pse udhëhiqej nga Partia e tij e çelniktë, e cila me politikën e saj të urtë dhe të vendosur e çoi në fitore dhe ua prishi planet edhe kësaj radhe imperialistëve dhe shërbëtorëve të tyre. Situata jonë e brendshme u forcua shumë e më shumë. Në këtë luftë të ashpër, që i bëjnë popullit tonë imperialistët dhe shërbëtorët e tyre, u kalit mbrojtja jonë, u kalit populli ynë dhe ai i shtërngoi shumë e më shumë radhët e tija rreth Partisë dhe qeverisë së tij, rreth pushtetit të tij popullor.

Armiqtë e jashtëm dhe të brendshëm u çorën duke bërëtitur se «Shqipëria mbaroi», se «ajo është e izoluar», se «populli ynë do të vdesë urie», se «Bashkimi Sovjetik është larg dhe nuk e ndihmon dot Shqipërinë», se «titistët ja kanë prerë rrugën me demokracitë popullore, që mund të ndihmojnë Shqipërinë», se «Shqipëria mbeti si peshku pa ujë» e të tjera dokrra e pallavra të vlefshme për njerëzit, që ngopen me lugë të zbrazët dhe që kërkojnë të shohin ëndrra me sy hapët.

Si kurdoherë, Bashkimi Sovjetik ishte më afër se kurrë popullit tonë e në çdo moment dhe me të gjitha forcat e tija e ndihmoi të kapërcente të gjitha këto vështirësi, të brendshme dhe të jashtme. Në lëmin ndërkombëtar Bashkimi Sovjetik u dhë një dackë të re

imperialistëve dhe shërbëtorëve të tyre monarko-fashistë dhe titistë, që u përpoqën të bënëin fajtoreshë Shqipërinë për aktet e tyre kriminale kundër popullit vëllë dhe heroik grek dhe të krijonin shkaqe për ta dëmtuar vendin dhe popullin tonë. Shqipëria, nuk mund të invadohet, si në 7 prill të vitit 1939; vdiqën ato kohëra dhe s'kthehen më. Shqipëria ka zot, është populli që ka tani fuqinë në duart e veta dhe ky popull trim udhëhiqet nga Partia e tij e Punës, besnike e marksizëm-leninizmit. Shqipëria nuk mund të invadohet lehtë as nga imperialistët amerikano-anglezë dhe as nga shërbëtorët e tyre, ashtu siç ëndërrojnë mbeturinat e reaksionit të brendshëm, pse populli shqiptar mbrohet fuqimisht nga Bashkimi i madh Sovjetik, nga demokracitë popullore motra, nga i gjithë kampi i paqes, nga vetë njerëzit përparimtarë të Shteteve të Bashkuara dhe të Anglisë, pse kurrë popujt vëllëzër të Jugosllavisë, të Greqisë dhe të Italisë nuk do të lejojnë xhelatët e tyre të sulmojnë popullin shqiptar.

Por sukseset që ne kemi korrur në forcimin e situatës sonë të brendshme nuk duhet të na dehin aspak, të mos flemë në dafina dhe të harrojmë rrezikun që vazhdimisht e kërcënon vendin tonë, paqen e njerëzimin. Populli ynë thotë një fjalë, që s'duhet ta harrojmë kurrë: «uji fle, hasmi s'fle». Armiku i popullit nuk fle, prandaj aq më fort populli duhet të vigjëlojë, të shtërngojë radhët dhe të godasë pa mëshirë të gjithë armiqtë e tij kudo që të shfaqen dhe nën çdo maskë që do të tentojnë të fshihen. Fitoret e Partisë dhe të popullit tonë, duhet t'i nxitin komunistët dhe gjithë masat e gjera të popullit për një vigjilencë më të fortë dhe të gjith-

anshme, për një punë më të organizuar dhe me rendiment më të lartë në të gjitha fushat e aktivitetit.

Në asnjë çast të mos mendojmë se imperialistët amerikano-anglezë i kanë hedhur armët. Përkundrazi, ata do t'i shtojnë edhe ca më tepër përpjekjet e tyre kundër vendit tonë, duke kujtuar se Republika Popullore e Shqipërisë është një pikë e dobët e kampit të socializmit. Ata gabohen në hesapet e tyre dhe megjithëse kanë pasur prova bindëse për këtë gjë, prapëseprapë do të vazhdojnë punën e tyre të ndyrë derisa të shfarosen. Imperializmi do të mbështetet fuqimisht dhe do ta zhvillojë punën armiqësore kundër nesh në radhë të parë, me anën e agjentëve të tij të Beogradit, të monarko-fashistëve grekë si dhe të fashistëve italianë. Me anë të këtyre tri foleve të tija, imperializmi do të përpiqet të pregatitë kriminelët e luftës dhe diversantët për t'i hedhur në vendin tonë me qëllim që të kryejnë akte sabotazhi dhe diversioni, të kryejnë atentate dhe të krijojnë turbullira brenda për të dobësuar rendin tonë popullor dhe për të ndryshuar kështu situatën në favorin e tyre dhe të armiqve të popullit. Sabotatorët dhe diversionistët do të tentojnë të rigrumbullojnë mbeturinat e reaksionit të brendshëm për t'i vënë këto në lëvizje kundër ndërtimit të bazave të socializmit në vendin tonë. Kjo është e vetmja rrugë dhe i vetmi fishek që u ka mbetur imperializmit, titistëve, monarko-fashistëve grekë dhe fashistëve italianë. Të gjithë këta ujqër shpresojnë në reaksionin e brendshëm për të bërë diçka, kurse reaksionarët e zgjebosur të vendit tonë shpëtimin e presin të vijë nga jashtë!

Në këto drejtime do të aktivizohet më shumë armi-

ku i jashtëm dhe i brendshëm për të dëmtuar punën ndërtimtare dhe paqësore të vendit tonë, prandaj Partia dhe populli ynë duhet t'i mprehë armët dhe të godasë pa mëshirë të gjithë ata që do të tentojnë të çënojnë interesat e popullit dhe të atdheut tonë. Përpara Partisë sonë shtrohen, pra, detyra të rënda dhe të domosdoshme, që të forcojë punën e saj politike dhe organizative dhe të vëjë të gjitha forcat dhe përvojën e saj për të konsoliduar dhe forcuar shumë e më shumë situatën e brendshme. Dhe situata e brendshme do të forcohet dita-ditës, kur të përmbushen si duhet detyrat e mëposhtme:

Të forcohet gjendja ekonomike e vendit tonë, që do të thotë të realizohet me sukses dhe të tejkalohet plani ekonomik i shtetit.

Të forcohet pushteti ynë popullor, duke zgjedhur në organet e tij njerëz besnikë të popullit, njerëz të zot dhe të ndershëm që t'i kushtojnë detyrës që u ngarkon populli, kohën më të madhe dhe jetën e tyre. Njerëzit e pushtetit të jenë besnikë dhe vigjilentë për pasurinë e popullit, t'i shërbejnë popullit me vetëmohim, të hedhin tej dhe të luftojnë burokratizmin dhe të gjitha veset e këqia. Kontrolli i masave mbi njerëzit e pushtetit të jetë i vazhdueshëm, pse ai është shpëtimtar.

Të forcohen me njerëz besnikë, trima e bij të thjeshtë të popullit, ushtria e popullit, Arma e Sigurimit të Shtetit, e policisë, forcat e kufirit, të cilat, të bëhen tmerri i armikut të jashtëm dhe të brendshëm dhe armë të dashura për popullin, pse këto armë janë dhe do të jenë vazhdimisht në luftë të paprerë, të ashpër e heroike me armiqtë e fshehtë, me sabotatorët, me diversantët.



Roli dhe kujdesi i Partisë për forcimin e gjithanshëm të këtyre armëve duhet të jetë i vazhdueshëm dhe i madh. Këto të jenë kurdoherë të gatshme dhe vigjilente për ta diktuar armikun me kohë, për ta goditur pa mëshirë dhe për ta asgjësuar atë.

Gjithë anëtarët e Partisë dhe masat e popullit punonjës të edukohen dhe t'u jepet gjithë mundësia të kuptojnë qëllimet, detyrat dhe mënyrat e punës së sabotazhit e të diversionit që bëjnë agjentët e spiunazhit të huaj dhe të brendshëm, me qëllim që të jenë të armatosur për t'i njohur dhe goditur këta rëndë e me kohë.

Të bëhen përpjekje të mëdha nga ana e Partisë dhe e masave të popullit për të përhapur në shkallë të gjerë arësimin e kulturën, të ngrihet niveli politik e ideologjik i masave të gjera të popullit dhe të zhduket prapambetja dhe errësira, të zhduket analfabetizmi.

Të demaskohen gjerësisht dhe rrënjësisht titizmi dhe agjentët titistë nën çdo petk që ata do të përpiqen të fshihen. Të kuptojë qartë edhe njeriu më i fundit në vendin tonë se tradhëtarët e Beogradit janë veglat dhe shërbëtorët më të bindur të imperialistëve, armiqtë e betuar të vendit tonë, që kërkojnë t'i rrëmbejnë popullit tonë fitoret e arritura me gjak e sakrifica, që kërkojnë t'i rrëmbejnë punëtorit djersën e ballit dhe t'i hedhin zinxhirët e robërisë, që kërkojnë të sjellin në fuqi bejlerët dhe kulakët për t'i rrëmbyer fshatarit tokën dhe gjithë pasurinë e tij dhe për ta skllavëruar atë si në kohët e kaluara. Populli duhet ta kuptojë mirë se nacionalistët e Beogradit, për të realizuar qëllimet e tyre armiqësore kundër vendit tonë, do të tentojnë të

rekrutojnë të gjithë armiqtë e brendshëm, spiunët, bejlerët, agallarët, kulakët. Këta njerëz ne do t'i hasim në rrugën tonë ndërtimore duke sabotuar, duke ngadalësuar punën, duke prishur. Prandaj, të mos hezitojmë asnjë çast për t'i goditur pa mëshirë. Partia dhe populli ynë kanë një eksperiencë të madhe në këtë drejtim. Ashtu si fashizmi italian dhe ai gjerman grumbulluan rreth vetes, për të zbatuar veprën e tyre gjakatare, të gjithë klasën pasanike të bejlerëve, feudalët dhe njerëzit me njëqind flamurë në xhep, që s'kishin as nder as atdhe, po kështu dhe imperializmi me anën e grupit të Titos, me anën e monarko-fashistëve grekë dhe neo-fashistëve italianë, do të tentojë të grumbullojë rreth vetes të gjitha fundërinat, që kanë mbetur në vendin tonë, t'i mobilizojë dhe t'i aktivizojë këto kundër planit tonë ekonomik dhe kundër mbrojtjes së vendit. Lufta e klasave të ashpërsohet çdo ditë e më tepër, pse vetëm kështu do të shfarosen diversantët, do të demaskohen dhe do të goditen elementët armiq dhe sabotatorë, kështu do të forcohet uniteti i popullit tonë, do të forcohet patriotizmi i masave, do të forcohet e do të çelënikoset situata e brendshme dhe do të dështojnë me siguri të gjitha planet e armiqve të popullit tonë.

Të ruajmë organizatat tona dhe institucionet shtetërore nga sabotimet dhe diversionet e elementit armik dhe trockist, që ndodhet ose që përpiqet të futet jo vetëm brenda në organizatat bazë dhe në institucionet e ulëta, por edhe në vendet më përgjegjësi. Në vendin tonë janë bërë një sërë gjyqesh kundër elementit armik dhe sabotator, kundër diversantëve dhe kundër trockistëve agjentë të Beogradit. Me anë të këtyre gjyqeve

shokët e Partisë dhe gjithë punonjësit e vendit tonë janë vënë në korrent mbi qëllimet dhe mënyrat që kanë përdorur dhe ku donin të arrinin këta armiq të popullit. Këto gjyqe kundër këtyre kriminelëve duhet t'u kenë shërbyer dhe u kanë shërbyer njerëzve tanë për të genë kurdoherë vigjilentë për të mbrojtur vendin tonë. Por kjo vigjilencë nuk është kurrë e mjaftueshme. Duhet që të gjithë dhe në radhë të parë shokët e Partisë, që udhëheqin masat punonjëse dhe fatet e vendit, të mos e nënvleftësojnë për asnjë çast armikun e jashtëm dhe atë të brendshëm, të mos nënvleftësojnë bashkërendimin e punëve midis tyre, pse armiku që harrohet, na mëson shoku Stalin, është ai më i rrezikshmi. Dhe një harresë e tillë e ka burimin të dehja nga sukseset në luftën kundër armiqve dhe të pikëpamja e gabuar se ata i kemi shfarosur dhe likuiduar. Një pikëpamje e tillë sjell me vete rreziqe të mëdha për pavarësinë e vendit dhe ekonominë tonë popullore, ngjall krenarinë e dëmshme dhe të rrezikshme në njerëzit që ju pëlqen mendja, shkakton pakujdesi në punë, ndjell zemërbutësi, shpirtgjerësi përpara të metave, gabimeve, akteve armiqësore, sjell naivitetin dhe lehtëson armikun të përfitojë nga të gjitha këto dobësi për të forcuar punën e tij shkatërrimtare.

Me gjithë të metat dhe lëshimet tona në punë, ne mund të themi se situata jonë e brendshme është përmirësuar shumë si politikisht ashtu dhe ekonomikisht; është forcuar edhe fuqia mbrojtëse e vendit tonë. Por kjo gjë nuk duhet të na bëjë të biem në rreziqet që përmenda më lart, përkundrazi të na nxitë që të forcojmë më shumë punën tonë politike dhe organizative, të

forcojmë unitetin e popullit tonë. Përpara nesh kemi fushatën e zgjedhjeve për Kuvendin Popullor. Kjo është një fushatë e madhe patriotike për të gjithë popullin, prandaj kërkohet një mobilizim total i të gjithë punonjësve për të realizuar detyrat që kanë ndaj atdheut dhe popullit. Njerëzit e Partisë dhe ata pa parti, të bashkuar si një trup i vetëm në Frontin Demokratik dhe nën udhëheqjen e Partisë, gjatë gjithë fushatës së zgjedhjeve t'ja bëjnë çdo gjë të qartë popullit, që ai të shohë mirë ku janë miqtë dhe armiqtë e tij, të kuptojë rrënjësisht rrugën e lavdishme të socializmit ku e udhëheq Partia jonë, kështu që ai të mobilizohet totalisht në këtë rrugë, që është rruga e shpëtimit të tij përgjithmonë nga varfëria, nga prapambetja dhe injoranca, nga vuajtjet dhe sëmundjet.

Të shërbejë kjo fushatë e madhe e zgjedhjeve për Kuvendin Popullor që të vijë në këtë organ të lartë të Republikës sonë Popullore njerëzit më të mirë të popullit, besnikë e patriotë, që kanë dhënë prova në luftë dhe në punë, të vijë punëtorët, fshatarët e varfër, anëtarë të kooperativave bujqësore, intelektualë patriotë që i shërbejnë popullit me vetëmohim, që u dhimbset populli dhe që janë gati në çdo çast të bëjnë fli dhe jetën e tyre për popullin, për Partinë, për atdheun! Nga rezultatet e mira të zgjedhjeve do të duket uniteti i shkëlqyeshëm i popullit tonë, që s'ka forcë ta thyejë dhe ta dëmtojë, që s'ka forcë ta pengojë në rrugën e tij të socializmit.

Le të bëhet fushata e zgjedhjeve një manifestim i përgjithshëm i forcave të pashterura të popullit tonë, i besnikërisë së pakufishme ndaj udhëheqjes së saj —

Partisë së Punës, një manifestim i ndjenjave të dashurisë ndaj Bashkimit Sovjetik dhe Stalinit të madh, ndaj demokracive popullore motra, ndaj kampit dhe kauzës së paqes së mbarë njerëzimit!

## II

### MBI DISA PROBLEME EKONOMIKE NË VENDIN TONË

Kanë kaluar gati 17 muaj që prej Kongresit I të Partisë dhe problemet ekonomike kanë qenë në qendër të vëmendjes së Partisë sonë të Punës, të Qeverisë së Republikës Popullore dhe të gjithë masave punonjëse të vendit tonë. Kongresi I i përcaktoi Partisë sonë vijën ekonomike, që duhet të zbatojë ajo për ndërtimin e bazave të socializmit në vendin tonë dhe kjo vijë ekonomike, që është e pandarë nga vija politike e organizative e Partisë sonë, bëri që gjatë gjithë kësaj periudhe Partia të korrë suksese të rëndësishme në këtë sektor me rëndësi. Partia ka qenë vazhdimisht e preokupuar me këtë problem të madh dhe kurdoherë ajo ka qenë në krye të detyrës së rëndë dhe të shenjtë për të ndër-tuar një jetë më të mirë dhe më të begatshme për popullin tonë.

Në saje të udhëheqjes së drejtë dhe të guximshme të Partisë, në saje të mobilizimit të klasës sonë punëtore, të rinisë, të fshatarësisë, të grave, në saje të dashurisë, të besimit dhe të besnikërisë që masat e gjera të punonjësve ushqejnë dita-ditës më shumë për Partinë he-

roike të tyre, ne kapërcyem të gjitha vështirësitë, korrëm suksese në lëmin ekonomik, kultural dhe social, forcuam shumë situatën e brendshme të vendit dhe ngritëm në një shkallë më të lartë mirëqenjen e popullit tonë, mirëqenjen që dita-ditës po përmirësohet dhe bën përparime të mëdha.

Tradhëtarët e Beogradit, këta hajdutë me çizme të imperializmit, na shkaktuan dëme kolosale në ekonominë tonë, për riparimin e të cilave na u desh të shpenzonim dhe të punonim shumë. Por hovi revolucionar i Partisë dhe i popullit tonë bëri që t'i kapërcejmë të gjitha pengesat. Në këtë gjendje të vështirë, ku na kishin futur trockistët e Beogradit dhe agjentët e tyre shqiptarë, ndihma e Bashkimit Sovjetik ka qenë e madhe dhe e çmueshme. Si rrjedhim i kësaj ndihme bujare, të shpejtë, vëllazërore, ekonomia jonë njohu një hov të madh në të gjithë sektorët. Me kreditë e njëpasnjëshme dhe pa interes që na akordoi Bashkimi Sovjetik ne mundëm të hedhim hapa të mëdhenj dhe të sigurtë përpara në ndërtimin e bazave të socializmit, të furnizojmë popullin me sendet e nevojës së parë, të ndërtojmë kombinatë, fabrika, të zgjerojmë aktivitetin e industrisë dhe të minierave tona, të bëjmë që bujqësia jonë të shkojë në rrugën e përparimit e të mekanizimit. Përparimet e mëdha dhe përmirësimin e jetës së popullit tonë ne ja detyrojmë edhe ndihmës së çmueshme të Bashkimit Sovjetik dhe Stalinit të madh, që kurdoherë ushqejnë për popullin tonë të vogël, heroik dhe paqedashës ndjenjat më të mira dhe më të kulluara. Demokracitë popullore motra ju përgjegjën me bujari kërkesave të Partisë sonë dhe të qeverisë dhe na ndihmuan dhe na

ndihmojnë që vendi ynë të përparojë, që populli ynë të ecë përpara në rrugën e socializmit. Imperialistët, titistët dhe të gjithë bashkëpunëtorët e tyre kujtuan se vendi ynë i vogël do të gjunjëzohej përpara diktatit të tyre të poshtër, por kjo nuk do të ngjiste kurrë dhe në vendin tonë u vërtetua e kundërta e dëshirave të tyre.

Populli ynë nën udhëheqjen e Partisë diti të organizonte punën e tij më së miri, të përfitonte si duhet nga ndihmat e Bashkimit Sovjetik dhe të demokracive popullore dhe të korrte suksese të reja që ju shtuan sukseseve të shumta që ai kishte arritur.

Përpara detyrave të mëdha, që i shtronte Partisë dhe gjithë punonjësve të vendit tonë plani dyvjeçar i shtetit, komunistët, në krye të klasës punëtore dhe të masave punonjëse të vendit, kanë vënë të gjitha energjitë dhe zotësitë e tyre, për t'ja dalë me sukses kësaj pune të madhe. Ata i ka karakterizuar vazhdimisht mobilizimi, hovi dhe përpjekja shembullore, pse ata i frymëzon dashuria e madhe për Partinë e tyre, për popullin e tyre, për Bashkimin Sovjetik dhe Stalinin e madh, i frymëzon ndjenja e internacionalizmit proletar dhe lufta për mbrojtjen e paqes. Kjo i ka bërë anëtarët e Partisë sonë të çelniktë, të pamposhtur përpara vështirësive dhe pengesave dhe ata kanë dalë gjithmonë fitimtarë. Prandaj populli ka çelnikosur dashurinë dhe besnikërinë e tij ndaj Partisë dhe ndaj komunistëve, të cilët i do, i ruan dhe i nderon si njerëzit e tij më të mirë.

Në kryerjen e detyrave tona në lëmin ekonomik, ne kemi pasur suksese, por kemi pasur edhe gabime e lëshime, të cilat duhet t'i ndreqim dhe këtë do ta bëjmë,

duke analizuar situatën ekonomike, duke njohur gabimet tona, ashtu siç bëjnë bolshevikët, pse kështu do të marrim çdo kala, ashtu si i marrin bolshevikët.

### INDUSTRIA DHE MINIERAT

Si u realizua plani i vitit 1949 në industri dhe miniera dhe masat që duhet të marrim për realizimin dhe tejkalimin e planit në këtë sektor për vitin 1950.

Pa asnjë dyshim sektori i industrisë dhe i minierave është sektori më i rëndësishëm dhe këtu duhet një mobilizim total i Partisë dhe i gjithë punonjësve. Planin në këtë sektor nuk është realizuar në mënyrë të kënaqshme, sidomos në industrinë vajgurore dhe veçanërisht në Kantierin vajgurator të Patosit. Për vitin 1949 nafta brut në Kantierin e Kuçovës është realizuar 91,2 për qind dhe në Patos vetëm — 61,7 për qind. Siç e shihni, në Kuçovë realizimi është i kënaqshëm, kurse në Patos ka bërë që realizimi i planit në fushat tona vajgurore të zbresë në 74,7 për qind për naftën brut. Përsa u përket nënprodukteve të naftës, plani i prodhimit të tyre është realizuar 83,7 për qind, kurse i bitumit fluksat, për mungesë fuçias prej llamarine — 35,6 për qind.

Në industrinë minerale rezultatet kanë qenë mjaft të kënaqshme, sidomos në krom, ku plani është realizuar 102 për qind dhe është punuar me një fuqi punëtore më të vogël nga ajo e planifikuar. Ky realizim do të thotë 286,9 për qind në krahasim me 1948-n. Gjithashtu në bitumin e Selenicës plani është realizuar dhe tejkaluar në mënyrë të kënaqshme 117,4 për qind, që do të



thotë 122 për qind më shumë në krahasim me 1948-n dhe 174 për qind në krahasim me 1938-n. Përsa i përket gymyrgurit dhe bakrit blister plani nuk është realizuar plotësisht ngaqë ka pasur mungesë transporti dhe tullash manjziti në radhë të parë.

Është e domosdoshme të analizojmë shkaqet, që kanë shpurrë në mosrealizimin e planit në disa degë të industrisë dhe të minierave dhe masat urgjente e radikale që duhet të marrim me qëllim që të realizohet pjesa e dytë e planit dyvjeçar, që është plani i vitit 1950.

Sikur të analizonim realizimin e planit në këta sektorë pas vendimeve të përbaškëta që u muarën nga Komiteti Qendror dhe qeveria, ne do të shihnim se në të gjithë sektorët e industrisë dhe të minierave, me përjashtim të prodhimeve vajgurore, grafiku i realizimit shkoi duke u ngjitur. Vetëm prodhimi i naftës qëndroi në vend. Kjo tregon se në kantieret e vajgurit jo vetëm mobilizimi nuk ishte i plotë, por puna e armiqve sabotatorë ishte e madhe. Kjo ndodhi veçanërisht në Patos, i cili kishte pjesën më të rëndësishme të planit. Trockistët jugosllavë na goditën rëndë në industrinë tonë të naftës dhe njëkohësisht përdorën të gjitha metodat për të sabotuar edhe shpimin, për të na konsumuar para kohe edhe centralet elektrike e materialin tjetër, që dispononim në këto fusha. Pasojat e këtij sabotimi, sidomos në Patos, ne i ndejmë edhe sot. Por këtij sabotimi sistematik të trockistëve jugosllavë ju shtuan edhe dëmet e reja, të shkaktuara nga grupi anti-parti i Abedin Shehut, veçanërisht nga ky vetë, nga Shyqri Këllezi, që zinte postin e drejtorit të Kombinatit të naftës, si dhe nga ish-drejtori i Patosit, N. M. e një

sërë elementësh të tjerë si dhe teknikë e administratorë armiq, që punonin atje dhe që kishin besimin dhe mbështetjen e drejtuesve në fjalë. Fakti është se Ministria e Industrisë në hartimin e planit të naftës dhe veçanërisht për planin e Patosit u mbështet në të dhënat që kishim, të cilat nuk mund të themi se ishin plotësisht të sigurta, meqenëse na mungonte dhe na mungon një studim i plotë gjeologjik i rezervave të sigurta në këto fusha e sidomos në atë të Patosit. Por në asnjë mënyrë kjo nuk mund të shpjegojë rënjen e prodhimit në një shkallë të tillë. Ministria e Industrisë nuk ka qenë në krye të detyrës dhe ca më keq Kombinati i naftës. Shyqri Këllezi dhe Abedin Shehu me shokë, për të mbuluar punën e tyre antiparti dhe armiqësore, u përpoqën të arësyetonin rënjen e prodhimit të naftës me mungesë materialit apo teknikësh. Është e vërtetë se ne nuk kemi shumë teknikë të kualifikuar në këtë sektor, por ne kishim forcën e madhe të Partisë, të punëtorëve tanë dhe eksperiencën sovjetike, të cilat do të sillnin realizimin me sukses të planit. Përsa i përket materialit të nevojshëm, ne mund të themi se ai ekzistonte, ndonëse jomodern dhe i plotë; ai ndodhej në vend dhe një pjesë e konsiderueshme e tij erdhi edhe nga Bashkimi Sovjetik. Kur u thirr përpara Plenumit të Komitetit Qendror para gjashtë muajsh, Shyqri Këllezi pohoi se mosrealizimi i planit nuk ishte shkaktuar për mungesa objektive, por 95 për qind për mungesa subjektive dhe premtoi se plani do të realizohej. Këto ishin gënjeshtër, pse ai punoi për të mos e realizuar planin, për ta sabotuar atë. Abedin Shehu, Shyqri Këllezi dhe shokët e tyre jo vetëm e nënvleftësuan rolin

udhëheqës të Partisë në prodhim dhe në drejtimin e të gjithë punës në Kuçovë e në Patos, por me masat arbitrare që merrnin ndaj kuadrit, ndaj metodave socialiste në punë, ndaj punëtorëve, bënë që hovi në këto kantiere të binte, të deformoheshin udhëzimet e dhëna për një organizim më të mirë të punës. Shyqri Këllezi dhe Abedin Shehu me shokë, të mbështetur në disa teknikë armiq të maskuar, bënë të tyren parullën se «plani për naftën është i perealizueshëm» dhe e ulën tri herë këtë plan dhe, sikur të mos ishin marrë masat përkatëse, ky plan do të binte edhe më tepër. Këta elementë ishin mbjellës të disfatizmit. Një çorientim i tillë dhe një mungesë kontrolli ka shkaktuar që të vërtetohen edhe gabime të tjera në punën e nxjerrjes së naftës, të cilat duhet t'i kenë parasysh të gjithë punonjësit. Në Patos e në Kuçovë nuk është bërë shfrytëzimi i mundshëm dhe racional i materialit që ekziston. Kur tubat e shpimit janë në kantier, ato kërkohen të vijnë e kështu dhe për një sërë materialesh të tjera. Oficinat e kantierit nuk kanë punuar në rregull, nuk janë shqyrtuar normat dhe ka pasur anarki në këtë drejtim. Nuk janë shfrytëzuar si duhet e në mundësinë e duhur puset dhe koeficienti i tyre i shfrytëzimit nuk është arritur në masën e duhur. Pastrimi i tyre nuk është bërë në rregull dhe traktorët ekzistues nuk janë mbajtur mirë e nuk janë shfrytëzuar si duhet. Nuk është studjuar vazhdimisht dhe në rregull regjimi i puseve.

Në mosrealizimin e planit të nxjerrjes së naftës duhet të gjithë të njohin në mënyrë bolshevike gabimet e tyre. Puna armiqësore e Abedin Shehut dhe e Shyqri Këllezit, të mbështetur nga një sërë elementësh armiq

që punonin në ato kantiere, ka qenë e madhe, por nuk duhet që, nën këtë, të fshehim dhe gabimet e të tjerëve e në radhë të parë një mungesë kontrolli rigoroz dhe të vazhdueshëm nga ana e qeverisë dhe veçanërisht nga Komisioni i Planit të Shtetit. Komisioni i Planit duhet të studjojë më mirë nevojat e fushave vajguore dhe të ndjekë si duhet realizimin e planit. Nga ana tjetër të ndjekë njëkohësisht realizimin e planit në sektorët e tjerë, që kondicionojnë realizimin e planit të nxjerrjes së naftës dhe t'i sinjalizojë me kohë qeverisë masat urgjente dhe të domosdoshme që duhet të marrë.

Një përgjegjësi të madhe ka gjithashtu edhe udhëheqja e organizatës së Partisë në kombinat për mungesën e vigjilencës revolucionare dhe për një punë të pamjaftueshme në çështjen e organizimit, në çështjet politike dhe kulturele, në organizimin e shëndoshë të bashkimeve profesionale dhe të punës me norma e me gara. Këto nuk kanë qenë në lartësinë e duhur. Organizata e Partisë duhet të jetë në krye dhe në udhëheqje dhe të marrë masa rigoroze, kur vëren se ngjasin çrregullime dhe padrejtësi, ashtu si kanë ngjarë në këto kantiere. Faktet tregojnë se me spastrimin e elementëve armiq, që pengonin dhe sabotonin punën në këto kantiere, nxjerrja e naftës ka filluar të rritet, hovi në punë i punëtorëve të Patosit dhe të Kuçovës është shtuar, kanë filluar të përmirësohen puna politike dhe kushtet materiale të punëtorëve.

Përsa i përket industrisë së lehtë, ne kemi pasur një realizim të kënaqshëm në prodhim si në makarona, në tekstile, në punimin e lëkurëve, në industrinë e cigareve, ku është tejkaluar plani si dhe në prodhimin

e çimentos, në energji elektrike dhe në prodhime të fonderisë në uzina. Këtu duhet të vëmë në dukje punën e mirë të fabrikës së tisazhit në Shkodër, e cila e ka realizuar planin e 1949-s në 106 për qind dhe atë të tremujorit të parë të 1950-s në — 105,51 për qind. Emulacioni në këtë fabrikë, ku punojnë më shumë gra, ka qenë shumë i mirë e shembullor. Punëtorët atje punojnë me norma e gara dhe dallohen për kujdesin e veçantë që kanë në mirëmbajtjen dhe përdorimin e maqinerisë. Komunistët këtu janë shembull dhe gëzojnë besimin e dashurinë e gjithë kolektivit punonjës.

Kantieri i Selçnicës planin e vitit 1949 e ka realizuar gjithashtu 117,4 për qind dhe atë të tremujorit të parë të 1950-s në — 103,44 për qind. Edhe këtu emulacioni socialist është organizuar mirë. Komunistët, punëtorët punojnë me entuziazëm, me ndërgjegje e me vrull dhe drejtoria e ndërmarrjes bashkëpunon ngushtësisht me organizatën bazë të Partisë dhe me komitetin profesional.

NISH Çimento në Shkodër planin e vitit 1949 e ka realizuar 91,1 për qind dhe këtë jo për fajin e saj, por për mungesë të thasëve, përndryshe ajo do ta kishte tejkaluar. Fabrika e çimentos ka realizuar planin e tremujorit të parë të këtij viti 120 për qind. Kjo fabrikë dallohet për organizim të mirë të punës, për përdorimin racional të fuqisë punëtore dhe për shfrytëzimin e mirë të maqinerisë. Punëtorët dhe drejtuesit e kësaj fabrike, që punojnë me ndërgjegje dhe me vrull, kanë mundur të revizionojnë maqinerinë para afatit të caktuar e në një kohë të shkurtër dhe kanë shfrytëzuar më së miri rezervat e brendshme.

Në industrinë e vajit plani nuk është realizuar veçse në masën prej 20 për qind dhe kjo për arsye se parashikohej që pas një sezoni të keq të kishim një prodhim të mirë ulliri në vitin 1949. Kjo nuk ngjau dhe ky artikull ka influencuar që të ulet 4,3 për qind realizimi i planit të industrisë së lehtë e veçanërisht të mos realizohet plani i prodhimit të sapunit.

Industria e sharrave nuk ka mundur dot të realizojë planin e saj dhe kjo për arsye të mungesës së fuqisë punëtore dhe të mospërdorimit të mirë të maqinerisë. Përsa i përket industrisë lokale dhe artizanatit, me gjithë të metat që kanë pasur, përsëri kanë dhënë prodhime dhe kanë ndihmuar sektorin e industrisë. Në artizanat ka pasur një luftë të vazhdueshme për realizimin e planit, për forcimin e organizimit dhe të disiplinës në punë. Në kooperativat e artizanatit duhet të bëhen përpjekje për përdorimin e mbeturinave të industrisë dhe të materialeve të vjetra e të luftohet prirja e gabuar që të prodhojmë vetëm me material të ri, të siguruar nga importi.

Në tremujorin e parë të vitit 1950 në tërë industrinë tonë u tejkalua plani në të gjithë sektorët, me përjashitim të nxjerrjes së naftës, që ka ardhur duke u shtuar dhe plani i caktuar për këtë vit do të realizohet dhe do të tejkalohej me siguri. Vetëm se deficitin e vitit të kaluar nuk mund të rekuperohet. Ka mundësi të rekuperohet deficitin e bitumit fluksat, për të cilin kemi siguruar tani llamarinën dhe një metodë të re sovjetike që na lejon të transformojmë edhe rezervat e mëdha të mazutit në bitum.

Plani i 1950-s është bërë duke u mbështetur në

eksperiencën e vitit 1949, janë ndrequr sa ka qenë e mundur gabimet që kanë ekzistuar në kohën e planifikimit, gjë që ka sjellë edhe një ulje të prodhimit të vitit 1950, si për shembull në naftën e Patosit. Mosrealizimi i plotë i planit të vitit 1949 sigurisht ka ndikuar edhe ky në uljen e planit të vitit 1950, pse mjaft investime dhe importime që do të bëheshin sivjet, vareshin nga realizimi i eksportimeve tona në 1949. Këtej del qartë se me aprovimin e planit të 1950-s plani dyvjeçar, si tërësi, është ulur ca, duke marrë parasysh se 1950-n do ta realizojmë tërësisht. Ja, pra, një arsye akoma më e madhe, që duhet të na nxitë të mobilizohemi shumë e më shumë jo vetëm për realizimin 100 për qind të planit, por për tejkalimin e tij dhe për realizimin e dyvjeçarit sa më afër parashikimeve të aprovuara nga Kuvendi Popullor. Kjo duhet të arrihet dhe do të arrihet me mobilizimin total të Partisë sonë heroike dhe të punonjësve të vendit tonë. Për këtë gjë, në mes të tjerave duhet të plotësohen këto detyra:

1) Të luftohet fryma e demobilizimit, e futur nga armiqtë dhe nga grupi antiparti i Abedin Shehut e i Niazi Islamit me shokë dhe të binden njerëzit se plani është real e i realizueshëm, sepse është i mbështetur në forcat tona, në heroizmin e punëtorëve dhe të masave punonjëse të vendit tonë, në eksperiencën e Bashkimit Sovjetik dhe në ndihmën e madhe të tij dhe të demokracive popullore.

2) Të përdoret si duhet materiali shumë i vlefshëm që na ka ardhur dhe do të na vijë vazhdimisht nga Bashkimi Sovjetik në radhë të parë si dhe nga demokracitë popullore për të ngritur dhe për të forcuar indus-

trinë dhe ekonominë tonë socialiste. Të vihet në jetë eksperienca shumë e vlefshme sovjetike në çdo sektor, e cila na jepet nga teknikët specialistë të shquar që na ka dërguar shoku Stalin dhe që punojnë me të gjitha forcat e tyre për të ndihmuar kuadrot tanë dhe ndërtimin e bazave të socializmit në Shqipëri.

3) Të kuptojnë mirë punëtorët, specialistët dhe teknikët tanë se realizimi i plotë i planit varet në radhë të parë nga vigjilenca e madhe revolucionare e tyre, nga mobilizimi, organizimi dhe entuziazmi i tyre.

4) Të forcohet disiplina, organizimi, kontrolli e përgjegjësia në punë dhe po të merret shembull nga organizimi i mirë i punës në Fabrikën e tisazhit dhe në Fabrikën e çimentos në Shkodër, nga Fabrika e lëkurëve në Korçë, nga miniera e Rubikut dhe ajo e Selenicës, do të shihet se është plotësisht i mundur një organizim shumë më i shëndoshë.

5) Të zgjerohet sa më shumë zbatimi i normave në punë, pse shumë pak është punuar me norma në këtë sektor të ekonomisë sonë.

6) Të bëhet një luftë më e ashpër për uljen e kostos së prodhimit me anë të një përdorimi më racional të fuqisë punëtore, me anën e uljes së normativave të konsumit të materialit, me anë të kursimit sa më të madh të materialit të importit, duke shfrytëzuar gjithmonë e më shumë rezervat e brendshme, të cilat në sektorin industri-miniera janë të mëdha.

7) Të ruhen, të mirëmbahen dhe të shfrytëzohen në mënyrë sa më racionale maqineritë e shumta që ka ky sektor.

8) Të krijohen kushte më të kënaqshme jetese për



punëtorët tanë në mënyrë që të shohin konkretisht çdo ditë e më shumë se lufta për realizimin e planit s'është gjë tjetër veçse luftë për përmirësimin e jetesës së tyre dhe kështu ta ndjejnë çdo ditë e më tepër veten të lidhur me fabrikën, me minierën, me maqinerinë. Kjo gjë është e mundshme në sektorin industri-miniera, ku qëndrat e punës janë stabël.

9) Të luftohet për të nxjerrë prodhim me cilësi të mirë, ashtu siç e kërkon sistemi i pushtetit dhe i ekonomisë sonë, që ka epërsi ndaj pushtetit dhe ekonomisë kapitaliste. Veçanërisht duhet të theksojmë se prodhime të tilla si këpucët e fabrikës së Tiranës ose ato të gomsterisë së Durrësit nuk mund të jenë të pranueshme dhe e dëmtojnë pushtetin dhe ekonominë tonë, si ekonomikisht ashtu edhe politikisht.

10) Të nxirren sa më shpejt udhëzime teknike mbi procesin teknologjik të çdo prodhimi, për çdo fabrikë e minierë dhe për çdo repart veç e veç dhe të ketë kështu të shkruar një rregullore ose dispozitë zyrtare, mbi të cilën të ecet me siguri dhe të punohet parcshtur për përsosjen e saj.

## NDËRTIMET

Një vend shumë të rëndësishëm në ekonominë tonë zënë ndërtimet, që përfaqësojnë ngritje kombinate, fabrikash, rrugësh, spitalesh, shkollash, bonifikime, kanalizime etj. Për vitin 1949 ndërtimet janë realizuar në 82 për qind për arsye të mungesës së fuqisë punëtore, të mospërdorimit dhe të mosorganizimit të mirë

të forcave në punë, të mungesës së maqinerisë, të transportit dhe të moszbatimit në shkallë të gjerë të normative. Po të krahasojmë investimet globale, që dalin nga realizimi i investimeve në 1949 dhe nga ato që parashikohen në planin e 1950-s, me investimet globale që parashikonte plani dyvjeçar, realizimi i tyre është 97 për qind. Këtë del se plani i investimeve për vitin 1950 është rritur kundrejt vitit 1950 të planit dyvjeçar 34 për qind dhe kundrejt realizimeve të 1949-s paraqitet 240 për qind. Investimet e këtij viti kanë 92 për qind karakter nacional dhe 8 për qind lokal nga të cilat 37,4 për qind janë për maqineri dhe 62,6 për qind për ndërtime. Investimet kryesore në këtë vit bëhen në industri, në komunikacion, në miniera, në bujqësi dhe në ndërtesa banimi. Këto arrijnë në 75 për qind; 25 për qind të tjera janë për arësimin, kulturën, shëndetësinë, fiskulturën dhe ndërtimet lokale.

Eksperiencia e vitit të kaluar duhet të na ndihmojë që ne të realizojmë këtë plan investimesh shumë të rëndësishëm që kemi sivjet; gjithashtu duhet të bëjmë përpjekje të mëdha që të zhdukim nga puna jonë gabimet, lëshimet dhe mungesën e organizimit. Në objektet kryesore të ndërtimit gjatë vitit 1949 ne kemi pasur suksese. Kantieri i ndërtimit të Kombinatit të madh të tekstilit «Stalin» e ka tejkaluar planin e 1949-s 124 për qind dhe planin e tremujorit të parë e ka realizuar e tejkaluar 15 ditë para afatit. Kombinati i madh i sheqerit në Maliq të Korçës e ka tejkaluar planin vjetor të 1949-s 106 për qind dhe planin e tremujorit të parë të 1950-s e ka realizuar 14 ditë para afatit. Në tejkalinimin e këtyre planeve anëtarët e Partisë kanë

kryer me nder detyrën dhe puna e inxhinierëve sovjetikë dhe metodat sovjetike të vëna në zbatim na kanë ndihmuar shumë. Organizimi i punës, dhe zhvillimi i emulacionit socialist ka qenë i mirë. Mobilizimi i punëtorëve, i rinisë sonë si dhe puna e teknikëve dhe e drejtorive të kantierëve kanë qenë shumë të mira.

Gjithashtu në Hekurudhën Peqin—Elbasan është tejkaluar plani i tremujorit të parë për 1950-n 103 për qind. Këtu përsëri duhet të theksojmë vrullin dhe entuziazmin e rinisë sonë heroike, e cila kryen kurdoherë çdo detyrë që merr përsipër, si edhe organizimin e mirë të punës dhe ndihmën e çmueshme të inxhinierëve sovjetikë. Me vrullin që punohet në këto kantiere të rëndësishme si edhe në ato të Hidrocentralit dhe të Ujësjellësit të Selitës, ku qeveria sovjetike dhe shoku Stalin na kanë dërguar nga inxhinierët më të mirë, plani i ndërtimit të tyre do të kryhet në afatin e caktuar. Populli ynë nga mesi i vitit të ardhshëm do të korrë frutet e punës së tij dhe të ndihmës së madhe të Bashkimit Sovjetik dhe do të ketë beze e stofra, ujë e dritë, sheqer dhe vija të reja hekurudhore.

Për realizimin me sukses të planit të vitit 1950 në sektorin e ndërtimeve na dalin përpara detyra të mëdha, që duhet t'i kryejmë dhe probleme gjithashtu të rëndësishme, që duhet t'i zgjidhim:

1) Problemi më i madh dhe mbi të gjitha është ai që ka lidhje me jetën e punëtorisë sonë në qendrat e punës; shumë është folur në këtë drejtim dhe nuk mund të themi se nuk është bërë gjë, por ajo që është bërë është pak. Shumë gjëra mund të bëheshin me mundësitë që kemi, por nuk janë bërë ngaqë drejtuesit e ndër-

marrjeve tona, bile edhe të ministrive, këtë problem nuk e kanë vënë në radhë të parë. Punëtori në kantieret e ndërtimeve duhet ta ndjejë veten mirë, sa më afër kushteve të jetës së shtëpisë së tij, bile përsa u përket kushteve materiale duhet ta ndjejë veten edhe më mirë.

2) Të njihet plani nga punëtorët; kjo është e domosdoshme nëse kërkojmë që punëtori të jetë i ndërgjegjshëm për atë që i kërkohet dhe si rrjedhim të japë maksimumin e kontributit të tij.

3) Edukimi dhe ngritja tekniko-profesionale e punëtorëve është një nga detyrat më të mëdha të Partisë dhe të bashkimeve profesionale. Rritja jonë e përditshme si shtet, zgjerimi i problemeve të çdo lloji, ritmi i ndërtimeve të vendit nuk pranojnë që ne të kemi një klasë punëtore analfabete ose me fare pak kulturë dhe shumë të ulët nga ana teknike e profesionale, se nuk ka si të mendohet për plane të tjera perspektive.

4) Zbatimi i normave dhe emulacioni socialist duhet të bëhen faktorë kryesorë në realizimin e planit. Në të kaluarën këto kanë çaluar mjaft, ndërsa kohët e fundit janë vënë disi në rrugë. Punë e madhe dhe e vazhdueshme kërkohet në këtë drejtim nga bashkimet profesionale. Pa norma, pa gara dhe pa emulacion s'ka si të flitet për ekonominë socialiste.

5) Realizimi i fuqisë punëtore është një detyrë e madhe. Për këtë përgjegjësia në radhë të parë u bie komiteteve ekzekutive të rretheve dhe fill mbas tyre ministrive dhe ndërmarrjeve. Është e domosdoshme që komitetet ta kenë preokupacionin më të madh dhe të luftojnë ta nxjerrin fuqinë punëtore në kohën që u kërkohet.

6) Të bëhet evidentimi i realizimit të planit. Nuk

ka si të flitet për operativitet në realizimin e planit, po nuk patëm një evidencë të shpejtë, të thjeshtë dhe të saktë, që nga qendra e punës deri në Drejtorinë e Statistikës. Në këtë drejtim kërkohet nga të gjithë që të ngulin këmbë për respektimin e datave dhe të udhëzimeve përkatëse.

7) Të kontrollohen dhe të ndihmohen vazhdimisht kuadrot, jo nga zyra, por në vend — atje do të shihet si punojnë, ç'mungesa kanë, atje do të njihet i zoti, sulmuesi, përtaci, atje do të zbulohet edhe armiku.

8) Të vendoset një disiplinë e fortë për zbatimin e planit dhe të luftohet me vrullin revolucionar që e karakterizon Partinë tonë duke pasur gjithmonë besimin e patundur në forcat e pashtershme të popullit dhe në ndihmën e madhe që na jep Bashkimi Sovjetik në radhë të parë dhe pastaj të gjitha demokracitë popullore.

Punonjësit e Ministrisë së Punëve Botore në radhë të parë, por edhe ata të ministrive të tjera, qoftë për ndërtimet që i kryen ky dikaster, qoftë për ato që i kryejnë vetë, po kështu edhe komitetet ekzekutive të rretheve, duhet të përfitojnë sa më shumë nga eksperiencia e vitit 1949 për të organizuar dhe koordinuar punën shumë më mirë që të realizojnë planin e ndërtimeve.

## TRANSPORTI

Çështja e transportit ka një rëndësi të jashtzakonshme për ekonominë tonë dhe nga kjo kushtëzohet shumë realizimi i planeve. Në transport ne kemi pasur dëme dhe sabotime nga jugosllavët, nga Niazi Islami

dhe sabotatorë të tjerë. Mirëpo me masat që mori Partia gjendja është përmirësuar si në transportin automobilistik ashtu dhe në atë hekurudhor e detar.

Plani i mjeteve të transportit për 1950-n në krahasim me rezultatet e 1949-s, paraqitet me një rritje të konsiderueshme: transporti automobilistik — 36,3 për qind, transporti detar — 27,5 për qind dhe transporti hekurudhor — 33,3 për qind. Megjithkëtë nevojat nuk plotësohen qind për qind. Për këtë gjë punonjësit e transportit ngarkohen me detyra të mëdha për realizimin e planit. Prandaj duhet të forcohet gjithmonë e më shumë disiplina, e cila ka çaluar; të praktikohen sistematikisht shërbimet profilaktike të automjeteve dhe të tregohet një preokupacion më i madh për mirëmbajtjen dhe gatishmërinë e tyre. Të luftohet për realizimin dhe tejkalimin e koeficientëve të shfrytëzimit që janë caktuar, të luftohet për ngritjen politike dhe teknike të kuadrit të këtij sektori. Të bëhen përpjekje të vazhdueshme për shtimin e inventarit, duke riparuar sa më shumë automjete për t'i vënë në shfrytëzim. Të organizohet gjithmonë e më mirë puna në ofiçinat, të luftohet për uljen e normave të konsumit të karburantit dhe për përdorimin sa më të mirë të gomave, duke tejkaluar normën e caktuar. Të bëhen përpjekje të vazhdueshme për zbatimin e kontratave ndërmjet punëdhënësve të ndryshëm të ndërmarrjeve të transportit, të organizohet më mirë ngarkim-shkarkimi dhe të tregohet më shumë kujdes për jetesën e punonjësve të transportit duke u krijuar kushtet e domosdoshme për t'i lidhur më shumë me punën dhe për t'i vënë në gjendje që të japin një rendiment më të lartë.

Këto porosi nuk u drejtohen vetëm punonjësve të Ministrisë së Komunikacionit, por gjithë punonjësve të sektorit ekonomik dhe në përgjithësi gjithë kuadrove tanë, që punojnë në Ministrinë e Industrisë, të Botores, të Bujqësisë, të Ministrisë së Punëve të Brendshme, të Mbrojtjes, të Tregëtisë, të Komitetit të Grumbullimeve, të Bashkimit të Kooperativave Tregëtare si dhe të Artizanatit, sektorë të cilët kanë nën vartësinë e tyre një numër të konsiderueshëm mjetesh transporti. Shfrytëzimi i automjeteve në këta sektorë çalon shumë dhe është shumë vështirë që të kontrollohen. Por këtyre sektorëve nuk u kërkohet vetëm që të shfrytëzojnë në masën më të madhe mjetet e tyre, por të ndihmojnë sa më shumë Ministrinë e Komunikacioneve në realizimin e planit, duke mos vonuar ngarkim-shkarkimin e mallrave që transportohen për ta, duke bërë që mallrat të jenë të gatshme për transportim dhe të ambalazhuara mirë, duke lajmëruar me kohë për mallrat që nuk disponohen, duke dhënë sa më shumë ndihmë për ngarkimin e automjeteve të tyre në agjencitë e transportit kur ato kthehen bosh etj.

Detyra të rëndësishme u ka ngarkuar me ligj pushteti organeve të Ministrisë së Punëve të Brendshme për kontrollin teknik të automjeteve dhe për zbatimin e të gjitha dispozitave përkatëse në fuqi, për një disiplinim më të fortë në qarkullimin automobilistik dhe për një shfrytëzim sa më të plotë të kapacitetit të mjeteve tona të transportit.

Këtu dua të theksoj heroizmin dhe punën plot vetëmohim të një numri të madh shoferësh, që janë hedhur në zjarr për të shpëtuar maqinën, që kanë punuar ditë

e natë, duke mos dashur të dorëzojnë maqinën në duar të të tjerëve për të mos u prishur. Duhet përmendur Parku i Shkodrës, që e ka realizuar planin e tremujorit të katërt të 1949-s 137,69 për qind dhe kantieri i Durrësit që ka arritur gjithashtu rezultate të mira. Nga ana tjetër theksojmë se në Parkun e Tiranës, në Oficinën e Vlorës dhe në Ndërmarrjen e shfrytëzimit të hekurudhave plani nuk është realizuar plotësisht dhe janë vërtetuar çrregullime, indisciplinime dhe sabotime.

### BUJQËSIA

Bujqësia zë një vend të dorës së parë në ekonominë tonë, prandaj plani dyvjeçar na shtronte përpara detyra të rëndësishme. Këto detyra, gjatë vitit 1949, pjesërisht janë kryer dhe pjesërisht jo. Përpjekjet në këtë drejtim kanë qenë të mëdha nga ana e Partisë dhe e fshatarësisë, por nga ana e Ministrisë së Bujqësisë ato nuk kanë qenë të mjaftueshme. Këtu përgjegjësi të madhe ka vetë ministri i bujqësisë, së bashku me ndihmësit e tij, të cilët megjithëse i kanë pasur të qarta drejtimet e zhvillimit të bujqësisë të ne dhe mjaft mjete për të realizuar planin e parashikuar për vitin 1949, nuk kanë ditur të organizojnë aq mirë punën për vënjën në jetë të vendimeve të Komitetit Qendror dhe të qeverisë. Duhet të theksohet gjithashtu se Drejtoria e bujqësisë në Komitetin Qendror nuk është treguar e aftë jo vetëm të studjojë problemet e rëndësishme të bujqësisë për të ndihmuar Komitetin Qendror, por as nuk ka ndjekur në jetë si zbatoheshin vendimet e Ko-



mitetit Qendror në sektorin e bujqësisë. Kështu që ndihma nga ana e saj as për Komitetin Qendror dhe as për Ministrinë e Bujqësisë dhe organet vartëse të këtyre s'ka qenë e kënaqshme.

Pikërisht në sektorin e bujqësisë, ku mbizotëron ekonomia private fshatare, duhej një organizim i shëndoshë dhe një kontroll i gjerë për zbatimin e planit dhe për ndjekjen e organizuar të të gjitha punimeve në sektorin e bujqësisë. Kjo nuk është bërë. Nuk është bërë gjithashtu si duhet studimi serioz i problemeve kyçe, që kushtëzojnë përparimin dhe modernizimin e bujqësisë sonë.

Çështja e tokës është problemi themelor në bujqësi. Ky problem bazë nuk është ndjekur me seriozitetin e duhur nga Ministria e Bujqësisë. Reforma agrare u ndau tokën fshatarëve, kjo ishte çështja kryesore, por Ministria e Bujqësisë i nënvleftësoi direktivat e Komitetit Qendror dhe të qeverisë që problemi i tokës nuk mund të mbaronte vetëm me ndarjen e saj, por duhej ndjekur dhe përmirësuar kjo ndarje në ndryshimet që do pësonte. Ministria e Bujqësisë u nis nga parimi i gabuar se problemi i tokës u zgjidh tok me reformën agrare dhe nënvleftësoi rolin e institucionit që duhej të merrej vazhdimisht me çështjen e tokës.

Një varg problemesh lindën, pra, në lidhje me tokën dhe këto nuk muarën zgjidhjen e drejtë, por u kaluan përciptazi dhe pak gjëra u zgjidhën drejt. U krijuan vështirësi të reja, që do të dëmtonin realizimin e drejtë të planit të shtetit në bujqësi. Ne duhej të kishim në bujqësi një pasqyrë të qartë të pronësisë së tokës në dorë të fshatarit dhe kjo pasqyrë, po të ishte bërë me

kohë dhe t'i bëheshin përmirësime nga viti në vit, do të bënte që të kishim tani, në mos një kadastër të plotësuar, të paktën një kadastër pak a shumë të sigurtë, ku do të mbështetnim më realisht planet tona për bujqësinë. Këtë kadastër e ka nënvleftësuar Ministria e Bujqësisë, me gjithë udhëzimet e vazhdueshme të Komitetit Qendror dhe të qeverisë dhe për këtë shkak ne nuk do të kemi edhe për disa vjet një kadastër të tillë. Jo vetëm kaq, por Ministria e Bujqësisë, në vend që t'i hynte këtij problemi të rëndësishëm me një plan pune, çdo vit hidhte poshtë studimet dhe eksperiencën e fituar në këtë drejtim dhe ja rifillonte rishtas një pune të re, me kritere, natyrisht, jo të shëndosha. Ç'na ngjet? Na ngjet që tani, kur vjen puna e mbjelljeve të pranverës dhe të vjeshtës, kur vjen koha e marrjes së angazhimeve nga ana e fshatarësisë, ne s'kemi të dhëna të sigurta ku të bazohemi. Ne bazohemi në kadastrën, ne bazohemi në një kadastër tjetër të ashtuquajtur të verifikuar, ne bazohemi në klasifikimin e tokave.

Ministria e Bujqësisë bën planin e përgjithshëm dhe ua çon rretheve dhe rrethet punojnë sipas kokës së tyre. Një rreth thotë «unë do ta bazoj planin mbi kadastrën», se ashtu i leverdis, tjetri thotë «mbi kadastrën e verifikuar», tjetri as në njërin dhe as në tjetrën por «në klasifikimin e tokave». Njëri rreth merr kompetencat e plota dhe bën ndreqjet e veta në atë farë kadastre që kemi dhe ul në më të shumtat e rasteve fondin e tokës si pa gjë të keq, duke shkuar nga parimi që «të jetë brenda planit të mbjelljeve dhe të grumbullimit», duke rënë shumë herë në pozitë e disa fshatarëve. Kështu ndodh çdo vit edhe pse Ministria e Bujqë-

sisë çon gjoja për studim ekipe, të cilat nuk udhëzohen dhe as kontrollohen si duhet në punën që kryejnë, gjë që lejon vazhdimin e një anarkie të tillë në këtë sektor kaq të rëndësishëm të ekonomisë sonë. Ka anomali të tjera në çështjen e tokës, Ka toka që akoma janë të pashpërndara dhe Ministria e Bujqësisë nuk merr masa për t'i sistemuar, por kur vjen çështja për detajimin e planit rrethi i Fierit, për shembull, për ta ulur planin në bujqësi, nxjerr si pretekst se ka në dispozicion afro 2 000 hektarë tokë që në parim nuk u punokan e nuk paskan zot, por që në praktikë fshatari e punon atë tokë, pa i qenë ndarë, por s'merr asnjë angazhim për të, pse atij nuk i figurojnë në pronën e tij dhe kështu ai shpëton nga detyrimet dhe nga angazhimet. Ka toka që kanë mbetur pa zot, ngaqë fshatarët që i posedonin janë larguar dhe punojnë nëpër fabrika e kantiere. Këto toka ata ua kanë lënë pa asnjë të drejtë farefisit, të cilët i punojnë për hesapin e tyre, por s'bëjnë asnjë deklaratë, s'marrin asnjë angazhim, s'paguajnë asnjë detyrim dhe çka është më e keqe, nuk i punojnë si duhet. Mund të vazhdoj të flàs pa mbarim për anomali të tilla, të cilat nuk kanë gjetur zgjidhje të drejtë nga ana e Ministrisë së Bujqësisë dhe organet e saj në rreth.

Çështja e statistikave në bujqësi është për tokë. Asgjë s'kemi të sigurtë në këtë drejtim. Si thotë njëri, nuk thotë tjetri. Qeveria ka dhënë urdhër dhe është krijuar një aparat, i cili do t'i centralizojë këto statistika të bujqësisë, por Komisioni i Planit akoma nuk e ka bërë këtë studim, i cili fle në raftet e tij.

Përveç këtij çrregullimi, që ekziston për kadastrën,

për klasifikimet e tokës, për statistikat problem akoma më i ndërlikuar është dhe ai i rendimenteve, që Ministria e Bujqësisë nuk i është vënë seriozisht për ta studjuar. Këtu përsëri nuk kemi koeficiente të sigurta dhe nuk dihen me saktësi sasinë e çdo prodhimi. Me e ditë këtë gjë nuk është dhe shumë e kollajtë në kushtet tona pa një kadastër, sepse fshatari nuk e tregon sasinë e saktë të prodhimit. Por Ministria e Bujqësisë gjatë këtyre viteve mund të kishte organizuar ekipe të posaçme në çdo rreth që të bënin prova të ndryshme dhe serioze në zona dhe në lloje tokash të ndryshme, që kështu të arrinte në koeficiente më reale për çdo rreth. Duke folur mbi çështjen e sipërfaqeve të mbjella Stalini thotë se metoda e shifrave mesatare të parektifikuara nga të dhënat e çdo zone nuk është një metodë shkencore. Përveç kësaj duhet të punohet me fshatarët e varfër dhe të mesëm për të njohur në mënyrë të saktë sasinë e prodhimeve për çdo lloj kulture, pse kjo do të ndihmojë në zgjidhjen e këtij problemi të vështirë, por të rëndësishëm, pse atëhere do të zbatohet kudo dhe drejt mesatarja e rendimentit në të gjithë Republikën.

Ministria e Bujqësisë dhe organet e saj, në mungesë të një kadastre, nuk janë në dijeni si duhet të tokave të reja që hapen nga fshatarët dhe nuk e drejtojnë si duhet këtë politikë të drejtë të qeverisë sonë, e cila do t'i sjellë dobi kolosale vendit tonë.

Një problem tjetër shumë i rëndësishëm në lidhje me tokën është çështja e rajonizimit të saj dhe e inkurajimit për mbjelljen e planifikuar e të përshtatshme në këto toka të kulturave të rëndësishme. Toka dhe klima e vendit tonë janë të tilla, që lejojnë të mbillet

çdo gjë, të mbijë dhe të japë frute të mira çdo bimë, vetëm se kulturat duhet t'i sistemojmë dhe të mos shkojmë sipas dëshirës së çdo fshatari individ, i cili me rutinën e zakonit e vjetra punon në mbjelljen e njërës kulturë dhe në braktisjen e një tjetre pa e njohur interesin e madh të tij. Fshatari e kupton lehtë ku është interesi i tij, në rast se ne dimë t'ja shpjegojmë, dimë ta udhëzojmë dhe ta ndihmojmë në këtë drejtim. Ka pasur pikëpamje të gabuara që të mënjanohet prodhimi i misrit. Kjo gjë as që mund të bëhet, përkundrazi do të inkurajohet mbjellja e misrit, po natyrisht atje ku ai ka mundësi të rritet i shëndetshëm dhe me një rendiment të lartë. Vendet e përshtatshme për grurë duhet të mbillen me grurë, ato që janë të përshtatshme për pambuk ose oriz të mbillen me pambuk dhe me oriz e kështu me radhë. Atje ku mund të mbillet jonxhë, duhet të mbillet jonxhë dhe atje ku duhet të rriten kafshë të trasha, duhet të rriten kafshë të tilla dhe jo dhi e dele e të krijohen çaire artificiale apostafat për këtë gjë. Vendet e përshtatshme për të rritur bagëtinë e imtë duhet të rezervohen për këto bagëti dhe jo të shkojmë kuturu, siç ecte bujqësia jonë në kohën e regjimeve të kaluara, kur çdo gjë bëhej sipas interesit të beut ose të agait. Tani çdo gjë duhet të zhvillohet në interesin e të gjithë popullit dhe të vendit tonë në tërësi si dhe të fshatarit si individ. Një ekonomi duhet të plotësojë tjetrën dhe të përfitohet sa më shumë e sa më mirë nga klima, nga toka, nga mekanizimi, nga farërat, nga metodat e reja agroteknike, nga shkenca pararojë e Bashkimit Sovjetik në bujqësi etj. Pa i pasur të qarta këto gjëra themelore dhe pa i organizuar në

mënyrë të shëndoshë, nuk mund të ecë me plan bujqësi jonë, të zbatohet si duhet ky plan dhe të shkojmë drejt transformimit socialist të bujqësisë. Në vendin tonë ekzistojnë të gjitha mundësitë për një bujqësi të përparuar si nga ana e klimës, e pjellorisë së tokës, nga ana e fshatarësisë sonë, e cila është e gatshme t'i përqafojë shpejt të gjitha metodat e reja në bujqësi që janë në interesin e saj, ashtu edhe nga ana e ndihmës me mjete të mekanizuara, me farëra, me eksperiencë të çmueshme, që na jepet nga Bashkimi Sovjetik për këtë sektor. Vetëm duhet që në radhë të parë t'u japim fund këtyre çrregullimeve dhe mungesave të organizimit, të cilat janë shumë të dëmshme.

Është e domosdoshme që planet tona në bujqësi, sa të jetë e mundur, të jenë reale e të mbështetura në të dhënat që ne kemi. Kur këto plane dërgohen poshtë në rrethe për t'u detajuar, të mos shkohet kurrsesi nga parimi që duhet të ulen e të ndryshojnë sa të jetë e mundur më shumë, përkundrazi, duke mos përjashtuar vërejtjet e drejta, këto plane të mbështeten e të aprovohen dhe, çka është më e rëndësishmja, të realizohen dhe të tejkalohen.

Çështja e angazhimeve nga fshatarët po konsiderohet si diçka formale ose propagandë. Përkundrazi angazhimet e marrura prej fshatit në tërësi dhe prej fshatarit si individ duhet të mbështetin realizimin e detyrave të parashikuara në plan, në ato sasi dhe në ato kultura të caktuara sipas cilësisë së tokës. Me këto angazhime janë lidhur dhe detyrimet nga shteti e nga fshatarët, të cilat duhet të respektohen nga të dy palët. Është e vërtetë se duhet të mbillet jonxha, por kjo du-

het të bëhet me plan, atje ku ajo është caktuar të mbillet dhe ku mund të mbijë e të rritet mirë; ne duhet të kënaqemi kur kjo kulturë mbillet në ato zona dhe në atë sasi që cakton plani dhe në kurrizin e atyre kulturrave që përcakton plani dhe të mos kënaqemi, siç ngjet me disa shokë, kur kjo mbillet në vende të papërshtatshme dhe në formë eksperimentale nga ana e fshatarëve. Po kjo ngjet edhe me lulen e diellit, e cila mbillet nëpër qoshe të arave me misër, kurse fshatari ka marrë angazhim që ta mbjellë në të gjithë arën. Kjo është arsyeja që, kur vjen koha e prodhimit në këtë kulturë, plani s'realizohet dhe angazhimi i marrur s'ka pasur kurrfarë vlere. Angazhimet duhet të ndiqen dhe të kontrollohen si zbatohen, duhet të ndiqen kulturat që në çastin që hidhen në tokë dhe derisa japin prodhimin, duhet udhëzuar fshatari vazhdimisht që të përdorë metoda të reja agroteknike, ta ndihmojmë dhe ta inkurajojmë atë që të përdorë sa më shumë mjete të reja në punë, ta mësojmë dhe ta ndihmojmë që të rritë mirë kafshët e punës dhe të tjera, ta ndihmojmë me dhënjen dhe përdorimin si duhet të krediteve shtetërore. Me pak fjalë, fshatari të shohë konkretisht interesimin e gjallë të pushtetit të tij dhe këtë interesim mos ta shohë vetëm në format agjitative dhe bombastike, por konkretisht: nga ndihmat, nga udhëzimet, nga drejtimi; të gjitha këto duhet ta nxitin atë të korrë më shumë misër, më shumë grurë, të mbledhë më shumë pambuk etj. Të shohë se çka parashikohet në planin e shtetit, u realizua dhe në favorin e tij, se duke zbatuar planin dhe këshillat e pushtetit të tij, bimët mbinë më mirë dhe dhanë prodhime me bollëk, të shohë gjithashtu se

shtimi i prodhimeve nuk varet vetëm nga shiu ose nga dielli.

Ne mund të themi me siguri se me gjithë të metat tona në punë ne kemi pasur edhe suksese në bujqësi. Sipërfaqet e mbjella janë shtuar 110 për qind në krahasim me 1948-n dhe 145 për qind në krahasim me 1938-n, janë shtuar gjithashtu edhe sipërfaqet e mbjella me drithëra si dhe rendimenti i tyre. Fshatari ka korrur me sukses frutet e djersës së vet dhe ka shtuar mirëqenjen e tij. Vetëm shifrat e grumbullimit të drithërave për vitin 1949 jo vetëm që na tregojnë sa të drejta e me baza marksiste-leniniste kanë qenë urdhëresat e reja të grumbullimit, por këto kanë qenë një nxitje jashtëzakonisht e madhe për vetë fshatarësinë, e cila, sido që zbatimi i urdhërësive u bë me vonesë, i përqafoi ato dhe u nxit prej tyre për një prodhim më të madh. Plani i grumbullimeve është realizuar për grurin 100,8 për qind në vitin 1949 dhe 138,77 për qind në krahasim me vitin 1948; për misrin — 77,54 për qind dhe kjo për arsye të përmytjeve në krahinat e Veriut dhe të thatësirës në krahinat e Lushnjës, të Vlorës dhe të Beratit. Megjithatë në krahasim me 1948-n sasia e misrit të grumbulluar është 255,70 për qind, tagjia si plan grumbullimi u realizua 107,6 për qind dhe 299,14 për qind në krahasim me 1948-n.

Fshatarësia ka shtuar sipërfaqet e mbjella me foragjere, të cilat arrijnë në 131 për qind në krahasim me vitin 1948 dhe po interesohet për mbjelljet e jonxhës, gjë që do të ndihmojë në shtimin dhe në përmirësimin e bagëtive, në përmirësimin e tokës dhe në ngritjen e rendimentit të disa kulturave të tjera. Plehrat kimike,



gati të panjohura në vendin tonë, kanë filluar ta tërheqin shumë fshatarin tonë dhe shpërndarja e tyre u realizua 124,5 për qind.

Lidhur me perimet e ndryshme, patatet etj. këtë vit fshatarët kanë mbjellë dhe kanë prodhuar me bollëk, gjë që ka lehtësuar furnizimin e mirë të qyteteve me sasi të mjaftueshme.

Përsa i përket mbjelljes së bimëve industriale plani është realizuar në një përqindje shumë të ulët jo vetëm në sektorin privat, por edhe në sektorin shtetëror. Gjithashtu rendimentet në bimët industriale kanë qenë shumë të ulëta, sepse këtyre kulturave nuk u janë bërë shërbimet e nevojshme dhe se fshatarëve u kanë munguar sqarimet e plota e të vazhdueshme si nga ana e Ministrisë së Bujqësisë, nga organet e saj në rrethe, ashtu edhe nga organizatat e Partisë. Një arsye tjetër që përqindja e realizimit të planit të bimëve industriale ka qenë e vogël ishte edhe mungesa e një stimulimi më të madh në çmimet dhe në stimulacionet e tjera.

Në fermat shtetërore gjatë vitit 1949 sipërfaqja e tokës nën kulturë është realizuar 107,07 për qind, por duhet të theksojmë se rritja e rendimenteve të kulturave në këtë sektor, ku kanë qenë të gjitha mundësitë agroteknike dhe mjetet e mekanizuara, me përjashtim të grurit, nuk ka shkuar mirë, kurse në bimët industriale rendimenti jo vetëm që nuk është ngritur, por është ulur. Një gjë e tillë ka ardhur për shkak të mungesës së organizimit dhe të ndihmës nga vetë Ministria e Bujqësisë. Fermat e shtetit jo vetëm që nuk e kanë plotësuar planin në disa kultura, por nuk kanë përmbushur njëkohësisht as detyrat për të qenë model dhe ndihmëse

për sektorin privat të bujqësisë. Përsa u përket bimëve industriale edhe këtu drejtorët e fermave kanë ngurruar shumë dhe kanë neglizhuar punën, si rrjedhim rendimentet kanë qenë më të ulëta se në sektorin privat. Fermat tona shtetërore i kanë të gjitha mundësitë të prodhojnë më shumë dhe të tejkalojnë planin, kanë gjithashtu shumë rezerva të pashfrytëzuara, pse vetë bilanci financiar i tyre tregon një fitim prej 10 milion lekësh kundrejt 2 milion lekë humbje që ishin planifikuar.

Në sektorin e SMT-ve megjithëse ekzistojnë një tok të metash, shumë probleme u vunë në rrugë të drejtë gjatë vitit 1949. Megjithkëtë rezultatet nuk kanë qenë shumë të kënaqshme. Numri i traktorëve të vënë në përdorim ka qenë shumë më i madh se ai i vitit 1948, domethënë kemi si fuqi motorike 70 për qind HP. më tepër se në vitin 1948. Një sërë masash organizative, që u muarën gjatë vitit 1949, të bazuara në eksperiencën sovjetike, shpënë në përmirësimin e gjendjes së SMT-ve. Por në SMT-të ka munguar puna e mirë drejtuese, ka munguar puna operative dhe përgjegjësia personale në punë. Puna politike, edukative dhe kulturele, për forcimin e disiplinës, për ruajtjen e maqinerisë dhe për ngritjen e ndërgjegjes në punë, nuk ka qenë në lartësinë e duhur. Ka çaluar organizimi i garave, ku ka pasur shumë formalizëm. Sukseset në punën e SMT-ve janë të lidhura ngushtë me përpjekjet e mobilizimit të madh të të gjithë punonjësve dhe të drejtorive të tyre. P.sh. SMT-ja më e mirë është ajo e Kërçës, e cila për vitin 1949 ka realizuar planin e plugimeve 104 për qind, të mbjelljeve — 115 për qind, të korrjeve — 135 për

qind, kurse të shirjes së të lashtave vetëm 41 për qind për arësye se fshatarët e Korçës me zor e pranojnë të shirët me maqinë. Po kjo SMT, me gjithë kushtet e papërshtatshme atmosferike, planin e tremujorit të parë të vitit 1950 e ka realizuar 103 për qind. Në këtë SMT organizimi i mirë i enulacionit socialist, zbatimi i rregullt i shërbimeve teknike, sipas eksperiencës së SMT-ve sovjetike, u dedikohen punonjësve të kësaj SMT-je, organizatës bazë të Partisë atje dhe ndihmës, që s'u është kursyer nga Komiteti i Partisë i rrethit të Korçës dhe nga komiteti ekzekutiv.

Po japim një shembull të SMT-së më të keqe: atë të Urës Vajgurore në Berat. Vitin e kaluar kjo SMT planin e plugimeve e realizoi vetëm 28 për qind, ndërsa planin e shirjeve — 53 për qind. Ndihma nuk i ka munguar kësaj SMT-je, por puna drejtuese, ajo organizative, politike dhe teknike ka qenë e dobët. Drejtuesit e ndërmarrjes në fjalë nuk kanë qenë të preokupuar dhe të disiplinuar për realizimin e planit. Shërbimet teknike nuk janë zbatuar rregullisht dhe maqinat e traktorët kanë pësuar vazhdimisht difekte. Në rastin e SMT-së së Korçës, traktoristët, punonjësit e tjerë dhe drejtuesit meritojnë urime, kurse drejtorit dhe punonjësve të SMT-së së Urës Vajgurore të Beratit u duhen bërë qortime dhe vërejtje, që të mos ta përsëritin më punën e tyre të dobët.

Në kooperativat bujqësore, megjithëse ka akoma shumë të meta për shkak të zbatimit të statutit, ka pasur një përmirësim në forcimin organizativ, ekonomik dhe politik, por ky përmirësim nuk është akoma i kënaqshëm. Në kooperativat është shtuar pjesëmarrja

në punë dhe kanë filluar të zbatohen normat në punë, është përmirësuar agroteknika dhe shfrytëzimi i maqinerisë në bashkëpunim me SMT-të. Gjatë këtij viti sipërfaqet e mbjella janë 167 për qind në krahasim me vitin e kaluar. Sipërfaqja e mbjellë me grurë në krahasim me 1948-n është shtuar 146 për qind dhe rendimenti është shumë më i lartë. Gjëja e gjallë në kooperativa gjithashtu sa vete po shtohet dhe po përmirësohet. Shembull për të gjitha kooperativat bujqësore është ajo e Maminasit «Drapër e Çekan» në rrethin e Durrësit, e cila planin e vitit 1949 e ka realizuar në këtë mënyrë: në të gjitha kulturat 100 për qind duke arritur rendimentet mesatare të mëposhtme: në grurë — 19,7 kv/ha., në misër — 18 kv/ha., në duhan — 5,8 kv/ha. Kjo kooperativë mban gjithashtu rekordin për prodhimin e grurit në një parcelë prej 1,5 hektarësh, duke arritur një rendiment mesatar prej 50 kv/ha. Ja ç'bën organizimi i mirë i punës, që u detyrohet të gjithë pjesëtarëve të kooperativës, shumica e të cilëve janë fshatarë të varfër, kryesisë dhe kryetarit të saj, zbatimit të eksperiencës së kolkozeve sovjetike. Në këtë mënyrë, ne shohim të ngrihet vazhdimisht mirëqenja në kooperativat bujqësore, që po bëhen shembull për masat e fshatarësisë, të cilat kanë interes për ngritjen e kooperativave bujqësore për ndërtimin e socializmit në fshat. Por për fat të keq ne kemi dhe kooperativa, që nuk janë ngritur në baza të shëndosha, që nuk shkojnë mirë, që nuk arrijnë të bëjnë bukën, pse u mungon organizimi i duhur, pse në to kanë qenë futur elementë kulakë, deri edhe në krye të kryesisë së kooperativës, siç ka qenë kryetari i kooperativës së Pojanit.

Partisë dhe pushtetit u vihet si detyrë të forcojnë kooperativat bujqësore ekzistuese për t'i bërë ato shembull, ndihmëse dhe nxitje për fshatarët e varfër dhe të mesëm që të krijojnë kooperativa të reja. Ngritjen e kooperativave të reja as nuk duhet ta shpejtojmë, por as nuk duhet ta harrojmë. Nuk duhet ta shpejtojmë për arsye të vendit tonë malor dhe pa krijuar kushtet e posaçme për të cilat duhet të bëhet një punë e madhe politike, bindëse dhe konkrete me fshatarët; gjithashtu nuk duhet ta harrojmë, pse kjo është rruga jonë për futjen e bujqësisë në rrugën socialiste dhe kjo të mos lihet pas dore sidomos në fusha, ku duhet punuar intensivisht në drejtimet që përmendëm më lart.

Duke u bazuar në eksperiencën gjithnjë e më të madhe që fitojnë njerëzit tanë në këtë sektor të rëndësishëm, por edhe të ndërlikuar dhe, duke u mbështetur në forcën e fshatarësisë sonë ne duhet që planin e vitit 1950 ta realizojmë dhe ta tejkalojmë si në sektorin shtetëror ashtu dhe në atë privat. Për këtë të marrim të gjitha masat që u thanë më sipër dhe të mësojmë nga gabimet e kaluara për të mos i përsëritur ato.

Të shfrytëzohet në maksimum fushata e mbjelljeve të pranverës për të fituar luftën për bukën, për të prodhuar sa më shumë drithëra dhe në radhë të parë grurë, misër etj. Por një fakt tërheq vëmendjen: akoma nuk është kuptuar mirë që «lufta për bukë është luftë për socializëm». Nga detajimi që i kanë bërë planit të grumbullimit të drithërave të 26 rrethet, 23 propozojnë zbritje të konsiderueshme në planin e drithërave. Vetëm Lushnja shton 369 kv., Saranda — 323 kv. dhe Rrësheni — 893 kv. Nga ana tjetër të gjitha rrethet shtojnë

sipërfaqet e planifikuara në kultura si tepë, tërshërë, koçkulla, të cilat nuk i nënshtrohen dorëzimit, por që në realitet edhe fshatari nuk i mbjell në atë masë, që ai deklaron. Dhe kjo bëhet në kurriz të bukës. Në foragjeret tejkalohet plani i shtetit, ndërsa në drithërat pakësohet. Kjo nuk mund të pranohet, pse nuk i përgjigjet realitetit, as nevojave tona. Pushteti dhe Partia duhet të përpunojnë planin e sidomos për drithërat dhe në përgjithësi për të gjitha kulturat duke i kushtuar kujdes dhe pambukut, në mënyrë që i tërë fshati kolektivisht ta pranojë me bindje planin që i caktohet dhe ta zbatojë deri te ekonomia më e vogël individuale si një ligj, ashtu siç është. Partia duhet të ketë parasysh detyrën që çdo vit të pakësohet importimi i drithit nga jashtë dhe të zëvendësohet me prodhimin tonë. Të ketë parasysh gjithashtu se duhet të luftojmë për heqjen sa më parë të triskave të bukës. Kjo është një detyrë shumë e rëndësishme ekonomike dhe politike.

Zbritja që i bëjnë rrethet planit të grumbullimit të drithërave, duke u nisur edhe nga shtesat në foragjere, që arrijnë vetëm një të pestën e zbritjes së drithërave, tregon edhe prirjen e përgjithshme që ekziston në fshatarësinë tonë për të zbritur tokën nga klasifikimi, sikur të gjitha sipërfaqet të jenë regjistruar më të larta në kadastër dhe klasifikimi të jetë bërë më i lartë. Sigurisht që në kadastër ka edhe gabime, siç përmenda më lart, por kjo nuk do të thotë që të shkojmë në ekstremin tjetër dhe, pa asnjë mundim, pa asnjë studim, të bëhen zbritje jo të drejta në fondin e tokës.

Është e domosdoshme që në kadastrën, që ekziston sot, të mos bëhen ndryshime pa vend, kohë pa kohë

dhe pa urdhër nga Ministria e Bujqësisë, sikundër po procedohet deri tani. Kadastra duhet të jetë një akt me shumë rëndësi dhe çdo reklamim duhet të vërtetohet me ekspertizë, të provohet nëse është i drejtë, pastaj të bëhet ndryshimi në kadastër dhe ky ndryshim të bëhet në bazë të ligjit në fuqi. Prandaj duhet të caktohet procedura zyrtare për të bërë zyrtarisht ndryshimet eventuale të aprovuara.

Ka edhe probleme të tjera që duhet t'i kemi parasysh për t'i zgjidhur si duhet në lidhje me realizimin e planit të vitit 1950 në bujqësi.

Një problem i madh për ekonominë e vendit tonë janë mbjelljet e bimëve industriale. Bimët industriale dhe në radhë të parë pambuku e pastaj lulja e diellit, kikiriku, recini, etj., janë dhe do të bëhen akoma më shumë një burim i mirë të ardhurash për ekonominë fshatare dhe për gjithë ekonominë socialiste në vendin tonë. Klima dhe toka jonë janë të përshtatshme për këto kultura, të cilat nuk duan më shumë shërbime se sa kulturat e tjera dhe të ardhurat prej tyre janë më të mëdha. Në vendin tonë me ndihmën e Bashkimit Sovjetik, po ngrihet Kombinati i madh i tekstileve «Stalin» dhe pambuku, lënda e parë me të cilën do të punojë ky kombinat, duhet të prodhohet në vend. Fshatari ynë duhet të kuptojë mirë se përveç fitimeve të tjera të mëdha që do të ketë nga rritja e pambukut, ai do të ketë në masë të mjaftueshme dhe me çmime të lira rrobe dhe beze, që tani jemi të detyruar t'i sjellim nga jashtë. Përveç kësaj, pambuku kërkohet shumë në vendet e tjera të demokracisë popullore dhe ne jo vetëm që do të plotësojmë dhe disa nevoja të tyre, por do të

shtojmë nëpërmjet importimeve edhe sendet e nevojshme që s'prodhohen te ne. Pambuku duhet të mbillet me shumicë në të gjitha fushat e përshtatshme dhe të caktuara nga Ministria e Bujqësisë dhe të bëhet një kulturë kombëtare. T'i hiqet fshatarit frika për bukën, pse ai që prodhon pambuk e ka bukën të siguruar shumë më mirë. Të ndihmohen fshatarët që mbjellin pambuk, të këshillohen për mënyrat e reja të agroteknikës dhe Partia e pushteti t'i kushtojnë kësaj kulture një rëndësi të veçantë.

Siç e dimë, Byroja Politike dhe qeveria kanë marrë masa dhe me stimulacionet e reja, që janë caktuar për bimët industriale duhet patjetër të arrihen rezultatet e dëshiruara.

Problem i madh dhe i vazhdueshëm është për ne rritja e sipërfaqeve të mbjellshme; në këtë drejtim janë bërë mjaft përparime nga viti në vit, por një statistikë të saktë, të dalë nga matja dhe kontrolli i vazhdueshëm nuk e kemi. Ka shumë toka nëpër kodrat dhe nëpër prozimet, afër qyteteve dhe afër fshatrave, të cilat mund të hapen nga fshatarët, nga organizatat dhe nga ndërmarrjet dhe të shtohen kështu tokat e mbjellshme, mbasi një pjesë e mirë e tokave të fushave më pjellore do të merret nga viti në vit për bimët industriale. Hapja e tokave të reja duhet të bëhet nën drejtimin dhe kontrollin e organeve të bujqësisë e me ndihmën e madhe të kuadrove të Partisë. Dhe çdo tokë e hapur duhet matur.

Është e vërtetë se shumë toka mund të nxirren nga fushat tona të Myzeqesë, të Zadrimës, të Trushit në Shkodër, të Lezhës, të Bushneshit në Krujë, nga kënetat



e Durrësit etj., por këto kërkojnë organizim, punime dhe investime të mëdha dhe që do të bëhen me një plan të gjatë dhe të kushtueshëm, kur ekonomia jonë të ketë vënë baza më të shëndosha. Ndërsa hapja e tokave të reja, duke i kthyer prozhet në toka buke, kërkon më pak shpenzime, një organizim jo të madh dhe jo shumë punë.

Ulliri është një pasuri tjetër për vendin tonë, por kësaj kulture nuk po i bëhet shërbimi siç duhet. Për këtë kulturë kaq të rëndësishme për vendin tonë, organet e bujqësisë nuk kanë treguar kujdes të mjaftueshëm. Jo vetëm që janë mbjellë pak ullinj deri tani, por nuk po u kushtohet kujdesi i duhur as atyre që ekzistojnë. Prodhimi i tyre, vaji, është ushqim kryesor për popullin dhe këto dy vjet, për shkak të mungesës së vajit, kemi kaluar dhe po kalojmë çaste të vështira. Organet e bujqësisë deri më sot nuk kanë bërë një studim të posaçëm për përmirësimin dhe përhapjen e kësaj kulture. Byroja Politike dhe qeveria e kanë shtruar dhe e shtrojnë me forcë shtimin e ullirit; është në studim e sipër edhe rajonizimi i tij. Partia jonë duhet të shohë qartë se përmirësimi dhe përhapja e kësaj kulture jo vetëm që do të sigurojë yndyrën kryesore për popullin tonë dhe lëndën e parë për sapunin, por do të jetë edhe një artikull me vlerë për eksportimet tona. Klima jonë është shumë e përshtatshme për rritjen e ullirit. Toka për zgjerimin e kësaj kulture ka shumë; mjafton t'u hedhim një sy zonave tona kodrinore që nga Mamurasi, Tirana, Elbasani, Berati, Mallakastra, Vlora e deri tutje.

Për përhapjen e kulturës së ullirit duhen mobilizuar masat e fshatarësisë sonë, duke i ndihmuar dhe

duke i vënë në garë kush të mbjellë dhe kush të shartojë më shumë ullinj.

Sivjet ka një plan më të madh se vitin e kaluar në sektorin e SMT-ve dhe për këtë duhet që punonjësit e saj të bëjnë më shumë përpjekje për mënjanimin e të metave që ekzistojnë akoma në këtë sektor, me gjithë përmirësimet e arritura më 1949. Akoma në shumë vende nuk respektohen kontratat me fshatarin, nën pretekste të ndryshme akoma nuk shfrytëzohen plotësisht traktorët. dhe nuk respektohen normat e konsumit të karburantëve. Organizimi dhe shërbimi i SMT-ve si edhe realizimi nga ana e tyre i planit në sasi, lloje dhe kohë, bashkë me sukseset që duhet të arrihen në fermat dhe në kooperativat bujqësore, duhet të jenë gjithmonë një nxitje e madhe për bujkun tonë që të organizojë më mirë punën dhe të pranojë më lehtë futjen e kriterëve të agroteknikës në bujqësi, të kujdeset më shumë për ngritjen e rendimenteve. Por SMT-të janë akoma larg nga objektivi që u ka caktuar Partia. Prandaj të shtohen gjithmonë e më shumë përpjekjet për një punë më të organizuar, për një disiplinë më të shëndoshë dhe për një kontroll dhe ndihmë më të vazhdueshme si edhe për një zbatim më të gjerë të kriterëve të agroteknikës nga SMT-të.

Fermat dhe kooperativat bujqësore, sektori bujqësor i shtetit dhe ai kooperativist duhet të bëhen shembull, mbasi ndodh që rendimentet, që arrihen në disa ferma dhe në disa kooperativa, janë më të ulëta se ato të sektorit privat. Kjo anomali duhet të marrë fund. Punonjësit e këtyre sektorëve duhet të jenë në garë të vazhdueshme ndërmjet tyre dhe në asnjë mënyrë nuk

duhet të pranojnë që në sektorin privat të bujqësisë të arrihen rendimente më të larta.

Blegtoria në përgjithësi gjatë vitit 1949 nuk ka dalë aq mirë për shkak të kohës së keqe: dimri 1948—1949 qe shumë i thatë dhe e ka dëmtuar mjaft. Ndërsa dimri 1949—1950 ka qenë mjaft i mirë për bagëtinë, megjithëse nuk përjashtohet të ketë pasur dhe humbje, për të cilat nuk kemi akoma të dhëna të sakta; ky fakt do të ketë efekt për shtimin e saj. Por ndarja e mirë e kullotave nga ana e organeve të bujqësisë, sigurimi gjithmonë e më i madh i foragjereve, shërbimet veterinare dhe mbajtja më e mirë e bagëtisë, duhet të jenë gjithmonë probleme për t'u zgjidhur shpejt dhe drejt. Vendi ynë ka shumë mundësi për të pasur një blegtori më të madhe dhe më të përparuar, pse populli ynë është marrë gjithmonë me të.

Blegtorinë është një nga bazat më të shëndosha të ekonomisë sonë. Industrializimi i vendit dhe përmirësimi i vazhdueshëm i nivelit të jetesës së masave tona punonjëse kërkojnë më shumë lesh, më shumë lëkurë, më shumë bulmet, më shumë mish.

Me zgjerimin e sipërfaqeve të mbjella, me nevojat që do të ketë për lesh fabrika e stofave të lehta, me nevojat gjithmonë e më të mëdha për qumësht që do të kenë qendrat tona të punës dhe qytetet, me nevojat që ka vetë bujqësia për gjedhë parmende dhe transporti dhe me nevojat e mëdha të vendit për lëkurë të trasha, para sektorit të blegtorisë shtrohen probleme të mëdha si përmirësimi i racës, i përpjesëtimeve ndërmjet llojeve të ndryshme: dele, dhi, lopë, qe, buaj dhe derra, kjo, e lidhur natyrisht edhe me larmitë topo-

grafike dhe klimaterike të vendit tonë. Eksperienca sovjetike duhet të na ndihmojë që ne ta vëmë në rrugë të drejtë këtë problem me kaq rëndësi.

Gjatë vitit 1949 është vënë në zbatim urdhëresa për seleksionimin e gjedhit të Shkodrës, urdhëresa për seleksionimin e lopës së Mursisë dhe urdhëresa për seleksionimin e dhisë «Saana» në Tiranë. Megjithëse nuk janë zbatuar si duhet këto urdhëresa, janë dukur shenjat e para të përmirësimit cilësor të bagëtive në këto zona.

Detyrë e madhe i takon në këtë çështje sektorit blegtoral të shtetit, në të cilin ka pasur dhe ka çrregullime dhe humbje të mjafta. Është e domosdoshme që këtij sektori t'i japim ndihmë më shumë dhe ta vëmë në rrugë të drejtë.

*Pyjet* paraqitin një problem shumë të madh, që e kemi ngritur dhe po e ngremë vazhdimisht.

Plani i pyllëzimeve të vitit 1949 është realizuar 102 për qind, ai i mbarështrimit të pyjeve është realizuar 186 për qind dhe plani i inventarizimit të pyjeve është realizuar 140 për qind. Pyjet që kemi përfaqësojnë një pasuri të konsiderueshme për vendin tonë, mbrojtja e tyre dhe ngritja e pyjeve të reja do ta shtojnë këtë pasuri. Në planin e sivjetëm ka investime për pyjet ekzistuese dhe për pyllëzime të reja. Më 1949 qeveria nxori një urdhëresë për shfrytëzimin e pyjeve dhe këtë vit nxori urdhëresën për mbrojtjen e pyjeve. Të dyja këto urdhëresa duhet të vihen në zbatim, pse po nuk u disiplinuan shfrytëzimi dhe mbrojtja e pyjeve, nuk mund të flitet për pyllëzim. Partia duhet të zhvillojë paralelisht shumë punë me masat për t'i bërë ato të ndërjegjshme për problemin e pyllëzimeve. Partia dhe

qeveria kanë në studim një plan perspektiv për zhvillimin e pyjeve në vendin tonë. Problemi më i madh për Partinë nuk është mobilizimi i masave për mbjelljen e pemëve. Për këtë kemi shembuj të shumtë në gjithë vendin tonë sepse për aksione të tilla masat punonjëse janë treguar të gatshme kurdoherë. Problemi kryesor qëndron te ruajtja dhe shërbimi, që duhet t'i bëhet nga masat e vendit tonë fidanit të ri që mbillet dhe që duhet të bëhet një pemë e madhe. Prandaj duhet të futim në popullin tonë dashurinë për pemët dhe ta bëjmë çdo qytetar një ruajtës të vendosur të çdo peme të re që mbjellim dhe një zbatues të ndërgjegjshëm të urdhëresave dhe të ligjeve të shtetit në këtë lëmë.

Po të krahasojmë sektorët e tjerë ekonomikë, si minierat, industrinë, ndërtimet, komunikacionet etj. me sektorin e bujqësisë, ne do të shohim se në këta sektorë puna e Partisë është më e lehtë, pse në ta problemet janë më të përcaktuara si në kohë ashtu edhe në vend, kurse në bujqësi janë më të ngatërruara, nga vendi në vend dhe nga koha në kohë. Përveç kësaj në këta sektorë kemi të bëjmë me masa më të ngritura, më të ndërgjegjshme, më të organizuara dhe më të disiplinuar. Këtu janë bazat më të shëndosha të Partisë, kurse në sektorin e bujqësisë kemi të bëjmë me masa më pak të ngritura, jo të tëra të organizuara dhe të disiplinuar. Prandaj, Partisë i bie një barrë më e madhe për të punuar në sektorin e bujqësisë, në fshat. Për mbarëvajtjen e prodhimeve të bujqësisë Partia duhet të vëjë mirë në lëvizje organizatën e Frontit, të Rinisë

dhe të Gruas dhe të bëjë çmos për ngritjen e bujkut tonë, duke e ndihmuar që të përmirësojë metodën dhe stilin në punë.

Emulacioni midis bujqve në të njëjtin fshat, garat ndërmjet një fshati dhe një fshati tjetër, një rrethi dhe një rrethi tjetër, se kush të realizojë më mirë planin e shtetit, kush të japë më shumë prodhime, kush të çelë më shumë toka të reja, kush të mbjellë më shumë ullinj, kush të shtojë më tepër numrin e derrave etj., sigurisht do të kenë efekt të madh, do të japin rezultate të kënaqshme dhe do të nxjerrin kuadro me vlerë për sektorin e bujqësisë.

Për t'ja arritur këtij qëllimi organet e bujqësisë në qendër dhe në rrethe duhet të konkretizojnë kudo anën teknike të garave e të ndihmojnë sa më shumë fshatarët dhe konkretisht në mënyrë që të fitojnë besimin, qoftë në rezultatet e garave, qoftë në ndihmën që u jepet.

## **GRUMBULLIMI I PRODHIMEVE BUJQËSORE E BLEGTORALE**

Në sektorin e grumbullimit janë bërë ndryshime rrënjësore si nga ana parimore ashtu edhe nga ana organizative. Problemi i grumbullimit u bë një problem i madh për Partinë dhe për qeverinë tonë.

U përcaktua drejt politika ekonomike e Partisë sonë në lidhje me grumbullimet. U vu në jetë një sistem i tillë, që siguron fondin shtetëror të grumbullimeve për furnizimin e qendrave të punës, të masave punonjëse

të qytetit dhe të ushtrisë dhe që nxit shtimin e prodhimeve bujqësore dhe blegtorale, duke ja bërë të qartë fshatarit punonjës perspektivën.

U ndërrua krejtësisht struktura e aparatit të grumbullimeve dhe u zbatuan forma të reja organizative të mbështetura në eksperiencën sovjetike.

Sot ky sistem grumbullimi, i bazuar në shkencën marksiste-leniniste dhe i provuar nga eksperiencia sovjetike, është kuptuar nga fshatari ynë punonjës, është pritur mirë prej tij dhe ka dhënë rezultate të kënaqshme jo vetëm sepse ka rritur në mënyrë të konsiderueshme fondin e grumbullimit të shtetit në krahasim me 1948-n, por edhe pse ka nxitur fshatarin të bëjë më shumë përpjekje për të gjetur burime të reja prodhimi.

Urdhëresa e grumbullimit të mishit ka luajtur një rol të rëndësishëm si në rritjen e fondit të grumbullimeve, ashtu dhe në përmirësimin e shtimin e blegtorisë. Me gjithë rezistencën që patëm në fillim, fshatari e kuptoi mirë këtë sistem dhe është përpjekur të marrë masat që t'i përgjigjet detyrimit, megjithëse urdhëresa doli me pak vonesë dhe e gjeti fshatarin të papregatitur. Në të ardhshmen e afërt, fshatari do të shikojë më qartë leverdinë e këtyrë urdhëresave, të cilat, e nxitin të shtojë burimet e të ardhurave të tija dhe të përmirësojë kushtet materiale të familjes së vet.

Kthesa e Partisë u ndie thellë edhe në sektorin e tregëtisë dhe të kooperativave, ku këtë vit janë bërë ndryshime të mëdha në furnizimin e punonjësve dhe në zbatimin e politikës ekonomike të Partisë.

Gjatë këtij viti Partia duhej të vendoste një sistem të atillë grumbullimi e furnizimi që të ndihmonte në

zhvillimin e bujqësisë dhe të blegtorisë, në shtimin e prodhimeve bujqësore për treg dhe në furnizimin sa më të mirë të qendrave të punës dhe të masave punonjëse të qytetit, të cilat po rriten çdo ditë e më tepër si rezultat i industrive të reja që po ngrihen dhe i objekteve të shumta që duhet të ndërtojmë.

Ky parim i rëndësishëm në politikën ekonomike të Partisë u konkretizua me vendimin e Komitetit Qendror dhe të qeverisë mbi sistemin e ri të grumbullimit dhe të furnizimit dhe ka pasur rezultate të kënaqshme në zbatimin praktik të tij nga organet e tregëtisë dhe të kooperativave.

Sistemi i ri i grumbullimit dhe i furnizimit forcoi marrëdhënjet fshat-qytet dhe konkretizoi rolin e madh të kooperativave të shitblerjes në zhvillimin e tregëtisë kolektive në fshat.

Sistemi i ri i grumbullimit dhe i furnizimit, i plotësuar me urdhëresën «mbi masat për zgjerimin dhe rregullimin e tregëtisë me prodhime bujqësore e blegtoriale në qytete e qendra industriale», i ka dhënë një hov të madh tregëtisë në fshat e qytet dhe i ka aktivizuar më tepër kooperativat. Megjithëse ka kaluar vetëm një periudhë kohe relativisht e shkurtër, efekti i këtyre urdhëresave të drejta të Partisë po ndjehet në mënyrë të dukshme me shtimin e prodhimeve bujqësore dhe me uljen e vazhdueshme të çmimeve në treg.

Këto sisteme të reja konkretizuan vijën e Partisë në lidhje me tregëtinë e vogël private, si ndihmëse të sektorit shtetëror kooperativist dhe kanë krijuar të gjitha mundësitë për aktivitetin e kësaj tregëtie, e cila do të ndihmojë në shtimin e prodhimit për treg dhe në



zhvillimin e konkurrencës ndërmjet asaj dhe sektorit shtetëror kooperativist. Si rezultat do të kemi jo vetëm më shumë prodhime në treg, por edhe çmime më të ulëta dhe një përmirësim të vazhdueshëm të konditave materiale të masave punonjëse.

Sistemi i ri i furnizimeve bëri diferencimin në mes të parazitëve dhe të punonjësve, krijoi mundësitë për nxjerrjen e fuqisë punëtore nga fshati e qyteti dhe e largoi fshatarin nga gjendja parazitare. U rishikua sistemi i çmimeve, që zbatohet për të gjitha prodhimet që grumbullon dhe shpërndan shteti, u konkretizua një politikë e drejtë çmimesh, e cila nuk ka ekzistuar më parë si rezultat i punës armiqësore të titistëve dhe të synimeve të tyre koloniale ndaj vendit tonë. U përcaktuan çmime të diferencuara duke u mbështetur në fuqinë blerëse të qytetit dhe të fshatit dhe në ndryshimin e kësaj fuqie blerëse në mes qytetit e fshatit.

Problemi i grumbullimeve lidhet shumë ngushtë me zhvillimin dhe përparimin e bujqësisë sonë, varet shumë nga realizimi i planit në bujqësi. Ky problem qëndron gjithmonë si një nga problemet kapitale për Partinë.

Plani i grumbullimeve për vitin 1950, kundrejt planit të po këtij viti sipas dyvjeçarit, paraqitet gjithashtu ku me ulje e ku me ngritje. Eksperiencat e vitit 1949 ka qenë edhe këtu faktori kryesor për të hartuar një plan sa më real, sado që, siç e përmendëm, ky varet kryekëput nga viti bujqësor, pse në grumbullimet peshën kryesore e mbajnë prodhimet bujqësore dhe blegtorale. Në krahasim me realizimin e planit të grumbullimeve të vitit 1949, më 1950 parashikohen kudo rritje.

Në përgjithësi grumbullimet tona kanë lidhje vetëm

me një numër të vogël prodhimesh të dorës së parë për jetesën e punonjësve të qendrave të punës dhe të qyteve tona. Mbi këto grumbullime mbështeten pjesërisht edhe eksportimet tona. Eksperienca e viteve të kaluara tregon se organet e ngarkuara posaçërisht me këtë problem kaq të rëndësishëm nuk e kanë gjetur akoma rrugën e një organizimi të mirë të punës, e një ndjekjeje më sistematike të problemeve, e një parashikimi më të drejtë dhe me kohë të masave që duhen marrë për këtë ose atë grumbullim, për këtë ose atë depozitim materiali etj. etj.

Përpara punonjësve të grumbullimit shtrohet, pra, problemi i madh që të organizojnë mirë punën e tyre, të ndjekin vazhdimisht zhvillimin e punës në fshat, duke qenë këtu të ndihmuar sa më shumë nga organet e bujqësisë, me të cilat duhet të bashkëpunojnë vazhdimisht. Më duket se organet e grumbullimit duhet të mbajnë kontakte të shpeshta me bujqit dhe jo të shihen me ta vetëm kur u lëshojnë fletën e detyrimit dhe pastaj kur venë të kërkojnë prodhimin. Në rast se do t'i përforcojnë lidhjet me bujkun, ata, veç faktit që do të shohin me sy si shkon rritja e bimëve, do të mund të ndihmojnë edhe fshatarin, duke kërkuar nga teknikët e bujqësisë që t'i japin këtij më shumë ndihmë me këshilla agroteknike ose me vegla, me pleh kimik e me kredit agrar; ata do të mundin të tërheqin edhe vëmendjen e këshillit të fshatit kur njëri bujk ose tjetri nuk i bën si duhet shërbimin grurit, mîsrit ose pambukut, nuk i korr, i lë të kalben e të tjera e të tjera. Me pak fjalë, punonjësit e grumbullimit ta ndjejnë mirë përgjegjësinë e madhe që u ka ngarkuar Partia, prandaj

dhe duhet ta realizojnë planin e grumbullimeve në sasinë dhe në kohën e planifikuar për të mos e vënë Partinë dhe pushtetin përpara situatash të vështira. Ata kanë urdhëresat dhe kontratat përkatëse, të cilat fshatari i ka kuptuar shumë mirë. Eksperienca e vitit 1949 të jetë për ta një forcë e madhe, që t'i nxitë për një punë më të shëndoshë, më të disiplinuar, më me baza dhe më të studjuar. Me bukën e popullit nuk mund të luajmë, as me furnizimin e rregullt të qendrave tona të punës, të ushtrisë sonë, të masave të qytetit me mish, me fasule, me oriz dhe me vezë; nuk mund të luajmë as me entuziazmin e punëtorisë sonë për realizimin e planit në lëkurë dhe në këpucë, i cili varet nga furnizimi me lëkurë në sasi, cilësi dhe kohë të planifikuar. Po kështu s'ka si të pranohet që ne të ndryshojmë planet me shtetet miq në lidhje me angazhimet tona, pse lëkurët, pambuku, lulja e diellit etj., nuk grumbullohen në sasi, në cilësi dhe në kohë.

Depozitimi dhe ruajtja e prodhimeve pas atij të grumbullimit duhet të jenë preokupacioni më i madh. Vjet Partia dhe pushteti u ndodhën përpara situatash shumë të vështira në këtë drejtim, megjithëse nuk ishte viti i parë që grumbulloheshin prodhime. Sigurisht, këtu ka neglizhenca të mëdha që nuk duhet të tolerohen më. Është e vërtetë se sivjet janë marrë masa për ndërtimin e depove, por kjo nuk e zgjidh akoma problemin. Prandaj duhet të merren masat me kohë që të mos na shkojnë prodhimet dëm. Të mendohet për depo të thjeshta dhe të kërkohen vende për depo. Prandaj është krijuar një aparat i posaçëm nga Partia që të zgjidhë mirë dhe me kohë problemet që i takojnë.

Punonjësit e grumbullimit duhet të preokupohen seriozisht edhe për trajtimin e gjësë së gjallë që grumbullojmë për llogari të taksës së mishit. Nga trajtimi i keq që u është bërë këtyre bagëtive, vitin e kaluar ne kemi pasur humbje ekonomike dhe kjo për shkak se bagëtitë janë dobësuar dhe kanë rënë në peshë. Por kemi pasur edhe humbje politike, mbasi populli krahason mishin që shitet në tregun e shtetit me atë të tregut privat dhe, logjikisht, ai tërhiqet nga ai që është më i majmë, duke preferuar ta blejë edhe pak më shtrenjtë, sepse mishi i majmë nuk kërkon yndyrë të veçantë, siç kërkon ai i dobëti. Kjo ka ndodhur dhe ndodh në një kohë, kur problemi i yndyrnave ngrihet me forcë nga Partia dhe qeveria si një problem i madh. Prandaj është e domosdoshme që kësaj gjendjeje t'i jepet fund, duke marrë masat me kohë. Eksperienca e vitit të kaluar të na shërbejë jo vetëm për të mos humbur as ekonomikisht e as politikisht në këtë sektor, por në të kundërtën ne duhet të fitojmë nga shtimi i peshës e i majmërisë dhe popullit t'i shërbehet më mirë dhe më lirë. Nga ana tjetër, punonjësve të grumbullimit nuk u ngarkohen vetëm detyrat për grumbullimet e detyrueshme, në bazë të urdhëresave dhe të kontratave. Ata duhet të luftojnë edhe për grumbullimin e tepriçave, të cilave Partia dhe qeveria u kanë kushtuar kujdes të posaçëm. Për blerjen e tyre ato kanë nxjerrë dhe nxjerrin dispozita të veçanta. Pra, duhet ta kuptojmë mirë rëndësinë e madhe të grumbullimit të tepriçave, të cilat destinohen për të rritur sa më shumë fondet shtetërore duke plotësuar me to boshllëqet që mbeten nga një prodhim akoma shumë i paktë në kra-

hasim me nevojat e ndryshme të popullatës. Kjo vlen dhe për ato prodhime që grumbullon sektori i industrisë siç janë ulliri, duhani, panxhari i sheqerit etj.

Vëllimi i punës që i cakton plani i vitit 1950 sektorit të tregëtisë është më i madh nga ai që u realizua në këtë sektor gjatë vitit të kaluar. Xhirua parashihet të jetë 49 për qind më e madhe nga sa u realizua vjet.

Sigurisht, që të realizohet plotësisht kjo xhiro, duhet të realizohet njëkohësisht plani i 1950-s sidomos në sektorët e prodhimeve, të grumbullimit dhe të importit, pse këtej dalin mallrat që shpërndan tregëtia. Është e qartë se një pjesë e prodhimeve varet nga realizimi i investimeve. Si konkluzion del se realizimi i planit të shpërndarjes kushtëzohet nga realizimi i planit në gjithë sektorët e tjerë.

Në të gjithë artikujt që parashikohen në plan për t'u shpërndarë ka një rritje të konsiderueshme, gjë që tregon se në treg do të ketë prodhime më shumë dhe sigurisht, kjo sjell me vete dhe ulje çmimesh në tregun e lirë.

Si rezultat i këtyre sukseseve Republika jonë mundi të dalë lirisht në tregun e jashtëm. Në të kaluarën kjo na qe ndaluar nga politika kolonizuese që agjentët e Beogradit i kishin imponuar Republikës sonë. Ne lidhëm marrëveshje tregëtare me Bashkimin Sovjetik dhe me demokracitë popullore motra. Këto marrëveshje synojnë të gjitha në forcimin e marrëdhënjeve ndërmjet shteteve të kampit socialist, pra, në forcimin e frontit të paqes dhe të socializmit, por mbi të gjitha synojnë që të ndihmojnë ngritjen e ekonomisë popullore të Shqipërisë.

Këto marrëveshje janë dy llojesh: marrëveshje për

dhënje mallrash me kredit dhe marrëveshje për shkëmbim mallrash. Importimet e mallrave sipas këtyre marrëveshjeve përbëjnë bazën kryesore për ngritjen e industrisë sonë, për shfrytëzimin e minierave tona dhe për fuqizimin e transportit. Nga ana tjetër, këto importime kanë luajtur një rol të madh për financat tona dhe për furnizimin e tregjeve tona me mallra të konsumit të gjerë, duke kontribuar në mënyrë të ndieshme në përmirësimin e jetesës së masave tona punonjëse dhe, bashkë me politikën e re të furnizimit dhe të çmimeve të vendosura nga Partia dhe qeveria më 1949, kanë ndikuar edhe në uljen e çmimeve në tregun e lirë.

Por me anë të këtyre marrëveshjeve shteti ynë ka marrë edhe një sërë angazhimesh: të japë me shkëmbim pjesërisht prodhimet e minierave tona dhe disa prodhime bujqësore e blegtorale.

Bashkimi Sovjetik në radhë të parë dhe të gjitha demokracitë e tjera edhe këtë vit ju përgjegjën kërkesave tona për kredi të reja. Në këtë ndihmë mbështeten pjesërisht dhe planet tona të investimit e të furnizimit të popullsisë. Mosrealizimi i prodhimit nga ana jonë në vitin e kaluar, sidomos në naftë, bitum, bimë industriale dhe bakër, na ngarkon me detyrime edhe më të mëdha. Prandaj mbi ne rëndon përgjegjësia e madhe që të realizojmë qind për qind planin e 1950-s dhe bile të bëjmë përpjekje për tejkalimin e tij me çdo kusht.

Problemi për realizimin e eksportimeve tona dhe për rritjen e tyre të vazhdueshme është problem kyç i ekonomisë, nga i cili varen përmirësimi i jetesës së masave tona, forcimi i Republikës sonë dhe përforcimi gjithmonë e më i madh i lidhjeve me Bashkimin

Sovjetik, që na jep ndihmën më të madhe në çdo drejtim, dhe me gjithë republikat e tjera popullore, të cilat na ndihmojnë për ngritjen e ekonomisë sonë dhe për shkuarjen bashkë me to në socializëm.

### MBI PREGATITJEN E KUADROVE PËR REALIZIMIN E DETYRAVE TË PLANIT

Pregatitja e kuadrove për realizimin e këtij plani, siç e dimë të gjithë, ka një rëndësi të dorës së parë. Dimë, nga ana tjetër, se në çastet që kalojmë hasim në vështirësi të mëdha për mungesë të kuadrove teknikë, specialistë dhe të kualifikuar. Dhe nuk mund të jetë ndryshe. Vendi ynë pas çlirimit u ndodh para detyrash shumë të mëdha, të cilat kërkonin kuadro të lartë teknikësh, kuadro specialistë dhe të kualifikuar në një numër të madh për të ndërmarrë ndërtimin e shkatërrimeve të luftës dhe sidomos ndërtimin e një shoqërie të re socialiste. Këta kuadro qoftë si numër, qoftë si cilësi na mungonin. Por Partisë sonë, Parti revolucionare dhe heroike, nuk ju tremb syri dhe ndërmori me guximin që e karakterizon ndërmarrjen e madhe. Dhe pati suksese. Në këtë luftë, si në çdo luftë dhe përpjekje, që ishte shumë e ashpër për shkak të mungesës së madhe të teknikëve, nuk na ka munguar ndihma e Bashkimit të madh Sovjetik. Teknikë të lartë sovjetikë na kanë ndihmuar dhe na ndihmojnë me gjithë zemër. Teknikë të tjerë sovjetikë do të vijnë për të na ndihmuar gjithnjë e më shumë, derisa nga shkollat e larta të Bashkimit Sovjetik dhe të republikave demokratike

popullore të kenë mbaruar qindra të rinj, që kanë shkuar atje për të marrë dijenitë teknike dhe shkencore.

Gjatë këtyre pesë viteve të çlirimit me qindra teknikë të mesëm kanë mbaruar shkollat në teknikumet dhe në kurset tona të shpejta; me mijëra punëtorë të kualifikuar kanë dalë në punë e sipër dhe nga kurse të shpejta. Dhe sot e gjithë barra e zbatimit të punës teknike dhe të kualifikuar rëndon mbi shpatullat e këtyre teknikëve, specialistëve dhe punëtorëve të kualifikuar të dalë nga klasa jonë punëtore heroike dhe nga rinia jonë entuziaste.

Janë duke u kryer vepra teknike dhe duke u ngritur ndërmarrje, të cilat do të jenë monumente të pavdekshme që ngre Partia jonë e lavdishme dhe populli ynë heroik me ndihmën e të madhit Stalin; njëkohësisht këto vepra janë mburrja e meritueshme e klasës sonë punëtore dhe e popullit tonë punëtor, trim dhe paqdashës që me guxim ndërmerr ndërtimin e veprave të vështira si Hidrocentrali i Selitës, Kombinati «Stalin», fabrika e sheqerit, Spitali i Gjirokastrës, Porti i Durrësit, Uzina «Enver», kantieri detar, Vajgursjellësi Patos-Vlorë, hekurudha e të tjera e të tjera monumente si këto.

Por e vërteta është se përsa u përket specialistëve dhe teknikëve të mesëm e të ulët jemi gjithmonë në deficit edhe si numër, përveç faktit që si cilësi çalojmë shumë. Do të na duhen me mijëra kuadro të tillë brenda pak viteve, prandaj problemi i madh i rritjes së vazhdueshme të radhëve të teknikëve të mesëm, të specialistëve dhe të punëtorëve të kualifikuar si dhe perfeksionimi dhe ngritja profesionale e atyre që janë përgatitur deri më sot, qëndron gjithmonë në rendin e ditës



për të gjithë Partinë. Kjo çështje nuk është ndjekur deri më sot me preokupacionin që meriton; shumë është bërë në këtë drejtim, por kishte mundësi që, me një kujdes më të madh dhe me një organizim më të mirë, të bëhej më shumë. . .

Zhvillimi gjithmonë e më i madh i ekonomisë sonë dhe paralelisht i kulturës dhe i mirëqenjes së masave punonjëse, zbatimi i planeve tona perspektive, që do ta çojnë Republikën tonë Popullore në socializëm, kërkohet që ne të marrim të gjitha masat për zgjidhjen e këtij problemi kaq të madh për Partinë dhe për popullin tonë; nuk duhet të lejohet asnjë fije pakujdesie në planifikimin e përgatitjen e kuadrove që na duhen për zhvillimin e ekonomisë e të kulturës.

Prandaj, të forcohen gjithmonë e më shumë shkollat tona të mesme, politeknikumi dhe teknikumet e tjera, të shtohen radhët e nxënësve të këtyre shkollave me të rinj e të reja të ardhur nga shtresat e punëtorisë dhe të fshatarësisë sonë të varfër dhe të mesme. Të ngrihet sa më parë që të jetë e mundur shkolla e rezervave të punës që ka në studim qeveria dhe të dërgohen në shkollat e larta të Bashkimit Sovjetik dhe të demokracive popullore, kuadro, nga radhët e të rinjve dhe të të rejave, nga më të mirët dhe më besnikët.

### SIGURIMI I FUQISË PUNËTORE

Për realizimin e planit të vitit 1950 nevojat për fuqi punëtore janë 60 për qind më shumë punëtorë nga sa ka kërkuar realizimi i planit të vitit 1949. Vetëm ndër-

timet, që ka në planin e saj Ministria e Punëve Botore, janë 49 për qind më të larta se realizimi i 1949-s. Po kjo gjë ndodh përafërsisht me ndërtimet që kryejnë vetë Ministria e Bujqësisë, e Industrisë, e Tregëtisë, e Mbrojtjes, e Komunikacionit dhe komitetet ekzekutive të këshillave popullore të rretheve. Po kështu planet e shfrytëzimit dhe të kërkimeve në minierat tona kërkojnë më shumë punëtorë se më 1949, po ashtu edhe bujqësia për punimet e saj dhe me radhë Komiteti i Grumbullimit, kooperativat tregëtare etj.

Më 1949 janë hasur shumë vështirësi në realizimin e planit të fuqisë punëtore në numër dhe në kohën e duhur. E gjithë Partia ka qenë e mobilizuar për këtë problem dhe në gjashtëmuorin e dytë janë arritur rezultate më të mira. Por ky problem qëndron gjithmonë i madh dhe duhet të hyjë në rrugën e zgjidhjes së drejtë. Partia duhet ta shikojë mirë këtë çështje. Kërkesat për punëtorë të thjeshtë dhe të kualifikuar, ashtu siç u tha më sipër kur u fol për kuadrot teknikë, do të vijnë nga viti në vit duke u shtuar. Nga disa studime që ka bërë Komiteti Qendror mbi ritmin se si do të shtohen kërkesat për punëtorë të thjeshtë dhe të kualifikuar në vitet e ardhshme, deri më 1955, ky ritëm pasqyrohet nga këto përqindje: po të marrim realizimin e vitit 1949 baras me 100 për qind, më 1950 kërkohen 160 për qind, më 1951 kërkohen 190 për qind, më 1952 kërkohen 230 për qind, më 1953 kërkohen 255 për qind, më 1954 kërkohen 285 për qind dhe më 1955 — 305 për qind.

Plani i ardhshëm perspektiv është i përcaktuar nga vijat e politikës ekonomike të Partisë sonë, të caktuar nga Kongresi I, nga lufta që ka bërë populli ynë për

çlirim dhe nga përpjekjet që ka bërë në këto pesë vjet për ndërtimin e vendit. Ky plan do të ndjekë këto vija dhe rrugën që e çon vendin tonë në socializëm dhe sigurisht do të karakterizohet nga një rritje e vazhdueshme e investimeve dhe e zhvillimit të sektorëve prodhues të vendit tonë: miniera, industri, bujqësi etj. Ky plan patjetër do të kërkojë një angazhim forcash më të mëdha dhe për këtë Partia jonë duhet të përgatitet duke marrë të gjitha masat.

1) Mbi të gjitha duhet të mbahet gjithmonë parasysh nga organet tona shtetërore që t'u përmirësohen punëtorëve sa më shumë kushtet e jetesës në qendrat e punës.

2) Organizatat e Partisë dhe të masave të bëjnë sa më shumë përpjekje për edukimin politik dhe kultural të punëtorëve tanë në qendrat e punës.

3) Bashkimet profesionale të organizojnë mirë dhe në çdo qendër pune ngritjen tekniko-profesionale të punëtorëve tanë.

4) Organet e tregëtisë të zbatojnë pikë për pikë vendimet e qeverisë mbi furnizimin e familjeve të punëtorëve si dhe të vetë punëtorëve në qendrat e punës me veshmbathjen që u takon.

5) Të shtohen përpjekjet për tejkalimin e normave të punës me anë të garave dhe të emulacionit socialist dhe në asnjë sektor të mos lejohet që të punohet pa norma.

6) Të planifikohen drejt dhe në bazë normash nevojat për fuqi punëtore që nga ndërmarrjet, komitetet ekzekutive të këshillave popullore dhe deri në Komisionin e Planit.

7) Të bëhen më shumë përpjekje për futjen e gruas në të gjithë sektorët e prodhimit. Në çdo qendër pune ka kurdoherë punë të përshtatshme për gruan.

8) Të bëhet një planifikim më i drejtë i nxjerrjes së fuqisë punëtore nga rrethet e ndryshme.

9) Të bëhet çështje nderi dhe patriotizmi pjesëmarrja e çdo qytetari në sektorët shtetërorë të prodhimit dhe të ndërtimit.

10) Të mos harrohet kurrë nga organet e Partisë dhe të pushtetit në bazë se realizimi i planit të nxjerrjes së fuqisë punëtore sidomos në kohën e planifikuar është garancia më e madhe për realizimin e planit tonë. Nga statistikat që disponojmë del se në vendin tonë ekziston fuqia punëtore jo vetëm për planin e 1950-s, por edhe për planet perspektive më të mëdha.

### **LUFTA PËR ULJEN E KOSTOS SË PRODHIMIT**

Realizimi i planit do të thotë realizimi i të ardhurave shtetërore, domethënë rritje e vazhdueshme e pasurisë së popullit dhe e fuqisë blerëse të lekut. Mosrealizimi i planit të vitit 1949 efektin e parë e ka pasur në financat tona, të cilat nuk kanë realizuar të ardhurat nga tatimi mbi xhiro, që është një nga bazat e sistemit tonë financiar, pse financat tona nuk janë të tipit borgjesh. Këto të fundit, siç e dini, mbështeten në taksat direkte dhe indirekte që nxirren nga masat punonjëse të shtypura dhe të shfrytëzuara, ndërsa financat tona mbështeten kryesisht në realizimin e planit të ndërmarreve shtetërore, si dhe në ndihmën e jashtme që na

vjen nga Bashkimi Sovjetik në radhë të parë dhe nga demokracitë popullore. Vitin e kaluar të ardhurat e parashikuara nga importimet u realizuan 100 për qind, ndërsa ato të parashikuara nga tatimi mbi xhiron u realizuan 86 për qind.

Problem i madh gjithmonë për kuadrot e Partisë është ulja e kostos së prodhimit. Këtu pasqyrohen të gjitha përpjekjet: kursimi i materialeve, ulja e normativave të konsumit, reduktimi i organikave, tejkalimi i normave të punës, plotësimi i punës brenda 8-orëshit dhe pa qenë nevoja për punë jashtë orarit, racionimi i fortë i fuqisë punëtore në ndërtim dhe në prodhim, zbatimi i metodave të reja në punë, shfrytëzimi racional i maqinerisë dhe i rezervave tona, pakësimi i shpenzimeve inproduktive, organizimi i shëndoshë në punë, ndjekja sistematike e anës kontabile të punës, respektimi i kontratave etj. Fatkeqësisht në këtë problem kyç të ekonomisë sonë, me gjithë përmirësimet aty-këtu, jemi akoma shumë prapa. Akoma nuk është vendosur ndër ne një regjim i fortë kursimi në çdo sektor, akoma kursimi nuk po bëhet një cilësi e masave punonjëse.

Është e vërtetë se njerëzit tanë kanë fituar një eksperiencë në analizat e kostove dhe se drejtuesit e ndërmarrjeve kanë filluar të preokupohen diçka më shumë se më parë për koston. Por akoma punohet shumë pak për uljen e kostos.

Është e domosdoshme që kostot e prodhimit të aprovuara nga qeveria të ndiqen vazhdimisht nga organet qendrore, duke bërë kontrolle të posaçme dhe të shpesh-ta në vend dhe duke u dhënë ndihmën më të madhe

kuadrove tanë për ta kuptuar mirë këtë problem. Duhet ta kuptojmë mirë se objektivi kryesor i ekonomisë, që është rritja e vazhdueshme e prodhimit, është i kushtëzuar nga mostejkalimi i shpenzimeve të kostos. Ulja e vazhdueshme e kostos, që do të thotë kursim, jep mundësi për investime të reja, të cilat shtojnë mirëqenjen ekonomike dhe kulturele të popullit. Por ulja e kostos është e lidhur edhe me fuqinë blerëse të popullit. Po të ulët kostoja, do të ulen çmimet dhe populli do të blejë më shumë.

Që të arrihen rezultate më të mira në uljen e kostos është e domosdoshme që plani i kostos, ashtu si dhe plani i prodhimit, të shtrohen përpara punëtorëve duke u zbërthyer deri në zërin më të thjeshtë të tyre. Po nuk ju analizua si plani i prodhimit, ashtu edhe ai i kostos atij që do ta realizojë dhe po nuk e kuptoi mirë këtë çështje punëtori, nuk ka si të kemi realizime plani në kohë, në sasi, në cilësi dhe në kosto. Po nuk u bë metodë pune dhe detyrë më kryesore zbërthimi i planit përpara punëtorëve, nuk do të kemi atë entuziazëm, atë heroizëm, atë novatorizëm dhe atë sasi e cilësi prodhimi që do të kishim, kur të bëhej i ndërgjegjshëm punëtori ynë mbi atë që përfaqësojnë zërat e ndryshëm të planit të prodhimit dhe të atij të kostos.

Eksperienca është shumë e hidhur në lidhje me koston. Ky problem, zakonisht shikohet nga ministrinë dhe nga ndërmarrjet vetëm dy herë në vit: një herë kur përgatitet buxheti dhe një herë kur mbyllet buxheti. Është e vërtetë se ka vështirësi teknike për të kontrolluar me saktësi në çdo kohë koston e vërtetë, por kjo nuk po bëhet as për afërsisht, gjë që është e mundur.

Kjo tregon nënvleftësimin që ekziston për sektorin bazë të ekonomisë sonë. Organeve të Komisionit të Planit dhe të Ministrisë së Financave në radhë të parë u bie përgjegjësia më e madhe për kontrollimin e vazhdueshëm të realizimit të kostove. Ministrive, ndërmarrjeve dhe gjithë punonjësve të tjerë të sektorit ekonomik nuk u bie më pak përgjegjësi për mosrealizimin e drejtë të planeve të koston.

### **TË ORGANIZOJMË KONTROLL TË RREPTË NGA LART DHE NGA POSHTË**

Para se të mbaroj këtë pjesë të raportit mbi çështjet ekonomike dëshiroj të vë në dukje një sërë të metash që janë konstatuar në punët tona, me qëllim që këto të na shërbejnë në të ardhshmen e të mos përsëriten.

Kontrolli duhet të jetë i organizuar e i rreptë si nga lart, ashtu edhe nga poshtë dhe të goditen pa mëshirë të gjithë ata që dëmtojnë ekonominë e vendit tonë dhe realizimin e planit. Komisioni i Kontrollit të Shtetit duhet të veprojë energjikisht.

Nga kontrollet e bëra më 1949 dhe në këtë tremujor janë konstatuar dëme në materiale dhe në mjete financiare, moszbatim të urdhërave dhe të vendimeve të qeverisë, të meta serioze në punën e shumë organizatave ekonomike, që e kanë burimin kryesisht në mosorganizimin e mirë të punës, në radhë të parë në vetë dikasteret përkatëse, në mosngritjen me forcë të përgjegjësisë personale, në mungesën e kontrollit dhe

të ndihmës për kuadrin nga ana e dikastereve, në mungesën e kontrollit për verifikimin e zbatimit të urdhërave dhe në shfaqjet burokratike që ndihen akoma shumë në disa organe qendrore.

Në këto kushte shpërdorimet, abuzimet dhe puna e armikut ka mundur të kryhet më lehtë, me pasoja të dëmshme në punën për realizimin e planit të shtetit dhe duke dëmtuar rëndë ekonominë.

Nga analiza mbi realizimin e buxhetit të shtetit del që si të ardhurat, ashtu edhe shpenzimet nuk janë realizuar sipas parashikimeve vjetore të buxhetit të shtetit. Arësyet e mosrealizimit të të ardhurave janë nga moszbatimi i planeve të prodhimit dhe të shpërndarjes dhe ato të mosrealizimit të shpenzimeve nga mosplotësimi i një pjese të investimeve dhe të eksportimeve. Në disa artikuj ka pasur tejkalim shpenzimesh. Kjo, për një pjesë të vogël, vjen pse parashikimet nuk kanë qenë të sakta, por ajo që duhet theksuar më shumë është se gati në të gjitha ndërmarrjet nuk ka pasur një regjim të fortë kursimi, gjë që ka lejuar shpenzime të tepërta. Vendosja e një regjimi të fortë kursimi, ashtu si e ngre Partia me forcë, është një problem, për të cilin duhet të bëhen akoma shumë përpjekje. Një çështje tjetër kryesore, që duhet të shikohet me kujdes, të përmirësohet dhe të forcohet, është çështja e disiplinës në punë, mungesa e së cilës ka penguar shumë në moskryerjen e detyrave dhe në bërjen e gabimeve, nga të cilat shteti ka pasur humbje.

Nga një burokratizëm i theksuar dhe mungesë operativiteti, nga lëshimet ndaj disiplinës në punë, nga mosvënja e njerëzve para përgjegjësisë, nga mosstu-



dimi i drejtë dhe mos organizimi i mirë i punëve që në qendër, në sektorin e bujqësisë, qoftë vitin e kaluar, qoftë në këtë tremujor, janë konstatuar gabime të rënda dhe dëme të rëndësishme. Siç dihet edhe vitin e kaluar fermat dhe kooperativat e punës për mungesë ndihme nga lart nuk kanë shkuar mirë, ndërsa edhe sektori privat nuk është ndihmuar në bazë të vijës së Partisë dhe të dispozitave të qeverisë. Përveç kësaj në sektorin e blegtorisë vetëm në 7 muajt e 1949-s ka pasur një humbje prej rreth 12 000 kokë bagëti, që përbëjnë 14 për qind të gjithë numrit të dhenve dhe 9 për qind të atij të dhive. Po në ndërmarrjet blegtorale nga shpërdorimi dhe shitja jo e drejtë e produkteve të tyre ka pasur një humbje prej 10 milion lekësh. Megjithëse qeveria ka marrë vendime të posaçme lidhur me këtë gjendje, prapë nga kontrolli i bërë dy ndërmarrjeve, krerët e humbura gjatë vitit 1949 arrijnë në 5 574, gjë kjo që përbën 21 për qind të inventarit të njërës ndër-marrje dhe 11 për qind të tjetrës.

Mosorganizimi i mirë i punëve në SMT-të në vitin e kaluar dhe mungesa e kontrollit ka bërë që rendimenti i tyre të jetë nën nivelin e duhur, qoftë si sasi, qoftë si cilësi. Por SMT-të edhe këtë vit nuk kanë qenë shumë në rregull megjithëse planet e tyre ishin shumë të vogla. Kështu SMT-ja e Kavajës nuk është në rregull qoftë nga gatishmëria e traktorëve për punë, qoftë nga çrregullimet e brendshme që e detyrojnë të mos respektojë kontratat me fshatarët, kurse drejtori i SMT-së në Kavajë, për t'i shpëtuar përgjegjësisë, ka falsifikuar datat e kontratave.

Gjithashtu në sharrat e Pukës, vetëm në periudhën

që kanë qenë nën administrimin e Ministrisë së Bujqësisë, janë vërtetuar çrregullime financiare dhe humbje në një shumë prej 10 milion lekësh. Përgjegjësia këtu, përveç udhëheqjes së Ministrisë së Bujqësisë i bie vetë drejtorit që ka drejtuar atje për një kohë të gjatë. Mbas gjithë këtyre edhe në këtë tremujor janë zbuluar dëme të rënda, për të cilat ka përgjegjësi vetë udhëheqja e ministrisë, ndihmësministrat dhe vartësit e tyre direkt si kryetari i degës së fermave dhe drejtori i fermës së Sukthit për ngordhjen e 550 krerëve dhi. Edhe për prishjen e 521 kv. farë pambuku në Fier ka përgjegjësi kryetari i degës së farërave të Fierit.

Për të furnizuar Tiranën me qumësht Ministria e Bujqësisë në maj të vitit të kaluar ka dërguar në Sukth 4 000 krerë dhi dhe në shtator 1 000 të tjera. Nga moskujdesia dhe mosstudimi i mirë i çështjes prej ministrisë dhe nga mosmarrja e masave me kohë, këto 5 000 dhi janë mbajtur në kushte shumë të këqia dhe kanë pësuar humbje të mëdha, qoftë nga ngordhjet, qoftë pse në to është përhapur sëmundja dhe si pasojë ka rënë në peshë. Nga ana tjetër nuk kanë pasur asnjë lloj strehimi gjatë gjithë dimrit dhe kanë pasur mungesë të madhe ushqimi. Ministria nuk e ka studjuar mirë nëse mund të mbahet një kope e tillë në Sukth, ku dihet se nuk ka mera dhish, nuk ka marrë masa izolimi dhe mjekimi për dhitë e sëmura dhe aq më pak për të rregulluar strehimin dhe ushqimin e tyre. Gjithashtu edhe pse e dinte këtë gjendje të vështirë, nuk ka ndihmuar drejtorinë e fermës për ta zgjidhur këtë çështje.

Në Fier nga pakujdesia e njerëzve të ngarkuar me ruajtjen e farës së pambukut dhe nga mungesa e kon-

trollit në kohën e duhur nga ana e ministrisë për sigurimin dhe ruajtjen e kësaj fare, janë gjetur këto ditët e fundit 521 kv. farë të prishur pambuku që nuk mund të përdoret për mbjellje.

Çështja e ndihmës që dikasteret duhet t'u japin organeve të tyre, qoftë për t'i udhëzuar, qoftë për të kontrolluar zbatimin e urdhërave, është e dobët. Kjo mungesë krijon një atmosferë lëshimi dhe pakujdesie në kryerjen e detyrave, dobëson disiplinën e punës dhe u lë shteg humbjeve dhe shpërdorimeve në materiale dhe në mjete financiare. Në përgjithësi del se kontrolli dhe revizionet e bëra nga dikasteret vetë ose nga ndërmarrjet nuk kanë qenë të thelluara dhe nuk kanë zbuluar të gjitha të metat. Në të vërtetë ka një lëvizje shumë të madhe njerëzish nga dikasteret poshtë, por rezultatet e këtyre kontrolleve nuk janë të kënaqshme. Shumica e dëmeve konstatohen pasi janë bërë dhe një pjesë nuk konstatohen fare. Një kontroll më i mirë mbi njerëzit dhe vënja e tyre përpara përgjegjësisë do ta përmirësonin shumë punën e kontrollit. Ministria e Bujqësisë ka bërë kontrole dhe revizione në sharrat e Pukës, në SMT-të e Kavajës e të Vlorës dhe në ndërmarrjet blegtorale. Ministria e Industrisë ka bërë kontroll shumë të sipërfaqshëm në shtypshkronja dhe në miniera, por ka munguar zbulimi i të metave kryesore dhe marrja e masave të menjëhershme qoftë për rregullimin administrativ të ndërmarrjeve, qoftë për jetën e punëtorëve, qoftë për dënimin e fajtorëve. Këto të meta kanë qenë akoma më të mëdha dhe në rendin e ditës në sektorin e industrisë, ku nga mungesa e kontrollit, e ndihmës dhe e operativitetit, udhëheqja nuk

ka qenë në gjendje të luftojë dhe, siç doli më vonë nga analiza që i bëri punës Partia, vetë udhëheqja është shkaktare e dëmeve dhe e sabotimeve që janë bërë në këtë sektor. Në të gjitha ndërmarrjet industriale, që janë kontrolluar ka pasur gabime të rënda si për trajtimin e punëtorëve, siç është rasti në shumë miniera, ashtu dhe për organizimin e keq të punëve. Në Gomisterinë e Durrësit ka pasur një punë të çorganizuar dhe prodhim me një cilësi shumë të dobët. Për prodhimin e vozave ministria nuk ka treguar kujdesin e duhur për realizimin e planit. Në shtypshkronjat e Tiranës ka pasur dëmtime dhe shenja të një pune armiqësore, por ministria nuk është kujdesur asnjëherë. Në ofiçinat e Shkodrës kostoja ngrihej vazhdimisht për arsye të çrregullimeve në punë, të harxhimit të kotë të materialit e të fuqisë punëtore dhe për cilësi të dobët.

Nga kontrolli në shtypshkronjat e Tiranës doli se atje ka abuzime, shpërdorime materiali, thyerje të rëndë të disiplinës në punë dhe shenja të një pune armiqësore. Plani i aprovuar nga qeveria për vitin 1949 dhe që i ka shkuar ministrisë në muajin qershor nuk i është njoftuar fare ndërmarrjes. Ndërmarrja ka punuar me dy plane të tjera, njëri i dhënë në fillim të vitit dhe që është dy herë më i madh nga ai i qeverisë dhe tjetri i dhënë më vonë si plan orientues dhe që ka qenë përpiluar nga Komisioni i Planit e aparati i Komitetit Qendror dhe që është gati gjysmë herë më i madh se ai i qeverisë.

Vetëm në shtator dhe në tremujorin e katërt janë thyer 22 maqina, 17 prej të cilave vetëm në Stabilimentin «Mihal Duri». Materiali shpeshherë ka dalë me një

cilësi të keqe dhe janë bërë në shtyp gabime të rënda politike.

Është lejuar që disa punëtorë të thyejnë disiplinën e punës, ndërsa ka munguar kujdesi për një trajtim më të mirë të tyre dhe për ngritjen tekniko-profesionale; puna teknike ka mbetur pothuajse në duart e disa teknikëve ish-pronarë shtypshkronjash dhe me qëndrim të keq politik. Megjithkëtë gjendje, ndërmarrja ka dalë me fitime dhe ka marrë flamurin. Këto fitime nuk vijnë nga organizimi i mirë i punës ose nga kursimi, por nga shitja e disa punimeve që ishin planifikuar dhe filluar më 1948 dhe që mbaruan më 1949, nga shitja e letrës skarco, si dhe nga ndryshimet në çmimet e letrës. Kostoja e punimeve dhe normat kanë qenë të pastuduara dhe në baza joreale. Është për t'u theksuar se kërkesave të ndërmarrjes ministria nuk u është përgjegjur megjithëse ka qenë në dijeni të disa të metave. Përgjegjësia e ministrisë rëndohet edhe më shumë nga fakti se edhe në kohën e kontrollit ajo mendonte sikur puna shkonte shumë mirë në shtypshkronja.

Centralin elektrik të Tiranës ministria nuk e ka kontrolluar kurrë, megjithëqë e dinte se ai funksiononte keq dhe nuk i jepte rregullisht dritë gjithë Tiranës. Ministria e kishte fjetur mendjen dhe ja hidhte fajin mungesës së disa veglave që duhej të vinin nga jashtë. Edhe mbas kontrollit që u bë, ish-ministri i industrisë në atë kohë, Abedin Shehu e ka quajtur përsëri këtë si mungesë kryesore. Në fakt doli se mungesat më të mëdha ishin për shkak të organizimit të keq të punës në central, për pakujdesi në ruajtjen dhe në përdorimin e keq të maqinorisë, për mosinteresimin e drejtorit F.L.

(që u shkarkua nga përgjegjësia mbas kontrollit) që kishte rënë në pozitat e teknikëve të centralit, të cilët janë njerëz të pasigurtë politikisht dhe të lënë jashtë çdo kontrolli nga vetë ministria. U vërtetua se Tirana mund të ketë dritë po me këta motora, se riparimet mund të bëhen në Shqipëri, se veglat e porositura nuk kushtëzojnë dorë për dorë funksionimin e mirë të centralit. Por ministria duhet të kujdeset që të sigurojë veglat e nevojshme dhe të marrë një sërë masash organizative, pa të cilat nuk mund të funksionojë mirë centrali.

Këto dhe të meta të tjera vijnë për arsye se dikasteret mbështeten shumë e vetëm në raportimet që u bëjnë ndërmarrjet e tyre, duke mos njohur në këtë mënyrë gjendjen reale të të metave në punë.

Një shembull tjetër i dobësisë së kontrollit është rasti i mbylljes së bilanceve në ndërmarrjet e ndërtimit. Në bazë të rezultateve të inventarizimit, pesë ndërmarrje ndërtimi dalin me një deficit të përgjithshëm prej 21 milion lekësh dhe me një suficit prej 16 milion lekësh. Vetëm ndërmarrja «Ura» ka një humbje materialesh të pajustificuara prej 735 000 lekësh. Por këto bilance nuk janë bërë në bazë të rregullave dhe ligjeve financiare, për arsye se nuk janë bërë inventarizimet me saktësi dhe ndërmarrjet, nga ana tjetër, nuk dinë të analizojnë me hollësi dhe nuk dinë të justifikojnë as suficitet as deficitet. Në këtë rast Ministria e Punëve Botore megjithëse ka konstatuar se nuk është gjithshka në rregull, në vend që të marrë masa me kohë për kryerjen siç duhet të bilanceve dhe të dënojë ata që shkulin dispozitat e qeverisë, këto bilance ja paraqit qeverisë për

të mbyllur deficitet. Nga revizioni që është duke u bërë në Portin e Durrësit, del se drejtorja i ka raportuar Ministrisë së Komunikacioneve shifra jo të sakta mbi realizimin e planit të nxjerra me hamendje dhe në bazë dokumentash jo të plotë.

Disa dikastere janë mjaftuar të dërgojnë urdhëra me shkresa pa u preokupuar që të japin udhëzime më të gjera dhe të kontrollojnë në vend zbatimin e tyre, duke lënë në vështirësi ndërmarrjet e tyre, të cilat, nga mosinterpretimi i mirë i urdhërit, i kanë shkaktuar dëme arkës së shtetit. Nga një urdhër i tillë, i lëshuar nga Ministria e Tregëtisë në fundin e vitit 1949 mbi çmimet për shitjen e misrit, arka e shtetit ka pasur një humbje prej më tepër se 1 milion lekësh. Nga një urdhër i paiminterpretuar mirë nga agjencitë e Ministrisë së Industrisë për blerje duhani nga fshatarët, arka e shtetit ka humbur 32 000 lekë. Po kështu disa SMT kanë paguar personelin e tyre më tepër, duke zbatuar keq dispozitat e ministrisë dhe duke i shkaktuar shtetit një dëm prej 140 000 lekësh.

Në ruajtjen dhe përdorimin e materialit e të mjetëve financiare e në përgjithësi të pasurisë së shtetit ka gabime të mëdha.

Vitin e kaluar, me urdhër verbal të ish-ministrit të botores Abedin Shehut është filluar, jashtë çdo rregulli, ndërtimi i kalatës së Durrësit, e cila më vonë, për arsye se nuk qe studjuar mirë, u la. Në këtë rast ka pasur humbje materiali dhe shpenzime të tjera, që arrijnë në një shumë rreth 3 milion lekësh. Po kështu në gjendje jo të rregullt, të paimventarizuara si duhet dhe jashtë shfrytëzimit, janë gjetur një sasi e konsi-

derueshme maqinerish dhe automjetesh si në ndërmarrrjet e ndërtimit ashtu dhe në ato të komunikacionit.

Ministria e Komunikacioneve vitin e kaluar jo vetëm që nuk ka ushtruar asnjë kontroll dhe nuk ka bërë punë të organizuar, por në sektorin e saj janë vërtetuar sabotime. Në fakt qëndrimi armiqësor i drejtuesit të saj, Niazi Islami, ka favorizuar çrregullimet dhe sabotimet.

Në Portin e Durrësit prej shumë kohësh kishte mbetur një sasi materiali i importuar, që arrinte në 12 000 ton dhe një sasi çimentoje prej 1 200 ton. Dikasteret e interesuara nuk janë preokupuar dhe tërheqja e tyre është vonuar deri këto kohët e fundit. Me gjithë urdhërin e qeverisë për tërheqjen e tyre nga Porti i Durrësit, ka munguar shpejtësia e duhur nga ana e dikastereve për materialin e importuar, ndërsa çimentoja ka mbetur akoma në port dhe përgjegjësia për këtë i bie Ministrisë së Punëve Botore.

Depot dhe magazinat nuk mbahen akoma mirë. Stivosja e materialit shumë herë është bërë jashtë rregullave teknike të domosdoshme, gjë që rrezikon të dëmtohet materiali. Kujdesi dhe vigjilenca për ruajtjen nga armiku dhe masat për mbrojtjen nga zjarri e nga uji, kanë munguar. Rojtarët nuk janë të zgjedhur dhe të sigurtë. Nga këto shkaqe janë djegur dy depo pambuku, një stabiliment i sharrës në Pukë, një vaskë karburanti në Kuçovë, përveç dëmtimeve të tjera në sasi më të vogla që ndodhin më shpesh si dhe prishjes së farës së pambukut në Fier dhe e një sasive misri në Lushnjë që ka zënë mizë etj.

Magazinat, në shumë raste nuk kanë akoma inven-



tare të sakta, lëvizjet e mallit nuk bëhen në bazë të rregullave të caktuara, dhënja dhe marrja në dorëzim ose nuk bëhet fare, ose bëhet duke inventarizuar materialin me hamendje. Nga të gjitha kontrollet tona qoftë vjet, qoftë këtë vit ka dalë se gjendja kontabile e magazinave nuk është përputhur kurrë me gjendjen fizike të materialeve, gjë që u lë vend abuzimeve dhe shpërdorimeve të çdo lloji, sidomos kur mungon kontrolli nga lart.

Bagëtia e shtetit, e grumbulluar për detyrime mishi, për mungesë kullotash, stallash dhe mirëmbajtje ka pasur humbje si në numër ashtu dhe në peshë.

Kundër përgjegjësve për mbajtjen keq të pasurisë së shtetit dhe për dëmtimet e ndryshme deri nga fundi i vitit 1949 masat kanë qenë të pakta dhe me vonesë, kurse më vonë ka pasur një kujdes më të madh. Por ajo që mungon akoma dhe nga e cila varet shumë ruajtja dhe mirëmbajtja e pasurisë së shtetit është çështja e kontrollit dhe e masave që duhen marrë më parë se të bëhet dëmi. Ky kontroll është i nevojshëm të forcohet seriozisht.

Çështja e ruajtjes së sekretit të shtetit është akoma shumë e dobët. Në të gjitha zyrat e aparatit të shtetit që janë kontrolluar, janë gjetur pa përjashtim, dokumenta sekretë të lënë pa kujdes mbi tavolina si plane të shtetit, urdhëra e qarkore sekrete. Në Ministrinë e Industrisë u gjetën të pasiguruara plani i industrisë dhe lista e disa kontratave me jashtë. Në ndërmarrjet mungesat për ruajtjen e sekretit të shtetit janë edhe më të rënda. Nga urdhërat e qeverisë, që nuk janë zbatuar për shkak se nuk është organizuar dhe kontrolluar

zbatimi i tyre, nga më të rëndësishmit janë këta: Ministria e Tregëtisë nuk ka zbatuar urdhërin e Kryeministrit për transportimin e disa mallrave të konsumit të gjerë dhe për eksport, veçse në një masë 54 për qind duke shkaktuar njëkohësisht humbje të konsiderueshme të kapacitetit transportues. Përgjegjësia në radhë të parë i bie udhëheqjes së ministrisë, e cila rëndohet edhe më shumë, pse ka qenë vetë ajo që ka propozuar të jepej një urdhër i tillë dhe mbasandaj nuk është kujdesur sa duhet ta zbatojë plotësisht atë. Moszbatimi i urdhërit ka ardhur ngaqë organizimi i punës në aparatën e ministrisë ka qenë shumë i dobët, evidencat kanë qenë shumë të çrregullta dhe ka pasur mungesë lidhjeje me bazën.

Po për mosorganizim të mirë, për mungesë kontrolli dhe për ndjenjë të dobët përgjegjësie ndaj detyrës, Komiteti i Grumbullimeve ka furnizuar ushtrinë me bar vetëm me 49 për qind të sasisë së planifikuar, duke vënë në vështirësi kafshët e saja.

Vendimi i Këshillit të Ministrave përsa u përket ndërmarrjeve blegtorale akoma nuk ka gjetur realizimin e tij të plotë. Në ndërmarrjet e kontrolluara janë gjetur mjaft të meta në organizimin e punëve, në mirëmbajtjen dhe rritjen e bagëtive, në sigurimin dhe mirëmbajtjen e kullotave, në kontabilitet, të meta që kanë shkaktuar, siç u tha më lart, prapë humbje të mëdha.

Vonesa në zbatimin e urdhërave të qeverisë ka pasur gjithashtu nga Ministria e Industrisë për Gomistërinë e Durrësit. Dhe tani së fundi është vonuar edhe marrja e masave për rregullimin e centralit të Tiranës, megjithëqë vetë ministria ka qenë plotësisht dakord për këto masa.

Për jetesën e punëtorëve, megjithëqë ka përmirësime nga e kaluara, prapë ka disa të meta në furnizimin e tyre dhe në sigurimin e masave higjienike, pse akoma çalon kujdesi i vetë drejtuesve të ndërmarrjeve si në sharrat e Pukës dhe në Kuçovë.

Industria lokale shpeshherë është gjetur në vështirësi për arsye se puna e saj ka qenë lënë vetëm në duart e komiteleve ekzekutive dhe Ministria e Industrisë nuk ka mbajtur asnjë lidhje dhe nuk ka dhënë ndihmë.

Në kooperativat e artizanatit, për mungesë udhëzimesh unike nga lart dhe nga mungesa e studimit dhe e përcaktimit të normativave të materialit dhe të normave të punës, janë prodhuar artikuj të njëjlojtë me çmime të ndryshme si këpucë, punime druri etj.

Shokë dhe shoqe,

Lenini na mëson:

*«Qëndrimi i një partie politike kundrejt gabimeve të veta është një nga kriteret më të rëndësishme dhe më të sigurta të seriozitetit të Partisë dhe të zbatimit në fakt të detyrave të saja kundrejt klasës së vet dhe kundrejt masave punonjëse».<sup>1</sup>*

Prandaj gabimet tona ne i njohim dhe i themi hapët, se ne duam të mësojmë nga to për të mos i përsë-

<sup>1</sup> V. I. Lenin. Veprat, vëll. 31. f. 49.

ritur. Një qëndrim i tillë leninist i Partisë sonë përpara gabimeve të saj ka bërë që plani në tremujorin e parë të vitit 1950 të tejkalohet gati në të gjithë sektorët. Nxjerrja e naftës ka filluar të shtohet 85 për qind, e bitumit të spastruar — 103,5 për qind, e kromit — 102,9 për qind, e qymyrgurit — 107,3 për qind, e sapunit për rrobe — 100 për qind, e tekstileve — 110 për qind, e lëkurëve — 121,9 për qind, e këpucëve — 113,5 për qind, e çimentos — 119,9 për qind, e lëndës së sharruar — 101,5 për qind e kështu me radhë.

Vija e drejtë e Partisë bëri që jeta e punonjësve tanë të fshatit dhe të qytetit të përmirësohet, të ngrihet mirëqenja e fshatarëve, të ngrihet niveli i jetesës së punëtorëve dhe të ngrihet paga reale e tyre. Çmimet e tregut fshatar për artikujt kryesorë janë ulur dhe kjo tregon se fshatarësia, duke kuptuar dhe duke zbatuar në jetë direktivat e Partisë dhe të qeverisë sonë, ka prodhuar më shumë, ka plotësuar nevojat e saja dhe forcon çdo ditë e më tepër aleancën me klasën punëtore dhe me të gjitha masat punonjëse të qytetit. Do të japim disa shifra mesatare, që pasqyrojnë çka thamë më lart dhe këto s'janë një fenomen sporadik, por konsekuencë e rrugës socialiste dhe të ekonomisë së planifikuar. Mishi në korrik 1949 shitej 280 lekë kg., në mars 1950 arriti në 105 lekë, pra, zbriti 62,5 për qind; gjalpi i shkrirë në korrik 1949 shitej 1 215 lekë, në mars 1950 shitej 540 lekë, pra, zbriti 55,56 për qind; djathi në korrik 1949 shitej 321 lekë, në mars 1950 shitej 164 lekë, pra, zbriti 48,91 për qind; qumështi në korrik 1949 shitej 63 lekë, në mars 1950 shitej 38 lekë, pra, zbriti 39,68 për qind; vaji në korrik 1949 shitej 800 lekë kg., në mars 1950

shitej 340 lekë, pra, zbriti 57,50 për qind; perimet në korrik 1949 shiteshin 29 lekë, në mars 1950 shiteshin 6 lekë, pra, zbritën në 79,31 për qind; patatet në korrik 1949 shiteshin 24 lekë, në mars 1950 shiteshin 15 lekë, pra, zbritën në 37,50 për qind. Krahas me këtë ulje çmimesh në tregun fshatar, qeveria uli çmimet e një sërë mallrave në masën e mëposhtme: sheqerin — 28,57 për qind, makaronat — 20 për qind, fasulet — 34 për qind, pëlhurat e pambukta — 20 për qind, pëlhurat e mëndafshita — 28 për qind, pije të vendit — 22 për qind, marmalatën — 20 për qind, vezët — 20 për qind etj.

Këto masa të drejta të Komitetit Qendror dhe të qeverisë kanë sjellë një kënaqësi të madhe në masat e punonjësve të qytetit dhe të fshatit, por kjo nuk do të mbarojë me kaq. Populli ynë do të shohë vazhdimisht ditë shumë më të mira. Realizimi i planit në çdo sektor do t'i japë popullit më me bollëk dhe me çmime edhe më të lira gjëra që ai ka nevojë. Ai për së shpejti do të ketë Kombinatin e madh të tekstileve «Stalin», që do t'i japë basme të prodhuara në vend, do të ketë fabrikën e tij të sheqerit, do të ketë fabrikën e tij të leshit. Fabrikat e tjera ekzistuese do të zmadhohen, do të përmirësohen dhe do të prodhojnë më shumë. Por nuk do të mjaftohemi me kaq.

Partia dhe qeveria janë duke studjuar dhe duke hartuar planin e ardhshëm të madh, që mund të jetë një plan pesëvjeçar, i cili do t'i japë ekonomisë sonë një hov të jashtëzakonshëm. Me ndihmën e madhe të Bashkimit Sovjetik, ne do të njohim për së shpejti ku janë pasuritë e nëntokës sonë, në sasi të dhe në llojet e ndryshme, ne do të njohim më me saktësi forcën e

ujërave tona për të prodhuar energji elektrike, që do t'i shtohen Hidrocentralit të Selitës që po ndërtojmë me ndihmën e Bashkimit Sovjetik. Ne do të njohim me saktësi dhe shkencërisht natyrën e tokave tona, të pyjeve etj. Ne do të shtojmë nxjerrjen e prodhimeve tona të nëntokës që nga nafta e deri në metalet e tjera, që flenë nëntokë dhe që do të jenë një pasuri kolosale për popullin tonë. Ne do të ngremë rafineri të re e të fuqishme nafte që na vjen nga Bashkimi Sovjetik, do të ngremë fabrika të reja, që do të na i akordojnë Bashkimi Sovjetik dhe demokracitë popullore motra. dhe këto fabrika të reja do t'i japin popullit tonë vajguri, kompensato, letër, lëndë të imprenjuar, karton katramat, pllaka eterniti, sodë kaustike, acide sulfurike, vajra vegjetale, konserva mishi, konserva peshku, fije pambuku, alkool etj. Vendi ynë do të industrializohet dhe ekonomia e popullit tonë do të fuqizohet. Demokracia jonë popullore po ecën me hapa të sigurtë në rrugën e socializmit dhe për këtë populli ynë do t'i jetë mirënjohës për jetë Bashkimit Sovjetik, Partisë Bolshevike dhe të shtrenjtit Stalin.

Perspektivat e jetës së begatshme për popullin tonë janë të ndritura. Prandaj, shokë dhe shoqe, ky vit duhet të jetë vendimtar për realizimin e plotë të planit tonë për vitin 1950 si dhe për planin dyvjeçar në total. Eksperienca e vitit 1949 të na ndihmojë shumë në këtë drejtim. Duhet të kemi kurdoherë parasysh se plani i ardhshëm perspektiv do të kërkojë më shumë vigjilencë, më shumë organizim, më shumë luftë dhe kombativitet nga të gjithë njerëzit punonjës të vendit tonë. Këtëj kuptohet përgjegjësia e madhe që ka përpara klasës

punëtores Partia jonë dhe gjithë populli shqiptar. Partia jonë kurrë nuk u është trembur dhe nuk do t'u trembet vështirësive e përgjegjësive. Ajo në krye të masave punonjëse të vendit tonë do të triumfojë, pse ajo është një parti e tipit leninist, pse ajo udhëhiqet nga mësimet e marksizëm-leninizmit.

### III

#### LUFTA E PARTISË PËR FORCIMIN E SAJ

Ka kaluar më shumë se një vit që nga Kongresi I dhe gjatë kësaj periudhe Partia ka qenë në krye të detyrës së saj të madhe dhe e angazhuar vazhdimisht në luftë dhe në punë për zbatimin me sukses të vijës që i përcaktoi kongresi për forcimin dhe bolshevizimin e saj.

Për të gjithë është shumë e qartë se në ç'rrezik të madh ndodhej Partia jonë para letrave të KQ të Partisë Bolshevike, drejtuar Komitetit Qendror të Partisë Komuniste Jugosllave.

Partia Bolshevike e Lenin-Stalinit e ndihmoi Shqipërinë dhe popullin tonë, herën e parë me luftën heroike të popujve sovjetikë dhe herën e dytë me demaskimin në kohë të agjenturës nacionaliste e trockiste të Titos; që punonte nën rrogë për hesap të imperializmit amerikano-anglez. Letrat e KQ të Partisë Bolshevike të Lenin-Stalinit dhe Rezolucioni i Informbyrosë çorë maskën e grupit nationalist të Tito-Rankoviçit, pasuruan thesarin e paçmueshëm të marksizëm-leninizmit dhe

u dhanë partive komuniste dhe punëtore të të gjithë botës një armë të fuqishme për të zbuluar dhe për të goditur pa mëshirë agjenturat e imperializmit, të cilat të maskuara nën parulla false, kërkojnë të minojnë kampin e socializmit, të shkatërrojnë lëvizjen punëtore ndërkombëtare, të diskreditojnë dhe të dëmtojnë ndërtimin socialist dhe të rivendosin kapitalizmin në të gjitha ato vende ku kanë triumfuar idetë e Marksit-Engelsit-Leninit-Stalinit. Me Plenumin XI të KQ të Partisë u bë kthesa me rëndësi të madhe në jetën e Partisë sonë dhe me Kongresin I të PKSH u kurorëzua me sukses lufta e Partisë dhe e masave punonjëse kundër devijimeve dhe veprimtarisë oportuniste të udhëheqjes jugosllave dhe të grupit antiparti të Koçi Xoxes. Letrat e KQ të PK të Bashkimit Sovjetik, drejtuar Komitetit Qendror të PK Jugosllave dhe Rezolucioni i Byrosë Informative «Mbi gjendjen në Partinë Komuniste Jugosllave», u aprovuan unanimisht nga e gjithë Partia, nga gjithë masat punonjëse të vendit tonë dhe patën një rëndësi të madhe për PKSH dhe popullin shqiptar. Që nga letrat e shokut Stalin çdo ditë që ka shkuar ka vërtetuar sa të thella dhe sa ektakte kanë qenë mësimet e mëdha të Stalinit, të cilat u ndritën rrugën partive tona për ta zbuluar gangrenën titiste deri në rrënjë. Gjyqet e Rajkut, Kostovit, Koçi Xoxes ishin dëshmia e qartë e gjykimit të drejtë të Partisë sonë, e tej pamjes gjeniale dhe revolucionare të Partisë Bolshevike dhe të Rezolucionit të Byrosë Informative «Mbi gjendjen në Partinë Komuniste Jugosllave».

Fjalët e shokut Stalin në Plenumin e KQ të Partisë Bolshevike më 1937, në lidhje me trockizmin, u vërte-



tuan edhe një herë përsa i përket bandës titiste. Stalini në mes të tjerave ka thënë:

*«... trockizmi u shndërrua në një bandë të tërbuar e pa parime sabotatorësh, diversantësh, spiunësh dhe vrasësish, që veprojnë sipas udhëzimeve të organeve të zbulimit të shteteve të huaj»<sup>1</sup>.*

*«... trockistët ka kohë që janë shndërruar në kusarë të rrugës së madhe, të aftë për çfarëdo poshtërsie, të aftë për çdo gjë të ulët deri te spiunazhi dhe te tradhëtia e hapët ndaj atdheut të vet, vetëm e vetëm që të dëmtojnë Shtetin Sovjetik dhe Pushtetin Sovjetik»<sup>2</sup>.*

Partia jonë, që vuajti pa masë nga klika e Tito-Rankoviçit dhe nga agjentët e tyre në vendin tonë, nxori konkluzionet e duhura në Kongresin I të saj dhe pësimet ju bënë mësim. Kjo ishte një provë e madhe për Partinë tonë dhe një shkollë nga më të lartat që i shërbyen më vonë për të zbuluar veprimtarinë armiqësore dhe antiparti të grupit të Abedin Shehut me shokë dhe që do t'i shërbejë edhe në të ardhshmen për të zbuluar dhe asgjësuar të gjithë armiqtë e Partisë dhe të popullit tonë nën çdo maskë që ata do të tentojnë të fshehin veprimtarinë e tyre.

Mësimet që nxuarëm nga letrat historike të Partisë Bolshevike dhe nga zbulimi e goditja që Partia jonë

<sup>1</sup> J. V. Stalin. Veprat, vëll. 14, f. 97.

<sup>2</sup> Po aty, f. 100.

dhe partitë komuniste e punëtore motra i bënë klikës së Tito-Rankoviçit dhe agjentëve të tyre, i kemi të freskëta në kokën tonë dhe vazhdimisht e kurdoherë duhet të na ndriçojnë rrugën, pse lufta dita-ditës do të ashpërsohet me imperialistët dhe me agjenturat e tyre. Po të na ndryshket vigjilenca dhe t'i harrojmë këto mësimë të mëdha, do të na ngjasin gjëra të papritura dhe shumë të hidhura. Askujt nuk mund t'i lejohet një gjë e tillë dhe ca më pak anëtarëve të Partisë, që drejtojnë fatet e tërë popullit. Populli dhe jeta e tij duhet të mbrohen me çdo kusht dhe kjo detyrë e rëndë dhe e shenjtë i është ngarkuar Partisë sonë. Prandaj, çdo anëtar i Partisë, që nga ata që janë zgjedhur në funksione më të larta dhe deri te anëtari më i thjeshtë, duhet të gjithë të kuptojnë detyrat e tyre, të drejtat e tyre dhe të marrin përgjegjësitë e tyre. E gjithë Partia është përgjegjëse për veprimtarinë e saj përpara klasës punëtore dhe popullit tonë dhe çdo anëtar i Partisë veç e veç është përgjegjës për punën e tij përpara Partisë dhe përpara popullit.

Partia, pra, është kyçi i të gjitha fitoreve të popullit. Partia, pra, nervi jetik i popullit, është kurdoherë objekti kryesor i goditjeve të armikut të klasës.

Është për këtë gjë që Partia jonë duhet të dhjetëfishojë vigjilencën e saj revolucionare, të jetë vazhdimisht e ndërgjegjshme dhe e gatshme të godasë çdo rrezik që do t'i turret nga çdo anë qoftë. Partia jonë dhe i gjithë populli të mos t'i harrojnë mësimet që nxuarën në Kongresin I veçanërisht në lidhje me zbulimin dhe goditjen e veprimtarisë të trockistëve të Beogradit dhe të agjentëve të tyre në Partinë tonë.

Punimi i Rezolucionit të Plenumit XI të Komitetit Qendror dhe pak më vonë i atij të Rezolucionit të Kongresit I të Partisë ua bëri të qartë të gjithë anëtarëve të Partisë metodat e përdorura nga titistët jugosllavë dhe agjentët e tyre, Koçi Xoxe me shokë. Këtu nuk duam të përsëritim gjithshka, por sikur të përsëriten disa çështje themelore nuk do të bëjmë gabim.

Grupi trockist i Koçi Xoxes paraqitej shumë i rrezikshëm për Partinë tonë, pse mënyra dhe metodat që u përdorën prej titistëve jugosllavë për ta shtyrë përpara këtë grup në udhëheqje të Partisë dhe për ta mbështetur atë të merrte në duart e veta të gjitha frenat e drejtimit, qoftë në Parti, qoftë në pushtet s'ndryshojnë në asnjë presje nga metodat që përdorën titistët për të vënë ish-Partinë Komuniste Jugosllave dhe Republikën Popullore të Jugosllavisë në shërbim të imperializmit, ato s'ndryshojnë nga metodat dhe taktika që ata përdorën për të minuar partitë motra të Hungarisë dhe të Bullgarisë. Fakti që grupi nacionalist i Titos dërgoi në Shqipëri qysh gjatë kohës së luftës dy nga bashkëpunëtorët e tij kryesorë, Vukmanoviç Tempon dhe Bllazho Jovanoviçin, provojnë interesimin e këtij grupi për ta hedhur vendin tonë në kthetrat e tyre. Koçi Xoxe që nga ata që ngrii duart përpara policisë italiane kur ajo shkoi ta arrestojë, e pa bërë asnjë përpjekje u dorëzua i gjallë në duart e OVRA-s e të SIM-it; Koçi Xoxe që ai që, me të dalë nga burgu, u end andej-këtej në prapavija duke ndrequr rrjetat telefonike dhe duke ndërtuar baraka në vend që të kryente funksionet e tij që i kishte ngarkuar Konferenca e parë e Vendit e Partisë, që u mbajt në Labinot. Këtë gjë ai e bëri jo

pse pengohej në kryerjen e funksioneve të tij, siç pretendonte, se sa nga mungesa e zotësisë dhe e kurajës.

Agjenti Vukmanoviç Tempo përpiqej që të krijonte agjentura të reja në shërbim të Beogradit në vendin tonë, në Greqi, në Maqedoni, në Bullgari e gjetkë dhe këto të formonin një rrjetë të tërë që në atë kohë në shërbim dhe nën drejtim të Titos. Për këtë qëllim ai kishte ardhur shumë herë në Shqipëri dhe përpiqej që të ndërronte kursin e Luftës sonë nacional-çlirimtare. Për realizimin e qëllimeve të veta i vuri syrin Koçi Xoxes, të cilin e bëri të tijtë, e mori me vete në Greqi dhe e pregatiti për punën e tij të ardhshme. Me kthimin e tij nga Greqia, Vukmanoviç Tempo, tok me Koçi Xoxen, me Sejfulla Malëshovën etj., filloi luftën kundër vijës së Partisë sonë. Vukmanoviç Tempo ishte i ndër-gjegjshëm se Partia jonë po ecte jo në rrugën që dëshirononte grupi i agjentëve të vjetër Tito-Rankoviç, por në rrugën bolshevike. Prandaj ai kishte marrë si detyrë nga padronët e tij që t'ja ndërronte drejtimin Partisë sonë dhe për t'ja arritur këtij qëllimi veproi energjikisht. Puna e tij prej sabotatori nuk pati përfundimet që ai ëndërronte, pse udhëheqja jonë nuk ja pranoi pikëpamjet e tija dhe ja kundërshtoi, por frutet e punës së tij ai do t'i kornte më vonë, në prakun e çlirimit të Shqipërisë, në Plenumin II të KQ të PKSH, në Berat. Asnjërit nga ne nuk mund t'i shkonte ndër mend, jo vetëm atëhere, por edhe shumë kohë më vonë që, nën maskën e komunistëve e të miqve të Partisë dhe të popullit tonë, të fshiheshin agjentë kaq të rrezikshëm, trockistë të dorës së parë, siç ishin Tito, Rankoviç, Tempo, Bllazho Jovanoviç, Dushan Mugosha e të tjerë.

Askush nga ne nuk mund të pretendojë se ishim aq të ngritur ideologjikisht dhe të kishim eksperiencën e duhur për të kuptuar qëllimet e errëta, që fshiheshin me demagogji pas frazeologjisë së tyre komuniste. Por hovi i madh revolucionar i Partisë sonë, besimi i patundur në rrugën tonë të drejtë, megjithëse ne bënim edhe gabime, dhe dashuria e besnikëria ndaj Bashkimit Sovjetik, e shpëtuan Partinë tonë gjatë luftës nga kurthet që i ngrinin këta agjentë të vënë në shërbim të kapitalit.

Këtu duhet të kemi parasysh, në dritën e veprimtarisë armiqësore të trockistëve jugosllavë, në dritën e Plenumit II të KQ, që u mbajt në Berat, të gjithë veprimtarinë armiqësore të Koçi Xoxës dhe të shokëve të tij që u zhvillua dhe u zbulua më vonë, të këtyre alcatëve të përhershëm të trockistëve jugosllavë. Trockistët jugosllavë grumbulluan rreth vetes së tyre njerëz të pakënaqur, të paaftë, megalomanë dhe ambiciozë, njerëz që kishin bërë në jetën e tyre krime, vjedhje, njerëz arrivistë që u pëlqenin mburrjet dhe lëvdatat, njerëz të mykur të shtresave mikroborgjeze dhe borgjeze. Sillni në mendje të gjithë ata njerëz, që me plot ndërgjegje u solidarizuan me titistët jugosllavë për të hedhur në erë Partinë tonë dhe do të gjeni në ta të gjitha këto tipare të huaja për njerëzit e shëndoshë të Partisë.

Një karakteristikë tjetër e veprimtarisë trockiste që ka përcaktuar shoku Stalin është se

*«... trockistët e sotëm kanë frikë t'i tregojnë klasës punëtore fytyrën e vet të vërtetë, kanë*

*frikë t'i shfaqin asaj qëllimet dhe detyrat e veta të vërteta, mundohen t'ja fshehin klasës punëtore fizionominë e vet politike, duke pasur frikë se mos klasa punëtore, po të marrë vesh synimet e tyre të vërteta, do t'i nëmë ata, si njerëz të huaj për të, dhe do t'i largojë nga vetja. Kështu shpjegohet, në të vërtetë, që metoda kryesore e punës së trockistëve nuk është tani propagandimi i hapur dhe i ndershëm i pikëpamjeve të veta në klasën punëtore, por maskimi i pikëpamjeve të veta, lavdërimi servil dhe miklues i pikëpamjeve të kundërshtarëve të vet, shkelmimi i rremë dhe hipokrit i pikëpamjeve të veta»<sup>1</sup>.*

Kështu në veprimtarinë armiqësore të trockistëve jugosllavë dhe të trockistëve shqiptarë me Koçi Xoxen në krye do të gjejmë pikë për pikë të gjitha sa na mëson shoku Stalin. Këto banda trockiste në punën e tyre e kanë fshehur vazhdimisht qëllimin e vet nga Partia dhe nga klasa punëtore, pse, natyrisht ai ka qenë i dënueshëm, antimarksist e antileninist, antipopullor, antisovjetik. Trockistët jugosllavë dhe Koçi Xoxe me shokë të gjitha prapaskenat i kanë bërë fshehurazi nga Partia, me metoda komplotiste e puçiste. Në sipërfaqe ata tregoheshin prosovjetikë, por në realitet dhe në praktikë luftonin Bashkimin Sovjetik me të gjitha forcat. Ata i thurnin lëvdata Bashkimit Sovjetik në mënyrë servile, por nga ana tjetër, i futnin thikën. Për

<sup>1</sup> J. V. Stalin. Veprat, vëll. 14, f. 98.

sy e faqe titistët jugosllavë e mburrnin Partinë tonë duke thënë se kjo «pas partisë jugosllave, e kishte kryer qind për qind detyrën gjatë kohës së luftës», por, nga ana tjetër, i futnin thikën pas shpine. Trockistët jugosllavë dhe agjentët e tyre shqiptarë e kanë fshehur kurdoherë veprimtarinë e tyre kundër Partisë dhe Republikës sonë Popullore. Nga një anë komplotonin për aneksimin e Shqipërisë prej Jugosllavisë titiste, nga ana tjetër hiqeshin sikur këto «ide gjeniale» ishin fruti i dëshirës së popullit tonë.

Shoku Stalin na mëson gjithashtu një gjë me rëndësi në lidhje me veprimtarinë e trockistëve, që ne duhet ta kemi parasysh:

*«Në procesin gjyqësor të vitit 1936, në qoftë se ju kujtohet — thotë shoku Stalin — Kamenievi dhe Zinovjevi nuk pranuan në asnjë mënyrë të kishin pasur ndonjë platformë politike. Ata i kishin të gjitha mundësitë të shtjellonin gjatë procesit platformën e vet politike. Por ata nuk e bënë këtë, duke deklaruar se nuk kishin asnjë platformë politike. Nuk mund të ketë dyshim se që të dy ata gënjyen kur mohuan të kishin pasur një platformë politike. Tani edhe të verbërit e shohin se ata kanë pasur platformën e vet politike. Por përse ata mohuan të kishin pasur ndonjë platformë politike? Sepse ata kishin frikë të zbulonin fytyrën e vet politike të vërtetë, ata kishin frikë të shpallnin platformën e vet të vërtetë, që ishte ajo e restaurimit të kapitalizmit në BRSS, duke drujtur se*

*mos një platformë e tillë do të ngjallte neveritje në klasën punëtore»<sup>1</sup>.*

Po të keni parasysh veprimtarinë armiqësore të trockistëve Koçi Xoxe dhe Pandi Kristo me shokë do të gjeni të gjitha ato karakteristika për të cilat flet shoku Stalin.

Prapaskena e Plenumit II të Beratit, e kurdisur nga agjentët jugosllavë dhe nga Koçi Xoxe me shokë, ka pasur një platformë politike. Këtë platformë politike, Koçi Xoxe dhe shokët e tij ja fshehën Partisë dhe deri në fund ata patën frikë t'ja kallëzonin asaj. Por kjo platformë politike dhe qëllimet e tyre dolën qartë përpara Partisë. Trockistët jugosllavë dhe Koçi Xoxe me shokë donin të likuidonin që në Plenumin e Beratit udhëheqjen e shëndoshë të Partisë, për t'i pasur krejtësisht duart të lira, për ta çuar Partinë tonë në greminën e tyre.

Demaskimi i klikës së Titos dhe zbulimi i tradhëtisë së Koçi Xoxes, të Pandi Kristos etj., tregoi qartë se këta kishin një platformë politike. Kjo platformë e hartuar dhe e vënë në zbatim nga agjentura Tito-Rankoviç u vu në veprim në vendin tonë nga banditët Koçi Xoxe, Pandi Kristo etj. Me anën e kësaj platforme ata kishin si qëllim që të hidhnin në dorë Partinë tonë Komuniste, ta shndërronin atë në një parti fashiste, në një rrjet spiunazhi e në një polici fashiste, të aneksonin dhe të kolonizonin Shqipërinë nga ana e Jugosllavisë titiste, të rrëzonin pushtetin e diktaturës së demokracisë po-

---

<sup>1</sup> J. V. Stalin. Veprat, vëll. 14, f. 98-99.



pullore në vendin tonë, të restauronin në Shqipëri regjimin kapitalist dhe ta bënin vendin tonë një arsenal lufte kundër Bashkimit Sovjetik dhe demokracive popullore motra. Trockistët shqiptarë me në krye Koçi Xoxen ishin në dijeni të plotë të këtij plani dhe vepronin me kohë dhe me ndërgjegje të plotë. Por Koçi Xoxe dhe shokët e tij nuk e pohuan kurrë ekzistencën e kësaj platforme politike dhe qëllimet e tyre djallëzore. Ata u detyruan të pohojnë të gjithë veprimtarinë e tyre tradhëtare, por nuk guxuan të pohojnë se e gjithë kjo veprimtari bëhej për një qëllim të caktuar dhe e bashkërenduar me klikën titiste të Beogradit. Trockistët shqiptarë, Koçi Xoxe me shokë, ishin zbatuesit e planit titist në Republikën tonë Popullore. Ata patën frikë të pohojnë platformën dhe qëllimet e tyre, pse do të merrnin mallëkimiin e klasës punëtore dhe të popullit tonë, sikundër e muarën.

Veprimtaria e trockistëve jugosllavë dhe shqiptarë në periudhën para Plenumit XI të PKSH ose më mirë para ardhjes së letrave të KQ të Partisë Bolshevike, drejtuar KQ të PKJ dhe Rezolucionit të Byrosë Informative «Mbi gjendjen në PKJ» ka qenë jashtëzakonisht e rrezikshme, pse, nën maskën e aleancës që ekzistonte në mes popullit tonë dhe popujve të Jugosllavisë, trockistët jugosllavë kishin futur hundët në punët tona të brendshme dhe mbështetnin fuqimisht agjenturën e tyre të kryesuar nga Koçi Xoxe.

Trockistët jugosllavë dhe agjentët e tyre shqiptarë u gabuan rëndë. Ata kujtuan se punët u shkonin si në gjalpë dhe do të realizonin me lehtësi planet e tyre shkatërrimtare. Letrat e Partisë Bolshevike, të cilat ho-

dhën dritë mbi rrezikun që e kërcënonte Partinë tonë nga banda nacionaliste e Beogradit, e ndihmuan Partinë tonë që të dërmojë veprimtarinë armiqësore të trockistëve jugosllavë dhe të tradhëtarit Koçi Xoxe me shokë. Kjo përcaktoi kthesën historike të Partisë. Kishte njerëz në poste me rëndësi e drejtuese në Parti dhe në pushtet, që ishin infektuar nga kjo punë armiqësore, por kjo nuk përjashtonte që edhe në organizatat e ulëta të kishte njerëz, që ishin helmatisur nga metodat e punës agjenturale titiste.

Partia mori masa të rënda kundër fajtorëve kryesorë, kurse kundër atyre, që kishin bërë faje, por që jepnin shpresa se, me ndihmën e vazhdueshme të Partisë, do të ndreqeshin, mori masa edukative. Çështja kryesore ishte se Partia u armatos me një eksperiencë të madhe dhe mësoi nga gabimet e veta për të përballuar rreziqet në të ardhshmen. Partia pas Kongresit I të saj u forcua si organizativisht ashtu dhe politikisht. Kongresi I i dha Partisë orientimin, që të forcohej puna politike dhe ajo organizative, të çrrënjoseshin pikëpamjet trockiste e disfatiste, që agjentët titistë jugosllavë kishin mbjellë në Partinë tonë, të forcohej puna organizative, duke spastruar aparatet nga të gjitha format organizative trockiste, duke vendosur në vend të tyre forma organizative në bazë të parimeve marksiste-leniniste. Kongresi orientoi Partinë të mbështetej në mënyrë rigorozë në Statutin e saj, që të luftohej për forcimin e demokracisë së brendshme, për ruajtjen e rregullave organizative, për forcimin e disiplinës së ndërgjegjshme dhe të çelniktë, të zhvillohej kritika dhe autokritika, si armët më të forta, të forcohej vigji-

lenca revolucionare për ruajtjen e radhëve të saja nga çdo aktivitet trockist dhe armiqësor të mëvonshëm dhe nga çdo shfaqje tjetër që mund ta dëmtonte Partinë.

Në këto drejtime ne mund të themi se Partia jonë ka pasur suksese, ajo është forcuar shumë organizativisht dhe politikisht megjithëse në punën tonë gjatë gjithë kësaj periudhe që na ndan nga kongresi janë vërtetuar gabime në punë dhe shfaqje të sëmura në Parti, të cilat janë goditur dhe ndrequr me kohë. Për këto shfaqje të sëmura unë do të flas më poshtë.

Më parë dua të flas për veprimtarinë antiparti të grupit trockist të Abedin Shehut dhe të Niazi Islamit me shokë, që u paraqit si më seriozi. Zbulimi i këtij grupi antiparti të kryesuar nga Abedin Shehu dhe Niazi Islami, i tregoi Partisë se reaksioni i brendshëm dhe i jashtëm nuk fle, por punon, organizohet dhe e godet Partinë në çastin e përshtatshëm në rast se ajo nuk qëndron vazhdimisht vigjilente dhe e gatshme për ta zbuluar këtë veprimtari dhe për ta asgjësuar me kohë. Veprimtaria e Niazi Islamit, Hamit Keçit, Isuf Keçit dhe e shokëve të tyre, s'është veçse një sërë aktesh sabotazhi dhe armiqësore. Një hap i vogël i ndan këta nga klika Tito-Rankoviç. Ne shpresojmë dhe dëshirojmë të mos ta kenë hedhur këtë hap. Puna dhe qëndrimet e tyre të mëvonshme do ta vërtetojnë nëse ata e kanë hedhur këtë hap ose jo. Përsa i përket punës së këtyre elementëve antiparti, nuk ka rëndësi në është një punë grupazhi apo fraksioni si kërkonte «të filozofonte» Abedin Shehu. Puna e tyre shqip është një veprimtari armiqësore dhe antiparti.

Partia u vu në dijeni dhe punoi në aktive të gjera

e në organizatat bazë të saja rezolucionet e Plenumit V të Komitetit Qendror, që zbuloi dhe dënoi aktivitetin antiparti dhe armiqësor të grupit të Abedin Shehut e Niazi Islamit me shokë, si edhe punën antiparti dhe trockiste të Nexhip Vinçanit e të shokut të tij Gjin Markut. Në se ka konsistuar veprimtaria antiparti dhe trockiste e këtyre grupeve, për të cilat bëjnë fjalë rezolucionet e Plenumit V që Partia i ka mbaruar së punuari?

Grupi antiparti i udhëhequr nga Abedin Shehu kishte në gjirin e vet, përveç të tjerëve, dy anëtarë të Komitetit Qendror dhe një kandidat të Komitetit Qendror të Partisë sonë. Njerëzit e këtij grupi ishin në kundërshtim me Partinë dhe me udhëheqjen e saj jo për çështje të vogla. ose për moskuptime të zgjidhshme nëpërmjet kritikës dhe autokritikës, por për çështje parimore. Te pjesëtarët kryesorë të këtij grupi këto kundërshtime parimore me Partinë tonë nuk lindën në një ditë dhe as kohët e fundit, por këto kanë qenë që në fillimin e të ashtuquajturës jetë të tyre revolucionare. Këta kanë qenë antimarksistë që në fillim të jetës së tyre në Parti, edhe para formimit të Partisë, edhe pas formimit të saj. Pikëpamjet antiparti dhe antimarksiste këta elementë i kanë shfaqur herë-herë edhe në punën e tyre dhe janë goditur, kritikuar, janë këshilluar t'i ndreqin, por më të shumtat e herës i kanë fshehur me kujdes. Këta elementë, me gjithë këto të meta që kanë pasur, kanë depërtuar e janë mbajtur në Parti dhe jo vetëm kaq, por kanë ngjitur shkallët deri në Komitetin Qendror. Këta kanë përfituar nga çastet e turbullta që ka kaluar Partia, por duhet të pranojmë, gjithashtu, se këta njerëz kanë përfituar edhe nga ze-

mërbutësia, zemërgjerësia, shpirtmirësia dhe naiviteti ynë. Shikimi me syrin kritik i kësaj mungese të vigjilencës revolucionare dhe nxjerrja e mësimëve për të ardhshmen ka një rëndësi të madhe për Partinë.

Organizimi dhe metodat e përdorura nga ky grup antiparti janë po ato të të ashtuquajturit grupi komunist i «Të Rinjve», por këtë herë «të pasuruara» me forma dhe metoda të reja, të përvetësuar nga eksperiencia e trockistëve jugosllavë dhe e agjentëve të tyre Koçi Xoxe me shokë. Megjithëse është e njohur nga Partia historia e vjetër e grupeve komuniste, që ekzistonin para formimit të Partisë, prapëseprapë nuk bëjmë dem të rikthehemi dhe të nxjerrim disa mësim të reja.

Origjinën e këtij rigrupimi të ri antiparti në gjirin e Partisë dhe me në krye dy anëtarë të Komitetit Qendror dhe një kandidat duhet ta kërkojmë që në grupet komuniste para formimit të Partisë dhe veçanërisht në grupin e «Të Rinjve». Por njëkohësisht duhet ndjekur zhvillimi i pikëpamjeve të këtyre elementëve jo të shtresës punëtore dhe në opozicion me Partinë dhe me udhëheqjen e saj, gjatë gjithë jetës së Partisë dhe fazave të vështira nga ka kaluar kjo. Elementët kryesorë të këtij grupi trockist, me përjashtim të Niazi Islamit që ka qenë anëtar i grupit të Korçës dhe pastaj ka marrë lidhje me të tjerët, kanë qenë pjesëtarë të grupit të «Të Rinjve». Të tillë ishin Abedin Shehu, Isuf Keçi, Hamit Keçi, Shyqri Këllezi dhe disa elementë të tjerë, kush më shumë e kush më pak të implikuar me ta, të cilët edhe ata ose vinin nga grupi i «Të Rinjve» ose i puqnin pikëpamjet dhe rruga e përbashkët me ta.

Abedin Shehu, si në biografinë e tij, ashtu dhe në

analizën që u bë nga Komiteti Qendror, është munduar t'i nxjerrë lidhjet e tija me grupin e «Të Rinjve» si të dobëta, të rastit dhe pa kurrfarë vlere dhe këtë me qëllim dhe me paramendim. Ai është përpjekur t'i nënvleftësojë këto lidhje për të dalë i pastër dhe pa asnjë influencë nga mbeturinat e sëmura të këtij grupi. Por realiteti qëndron ndryshe. Abedin Shehu ka pasur lidhje të ngushta me këtë grup dhe këto lidhje janë mbajtur nëpërmjet kryetarëve të këtij grupi, trockistëve Anastas Lula dhe Sadik Premte. Abedin Shehu ka marrë direktiva dhe urdhëra drejtpërdrejt prej tyre dhe janë ata, që e kanë këshilluar që të shkojë në shkollë në Itali dhe në ushtrinë italiane në Sardenjë në vitet 1940, 1941, 1942.

Isuf Keçi ka qenë aktiv në grupin e «Të Rinjve», bile shumë aktiv. Ka pasur lidhje të ngushta me krerët e grupit dhe ka qenë dora e djathtë e tyre. Para formimit të Partisë Isuf Keçi ka bërë vepra gangsterizmi, i shtyrë nga natyra e tij, karakteri dhe origjina shoqërore nga e cila rrjedh dhe i edukuar nga fryma trockiste e grupit ku ai bënte pjesë. Ai ka qenë në kundërshtim të hapët me përpjekjet për formimin e Partisë dhe ka vepruar solidar me krerët e grupit të «Të Rinjve» për të sabotuar organizimin e Partisë dhe të Rinisë Komuniste. Më vonë pas formimit të Partisë «aksionet» e tij në qytet kanë pasur të gjitha ngjyrë gangsterizmi dhe për këtë gjë ai u nxuar jashtë Partisë.

Hamit Keçi ka qenë dhe ai pjesëtar i grupit të «Të Rinjve», sido që para formimit të Partisë ka qenë për një kohë i internuar në Itali. Pas kthimit nga Italia, ku kishte bërë aktin e nënshtrimit të Musolini dhe këtë

tradhëti ja fshehu Partisë deri në fund, u lidh me elementët e grupit të «Të Rinjve» që militonin tani në Parti, përvetësoi metodat dhe pikëpamjet e vjetra të grupit, megjithëse nuk ekzistonin më grupe, por ndërta ekzistonte e gjallë fryma e grupit.

Shyqri Këllezi, po ashtu, ishte i lidhur me grupin e «Të Rinjve» dhe ishte element aktiv i grupit. Pas formimit të Partisë u duk sikur ai bëri kthesë dhe i harroi miqësitë e vjetra të sëmura me shokët e grupit të «Të Rinjve», por më vonë këto miqësi u ringjallën, u forcuan dhe ai u rikthye përsëri në llumin e vjetër.

Këta elementë, që u bënë anëtarë të Partisë Komuniste, pas formimit të saj, ruajtën në zemrën e tyre nostalgjinë e grupit dhe pikëpamjet antimarksiste të tija. Origjina e tyre prej borgjezësh të pasur, tregëtarësh të mcsëm të falimentuar e të varfëruar dhe fshatarësh mikroborgjezë ndikoi shumë në ta që të mos mundin dot të pastrojnë pikëpamjet antiparti të shtresave prej nga vinin. Ata u hoqën si komunistë, «e ndoqën» luftën e Partisë për çlirimin e popullit, por bënë lëshime dhe gabime të rënda ngaqë u mungonte gjëja kryesore: besimi i plotë dhe i vërtetë te Partia. Këta nuk e shihnin Partinë si shtëpinë e tyre dhe s'e ndjenin veten të lidhur me të dhe me luftën e saj. Edukata e vjetër antimarksiste e grupit kishte zënë rrënjë të thella në zemrën dhe në kokën e këtyre njerëzve jo të shtresës; ajo kishte nxitur pasionet e veset e tyre borgjeze, të cilat i kishin ngritur në një teori antikomuniste dhe këtë teori antikomuniste e kishin quajtur «teori të vërtetë marksiste-leniniste!». Këta elementë jo të shtresës pajtoheshin plotësisht me këtë «teori komuniste të

grupit» dhe kjo u bë një bindje për ta. Grupi i hodhi këta elementë në aksione të turpshme gangsterësh, i bëri vjedhës, atentatorë pa kriter, imoralë dhe këto aksione grupi i quante «aksione komuniste nga më të kulluarat». Elementët e këtij grupi formuan bindjen se ky ishte komunizmi.

Krerët trockistë dhe fashistë të grupit, Anastas Lula dhe Sadik Premtja, ditën të grumbullonin e të drejtonin elementin e ri të borgjezisë përparimtare dhe intelektualët përparimtarë, që ishin për reforma shoqërore, kundër regjimit të Zogut dhe kundër okupacionit, në një vijë politike me formula gjoja të majta revolucionare, por që në realitet fshihnin një vijë fashiste. Kështu krerët e grupit u përpoqën që këta njerëz t'i çonin në rrugën e armiqve të popullit dhe të komunizmit. Veprimet e grupit në vetëvete ishin të dënueshme nga regjimet e kaluara dhe nga ligjet e borgjezisë, pse ato ishin akte vjedhjeje, vrasjeje etj. Këto akte ishin gjithashtu të dënueshme nga regjimet në fuqi, pse mbulohehin me parulla gjoja të majta. Prandaj disiplina e grupit ka qenë e fortë dhe metoda e përgatitjes së anëtarëve të tij ka qenë e egër dhe çnjerëzore. U krijua pikëpamja në këtë grup se elementët që do të bënin pjesë në të, duhej të provoheshin dhe provat ishin të tmerrshme e të egra, ata duhej të pranonin se ishin gati të masakronin ose të vrisnin të afërmit e tyre, ose të bënin marrëzira të tilla si të ndërronin gratë e njëri-tjetrit, të kryenin veprime të tjera imorale, të sulmonin njerëz të pafajshëm në rrugë, të grabitnin pasurinë e familjes etj. Këto veprime të tmerrshme e të egra i futën njerëzit e grupit në rrugën e gangsterizmit dhe të



fashizmit dhe te ata u krijua bindja se ishin njerëz të zot, aktivë, të zgjuar. Elementët e këtij grupi u bënë me të vërtetë të zot, por të zot në banditizëm. Njëkohësisht elementët e këtij grupi edukoheshin edhe me teori, por teoria e tyre ishte antimarksiste dhe trockiste, e cila bëhej mbështetje dhe përligjte këto akte kriminale.

Forma e organizimit të grupit, lidhjet, aksionet e këtij lloji, misteri, aventurat, konspiracioni dhe disiplina prej gangsteri u përshtateshin pikëpamjeve të këtyre elementëve të borgjezisë, që vegjetonin në këtë grup. Te ata u formua një edukatë e tërë dhe një bindje se e tillë duhej të ishte «partia komuniste» që ata dëshironin. Është e kuptueshme se elementë të tillë të sëmurë rëndë nuk mund të pranonin formimin e Partisë sonë dhe, pas formimit të saj, nuk mund të mos ishin në kundërshtim dhe në luftë me të. Partia Komuniste s'ishte Partia e tyre, ishte armikja e grupit të tyre, të cilin ata e quanin «parti komuniste». Partia nxori në shesh poshtërsitë e tyre, por nuk dolën të gjitha në pah; ata ditën të fshehin shumë gjëra. Njerëzit e sëmurë të këtij grupi s'mund të pajtoheshin me situatën që krijoi Partia jonë dhe t'u nënshtroheshin e t'u bindeshin normave, rregullave dhe vijës së Partisë. E kur këta u revoltuan, Partia u dha dënimin e merituar.

Njerëzit e ndershëm të këtij grupi, që kanë qenë larg krerëve dhe që nuk vinin në zbatim metodat e gangsterizmit, pranuan normat dhe vijën e Partisë që në fillim dhe bindja e tyre u forcua edhe më tepër gjatë luftës dhe u bënë besnikë të fortë të Partisë. Një pjesë tjetër eci zvarrë pas Partisë, e ngaqë nuk ishte e bindur mbeti rrugës, duke u munduar të fshchë me kujdes së-

mundjet dhe moskënaqësitë. Të pandreqshmit shkuan në fraksione, në luftë të hapët me Partinë dhe u dërmuan prej saj. Ajo pjesë që e pranoi me gjysmëzëri formimin e Partisë, që nuk u bind në rrugën e Partisë, që mbeti e pakënaqur, ka qenë kurdoherë në kundërshtim me Partinë, me vijën e saj dhe me udhëheqjen e saj. Pakënaqësitë dhe mosbesimi i njerëzve të kësaj kategorie shfaqeshin herë hapur dhe herë mbyllur. Këta ishin kurdoherë të predispozuar dhe të gatshëm të merrnin rrugën e kundërt të Partisë, por lufta e Partisë sonë kundër armikut të jashtëm dhe kundër fraksionistëve i dobësoi këto forca të pakënaqura, që endeshin nga një repart në tjetrin ose nga një terren në tjetrin, duke kaluar nga një etapë në një tjetër me shpirt të vrerosur, me një ambicie të madhe dhe me një megalomani të shfrenuar. Këta njerëz të shturur dhe me shpirt të vrrarë e ndjenin veten të huaj në Parti, s'e duronin dot disiplinën e Partisë, kishin nostalgji për të kaluarën dhe ndjenin kënaqësi të hapnin zemrën kur piqeshin me ndonjë shok të vjetër të grupit të tyre, që dhe ai kishte nostalgjinë e grupit. Këta njerëz prisnin kohën e tyre, prisnin çastin e përshtatshëm, përpiqeshin të mbanin gjallë të paktën kontaktet me njëri-tjetrin, përpiqeshin të ngjitnin shkallët në Parti dhe në shtet e të zinin pozita me rëndësi. Tesera e Partisë për ta ishte një mjet për t'ua arritur qëllimeve të tyre, pse s'kishin forcë për ta hedhur Partinë në duart e tyre. U duhej të pregatiteshin, të forcoheshin, të riorganizoheshin.

Puna dhe lufta e Partisë nuk mundi t'i shëronte dhe t'i ndreqte këta elementë të cilët ishin të rrënjosura kaq shumë pikëpamjet e gabuara antiparti. Këta

duke ecur «në rrugën e Partisë» ruanin dhe shtonin jo vetëm pakënaqësitë dhe ambiciet, por ruanin si një thesar të çmueshëm frymën, mentalitetin, pikëpamjet dhe metodat e vjetra të grupit. Te një pjesë e mirë e këtyre elementëve ekzistonin nostalgjia e mënyrës së jetesës dhe e mendimit të grupit dhe kjo i tërhiqte vazhdimisht në një jetë të shturur, plot mistere dhe intriga, në një jetë ahengu dhe imoraliteti.

Në situatat e vështira që ka kaluar, Partia jonë ka vigjiluar mbi këto shfaqje të sëmura të mbeturinave të grupeve të vjetra dhe i ka ruajtur radhët e saja nga goditjet e këtyre elementëve me dy faqe. Por më vonë erdhën çaste më të rënda, nga të cilat ata përfituan, Edhe pas kongresit të Partisë, këta elementë në vend që të spastroheshin nga gabimet dhe pikëpamjet e shtrembëra, përvetësuan metodat e njerëzve të ligj të Partisë, përfituan nga metodat e trockistëve jugosllavë dhe shqiptarë. Ata pasuruan torbën e tyre me fishekë më të helmatisur. Abedin Shehu me shokë ishin njerëz që rronin duke menduar «lëre se ç'po ngjet dhe të shohim ç'mund të përfitojmë». Ata herë hiqen të persekutuar dhe kalojnë qosheve pa bërë zë, herë ngrenë veshët dhe bëjnë zhurmë të madhe. Në Plenumin VIII të KQ të Partisë, kur po gërryheshin themelet e saj nga trockistët jugosllavë dhe agjentët e tyre, ata bërtitën me të madhe për Koçi Xoxen që «shpëtoi Partinë». Kur u zbulua tradhëtia e Koçi Xoxes, ata bërtitën më tepër nga të tjerët kundër Koçi Xoxes dhe nxorën defterët e vjetër për të treguar se gjoja qenë të persekutuar. Kjo është karakteristikë e njerëzve pa karakter dhe me dy faqe, e njerëzve pa princip ose më drejt në kundërshtim

flagrant me principet marksiste-leniniste. Shumica e elementëve të këtij grupi s'bëri kurrë një autokritikë të hapët dhe të ndershme për gabimet dhe pikëpamjet e tyre të gabuara, por s'munguan të kritikonin jashtë masës gabimet e të tjerëve dhe, çka është antikomuniste, ata përdorën autokritikën e ndershme të të tjerëve si një armë për t'i futur në baltë anëtarët e ndershëm të Partisë dhe kështu të vinin më në dukje personin e tyre. Nga ana tjetër, të gjithë kalbësirën që kishin në trurin e tyre, ata e cilësonin si një anë shumë pozitive për ta dhe për Partinë, pse çdo gjë gjoja e kishin parë drejt dhe mbi këto baza të kalbura ata mendonin se do ta gënjenin për shumë kohë Partinë. Këtu u gabuan rëndë, por është e vërtetë se edhe ne, duke dashur t'u japim mundësi këtyre njerëzve që të ndreqeshin, që të punonin dhe duke kujtuar se nga puna armiqtësore trockiste këta ishin nënvleftësuar, u dhamë dorën, por duke u dhënë dorën, u treguam ca zemërgjerë dhe naivë. Megjithkëtë, mësimet e mëdha të Kongresit I, nuk i harruam, nuk ramë në gjumë, «*besuam, por edhe vigjiluum*» — siç thotë shoku Stalin, — dhe s'shkoj shumë kohë e vigjilenca e Partisë i kapi këta elementë me presh në dorë.

Disa shokë në aktive kanë pyetur: «Pse nuk u zbuluan më parë këta njerëz?». Kështu duhej të ngjiste; puna armiqtësore brenda dhe jashtë Partisë duhet të zbulohet shpejt që të mos i kushtojë dëme materiale dhe politike as Partisë as popullit. Kjo do të ngjasë kështu, kur vigjilenca e gjithë Partisë në tërësi dhe e çdo anëtarit veç e veç të jetë një vigjilencë revolucionare, e gjallë, e pamëshirshme kundër lëshimeve dhe gabi-

meve, të jetë vigjilencë luftarake. Shumë anëtarë partie kujtojnë dhe këtu gabohen, se vigjilenca revolucionare i përket dhe është një apanazh vetëm i udhëheqjes dhe nuk mendojnë se udhëheqja pa Partinë, pa ndihmën e anëtarit më të thjeshtë, mbetet si peshku pa ujë. Vigjilenca e bazës së Partisë — kjo është ajo që e shpëton Partinë nga çdo rrezik, që e armatos vigjilencën e udhëheqjes së Partisë me të dhëna konkrete, të cilat e çojnë Komitetin Qendror në zbulimin e punës armiqësore nën çdo maskë që të fshihet. Armiqtë e Partisë përdorin metoda të stërholluara në punën e tyre dhe këtë punë ata e zhvillojnë në praktikë, në jetë, në punë. Kur e gjithë Partia vigjilon dhe lufton, patjetër puna e armiqve s'ka jetë të gjatë. Kjo është rruga e bolshevizimit të Partisë dhe Partia jonë ecën me vendosmëri në këtë rrugë. Zbulimi i punës antiparti të grupit të Abedin Shehut me shokë i detyrohet vetëm vigjilencës revolucionare të anëtarëve të Partisë sonë, që e ndihmuan Komitetin Qendror.

Por mjerisht ngjet dhe diçka tjetër, që çdo zbulim armiqsh, agjentësh diversantë e trockistë, brenda ose jashtë Partisë, shumë organizata të Partisë, anëtarë të thjeshtë të Partisë dhe drejtues i habit dhe dëgjohet të thonë si pa gjë të keqe: «kjo na ra si bombë», «këtë nuk e prisnim», «kjo s'na shkonte ndër mend» ose «këta njerëz s'na e merrte mendja të ishin armiq ose spiunë» etj. Ç'tregon kjo? Kjo tregon mjaft gjëra. Ka shokë të ndershëm që bëjnë konferenca, që mbajnë fjalime e thërrasin me të madhe se duhet ashpërsuar lufta e klasave, por këta akoma s'e bëjnë këtë luftë klasash në jetë, në praktikë, u kalojnë gjërat, si i thonë fjalës «nën

mjekër» dhe kujtojnë se armiku i klasës do të mbajë një tabelë në gjoks që të njihet mirë. Ka shokë të ndershëm, që flasin në teori për presionin e borgjezisë në Parti, që armiku përpiqet me çdo kusht të futë njerëz në organizatat tona të Partisë dhe të shtetit dhe jo vetëm në organizatat bazë të Partisë dhe në institucionet e ulëta të shtetit, bile edhe në forume drejtuese, por në praktikë dhe në jetë këtë presion të borgjezisë kundër Partisë ata nuk e shohin, nuk e godasin, nuk e spastrojnë. Këto shfaqje si pa gjë të keqe, i marrin si të rastit, ose si çështje të parëndësishme, sepse ata vetë s'janë zhveshur krejtësisht nga mbeturinat mikroborgjeze dhe nuk mund t'i shohin këto edhe te të tjerët. I shohin vetëm atëhere kur, si thotë populli, ja bëjnë «mu». Por tamam atëhere është shumë vonë, atëhere Partisë, popullit i është bërë dëmi dhe tamam nga kjo nuk zbulohet në kohë puna armiqtësore.

Abedin Shehu dhe shokët e tij, duke e gënjyer Partinë, duke e shpërdoruar besimin e Partisë, muarën pozita të rëndësishme në Parti dhe në shtet dhe, që pas kongresit të Partisë, ata u rigrupuan dhe formuan grupin e tyre, i cili vepronte në prapashpinën e Partisë, si një grup antiparti, antipopullor dhe trockist.

Për këta elementë direktivat dhe vendimet e Partisë e të qeverisë s'kishin asnjë rëndësi, bile nuk përfilleshin, përbuzeshin, shkeleshin. Kjo ngjiste se këta s'kishin besim as te Partia as te udhëheqja e saj as te Qeveria e Republikës Popullore. Këta njerëz ishin të fryrë nga një megalomani tipike trockiste dhe nga një ambicie e sëmurë. Ata e quanin veten si «komunistët më të zot», që «e kishin teorinë marksiste-leniniste në

majë të gishtërinjve», por që në realitet kjo ishte teori e Anastas Lulës, që përmenda më lart, pse nga teoria e vërtetë marksiste-leniniste ata as që merrnin erë fare, megjithëse përdornin edhe disa fraza të kësaj teorie të vërtetë, të cilat u shërbenin atyre vetëm për t'u hedhur hi syve naivëve dhe atyre njerëzve, që përpiqeshin t'u hidhnin grepin. Ky grup diskutonte, kritikonte, dekonspironte çdo direktivë dhe çdo urdhër të Komitetit Qendror e të qeverisë. Sekretet e shtetit, të ushtrisë, të mbrojtjes i kishin bërë objekt muhabeti rreth kupës së rakisë dhe në mes ahengjeve. Anëtarët e grupit konsultoheshin më parë me njëri-tjetrin dhe sidomos me Abedin Shehun para se të shkonin të zbatonin detyrat e tyre, që u ngarkoheshin nga Partia dhe qeveria dhe kur ktheheshin për të dhënë llogari, ata jepnin më parë llogari në grupin e tyre. Njerëzit e këtij grupi, nga diskutimet e tyre që bënin mbarë dhe prapë, delnin me konkluzionet e tyre, me pikëpamjet e tyre, që ishin në kundërshtim me ato të Partisë dhe të qeverisë dhe këto i zbatonin në jetë dhe në punë. Duke sulmuar vijën e Partisë e direktivat e saja, ata sulmonin njëkohësisht udhëheqjen e Partisë dhe njerëzit drejtues të Partisë e të shtetit. Ata ruanin çdo çast, përpiqeshin të përfitonin në rrugën antiparti nga çdo gabim që mund të vërte-tohej, vëzhgonin dhe përpiqeshin të përfitonin nga çdo e çarë që ata mendonin se ekzistonte në radhët e udhëheqjes, ushtronin presion, merreshin me kritika të ulëta dhe dezinformonin për të forcuar pozitat e tyre drejtuese dhe për t'u ngjitur më lart, për të marrë poste drejtuese më me rëndësi në Parti dhe në shtet.

Grupi i Abedin Shehut vepronte si një qendër or-

ganizuese dhe mobilizuese e elementit të dobët, karrierist, llafazan, megaloman, ambicioz, me origjinë shoqërore jo të shëndoshë, ndërsa atyre që mund të ishin punëtorë ua dërmonte ndjenjat, duke i demoralizuar, ose duke ua rritur mendjen për t'i degjeneruar dhe për t'i deklasuar. Format e rigrupimit të tyre ishin po ato të ish-grupit të «Të Rinjve». Ata lidheshin me njëri-tjetrin me miqësi, me shoqëri të sëmura, me anën e qejfeve imorale, me anën e komprometimit, me anën e lajkave, të mburrjeve për njëri-tjetrin, me anë shpifjesh për njëri-tjetrin, me anën e korruptimit, me anën e kërcënimit që u bënë në tjerëve nga pozitat që zinin në Parti dhe në shtet, me zbulimin e ekzistencës së pakënaqësive në njerëzit dhe me nxitjen e këtyre pakënaqësive ndaj Partisë, ndaj pushtetit ose individëve të veçantë, me krijimin e moskënaqësive të reja etj.

Për të grumbulluar elementë rreth vetes njerëzit e këtij grupi përdornin korruptimin në radhë të parë, zhvillonin frymën lokaliste, në dëm të politikës së drejtë të Partisë dhe të qeverisë. Metodatat e bajraktarizmit ishin metodatat e tyre në dëm të influencës së Partisë dhe të pushtetit popullor. Në krahinat e Kukësit e të Peshkopisë, çdo përparim që bëhej atje, qoftë në lëmin ekonomik, qoftë në lëmet e tjera, grupi i propagandonte se ishte Abedin Shehu ai që i bënte këto. E tillë ishte propaganda e tyre sa që edhe anëtarë partie nga ato rrethe kishin arritur të mendonin dhe të thoshnin me mburrje prej lokalisti të sëmure: «e nxori dhe Kukësi një njeri të madh, Abedin Shehun, i cili është një mbështetje për atë krahinë» dhe një pikëpamje e tillë i bënte këta anëtarë partie naivë, që kurdoherë që vinin



në Tiranë me punë private ose shtetërore, më parë do të shkonin te «bajraktari» Abedin Shehu të merrnin vijën, pastaj të shkonin ku duhej të shkonin. Por ky lokalizëm nuk shtrihej nga ana e tyre vetëm në krahinën e Kukësit dhe të Peshkopisë, ky përpiquej të shtrihej dhe në elementin tiranas e të krijonin edhe baza në Shkodër. Grupi i Abedin Shehut afronte rreth vetes shokë partie tiranas ose që kishin jetuar në Tiranë dhe ekzistonte tendenca me krijue influencë edhe në Shkodër me anë krushqish e me mënyra të tjera. Kjo rrugë, natyrisht, i çonte këta në ndasitë e vjetra borgjeze dhe antimarksiste, toskë e gegë. Propagandimi i këtyre «njerëzve të mëdhenj» nga ana e grupit bëhej me insistim, jo vetëm në rreth të ngushtë, por edhe në rrethe të gjera e të ndryshme dhe këto patjetër s'bëheshin pa qëllim, por bëheshin në dëm të Partisë dhe të unitetit të saj.

Le të shohim tani konkretisht në se kanë konsistuar aktet e sabotazhit të grupit të Abedin Shehut, të Niazi Islamit dhe të Shyqri Këllezit me shokë: mbjellje disfatizmi dhe demoralizimi në kuadrot e sektorëve të industrisë; në Kuçovë dhe Patos, veçanërisht, u sabotua plani i shpimit dhe i prodhimit nga Shyqri Këllezi dhe shokët e tij, të cilët ishin solidarë dhe vepronin nën urdhërat e Abedin Shehut. Vetë u detyruan të pohojnë se materiali ekzistonte për të realizuar atë plan, por Shyqri Këllezi dhe Abedin Shehu në mbledhje të gjera të teknikëve dhe të punëtorëve të naftës, kanë folur haptas se «plani nuk mund të realizohet» dhe se «ata e kishin humbur krejt shpresën në ardhjen e ma-

terialit tjetër plotësues». Nga ana tjetër, ata dhe shokët e tyre në fushat vajguore krijuan një çorganizim të madh dhe përhapën frymën demobilizuese ndër punëtorët. Ata proceduan me qindra punëtorë pa faj vetëm për arsye se kishin munguar kush tri minuta, kush pesë minuta nga orari i punës, dhe, nga ana tjetër, jo vetëm që këta punëtorë dënoheshin pa faj e i demoralizonin, por i hiqnin nga prodhimi me orë të tëra për t'i gjykuar dhe proceduar. Shyqri Këllezi dhe Abedin Shehu përbuznin haptas eksperiencën sovjetike duke e diskredituar këtë eksperiencë në sy të teknikëve të tjerë dhe të punëtorëve. Abedin Shehu dhe Shyqri Këllezi në këtë sektor të rëndësishëm u mbështetën në disa teknikë shqiptarë jo të ndershëm dhe jo të besueshëm. Kuçova dhe Patosi për ta ishin shndërruar në vende dëfrimi dhe vilexhiature për njerëzit e grupit, ku bëheshin ahengje dhe nga ana tjetër sabotonin mirëqenjen e punëtorëve, sabotonin ndërtimin e shtëpive për punëtorët dhe furnizimin e tyre. Shyqri Këllezi dhe Abedin Shehu e konsideronin veten si agallarët e këtij çifliku të madh dhe për ta s'kishte vlerë as Partia as drejtimit dhe udhëzimet e saj. Punëtorët goditeshin rëndë prej tyre, shaheshin prej tyre sikur të ishte koha e okupacionit. Dhe kur bëheshin të gjitha këto gjëra, kur Partia e ngrinte me forcë nxjerrjen e fuqisë punëtore dhe pjesëmarrjen e gjerë në prodhim, kur Partia mobilizonte punëtorë dhe forconte klasën punëtore, ky grup antiparti, e shkallmonte, e demoralizonte, e godiste klasën punëtore. Nga një anë Abedin Shehu ngrinte gjoja me forcë nevojën e fuqisë punëtore, pse ndryshe s'mund të realizohej plani i ndërtimeve dhe i

industrisë, nga ana tjetër, kur Partia dhe rinia i përgjigjej thirrjes së Komitetit Qendror dhe të qeverisë, Abedin Shehu e Shyqri Këllezi, i kthenin punëtorët, i demoralizonin, i linin pa bukë e pa strehë.

Grupi i Abedin Shehut dhe i Niazi Islamit me shokë propagandonin me të madhe se plani është i parrealizueshëm, pse ai s'është i studjuar mirë, pse nuk ka organizim dhe mobilizim, pse nuk ka drejtim të mirë. Nga ana tjetër, këta elementë, si Abedin Shehu, Niazi Islami dhe Shyqri Këllezi, ishin ata që Partia u kishte besuar sektorë nga më të rëndësishmit të ekonomisë shtetërore dhe, pikërisht në këta sektorë që këta drejtonin, kemi mosrealizim të madh të planit, pra, kemi sabotim të planit nga ana e tyre, duke i shkaktuar dëme të konsiderueshme ekonomisë së vendit.

Trockisti Niazi Islami shqelmonte të gjithë eksperiencën e vlefshme sovjetike në organizimin e mirë të transportit, ai mashtronte qeverinë sy për sy, duke u përpjekur të kalonte forma organizimi të trockistëve jugosllavë, për forma të drejta dhe si të nxjerra nga eksperiencia sovjetike. Niazi Islami nuk zbatonte vazhdimisht ligjet dhe rregulloret e qeverisë për transportin. Ai në fakt u bë bashkëpunëtori i agjentëve dhe i spiunëve sabotatorë që vepronin në hekurudhë nën drejtimin e Rankoviçit. Ky i mori nën mbrojtjen e tij këta sabotatorë dhe me gjithë sinjalizimin, që i bëhej nga ana e qeverisë, Niazi Islami jo vetëm që nuk merrte masa, por propozonte për dekorim agjentët e diversantët jugosllavë. Niazi Islami është direkt përgjegjës dhe frymëzues i dëmeve të mëdha në hekurudhë. Ai ishte frymëzuesi dhe udhëheqësi i sabotazhit të transportit

automobilistik dhe veçanërisht i automobilave ZIS që na vinin nga Bashkimi Sovjetik. Ai në fillim përhapi parullën se rimorkiot, që kanë ardhur nga Bashkimi Sovjetik, nuk mund të përdoren në rrugët tona dhe në fakt, me gjithë insistimin e qeverisë, ai kundër urdhërave të saj për një kohë të gjatë nuk i vuri në lëvizje këto rimorkio duke i shkaktuar shtetit një dëm të madh në transport, të cilin e çorientoi. Pas grushtit të rëndë që hëngri në këtë drejtim, ai përhapi parullën se ZIS-et sovjetike harxhonin shumë benzinë. Kjo ishte një shpifje dhe njëkohësisht një sabotazh i dorës së parë, pse me këtë parullë Niazi Islami u bë përkrahësi i atyre kusarëve, që vepronin në transport duke vjedhur dhe duke shitur kontrabandë benzinën e shtetit. Kjo veprimtari sabotazhi, e kryesuar nga Niazi Islami, ishte e koordinuar me gjithë veprimtarinë e agjentëve të tjerë titistë dhe bëhej në momente shumë të vështira nëpër të cilat kalonte vendi ynë; ajo bëhej në momente, kur transporti ynë ishte shumë i dobët, kur Bashkimi Sovjetik dhe demokracitë popullore dërgonin te ne material të rindërtimit e të konsumit të gjerë për popullin dhe ky material aq i vlefshëm, nuk transportohej dot në qendrat e ndryshme; ajo bëhej në një moment kur na mungonte benzina dhe Niazi Islami mbronte kusarët dhe shpërdoruesit e benzinës. Niazi Islami me shokë, me sabotazhet që bënte, ndiqte shumë qëllime: nga një anë sabotonte transportin hekurudhor, automobilistik etj., nga ana tjetër nuk furnizonte popullin për të plotësuar nevojat e tija, dezekuilibronte realizimin e planit.

Grupi antiparti i Abedin Shehut në fakt do të bashkonte veprimtarinë e tij me atë të reaksionit ndër-

kombëtar dhe veçanërisht titist, që pretendonin se Shqipëria është e izoluar, se Bashkimi Sovjetik dhe demokracitë popullore, nuk po e ndihmojnë më Shqipërinë. Nga ana tjetër, grupi në fjalë propagandonte dhe nxiste parullën armike «përse të bëjmë tregëti me demokracitë popullore, duhet të bëjmë tregëti dhe të kemi lidhje me shtetet e Perëndimit»<sup>1</sup>. Këto parulla përngjanin me ato të amerikanëve, që propagandonin planin Marshall. Këto sabotime në kurriz të popullit i shërbenin këtij grupi antiparti dhe antipopullor, për të forcuar dhe «prestigjin» e këtyre sabotatorëve.

Me muaj të tërë s'vente as kripë as vaj në krahinat e Veriut. Kjo patjetër krijonte moskënaqësi në popull dhe Abedin Shehu në shëtitjet e tija që bënte në ato krahina u fliste se me të shkuar në Tiranë do ta rregullonte këtë punë! Kripa dhe sendet e tjera, nën presionin e vazhdueshëm të qeverisë, më në fund dërgoheshin në këto krahina, por elementët e këtij grupi propagandonin se këtë punë e bëri Abedin Shehu dhe «zotësia» e Niazi Islamit.

Ky grup kishte zhvilluar dhe kishte vënë në zbatim format e sabotazhit edhe në sektorë të tjerë nga më të rëndësishmit të ekonomisë sonë. Në industri ata sabotuan prodhimin e naftës dhe të nënprodukteve të saj, prodhimin dhe transportin e kromit, transportin e çimentos dhe nxjerrjen e bitumit dhe të bakrit, me një fjalë sektorët më të rëndësishëm të industrisë sonë. Me

<sup>1</sup> Zgjerimi i rrjetit të tregëtisë, në një kohë kur vendi ynë me vështirësi po përballonte edhe tregëtinë me shtetet e demokracive popullore, nga vet kushtet tona ekonomike të asaj periudhe, ishte i pamundur.

këto sabotazhe ndiqeshin prej tyre shumë qëllime: të dëmtonin ekonominë e shtetit tonë dhe ta varfëronin këtë, të ngjallnin pakënaqësi në popull për sendet e nevojave të dorës së parë për konsum dhe për ndërtim. Kështu bëheshin sabotime edhe në degët e tjera të ekonomisë. Uleshin eksportimet tona dhe kështu, duke mos mbajtur angazhimet e veta, vihej në pozita të vështira shteti ynë dhe diskreditohej ai në sy të Bashkimit Sovjetik dhe të demokracive popullore.

Më duket se s'është nevoja të zgjatem më tepër mbi këtë grup antiparti dhe trockist, pse Rezolucioni i Plenumit V dhe punimi i tij në aktive dhe në organizatat bazë të Partisë, ja bëri gjithsecilit të qartë punën dhe rrezikshmërinë e këtij grupi. Partia nxori një tok gjërash të tjera të poshtra të këtyre elementëve që po t'i riprodhoj për të ilustruar çka ekspozova më lart në këtë raport, do të duheshin edhe pesë herë a më shumë faqe se sa kam shkruar. Sikundër shprehet edhe Rezolucioni i Plenumit V, ky grup antiparti dhe trockist punonte për të dëmtuar Partinë tonë, për të diskredituar Bashkimin Sovjetik dhe demokracitë popullore, për të forcuar pozitën e veta në Parti dhe në shtet dhe, në çastin që ai do ta mendonte të përshtatshëm, të pëlciste bomba në Parti. Por bomba plasi në duart e tyre. Partia i mbërtheu me shpatulla në mur.

Përsa i përket punës antiparti të Nexhip Vinçanit, ajo ka qenë shumë e rrezikshme, pse Nexhip Vinçani dhe shoku i tij Gjini Marku, nuk kanë vepruar në tym, por kanë pasur dhe ata një qëllim të tyre të kurdisur, kundër Komandës udhëheqëse të ushtrisë dhe kundër gjithë udhëheqjes së Partisë. Karakteristike është, nga

ana tjetër, se veprimtaria e Nexhip Vinçanit zhvillohej paralelisht, me po të njëjtat tipare me atë të grupit të Abedin Shehut, por në sektorin e ushtrisë. Puna e Nexhip Vinçanit dhe e shokut të tij Gjin Markut, nuk është vetëm pjellë e një mentaliteti të sëmurë e mikro-borgjez, por është vepër e dy megalomanëve ambiciozë dhe intrigantë të mëdhenj, që hartojnë plane të rrezikshme në kokën e tyre, të cilat tregojnë me të vërtetë sa vlejnë si anëtarë partie dhe për ç'gjëra të dëmshme ata kanë qenë të aftë. Vetëm natyra sekrete e detyrës ushtarake, ku ata ishin ngarkuar të punonin, më ndalon t'u them dhe të ekspozoj para jush sa e ndytë ka qenë veprimtaria antiparti e Nexhip Vinçanit, e këtij elementi jashtëzakonisht të dobët, pa kurrfarë morali komunist dhe vendosmërie komuniste. Nexhip Vinçani, veçanërisht, s'kishte dhe s'tregonte asnjë besim te Partia. Ai kishte një frikë të jashtëzakonshme nga Partia, pse ai nuk e quante Partinë si të tijën. Ai, me ndërgjegje, i fshihte çdo gjë Partisë dhe vazhdon t'i fshehë shumë gjëra të tjera. Ai është treguar përpara Partisë një akrobat dhe matrapaz, si një njeri gjoja i gënjyer nga Gjin Marku. Gjin Marku ka fajet e tij shumë të rënda, por Nexhip Vinçani nuk është gënjyer nga Gjin Marku dhe s'mund të gënjehej kollaj. Por kjo ishte «mbulimi» i tij i fundit për të zvogëluar fajet e tij të rënda dhe për të krijuar një situatë të tillë, që në rast se Gjin Marku do të pendohej dhe të zbulonte kalbësirën që ekzistonte në ta, Nexhip Vinçani të gjente pretekstin dhe të përgatiste terrenin, që të mos besonte njeri në thënjet e Gjin Markut. Kjo është tipike e një beu matrapaz, që kapet me presh në dorë.

Ju jeni në korrent të veprimtarisë dhe të qëllimeve të Nexhip Vinçanit. Këtu nuk do të përsëris ato që u thanë në Rezolucionin e Plenumit V dhe të gjitha ato që zbuloi Partia. Por përveç këtyre, Nexhip Vinçani ka dekonspiruar sekretet e Komandës së Përgjithshme nga më të rëndësishmet, ka shpifur kundër udhëheqjes; këto tregojnë se Nexhip Vinçani është një intrigant i ulët, një përçarës, një element sa servil, aq edhe megaloman, të mos flasim për të tjerat. Në këto punë ishte dhe Gjin Marku solidar me të. Gjin Marku në autokritikën e tij me shkrim që i drejtoi tani së fundi Komitetit Qendror, i zbuloi të gjitha këto sa përmenda më lart, shqip, zhveshur dhe pa fraza boshe. Këto pohime të Gjin Markut e ndihmuan Partinë për ta parë më qartë këtë punë.

Nga të gjitha këto gjëra ne duhet të nxjerrim mësim dhe detyra për të gjithë Partinë, për t'i zhdukur të metat në punën tonë.

Pikësëpari duhet të forcojmë punën organizative dhe atë politike në Parti. Nga zbulimi i këtyre ngjarjeve të fundit dhe nga punimi i Rezolucionit të Plenumit V si dhe nga punimi i letrave të tjera direktive që i janë dhënë herë pas here Partisë brenda këtij viti, ne nxjerrim konkluzionet se përveç sukseseve që ka arritur Partia jonë në forcimin e saj organizativ, ka akoma shumë të meta dhe gabime që duhet t'i spastrojmë.

Shumë e rëndësishme është që të kuptohet dhe të zbatohet Statuti i Partisë dhe rregullat e tij prej të gjithëve, jo vetëm nga anëtarët e thjeshtë të Partisë, por nga udhëheqësit e nga forumet që shumë herë i shkelin.



Nuk mjafton vetëm të jepen udhëzime dhe të bëhen leksione për ta kuptuar Statutin, por më e rëndësishmja është që të ndiqet mirë në jetën e Partisë se si zbatohet Statuti dhe nenet e veçanta të tij, që janë ligjet themeltare mbi të cilat mbështetet Partia jonë. Në këtë drejtim vetëm Komiteti Qendror duhet të kontrollojë më mirë zbatimin e Statutit nga komitetet e Partisë në radhë të parë dhe pastaj nga çdo anëtar i Partisë dhe të marrë masa në këtë drejtim.

Drejtimesit dhe komitetet nuk i respektojnë sa duhet të drejtat e anëtarit të Partisë; ka mjaft burokratizëm, moskokëçarje dhe fodullëk në këtë drejtim. Kjo është shumë e dëmshme dhe e rrezikshme. Ka ngjarë që komitetet e Partisë të rretheve të mos shohin gabimet e shokëve të tyre të komitetit, t'i lënë këto gabime pa i kritikuar ashpër dhe pa i goditur këta njerëz dhe, nga ana tjetër, me një lehtësi të madhe dhe pa kurrfarë drejtësie prej komunisti, të përjashtojnë nga Partia nga 30-40 anëtarë partie përnjëherësh, pa i studjuar mirë dhe një nga një çdonjërin. Në më të shumtat e rasteve kopaçja bie mbi anëtarët e thjeshtë të Partisë, kurse drejtimesit e forumet mbeten të paprekur dhe të pakritikueshëm për gabimet e tyre. Këtë rrjedh një sëmundje shumë e rrezikshme për Partinë, pse krijohet kështu një shtresë burokratësh dhe aristokratësh në Parti, të cilët përdorin autoritetin e Partisë dhe shpërdorojnë Statutin e Partisë për të fshehur gabimet e tyre. Partia këtë gjë nuk duhet ta lejojë në asnjë mënyrë. Prandaj duhet të zhduket rrënjësisht drojtja te anëtarët e Partisë për të kritikuar këdo qoftë, udhëheqës dhe forum, kur këta bëjnë gabime dhe aspak të mos mendohet se nje-

rëzit në Parti kontrollohen vetëm nga lart, domethënë se vetëm udhëheqësit kontrollojnë ata që kanë nën drejtimin e tyre.

Shoku Stalin na mëson:

*«Kontrolli nga lart, sigurisht, është i nevojshëm si një nga masat efektive për të kontrolluar njerëzit dhe për të kontrolluar zbatimin e detyrave. Por e gjithë puna e kontrollit nuk mbaron aspak vetëm me kontrollin nga lart. Ka edhe një formë tjetër kontrolli, kontrolli nga poshtë, kur masat, kur vartësit kontrollojnë drejtuesit, vënë në dukje gabimet e tyre dhe tregojnë se si mund të ndreqen ato. Kjo formë kontrolli është një nga mënyrat më efektive për të kontrolluar njerëzit»<sup>1</sup>.*

Në Partinë tonë kemi shumë gjëra për të bërë në këtë drejtim dhe kjo është me shumë rëndësi, pse në rast se nuk veprohet në mënyrën e mësipërme, thyhet centralizmi demokratik, zhduket liria e kritikës dhe e autokritikës dhe pengohet kontrolli i udhëheqësve të Partisë nga masat e Partisë. Këtëj kanë rrjedhur shumë rreziqe në Partinë tonë, këtëj ka rrjedhur që shumë çështje mund të zgjidheshin më shpejt dhe të shmangeshin gabime dhe dëme. Këtëj rrjedh që në mjaft organizata bazë mbledhjet nuk bëhen të gjalla. Kjo ngjet sepse disa anëtarë partie nuk pregatiten seriozisht

---

<sup>1</sup> J. V. Stalin. Veprat, vëll. 14, f. 127.

dhe shkojnë formalisht në mbledhje, rendi i ditës nuk hartohet mirë dhe se problemet nuk shtrohen si duhet. Kjo gjendje ndreqet, përmirësohet, përparon, kur çështja themelore të vihet drejt. Çështja kryesore është që në mbledhjet e Partisë, në aktive, në konferenca, në kongrese, anëtari i Partisë jo vetëm të dëgjojë raportet e udhëheqësve, por edhe të kritikojë mungesat, gabimet, njerëzit me plot gojën dhe të ushtrojë të drejtën që ka për të kërkuar edhe llogari, t'i zgjedhë përsëri ata që punojnë mirë dhe t'i heqë ata që bëjnë gabime. Kjo gjë nuk praktikohet si duhet në Partinë tonë dhe është për këtë arsye që nuk ka kurdoherë frymë luftarake në diskutimet që zhvillohen në organizatat bazë të Partisë. Shokët druhen të shfaqin haptas pikëpamjet e tyre, të mira ose të shtrembra dhe në rast se janë të gabuara, t'u ndreqen atje, të binden dhe të dalin të qartë nga mbledhja. Por ngjet që kur ata guxojnë të kritikojnë, ka njerëz që ua presin hovin me autoritetin e tyre që e shpërdorojnë. Kjo sjell që shumë herë mjaftohet me ndonjë kritikë që i bëhet ndonjë shoku me nivel të ulët, që ka thënë kështu, ose ka bërë ashtu dhe lihet mënjanë diskutimi i problemeve të rëndësishme e kritika e të metave rrënjësore. Kalohet mbi këto, duke thënë se «këto i di Partia, këto i di komiteti ose Komiteti Qendror, prandaj të mos flasim». Komunistët janë njerëz me horizont të gjerë, me mendime të zhvilluara dhe të përparuara, janë njerëz revolucionarë, që kanë mendime të reja dhe këto përbëjnë forcën e vërtetë të Partisë sonë. Në rast se kjo forcë e madhe e Partisë, ky dinamizëm bolshevik i masave të Partisë nuk merret parasysh, atëhere fishket forca e Partisë

dhe mbeten komitetet dhe drejtuesit si burokratë të pavlefshëm. Lenini dhe Stalini na porositin që jo vetëm duhet t'i mësojmë masat, por edhe të mësojmë nga masat dhe neve, udhëheqësve, të mos na rritet mendja, gjë që ngjet shpesh te ne duke kujtuar se i dimë të gjitha. Shoku Stalin thotë:

*«Posti në vetëvete nuk të jep njohuri dhe eksperiencë. Aq më pak i jep këto titulli.*

*Kjo do të thotë se për të drejtuar mirë nuk mjafton vetëm eksperiencia jonë, eksperiencia e drejtuesve, se prandaj eksperiencia jonë, eksperiencia e drejtuesve, duhet të plotësohet me eksperiencën e masave, me eksperiencën e masës së partisë, me eksperiencën e klasës punëtore, me eksperiencën e popullit»<sup>1</sup>.*

Do të vazhdoj shokë me citate të Stalinit:

*«... ta dëgjojmë me vëmendje zërin e masave, zërin e anëtarëve të thjeshtë të partisë, zërin e të ashtuquajturve «njerëz të thjeshtë», zërin e popullit... Zgjidhjen e drejtë nuk mund ta gjesh pa u mbështetur në eksperiencën e masave, të cilat i provojnë mbi shpinën e vet rezultatet e drejtimit tonë...*

*Dy shembuj që tregojnë se kjo tezë e Leninit është e drejtë.*

---

<sup>1</sup> J. V. Stalin. Veprat, vëll. 14, f. 132-133.

Kjo ka ndodhur disa vjet më parë. Ne, anëtarët e KQ, ishim duke diskutuar çështjen e përmirësimit të gjendjes në Donbas. Projekti i masave, i paraqitur nga Komisariati i Popullit për Industrinë e Rëndë, nuk ishte aspak i kënaqshëm. Projekti ju kthye tri herë Komisarariatit të Popullit për Industrinë e Rëndë. Tri herë muarëm nga Komisariati i Popullit për Industrinë e Rëndë projekte të reja. Dhe prapëseprapë asnjëri prej tyre nuk mund të quhej i kënaqshëm. Më në fund, vendosëm të thërrisnim nga Donbasi disa punëtorë dhe disa kuadro të thjeshtë të organizatave ekonomike dhe të bashkimeve profesionale. Biseduam për tri ditë me radhë me këta shokë. Dhe që të gjithë ne, anëtarët e KQ, u detyruam të pranonim se vetëm ata, këta punonjës të rëndomtë, këta «njerëz të thjeshtë» ditën të na tregonin zgjidhjen e drejtë. Ju kujtohet me siguri vendimi i njohur i KQ dhe i Këshillit të Komisarëve të Popullit mbi masat për shtimin e nxjerrjes të qymyrgurit në Donbas. Pikërisht ky vendim i KQ dhe i Këshillit të Komisarëve të Popullit, të cilin gjithë shokët tanë e quajtën të drejtë e bile të famshëm, na u sugjerua prej njerëzve të thjeshtë nga poshtë»<sup>1</sup>.

Sikundër e pamë më lart, në shumë degë të industrisë sonë punët nuk kanë shkuar mirë dhe sidomos në Kuço-

<sup>1</sup> J. V. Stalin. Veprat, vëll. 14, f. 133-134.

vë dhe në Patos. Tri herë me radhë Abedin Shehu dhe Shyqri Këllezi e kanë ulur planin e nxjerrjes së naftës, ashtu si u ka ardhur pas qejfit atyre, natyrisht, jo pa kundërshtime nga ana jonë. Por a kemi thirrur ne ndonjë grup punëtorësh dhe teknikësh nga fushat e vajgurit që të bisedojmë drejtpërdrejt me ta dhe të këshillohemi prej tyre? A kemi thirrur ne grupe punëtorësh nga sektorët e tjerë, për t'i dëgjuar ata ç'thonë dhe ç'na këshillojnë për të dalë nga situata të vështira? Jo, ne s'e kemi bërë këtë dhe vazhdohet të mos bëhet. Ne, anëtarët e Komitetit Qendror, kemi gabuar në këtë drejtim dhe s'kemi vepruar hiç mirë. Ne që jemi udhëheqës të Partisë e kemi nënvleftësuar zërin e njerëzve «të vegjël».

Po vazhdoj edhe me një citat tjetër të shokut Stalin, që ka të bëjë me mendimin që theksova më lart:

*«Kam parasysh rastin e shoqes Nikollajenko. Cila është kjo Nikollajenko? Nikollajenko është një anëtare e thjeshtë e partisë. Është një «njeri i thjeshtë», i zakonshëm. Një vit të tërë ajo dërgoi sinjalizime për dobësitë që ekzistonin në organizatën e partisë të Kievit, ku ajo demaskonte familjaritetin, qëndrimin e ngushtë filistin ndaj kuadrove, mbytjen e autokritikës, dhunën e sabotatorëve trockistë. Të gjithë i largoheshin si të ishte një mizë e bezdisshme. Më në fund, për të shpëtuar prej saj, e përjashtuan edhe nga partia. As organizata e Kievit as KQ i PK (b) të Ukrainës nuk e ndihmuan të gjente të drejtën. Vetëm ndërhyrja e Komitetit Qendror*

*të partisë ndihmoi që të zgjidhej kjo nyje ë ngatërruar. Ç'doli pas shqyrtimit të çështjes? Doli se Nikollajenko kishte të drejtë, kurse organizata e Kievit—jo. As më pak e as më shumë. Po ç'është kjo Nikollajenko? Sigurisht, ajo nuk është anëtare e KQ, nuk është komisarë e popullit, nuk është sekretare e organizatës së partisë të qarkut të Kievit, nuk është as sekretare e ndonjë celule, është vetëm një anëtare e thjeshtë e partisë.*

*Siç e shihni, nganjëherë njerëzit e thjeshtë janë shumë më afër së vërtetës se disa institucione të larta»<sup>1</sup>.*

Ka me mijëra e me mijëra anëtarë partie, që luftojnë, që vigjilojnë, që sinjalizojnë në organizatat bazë e në komitetet tona për punën e armiqve, për shkelje të rregullave të Statutit nga forume apo anëtarë të pandërgjegjshëm ose mashtrues, që zbulojnë njerëz që vjedhin, që shkatërrojnë, që punojnë për armikun; ka shokë që qahen për padrejtësitë që u ngjasin, por mund të themi pa u gabuar se shumë herë zëri i tyre nuk dëgjohet nga drejtuesit, ose këta s'u vënë rëndësinë e duhur, ose i fshehin se s'janë në rregull për veten e tyre dhe kanë frikë se u zbulohen të palarat. Dhe na ngjet një gjë e çuditshme: kur kërkohet llogari për çështjet, na thuhet se «Partia nuk është vigjilente, nuk është mobilizuar për atë ose këtë çështje». Kjo s'është e vër-

<sup>1</sup> J. V. Stalin. Veprat, vëll. 14, f. 134-135

tetë, s'mund të jetë e vërtetë, pse anëtarët e Partisë sonë janë revolucionarë të vendosur, e duan me shpirt Partinë dhe popullin, luftojnë dhe vigjilojnë, ata janë në gjendje të zbulojnë çdo punë armiqësore brenda dhe jashtë Partisë.

Do të them disa gjëra që e provojnë këtë pjekuri të Partisë sonë, këtë hov revolucionar, ashpërsinë dhe njëkohësisht drejtësinë shembullore të Partisë sonë.

I mbani mend plenumet dhe mbledhjet e organizatave të Partisë, kur u zbulua puna tradhëtare e Koçi Xoxes me shokë dhe e padronëve të tyre titistë, e mbani mend Kongresin I të Partisë, i keni të freskëta kujtimet nga aktivet dhe mbledhjet e organizatave bazë, ku u gjykua puna antiparti e Abedin Shchut, e Nexhip Vinçanit e të tjerëve? A e patë ç'forcë ka Partia, ç'logjikë marksiste-leniniste, ç'konsekuencë, ç'ashpërsi dhe ç'drejtesi në gjykime dhe në vendime? Nga kjo eksperiencë udhëheqja duhet të përfitojë dhe të nxjerrë mësimë se ka nevojë për këto mësimë të Partisë. Armiqtë trockistë u drodhën përpara masës së Partisë, pse ajo s'i lëshoi aq kollaj, por i mbërtheu me shpatulla në mur, i zhveshi lakuriq, si thotë populli. Vallë kjo forcë e madhe e Partisë a mos është një fenomen i çastit dhe i rastit? Në asnjë mënyrë jo. Po pse ngjet atëhere që ky hov bolshevik zvogëlohet? Mos vallë anëtarët e Partisë sonë zbuten ndaj armiqve të klasës, të Partisë dhe të popullit? Në asnjë mënyrë jo. Po pse vallë anëtarët e Partisë nuk e bëjnë mbledhjen e organizatës bazë një mbledhje luftarake, ku të shtrohen probleme, të diskutohet gjallërisht për ato, të kritikohen drejt ata që bëjnë gabime, të ndreqen të ndreqshmit dhe të goditen armiqtë, të kenë kurajë nje-



rëzit të bëjnë autokritikën e tyre haptas, pa frikë, pa drojtje? Vallë anëtarët e Partisë nuk e duan Partinë, nuk i dinë rregullat dhe nuk duan t'i zbatojnë? Jo, aspak jo. Çështja s'qëndron këtu, por qëndron në të metat që përmenda më lart: në formalizmin, në burokratizmin, në mendjemadhësinë që ka mbuluar disa udhëheqës dhe forume, të cilët nuk e kanë vetë në radhë të parë të qartë sa duhet Statutin e Partisë, rregullat, të drejtat e tyre dhe të drejtat e të tjerëve. Po si duhet t'i shërojmë këto? Ka shërim dhe ky shërim i domosdoshëm është kontrolli i kombinuar nga lart dhe nga poshtë, i përditshëm, i vazhdueshëm. Anëtarët e Partisë ta ndjejnë veten zot të vetëm në shtëpinë e tyre, në Partinë e tyre, ta përdorin kritikën dhe autokritikën si një armë të fuqishme, pa frikë nga askush. Organizatat e Partisë të gjallërohen, anëtarët e Partisë të luftojnë në to me atë hov bolshevik që i karakterizon në mbledhjet, në konferencat, në aktivet që përmenda më lart. Të zhduken dhe të luftohen kritikët e sëmura nëpër qoshe e vesh më vesh, pse këto e dëmtojnë dhe e dobësojnë Partinë, krijojnë rrethe të sëmura, e gangrenosin çështjen, e lejojnë armikun të ndërhyjë me lehtësi në këto rrethe.

Shoku Stalin na mëson:

*«Disa shokë thonë se nuk është mirë të flasin hapur për gabimet tona, sepse njohja e hapët e gabimeve tona mund të merret nga armiqtë tanë si dobësi dhe mund të shfrytëzohet prej tyre. Këto janë gjepura, shokë, janë me të vërtetë gjepura. Përkundrazi, njohja e hapët e ga-*

*bimeve tona dhe ndreqja e ndershme e tyre nuk mund të bëjë gjë tjetër veçse ta forcojë partinë tonë, të rritë autoritetin e partisë sonë në shtetë e punëtorëve, të fshatarëve, të inteligjencies punonjëse, ta rritë forcën dhe fuqinë e shtetit tonë. Dhe kjo është kryesorja. Mjafton të kemi me vete punëtorët, fshatarët, inteligjencien punonjëse, pa të gjitha të tjerat rregullohen»<sup>1</sup>.*

Partia duhet të rrojë e lidhur ngushtë me masat punonjëse të vendit tonë, t'ua thotë haptas të mirat dhe të këqiat, asgjë s'duhet t'i mbahet fshehur popullit, pse pa popullin Partia s'ka jetë. Atje dhe vetëm atje është forca e saj. Ne do t'u themi punëtorëve të Patosit se sjelljet e drejtorit dhe të shokëve të tij, që mbanin qëndrim brutal ndaj punëtorëve, që i procedonin pa të drejtë, që i shanin e i sikterisnin duke u thënë se «jeni ballistë», kanë qenë sjellje të palejueshme, të dënueshme dhe antikomuniste. Do t'u themi punëtorëve gjithashtu se në ligjin e mobilizimit që kemi nxjerrë ka gabime, nga të cilat kanë përfituar armiqtë e ne do t'i ndreqim. Ne do t'u themi punëtorëve se shteti ynë mund të bënte edhe më shumë në kushtet që kishim për përmirësimin e jetesës së tyre, por ka pasur burokratizëm në organet tona, ka pasur armiq që kanë sabotuar. U kemi thënë fshatarëve se jeta e tyre do të përmirësohet dhe u përmirësua e çdo ditë po përparon. U kemi thënë masave punonjëse të qytetit se jeta e tyre do të

---

<sup>1</sup> J. V. Stalin. Veprat, vëll. 14, f. 131.

përmirësohet dhe u përmirësua e dita-ditës do të përparojë. Por do t'u themi se ka akoma plot gabime, plot të meta, ka funksionarë të pandërgjegjshëm, që abuzojnë, që sillen keq, që mashtrojnë. Ata do t'i shtypim dhe të metat do t'i ndreqim me forcën dhe vigjilencën e Partisë, me forcën dhe vigjilencën e popullit që i ka shtërnguar radhët rreth Partisë së tij. Por vallë po t'ja themi këto hapët popullit mos do të dobësohet pushteti ynë? Përkundrazi, ne do të forcohem më tepër. Populli i urren rrenacakët, falsifikatorët, mashtruesit dhe i do e i mbron njerëzit e ndershëm, njerëzit e guximshëm, njerëzit që luftojnë, përpiqen, dërsijnë dhe flijohen për kauzën e tij. Por armiqtë e popullit tonë do ta përdorin autokritikën tonë të ndershme si një dobësi nga ana jonë. Aq na bën dhe as na prish punë. Le të bërtasë radio Beogradi dhe le të lëshojë gënjeshtër dhe shpifje me thes. Në vendin tonë herë pas here bëhen ulje çmimesh, ndërsa në Jugosllavi, në «parajsën» e Titos, të cilën trockistët e Beogradit e kanë shitur te imperialistët amerikanë, gjendja ekonomike është mjaft e vështirë dhe sendet e ndryshme si gjalpi, mishi e veza që te ne shiten me çmime të arësyeshme, atje shiten me çmime shumë të larta. Kur në tregun tonë ulen çmimet, atje shkojnë çmimet në qiell. Kur fshatari ynë është zot i tokës së tij, e punon atë, prodhon, përparon, në «parajsën» e Titos, kanë ardhur përsëri në fuqi Vërlacët, Vrionasit e Biçakçinj-të jugosllavë. Le të bërtasë radio Londra se gjoja kalamanët tanë po vdesin nga tuberkulozi, se s'kanë se ç'hënë. Populli qesh me këta sharlatanë dhe kalamanët tanë ua nxjerrin gjuhën një pëllëmbë duke u thënë atyre të Londrës dhe të Uashingtonit: «Mbajeni për vete dhe

helmoni veten me vezët pluhur dhe me qumështin e molepsur që përpiqeni të na i çoni neve jo për të na ushqyer, por për të na helmatisur, ashtu sikundër bëni me kalamanët e të gjitha shteteve të marshallizuara dhe për të na dërguar nën maskën e kësaj ndihme, spiunë dhe diversantë. Ne kemi gjalpin tonë, qumështin tonë, mishin tonë të freskët, që e prodhojnë kafshët tona që kullosin në male e në çaire të gjelbërta, të bukura dhe të lira të atdheut tonë të dashur. Ne kemi atdheun tonë të lirë, në jemi njerëz të lirë, ne kemi Partinë tonë, ne kemi Bashkimin Sovjetik, ne jetojmë të lirë, të shëndetshëm dhe mos u bëni merak për ne, se nuk vdesim ashtu si pretendoni ju. Ne u urojmë kalamanëve të vendeve të marshallizuara dhe të Shteteve të Bashkuara të rrojnë edhe ata si ne».

Kështu, shokë, vetëm kështu, Partia jonë do të bolshevizohet dhe do të lidhet ngushtësisht me masat e popullit. Kurdoherë ta kemi parasysh mësimin e Leninit që thotë:

*«Qëndrimi i një partie politike kundrejt gabimeve të veta është një nga kriteret më të rëndësishme dhe më të sigurt të seriozitetit të partisë dhe të zbatimit në fakt të detyrave të saja kundrejt klasës së vet dhe kundrejt masave punonjëse. Të pranosh haptazi gabimin, të zbulosh shkaqet e tij, të analizosh rrethanat që e shkaktuan atë, të shqyrtosh me kujdes mjetet për ta ndrequr gabimin — ja kjo është shënja e një partie serioze, ja kjo është kryerja nga ana e saj e detyrave të veta, ja ky është edu-*

*kimi dhe mësimi i klasës dhe pastaj edhe i masës»<sup>1</sup>.*

Prandaj komunistët nuk duhet t'i fshehin kurrë gabimet e tyre, sikundër ndodh shumë herë te ne. Të bësh autokritikë bolshevike është e zorshme dhe shumë i shmangen kësaj, por kjo duhet të mbarojë. Stalini na mëson:

*«Por bolshevikët, në duan me të vërtetë të jenë bolshevikë, duhet të kenë burrërinë, t'i pranojnë haptazi gabimet e veta, të zbulojnë shkaqet e tyre, të caktojnë mënyrat e ndreqjes së tyre dhe ta ndihmojnë kështu partinë, t'i mësojë drejt kuadrot dhe t'u japë një edukatë politike të drejtë, sepse vetëm në këtë mënyrë, vetëm me një autokritikë të hapët dhe të ndershme mund të edukohen kuadro me të vërtetë bolshevikë, mund të edukohen drejtues bolshevikë të vërtetë»<sup>2</sup>.*

Prandaj, shokë dhe shoqe, përpara na vihen detyra të rëndësishme: të forcojmë demokracinë e brendshme të Partisë në të gjitha format e saja, të forcojmë kritikën dhe autokritikën bolshevike, të forcojmë disiplinën e ndërgjegjshme dhe të hekurt, të forcojmë konspiracionin, i cili lë shumë për të dëshiruar si në Parti, në radhë të parë dhe në shtet ca më keq.

Për çështjen e fundit familjariteti i sëmure në mes

<sup>1</sup> V. I. Lenin. Veprat, vëll. 31, f. 49.

<sup>2</sup> J. V. Stalin. Veprat, vëll. 14, f. 129.

të njëri-tjetrit, moskuptimi sa duhet drejt i rëndësisë së funksionit që gjithsecilit i është ngarkuar dhe përgjegjësia që ai ka për kryerjen sa më mirë të detyrës së tij, moskuptimi si duhet i rrezikut të armikut të jashtëm dhe të brendshëm, i cili përgjon, punon për të tërhequr çdo informatë, i bën disa shokë, që mund të jenë dhe tanët, që të thyejnë konspiracionin, i bën ata që të mos i zëjë gjumi pa ja treguar gjitonit ose shokut detyrën o sekretin që ai duhet të ruajë pa menduar që jo vetëm s'ndreq ndonjë punë, pse ja tregon tjetrit, por përkundrazi prish punë. Kjo rrjedh, nga ana tjetër, nga bisedimet e shthurura dhe joserioze që zhvillohen jo vetëm në mes komunistësh, po edhe me ata që s'janë komunistë. Këtu s'është çështja, mos me u shoqëruë, mos me diskutue, mos me rrah probleme me njëri-tjetrin. Kjo do të jetë gabim, në parim gabim, pse atëhere, komunistët do të këputnin çdo kontakt me njëri-tjetrin, me masat, me popullin. Por një komunist di të gjykojë ç'duhet diskutuar, ç'duhet rrahur dhe ç'duhet mbajtur sekret në këto bisedime. Komunisti duhet ta matë çdo gjë me interesin e Partisë, të shtetit dhe të popullit dhe jo ta matë me familjaritetin që ka me njërin ose me tjetrin ose me kushërillëkun a me krushqinë. Kjo ngjet shpesh në radhët tona dhe e kemi parë sa dëme kanë rrjedhur këtej. Këto shfaqje duhet t'i luftojmë. Komunisti duhet të dijë vetë e të mësojë edhe të tjerët si duhet të kritikohen çështjet që s'janë vënë drejt dhe se këto kritika duhet të bëhen në organizatën bazë, në konferencë, në aktiv ose në qendrën e punës. Çdo gjë ka rregull, ka disiplinë. T'i bëjmë luftë anarkisë kudo dhe në çdo mënyrë që ajo të shfaqet.

Një detyrë tjetër me shumë rëndësi dhe urgjente që i vihet udhëheqjes së Partisë dhe gjithë Partisë është çështja e ngritjes ideologjike të anëtarëve. Këtu duhet të flasim qartë. Niveli ideologjik i anëtarëve të Partisë është shumë i ulët dhe prandaj duhet të vëmë të gjitha forcat në këtë drejtim që të përmirësohet gjendja. Patjetër nuk duhet të nënvleftësojmë rezultatet e mira që kemi arritur me çeljen e Shkollës së Partisë, me kurset teorike në qendrat e ndryshme të vendit tonë, nuk duhet të nënvleftësojmë përpjekjet që bëjnë vetë anëtarët e Partisë për të studjuar, por megjithkëtë jemi akoma mjaft prapa. Pa mësuar teorinë marksiste-leniniste nuk mund të ecim dot përpara, do të hasim shumë vështirësi dhe këto vështirësi po i hasim kudo dhe kurdoherë. Në Partinë tonë ka një përqindje të madhe komunistësh që s'kanë kulturë të përgjithshme të mjaftueshme ose që s'kanë fare, kemi akoma disa që janë pothuaj analfabetë. Duhet të bëjmë të gjitha përpjekjet, që këto të meta t'i zhdukim sa më parë, duhet përpjekje, kurajë, pse çdo gjë kapërcehet. Por, natyrisht, këto nuk mund të kapërcehen pa flakur tej metodat e Shyqri Këllezit dhe të disa të tjerëve, që jo vetëm s'kapnin me dorë Historinë e Partisë Bolshevike dhe material tjetër teorik, që ne disponojmë në sasi të mjaftueshme, por s'lexonin as «Zërin e Popullit» dhe asnjëfarë gazete; ata shkonin dhe edukoheshin me çka ju përrallose Abedin Shehu. Patjetër nuk mund të zhduket injoranca në Parti dhe në popullin tonë, në rast se nuk luftohet me forcë të madhe analfabetizmi, zhdukja e të cilit duhet të bëhet një detyrë e madhe e Partisë dhe e rinisë, në rast se nuk ndiqet me rigorozitetin

më të madh nga Partia dhe nga shteti, zbatimi i reformës shkollore, në rast se anëtarët e Partisë nuk e marrin si një detyrë të madhe përsipër që vetë t'i ndjekin me çdo kusht shkollat e kurset që janë ngritur për ta pa shkëputje nga puna. Të mos kënaqemi me sukseset që kemi korrur. Të jemi më shumë ekzigjentë dhe të kemi më tepër kontroll në çështjen e mësimin dhe të edukimit marksist, pse vetëm atëhere nuk do të ngjasin ato që na kanë ngjarë, pse vetëm atëhere nuk do të na ngjasë që në Parti të kemi njerëz që agjërojnë. Është karakteristikë se njerëzit tanë e ndjejnë nevojën e madhe të mësimin dhe të studimit, të gjithë kanë etje, por kur vjen puna që të organizohet si duhet studimi dhe shpërndarja e materialit ose e shtypit, i cili duhet të vejë kudo e të lexohet prej të gjithëve, ose të organizohet leximi edhe te ata që s'dinë të lexojnë, për këto as që merren masa serioze. Ky problem duhet të ngrihet me forcë nga e gjithë Partia dhe të kritikohen e të goditen në radhë të parë institucionet e qendrës, pastaj edhe institucionet e shpërndarjes në rrethe dhe në lokalitete.

Mësimi dhe kultura janë po aq të nevojshme sa edhe buka e në rastin tonë ja kalojnë edhe ca bukës, pse bukën populli ynë e ka tani të siguruar. Njerëzit që punojnë në sektorët e agjit-propit të Partisë si në qendër ashtu edhe në rrethe, duhet t'i vënë një rëndësi të madhe këtij problemi, të ndihmojnë njerëzit, t'i kontrollojnë vazhdimisht që të mos na ngjasë si me Niko Xhaçkën, i ngarkuar me agjitacionin dhe propagandën në Komitetin e Partisë në Korçë, i cili, në vend që të drejtojë propagandën e Partisë, drejton mbledhje të



pakënaqurish, nxit pakënaqësitë te njerëzit që i fërkojnë krahët, që i bëjnë lajka dhe ka arritur që t'i rritet mendja, që t'i fryhet koka e t'i bëhet daulle, të hiqet njeri shumë i zoti dhe të lërë që në gjimnazin e Korçës dhe në spitalin e po këtij qyteti të zhvillohet propagandë armiqësore. Por për fat të mirë në Partinë tonë nuk janë shumë ata që mendojnë si Niko Xhaçka dhe ca më pak që punojnë si ai. Ka njerëz të thjeshtë dhe të pastër që kanë pak kulturë, që janë punëtorë ose fshatarë të thjeshtë, por që bëjnë përpjekje të mëdha për të mësuar, për t'u kulturuar, për të përvetësuar teorinë marksiste-leniniste megjithëse nuk e zotërojnë atë si duhet. Do të vijë koha shpejt që ata do ta zotërojnë, pse janë njerëz të thjeshtë të popullit. Do t'ju sjell një shembull, që karakterizon përpjekjet e njerëzve tanë:

Sekretari i organizatës bazë të Partisë të lokalitetit të Vithkuqit, Haxhi Çemericë, një fshatar i thjeshtë, po lufton me kulakët, të cilët i njeh mirë në praktikë se ç'janë dhe cilët janë, ua di manevrat dhe i lufton, por dëshiron dhe bën përpjekje që këtë luftë kundër kulakëve ta kuptojë edhe nga ana teorike. Dhe ai lexon me etje Historinë e Partisë Bolshevike. Kur lexoi kapitullin e Historisë së Partisë Bolshevike, që bën fjalë për narodnikët, ai tha: «I gjeta, kulakët janë narodnikët». Kur kaloi në kapitullin tjetër, ku flitet për menshevikët, ai erdhi në konkluzionin se «kulakët janë menshevikë». Më vonë kur lexoi kapitullin mbi trockistët, tha: «Kulakët janë trockistë». S'ka gjë pse sekretari i organizatës bazë të fshatit të Vithkuqit nuk i ka edhe aq të qarta këto gjëra, por një gjë është e sigurtë,

se ai do t'i mësojë ato dhe do t'i ketë edhe më të qarta se Niko Xhaçka dhe këtë sekretar organizate, anëtar të thjeshtë dhe të pastër të Partisë nuk do ta gënjejnë kurrë as narodnikët as menshevikët dhe as trockistët, por do ta pësojnë kulakët nga ai sekretar organizate nën çdo etiketë që ata të fshihen. I tillë është brumi i Partisë sonë që rritet, që mëson, që lufton.

Duke mbaruar do të prek shkurtimisht edhe një çështje tjetër, pse për këtë do të flitet veçanërisht në referatin për çështjet organizative. Është çështja e politikës së kuadrit që duhet të bëjë Partia. Pa asnjë dyshim, ne jemi larg pikëpamjeve të gabuara, që ekzistonin mbi kuadrin dhe politikën e kuadrit në kohën e trockistëve Koçi Xoxe me shokë. Ne kemi përparime dhe përmirësime. Por ne kemi akoma shumë të meta në Komitetin Qendror dhe në komitetet e rretheve.

Duhet të kuptohet mirë se roli i organeve që merren me kuadrin, nuk konsiston vetëm me transferime ose emërime. Kjo është një pjesë e punës. Pjesa tjetër dhe nga më të rëndësishmet është me e studjue kuadrin, me e zgjedhë kuadrin, me e shtue kuadrin, me e edukue kuadrin në kompleksin e tërë politikës së drejtë të kuadrit. Drejtoria e kuadrit në Komitetin Qendror konsiderohet nga të gjithë si një fabrikë kuadrosh, ndërsa duhet të konsiderohet drejt se burim kuadrosh është Partia, është populli, janë masat e gjera punonjëse, është klasa punëtore, bashkimet profesionale, është rinia jonë heroike, e gjallë, e zgjuar, besnike e Partisë dhe e popullit, është fshatarësia etj. Kuadrot zgjidhen në luftë, në punë, në fabrika, në kantiere, në kooperativa, atje ato

edukohen, rriten, shumëzohen nën drejtimin e përherëshëm të Partisë, të të gjithë Partisë, të celulës në fabrikë, në kantier, në shkollë, në fshat, në kooperativë. Komiteti Qendror dhe Drejtorja e kuadrove në Komitetin Qendror duhet ta organizojë dhe ta drejtojë më së miri këtë politikë të kuadrove, t'i udhëzojë, t'i frymëzojë, t'i drejtojë dhe t'i kontrollojë seksionet e veta, kudo që i ka. Komiteti Qendror e ka bërë me të meta këtë gjë dhe sidomos drejtuesit e Drejtorisë së kuadrit të Komitetit Qendror, të cilët mund të themi se pak janë preokupuar të venë në një mbledhje organizate bazë ose komiteti partie ose në kurse të Partisë, për të parë me sytë e tyre si punojnë kuadrot, si diskutojnë, si mësojnë, si rriten. Puna e tyre e deritanishme më shumë ka qenë një punë zyre dhe letrash. Kjo praktikë duhet të marrë fund menjëherë. Kjo mund të thuhet edhe për drejtoritë e tjera të Komitetit Qendror. Ne mund të themi se kanë qenë situata të tilla që na kanë detyruar të emëronim e të transferonim shumë kuadro por kjo nuk i shpjegon të gjitha.

Ka në përgjithësi te njerëzit që punojnë me kuadrin si në organet drejtuese në qendër ashtu edhe në rrethe e në dikastere a në ndërmarrje një qëndrim të ngurtë ndaj kuadrit. Në përgjithësi po vihet rrotull kuadrit të njohur dhe s'bëhen përpjekje aq sa duhet për të ngritur kuadro të rinj, megjithëse në popullin tonë ka vlera të mëdha, të çuditshme. Të gjithë kërkojnë njerëz të kualifikuar, pa menduar aspak se ku do të gjenden këta njerëz të kualifikuar në rast se nuk i ngremë ne, nuk i edukojmë, nuk u besojmë punë dhe nuk i shtyjmë përpara. Njerëzit që kërkojnë ta bëjnë punën me elementë

të kualifikuar dhe nënçmojnë vlerat e mëdha që fshihen te punëtorët e rinj, te fshatarët e rinj, te vajzat dhe te gratë tona, a nuk mendojnë vallë se ç'eksperiencë kishin ata kur u besuan poste të rëndësishme në Parti dhe në shtet, e megjithatë detyrat u kryen, njerëzit përparuan, u ngritën, u mësuan, fituan eksperiencë. Kështu duhet të mendojmë për ngritjen e kuadrit dhe edukimin e tij.

Shoku Stalin na mëson:

*«Para së gjithash duhet t'u propozohet drejtuesve tanë të partisë, nga sekretarët e celulave deri te sekretarët e organizatave të partisë të qarqeve dhe të republikave, të marrin për një periudhë të caktuar nga dy vetë, nga dy kuadro partie, të aftë për t'u bërë zëvendës të tyre të vërtetë. Mund të thonë: po ku t'i gjejmë ata, dy zëvendës për secilin, ne nuk kemi njerëz të tillë, nuk kemi kuadro të përshtatshëm. Nuk është e vërtetë, shokë. Ne kemi me dhjetëra mijëra njerëz të aftë, njerëz të talentuar. Vetëm se ata duhen njohur dhe duhen ngritur në kohën e duhur, në mënyrë që ata të mos mbeten gjithnjë në detyrën e vjetër dhe të mos fillojnë të myken»<sup>1</sup>.*

Shokë dhe shoqe,

Populli ynë mburret me Partinë e tij heroike, pse në saje të Partisë ai u çlirua përgjithmonë nga zinxhirët

<sup>1</sup> J. V. Stalin. Veprat, vëll. 14, f. 118.

e robërisë dhe nën udhëheqjen e saj të sigurtë dhe të urtë, ai ndërton socializmin. Të gjithë ne anëtarët e Partisë të jemi të denjë për emrin që mbajmë pasi është nderi dhe lavdia më e madhe me qenë anëtar i Partisë së Punës të Shqipërisë. Partia jonë, shokë dhe shoqe, po zmadhohet, po forcohet, po bolshevizohet dita-ditës në shembullin dhe në gjurmat e lavdishme të Partisë së Lenin-Stalinit. Të gjithë armiqtë e Partisë dhe të popullit kanë thyer kokën përpara murit të çelniktë të Partisë sonë dhe me siguri matematike, çdo orvatje e tyre, në të ardhshmen, do të pësojë disfata më të turpshme. S'ka forcë armike që t'i rezistojë Partisë sonë, s'ka intrigë dhe punë armiçësore, e hapët ose e maskuar, që t'i rezistojë vigjilencës revolucionare të Partisë dhe goditjes së saj vdekjeprurëse. Këtë e ka treguar jeta, historia, eksperiencia. Të vëmë, pra, të gjitha forcat tona, jetën tonë në shërbim të Partisë që kjo dita-ditës të forcohet, të bolshevizohet, pse vetëm kështu ne do të kemi kryer detyrën tonë ndaj popullit, për të cilin Partia është gjëja më e dashur e më e shenjtë. Të forcojmë dashurinë për Partinë e lavdishme Bolshevike të Lenin-Stalinit dhe për mësuesin dhe udhëheqësin tonë të shtrenjtë, shokun e madh Stalin. Të ngremë lart e më lart flamurin e internacionalizmit proletar, flamurin plot lavdi të Marksit-Engelsit-Leninit-Stalinit, shpëtimtarë të njerëzimit.

Shokë dhe shoqe, po e përfundoj raportin. Le të shërbejë Konferenca II Nacionale e Partisë për të ecur me vendosmëri përpara në bolshevizimin e Partisë sonë, për t'i dhënë një hov kurdoherë më të madh ndërtimit të bazave të socializmit në vendin tonë dhe të ndërtojmë

për popullin tonë dhe për brezat e ardhshëm një jetë të lumtur, të begatshme e pa brengë.

Rroftë Partia jonë e dashur e Punës!

Rroftë populli dhe atdheu ynë, Republika Popullore e Shqipërisë!

*Botuar për herë të parë në gazetën «Zëri i Popullit», Nr. 87 (476), 11 prill 1950 dhe Nr. 88 (477), 12 prill 1950*

*Botohet sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë, me ndonjë shkurtim*

## FJALA E MBYLLJES NË KONFERENCËN II NACIONALE TË PPSH

14 prill 1950

Shokë dhe shoqe,

Nuk dëshiroj të zgjatem, mbasi të gjitha problemet që u shtruan, u rrahën më së miri, por dëshiroj të theksoj se Konferenca II Nationale duke e vlerësuar këtë me peshën e problemeve që u shtruan dhe nga vendimet që u muarën, do të mbetet një nga ngjarjet më të rëndësishme në historinë e Partisë sonë.

Problemet u diskutuan me seriozitet të plotë, gjë që na forcon dhe na gëzon pa masë. Serioziteti dhe niveli i lartë i punimeve të konferencës, siç duket edhe nga numri i madh i delegatëve që folën dhe përmbajtja e shëndoshë e diskutimeve të tyre, tregojnë pjekurinë çdo ditë e më të madhe që ka fituar Partia në drejtimin e gjithanshëm dhe me sukses të shtetit tonë.

Kjo konferencë tregoi edhe një herë sa e fortë, sa e gjallë dhe sa revolucionare është Partia, sa kompakte, monolite dhe e lidhur ngushtë me popullin tonë, sa besnike dhe luftëtare është ajo për të mbrojtur dhe për të ruajtur të pastra parimet marksiste-leniniste, që për-

bëjnë forcën, gjallërinë dhe jetën e saj mbi të cilat ajo është ndërtuar.

Konferenca tregoi në mënyrë të shkëlqyer dashurinë dhe besnikërinë e madhe që ushqejnë Partia dhe populli ynë për shokun e madh Stalin, mësuesin tonë gjenial dhe të shtrenjtë, për Partinë e lavdishme Bolshevike dhe Bashkimin Sovjetik, përkrahësit e mëdhenj të popullit shqiptar.

Mendoni, shokë, ç'gëzim, ç'krenari dhe ç'siguri të madhe ndjen mbarë populli ynë, kur sheh se udhëheqja e saj heroike, Partia e Punës, është e fortë, e çelniktë, e papërkulur dhe kurdoherë fitimtare në të gjitha betejat për ndërtimin e socializmit, mbrojtjen e atdheut dhe të interesave të tij të larta.

Mendoni gjithashtu, shokë, përgjegjësinë e madhe që kemi ne komunistët në kryerjen e detyrave dhe ç'përpjekje të pareshtura duhet të bëjmë që të meritojmë çdo ditë e më shumë këtë besim të madh që klasa punëtore dhe populli ynë kanë për Partinë tonë! Edhe anëtarët e Partisë së Punës i kanë kryer dhe do të vazhdojnë t'i kryejnë me nder detyrat e tyre. Çdo gjë, edhe jetën e tyre, si kurdoherë ata e kanë vënë në shërbim të popullit. Për interesat e klasës punëtore dhe të popullit punonjës, për triumfin e socializmit dhe të komunizmit, komunistët shqiptarë në çdo moment luftojnë me vetëmohim dhe janë kurdoherë gati të sakrifikojnë jetën e tyre. Kjo është besa që anëtarët e Partisë së Punës i japin popullit të tyre të dashur.

Dashuria e pakufishme e komunistëve për popullin e tyre u tregua në luftën e ashpër të çlirimit. Ajo shprehet sot, gjithashtu, në luftën ngadhnjimtare që



po zhvillojmë për ndërtimin e bazave të socializmit, në luftën heroike të përditshme, gjatë së cilës po lindin heronjtë e punës, bien në përpjekjet me armiqtë heronjtë e Partisë dhe të popullit për të mbrojtur atdheun, interesat e tij dhe të paqes, në luftë të hapur e të fshehtë kundër imperialistëve dhe armiqtë diversantë. Në gjurmat e lavdishme të këtyre heronjve, që edukoi dhe rriti populli dhe Partia, ecën me besim të patundur një popull i tërë, që udhëhiqet në fitore nga mësimet gjeniale të Leninit dhe të Stalinit.

Prandaj, shokë delegatë, udhëheqës dhe anëtarë të thjeshtë të Partisë, të pajisur me këtë eksperiencë të madhe, që fituam në këtë konferencë, e cila ka qenë një shkollë e madhe revolucionare për të gjithë ne, të shkojmë sa më parë në detyrat që na janë caktuar për t'i dhënë një hov edhe më të madh punës për ndërtimin e socializmit në vendin tonë. Eksperiencën që fituam këtu, ne duhet ta çojmë në gjithë Partinë dhe ta armatosim atë që të dijë ta udhëheqë me sukses popullin në rrugën e ndritur të Partisë.

Ta shtojmë dhe më tej hovin që treguan delegatët në këtë konferencë, ta mbajmë gjallë këtë zjarr të madh, pse kështu do të sigurojmë fitoren dhe do të mposhtim të gjithë armiqtë e popullit tonë. T'i shtrojmë dhe t'i gjykojmë problemet ashtu si bënë shokët e Partisë këtu, duke përdorur shembuj konkretë. T'u vemi problemeve deri në fund dhe nga duart tona të dalë kurdoherë punë e pastër, e cila t'i japë popullit frute konkrete.

Puna e kësaj konference, shokë dhe shoqe, u karakterizua nga një kritikë dhe autokritikë e shëndoshë. Shumë shokë udhëheqës të organeve të Partisë, të push-

tetit dhe të ekonomisë në rrethe, të dikastereve dhe të organizatave të masave, me kurajë bolshevike i kritikuan gabimet e tyre, gjë që na forcon bindjen se ata, për arsye se i njohën gabimet e tyre, kanë dalë këtej me forca të dhjetëfishuara. Me autokritikën e tyre, megjithëse kanë pasë gabuar, fituan me të drejtë simpatinë e gjithë delegatëve dhe u bënë shembull. Ndryshe ndodhi me ndonjë shok që u përtyp në autokritikën e tij dhe që u duk qartë se mbledhja nuk mbeti e kënaqur nga qëndrimi i tij. Prandaj frymën e kritikës dhe të autokritikës bolshevike ta çojmë kudo deri në bazë dhe ta mbajmë gjallë, pse është shpëtimtare për Partinë tonë. Nuk ulet shoku kur njeh ballëhapur gabimet e tij, përkundrazi rritet respekti për të, ai del i pastër nga autokritika dhe rifiton kështu forca të reja. Kurse ai që nuk bën autokritikë, nuk mund të jetë kurrë i qetë. Atëhere përse të ngjasë ndryshe, kur Partia u jep në dorë armën e fuqishme të autokritikës që i shëron dhe i pastron nga gabimet e të metat? Kështu duhet ta kuptojnë anëtarët e Partisë kritikën dhe autokritikën. Partia i do njerëzit e saj, ajo i ruan ata si sytë e ballit, pse për të nuk ka gjë më të vlefshme se njeriu, se kuadrot, që i do dhe punon që ata të jenë sa më fortë e të vendosur.

Nga kjo konferencë ne nxjerrim mjaft mësimë. Frymën militante luftarake që përshkoi tërë punimet e saj, të mos e lëmë të ulet. Vetëm kështu ne do të shohim sa lehtë do t'i realizojmë detyrat që na janë ngarkuar, vetëm kështu do t'i kalojmë vështirësitë.

Vigjilenca revolucionare duhet të forcohet dita-ditës, pse armiqtë punojnë me njëmijë mënyra, prandaj

të kemi shumë kujdes, jo pas një muaji të flemë mendjen, duke menduar se armiqtë që ishin, i zbuluam e i demaskuam dhe tani mbaroi lufta kundër tyre, pse nga mungesa e vigjilencës, pas një farë kohe, mund të ndodhë që të na dalë një tjetër grup, «i papritur» siç thonë disa anëtarë partie. Që të zhduket çdo «e papritur» është e domosdoshme që vigjilenca e Partisë të jetë e madhe dhe e vazhdueshme, mbasi duhet të kemi parasysh që do të jetë e vazhdueshme edhe puna armiqësore kundër Partisë dhe Republikës sonë Popullore. Prandaj çështjen duhet ta kemi mirë të qartë.

Në konferencë u diskutua gjerësisht edhe për çështjet ekonomike. Ato janë probleme me rëndësi të madhe për Partinë dhe unë mendoj se diskutimet në këtë drejtim kanë qenë shumë të mira dhe pozitive. Gjithë sa u thanë këtu ne duhet të bëjmë të gjitha përpjekjet që t'i realizojmë, pse kjo është një nga detyrat kryesore për Partinë tonë në etapën që kalojmë. Vetëm të kemi kurdoherë parasysh që për problemet ekonomike, Partia duhet të mobilizojë të gjitha masat e popullit, duke vënë në lëvizje të gjitha levat e saja. Të tregohet gjithashtu kujdes që kuadrot drejtues të mos merren edhe me çështje fare të vogla, që u përkasin të tjerëve për t'i zgjidhur dhe ata të harrojnë problemet kryesore, pse nganjëherë në praktikë ngjet që organet e Partisë, duke u marrë shumë me çështje ekonomike, harrojnë detyrat politike dhe organizative të Partisë. Si detyrat politike dhe ato ekonomike, kanë shumë rëndësi dhe janë të lidhura ngushtë me njëra-tjetrën. Atje ku çështjet ekonomike, nuk shoqërohen me punën politike, atje nuk realizohet plani dhe shokët e Partisë humbasin në

masën e gjërave të vogla të përditshme. E vë theksin në këtë çështje, pse bile edhe këtu në konferencë, nuk u diskutuan gjerë problemet e politikës së brendshme dhe të jashtme, për të cilat ne kemi shumë për të thënë, duke kujtuar se i dimë këto probleme.

Çështjet ekonomike janë gjithashtu shumë të rëndësishme për ne, prandaj udhëheqësit e Partisë në rrethe duhet të jenë vazhdimisht në drejtimin e tyre, të ndihmojnë, të udhëzojnë dhe t'i shoqërojnë veprimet e pushtetit me masa politike të fuqishme, në mënyrë që ligjet, urdhëresat e urdhërat të njihen e të zbatohen sa më mirë nga populli. Udhëheqësit e organizatave të Partisë në rrethe është e domosdoshme të shkarkohen nga gjërat e vogla, duke ua lënë ato atyre që i kanë në kompetencë. E them këtë, pse konstatojmë që sekretarët e komiteteve të Partisë merren shumë herë edhe me gjëra të vogla. Partia, përderisa të krijojë kuadro të shëndoshë e të specializuar, do të interesohet edhe për shumë kohë e në mënyrë direkte për çështjet ekonomike, megjithatë shokët në bazë që janë në udhëheqje, duhet të dinë si të shkarkojnë nga vetja gjërat e vogla.

Lufta për mbrojtjen e paqes duhet të merret me seriozitetin më të madh, pse ndërtimi i socializmit në vendin tonë lidhet shumë ngushtë me këtë problem të madh. Lufta për paqen duhet të bëhet në mënyrë të organizuar e të vazhdueshme. Duhet të luftohet kudo e në çdo rast për çështjen e mbrojtjes së paqes, prandaj të mos merret kjo vetëm si një parullë e thirrje politike.

Të punohet pareshtur për demaskimin me forcë të imperializmit, të titizmit dhe të agjenturave të tyre, pse ata janë armiqtë më të egër të socializmit, të Bash-

kimit Sovjetik dhe të popullit tonë. Titizmin ne e kemi në kufi dhe të jemi të ndërgjegjshëm se ai me njëmijë mënyra do të përpiqet të na dëmtojë. Prandaj të mprehim vigjilencën kundër spiunëve dhe diversantëve titistë, të luftohen ata ashpër. Kjo punë të mos jetë vetëm një problem i Partisë ose i organeve të Sigurimit të Shtetit, por një çështje e të gjithë popullit tonë.

Nga ana tjetër, Partia jonë të punojë që dashuria për Bashkimin Sovjetik, që është mbrojtësi ynë i lavdishëm, të rrënjoset thellë në shpirtin e popullit tonë.

Prandaj, shokë dhe shoqe, le të mobilizohemi për të zbatuar gjithë këto detyra që na vuri përpara konferenca me po atë vrull, me po atë vendosmëri e disiplinë që karakterizon Partinë tonë të tipit të ri marksist-leninist. Ne duhet të vëmë të gjitha forcat që Partia të çelNIKOSËT çdo ditë e më tepër, që kuadrot e Partisë dhe gjithë Partia jonë me eksperiencën e përditshme, që fitojnë në luftë e në punë, të pajisen me kulturën dhe me teorinë e pararojës, marksizëm-leninizmin, pse kështu do të kryejnë me sukses detyrat e shenjta dhe të lavdishme që kanë përpara.

Ne komunistët zotohemi nga kjo tribunë e lartë përpara popullit tonë se do t'i kryejmë me nder të gjitha detyrat që na ngarkohen.

Rroftë Partia jonë heroike e Punës!

Rroftë Partia e lavdishme Bolshevike dhe shoku i madh Stalin!

*Botuar për herë të parë në gazetën «Zëri i Popullit»*

*Nr. 91 (480), 15 prill 1950*

*Botohet sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror*

*të Partisë*

## FJALIM NË KONGRESIN E DYTË TË FRONTIT DEMOKRATIK TË SHQIPËRISË

7 maj 1950

Shokë delegatë të Frontit Demokratik,

Në emër të Kryesisë së Këshillit të Përgjithshëm të Frontit, kam nderin t'ju sjell përshëndetjet më të nxehta juve, gjithë anëtarëve të organizatës dhe mbarë popullit tonë heroik dhe paqedashës. Sot në këtë ditë të shënuar për organizatën e Frontit, të gjithë ne anëtarët e saj shprehim dashurinë dhe besnikërinë për Partinë heroike të Punës dhe Komitetin Qendror të saj që udhëheqin popullin dhe organizatën tonë me vendosmëri dhe me urtësi në rrugën e socializmit.

Nën udhëheqjen e Partisë, organizata e Frontit ka përshkuar një rrugë të gjatë plot suksese dhe fitore. Masat e gjera punonjëse të vendit tonë kanë në Frontin Demokratik organizatën e tyre të gjerë, ku luftojnë të organizuar dhe të bashkuar si një trup i vetëm për të ruajtur fitoret e Luftës nacional-çlirimtare, për t'i çelënikosur dhe zgjeruar edhe më tej këto fitore.

Të gjithë njerëzit e ndershëm dhe patriotë të vendit tonë janë jashtëzakonisht të interesuar që atdheu i tyre

të rrojë i lirë dhe i pavarur, të përparojë dhe të lulëzojë. Populli ynë është jashtëzakonisht i interesuar që të ndërtojë në paqe një jetë kurdoherë më të mirë dhe më të begatshme për veten e tij dhe për brezat e ardhshëm. Ai lufton që tokat e tija të bëhen sa më pjellore, të krijohet bollëku e të zhduket injoranca. Populli ynë lufton që në çdo familje të ketë gëzim, të hyjë përparimi, të rriten kalamanë të shëndetshëm, të gëzuar dhe të mos kenë shqetësime e pasiguri për të ardhshmen. Çdo njeri i ndershëm e patriot është i interesuar dhe punon me të gjitha forcat që në vendin tonë të ngrihen sa më shumë fabrika dhe kombinatë, të nxirren sa më shumë prodhime nga nëntoka jonë e pasur, të hapen sa më shumë shkolla dhe spitale, të ngrihen sa më shumë banesa për punonjësit, të ketë sa më shumë kopshte të lulëzuara, të rriten dhe të shtohen pyjet dhe kullotat. Të gjitha këto bëjnë pjesë në luftën për ndërtimin e socializmit. Suksesi në këtë rrugë do të thotë ndërtimi i socializmit në vendin tonë. Për këtë lufton Partia në krye të popullit tonë.

Pa dyshim, rreziqet dhe kërcënimet kanë qenë të mëdha për popullin tonë në rrugën e çlirimit, por të gjitha këto u kapërcyen me heroizmat e papërshekruara të popullit nën udhëheqjen e Partisë. E kaluara e urryer u shemb përgjithmonë dhe në vend të saj po lulëzon jeta e re.

Populli dhe atdheu ynë kanë bërë hapa të mëdhenj përpara që prej çlirimit e deri tani. Kurrë s'është parë një përparim dhe një entuziazëm i tillë; kurrë s'është parë një mobilizim i tillë i masave të gjera të popullit në punë, në ndërtim, në luftë politike për të ndërtuar

bazat e socializmit. Populli për herë të parë e ndjeu veten zot në shtëpinë e tij dhe ju përvesh punës me zell të madh për të ndërtuar dhe zbukuruar shtëpinë dhe jetën e tij. Sukseset e kësaj pune populli tani i prek me duart e tija, ai korr frutet e punës së tij të palodhur. Jeta e popullit po përmirësohet dita-ditës, me hapa të mëdhenj po përparon bujqësia, pse fshatari është zot i tokës, i mjeteve të punës, i prodhimeve. Perëndoi koha kur fshatarit i rrinte mbi kokë agai dhe beu. Sot ai ka pushtetin e tij që e mbron, e ndihmon, i jep kredi, i jep vegla moderne për ta punuar më mirë tokën, i jep shkollën dhe gjithë të mirat.

Jeta e punëtorëve dhe e gjithë punonjësve të qytetit po përmirësohet dita-ditës. Vendi ynë po mbushet me fabrika dhe me kombinatë, që do të punojnë lëndën e parë të vendit dhe do të prodhojnë më me shumicë sende për të cilat ka nevojë populli. Po zgjerohen minierat tona, pasuri e madhe e vendit dhe që me prodhimet e tyre do ta shtojnë begatinë e popullit tonë, i cili do të ketë më shumë traktorë, më shumë maquina e fabrika, më shumë shkolla e vende pushimi, më shumë dituri dhe kulturë.

Një fshatar i varfër nga një kooperativë e fushës së Korçës, i cili para çlirimit s'kishte asnjë pëllëmbë tokë për t'u varrosur dhe që vjet kishte fituar vetëm nga patatet 30 000 lekë, duke biseduar me të më tha:

«Jam i kaluar nga mosha dhe vetëm një gjë dëshiroj, të rroj dhe ca e të gëzoj, se vetëm tani më qeshi buza. Ëndrrat e mia në të kaluarën kanë qenë të thjeshta: të kisha pak tokë pa le të vdisja. Tani, shih — më tha duke më treguar me dorën e tij të rrudhur nga



puna — të tëra këto toka janë të miat, të gjitha ato pendë që, janë të miat; as ma merrte kurrë mendja të thahej Maliqi, por shih si ndrit uji i kanalit të Devollit, shih si duket toka e zezë në batakun e Maliqit, shih si ngrihen lart muret e fabrikës së sheqerit të Maliqit. E fortë është Partia, si populli ynë». Një tjetër fshatar i shkuar nga mosha i po kësaj kooperative më tha:

«Sapo jam kthyer nga Australia. S'kisha ç'të bëja, mora borxh dhe shkova në Australi të punoja. Atje vuajta pa masë, punoja rob te inglizi, gjithnjë qaja për vendin tim, për djalin tim që e lashë të vogël. Atje ndejta 20 vjet dhe u ktheva që andej prapë me borxh. Kur mbërrita në fshat, të nesërmen u gjenda i pasur. Djali im ishte bërë burrë, kishte rrokur armën dhe kishte dalë partizan, Shqipëria u çlirua dhe tani ne kemi tokë boll, kemi që, kemi shkollë, do të kemi dhe radio. Ne jemi të lumtur dhe të gëzuar».

Të tilla janë sukseset që ka korrur populli ynë brenda pak kohe dhe ky është vetëm fillimi, por një fillim i mirë dhe me baza të çelnikta. Imperialistët dhe spiunët e tyre, ballistët, zogistët dhe tradhëtarët e çdo kallëpi po grijnë si mulliri pa kokrra se populli ynë, gjoja, po vdes urie. I qajnë hallin kalorësit se i varen këmbët. Ata do të thoshin të vërtetën vetëm në qoftë se do të pohonin se në Shqipëri bejlerët dhe tregëtarët e mëdhenj mbetën pa shtëpi e pa prokopi dhe se agai s'ka më as çiflik dhe as qostek sahati në jelek. Kjo është më se e vërtetë dhe kurrë ata nuk do ta ngrenë më kokën. Mbaroi «devra» e tyre, në fuqi është populli, janë punëtorët, janë fshatarët, që deri dje kishin vuajtur nën kamxhikun e tyre. Armiqtë e popullit e pësuan si ajo

dhelpra që nuk i arriti dot rrushtë e pjekur dhe i pësh-tyu, kështu e pësuan dhe armiqtë e popullit që lëshojnë vrer. Por dhelpra është dhelbër, dinake dhe grabitqare, prandaj në çdo moment është e rrezikshme, sidomos kur i afrohet vdekja. Pra, vazhdimisht duhet të ruhemi prej egërsirave derisa të shfarosen. Të tillë janë imperialistët amerikanë dhe anglezë e gjithë shërbëtorët e tyre që prej tradhëtarëve të Beogradit dhe deri te kulakët në fshatrat tona. Këta, të uritur për pasuritë e popullit, duke parë se po u rrëshqet toka nën këmbë, përpiqen me të gjitha mjetet e tyre të përgatitin një luftë të re botërore. Këta vënë në rrezik seriozisht paqen, që njerëzimi e fitoi me aq sakrifica. Vallë do të lejojmë më, mëma, motra, vëllezër që të përsëriten tmerret e luftës që të na vriten djemtë, vajzat, kalamanët tanë që të na digjen shtëpitë tona, që i ndreqëm me djersë, të na përvëlohen arat, kopshtijet, pyjet, të na shkatërrohet bagëtia e pasuria, që i ngritëm me krahët dhe me djersën tonë? A do të lejojmë më punëtorët tanë që t'u shkatërrohen fabrikat dhe minierat dhe t'i zптоjë i huaji e shërbëtori i tij, fabrikanti i pangopur? A do të lejojmë më fshatarësia që të vijë beu dhe agai t'i grabitë tokën dhe pasurinë e tij dhe ta kthejë në skllav si më parë? Jo, kurrë nuk do të lejojmë që të përsëriten regjimet e tmerret e së kaluarës. Popujt i urrejnë luftërat imperialiste dhe ata qëndrojnë më këmbë për të mbrojtur me çdo kusht paqen. Përgatitjet dhe manevrat e luftëdashësve imperialistë janë të destinuara të dështojnë, pse kampi i partizanëve të paqes në botë, me në krye popujt e lavdishëm sovjetikë, është ngritur si një gardh i çelniktë dhe u thotë ndal armiqve të paqes.

Stalini i madh i frymëzon dhe i udhëheq popujt e mbarë botës që të shtërnojnë radhët e tyre dhe të bëjnë të dështojë çdo orvatje e imperialistëve, që kërkojnë të mbytin botën në gjak. E fuqishme është lëvizja e partizanëve të paqes në botë dhe ajo dita-ditës po forcohet, po zmadhohet. Kjo i tmerron luftëdashësit amerikanë dhe satelitët e tyre, prandaj ata s'janë aspak të qetë dhe të sigurtë në ndërmarrjen e tyre të tmerrshme. Në vendin tonë lëvizja e partizanëve të paqes ka marrë një hov të madh. Paqja është e domosdoshme për popullin tonë, prandaj ai lufton me të gjitha forcat për paqen dhe për jetën e re. Vendimet e Stokholmit duhet t'i bëhen të njohura mirë popullit tonë dhe ai të firmosë apelin dhe të luftojë për ndalimin e përdorimit të bombës atomike si mjet shfarosjeje njerëzish. Të ngrihet zëri i popullit tonë dhe të bashkohet me zërin e fuqishëm të mbarë popujve të botës për t'u thënë ndal luftërave grabitqare që përgatitin imperialistët amerikano-anglezë dhe shërbëtorët e tyre. Lufta nuk është e pandalshme dhe fatale, por dhe as nuk duhet ta nënvleftësojmë rrezikun që e kërcënon paqen, pse edhe kjo është një manevër e armikut, që kërkon të vëjë popujt në gjumë dhe t'i gjejë në befasi për t'i shfarosur më lehtë. Rrezikun duhet ta shikojmë pa frikë në sy dhe të jemi kurdoherë vigjilentë e të gatshëm se vetëm kështu mund ta mënjanojmë atë.

Kampi demokratik antiimperialist me në krye Bashkimin Sovjetik është bërë forca e madhe dhe ngadhënjimtare në botë, përpara të cilit do të dështojnë të gjitha shantazhet dhe kërcënimet e kampit imperialist luftëdashës, që udhëhiqet nga imperializmi amerikan.

Vendi ynë i çliruar nga ushtria e tij lavdiplote, po lulëzon në saje të udhëheqjes së drejtë të Partisë së Punës dhe të ndihmës bujare të Bashkimit Sovjetik dhe mikut të shtrenjtë, Stalin. Kanë ardhur kohërat që populli shqiptar të mos ta ndjejë më veten e tij të përbuzur, të vogël prej një milionësh, por ta ndjejë veten të fortë në të drejtat e tija të pacënueshme, në dinjitetin e tij, ta ndjejë veten prej disa qindra milionësh, pse ai ka përkrah Bashkimin Sovjetik dhe demokracitë e tjera popullore. Duke ndjekur me besnikëri leninizmin dhe mësimet e Stalinit, Partia jonë e nxori popullin në dritë dhe po e çon në socializëm. Populli ynë i lumtur dhe i lirë e ndjen thellësisht përkrahjen e Bashkimit Sovjetik.

Ishte një kënaqësi e madhe kur shikoje popullin tonë, aq fort të bashkuar dhe të lumtur, të manifestonte në ditën e 1 Majit gëzimin për jetën e tij të re, dashurinë për Partinë e tij, për Bashkimin Sovjetik dhe për Stalinin e madh. Për të gjithë ishte një gëzim i papërshtueshëm, kur shihnin se Partia dhe Fronti Demokratik me punën e tyre kanë krijuar dhe rrënjosur thellë në zemrat e njerëzve të thjeshtë të popullit një dashuri aq të fortë, aq të thellë dhe të pastër për Bashkimin Sovjetik, për Partinë Bolshevike dhe për Stalinin. Në masën e madhe të popullit që parakalonte ditën e 1 Majit, më zuri syri një djalë të ri, të shtrirë në shtratin e një karroce që gjyshja e tij e shtynte përpara në mes të kësaj mase të madhe të popullit. Fytyra e tij ndriste nga gëzimi, sadoqë nën mbulesën e krevatit, ai mund t'i kishte këmbët të prera ose të paralizuara. Ai ngrinte lart një fotografi të Stalinit, të njeriut të dashur të tij, të njeriut që e bënte t'i harronte dhimbjet fizike. Shqi-

përia jonë, në të kaluarën e hidhur, i ngjiste këtij djali të ri, por Partia jonë e udhëhequr nga mësimet e Leninit e të Stalinit e çoi në këmbë Shqipërinë, i dha forcë, i dha jetë, i dha lumturinë.

Jetën dhe lumturinë e popullit tonë, t'i ruajmë si sytë e ballit, t'i forcojmë e t'i zmadhojmë. Organizata e Frontit, nën udhëheqjen e ndritur dhe të urtë të Partisë, të vëjë të gjitha forcat në kryerjen e detyrave të saja. Të mobilizojë të gjitha masat e popullit tonë punonjës në punën e saj paqësore dhe ndërtimore, të forcojë unitetin e popullit, dashurinë në mes të punonjësve, të forcojë patriotizmin e masave, të shtojë urrejtjen dhe luftën kundër armiqve të brendshëm dhe të jashtëm të popullit, të forcojë luftën për mbrojtjen e paqes që kërcënohet nga imperialistët luftëdashës amerikano-anglezë.

Organizata e Frontit të zhvillojë një punë politike të gjerë dhe intensive në masat e popullit dhe t'i mobilizojë njerëzit në kryerjen e detyrave patriotike, në kryerjen e detyrave që u ngarkon pushteti i tyre. Të gjitha masat e gjera të punonjësve të mobilizohen si një trup i vetëm në realizimin e planeve ekonomike të shtetit që përfaqësojnë ndërtimin e një jete më të lumtur, më të begatshme, që na çojnë drejt socializmit. Të mobilizohet i gjithë populli ynë që të forcohet ekonomia socialiste e vendit tonë, të përparojë industria jonë, të përparojë bujqësia, të zhduket injoranca, analfabetizmi, të ngrihet kultura në masat e gjera të popullit, që populli të shohë kurdoherë ditë të lumtura dhe të gëzuara. Të mobilizohet gjithë populli për forcimin e mbrojtjes së Republikës sonë Popullore, të jetë kurdoherë vigjilent dhe të

godasë pa mëshirë armiqtë e tij nën çdo maskë që ata do të përpiqen të fshihen, t'i demaskojë dallaveret e tyre, të forcojë pushtetin popullor dhe të asgjësojë të gjithë armiqtë e tij. Të mobilizohet i gjithë populli dhe Fronti për fushatën e madhe të zgjedhjeve për deputetë në Kuvendin Popullor. Kjo është një çështje nga më të rëndësishmet, pse zgjidhet organi më i lartë i Republikës sonë Popullore, prandaj këtu duhet të vijnë njerëzit më të besuar, më besnikë, punëtorë të palodhur për kauzën e popullit. Më 28 maj, të gjithë zgjedhësit duhet të shkojnë pa përjashtim në votime, dhe pa përjashtim të votojnë për kandidatët e Frontit, pse kështu ata kanë votuar për jetën e lumtur të popullit dhe të atdheut të tyre, pse kështu ata kanë votuar për sigurimin e jetës së fëmijëve të tyre, ata kanë votuar për socializmin, për mbrojtjen e paqes.

Punëtorë, fshatarë, intelektualë patriotë, mëma, motra dhe ju të rinj heroikë të vendit tonë, që keni arritur moshën e votimit, përdorni votën tuaj si një armë të fuqishme dhe tregoni si kurdoherë besnikërinë dhe dashurinë tuaj të madhe ndaj atdheut, ndaj popullit, ndaj Partisë suaj të dashur, ndaj Frontit Demokratik, ndaj Bashkimit Sovjetik dhe Stalinit të madh; tregoni me votën tuaj për kandidatët e Frontit, komunistë e pa parti, dashurinë ndaj demokracive popullore motra, ndaj kampit të socializmit dhe të paqes!

Më 28 maj, duke votuar të gjithë pa përjashtim për kandidatët e Frontit, tregojuni armiqve të popullit tonë dhe të Republikës sonë Popullore, imperialistëve, tradhëtarëve titistë të Beogradit, monarko-fashistëve, neo-fashistëve e armiqve të tjerë të këtij kallëpi, se uniteti

i popullit shqiptar rreth Partisë dhe qeverisë së tij, është si një shkëmb graniti, se ai është rreshtuar fuqimisht në kampin e socializmit dhe të paqes dhe s'ka forcë e intrigë nga ana e tyre që ta dëmtojë dhe ta dobësojë!

Të gjitha përpjekjet e tyre për të dëmtuar Shqipërinë do të dështojnë, pse populli ynë është një popull paqedashës dhe që ecën i vendosur në rrugën e Leninit dhe të Stalinit, është një popull që e do lirinë dhe di të luftojë, të mbrohet dhe të fitojë kundër armiqve që do të guxojnë t'i bien në qafë, pse populli ynë ndjek me besnikëri mësimet e Leninit dhe të Stalinit; populli shqiptar është nga ata popuj që nuk i trembet kurrë syri, pse s'është vetëm. Populli ynë i ka kapërcyer dhe do t'i kapërcejë të gjitha rreziqet dhe pengesat, pse atë e udhëheq Partia e tij e lavdishme, pse atij i ndrit rrugën Stalini.

Duke i uruar Kongresit të dytë të Frontit Demokratik punë të mbarë, le të brohorasim:

Rroftë populli heroik dhe paqedashës shqiptar!

Rroftë Partia heroike e Punës dhe Komiteti Qendror i saj!

Rroftë Fronti Demokratik i Shqipërisë!

*Botuar për herë të parë në gazetën «Zëri i Popullit», Nr. 111 (500), 8 maj 1950*

*Botohet sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë*

## **FJALA E MBAJTUR PARA ZGJEDHËSVE TË ZONËS ELEKTORALE NR. 108 TË QYTETIT TË TIRANËS**

**25 maj 1950**

Të dashur shokë dhe shoqe,

Jam shumë i prekur dhe i gëzuar nga kjo dashuri dhe pritje e ngrohtë nga ana juaj. Ju falemnderit nxeh-tësisht për këtë dhe për nderin e madh që më keni bërë duke më propozuar si kandidatin tuaj në zgjedhjet për Kuvendin Popullor.

Kjo dashuri e ngrohtë dhe ky besim i popullit që shprehet kudo me kaq forcë në vendin tonë, i kushtohen Partisë sonë të dashur të Punës dhe Komitetit Qendror të saj, një nga anëtarët e të cilit jam edhe unë. Partisë sonë ja detyrojmë çdo gjë që gëzojmë, pse ajo organizoi dhe udhëhoqi popullin në fitoren e plotë mbi çdo armik të jashtëm dhe të brendshëm dhe pse ajo është garancia e fitoreve të tjera të shkëlqyera që e presin popullin tonë në të ardhshmen.

Për popullin që na lindi dhe na rriti, Partia na edukoi dhe na brumosi që të jemi ushtarë besnikë të çështjes së popullit punonjës, të jemi të përgatitur dhe të gatshëm në çdo moment të luftojmë për të, të derdhim



gjakun kur ta lypë nevoja për të mbrojtur jetën dhe interesat e popullit, të derdhim djersë dhe të punojmë pa u lodhur për t'i siguruar atdheut tonë një të ardhshme kurdoherë më të mirë. Partia na ka mësuar që çdo gjë nga vetja jonë t'ja kushtojmë popullit, të jemi shërbëtorët e tij më besnikë, pse s'ka nder dhe gëzim më të madh për një njeri që dëshiron ta mbarojë jetën e tij me nder dhe të fitojë të drejtën të thotë se e ka përmbushur detyrën e tij. Asgjë s'duhet të vihet mbi interesat e popullit, na mëson Partia dhe çdo gjë duhet t'u nënshtrohet këtyre. Interesat e vogla dhe personale nuk duhet kurrë, as të errësojnë, as të pengojnë interesin e lartë të popullit dhe të atdheut, përkundrazi, ato duhet të harmonizohen me interesat e popullit dhe t'u shërbejnë atyre. Ky është kandari me të cilin duhet të matet çdo akt dhe çdo punë e kujtdo qoftë. S'ka as rrugë të dytë dhe as të tretë.

Ne, komunistët, në luftën dhe në punën tonë na ka rrethuar vazhdimisht dashuria e madhe e popullit për Partinë e tij të Punës, si ai dielli i shkëlqyer dhe jetëdhënës, na ka forcuar pa masë, na ka shtuar aftësitë, vullnetin, guximin për të kryer detyrat me përgjegjësi të madhe që na ka ngarkuar populli dhe Partia.

Kemi qenë kurdoherë të ndërgjegjshëm për detyrat, për vështirësitë që do të hasnim në rrugë dhe për përgjegjësitë e mëdha. Mund të themi se jemi përpjekur me të gjitha forcat që t'i kryejmë sa të jetë e mundur më mirë këto detyra, të mos u trembemi vështirësive dhe kurrë s'u jemi shmangur përgjegjësive, qofshin këto nga më të rëndat. Ne nuk përjashtojmë aspak që të mos kemi pasur të meta dhe lëshime në pu-

në, pse kush punon edhe gabon, thotë i madhi Lenin, por neve s'na ka munguar kurrë guximi për t'i zbuluar këto të meta, për t'i njohur dhe për t'i korigjuar. Kjo është një veti e lartë e komunistëve që i bën këta t'i dojë populli, t'i respektojë dhe t'i ndjekë me vendosmëri në realizimin e programit të tyre që përfaqëson të tanishmen dhe të ardhshmen e lumtur të popullit.

Populli është i vetmi gjykatës, i plotfuqishëm dhe i pagabueshëm në vendin tonë, në demokracinë tonë popullore. Ai le t'i gjykojë veprimet tona, le t'i çmojë, kur janë për të çmuar dhe le t'i qortojë dhe të marrë masa kur janë për të qortuar ose dënuar. Kjo është demokracia e madhe që ka vendosur Partia në Republikën tonë Popullore dhe pa një demokraci të tillë të vërtetë, nuk do të kishte mundësi forcimi i pushtetit tonë popullor sikundër është bërë në realitet. Një parti marksiste-leniniste në fuqi, siç është Partia jonë e Punës, do të thotë populli në fuqi, do të thotë i gjithë pushteti në duart e popullit punonjës. Këtej del rëndësia e madhe e votimeve që do të zhvillohen më 28 maj, kur populli do të zgjedhë për në Kuvendin Popullor përfaqësuesit e tij nga bijtë më të mirë, më punëtorët, më besnikët, qofshin këta anëtarë të Partisë së Punës ose jo, por të gjithë anëtarë të Frontit Demokratik, luftëtarë të ndërgjegjshëm, konsekuentë, patriotë dhe të sakrificës për kauzën e madhe të popullit dhe të Republikës Popullore.

Pak ditë na ndajnë nga dita e votimeve dhe një valë entuziazmi ka përshkuar me kohë gjithë atdheun tonë dhe fushata e zgjedhjeve ka treguar sa i fortë është uniteti i popullit tonë, sa e madhe është dashuria e tij për Partinë e tij të Punës, për udhëheqësen e tij, sa i

madh është besimi në pushtetin popullor dhe në të ardhshmen e lulëzuar. Populli ka caktuar kandidatët e tij për deputetë nëpërmjet mbledhjesh dhe konferencash, ku masat e gjera të popullit kanë treguar një pjekuri të madhe politike, një kuptim të lartë mbi përdorimin e të drejtave, e lirive demokratike që ai i ka fituar duke luftuar vite me radhë kundër armiqve të tërbuar fashistë dhe gjakpirësve të vendit tonë, klasës sunduese të feudoborgjezisë.

Në të gjitha manifestimet e jetës së tij të lirë plot punë të frutshme dhe fitore të shkëlqyera, populli shqiptar shpreh në mënyrë të prekshme dashurinë dhe mirënjohjen e pafund që ai ushqen për Bashkimin Sovjetik dhe për shokun e madh, Stalin. Të tilla ndjenja të pastra dhe të rrënjosura thellë për Bashkimin Sovjetik dhe udhëheqjen e tij mbushin me gëzim dhe zbukurojnë jetën e popullit tonë. Në këtë dashuri të madhe që ndjen populli ynë për popujt e Bashkimit Sovjetik dhe për Stalinin, asgjë s'është e përciptë, çdo gjë buron e pastër nga zemra e tij dhe është e menduar dhe e peshuar thellë. Për këtë arsye miqësia është e përjetshme dhe shkon dita-ditës duke u forcuar e s'mund të ketë forcë që ta errësojë këtë gjë.

Si ka qenë dhe si është Shqipëria? Ku ishte dhe ku është tani populli shqiptar? Këto pyetje ja bën vetes me gëzim çdo qytetar i ndershëm i Shqipërisë. Kush i ndryshoi fatet e errëta të Shqipërisë, kush e nxori popullin shqiptar në dritë, i dha lirinë, e bëri zot të vendit të tij, i dha forcë të shporrë nga vatrata armikun e mallkuar okupator dhe të mposhtë përgjithmonë bejlerët dhe agallarët që i qëndronin në kurriz, i pinin

gjakun, e vrisnin, e torturonin, e shnderonin? Partia e Punës e Shqipërisë.

Kush i mposhti intrigat dhe lakmitë e imperializmit anglo-amerikan, i cili që në kohën e luftës, u puq me kuislingët dhe me tradhëtarët ballistë dhe zogistë e të tjerë mercenarë, për t'ja rrëmbyer fitoren nga duart popullit shqiptar? Udhëheqja e drejtë e Partisë sonë e mësimet e Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik dhe të Stalinit.

Ku e fitoi populli ynë besimin e madh në fitoren e kauzës së tij, ku e mësoi populli organizimin e forcave të tija të gjalla në luftën më të përgjakshme që ka parë historia, ku e mori shembullin populli ynë që nxori nga gjiri i tij Partinë e tij të lavdishme Komuniste, e cila u bë udhëheqësja e sigurtë dhe e vetme e popullit të pamposhtur shqiptar, në ç'shembuj dhe në ç'baza u ndërtua Partia jonë Komuniste që priu popullin tonë në fitoren më të shkëlqyer që ka parë historia e vendit tonë? Për të gjitha këto pyetje ka këtë përgjegje: te Bashkimi Sovjetik, te Partia Bolshevike e Lenin-Stalinit, te mësimet e marksizëm-leninizmit. Me miliona e me miliona njerëz nga më të mirët e Bashkimit Sovjetik u vranë për të çliruar popujt nga skllavëria e fashizmit, ushtria e Stalinit luftoi edhe për lirinë, gëzimin e sigurimin e jetës e të punës ndërtimore të popullit tonë dhe të së ardhshmes së brezave të rinj. Punëtori shqiptar, që shkon çdo mëngjez në punë, i gëzuar se jeta e tij ka ndryshuar krejtësisht, mendon me dashuri për Partinë e tij, për Bashkimin Sovjetik dhe Stalinin, të cilët e mësuan të organizohet, të luftojë, të marrë fuqinë në dorë, të bëhet zot i fabrikës dhe i vendit, të

vendosë drejtësinë e tij shembullore. Po ashtu edhe fshatari punon i lumtur tokën që tani është e tij.

Lenini dhe Stalini i thanë fshatarit shqiptar nëpërmjet Partisë së tij Komuniste Shqiptare: lidhu në aleancë të ngushtë dhe të pathyeshme me klasën punëtore dhe nën drejtimin e kësaj shko në luftë për çlirimin e atdheut se vetëm kështu do të shkëputësh zinxhirët e robërisë shekullore të beut dhe të agait, se vetëm kështu do ta shporrësh armikun nga vatra jote, vetëm kështu toka do të bëhet e jotja dhe e fëmijve të tu, vetëm kështu do të punosh i lumtur dhe i gëzuar dhe do të gëzosh frutet e punës tënde.

Tani fshatari ynë përpara arave të tija me grurë, përpara lëndinave të gjelbëruara ku kullosin bagëtitë që nga viti në vit po i shtohen, duke parë kalamanët e tij të gëzuar që me libra nën sqetull shkojnë në shkollë të bëhen njerëz të mësuar, duke parë shtëpinë e tij të zbukuruar, të rindërtuar, të gëzuar, mendon për Partinë e tij të Punës që i dha dinjitetin e vërtetë të një njeriu të lirë.

Sot nëna shqiptare punon e gëzuar se fëmijët e saj rriten të lumtur, të mësuar, se ata nuk do të njohin më tmerret e luftës as kampet e tmerrshme të përqëndrimit, pse gjithë bota përparimtare është çuar në këmbë, për të ndaluar luftërat grabitqare. Në krye të fushatës për mbrojtjen e paqes qëndrojnë popujt e Bashkimit Sovjetik të udhëhequr nga Stalini. Për popujt e Bashkimit Sovjetik dhe për Stalinin s'ka popull të madh ose të vogël, por të gjithë janë njësoj, ata i duan, i respektojnë, i mbrojnë dhe i ndihmojnë me të gjitha mundësitë bile popujt e vegjël më shumë. Popujt

e Bashkimit Sovjetik dhe Stalini i kanë thënë popullit tonë «ti ke të drejtën e plotë të rrosh i lirë, i lumtur, në atdheun tënd, ndërto jetën tënde të re, unë nuk do të ta kursej ndihmën time, unë do të të ndihmoj për t'u mbrojtur nga çdo rrezik dhe nga çdo lakmi e atyre që kërkojnë të të kthejnë ditët e errëta të së kaluarës». Sot populli ynë është më i fortë se kurrë dhe i sigurtë në punën dhe në të ardhshmen e tij. Këto kanë bindur dhe ata më skeptikët të shohin rrugën e drejtë dhe të mirën e tyre, të afrohen te populli, të thyejnë paragjykimet e mykura dhe arësytimet e sëmura që i pengonin të gjenin rrugën e drejtë. Paragjykimet e mykura dhe skepticizmin e këtyre njerëzve i mundi drejtësia e Partisë sonë, i mundën veprat e Partisë sonë dhe politika e saj e drejtë që synon bashkimin e të gjithë njerëzve të ndershëm të Shqipërisë, që synon në ndërtimin e një uniteti të çelniktë të popullit shqiptar. Paragjykimet e gabuara të këtyre njerëzve i mundi politika e ndritur dhe paqedashëse e Bashkimit Sovjetik ndaj vendit tonë, ata panë dhe u bindën se sa shumë e do dhe e ndihmon Bashkimi Sovjetik popullin shqiptar dhe ata u bashkuan në veprën ndërtimtare të popullit. Vetëm ai që është armik i betuar i popullit do të qëndrojë dhe do të vdesë armik i popullit.

Populli ynë nën udhëheqjen e Partisë së tij, brenda këtyre katër viteve që na ndajnë nga zgjedhjet e para të Asamblesë Kushtetuese, ka bërë hapa të mëdhenj drejt përparimit dhe mirëqenjes. Atdheu ynë ka ndryshuar pamje, ai është ndërtuar dhe zbukuruar, jeta e njerëzve është përmirësuar shumë. Suksese të mëdha janë arritur në çdo fushë. Armiqtë e popullit, që pre-

dikonin dhe punonin për rrëzimin e pushtetit popullor, mbetën me gisht në gojë. Ata ëndërronin shkatërrimin e popullit tonë, ata mendonin se shpejt do të falimentonim dhe do të vinin përsëri në fuqi të rrëmbenin çifliqet dhe pasuritë e popullit dhe ta kthenin këtë përsëri në skllavëri. Ata u gabuan në hesapet e tyre, ata e nënvleftësuan forcën e madhe të popullit, dinamizmin e tij, shpirtin dhe forcën krijuese të tij, që bëri mrekullira në një kohë kaq të shkurtër. Sukseset e mëdha, frutet e të cilave i gëzon populli sot, u arritën nën udhëheqjen e drejtë të Partisë së Punës dhe në saje të një pune të madhe vetëmohuese të masave të gjera të popullit, të klasës punëtore, të fshatarësisë, të rinisë sonë të shkëlqyer, të grave të Shqipërisë, të intelektualëve patriotë e të ndershëm. Populli i vuri gjoksin punës dhe ndërtoi shtëpitë e tija të djegura nga lufta, ndërtoi rrugët, urat, fabrikat, minierat. U çelën me mijëra shkolla të reja në fshatra e në qytete, u ngritën shtëpi kulture, shtëpi popullore leximi, u ngritën biblioteka në të katër anët e vendit, u ndërtuan kinema të reja, u ngritën muzeume, teatro, kënde sportive, centrale elektrike të reja, kombinat dhe fabrika të reja, u ngritën banesa për punonjësit e spitale të reja, u ndërtuan olecodote dhe rafineri, u zhvillua bujqësia jonë, u zhvillua blegtoria, u hapën mijëra hektarë toka të reja, u pyllëzuan me mijëra hektarë toka, u hapën kanale, u thanë kënetat, u ndërtuan hekurudha, u çanë male dhe u hapën tunele. Në çdo sektor të aktivitetit shtetëror, social apo kultural, ne shohim realizime të mëdha. Reforma agrare, që u dha tokën fshatarëve, i ndryshoi krejtësisht raportet e forcave në lëmin e bujqë-

sisë; fshatari mori frymë lirisht dhe ju përvesh punës me zell. Ai e punon tokën me mjete të reja dhe tani prodhon më shumë. Ai përqafon metodat e reja në bujqësi, ai përdor në shkallë të gjerë traktorët dhe maqinat e tjera shirëse e korrëse që kemi sjellë nga Bashkimi Sovjetik dhe që ja ka vënë në dispozicion qeveria. Fshatarët po mbjellin me kënaqësi kultura të reja. Industria jonë po zmadhohet me fabrika të reja madhështore, siç është Kombinati i tekstileve «Stalin», Fabrika e sheqerit e Maliqit e shumë fabrika të tjera të reja që janë ngritur e po ngrihen, përveç atyre ekzistuese që janë riparuar e zgjeruar. Duke marrë për bazë prodhimet e realizuara në vitin 1945 si 100 për qind, shohim se në vitin 1949 ne kemi këto përqindje në shtimin e prodhimit në degë të ndryshme të industrisë: industria tekstile — 722,4 për qind, industria e lëkurës dhe e këpucëve — 1 723,4 për qind, industria e çimentos — 522,2 për qind, industria e duhanit — 318,6 për qind, industria e drurit — 381,9 për qind, industria elektrike — 307,7 për qind, industria e vajgurit — 400,8 për qind, minerali i bitumit — 1 174 për qind e kështu me radhë.

Arësimi e kultura, brenda këtyre pak viteve, kanë marrë një hov të madh. Në më të shumtat e fshatrave, atje ku më parë nuk kishte fare shkolla, tani ka shkolla fillore, numri i shkollave 7-vjeçare gjatë vitit 1948-1949 u rrit në 1 123 për qind, janë shtuar shkollat e mesme, është çelur Instituti i lartë pedagogjik. Njerëzit po pajisen me dituri, po shtohen aftësitë e tyre si kurrë ndonjëherë tjetër, sepse dituria bën që të ndërtohet më shpejt çdo gjë, të prodhohet më shumë dhe më mirë dhe



popullit t'i shtohet mirëqenja në çdo pikëpamje. Zhvillimi i ekonomisë sonë me të tilla ritme është një bazë e shëndoshë për realizime të ardhshme edhe më të mëdha në çdo sektor. Realizimi i planit ekonomik dyvjeçar i shtetit do të jetë bazë e shëndoshë për një plan ekonomik shtetëror më të madh, më të gjcrë, që do të shfrytëzojë në shkallë të madhe të gjitha pasuritë e mbitokës dhe të nëntokës së vendit tonë. Realizimi i këtij plani do të thotë shtimi i industrisë, i fabrikave tona, të cilat do të prodhojnë në vend shumë artikuj të konsumit të gjerë, që deri tani i kemi sjellë nga jashtë, do të thotë modernizimi i bujqësisë, prodhimi me shumicë i sendeve ushqimore dhe të gjitha këto do të ndihmojnë për një furnizim më të mirë të popullit dhe me çmime edhe më të lira. Politika e drejtë e qeverisë sonë në lëmin ekonomik bëri që të normalizohet tregu dhe të përmirësohet jeta e popullit, të forcohet aleanca në mes punëtorit dhe fshatarit dhe të lulëzojnë marrëdhënjet e fshatit dhe të qytetit. Nga viti në vit do të shtohen shkollat; me mijëra e me mijëra djem të popullit do të mbarojnë teknikume, gjimnaze, universitete dhe, të pajisur me shkencën përparimtare do t'i përvishen punës për ta zbukuruar kurdoherë më tepër jetën e popullit tonë, do të bëjnë që industria e bujqësia të modernizohen, të luftohen sëmundjet, të zhvillohen muzika, kinemaja, teatri, sporti, të edukohen njerëzit me frymën e re dhe të kenë të gjitha komoditetet e jetesës. Ky është programi i Partisë dhe Partia do të luftojë për realizimin e detyrave e të planeve sikundër i ka realizuar deri tani. Vendi ynë, nën udhëheqjen e sigurtë të Partisë, shkon drejt socializmit dhe asgjë s'e

ndalon, pse populli është i vendosur ta mbrojë dhe ta ndërtojë jetën e re, pse vendi ynë ndihmohet në këtë rrugë nga Bashkimi Sovjetik në radhë të parë dhe nga demokracitë popullore motra. Populli shqiptar i është përjetë mirënjohës Bashkimit Sovjetik dhe shokut Stalin për ndihmën që i jep në çdo lëmë të aktivitetit të tij. Pa këtë ndihmë nuk do të ishte e mundur të ecnim me kaq hapa të shpejtë drejt ndërtimit të socializmit dhe të jetës së lumtur në vendin tonë.

Ndihma ekonomike e Bashkimit Sovjetik, përkrahja e fuqishme në arenën ndërkombëtare që i bën atdheut tonë dhe të drejtave legjitime të popullit shqiptar, eksperiencia e pakufishme në ndërtimin e socializmit që na i vë pa rezerva në dispozicion, janë shprehje e miqësisë së përzemërt të popujve sovjetikë për popullin tonë.

Bota kaloi dhe po kalon rreziqe të mëdha. Imperialistët amerikano-anglezë dhe satelitët e tyre po grumbullojnë re të zeza mbi kokën e njerëzimit. S'ishte mjaft gjaku, rrënimet dhe tmerret e Luftës së dytë botërore për hitlerianët e rinj, imperialistët amerikanë dhe anglezë e shërbëtorët e tyre, që në ethe po preगतitin një kasaphanë të re, më të tmerrshme se ajo e para. Një grusht miliardësh kërkojnë t'u rrëmbejnë fitoret popujve, kërkojnë t'u hedhin përsëri zinxhirët e robërisë dhe të mbajnë nën thundër të tyre popujt e vendeve koloniale. Atyre po u afrohet fundi, prandaj ata egërsohen dhe me çdo kusht ata përpiqen t'i ruajnë pasuritë e tyre duke sakrifikuar me miliona njerëz në botë. Kapitalizmi po heq shpirt dhe është tërbuar, prandaj bota kërcënohet nga një rrezik i madh, nga

rreziku i një lufte të tmerrshme. Imperializmi amerika-no-anglez po armatoset, ai po armatos satelitët e tij, ai po ngre në Gjermaninë Perëndimore një strofkë të re naziste që ta përdorë si urë zjarri për t'u vënë përsëri flakën Evropës dhe gjithë kontinenteve. Ai kërcënon botën me tmerrin e bombës atomike. Duhet t'i hedhim zinxhirët bishës imperialiste dhe ta ndalim në tmerret e saj që ajo po përgatit. Gjithë popujt e botës, me në krye popujt e Bashkimit Sovjetik, janë çuar në këmbë dhe, të rreshtuar në frontin e fuqishëm të partizanëve të paqes, i thonë ndal luftës. Lufta nuk është e paevitueshme siç thonë kasnecët e imperializmit që kërkojnë të mbjellin fatalizmin e kataklizmës në mendjen e njerëzve me nerva të dobët. Paqja është në duart e popujve dhe sa më e vendosur dhe e gjerë që të jetë lufta e tyre për mbrojtjen e paqes, aq më tepër largohet rreziku i luftës. Kjo duhet ta bëjë popullin tonë të mos ta nënvleftësojë rrezikun e një lufte që kërkojnë të shpërthejnë imperialistët, por të mobilizohet i tëri në luftën për mbrojtjen e fitoreve. Para popullit tonë sot shtrohen dy detyra të mëdha për çështjen e paqes: së pari të nënshkruajë i tëri apelin e Stokholmit për ndalimin e bombës atomike dhe së dyti të intensifikojë propagandën e vet për demaskimin e planeve të luftëdashësve imperialistë amerikanë dhe anglezë. Çdo njeri duhet të bëhet një agjikator e propagandist në popull, për t'ja bërë atij të qarta qëllimet e manevrat e imperialistëve dhe gjithë planet djallëzore të tyre. Çdo shqiptar, i madh e i vogël, të armatoset me një urrejtje të pafund për këta kriminelë të rinj që duan të gjakosin popujt, që duan të na djegin përsëri vendin tonë,

të na vrasin kalamani, mëmat, motrat, të dashurit e zemrës sonë, që duan të na shkatërrojnë ato që ndërtoam me gjak dhe me djersë.

Popujt e mbarë botës që e urrejnë luftën, se ajo është e huaj për ta, luftojnë me të gjitha forcat e tyre për ta mbrojtur paqen. Planet djallëzore të imperialistëve dhe të shërbëtorëve të tyre do të dështojnë përpara grushtit të fuqishëm të frontit të partizanëve të paqes, që përbëhet nga popujt e lavdishëm dhe të pathyeshëm të Bashkimit Sovjetik, të demokracive popullore si dhe të gjithë kampit antiimperialist që udhëhiqen nga politika paqësore e Stalinit të madh.

Përveç detyrave të mëdha që theksova më lart, popullit tonë i vihen si detyra jetike: të forcojë fuqinë mbrojtëse të vendit të tij, të forcojë pushtetin, të forcojë ekonominë, organizimin, unitetin e vet moral dhe politik. Imperialistët dhe shërbëtorët e tyre e kanë halë në sy Republikën tonë Popullore, që lulëzon dhe ecën drejt socializmit, por të gjitha planet e tyre do të dështojnë. Shqipëria rron dhe do të rrojë e lirë dhe e pavarur, pse atë ka kush e mbron dhe e ndihmon. Imperialistët kanë vënë gjithshka në lëvizje për ta dëmtuar vendin tonë. S'kanë lënë shantazh dhe kërcënim pa përdorur kundër vendit tonë; s'lanë kuisling dhe kriminel lufte pa e përgatitur për ta lëshuar ose ndërsyer si qen kundër vendit tonë; s'lanë shpifje dhe intrigë pa kurdisur kundër vendit tonë, por që të gjitha këto u dështuan me turp, që të gjitha u përplasën në fytyrën e tyre të ndyrë dhe të gjakosur. Ju po i dëgjoni vetë agjentët e imperialistëve të pohojnë me gojën e tyre, përpara gjyqit të popullit, që mbahet këto ditë në

Tiranë<sup>1</sup>, ç'plane djallëzore kurdisin imperialistët amerikanë dhe fashistët italianë bashkë me kriminelët e luftës, njerëzit e shitur, dje te fashistët gjermanë e italianë dhe sot te imperialistët amerikanë, te neofashistët italianë, te monarko-fashistët grekë, te tradhëtarët titistë dhe te Vatikani i urryer. Tradhëtarët e «Ballit Kombëtar», të «Legalitetit», të «Blokut Independent», të gjithë njerëzit e hurit dhe të litarit, si Lumo Skëndo, Hasan Dosti, Bazi i Canës, Ahmet Zogu, Ernest Koliqi, Ali Këlcyra, Gjon Marka Gjoni e të tjerë hajdutë, që kurdoherë e kanë shitur Shqipërinë për disa lireta ose marka dhe tani për disa dollarë, përpiqen më kot ta dëmtojnë Shqipërinë. Këta janë njerëzit e të ashtuquajturës demokraci perëndimore, këta janë njerëzit e «demokracisë» amerikane, këta janë ata që kanë pretendime të sundojnë mbi popullin shqiptar, për t'i bërë varrin dhe këta kriminelë pretendojnë të quhen shqiptarë. Populli ynë u njeh dhëmbë e dhëmballë këtyre xhelatëve dhe u ka bërë dhe do t'ua bëjë varrin atyre vetë dhe gjithë atyre që ëndërrojnë të kthehet përsëri regjimi i satrapëve. Asnjë mëshirë s'duhet të ketë njeriu për këta xhelatë nën çdo maskë që ata të fshihen. Armiqtë e vendit tonë s'i hedhin armët, por përdorin njëmijë djallëzi për ta dëmtuar Shqipërinë, prandaj detyra e çdo qytetari të ndershëm, e çdo patrioti është të shtojë vigjilencën, të diktojë armikun kudo që ai

---

<sup>1</sup> Më 24 maj 1950 u hap në Tiranë gjyqi kundër bandës së Ethem Çakos, që u hodh me parashutë në vendin tonë më 8 korrik 1949 nga imperialistët amerikanë dhe nga fashistët italianë për të kryer akte kriminale e spiunazhi.

tenton të fshihet dhe t'ja hedhë duart në fyt, ta shqelmojë e ta dërmojë.

Imperialistët kujtojnë se Shqipëria është pa zot; le të shohin dhe le të nxjerrin konkluzionet nga ç'po u ngjet agjentëve të tyre që i hedhin me parashuta ose që i futin nga kufiri jugosllav dhe grek. Populli shqiptar këtë fat do t'u rezervojë të gjithë tradhëtarëve e renegatëve dhe të gjitha tentativat e tyre e të padronëve të tyre do të dështojnë me turp.

Tradhëtarët e Beogradit janë bërë qen roje të imperializmit amerikan, ata janë armiq të betuar si të popujve të Jugosllavisë ashtu dhe të popujve të Bashkimit Sovjetik, të demokracive popullore dhe veçanërisht të vendit tonë.

Tradhëtarët trockistë të Beogradit, me Titon në krye e shitën Jugosllavinë te imperialistët. Në Jugosllavi çdo gjë po kalon në duart e kapitalistëve amerikanë dhe klika e Tito-Rankoviçit është ekzekutuese e veprave dhe e planeve të Uoll Strit-it. Këta agjentë amerikanë kanë dalë me fytyrën e vërtetë të tyre prej provokatorësh. Ata po përpiqen me të gjitha mjetet të dëmtojnë atdheun dhe jetën e popullit tonë. Jugosllavia e Titos është bërë çerdhe diversantësh dhe kriminelësh shqiptarë të luftës, që tentojnë të kalojnë kufinë për të krijuar konfuzion në vendin tonë, për të organizuar banda sabotazhi dhe për të kryer atentate. Ata po shkelin të gjitha rregullat e ligjet ndërkombëtare dhe praktikat diplomatike, ata u bëjnë të pamundur jetën përfaqësuesve diplomatikë të vendit tonë në Beograd, ata i provokojnë e i shajnë për të krijuar incidente. Ata bëjnë shpifje të poshtra kundër vendit tonë, për të

gënjyer popullin jugosllav, ata bëjnë manevra me trupat e tyre në kufi dhe akte të tjera për të impresionuar popullin e fshatrave afër kufirit, sidomos duke menduar se do të arrijnë të impresionojnë popullin tonë në ditën e zgjedhjeve. Por sa rëndë gabohen këta banditë dhe sa keq e njohin kokën e shqipos. Këto akte kriminale dhe këto aksione të ndyra janë të koordinuara me ato të monarko-fashistëve grekë që dhe ata duke marrë urdhëra nga i njëjti burim me titistët, filluan përsëri këto ditë provokacionet e tyre të zakonshme në kufirin e Jugut<sup>1</sup>, duke qëlluar me armë dhe duke futur ushtarë në kufirin tonë për të impresionuar popullatën që përgatitet për votimet. Por që të dyja palët e muarën përgjegjen e merituar nga rojet tona heroike të kufirit. Titistët dhe monarko-fashistët, që deri dje vepronin nën rrogëz, tani u përqaftuan haptas, por të gjitha planet e tyre do të dështojnë. Edhe për kalamanin e vogël shqiptar është e qartë se çfarë tradhëtarë dhe banditë janë ata, prandaj i madh e i vogël në Shqipëri i ka hapur sytë e i ka bërë katër për të goditur pa mëshirë çdo veprim të tyre kundër vendit tonë, për të demaskuar plotësisht veprën e tyre kriminale si nxitës lufte dhe armiq të betuar të socializmit dhe të kampit të paqes.

Të dashur shokë dhe shoqe,

Dua të falënderoj nxehtësisht nga zemra dhe t'i shfaq mirënjohjen time të thellë popullit shqiptar, për

---

<sup>1</sup> Është fjala për provokacionet e monarko-fashistëve grekë të 23 dhe 24 majit 1950 në Malin e Mesit, midis piramidave Nr. 6 dhe 7.

dashurinë dhe besimin e pakufishëm që tregoi për Partinë tonë duke më caktuar mua, anëtarin e saj, si kandidat për deputet në shumë qendra të mëmëdheut tonë. Kjo tregon sa të shëndosha dhe të thella janë lidhjet e popullit me Partinë, kjo tregon sa e fortë është Partia jonë dhe sa e gjerë është influenza e saj në masat. S'ka kufi që e ndan Partinë nga populli, Partia është në zemrën dhe në gjakun e popullit. Partia lë kokën për popullin dhe populli s'mund ta ketë jetën të sigurtë pa Partinë. Kështu shpjegohen këto lidhje kaq të forta që janë bërë një realitet i madh në vendin tonë. Si i gjithë populli ynë. ashtu edhe unë personalisht, si djali i këtij populli, si ushtar i tij dhe i Partisë jam thellësisht i prekur nga ky realitet i madh që është farkëtuar dhe si gjithë të tjerët jam përpjekur me të gjitha forcat e mia që të jap dhe unë kontributin tim në këto realizime. Kudo që do të më kishte caktuar Komiteti Qendror i Partisë për të vënë kandidaturën time për deputet, për mua do të ishte njësoj dhe një gëzim i madh. Për mua është i dashur dhe i shtrenjtë i gjithë populli shqiptar, për mua është e shtrenjtë dhe e shenjtë çdo pëllëmbë tokë e Shqipërisë. Populli më rriti, më edukoi, më bëri njeri, luftova dhe do të luftoj derisa të kem jetën për popullin tim heroik, për popullin tim punëtor, paqedashës dhe përparimtar. Por kuptohet se s'mund të isha kandidat për deputet në shumë rrethe njëkohësisht. Komiteti Qendror më caktoi në Tiranë, më caktoi në zonën tuaj elektorale. Unë e falënderoj Komitetin Qendror të Partisë për këtë gjë, për këtë nder të madh që më bëri që të jem kandidat i juaj, i popullit punonjës të lagjeve të zonës suaj, ku



ndriti për herë të parë flaka e revolucionit popullor, ku u hodh guri themeltar i Partisë sonë heroike Komuniste që ngriti mbarë popullin në këmbë dhe nëpërmjet luftërave të përgjakshme e çoi në fitore. Lufta ime intensive për çlirimin e popullit filloi në gjirin tuaj. Me gjithë zjarrin e urrejtjes kundër okupatorit dhe tradhtarëve, që vlonte në zemrën time, isha i ri dhe pa eksperiencë në organizimin e kësaj pune të madhe, ku luhej fati i popullit tonë, por Partia më mësoi mua dhe shokët e mi, si të punonim, si të organizonim dhe si të luftonim. Gjëja e parë që na këshilloi Partia ishte: «ja, populli ynë heroik që vuan në robëri; duhet të luftojmë për popullin që ta çlirojmë, të mos kursejmë në asnjë moment as jetën për popullin. Të shkojmë në popull dhe tok me të të shkojmë në luftë. Fitëryja jonë është e sigurtë, pse me ne është drejtësia, me ne është Bashkimi Sovjetik, me ne është Stalini, pse në këtë ndërmarrje gjigande na udhëheqin dhe na ndritin rrugën e triumfit mësimet gjeniale të Marksit, Engelsit. Leninit, Stalinit». Dhe ne erdhëm me besim të patundur te ju. Ju na i hapët dyert, na i hapët zemrat. Ne s'kishim aso kohe as tituj as grada as pozita. Ne ishim djemtë tuaj të thjeshtë, ishim zemra dhe gjaku juaj, ne vetëm kishim një titull të nderuar: ishim komunistë dhe ishim të vendosur deri në vdekje që as njolla më e vogël të mos ta prekte këtë emër dhe këtë titull kaq të madh. Ju i mbani mend, ishin kohëra të vështira, por ishin kohëra heroike të lëvizjes sonë nga ku varej triumfi ose shkatërrimi. Partia triumfoi pse ajo i kishte bazat në popull, pse Partia ishte populli, ishit ju. Shtëpitë tuaja u bënë bazat e Partisë. As bombat as plumbat as litari

as terrori i fashizmit dhe i Mustafa Krujës nuk ju tuti. Zemra ime dhe e shokëve të mi është e pandarë nga të gjithë ju, që na mësuat si të luftojmë, që na mbrojtët, që luftuat tok me ne, tok me Partinë për çështjen e madhe të popullit tonë. Për mua janë të dashura shtëpitë tuaja të thjeshta ku rrihte zemra e popullit; janë të dashura rrugicat, kopshtet e shtëpive tuaja të thjeshta ku na prisnit me buzë në gaz ne që ndiqeshim nga milicët e fashizmit, ne të qullur nga shiu dhe nga balta e rrugëve, ne që sillnim me vete kërcënimin e reprezaljeve të fashizmit. Në bodrumet e shtëpive tuaja ne grumbullonim armë e municion, ne kishim ngritur shtypshkronja ilegale, nga ku dilnin me qindra mijë fletë që i ndritnin rrugën popullit, shtëpitë tuaja ishin bërë vende mbledhjesh ku janë marrë vendime të rëndësishme historike, shtëpitë tuaja u bënë spitale ku shëroheshin shokët tanë të plagosur. Zemra ime është kurdoherë pranë jush, pranë vatrave tuaja, pse atje kam punuar me shokë nga më të mirët të Partisë sonë, që kanë rënë heroikisht duke luftuar për popullin, ushtarët heroikë të Partisë: Qemal Stafa, Misto Mame, Mihal Duri, Vasil Shanto, Vojo Kushi, Xhoxhi Martini, Sadik Stavaleci etj. Atje kam kujtimet e shokëve të mi, Hamdi Mëzezit, Ferid Xhajkos, Nikolla Tupës, Shyqyri Ishmit, Perlat Rexhepit, Kajo Karafilit, Alqi Kondit, Nako Spirit, Dull Ketës, Gjik Kuqalit, Sabaudin Gabranit, Siri Kodrës, Lym Shyrit etj., që luftuan dhe dhanë jetën për mëmën Shqipëri. Atje kam kujtime të shtrenjta të shokut tonë trim, që luftoi për popullin tonë dhe komunizmin, birin të popujve heroikë të Jugosllavisë, Miladin Popoviçit, i vrarë tradhëtisht nga banditët

trockistë të Titos dhe Rankoviçit. Këto gjëra të shenjta më lidhin me ju përjetë. Unë jam po ai, si më keni njohur në ditët e para të luftës, as gradat as posti që kam në drejtimin e Partisë dhe të shtetit, nuk më kanë ndryshuar, as nuk më kanë rritur mendjen, pse këtë edukatë ma ka dhënë Partia dhe ju. Unë jam kurdoherë biri juaj, vëllai juaj, shoku juaj, jam një ushtar i thjeshtë i popullit dhe i Partisë që do të luftoj me të gjitha forcat e mia gjatë gjithë jetës sime për çështjen e popullit dhe të Partisë. Vetëm një gjë ka ndryshuar në vendin tonë, në popullin tonë dhe në gjithë ne, nga koha e luftës çlirimtare. Sot atdheu ynë është i lirë, i pavarur, sovran dhe çdo ditë e më shumë po lulëzon. Në rrugën për ndërtimin e socializmit te ne po formohet njeriu i ri, i cili për çështjen e popullit, të Partisë dhe të socializmit nuk kursen as jetën. Sot Shqipëria e re është më e fortë se kurrë. Të gjitha këto ne ja detyrojmë Partisë sonë e Komitetit Qendror të saj si dhe Bashkimit Sovjetik e të shtrenjtit Stalin.

Shokë dhe shoqe,

Në mëhallat tuaja popullore, ku ne punonim dhe luftonim së toku, kishte dhe nga ata njerëz, që nuk ishin aq të bindur në triumfin e kauzës sonë, por që s'ishin armiq. Dhe ata nuk na tradhëtuan. Ata shihnin lëvizjet tona, por heshtnin. Aq u jepej, thotë një fjalë populli. Por edhe ata e donin Shqipërinë dhe e urrenin armikun. Lufta jonë, drejtësia jonë i bindi dhe ata. Të tillë njerëz ka edhe tani që s'janë armiq, që e duan Shqipërinë dhe kurrë nuk mund të durojnë që ajo të

bëhet preja e imperialistëve, pse një gjë që është në dëm të atdheut, është medoemos dhe në dëmin e tyre. Por këta njerëz akoma ngurrojnë, të ndrydhur në konceptet e vjetra dhe prapanike të «demokracisë» borjeze, të «demokracisë» për një grusht kapitalistësh dhe shfrytëzuesish që, ata vetë, në fund të fundit, po t'i vënë gishtin kokës nuk mund të pajtohen me atë «demokraci». Kur them këto unë kam parasysh disa lntelektualë, që s'pajtoheshin me regjimin e urryer të Zogut, që s'e duronin okupacionin fashist, që e duan Shqipërinë se është atdheu i tyre, por që akoma nuk e shohin si duhet rrugën e vërtetë, rrugën e drejtë të Shqipërisë së re që duhet të jetë rruga e tyre. Por edhe këta si ata të parët, lufta jonë, drejtësia jonë, rruga dhe politika e drejtë e Partisë sonë do t'i bindë plotësisht. Ata do të ringjallen, do të dalin në një botë tjetër, të re, të bukur, të lumtur. Vetëm armiqtë e popullit do të mbeten dhe do të vdesin armiç të popullit.

Duhet të kemi durim të madh me njerëzit, na mëson Partia se «*njeriu është thesari më i vlefshëm*», thotë Stalini. Partia triumfon mbi çdo pengesë, ajo i ndreq njerëzit, i edukon, i rrit, i bën të vlefshëm për kauzën e përgjithshme të popullit. Një njeri i ndershëm është e pamundur të mos shkëputet shpejt ose vonë nga interesat e vogla dhe meskine, të cilat e pengojnë të kuptojë çështjen e madhe e vitale të popullit dhe të atdheut dhe të mos punojë për të. Por për ta kuptuar këtë çështje duhet kohë dhe punë politike, prandaj për edukimin e tyre duhet durim e këmbëngulje. Duke punuar në këtë mënyrë çdo pengesë do të kapërcehet, pse ne kështu i kapërcyem edhe vështirësitë e mëdha

të luftës dhe jo të mos i kapërcejmë sot që i kemi të gjitha mundësitë.

Populli shqiptar ka nevojë për paqe dhe lufton për ta mbrojtur paqen me të gjitha forcat e tija. Populli shqiptar aspiron të rrojë i qetë dhe të ndërtojë jetën e tij, ashtu si e dëshiron ai dhe ecën me vendosmëri në rrugën e ndritur të socializmit. Prandaj ai e forcon çdo ditë unitetin e tij, duke i qëruar armiqtë që e pengojnë në rrugën ndërtimtare dhe duke i bindur dhe duke i sjellë në rrugën e drejtë të gjithë ata që e kishin humbur busullën, që ishin të çorientuar dhe të gënjyer. Faktet dhe provat janë të gjalla dhe bindëse për çdo njeri që ka zemër dhe tru të gjykojë. Çdo njeri i ndershëm në regjimin e demokracisë popullore i ka të gjitha mundësitë të rrojë i lirë, të përparojë, të zhvillohet, të mësohet, të zbukurojë jetën e tij dhe të familjes së tij, të gjitha portat i ka të hapura, ka gjithë ndihmën nga pushteti i tij popullor. Prandaj për pushtetin tonë popullor të cilin populli e ngriti me kaq sakrifica të mëdha, duhet të mobilizojmë të gjitha forcat që ta forcojmë çdo ditë e më tepër, që ta demokratizojmë, që ai të jetë i tëri në duart e popullit dhe nën kontrollin e popullit. Këtë del rëndësia e madhe dhe përgjegjësia e rëndë dhe e shenjtë e përfaqësuesve që zgjedh populli, qoftë këshilltarët në këshillat popullore, qoftë deputetët në Kuvendin Popullor që do të zgjedhim më 28 maj. Këta deputetë s'janë përfaqësuesit e një klike ose të një grupi kapitalistësh, siç ngjiste në regjimet e errëta të së kaluarës në vendin tonë dhe siç ngjet në çdo vend ku sundon thundra e kapitalit, e imperializmit. Deputetët e Shqipërisë së re nuk blihen as me pare dhe as nuk

bëhen vegla të njërit e të tjetrit. Deputetët në Republikën tonë popullore, janë njerëzit më të ndershëm, të pakorruptuar, janë njerëz të sakrificës dhe më besnikë të popullit. Ata janë përfaqësues të popullit që rrojnë dhe luftojnë për popullin. Ata janë përgjegjës përpara popullit dhe vetëm përpara popullit. Detyrat e tyre janë të rënda, nga më të rëndësishmet dhe me përgjegjësi të madhe. Me qenë deputet s'është vetëm një titull ndëri. Të jesh deputet i popullit, përveç vetive të tjera duhet të jesh punëtor i palodhur dhe t'i shërbesh popullit në çdo çast. Populli zgjedh përfaqësuesit e tij në këshillat popullore dhe në Kuvendin Popullor, që këta ta drejtojnë popullin dhe t'i japin vazhdimisht llogari popullit për punën e tyre. Ju e dini esencën e regjimit tonë popullor e shprehur aq qartë në Statutin themeltar të Republikës sonë Popullore. Çdo përfaqësues i popullit, që nga anëtari i këshillit popullor deri te deputeti i Kuvendit Popullor, që është instanca më e lartë e shtetit tonë, duhet të udhëhiqet kurdoherë nga të drejtat dhe detyrat që i cakton Statuti themeltar, të veprojë brenda kuadrit të tyre dhe t'i kryejë ato me të gjitha forcat. Ata janë përgjegjës përpara popullit për bërjen e ligjeve që rregullojnë jetën në vendin tonë, por detyra e tyre s'ndalet këtu; ata janë përgjegjës për zbatimin e drejtë të këtyre ligjeve nga ana e tyre dhe nga ana e organeve ekzekutive. Ata kanë të drejtën e kontrollit rigoroz mbi të gjithë aktivitetin shtetëror të institucioneve që nga qeveria e deri poshtë te organet shtetërore të bazës dhe të njerëzve që punojnë në to. Ata, të organizuar në komisione të ndryshme, qoftë në këshillat popullore, qoftë në Kuvendin Popullor kanë

të drejtë dhe për detyrë të kontrollojnë gjithë veprimtarinë e qeverisë si tërësi dhe veç e veç të çdo dikasteri e ministri ose të organeve të tjera shtetërore, kur ata e shohin të nevojshëm; po kështu edhe ata të këshillave popullore kanë të drejtë dhe për detyrë të kontrollojnë dhe të ndihmojnë veprimtarinë e komiteteve ekzekutive, të kryesive të tyre dhe të çdo seksioni ose organi vartës të tyre. Ata duhet të mbajnë kontakte të vazhdueshme me zgjedhësit e tyre, t'u shpjegojnë problemet, të dëgjojnë zërin e masave, e kur duhet, të ndërhyjnë me autoritetin e tyre të madh për të ndrequr gabimet. Ata i japin vazhdimisht llogari popullit dhe zgjedhësve të tyre për kryerjen e detyrave që u janë besuar, në mbledhjet e tyre periodike të përgjithshme të caktuara sipas Kushtetutës së RPSH dhe ligjeve në fuqi. Kështu shpjegohet që pushteti në vendin tonë buron nga populli dhe i përket popullit. Kështu shpjegohet që në Kuvendin Popullor, populli dërgon nga njerëzit e tij më të mirë, më besnikë, më punëtorë, më trimë, më të ndershmit, dërgon njerëz nga të gjitha shtresat, krahinat dhe profesionet.

Kuptohet, pra, rëndësia e madhe që i vë populli ynë fushatës së madhe elektorale për zgjedhjet e 23 majit dhe është i natyrshëm ky gëzim i papërskruar dhe ky entuziazëm i madh që ka shpërthyer në vendin tonë në vigjiljen e kësaj ngjarjeje me rëndësi të madhe për vendin tonë. I tërë populli shqiptar, pa përjashtim do të shkojë në votime dhe do të votojë i gjithë si një blok graniti për kandidatët e Frontit Demokratik. Populli shqiptar, duke votuar i tëri për kandidatët e Frontit Demokratik, ka votuar për idealin për të cilin

ranë në fushën e nderit gjatë luftës së lavdishme çlirimtare me mijëra djem dhe vajza, nga më të mirët e tij, ka votuar që të mos përsëriten më tmerret e luftës, shkatërrimet, djegjet, të mos përsëriten më kampet e përqëndrimit të Prishtinës, të Dakaut e të Bukenvaldit, të mos përsëritet më terrori i 4 shkurtit; ka votuar që të mos digjet më Kurveleshi, Mallakastra, Përmeti, Korça, Tirana, Peza e Malësitë, ka votuar për paqen, për mbrojtjen e saj, ka votuar kundër imperialistëve gjakatarë dhe tradhëtarëve të vendit tonë. Populli shqiptar duke votuar i tëri si një blok për kandidatët e Frontit Demokratik, ka votuar për socializmin, për jetën e tij të lumtur, ka votuar që të forcohet e të lulëzojë atdheu, që kalamanët e tij të rriten si njerëz të vërtetë, të lumtur e të gëzuar dhe të mos kërcënohen më kurrë nga hija e urisë dhe nga tmerri i bombardimeve dhe i predhave të helmatisura të hitlerianëve të rinj: imperialistëve amerikanë dhe anglezë e shërbëtorëve të tyre, zogistëve, ballistëve, titistëve, monarko-fashistëve etj. Populli shqiptar duke votuar i tëri si një blok për kandidatët e Frontit Demokratik, ka votuar për Partinë e tij të lavdishme të Punës, që e nxori në dritë, që e shpëtoi nga robëria shekullore, që i siguroi atdheut tonë lirinë, pavarësinë dhe sovranitetin dhe që e udhëheq popullin në rrugën e lumtur të socializmit. I gjithë populli shqiptar duke votuar për kandidatët e Frontit Demokratik ka votuar për miqësinë e shtrenjtë me Bashkimin Sovjetik, ka shprehur dashurinë e tij për popujt e Bashkimit Sovjetik, për Partinë e lavdishme Bolshevike të Lenin-Stalinit, për udhëheqësin e shtrenjtë Stalin, përkrahësit e popullit tonë dhe të gjithë po-



pujve të botës. Populli shqiptar, duke votuar si një blok për kandidatët e Frontit Demokratik, ka votuar për miqësinë me popujt vëllezër të demokracive popullore në Evropë dhe në Azi, ka votuar për solidaritetin dhe miqësinë me punonjësit luftëtarë heroikë të Francës, të Italisë, të Spanjës, të Vietnamit, të Malezisë, të Jugosllavisë, të Greqisë, që luftojnë me vetëmohim kundër imperializmit skllavërues dhe agjentëve të tij, populli shqiptar ka votuar për solidaritetin ndërkombëtar të punonjësve, ka votuar për kampin e fuqishëm të socializmit dhe të paqes që udhëhiqet nga Bashkimi Sovjetik dhe nga Stalini i madh.

I bëj thirrje gjithë popullit shqiptar që dita e 28 majit të bëhet dita e një manifestimi më të madh popullor, dita e bashkimit të çelniktë të popullit tonë dhe t'u tregojmë atyre që s'na e duan të mirën se s'ka forcë që ta mposhtë popullin tonë.

I bëj thirrje popullit shqiptar që i gjithë të shkojnë në votime dhe i gjithë pa përjashtim të votojnë për kandidatët e Frontit Demokratik, të votojnë për mëmën e shtrenjtë Shqipëri, të votojnë për forcimin dhe lumturinë e atdheut të tij — Republikës Demokratike Popullore të Shqipërisë.

Rroftë populli shqiptar!

Rroftë Republika Popullore e Shqipërisë!

Rroftë Fronti Demokratik!

Rroftë Partia jonë heroike e Punës!

*Botuar për herë të parë në gazetën «Zëri i Popullit», Nr. 127 (516), 26 maj 1950*

*Botohet sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë*

## DISA ÇËSHTJE TË PUNËS SË PARTISË ME BASHKIMET PROFESIONALE

*Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike  
të KQ të PPSH<sup>1</sup>*

2 qershor 1950

Kam disa vërejtje për raportin e shokëve të bashkimeve profesionale.

Së pari, në mbledhje të Byrosë Politike të mos na paraqiten shumë çështje pse kështu nuk dallohen ato më kryesoret.

Së dyti, këtu të na vijë për studim e diskutim probleme serioze që i preokupojnë bashkimet profesionale dhe që kërkojnë zgjidhje nga Byroja Politike.

Së treti, ato çështje për të cilat kemi vendosur nuk ka pse të na paraqiten përsëri, për këto të na thuhet vetëm se si luftohet për zgjidhjen e tyre. Pse të na shtrohet çështja e shtëpive të pushimit ose e zbatimit të kodit të punës? Për këto ne kemi vendosur dhe për ata

---

<sup>1</sup> Në këtë mbledhje u diskutua rreth raportit të Këshillit Qendror të BPSH «Mbi gjendjen dhe problemet kryesore të bashkimeve profesionale».

që nuk i zbatojnë të merren masa duke bashkëpunuar për këtë me Kryeministrinë ose organet e tjera shtetërore përkatëse.

Organizata e bashkimeve profesionale duhet të mendojë më shumë për realizimin e planit jo me punë jashtë 8-orëshit, por duke organizuar mirë garat socialiste, duke shfrytëzuar mirë kohën e punës, duke zbatuar metodat e reja dhe duke përhapur shembullin e eksperiencën e më të mirëve. Këto janë një zinxhir i tërë dhe po të lidhet mirë ky zinxhir, plani me siguri do të realizohet. Bashkimet profesionale duke punuar për realizimin e planit të tregojnë kujdes të madh edhe për njerëzit. Kështu, p.sh. vullnetarët që shkojnë e punojnë në ferma duhet të trajtohen mirë sidomos me ushqim, sepse, ata që shkojnë nëpër aksione jo vetëm që janë njerëzit më të mirë, por trajtimi si duhet i tyre është një faktor që do të nxitë edhe të tjerë për të shkuar në aksione. Prandaj këtë çështje nuk duhet ta neglizhojmë.

Është e vërtetë se, siç u tha edhe këtu, bashkimet profesionale kanë bërë përparime dhe në të ardhshmen me siguri do të forcohen edhe më shumë. Të metat që vërehen në punën e tyre, mendoj se vijnë ngaqë Partia nuk i ka ndihmuar sa dhe si duhet ato. Veç kësaj, puna do të shkonte edhe më mirë në qoftë se ministrinë dhe organet e tjera të pushtetit lokal do të kuptonin më drejt rolin e bashkimeve profesionale dhe mbi bazën e këtij kuptimi të forconin edhe marrëdhënjet me to. Po të qe vepruar kështu, bashkimet profesionale do të ishin forcuar edhe më shumë dhe do të luanin edhe më mirë rolin e tyre.

Natyrisht, këto lidhje kanë ardhur duke u forcuar, por megjithatë, për të mos pasur neglizhenca për shumë çështje të punëtorëve sidomos në përmirësimin e kushteve të jetesës dhe të nevojave të tyre, duke filluar që nga banesat e deri te gjërat më elementare duhet që këto lidhje të jenë më të ngushta.

Bashkimet profesionale janë një organizatë politike, së cilës Partia i ka dhënë dhe disa kompetenca për kryerjen e detyrave të ngarkuara, që janë ligjësuar me anë të dispozitave të ndryshme. Por që ato të kryejnë mirë detyrat dhe të ushtrojnë kompetencat, duhet që edhe organet shtetërore, dikasteret e ndërmarrjet të marrin të gjitha masat për t'i ndihmuar ato në punën e tyre, për të zbatuar direktivat e Komitetit Qendror të Partisë.

Vështirësi ka dhe do të ketë, por duhet ta kuptojnë drejt, se plani do të realizohet vetëm nga njerëzit dhe kryesisht me klasën punëtore, prandaj ndërmarrja t'i kërkojë punëtorit jo vetëm realizimin e planit, por njëkohësisht t'i sigurojë atij banesën, mishin, bukën etj. Po nuk u bë kështu nuk mund të ecet përpara. Domethënë në qoftë se nuk kuptohet kjo detyrë e nuk merren masa për përmirësimin e jetesës së punëtorëve, as fuqinë punëtore nuk mund ta sigurojmë dhe as planin nuk mund ta realizojmë. Pra, ka rëndësi që t'u krijojmë atyre kondita të mira jetese, pse në rast se ne nuk mendojmë për banesat, për këndin e kuq, për ngritjen kulturele dhe për çlodhjen e tyre etj. nuk mund të realizohet plani. Po të merren të gjitha këto masa nuk do të jetë nevoja të punohet jashtë normave të kodit të punës për realizimin e planit. Organet shtetërore ekzekutive që

akoma nuk janë në rregull në këtë drejtim, duhet të marrin masa organizative dhe t'i kryejnë të gjitha detyrat që u takojnë atyre. Kur të sigurohen këto kondita nga shteti, atëhere krijohen mundësitë që edhe bashkimet profesionale ta bëjnë mirë punën dhe ne të kërkojmë më shumë prej tyre.

Ne nuk kemi pasur shumë mundësi që t'i kënaqim më tepër punëtorët dhe megjithatë ata u janë përgjegjur me entuziazëm thirrjeve tona. Tani konditat materiale të vendit tonë janë përmirësuar, mirëpo paralelisht me këtë, nuk është përmirësuar organizimi i punës nga ana jonë. Ne e kemi thënë shumë herë se qendrat e punës duhet të furnizohen në rregull. Këtë detyrë Ministria e Tregëtisë nuk e ka bërë si duhet megjithëse i ka të gjitha mundësitë që këtë problem ta zgjidhë mirë. Ne kemi bërë kategorizimin e punëtorëve, kemi marrë dhe shumë masa të tjera në favor të punëtorëve, por ato nuk po vihen në jetë ashtu siç duhet. Kjo vjen edhe ngaqë punohet akoma me normat e vjetra.

Ato që kanë propozuar shokët e BPSH duhet të shqyrtohen me shpejtësi e seriozitet dhe të caktohen edhe afate për realizimin e tyre. Në radhë të parë të sigurohen banesat, veshmbathjet dhe ushqimet që janë planifikuar për qendrat e punës. Të gjitha këto nuk duhet të shtrohen herë tjetër përpara Byrosë Politike, pse tani janë të gjitha mundësitë për t'i realizuar, por vetëm duhen përpjekje edhe më të mëdha nga njerëzit tanë.

Organizatat e Partisë në rrethe nuk i kanë ndihmuar sa duhet bashkimet profesionale dhe shihet se këtë detyrë ato nuk e kanë kuptuar efektivisht si duhet.

Të kuptojmë një herë e mirë se bashkimet profesionale janë levat kryesore të Partisë për ndërtimin e socializmit. Nëpërmjet anëtarëve të Partisë, që punojnë me bashkimet profesionale, duhet të mobilizohen të gjithë njerëzit që punojnë atje për edukimin e klasës punëtore. Që të kuptohet drejt ky problem, kuadrot e Partisë duhet të jenë gjithmonë pranë kësaj organizate. Anëtarët e Partisë dhe kuadrot kudo që ka punëtori, duhet të punojnë vazhdimisht për forcimin e organizatave profesionale, pse roli i tyre është i madh në ndërtimin e socializmit. Anëtarët më të mirë të Partisë të ndihmojnë më shumë në kurset e seminarët e bashkimeve profesionale. Në shtyp duhet të shkruhen, qoftë dhe shkurt, disa çështje të thjeshta teorike që kanë të bëjnë me problemet e bashkimeve profesionale. Këto punë të mos u lihen vetëm instruktorëve të aparatit të komitetit të Partisë që merren me këtë çështje.

Komitetet dhe organizatat e Partisë në rrethe duhet të ngrejnë vazhdimisht dhe si një problem të madh çështjen e bashkimeve profesionale dhe t'u kërkohet llogari anëtarëve të Partisë si në përgjithësi ashtu edhe veç e veç për detyrat që u takojnë në këtë drejtim.

Drejtesit e Partisë të mos u marrin kompetencat bashkimeve profesionale po t'i ndihmojnë ato që të kryejnë vetë detyrat e tyre. Nuk lejohet tendenca me spostue rolin e kësaj organizate, as me i dekurajue shokët që punojnë në to. Në këtë drejtim duhet t'i vëmë mirë pikat mbi «i» pse ka pasur edhe shfaqje të tilla. Bashkimet profesionale të ndihmohen vazhdimisht nga Partia dhe shokët që drejtojnë ato, kur të marrin pjesë në mbledhje të ndryshme, të nxiten dhe të inkurajohen

që të flasin, të sjellin mendimin e zërin e punëtorëve në Parti, të kritikojnë me guxim dhe të kritikohen e të ndihmohen për të përmirësuar punën e tyre. Po të ketë ndihmë dhe kontroll në bazë nga sekretari i Partisë do të gjallërohet puna e shokëve që punojnë në bashkimet profesionale e do të luftohet gjendja e fjetur që vërehet në disa raste.

Kjo të mbahet gjithmonë parasysht se ngandonjëherë rutina e punëve të përditshme, që tërheq shokët e Partisë në rrethe, bën që ata të harrojnë rolin e bashkimeve profesionale si leva kryesore të Partisë, nëpërmjet të cilave ata duhet të kryejnë në përgjithësi detyrat që shtron Partia para klasës punëtore.

Për bashkimet profesionale nuk duhet me u kursye. Shtëpitë e pushimit, si vila e Shirokës etj., t'u jepen atyre për t'i përdorë për pushimet e punëtorëve dhe të fëmijëve të tyre. Po t'u përmirësohen konditat materiale punëtorëve, klubet, mensat, vendet e çlodhjes etj. atëhere ata, kur shohin se ka interesim dhe nivel i jetës së tyre ngrihet vazhdimisht, lidhen më mirë me punën dhe plani realizohet plotësisht. Këto gjëra kanë rëndësi të madhe. Prandaj për të gjitha të metat që thamë kemi përgjegjësi dhe askush nuk mund të shkarkohet nga kjo përgjegjësi.

*Botohet për herë të parë sipas  
tekstit të nxjerrë nga proces-  
verbali i mbledhjes së Byrosë  
Politike të KQ të PPSH  
që gjendet në AQP*

## FJALA NË TAKIMIN ME NJË GRUP NXËNËSISH TË DALLUAR NË MËSIM

19 qershor 1950

Ne jemi shumë të gëzuar që erdhët këtu dhe u takuam. Ju jeni nga nxënësit më të mirë e më të shkëlqyer, ju keni marrë të gjitha notat pësa<sup>1</sup>.

Sikundër në fabrika, qendra pune e fshatra kemi heronj të punës e sulmues, ashtu edhe në shkolla kemi sulmues, të dalluar në mësim. Ju jeni shembull për të gjitha shkollat e tjera. Duke dalë me rezultate të tilla, ju jo vetëm që keni nderuar veten, prindërit, baballarët e nënat tuaja, si dhe mësuesit tuaj, por keni treguar dashuri të madhe edhe për atdheun e popullin, për shkollën, mësimin dhe për librin.

Unë e di që si ju ka dhe shumë të tjerë në shkollat tona, por ju jeni më të shkëlqyerit. Kjo na gëzon shumë, sepse kur Shqipëria ka nxënës të tillë, që mësojnë kaq mirë, e ardhshmja e popullit tonë është më e sigurtë.

Sot në shkolla shkojnë bijtë e punëtorëve dhe të fshatarëve. Kjo është e natyrshme, se vetë regjimi i so-

---

<sup>1</sup> Sipas sistemit të vlerësimit të asaj kohe pesa ka qenë nota më e mirë.



tëm është pushteti i punëtorëve dhe i fshatarëve. Ky pushtet, që u vendos në Shqipëri nga lufta e baballarëve, nënave, motrave e vëllezërve tuaj, nga lufta e klasës punëtore në aleancë me fshatarësinë, e cila çdo ditë vjen duke u forcuar për të siguruar të ardhshmen e lumtur të vendit tonë, bëri që kultura, arësimi, dituria të jenë të masave të popullit e në radhë të parë të punëtorëve e të fshatarëve.

Siç e keni mësuar në shkolla dhe siç u kanë treguar dhe prindërit tuaj, në regjimet e kaluara, në kohën kur sundonte Zogu, kishte shumë pak shkolla e në to shkonin shumë pak fëmijë, shkonin kryesisht fëmijë të shtresave të pasura, ndërsa fëmijët e të varfërve nuk kishin mundësi t'i ndiqnin ato. Si çdo regjim shtypës edhe regjimi i Zogut nuk donte që bijtë e punëtorëve dhe të fshatarëve të mësonin sepse, nga njëra anë, duke i lënë në errësirë mund t'i shfrytëzonte më lehtë dhe nga ana tjetër, kishte frikë se mos u hapeshin sytë dhe ngriheshin kundër vetë regjimit për t'i bërë varrin ashtu si ja bënë. Prandaj arësimi dhe sidomos ai i mesëm e i lartë ishte bërë monopol i bijve të feudoborgjezisë së lartë e të pasur, për të mbajtur kështu më mirë frenat e shtetit dhe për të shtypur më lehtë popullin. Po lufta jonë i rrëzoi ata. Pushteti popullor krijoi mundësi që djemtë e punëtorëve dhe të fshatarëve të edukohen, të studjojnë dhe të bëhen të aftë për të mbajtur frenat e shtetit në duar për të mos lejuar kurrë që të kthehet e kaluara. Arësimi dhe kultura kanë një rëndësi të madhe për ndërtimin e socializmit. Ato të ne janë të masave dhe duhet të vihen vetëm në shërbim të popullit, prandaj ju të keni kujdes të mësoni sa më

shumë. Por a mund të bëjmë ne që edhe fëmijët e disa ish të pasurve, që gjatë luftës janë treguar të lëkundur, por që sot punojnë mirë, të venë në shkollë, të mësojnë dhe të bëhen të vlefshëm për popullin? Po, edhe mundet, por, veçse arësimi i tyre duhet medoemos t'u shërbejë interesave të popullit. Natyrisht, organizata e rinisë dhe e pionierit duhet të punojnë shumë për t'i edukuar me frymën e re këta fëmijë, sepse sa më tepër njerëz të mirë të ketë Shqipëria, aq më shpejt do të shkojë përpara e do të lulëzojë ajo.

Ju i keni të gjitha mundësitë për të fituar dituri. Dituria është një stoli e nevojshme për njeriun. Njeriu, kur ka diturinë, ka një armë që e bën të zotërojë natyrën, të krijojë për të lulëzuar vendin dhe të luftojë për një jetë më të mirë, për socializmin. Ju sot jeni të pajisur me libra e sende të tjera që ju nevojiten. Shumë shkolla kanë laboratorë që do të plotësohen nga viti në vit. Ju keni shumë gjëra që ne nuk i kemi pasur, si fabrikat, uzinat dhe kombinatet që po ngrihen, keni mbështetje mësimet e shkencëtarëve të mëdhenj përparimtarë të botës. Ju gëzoni kujdesin atëror të Partisë sonë. Në të kaluarën ne s'i kishim të gjitha këto. Prandaj ju i keni të gjitha mundësitë që të mësoni sa më shumë.

Ju kur keni parë fabrikat që po ndërtohen e keni ndjerë veten krenarë dhe keni menduar të mësoni sa më shumë. Po nën udhëheqjen e Partisë sonë do të ndërtohen edhe më shumë fabrika e shkolla. Jeta do të bëhet më e lumtur.

Detyra juaj është të mësoni sa më shumë, të doni prindërit, arësimtarët dhe gjithë popullin, të bëheni njerëz të ndershëm për atdheun tonë, të vizitoni vendet

më të bukura, pyjet dhe fabrikat, minierat, Hidrocentralin e Selitës<sup>1</sup>, sharrat ku punojnë vëllezërit tuaj për të nxjerrë lëndë ndërtimi etj. Të organizoni ekskursione për të parë fshatarin duke punuar në arë, për të parë pyje të gjelbëruara etj. dhe me siguri, në fund, do të thoni: «Sa i bukur, sa i dashur është atdheu ynë!» Njëpërmjet ekskursioneve do të shikoni vendet ku kanë luftuar baballarët dhe nënat tuaja, vëllezërit dhe motrat tuaja, ku, nga ata, edhe janë vrrarë dhe do t'u mbushet zemra plot respekt për luftëtarët dhe dëshmorët dhe me urrejtje për armiqtë e vendit tonë. Në këtë drejtim duhet të ndihmojë organizata e rinisë dhe e pionierit.

Armiqtë kërkojnë të shpërthejnë një luftë të re grabitqare. Nga luftërat imperialiste kalamanët janë ata që vuajnë më tepër, që vriten, që mbeten në të katër rrugët. Prandaj rinia duhet të jetë shumë aktive dhe e vendosur për mbrojtjen e paqes. Ajo duhet të nënshkruajë apelin e Stokholmit që të ndalohej përdorimi i armëve çfarosëse si bomba atomike e tjera. Popujt, të mobilizuar, nuk do të lejojnë imperialistët amerikanë dhe të tjerët të shpallin luftën, paqja është në duart tona. Paqen do ta fitojmë se për atë luftojnë gjithë popujt e botës me në krye Bashkimin Sovjetik. T'u thoni baballarëve dhe nënave tuaja ta nënshkruajnë apelin e Stokholmit, se në këtë mënyrë ata kontribuojnë në luftën për mbrojtjen e paqes.

Imperialistët i mësojnë fëmijët e tyre me ndjenjën e luftës dhe të urrejtjes së popujve edhe nëpërmjet lojnavë. Ja një lojë: Në një aeroplan fëmijët vendosin

---

<sup>1</sup> Hidrocentrali «V. I. Lenin».

4 bomba dhe njëri shtyp sustën, bombat bien dhe shkatërrojnë qytetin. Kështu i mësojnë ata kalamanët e tyre, prandaj duhet t'i urrejmë imperialistët dhe t'i luftojmë me të gjitha forcat tona.

Rinia duhet t'i shtërngojë radhët e saja rreth Partisë dhe organizatës së saj të rinisë. Pa Partinë nuk do të kishim këto ditë të lumtura. Partia është pjesa më e ndërgjegjshme e masës së popullit, pjesa më luftëtare që del nga gjiri i popullit. Partia është pararoja e klasës punëtore që e çon popullin drejt jetës së lumtur, në socializëm. Në Parti janë njerëzit më të mirë, që luftojnë e punojnë me vetëmohim. Partia është udhëheqësja e popullit në luftën kundër imperialistëve, tradhëtarëve të Beogradit dhe monarko-fashistëve të Athinës. Prandaj ju të gjithë e doni Partinë, e keni atë në zemër.

Në vendet ku sundon kapitalizmi, fëmijët e të varfërve janë të zhveshur, s'kanë bukë të hanë, mbledhin koska e thërrime, kurse të pasurit vjedhin, grabitin dhe rrojnë në pallate. Por edhe atje do të vijë dita që popujt të çlirohen.

E ardhshmja është e socializmit, e komunizmit. Ky është ligj. Këtë e ka përcaktuar Marksi, Engelsi, Lenini, Stalini dhe kështu do të bëhet.

Rroftë Rinia jonë heroike!

Rroftë Partia dhe populli shqiptar!

Rroftë Bashkimi Sovjetik, rroftë Stalini i madh!

*Botuar për herë të parë në gazetën «Rinia», Nr. 38 (308), 21 qershor 1950*

*Botohet sipas tekstit të gazetës «Rinia», Nr. 38 (308), 21 qershor 1950*

**FJALA E MBAJTUR NË SESIONIN I TË  
LEGJISLATURËS SË DYTË TË KUVENDIT  
POPULLOR KU PARAQET DORËHEQJEN  
E QEVERISË**

**4 korrik 1950**

Shokë deputetë,

Kanë kaluar më tepër se katër vjet që kurse m'u besua nderi i madh të drejtoja Qeverinë e parë të Republikës sonë Popullore.<sup>1</sup> Duke marrë përgjegjësinë e rëndë përpara popullit për plotësimin e detyrave që i ngarkoheshin, qeveria e ka kryer me nder misionin e saj të lartë.

Sot detyra ime është që t'i paraqes Kuvendit të ri Popullor, që përfaqëson vullnetin e të gjithë popullit tonë, dorëheqjen e qeverisë.

Jam i bindur se qeveria i ka kryer me besnikërinë

---

<sup>1</sup> Më 11 Janar 1946, Asambleja Kushtetuese vendosi që Komiteti Antifashist Nacional-Çlirimtar i kryesuar nga shoku Enver Hoxha, zgjedhur në Kongresin e Përmetit dhe që u shndërrua në Qeveri Demokratike të Shqipërisë në Mbledhjen e dytë të KANÇ-it në Berat, të vazhdonte të kryente funksionet si Qeveri e Republikës Popullore të Shqipërisë.

më të madhe dhe me sukses detyrat që i ishin ngarkuar. E udhëhequr nga Partia e Punës, ajo ka punuar për zbatimin e ligjeve të aprovuara nga Kuvendi Popullor. Brenda periudhës që nga fillimi i Legjislaturës së parë e deri tani, pushteti ynë popullor u forcua dhe u bë një armë e shëndoshë në duart e popullit. Ekonomia e vendit tonë është zhvilluar me një ritëm të shpejtë dhe kjo ka bërë që jeta e popullit tonë të përmirësohet nga viti në vit në një shkallë të konsiderueshme. Fabrika, uzina, miniera, kombinat, hidrocentrale, rrugë, porte e hekurudha janë ndërtuar e po ndërtohen në vendin tonë. Bujqësia pas reformës agrare po shkon drejt modernizimit. Në fushat tona po futen metodat e reja agroteknike, tokat po punohen me traktorë dhe nga viti në vit është shtuar sipërfaqja e tokës së mbjellshme dhe numri i maqinave të fuqishme moderne në bujqësi.

Pas reformës arësimore është shtuar jashtëzakonisht rrjeti i shkollave, që po ndiqen, nga viti në vit, në numër më të madh nga bijtë e punëtorëve dhe të fshatarësisë punonjëse. Me qindra të rinj janë dërguar çdo vit në Bashkimin Sovjetik e demokracitë popullore për të ndjekur studimet e larta. Kultura po bëhet e masave në vendin tonë. Janë zhvilluar së tepërmi dhe kanë hyrë në rrugë të drejtë artet, teatri, sportet etj.

Sukseset e mëdha ekonomike e kulturele të vendit tonë gjatë katër vjetëve, kanë ndihmuar që vendi ynë të vihet në rrugën e sigurtë të ndërtimit të bazave të socializmit.

Me politikën e saj të drejtë, të vendosur dhe të urtë, Qeveria e Republikës sonë Popullore ka bërë të dështojnë të gjitha provokacionet e imperialistëve e të

fqinjëve tanë, monarko-fashistëve, titistëve dhe neofashistëve italianë si dhe sulmin e poshtër të monarko-fashistëve grekë në verën e kaluar<sup>1</sup>. Kështu qeveria, me besnikërinë më të madhe, ka mbrojtur lirinë, independencën dhe integritetin tokësor të shtetit tonë.

Qeveria, me politikën e saj të jashtme, ka forcuar gjithnjë më shumë miqësinë dhe bashkëpunimin me Bashkimin e lavdishëm Sovjetik, i cili kurdoherë e mbron dhe e ndihmon popullin tonë me të gjitha forcat. Me ndihmën e tij të vazhdueshme Republika jonë po përparon dhe forcohet pa pushim. Qeveria jonë ka forcuar shumë miqësinë dhe marrëdhënjet me demokracitë motra popullore. Me politikën e saj të drejtë qeveria e ka rreshtuar popullin tonë në kampin e madh të paqes e të demokracisë që udhëhiqet nga Bashkimi Sovjetik dhe Gjeneralisimi Stalin. Populli e qeveria e tij kanë luftuar me vendosmëri dhe kanë demaskuar të gjitha përpjekjet luftëdashëse të imperialistëve amerikanë, anglezë dhe të vasalëve të tyre që duan të dëmtojnë Republikën tonë Popullore dhe të çojnë botën në një gjakderdhje të re. Kështu vendi ynë është bërë një faktor me rëndësi për mbrojtjen e paqes në botë.

Të gjitha këto suksese të mëdha, që kanë ndodhur për herë të parë në historinë e popullit tonë, qeveria ka mundur t'i realizojë vetëm nën udhëheqjen e Partisë së Punës të Shqipërisë dhe me ndihmën e Bashkimit Sovjetik dhe të mikut më të shtrenjtë të popullit tonë, Stalinit të madh.

Kur u ngarkova për drejtimin e qeverisë, u zotova

---

<sup>1</sup> Është fjala për provokacionet e gushtit 1949.

përpara popullit se ne do të kryenim me besnikëri detyrat që na viheshin përpara. Tani ju takon juve, shokë deputetë, të gjykoni veprimtarinë tonë dhe të merrni vendimet e duhura që kërkon sot interesi i atdheut dhe i popullit.

Me rastin e paraqitjes së dorëheqjes së qeverisë kam nderin e madh të falënderoj në emër të shokëve ministra dorëheqës dhe në emrin tim Presidiumin e Kuvendit Popullor të Shqipërisë, gjithë funksionarët e shtetit dhe mbarë popullin tonë për ndihmën e madhe që i kanë dhënë qeverisë në ushtrimin e funksioneve të saj.

Gjithashtu i shfaq falënderimet më të mëdha Partisë së Punës të Shqipërisë dhe Komitetit Qendror të saj për ndihmën e madhe e të vazhdueshme që i ka dhënë qeverisë në zgjidhjen drejt të problemeve të mëdha që na shtronte përpara situata e vendit tonë.

Shokë deputetë, ne betohemi përpara popullit tonë se do të qëndrojmë besnikë deri në fund si ushtarë të pamposhtur për kauzën e tij.

Rroftë populli shqiptar!

Rroftë Partia heroike e Punës dhe Komiteti Qendror i saj!

*Botuar për herë të parë në gazetën «Zëri i Popullit», Nr. 162 (551), 5 korrik 1950*

*Botohet sipas tekstit të gazetës «Zëri i Popullit», Nr. 162 (551), 5 korrik 1950*



# FJALIM PROGRAMATIK NË SESIONIN I TË LEGJISLATURËS SË DYTË TË KUVENDIT POPULLOR

5 korrik 1950

Shokë deputetë,

Detyrën, që m'u ngarkua nga Kuvendi Popullor<sup>1</sup> për të riformuar Qeverinë e re të Republikës Popullore të Shqipërisë, e kreuva. Qeveria e re përbëhet nga shokët më të mirë, bij besnikë të popullit dhe të Republikës Popullore, besnikë të Partisë heroike të Punës, që drejton popullin tonë drejt fateve të lumtura të socializmit dhe të paqes, besnikë të Bashkimit Sovjetik dhe të Stalinit të madh, përkrahësit më të zjarrtë të popullit tonë.

Qeveria e re përbëhet nga bashkëpunëtorë të mi të vjetër të qeverisë dorëheqëse, si dhe nga bashkëpunëtorë të rinj, të cilët kanë dhënë prova zotësie dhe organizimi duke drejtuar sektorë të rëndësishëm të shtetit.

---

<sup>1</sup> Me propozim të një grupi deputetësh dhe me aprovim unanimit të Kuvendit Popullor më 4 korrik 1950 shoku Enver Hoxha u ngarkua të formonte Qeverinë e re të RPSH.

Që të gjithë janë shokë të provuar në luftën e çlirimit dhe në luftën për ndërtimin e bazave të socializmit në vendin tonë, janë shokë të aftë dhe me eksperiencë që do ta kryejnë me nder detyrën e rëndë dhe të shenjtë që na ngarkon populli, Partia dhe Kuvendi Popullor.

Shokë deputetë,

Programi i qeverisë së re do të jetë vazhdimi i pandërprerë i programit të qeverisë së mëparshme dorëheqëse. Qeveria e re do t'i qëndrojë besnike Kushtetutës së Republikës Popullore të Shqipërisë, do ta mbrojtë atë dhe do të zbatojë me përpikmëri të gjitha ligjet. Qeveria e re do të mbrojtë me besnikërinë më të madhe interesat e popullit shqiptar dhe fitoret e tija të shkëlqyera të Luftës nacional-çlirimtare dhe ato të pasçlirimit të Shqipërisë, do t'i çelnikosë ato, do të sigurojë fitore të reja dhe do të bëjë që ndërtimi i bazave të socializmit në vendin tonë të shkojë me hapa të mëdhenj dhe të sigurtë përpara. Qeveria e re e Republikës Popullore do të ketë për detyrë kryesore dhe të shenjtë mbrojtjen e lirisë dhe të pavarësisë së atdheut tonë kundër lakmive grabitqare të imperialistëve amerikanë dhe anglezë e të satelitëve të tyre, tradhëtarëve të Beogradit, monarko-fashistëve të Athinës dhe neofashistëve të Romës. Ajo me politikën e saj paqësore, të urtë, por të vendosur, nuk do të lejojë të cënohen asnjë grimë interesat jetike të popullit e të atdheut dhe do të bëjë të dështojë me siguri çdo orvatje nga ana e armiqve të popullit dhe të vendit tonë.

Qeveria e re e Republikës Popullore të Shqipërisë do të luftojë si kurdoherë me të gjitha forcat e saja për mbrojtjen e paqes në botë që kërcënohet nga nxitësit e luftës imperialistët amerikanë, anglezë dhe satelitët e tyre. Populli shqiptar dëshiron të rrojë i lirë e në paqe dhe nuk dëshiron kurrë të përsëriten tmerret e luftërave të para, që i shkaktuan njerëzimit dhe popullit tonë shkatërrime dhe mjerime të panumërta. Populli ynë është kundër luftërave grabitqare, prandaj ai dhe qeveria e tij janë të vendosur me të gjitha forcat e tyre të luftojnë për të mbrojtur paqen.

Populli shqiptar ushqen një dashuri të pakufishme për Bashkimin Sovjetik dhe Stalinin e madh, sepse me ndihmën e tyre ai u çlirua përgjithmonë nga skllavëria e rëndë shekullore, u çlirua nga kthetrat e fashizmit italo-gjerman, nga ato të trockistëve të Beogradit dhe nga të gjitha intrigat dhe kërcënimet e imperialistëve amerikanë dhe anglezë dhe të satelitëve të tyre të çdo kallëpi. Shqipëria po përparon me hapa të mëdhenj dhe të sigurtë. Në vendin tonë po ndërtohen me sukses bazat e socializmit dhe këto suksese të mëdha dhe historike populli ynë ja detyron në radhë të parë udhëheqjes së drejtë të Partisë së tij të Punës dhe ndihmës bujare të Bashkimit Sovjetik e kujdesit të shokut Stalin, që e ndihmojnë Shqipërinë të lulëzojë e të bëhet një vend i begatshëm. Qeveria e Republikës Popullore do ta ruajë si sytë e ballit këtë dashuri dhe miqësi kaq të ngushtë që lidh popullin tonë me popujt e Bashkimit Sovjetik dhe do të vërë të gjitha forcat e saja që kjo miqësi të çelënikoset dita-ditës dhe të zërë rrënjë të thella në zemrën e çdo shqiptari. Qeveria jonë do të punojë fuqimisht

që nga eksperiencia e Bashkimit Sovjetik të përfitojë sa më shumë populli ynë, që ky të edukohet, të frymëzohet e të udhëhiqet nga shembulli i Bashkimit Sovjetik dhe nga mësimet e të madhit Stalin.

Qeveria e Republikës Popullore do ta ruajë dhe do ta forcojë miqësinë e ngushtë që e lidh popullin tonë me vendet e demokracive popullore motra, të cilat po e ndihmojnë popullin shqiptar në ndërtimin e bazave të socializmit në vendin tonë. Qeveria jonë në përputhje me ndjenjat e popullit tonë përparimtar dhe paqedashës nga ku merr fuqi dhe jetë, është përkrah gjithë popujve që luftojnë heroikisht për t'u çliruar nga thonjtë e imperialistëve gjakpirës amerikanë, anglezë, francezë dhe kukullave të tyre që janë xhelatë popujsh dhe shërbëtorë të imperialistëve. Populli shqiptar e ndjen veten solidar me përpjekjet heroike të popujve të Evropës Perëndimore, që vuajnë nën planin skllavërues Marshall dhe që luftojnë për çlirimin e tyre, me popujt heroikë të Jugosllavisë dhe të Greqisë që luftojnë për të zhdukur klikat tradhëtare të Titos dhe të monarko-fashistëve, që sundojnë me terror duke u vënë në shërbim të imperializmit, me popujt e Azisë që luftojnë për t'u çliruar nga kolonizatorët gjakpirës imperialistë. Populli shqiptar është thellësisht i indinjuar dhe proteston energjikisht për sulmin barbar të imperialistëve amerikanë kundër Republikës Demokratike Popullore të Koresë<sup>1</sup>.

---

<sup>1</sup> Më 25 qershor 1950 forcat ushtarake këmbësore, detare dhe ajrore të SHBA-së në bashkëpunim me klikën e Sin Man Risë shpërthyen një agresion të hapur e në shkallë të gjerë kundër RDP të Koresë.

Populli shqiptar është me gjithë zemër me popullin vëlla heroik të Koresë, që përballoi me sukses sulmin tradhëtar të kukullave të imperialistëve amerikanë dhe agresionin e hapët amerikan dhe që po marshon përpara në fitore për unifikimin e atdheut të tij dhe për çlirimin e plotë të Koresë nga thonjtë e imperializmit amerikan. Populli shqiptar kërkon ndalimin e agresionit dhe tërheqjen e menjëhershme të trupave amerikane nga Korea. Populli heroik i Koresë do të fitojë, pse drejtësia është nga ana e tij dhe gjithë popujt përparimtarë të botës janë me të, janë për kauzën e tij të shenjtë.

Imperialistët luftëdashës amerikanë, anglezë e të tjerë dhe kukullat e tyre të Beogradit, të Athinës dhe të Romës, vazhdimisht po përpiqen të dëmtojnë Republikën tonë Popullore. Ata kurdišin plane dhe komplete, ata organizojnë banda spiunësh dhe sabotatorësh për të krijuar situata të favorshme për ta në Shqipëri me qëllim që të rrëzojnë pushtetin popullor dhe të sjellin në fuqi kriminelët e luftës, që mbahen, ushqehen dhe përgatiten në Romë, në Beograd e në Athinë. Por të gjitha tentativat e tyre kanë dështuar me turp dhe do të dështojnë me siguri dhe në të ardhshmen. Populli shqiptar, i bashkuar si një trup rreth Partisë dhe qeverisë së tij, do t'i dërmojë pa mëshirë të gjithë ata armiq të brendshëm dhe të jashtëm që guxojnë të hidhen me parashuta ose të hyjnë nga kufiri jugosllav dhe grek për të dëmtuar punën përparimtare dhe paqësore në vendin tonë. Armiqtë e vendit tonë, qoftë të jashtëm, qoftë të brendshëm, gabohen në llogaritë e tyre ndaj Shqipërisë. Ata kujtojnë se mund të mposhtet lehtë populli ynë, që me shekuj ka luftuar për ta fituar këtë

ditë që gëzon sot. Por realiteti është i hidhur për ta. Populli shqiptar, është i vogël në numër, por ai ka miq të lavdishëm që e duan dhe e ndihmojnë me gjithë zemër. Ai e ka çelnikosur unitetin e tij, gjë që e provoi edhe një herë më 28 maj 1950<sup>1</sup>. Populli shqiptar e ruan me vigjilencë të madhe lirinë, pavarësinë dhe integritetin tokësor. Populli shqiptar, as nuk u trembet armiqve dhe as nuk fle mbi dafina, por qëndron në këmbë zgjuar, vigjilent dhe i gatshëm për të goditur çdo orvatje të tyre. Populli shqiptar është i ndërgjegjshëm për rrezikun që kërcënon paqen nga ana e imperialistëve amerikanë etj., prandaj ai lufton me të gjitha forcat për të mbrojtur fitoret, duke forcuar ekonominë e tij socialiste dhe fuqinë mbrojtëse të vendit, duke nënshkruar apelin e Stokholmit, duke demaskuar rrënjësisht në popull fytyrën e egër dhe gjakatare të imperialistëve amerikanë dhe anglezë dhe duke çelnikosur çdo ditë e më tepër dashurinë dhe miqësinë me Bashkimin Sovjetik dhe demokracitë popullore motra. Populli shqiptar i ka njohur fashistët dhe imperialistët italianë që kurdoherë kanë dashur të robëronin popullin tonë. Dy herë në një periudhë të shkurtër i ka hedhur në det dhe ka dalë fitimtar. Fashistët e rinj të Romës, as që kanë mësuar nga pësimi dhe, as që e kanë harruar zakonin. Ata po kurdisin plane kundër vendit tonë. Por 7 prilli s'përsëritet më. Të gjitha orvatjet e tyre do të dështojnë.

Populli shqiptar i njeh mirë tradhëtarët e Beogra-

---

<sup>1</sup> Në zgjedhjet e 28 majit 1950 për deputetët e Kuvendit Popullor muarën pjesë 99,4 për qind e zgjedhësve, 93,13 për qind e të cilëve votuan për kandidatët e Frontit.

dit me Titon në krye. Ata egërsisht sulmojnë popullin tonë haptas dhe nën rrogoz. Ata bëjnë provokime të panumërta në kufitë tanë të Veriut, ata përpiqen pa sukses të dërgojnë në vendin tonë diversantë dhe sabotatorë, ata grumbullojnë kriminelët shqiptarë të luftës dhe i organizojnë kundër vendit tonë, ata janë në bashkëpunim të ngushtë me monarko-fashistët grekë për krijimin e boshtit Beograd-Athinë<sup>1</sup> me qëllim që të dëmtojnë Republikën tonë Popullore dhe të copëtojnë Shqipërinë në mes të tyre. Tradhëtarët titistë, shërbëtorë të amerikanëve, atë zanat kanë. Ata u ranë pas shpine popullit dhe partizanëve heroikë grekë<sup>2</sup> që luftonin për liri, ata kërkojnë gjithashtu t'i bëjnë varrin popullit tonë. Por ata do të dështojnë në të gjitha përpjekjet e tyre. Populli shqiptar me të gjitha forcat e tija do të godasë pa mëshirë veprat armiqësore të titistëve dhe të agjentëve të tyre dhe do t'ua shkatërrojë planet e tyre si monarko-fashistëve grekë ashtu edhe neofashistëve të Romës. Qeveria e Republikës Popullore do të jetë kurdoherë vigjilente kundër këtyre armiqve të egër dhe të poshtër të vendit tonë dhe do të dërmojë çdo orvatje të tyre dhe të agjentëve të tyre. Politika e Partisë dhe e qeverisë do të jetë e tillë që armiqtë e brendshëm dhe të jashtëm të popullit tonë të mos

---

<sup>1</sup> Është fjala për përgatitjet që po bëheshin nga Greqia, Turqia dhe Jugosllavia për krijimin e të ashtuquajturit «Pakt i Ballkanit», i cili u nënshkrua në shkurt 1953 dhe u plotësua me traktatin e Bledit (Jugosllavi), në gusht 1954.

<sup>2</sup> Në verën e vitit 1949 revizionistët jugosllavë lejuan ushtrinë monarko-fashiste greke të përdorte territorin jugosllav për të goditur pas shpine partizanët grekë.

gjejnë vend ku të futen në Shqipëri. Dita-ditës e më shumë do të rritet e do të forcohet vigjilenca, më e ashpër do të bëhet lufta kundër armikut të klasës, armiqve të popullit shqiptar dhe kundër banditëve, që do të guxojnë të vënë këmbët në Shqipëri të ardhur si minj nga kufiri jugosllav e grek, ose të hedhur me parashutë nga aeroplanë italianë; dy rrugë u mbeten: o të dorëzohen o të shfarosen. Ky është fati që i pret armiqtë e vendit tonë.

Politika e qeverisë në lëmin ekonomik, kultural dhe shoqëror do të ecë me vendosmëri përpara në rrugën e ndritur të socializmit që i ka caktuar popullit tonë udhëheqja e saj e lavdishme, Partia e Punës. Qeveria do të vërë të gjitha forcat për realizimin e planit dyvjeçar të shtetit, që përfaqëson një sukses të konsiderueshëm për vendin tonë dhe që do të jetë bazë e një plani të ardhshëm edhe më të madh. Aktualisht në vendin tonë janë duke u zhvilluar punime të mëdha në industri, në miniera, në bujqësi e gjetkë. Punimet po ecin me një ritëm të shpejtë në ndërtimin e Kombinatit të madh të tekstileve «Stalin», në Kombinatin e madh të sheqerit në Maliq, në Hidrocentralin e Selitës, në ndërtimin e Hekurudhës Peqin—Elbasan, në vepra për kanalizime tokash, në tharjen e kënetës së Maliqit, në asfaltime dhe ndërtime rrugësh të reja, në ndërtime shkollash dhe pallatesh për punonjësit etj. Të gjitha këto vepra monumentale për vendin tonë, që u realizuan edhe në saje të ndihmës së Bashkimit Sovjetik dhe të demokracive popullore motra, së shpejti do të japin frutet e tyre. Të gjitha maqinceritë e fuqishme dhe moderne që përbëjnë kombinatet dhe fabrikat tona



të reja, janë gati në Bashkimin Sovjetik, ku kanë shkuar dhe do të shkojnë me qindra djem dhe vajza të popullit për të përvetësuar teknikën moderne sovjetike dhe për ta vënë atë në shërbim të popullit të tyre. Fabrika të tjera të reja janë në plan të ngrihen, të cilat do të fuqizojnë industrinë dhe do të prodhohen në vend me shumicë sende të nevojshme për popullin tonë. Industria jonë, pra, po zgjerohet dhe fuqizohet nga viti në vit dhe në të gjitha drejtimet. Kësaj industrie do t'i shtohet gjithashtu industria ushqimore me shumë rëndësi për vendin tonë, ku janë të gjitha mundësitë për suksese, meqë vendi ynë është një vend bujqësor, me blegtori, me frutikulturë të shumëllojshme dhe ku ekziston një pasuri e madhe, por akoma e pashfrytëzuar, siç është peshku i detit dhe i lumenjve etj. Për të gjitha këto mundësi të mëdha, në programin e qeverisë, janë parashikuar të krijohen sektorë të rinj prodhimi, të ndërtohen fabrika të reja, punishte të shumta, në mënyrë që populli ynë të ketë më shumë veshmbathje, ushqime. Ky zhvillim tregon hovin e madh që ka marrë në vendin tonë ekonomia socialiste dhe superioritetin e sistemit socialist mbi atë kapitalist. E mjerueshme ka qenë industria dhe çdo gjë në vendin tonë në të kaluarën e errët. Me marrjen e pushtetit në duart e popullit, ndryshoi faqja e Shqipërisë dhe ditë më të lumtura e presin popullin tonë. Minierat tona, jo vetëm që u rindërtuan dhe japin rendimentin e plotë, por perspektiva për zhvillimin e tyre është e madhe. Si çdo sektor tjetër edhe sektori i minierave është bërë një pasuri e paçmueshme për popullin tonë. Ndhma teknike dhe mundësitë që na ka krijuar Bashkimi Sovjetik për të

dërguar në universitetet sovjetike bij të popullit për të dalë inxhinierë dhe specialistë, janë një përkrahje e konsiderueshme për popullin tonë. Këta djem e vajza të popullit tonë të pajisur me shkencën e pararojës, kanë filluar të kthehen në atdhe; të tjerë do të kthehen në vitet e ardhshme dhe me qindra të tjerë do të dërgohen atje dhe në demokracitë popullore. Kurrë vendi ynë nuk ka parë një numër të tillë të madh njerëzish të mësuar, bij të popullit, që shkojnë e mbarojnë me sukses mësimet që të vënë në shërbim të popullit të tyre shkencën dhe teknikën. Sektori i minierave tona në të ardhshmen do të zgjerohet e do të modernizohet. Mundësitë e mëdha që na paraqiten në këtë sektor të rëndësishëm do të shkaktojnë zhvillimin e mëtejshëm të ndërtimit të hekurudhave të reja, të qendrave punëtore të rëndësishme, të ndërtimit të sa më shumë banesave për punëtorët, të shkollave, klubeve, kinemave, teatrove dhe shtëpive të kulturës. Politika e Partisë dhe e qeverisë në këtë sektor, në një të ardhshme të afërt dhe të sigurtë do të jetë: sa më shumë naftë, bakër, qymyr, krom dhe të tjera minerale të vlefshme. Kjo do të pasurojë popullin tonë, do të sjellë me siguri matematike bollëk më të madh dhe begati.

Në sektorin e bujqësisë, të pyjeve dhe të blegtorisë, qeveria do të shtojë përpjekjet që këta sektorë të rëndësishëm të zhvillohen sa më shumë, të hapen sa më shumë toka të reja buke, të zgjerohet rrjeti i kanalizimeve, të mbillen sa më shumë bimë industriale dhe në radhë të parë pambuk dhe panxhar sheqeri, të futen në bujqësi metodat e reja agroteknike, të punohen sa më shumë toka me traktorë, të përdoren sa më shumë

mjete të tjera moderne në bujqësi, të forcohen dhe të zhvillohen kooperativat bujqësore dhe të përdoren edhe format e tjera kooperativiste, në baza kurdoherë vullnetare, të seleksionohen farërat, të përdoret nga ana e bujqve në shkallë të gjerë krediti agrar për të përmirësuar bujqësinë dhe mjetet e punës, të shtohet dhe të përmirësohet blegtoria, të ruhet dhe të pyllëzohet me plan dhe në shkallë të gjerë vendi ynë.

Në lëmin e arësimit dhe të kulturës, qeveria do të vërë të gjitha mjetet dhe përpjekjet e saja që arësimi të marrë një hov kurdoherë më të madh duke përmirësuar cilësinë e duke e zgjeruar edhe më shumë rrjetin e shkollave të çdo kategorie. Një politikë e njëjlojtë do të ndiqet nga qeveria në lëmin e kulturës, të arësimit, muzikës, teatrit, kinemasë, sportit etj. Do të shtohet numri dhe do të ngrihet niveli i pedagogëve, do të zgjerohet rrjeti i bibliotekave, do të shtohet numri i nxënësve në të gjitha degët e artit. Janë dërguar e do të dërgohen nxënës në Bashkimin Sovjetik për të mësuar në këto degë të rëndësishme. Shteti do të përkrahë zhvillimin e teatrit kombëtar, do të ngrejë një studio për prodhim filmash<sup>1</sup>, do të shtohen dhe do të përmirësohen shtëpitë dhe klubet e kulturës etj.

Qeveria do të zgjerojë dhe do të përmirësojë tregëtinë dhe rrjetin e saj, do të përkrahë zhvillimin e drejtë të kooperativave të çdo lloji, në mënyrë që populli të furnizohet sa më shumë dhe me kualitet sa më të mirë me sende që i nevojiten atij. Qeveria do të lejojë

---

<sup>1</sup> Është fjala për Kinostudion «Shqipëria e re».

inisiativën private në tregëtinë e vogël, por kurdoherë ajo do t'i nënshtrohet kontrollit shtetëror për të mos lejuar abuzimet dhe spekulimet në kurriz të popullit nga ana e matrapazëve dhe njerëzve të tjerë të pandërgjegjshëm.

Veçanërisht për punëtorët dhe të gjithë punonjësit, qeveria do të kujdeset për jetën e tyre materiale dhe kulturele. Klasa jonë punëtoje, me heroizëm të pasqorë i është përveshur punës dhe po realizon me sukses planin e shtetit. Shteti dhe qeveria do të kujdesen veçanërisht për përmirësimin sa më të madh të jetesës së tyre, duke ngritur shtëpi të reja banimi për ta, vende dëfrimi dhe pushimi, kurse të ndryshme ku punëtorët të perfeksionohen në zanatet e tyre, klube, biblioteka etj. Duke zbatuar politikën e drejtë të Partisë sonë, qeveria do të bëjë të gjitha përpjekjet që dita-ditës dhe konkretisht të çelnikoset aleanca në mes të klasës punëtoje dhe fshatarësisë punonjëse.

Qeveria do të vërë të gjitha forcat për të forcuar dhe modernizuar aparatën e shtetit, do të luftojë burokratizmin, javashllëkun në njerëzit, do të godasë pa mëshirë njerëzit e ligj, parazitët, dembelët, të pandërgjegjshmit në kryerjen e detyrave, spekulatorët dhe abuzuesit e çdo lloji që futen kontrabandë në aparatën e shtetit. Qeveria do të forcojë kontrollin e shtetit.

Qeveria do t'i kushtojë një kujdes të veçantë forcimit dhe modernizimit të Ushtrisë sonë Popullore dhe do ta edukojë atë si kurdoherë me artin e lavdishëm ushtarak stalinian. Ushtria, pjella më e dashur e popullit tonë, do të jetë si kurdoherë garancia e fitoreve të popullit tonë, garancia e pavarësisë dhe e lirisë së

atdheut, garancia e paqes dhe kurdoherë e gatshme dhe vigjilente.

Qeveria jonë, nën drejtimin e Partisë sonë heroike të Punës dhe të Komitetit Qendror të saj, duke ndjekur dhe zbatuar me besnikërinë më të madhe Kushtetutën e Republikës Popullore dhe ligjet e Kuvendit Popullor, duke u ndihmuar dhe duke u kontrolluar vazhdimisht nga i gjithë populli, nga deputetët e tij dhe nga Kuvendi Popullor, ju premtan se do të kryejë me nder detyrën e rëndë dhe të lartë që po i ngarkoni. Qeveria jonë e re për të cilën kam nderin të kërkoj votëbesimin e Kuvendit, do t'i kapërcejë të gjitha pengesat që do t'i dalin përpara, do ta drejtojë shtetin tonë në rrugën e ndritur të socializmit dhe duke jetuar e duke punuar e rrethuar nga një dashuri e madhe e popullit tonë, ajo do të vërë të gjitha forcat e saja që vendi ynë të përparojë, që jeta e popullit, e cila është përmirësuar në një shkallë të konsiderueshme, të përmirësohet ditë-ditës e më shumë. Qeveria jonë do t'i qëndrojë besnike e patundur popullit tonë heroik, çështjes së tij të shenj-të dhe Partisë së tij heroike të Punës.

Rroftë populli shqiptar dhe udhëheqësja e tij, Partia e Punës e Shqipërisë!

*Botuar për herë të parë në gazetën «Zëri i Popullit», Nr. 163 (552), 6 korrik 1950*

*Botohet sipas origjinalit që gjendet në Arkivin qendror të Partisë*

## MBI PROJEKTPLANIN E VITIT 1951

*Diskutim në mbledhjen e përbashkët të Byrosë  
Politike të KQ të PPSH dhe të Qeverisë së RPSH*

**19 korrik 1950**

Në rendin e ditës të kësaj mbledhjeje të përbashkët të Byrosë Politike dhe të qeverisë kemi shqyrtimin e planit të vitit të ardhshëm.

Projektplanin për vitin 1951, që është paraqitur për shqyrtim bazohet në mundësitë tona reale, në kreditë që na kanë dhënë BRSS, në radhë të parë, e vendet e demokracisë popullore, si dhe në kërkesat që do t'i paraqesim Këshillit Ekonomik.<sup>1</sup> Unë mendoj që kërkesat për kredi që do të bëjmë për të plotësuar këtë projektplan, janë mjaft të mëdha dhe do të na duhet t'i lëmë

---

<sup>1</sup> Këshilli i Ndhmës Ekonomike Reciproke u krijua më 1949 nga BS dhe vendet e demokracisë popullore për të organizuar shkëmbimin e eksperiencës ekonomike, ndihmën reciproke teknike, koordinimin e zhvillimit të degëve të ekonomisë të vendeve pjesëmarrëse mbi bazën e ndarjes racionale të punës. Mirëpo klika revizioniste sovjetike e ktheu këtë në vegël të saj për shfrytëzim, presion, ndërhyrje e agresion ndaj popujve të këtyre vendeve.

të gjitha shtesat e tjera për kredi që u propozuan këtu nga diskutantët.

Del e nevojshme që për planin e vitit 1951, të orientohen mirë dikasteret për të mos bërë shtesa, përkundrazi të bëjnë zvogëlime. Pra, të mos nisemi në asnjë mënyrë nga parimi i shtimit të kredive, por të shihet mundësia për t'i ulur ato.

Unë mendoj se të gjitha kërkesat që u bënë nga shokët në diskutimet e tyre janë të drejta dhe të nevojshme, veçse në vitin 1951 ne nuk mund t'i planifikojmë të gjitha sa u propozuan. Përpara kemi planin pesëvjeçar, për të cilin do të na duhen kredi të tjera. Prandaj në këtë vit na duhet të bëjmë përpjekje për ekonomizime duke bërë shkurtime me vend.

Çështja e parë për ne, siç u tha dhe këtu, është ajo e rritjes së eksportit, domethënë në këtë sektor duhet të realizojmë planin në maksimum. Shifrat e eksportit që janë vënë në projekt, duhet të shihen edhe një herë me qëllim që të shtohen. Pra, detyra është të realizojmë planin e eksportit në disa shifra më të larta dhe jo sipas dëshirës, po të studjuara dhe me kurajë. Por, ka disa sektorë që do ta kenë zor ta realizojnë planin dhe aq më pak ta tejkalojnë. Kemi për shembull transportin. Këtu nuk duhet të lëvizim asgjë, pse pa këto mjete nuk mund të realizohet plani. Shkurtime mund të bëjmë në planin e sektorit të bujqësisë. Nuk duhet të lejojmë në asnjë mënyrë që materialet që importojmë të mos vihen menjëherë në shfrytëzim siç po ndodh me maqineritë e centraleve elektrike, të cilat qëndrojnë në port të pashfrytëzuara. Kështu mund të ketë edhe materiale të tjera, prandaj të merren masa që këto të vihen menjë-

herë në përdorim se kështu do të kemi përfitime të mëdha dhe do të shkurtohet plani i importit. Në këtë drejtim duhet një organizim dhe kontroll më i fortë. Një problem tjetër është ulja e kostos së prodhimit; për këtë kërkohen më shumë përpjekje, pse jo vetëm që financat tona kanë nevojë të rritin të ardhurat e tyre, po edhe populli do të shohë vazhdimisht si përmirësohen konditat e jetës së tij.

Situata jonë, në krahasim me vendet e tjera, ka qenë e vështirë sepse ndërsa ato kanë trashëguar pasuri të mëdha, vendit tonë edhe atë pak industri që kishte para çlirimit, ja shkatërroi lufta. Por ne duhet t'i arrijmë ato dhe për këtë duhet të bëjmë përpjekje më shumë, të organizojmë më mirë punën dhe të kursejmë më tepër. Megjithëse janë bërë disa përparime në lidhje me përmirësimin e cilësisë së prodhimit, akoma kjo çështje nuk po shihet si duhet. Njerëzit tanë drejtues shohin vetëm realizimin e planit si sasi dhe mbyllin sytë përpara cilësisë, kostos dhe treguesve të tjerë tekniko-ekonomikë. Pra edhe për këtë problem duhet një punë më e madhe.

Lidhur me ndërtimet në sektorin e arësimit, mua më duket se ne mund të bëjmë edhe më pak. Ka mundësi që nxënësit të mësojnë edhe ca kohë në shkollat ekzistuese. Pas çlirimit ne kemi ndërtuar mjaft shkolla të reja. Shkollat e mëdha duhet të shfrytëzohen në maksimum me qëllim që tani për tani të mos bëjmë shumë ndërtime në këtë sektor. Gjithashtu duhet të punohet më tepër nga mësuesit dhe nxënësit që t'i mirëmbajnë shkollat ekzistuese dhe të ruhet më shumë pas-tërtia në to.



Po kështu edhe për depo ne jemi në pamundësi të bëjmë shumë, prandaj duhen mbajtur mirë dhe riparuar ato që kemi. Kështu mund të themi edhe për çështje të tjera të kësaj natyre.

Nuk duhet të shkojmë sipas dëshirës, po të bëjmë ato që kemi mundësi dhe që janë shumë të nevojshme, në qoftë se duam të ngremë ekonominë dhe të ecim me plan. Pra, ne duhet të bëjmë një plan që të realizohet me luftë të pandërprerë dhe me një mobilizim total të të gjitha forcave tona. Të kemi parasysh si ja kanë dalë në krye bolshevikët që kishin nga të katër anët armiq dhe arritën të realizojnë gjithë ato suksese që dimë, jo ne që kemi ndihmën dhe eksperiencën e tyre. Kërkesat tona të jenë të matura dhe në bazë të kushteve tona. Është mirë të rregullojmë gjithë qytetet me kanalizime, por unë mendoj se për këto do të duhen disa vite. Prandaj t'i shohim më realisht dhe më konkretisht çështjet.

Është e vërtetë se kemi për të bërë shumë për zbulimin e pastrimin e Tiranës dhe mund të arrijmë që brenda dhjetë ditëve qyteti i Tiranës të jetë më i pastërti, po një gjë e tillë nuk bëhet, sepse ka mungesë organizimi dhe drejtimi. Në këto çështje duhet një mobilizim i madh i gjithë Partisë, i punëtorëve dhe i nëpunësve, jo një mobilizim formal, por konkret. Veç kësaj është e domosdoshme të synohet që të gjitha gjërat të ecin paralel dhe, siç kërkohet zbatimi i Kodit të punës në mënyrë rigoroze, ashtu të kërkohet që edhe vetë punëtori t'i kryejë detyrat e tija në mënyrë rigoroze. Këto, duhet të ecin të dyja krahas njëra-tjetrës.

Ne do të bëjmë përpjekje që të na akordohen ato

që na nevojiten, po kjo nuk është e lehtë, megjithatë vështirësitë medoemos duhet t'i kapërcejmë. Përparime në çdo sektor kemi, përpjekje ka kudo, po duhet bërë akoma më shumë.

*Botohet për herë të parë sipas  
tekstit të nxjerrë nga proces-  
verbali i mbledhjes së përba-  
shkët të Byrosë Politike të KQ  
të PPSH dhe të Qeverisë së  
RPSH që gjendet në AQP*

**PËRGJEGJE LETRËS SË SHOKUT VËLLKO  
ÇERVENKOV NË LIDHJE ME KËRKESËN PËR  
DËRGIMIN E NJË ARTIKULLI MBI  
'GJERGJ DIMITROVIN**

21 korrik 1950

I dashur shoku Çervenkov,

Sot mora letrën tuaj të datës 31 maj 1950, me anën e së cilës më kërkoni një artikull për shokun tonë të dashur. Dimitrov. Letra juaj e dhjetorit 1949 që më kishte drejtuar po për këtë qëllim, nuk më ka rënë fare në dorë. Jam duke hetuar këtë vonesë nga ana e njerëzve tanë që i muarën në dorëzim letrat tuaja për të m'i dorëzuar mua.

Jam shumë i hidhëruar për këtë vonesë, pse ishte një nder dhe një detyrë për mua të shkruaja për shokun Dimitrov, për dashurinë, mallin dhe admirimin që ka populli ynë dhe veçanërisht unë, për mësuesin tonë dhe mikun e shtrenjtë të Shqipërisë, Gjergj Dimitrovin. Kam frikë se do të jetë vonë për botimin që keni vendosur<sup>1</sup>, por ju premtoj se unë do ta shkruaj atë artikull.

---

<sup>1</sup> Në letrën drejtuar shokut Enver Hoxha thuhej se KQ i

do t'jua dërgoj dhe do t'ju jem mirënjohës ta botoni kur dhe ku ta shihni vetë të arësyeshme.

Më falni, shoku Çervenkov, për këtë vonesë që ngjau. Ju përshëndes përzemërsisht.

*Enver Hoxha*

*Botohet për herë të parë sipas  
origjinalit që gjendet  
në Arkivin Qendror  
të Partisë*

---

PK Bullgare kishte vendosur të botonte një vëllim me artikuj, kujtime e shënime mbi Gjergj Dimitrovin, të shkruar nga shokë e bashkëpunëtorë të tij. Ky libër u botua më 1952 me titull «Gjergj Dimitrovi — personalitet i shquar i lëvizjes punëtore ndërkombëtare».

## GJERGJ DIMITROVI DHE MIQËSIA E PËRJETSHME NË MES POPËLLIT SHQIPTAR DHE BULLGAR <sup>1</sup>

[Korrik 1950]

Një miqësi e ngushtë, shumë e lashtë e tradicionale e lidh popullin shqiptar dhe bullgar. Që të dy këta popuj kanë pasur të njëjtin fat. Kanë vuajtur dhe kanë luftuar së bashku, shekuj me radhë, për lirinë dhe pavarësinë e tyre. Të njëjtët armiq: Perandoria Osmane, Patrikana Greke, klikat monarkiste greko-serbo-bullgaromadhe, janë përpjekur me çdo mjet dhe në çdo kohë t'u hidhnin popujve tanë pranga robërie të përjetshme, por s'kanë mundur t'ja arrinin qëllimit. Imperialistët anglezë, amerikanë, gjermanë, austro-hungarezë, italianë, kanë luajtur vazhdimisht me fatin e të dy popujve tanë. Ata i kanë pasë konsideruar këta si monedhë shkëmbimi dhe tregëtie për qëllimet e tyre grabitqare, por kanë hasur në rezistencën heroike të popujve tanë dhe malet tona, shekuj me radhë janë bërë kala të pamposhtura të lirisë dhe të pavarësisë. Popujt tanë kanë njohur fitore dhe disfata në luftën kundër im-

---

<sup>1</sup> Ky artikull i është dërguar KQ të PK Bullgare, sipas kërkesës së tij, i cili e botoi në librin «Gjergj Dimitrovi — personalitet i shquar i lëvizjes punëtore ndërkombëtare». Sofje, 1952.

perialistëve të ndryshëm, feudalëve gjakpirës vendës, mbretërve gjakatarë dhe politikanëve vendës të shitur te të huajt, por kurrë populli shqiptar dhe bullgar s'janë përkulur dhe më në fund fitorja ka qenë e popujve tanë heroikë.

Të dy popujt tanë kanë pasur mik dhe përkrahës të tyre, krahas popujve të tjerë edhe popullin e madh rus, i cili i ka ndihmuar gjatë historisë së tyre të lashtë, në luftën për çlirimin e tyre kombëtar. Së bashku me ushtarët rusë kanë luftuar bullgarët dhe shqiptarët kundër Turqisë së osmanllinjve, në tokë e në dete dhe arritën disa fitore, që sollën një farë përmirësimi në trajtimin e popujve tanë të robëruar nën zgjedhën e rëndë të halldupëve të Anadollit.

Në dokumentat e vjetër, ne gjejmë se që në shekujt IX-X tokat e Shqipërisë, të Bullgarisë dhe të Maqedonisë qenë përfshirë nga të njëjtat ngjarje të mëdha me karakter ekonomiko-shoqëror dhe politiko-kultural.

Popujt e vendeve tona luftuan së bashku në fillim të shekullit XI kundër zgjedhës shtypëse të Perandorisë Bizantine dhe kundër shfrytëzimit të saj të rëndë. Përpjekjet e fundit dhe më të ashpra të kësaj lufte u zhvilluan në tokat e Shqipërisë në krahinat e Beratit e të Tomorricës.

Që nga shekulli IX në tokat e Shqipërisë u shtri edhe veprimtaria e figurave të shquara të kulturës e të letërsisë së lashtë bullgare, me në krye nxënësin e Cirilit e të Metodit, Klementin e Ohrit, që gjetën fusha veprimi dhe në qytetet Devoll e Gllavenicë<sup>1</sup>.

<sup>1</sup> Ballshi I sotëm.

Përmendja e «tokës shqiptare» në mbishkrime e dokumenta bullgarë të shekujve XIII—XV, tregon se marrëdhënjet midis dy vendeve tona nuk u kufizuan vetëm në një periudhë të ngushtë e me karakter politiko-ushtarak, por atë kishin edhe lidhje tregëtare e kulturalë. Këto lidhje u zhvilluan veçanërisht në periudhën e luftës së madhe të popujve ballkanas kundër pushtimit osman. Shqiptarët së bashku me popujt e tjerë të Ballkanit u dolën përpara osmanllinjve më 1371 në brigjet e lumit Marica.

Lidhjet u dendësuan në epokën e luftës së popullit shqiptar të udhëhequr nga Skënderbeu, si edhe të kryengritjeve kundër regjimit të egër të sulltanëve. Shqiptarë, bullgarë e përfaqësues të kombësive të tjera ballkanike i gjejmë në fund të shekullit XVI dhe në fillim të shekullit XVII të bashkuar në kuvendet e organizuara për çlirimin e tyre. Luftëtarë të Shqipërisë, të Bullgarisë e të Maqedonisë marrin pjesë në një ushtri kryengritëse prej 10 000 vetësh, në krye të së cilës u vu një kryepeshkop i Ohrit, në juridiksionin e të cilit hynte Shqipëria dhe Bullgaria. Në shekullin XVII, shqiptarë nga krahina të ndryshme u shpërngulën në Bullgari e prej këtej më vonë, për t'u shpëtuar ndjekjeve të osmanllinjve, bashkë me bullgarë, kaluan për në Rusi.

Më 1876, kur në vende të ndryshme të Ballkanit zihen kryengritjet dhe populli bullgar ishte ngritur në luftë për t'u çliruar nga Turqia, Kristo Botevi, poeti i madh revolucionar bullgar, fliste edhe për kryengritjet shqiptare kundër turqve si një faktor për të arritur çlirimin e popujve ballkanas. Patriotët e Rilindjes shqiptare në luftë kundër turqve për çlirimin e Shqipërisë,

kanë gjetur strehë në gjirin e popullit bullgar dhe janë ndihmuar e përkrahur vazhdimisht nga revolucionarët bullgarë. Kur ishim të vegjël në bankat e shkollës ne këndonim këngën popullore:

«Që më një të kollozhekut,  
Ç'u formua Shoqëria<sup>1</sup>  
Ç'u formua brenda mu në Sofje,  
Për çlirimin e Shqipërisë».

.....

Që këtej, shoqëria patriotike shqiptare me emrin «Dëshira», dërgonte në Shqipëri, në mënyrë ilegale libra, gazeta, abetare për të zgjuar dhe mësuar popullin tonë e për ta nxitur atë në kryengritje kundër Turqisë. Në luftërat ballkanike, ne gjejmë bashkëpunimin e ngushtë në mes çetave shqiptare, bullgare dhe maqedonase që luftojnë së bashku kundër turqve dhe grekëve të megaliidhesë. Këto çeta çlirimtarësh, luftonin njëkohësisht edhe kundër imperialistëve anglezë, francezë, gjermanë, austriakë, serbomëdhenj që kërkonin të pushtonin vendet tona, të shqelmonin të drejtat e popujve shqiptar e bullgar dhe t'i skllavëronin e t'i gjakosnin këta dy popuj.

Populli shqiptar, në këngët e vjershat e tija, këndon me dashuri për miqësinë e lashtë dhe tradicionale në mes të tij dhe popullit bullgar. Populli shqiptar tërë jetën ka pasur një dashuri dhe një admirim për popu-

---

<sup>1</sup> Më 1890, shqiptarët e mërguar në Bullgari themeluan në Sofje shoqërinë patriotike «Dëshira», e cila vazhdoi rrugën e shoqërisë së Stambollit.



llin bullgar, pse ai është një popull trim dhe shqiptari i do shumë trimat që luftojnë për liri. Populli shqiptar e çmon popullin bullgar ashtu siç është, trim, besnik, të drejtë, të papërkulur në luftë. Populli ynë e ka kërkuar kurdoherë miqësinë me popullin bullgar, e ka dashur dhe e ka gjetur atë, pse si thotë populli ynë, shqiptarit i hahet buka me bullgarin. Shqiptarët dhe bullgarët kanë shumë cilësira të përbashkëta, kanë të njëjtat zakone, ata janë të duruar, të thjeshtë, punëtorë, të papërkulur përpara vështirësive, të pathyeshëm përpara armiqve, trima dhe luftëtarë që «të marrin gjak në vetull» kur është çështja për të mbrojtur lirinë, pavarësinë dhe të drejtat e tyre. Si bullgari dhe shqiptari, thonë për njëri-tjetrin: «kokë shqiptari» dhe «kokë bullgari» për të karakterizuar vendosmërinë dhe qëndrueshmërinë e tyre përpara vështirësive.

Në këngët popullore shqiptare, populli ynë i ka kënduar trimërisë shqiptaro-bullgare, luftës çlirimtare të të dy popujve, miqësisë dhe bashkëpunimit tradicional në mes tyre.

Por kjo dashuri dhe miqësi, në mes popullit shqiptar dhe bullgar, do të gjente shprehjen e plotë gjatë Luftës nacional-çlirimtare kundër nazistëve gjermanë dhe fashistëve italianë. Kjo luftë ishte për popujt tanë miq e vëllezër, lufta për jetë a për vdekje, ishte lufta që do të çlironte përgjithmonë popujt tanë nga skllavëria më e rëndë që kishin njohur gjatë shekujve, ishte lufta që do t'i lidhte me një miqësi të përjetshme. Popujt tanë u ngritën si një trup i vetëm në luftën çlirimtare dhe luftuan me heroizmin tradicional që i karakterizon kundër armiqve të shumtë në numër dhe të armatosur

deri në dhëmbë. Popujt tanë kishin besimin e patundur në fitoren, pse ata luftonin për një çështje të drejtë.

Lufta çlirimtare e të dy popujve u bë e mundur, u zhvillua, mori përpjesëtime të mëdha dhe më në fund u fitua, pse ata udhëhiqeshin nga parti revolucionare dhe pse në këtë ndërmarrje gjigande ata kishin ndihmës të mëdhenj dhe të fuqishëm Bashkimin Sovjetik, çlirimtarin e madh të popujve, kishin Ushtrinë famëmadhe dhe legjendare Sovjetike, që u theu koskat ushtrive fashiste. Ne fituam përgjithmonë, pse me ne ishte dhe na ndriçonte rrugën e fitores Stalini i madh, strategu më i madh i ditëve tona. Dashuria dhe besnikëria e partive tona komuniste motra dhe e popujve tanë për Stalinin ishte forcë e madhe guximi e pjekurie që frymëzonte partizanët heroikë të vendeve tona, në luftën që bënë për një çështje të madhe dhe të pavekshme.

Partitë tona komuniste u lindën, u rritën, u mbrujtën dhe u çelnikosën me mësimet e Leninit dhe të Stalinit. Besnikë të mësuesve të tyre të mëdhenj, Marksit, Engelsit, Leninit dhe Stalinit, ato ndoqën gjithmonë rrugën dhe mësimet e Partisë Bolshevike dhe nëpërmjet betejash të përgjakshme udhëhoqën popujt tanë drejt fitores së madhe që kishin ëndërruar stërgjyshërit tanë.

Popujt tanë sot janë në fuqi dhe kanë shtypur përgjithmonë armiqtë e tyre. Ata janë zotër të vendit e të jetës së tyre. Në vendet tona është vendosur dhe forcuar regjimi i demokracisë popullore dhe po ndërtohen me sukses bazat e socializmit. Këtë fitore të madhe ja detyrojmë edhe atdheut të madh të socializmit

dhe Stalinit, të cilët, si dje në luftën e çlirimit edhe sot në luftën për ndërtimin e bazave të socializmit, i ndihmojnë bujarisht popujt tanë në rrugën e lumtur dhe të begatshme të socializmit. Popujt tanë ndërtojnë për veten e tyre dhe për brezat e ardhshëm një jetë pa brenge, pa varfëri dhe mjerime. Popujt tanë me partitë tona komuniste dhe punëtoare në krye, ndjekin rrugën e paqes dhe të socializmit.

Për të parë popujt të lirë e të vëllazëruar, për të ndërtuar një jetë të lumtur e në paqe, luftoi gjithë jetën dhe shkriu gjithë energjitë e tija prej revolucionari të madh, biri i lavdishëm i popullit bullgar, udhëheqësi i shquar i Partisë Komuniste Bullgare, miku i shtrenjtë i popullit shqiptar, Gjergj Dimitrovi.

I shtrenjtë dhe i paharrueshëm është veçanërisht për ne, komunistët shqiptarë, për popullin tonë, Gjergj Dimitrovi. Ai duke qenë Sekretar i Përgjithshëm i Kominternit, u interesua posaçërisht për organizimin e lëvizjes punëtoare në vendin tonë. Shoku ynë i shquar Ali Kelmendi, me udhëzimet dhe këshillat e Dimitrovit, erdhi nga Moska në Shqipëri dhe filloi organizimin e lëvizjes punëtoare. Ali Kelmendi u tregua nxënës i denjë i Stalinit të madh dhe i Dimitrovit. Nën drejtimin e Ali Kelmendit, u hodhën bazat e lëvizjes komuniste në Shqipëri. Ali Kelmendi, i edukuar në rrugën e Lenin-Stalinit dhe të nxënësit të tyre, Dimitrovit, luftoi kundër trockistëve dhe arqiomarksistëve shqiptarë, goditi format sektare të lëvizjes komuniste të vendosura nga trockistët Niko Xoxi, Aristidh Qendro, Zai Fundo etj., arriti të vendosë lidhje me pjesën e shëndoshë të grupeve komuniste dhe u përpoq që t'i bindë ato për drej-

tësinë e direktivave të Internacionales së tretë Komuniste dhe të këshillave të shokut Dimitrov që konsistonin në lidhjen e shëndoshë të komunistëve me masat e popullit dhe në krijimin e frontit të gjerë antifashist.

Interesimi i Gjergj Dimitrovit për lëvizjen revolucionare në vendin tonë, për emigracionin revolucionar shqiptar, ka qenë shumë i madh. Kur unë u takova për herë të parë me shokun Dimitrov, në Sofje më 1947, ai më pyeti, një për një, për të gjitha grupet që ndodheshin më parë në emigracion. Ai njihte qëndrimin e grupeve të ndryshme dhe të çdo personi veç e veç si dhe tendencat e gjithsecilit. Në mënyrë të habitshme ai mbante mend çdo gjë. Qartësia e tij dhe parashikimet që ai bënte për të gjithë këta njerëz, ishin të mahnitshme për mua; kaq i mprehtë, kaq tej pamës ishte gjykimi dhe mprehtësia e këtij revolucionari të madh. Gjergj Dimitrovi kishte me dhjetëra vjet që i kishte humbur nga sytë këto grupe emigrantësh shqiptarë, këta elementë veç e veç, por ai kishte parashikuar qëndrimet e tyre të mëvonshme, sikur t'i kishte ndjekur këmba-këmbës në jetën e tyre.

S'mund të ketë komunist dhe revolucionar në botë, s'mund të ketë njeri të thjeshtë dhe të ndershëm që të mos ketë ndjekur me emocion të madh dhe të mos mburrej me qëndrimin heroik të Gjergj Dimitrovit, antifashistit të madh të orëve të para, në gjyqin e Laipcigut<sup>1</sup>. Ai s'ishte më vetëm revolucionari dhe udhëhe-

---

<sup>1</sup> Më 27 shkurt 1933 nazistët gjermanë, për të përgatitur opinionin kundër PK Gjermane dhe për t'u hapur rrugë veprimeve të tyre fashiste, i vunë zjarrin Rajhstagut. Për këtë ata

qësi i Partisë Komuniste Bullgare, por ishte Dimitrovi i të gjithëve, heroi i proletariatit botëror, që mbronte me heroizëm nga bishat hitleriane çështjen e lavdishme të socializmit dhe të komunizmit.

Qëndrimi heroik i Dimitrovit përpara gjyqtarëve, policëve, torturuesve nazistë, ishte shembull i lavdishëm i një bolshevikut të kalitur në shkollën e Stalinit, i një luftëtari të vjetër, me zemër kurdoherë të re, që s'ka frikë nga vdekja, që nuk kujdeset të shpëtojë kokën dhe lëkurën e tij, por të bëjë të triumfojë kauza e madhe e proletariatit.

*«Mos me pasë frikë nga vdekja, nuk është heroizëm personal, është thelbi dhe cilësia e komunistit, e punëtorit revolucionar, e bolshevikut»<sup>1</sup>*, ka thënë Dimitrovi.

Dhe Dimitrovi ishte një bolshevik i vërtetë. Ai mbrojti vijën e Internacionales së tretë, mbrojti Bashkimin Sovjetik, mbrojti kauzën e shenjtë të proletariatit dhe të partive komuniste.

*«Kur duhet të realizosh një vijë të tillë — thoshte Dimitrovi — nuk duhet të dridhesh për lëkurën tënde»<sup>2</sup>*.

I madhi Dimitrov, në Laipçig, nga i akuzuar, u bë akuzues dhe diti me zotësi dhe trimëri të rrallë, të marrë në dorë drejtimin e debateve të gjyqit. Dimitrovi i dërmoi nazistët, i demaskoi dhe bëri të dridhen nga

---

akuzuan komunistët, midis tyre edhe Dimitrovin, të cilin e arrestuan më 9 mars dhe e nxorën në gjyq, në Laipçig, më 20 shtator të atij viti, ku, nga i akuzuar u kthye në akuzues dhe, megjithëse në gjyq doli i pafajshëm, u lirua nga burgu më 27 shkurt 1934.

<sup>1</sup> Shih: Gj. Dimitrov. Veprat, vëll. 9, f. 428. (Bot. bullgarisht)

<sup>2</sup> Po aty, f. 377.

frika Gëringu, Gëbelsi e të tjerë banditë nazistë. Dimitrovi shkatërroi politikisht jo vetëm akuzën, por vetë armikun, policinë, kundërshtarët, Gëringun, Gëbelsin, regjimin e Hitlerit. Ai i demaskoi dhe i bëri gesharakë në sytë e të gjithë botës.

Mbrojtja e Dimitrovit në Laipçig ishte shkollë e madhe për revolucionarët e ardhshëm, për luftëtarët kundër fashizmit që luftuan me heroizëm dhe s'u përkulën asnjëherë përpara plumbave të armikut, por dhanë jetën duke brohoritur për popullin, për partinë e tyre komuniste, për Stalinin.

Fjalët e Dimitrovit përpara gjyqtarëve nazistë

*«Mbroj idetë e mia, koncepsionet e mia komuniste. Mbroj kuptimin dhe përmbajtjen e jetës sime. Është për këtë gjë që çdo frazë që unë shqiptoj përpara gjyqit, është gjaku i gjakut tim dhe mishi i mishit tim»<sup>1</sup>*, frymëzuan me mijëra luftëtarë të çështjes së popujve tanë, shqiptar dhe bullgar. Dimitrovi ka thënë se qëllimi i tij, me qëndrimin para gjyqit, ishte t'u tregonte masave të shtypura, në burgje, në kampe përqëndrimi, në uzina etj., atyre masave që rronin në një gjendje dëshpërimi, një shkëndi të kurajës revolucionare; se dëshironte t'u tregonte me shembull, që nuk është aspak e tmerrshme të luftosh kundër fashizmit.

Këtij qëllimi të lartë ja arriti plotësisht shoku Dimitrov. Ne, revolucionarët shqiptarë, si të gjithë revolucionarët e botës, mësuam, u edukuam në luftën e tij, në përpjekjet e tija gjiganteske dhe ndoqëm mësimet e tij, shembullin e tij. Dimitrovi, si Sekretar i

<sup>1</sup> Shih: Gj. Dimitrov. Veprat, vëll. 9, f. 258. (Bot. bullgarisht)

Përgjithshëm i Kominternit, na mësoi si të organizonim luftën kundër fashizmit. Raportet e tij shtypeshin ilegalisht dhe përhapeshin në malet tona nga Partia Komuniste e Shqipërisë, lexoheshin dhe studjoheshin në celulat e Partisë. Dimitrovi ishte i yni, vazhdimisht ai ishte pranë nesh në zemrën dhe në mendjen tonë. Ai luftonte tok me ne për çlirimin e popullit vëlla shqiptar.

Kuptohet lehtë se ç'gëzim të madh kam ndjerë kur u nisa me delegacionin e qeverisë shqiptare për në Sofje. Do të takohesha për herë të parë me të madhin Gjergj Dimitrov.

Ishin momente të rënda, veçanërisht për popullin dhe Partinë tonë Komuniste. Trockistët e Beogradit, akoma të fshehur, vepronin kundër Republikës Popullore të Shqipërisë. Një gjendje jashtëzakonisht e vështirë ishte krijuar te ne. Një atmosferë konspiracioni e sabotazhi po kurdisej në errësirë nga agjentura e tmerrshme amerikane në Ballkan e që kishte në krye renegatin Tito. Partia dhe Republika jonë Popullore ishin në rrezik të madh. Propozimi i Dimitrovit për të nënshkruar një traktat miqësie dhe bashkëpunimi në mes të dy vendeve tona, ishte si një rreze e ndritur e diellit. Letrat historike të Partisë Bolshevike dhe më vonë Rezoluta e Byrosë Informativë do ta kthjellonin këtë gjendje të turbullt. Nën dritën e tyre partitë tona do të shkatërronin përgjithmonë planet djallëzore të amerikanëve dhe të banditëve titistë, Traiço Kostovëve, Koçi Xoxëve etj. dhe do të shpëtonin edhe një herë tjetër popujt tanë nga një katastrofë e tmerrshme.

Dita e lumtur më në fund arriti. Miqtë e dashur bullgarë, përfaqësues të qeverisë, të Partisë Komuniste,

të ushtrisë heroike bullgare kishin dalë e na prisnin në kufirin bullgaro-jugosllav. Treni që na çonte për në Sofje, tani kalonte me shpejtësi nëpër tokën bullgare. Në çdo qytet, në çdo fshat, në çdo stacion ku kalonte hekurudha, me qindra e me mijëra vëllezër e motra bullgare, kishin dalë të na prisnin e të na përshëndetnin. Arritëm në stacionin e Sofjes. Vetë i shtrenjti Dimitrov kishte dalë të na priste. I papërshkrueshëm ishte gëzimi dhe emocionimi im dhe i shokëve të mi. Me të zbritur nga treni Gjergj Dimitrovi, i qeshur, i dashur u afrua dhe u përqaftua meqësisht. Ajo dashuri e madhe dhe e sinqertë që Gjergj Dimitrovi më shfaqti që në çastin e parë të takimit tonë, ishte për popullin shqiptar, për Partinë e tij. Unë isha shumë i gëzuar që populli ynë kishte një mik të tillë të Dimitrovi dhe të populli bullgar. Isha jashtëzakonisht i emocionuar. Shoku Dimitrov më mbante nga krahu dhe më prezantoi me radhë shokët, si shokun e paharruar Kolarov dhe bashkëpunëtorët e tjerë më të ngushtë të tij. Kaluam në mes të popullit të Sofjes. I madh dhe i vogël kishte dalë nëpër rrugë. Kurrë nuk do ta harroj atë dashuri të ngrohtë, të sinqertë që populli i Sofjes shfaqti për popullin vëlla shqiptar, për Republikën Popullore të Shqipërisë, për të madhin Stalin dhe për Gjergj Dimitrovin. Me ç'brohoritje të zjarra dhe të dala nga zemra i pritni populli i Sofjes ndjenjat e miqësisë, të vëllazërimit që unë pata nderin e madh t'i transmetoja në emrin e popullit shqiptar dhe të qeverisë shqiptare. Një entuziazëm i papërshkruar në masën e madhe të popullit, një buçitje e patreguar shpërtheu nga populli, kur Gjergj Dimitrovi filloi të flasë për miqësinë në mes



të dy popujve tanë. Fjalët e Dimitrovit elektrizonin masat. Sado që vuante prej shumë kohe nga një sëmundje e rëndë, që ja kishin shkaktuar lufta e tij legjendare prej revolucionari të madh, burgjet dhe vuajtjet e papërshkrueshme, zëri i këtij tribuni revolucionar buçiste i fuqishëm e prekte zemrat e njerëzve, i entuziazmonte. Populli s'pushonte së brohorituri për birin më të lavdishëm të tij, për atë që tërë jetën luftoi me të gjitha forcat e shpirtit dhe të trupit të tij për çlirimin e popullit bullgar dhe për të mirën e proletariatit botëror, për atë bolshevik të çelniktë, që zbatoi me heroizëm dhe me zotësi të madhe mësimet dhe këshillat e Leninit e të Stalinit, për atë që i qëndroi besnik deri në frymën e fundit mësuesit të lavdishëm të tij dhe të të gjithë proletariatit botëror, Josif Stalinit.

Të paharrueshme do të jenë për mua të gjitha ato ditë të lumtura që kalova pranë shokut Dimitrov dhe bashkëpunëtorëve të tij. Që në momentin e parë e vazhdimisht ai u interesua për popullin dhe Partinë tonë. Dimitrovi më tha:

*«S'ka lumturi më të madhe për njerinë se sa ajo që t'ja kushtojë tërë jetën e tij, tërë forcat e tija luftës për të mirën e popullit, për lumturinë e popullit. Unë jam aq i gëzuar për popullin shqiptar sa dhe për popullin tim që u çlirua përgjithmonë nga robëria, që sot rron i lirë dhe i pavarur dhe që ndërton jetën e lumtur socialiste. Të mendojmë si kanë qenë në të kaluarën dhe si janë popujt tanë sot. Të mos harrojmë të kaluarën e tmerrshme dhe lumturinë e sotme dhe atë që ndërtojmë për brezat e ardhshëm. Këtë ja detyrojmë «plakut» të lavdishëm të Kremlinit që do të rrojë i ri në shekuj. . . »*

Shoku Dimitrov, pasi i tregova situatën e vendit tonë, u gëzua pa masë dhe më tha:

*«Forconi ekonominë, ndërtoni industrinë dhe zhvilloni bujqësinë. Në këtë rrugë, si ju dhe ne kemi ndihmën e paçmuar të Bashkimit Sovjetik. Popujt tanë do të shohin ditë të lumtura, pse ata udhëhiqen nga partitë komuniste.*

*Forconi partinë tuaj. Ajo është parti marksiste-leniniste, e krijuar në zjarrin e luftës, kuadrot e saj janë të çelnikosur në luftë dhe ajo ka një aktivitet revolucionar të shkëlqyer. Por mbani kurdoherë parasysh se ajo është një parti e re, prandaj i mbani pastër radhët e saja nga oportunistët, nga sektarët, nga agjentët e imperializmit. I vini rëndësi të madhe ngritjes ideologjike të anëtarëve të partisë dhe përhapni kulturën përparimtare në masat e gjera të popullit tuaj, i cili ka qenë lënë në errësi nga regjimet e feudalëve dhe të borgjezisë.*

*Edhe ne — vazhdoi Dimitrovi — do ta ndihmojmë popullin vëlla shqiptar, me të gjitha mundësitë tona, që ai të shkojë përpara me hapa të mëdhenj, në rrugën e begatisë. Traktati që ne do të nënshkruajmë, do të jetë një instrument i rëndësishëm paqeje në Ballkan. Vdiq koha kur Ballkani ishte një fuçi baruti që në çdo moment imperialistët i vinin zjarrin për interesat e tyre grabitqare.*

*Në vendet tona çdo gjë ngrihet, ndërtohet, lulëzon për mirëqenjen e popullit, i cili punon në paqe dhe me besim të madh në të ardhshmen e tij të lumtur».*

Me etje të madhe i dëgjoja fjalët e shokut Dimitrov, që ishin mësimë shumë të çmueshme për mua dhe për Partinë tonë.

Ne pamë në jetë, kudo që shkuam në Bullgari, në fabrika, në miniera qymyri, në qendra pune, përparimet e mëdha që kishte bërë populli vëlla bullgar nën drejtimin e Partisë Komuniste Bullgare, të udhëhequr nga Dimitrovi. Kudo po ndërtohej, kudo një hov i madh në punë, një entuziazëm i papërs shkruar, kudo një dashuri e ngrohtë dhe e sinqertë për popullin tonë. Më në fund erdhi dita historike e 16 dhjetorit, kur ne do të nënshkruanim Traktatin e miqësisë, të bashkëpunimit dhe të ndihmës reciproke në mes të dy popujve tanë. Traktati do të nënshkruhej në Kritçim, jashtë Sofjes. U nisëm në mëngjez nga Sofja për Kritçim.

Automobili ynë kalonte përpara me shpejtësi të madhe, duke lënë shumë pas vargun e automobilave që sillnin shokët e tjerë në drejtim të Kritçimit. Frynte erë dhe tufan bore. Kalonim fusha të mbuluara me borë. kopshtie, pyje. Grupe fshatarësh, gjatë rrugës, përshëndetnin dhe brohoritnin të qeshur dhe të gëzuar, udhëheqësin e tyre të dashur dhe të madh, Gjergj Dimitrovin dhe mysafirin e tyre, përfaqësuesin e Republikës Popullore të Shqipërisë.

Gëzimi kishte pushtuar zemrat tona. Ne ishim thellësisht të prekur nga dashuria e ngrohtë dhe e sinqertë që populli vëlla bullgar tregonte gjatë gjithë udhëtimit tonë nga Sofja në Kritçim, për popullin shqiptar, për Gjergj Dimitrovin, për udhëheqësin, mësuesin dhe edukatorin e madh të popujve, Josif Visarionoviç Stalinin.

Sytë e revolucionarit të madh, Gjergj Dimitrovit, ndritnin nga gëzimi kur kalonim në mes masës së popullit, kur të rinjtë dhe plakat bullgare, punëtorët dhe fshatarët e përqaфонin nëpër stacionet e ndryshme. i

jepnin tufa me lule, i përkëdhelnin duart dhe fytyrën. Zemra e popullit bullgar rrihte me vrull dhe me dashuri të papërshekrueshme për udhëheqësin e tij të shtrenjtë dhe legjendar. Në sytë e Gjergj Dimitrovit reflektohehin si në pasqyrë të kristaltë vullneti i çelniktë i bolshevikut heroik, i mbrujtur në shkollën e lavdishme staliniane, dashuria e singërtë, thjeshtësia jashtëzakonisht e madhe prej bolsheviku, qartësia në mendime, pastërtia e shpirtit dhe besnikëria e tij e pafund për çështjen e socializmit dhe të komunizmit.

Po i afroheshim fshatit Kritçim, ku do të firmosnim aktin historik, që lidhi në një miqësi dhe aleancë të pathyeshme të dy popujt tanë miq e vëllezër. Gjergj Dimitrovi, më hodhi krahun e tij mbi supet dhe, duke më treguar fushat e gjera të mbuluara me borë, më tha:

*«Shih, pas furtunës vjen kurdoherë kohë e bukur. Bora do të shkrijë dhe kalliri i grurit do të hidhet përpjetë, ndër kopshtiet do të lulëzojnë trëndafilat. Këto toka kanë qenë çifliqet e xhelatit të popullit, Borisit,<sup>1</sup> i cili ua kishte grabitur fshatarëve dhe i kishte bërë skllevër. Por s'ka forcë që të mposhtë popullin dhe idetë e Marksit, të Leninit dhe të Stalinit. Populli s'u përkul, por luftoi, e mundi furtunën e Borisin dhe fitoi».*

I shtrenjti Gjergj Dimitrov, kurrë nuk do t'i harroj në jetën time ato momente aq të dashura për mua, kur ju më kishit hedhur dorën mbi supet e mia, kur unë, nxënësi yt i ri, ndjenja zemrën tënde prej luani të rrih-

---

<sup>1</sup> Borisi III, ish-mbret i Bullgarisë (1894—1943), i cili e futi Bullgarinë në aleancë me Gjermaninë hitleriane, duke e bërë satelite të saj.

te pranë meje, atë zemër që s'mundën kurrë ta mposhtnin armiqtë e tërbuar të njerëzimit, atë zemër që përballoi aq furtuna, aq rreziqe dhe doli fitimtare, atë zemër që rrahu tërë jetën për popullin, atë zemër që e donte aq shumë Stalinin tonë të shtrenjtë, Bashkimin Sovjetik, mikun e lavdishëm të popujve tanë.

Në të hyrë të Kriçimit na pritnin fshatarët. Automobili ynë u ndal. «Zbrit — më tha Dimitrovi — të takohemi me ta». U gjendëm në mes të fshatarëve që na përqaфонin. Një fshatar m'u drejtua në gjuhën bullgare, por nuk kuptoja çfarë më thoshte. «Kërkojnë t'u flasësh» — më tha Dimitrovi në rusisht, që unë e kuptoja fare pak.

Kërkoj përkthyesin, por ai ishte pas, në automobilat e tjerë.

«Fola shqip — më tha Dimitrovi — unë do t'ua përkthej në bullgarisht, s'ka gjë nëse nuk e kuptojnë gjuhën shqipe, ata kuptojnë ndjenjat e popullit shqiptar që janë po ato si të popullit bullgar». Dhe kështu bëmë. Unë fola shqip dhe Dimitrovi i përkthente në bullgarisht. Në mbarim të përkthimit, shoku Dimitrov u tha fshatarëve:

«A e shihni, o vëllezër, sa duhemi dhe kuptohemi me popullin vëlla shqiptar. Për fat të keq, unë nuk e di shqipen, as Enveri bullgarishten, po zemrat tona flasin në të njëjtën gjuhë dhe shprehin të njëjtat ndjenja».

Nuk mund të shpreh dot çka ndodhi në atë moment: kush të na përqafonte më parë e kush të na jepte bukën dhe kripën tradicionale. Një fshatar plak nxori nga xhepi dhe më vuri në dorë një kokërr mollë të kuqe.

Më datën 16 dhjetor, në sallën e madhe të pallatit

të Kritçimit nënshkruam Traktatin e miqësisë, të bashkëpunimit dhe të ndihmës reciproke. Nga ana bullgare e nënshkroi vetë shoku Dimitrov, ndërsa Konventa kulturale në mes të dy vendeve tona u nënshkrua nga Vëllko Çervenkov.

Ky akt i madh historik që nënshkruan popujt tanë, ishte shprehje e gjallë e dëshirave dhe e aspiratave të tyre.

Traktati i miqësisë lidhi ngushtë të dy popujt vëllezër, të cilët kanë një rrugë, luftojnë për të njëjtat qëllime dhe që në këtë rrugë të njëjtë, ata do të ndihmojnë shoqi-shoqin për të ndërtuar jetën e re e të lumtur dhe do të mbrohen së bashku, në rast se armiqtë do të guxojnë të çenojnë fitoret e popujve tanë dhe punën paqësore të tyre, lirinë dhe pavarësinë e të dy vendeve tona.

Ky traktat përbën një hallkë të sigurtë në vargun e miqësisë, midis vendeve të kampit të paqes dhe të demokracisë, që udhëhiqet nga Bashkimi i madh Sovjetik.

Traktati i miqësisë, shënoi një etapë të re të lavdishme në historinë e popujve tanë dhe realizoi aspiratat e tyre. Ja si u shpreh dhe shoku Dimitrov në ceremoninë e nënshkrimit:

*«Sot ne jemi lidhur dhe më ngushtë dhe më thellësisht nga zemra, nga shpirti dhe prej interesit për të ndjekur të njëjtin qëllim, në ditët e mira dhe të këqia, në gëzime dhe në hidhërime. S'ka dhe s'ka për të pasur asnjë forcë në të ardhshmen që të na ndajë».*

Aktin historik që ne nënshkruam në Kritçim, shtetet imperialiste dhe satelitët e tyre, si dhe agjentët e

fshehtë të amerikanëve në Ballkan, grupi nacionalist i Titos, natyrisht, e pritën me armiqësi. Klika e Beogradit, që në atë kohë vepronte akoma në mënyrë të maskuar, por shumë aktive për likuidimin e Partisë Komuniste të Shqipërisë dhe të regjimit të demokracisë popullore, ishte kundër nënshkrimit të Traktatit të miqësisë, të bashkëpunimit dhe të ndihmës reciproke në mes të Republikës Popullore të Shqipërisë dhe Republikës Popullore të Bullgarisë.

Titistët kishin në planin e tyre aneksimin dhe kolonizimin e Republikës sonë Popullore dhe për t'ja arritur këtij qëllimi, përveç punës sabotuese nga brenda në bashkëpunim me agjentët e tyre shqiptarë, Koç Xoxen etj., ata bënë çmos që ta izolonin Shqipërinë nga Bashkimi Sovjetik dhe nga vendet e demokracisë popullore. Trockistët jugosllavë e shqiptarë kishin filluar një fushatë djallëzore në shtet dhe brenda në Partinë tonë, duke folur keq për Bashkimin Sovjetik, duke pretenduar se Shqipëria s'mund të priste asnjë ndihmë morale, politike dhe materiale nga Bashkimi Sovjetik për arsye se «ai është larg», pse «ai s'mund të djegë jorganin për një plesht», pse «ai s'ka se si ta ndihmojë Shqipërinë materialisht për ndërtimin e socializmit, për arsye të dëmeve të mëdha që ka pësuar nga lufta» dhe se gjoja Jugosllavia e Titos është ngarkuar që të interesohej veçanërisht për Shqipërinë.

Nën pretekstin se ekzistonte traktati i miqësisë, i bashkëpunimit dhe i ndihmës reciproke në mes të Shqipërisë dhe Republikës Federative Jugosllave, nën pretekstin se ekzistonin marrëdhënje ekonomike në mes të dy vendeve tona, titistët mundoheshin të pengonin me

çdo mënyrë çfarëdo marrëveshje në mes të Shqipërisë dhe vendeve të demokracisë popullore. Kur në vitin 1947, Bashkimi Sovjetik i akordoi Republikës sonë Popullore një kredi me afat të gjatë, agjenti i amerikanëve, përfaqësuesi i trockistit Tito në Moskë, Vllado Popoviç, u nxi nga inati dhe nga zemërimi, derisa harroi dhe rregullat më elementare të një diplomati në sjelljet e tija ndaj përfaqësuesve diplomatikë të Republikës Popullore të Shqipërisë në Moskë. Ai kërkoi që t'i dorëzoheshin kopjet e marrëveshjes duke pretenduar që asgjë s'duhej të përfundohej pa pëlqimin e qeverisë jugosllave. Natyrisht, Vllado Popoviç, agjent titist dhe amerikan, nuk pati sukses në veprimin e tij të poshtër dhe qeveria nacionaliste e Beogradit u detyrua të dënojë për sy e për faqe ambasadorin e saj në Moskë dhe të «desolidarizohet» me gjestin e Popoviçit, kur qeveria jonë protestoi.

Këto akte tregonin në realitet çfarë fshihej në strofkën e trockistëve të Topçiderit.<sup>1</sup> Këta nën urdhërat e amerikanëve, përpiqeshin me dinakëri, me sabotazhe, me shantazhe e me kërcënime të krijonin konditat e përshtatshme, që më vonë, kur do të digjnin të gjitha etapat e tradhëtisë së tyre, Shqipëria të gjendej krejtësisht e izoluar dhe e vënë e tëra nën mëshirën e tyre. Titistët mendonin se kështu nuk do të kishin kokëçarje dhe pengesa për veprën e tyre djallëzore si nga ana e brendshme ashtu dhe nga ana ndërkombëtare, kur ata ta okuponin Shqipërinë «manu militari». S'ka dyshim

---

<sup>1</sup> Park në periferi të Beogradit pranë të cilit ndodhet rezidenca e Titos dhe e grupit të tij.



se puna armiqësore e jugosllavëve, haste në një rezistencë të fortë nga ana e Partisë, qeverisë dhe popullit shqiptar, që ushqente një dashuri të pakufishme për Bashkimin Sovjetik dhe Stalinin e madh. Populli shqiptar dhe Partia Komuniste e Shqipërisë nuk u zuri besë trillimeve të titistëve, nuk u frikësua nga presionet dhe shantazhet e tyre, kurdoherë dhe në çdo moment i kishte sytë dhe zemrën nga Moska e lavdishme, se Partia dhe populli ynë e dinte dhe e shihte konkretisht se ishte Bashkimi Sovjetik ai që e shpëtoi përjetë popullin tonë nga robëria fashiste, e ndihmonte dhe e mbronte atë nga çdo rrezik.

Shqipëria e re demokratike popullore kalonte me të vërtetë nga një rrezik i madh. Trockistët e Beogradit brutalisht kishin ndërhyrë në punët e brendshme të Partisë dhe të shtetit tonë; agjentura e tyre në Partinë dhe në shtetin tonë e udhëhequr nga Koçi Xoxe, Pandi Kristo etj., kishin marrë urdhër të shpejtonin veprimtarinë e tyre armiqësore. Shoku ynë Nako Spiru, anëtar i Byrosë Politike, nën presionin, shpifjet dhe kërcënimet e nacionalistëve të Beogradit dhe të agjentëve të tyre në Shqipëri, vrau veten. Sabotazhi, në të gjitha lëmet ë aktivitetit shoqëror, politik, ekonomik, ishte në rendin e ditës. Agjentët jugosllavë ishin udhëheqësit e këtyre sabotazheve. Por Partia jonë rezistonte heroikisht, me besim të plotë në parimet e pavdekshme marksiste-leniniste, në politikën e lavdishme staliniane.

Dhe pikërisht në këto momente kaq të rënda për Partinë dhe popullin tonë, në këto momente kur Titua dhe klika e tij besonte se i kishte përgatitur hallkat e zinxhirëve me të cilat do të lidhte pas qerres së tij

atdheun tonë të dashur, Partia dhe populli ynë të ndriçuar edhe nga politika e lavdishme staliniane, shpartalluan planet titiste. Republika Popullore e Shqipërisë s'mund të izolohej kurrë as ekonomikisht as politikisht nga Bashkimi Sovjetik dhe vendet e demokracisë popullore. Nxënësi i lavdishëm dhe besnik i Stalinit, revolucionari i madh, Gjergj Dimitrovi, udhëheqësi i lavdishëm i popullit vëlla bullgar dhe i Partisë Komuniste Bullgare, e çau, si kurdoherë, rrethimin fashist që i bëhej një populli të vogël, por trim e paqedashës, që tërë jetën e tij kishte derdhur gjak për liri e demokraci.

Heroi legjendar i Laipcigut i dha dorën popullit shqiptar, mik e vëlla i popullit bullgar, mik e vëlla besnik i popujve të lavdishëm sovjetikë. Njerëzit e ndershëm dhe të thjeshtë, mund të marrin me mend sa gëzim, sa kurajë e besim fituam në ato momente aq delikate, aq të rënda, aq të tmerrshme, kur i shtrenjti Gjergj Dimitrovi, në emër të qeverisë dhe të popullit bullgar, i bënte propozimin Qeverisë së Republikës Popullore të Shqipërisë, për të lidhur Traktatin e miqësisë të bashkëpunimit dhe të ndihmës reciproke.

Gjergj Dimitrovi ishte realizuesi i mësimëve të Stalinit të madh mbi miqësinë e sigurtë në mes të popujve. Populli dhe Partia jonë do t'i jenë mirënjohës për jetë Dimitrovit, që ishte inisiatori dhe realizuesi i Traktatit të miqësisë, të bashkëpunimit dhe të ndihmës reciproke që lidh për jetë të dy popujt tanë, ishte inisiator i konkretizimit të dëshirave dhe të aspiratave të popujve tanë.

Propozimi i Dimitrovit dhe i qeverisë bullgare, u ra si rrufe klikës së Beogradit dhe agjentëve jugosllavë

në Shqipëri. Kopeja e ujqërve u alarmua. Titistët kërkonin të mësonin me çdo kusht nga ç'anë u muar kjo inisiativë e papritur që u shkatërronte planet e tyre. Ata u përpoqën ta pengonin realizimin e kësaj marrëveshjeje. Por të gjitha u vanë kot. Në gjirin e Komitetit Qendror të Partisë sonë më kot u përpoqën agjentët Koçi Xoxe, Pandi Kristo etj. të sabotonin realizimin e kësaj marrëveshjeje, të përçmonin vlerën e saj politike, ekonomike e historike. Të gjithë ata u mundën dhe trockistët e Beogradit u detyruan të buzëqeshin përpara disfatës. Por intrigat dhe lufta e tyre s'kishin marrë fund.

Në pamundësi të ndalonin nënshkrimin e traktatit, agjentët e Jugosllavisë, kishin marrë urdhër nga Beogradi që në shtypin tonë të zvogëlohej vlera e këtij traktati, të diskreditohej udhëheqja e shtetit tonë. Ilegalisht, duke bërë një «fait accompli», agjentët shqiptarë në shërbim të trockistëve jugosllavë botuan artikullin e poshtër në gazetën «Bashkimi», ku në mes të tjerave thuhej «... rruga për në Sofje kalon nga Beogradi»<sup>1</sup>. Po përdorëshin metodat e Hitlerit dhe të Musolinit. Delegacioni i qeverisë shqiptare që u nis për në Sofje, për të nënshkruar traktatin, u detyrua të kalonte nga Beogradi. Sjelljet e titistëve ndaj ministrit bullgar në Tiranë që udhëtonte me ne dhe ndaj delegacionit të qeverisë shqiptare, qenë sjellje shumë të ulëta. Ministri bullgar në Tiranë, gjatë gjithë udhëtimit nëpërmjet Jugosllavisë, u izolua nga delegacioni ynë. Delegacioni ynë u izolua krejtësisht në një shtëpi. Vetëm Koçi Xoxe u

<sup>1</sup> Gazeta «Bashkimi», Nr. 920, 11 dhjetor 1947.

lejua të dalë jashtë, i cili shkoi të takohej me Rankoviçin e me Vukmanoviç Tempon dhe, natyrisht, mori prej tyre udhëzimet për veprim.

Banditi Koçi Xoxe sipas udhëzimeve të padronëve të tij, u përpoq intensivisht për të sabotuar marrëveshjen, për ta zhvlerësuar, për ta bërë atë një fletë pa vlerë. Por ai dhe ata që e udhëzonin dështuan.

Porositë e Rankoviçit që zbatonte banditi Koçi Xoxe, u dukën qartë në diskutimet që ai ngriti në gjirin e delegacionit tonë në Sofje, por që u hodhën poshtë. Koçi Xoxe, në shërbim direkt të Titos dhe të grupit të tij, u përpoq që nenet e traktatit të marrëveshjes të ndërroheshin dhe të hartoheshin në një mënyrë të tillë, ku të zhdukej sovraniteti dhe liria e vendit tonë, në favor të Republikës Federative Jugosllave. «Republika Popullore e Shqipërisë — sipas tezave të Koçi Xoxes dhe të klikës së Beogradit — duhej të koordinonte çdo veprim e çdo hap me Republikën Federative Jugosllave dhe asgjë s'duhej të bënte pa marrë pëlqimin dhe aprovimin e Beogradit». Kjo vartësi koloniale duhej të shprehej në frymën e traktatit.

Përsa u përket marrëdhënjeve ekonomike, teza e Koçi Xoxes dhe e grupit titist, duhej të formulohej në një mënyrë të tillë që këto marrëdhënje të ishin jo vetëm formale, por të mos realizoheshin kurrë. Koçi Xoxe luftoi me këmbëngulje në gjirin e delegacionit tonë për të imponuar këto teza, por ato ju hodhën poshtë.

Egërsia e titistëve dhe e agjentit të tyre Koçi Xoxe, kishte arritur deri në atë shkallë, sa që ky na kërcënoi se do të bënte skandal në mbledhjen plenare të të dy delegacioneve, duke kundërshtuar tekstin definitiv të

traktatit që kishim vendosur, Hysni Kapo dhe unë tok me palën bullgare. Po kërcënimet e Koçi Xoxes dhe të padronëve të tij nuk patën sukses dhe traktati u nënshkrua.

Por me kaq nuk kishte mbaruar armiqësia e grupit të Titos kundër popujve tanë dhe kundër vet personit të Dimitrovit.

Në darkën që shoku Dimitrov dha për nder të delegacionit tonë, pasi u nënshkrua traktati, ai foli me zjarr dhe dashuri për rolin vendimtar në historinë e njerëzimit të Bashkimit Sovjetik dhe të shokut Stalin, që duke thyer hordhitë naziste shpëtuan njerëzimin nga murtaja fashiste, që ndihmuan për çlirimin e popujve tanë nga robëria shekullore dhe që sot i ndihmojnë pa kursyer vendet dhe popujt tanë të ndërtojnë bazat e socializmit. Pastaj shoku Dimitrov foli me aq dashuri dhe simpati, me aq kompetencë dhe erudicion për historinë e popullit tonë, për luftërat e tija, për miqësinë e lashtë që lidh popullin bullgar me atë shqiptar, për miqësinë e pavdekshme që u mbryjt në mes të popujve tanë nëpërmjet Luftës nacional-çlirimtare kundër armiqve të përbashkët, fashistëve gjermano-italianë dhe kuislingëve. Fjalët e zjarra të revolucionarit të madh preknin zemrat tona. Pas shokut Dimitrov mora dhe unë fjalën. Isha shumë i emocionuar, se mendoja nëse do të shprehja dot me fjalë ato ndjenja të flakta dashurie dhe mirënjohjeje që ushqeja për popullin vëlla bullgar, për udhëheqësin e lavdishëm, Dimitrovin, për mësuesin tonë të shkëlqyer, për nxënësin e madh e besnik të Josif Stalinit, për mikun e shtrenjtë të popullit tonë. Fytyra e çelët dhe e gëzuar,

thjeshtësia e çuditshme e Dimitrovit ma zhdukën drojtjen e fillimit dhe shpreha në fjalën time, jo të shkëlqyer, ndjenjat e zemrës sime, që ishin të njëjta me ato të popullit tim, të Partisë Komuniste të Shqipërisë. E paharrueshme do të jetë për mua ajo natë, jo vetëm për gëzimin e lumturinë që ndjeva pranë shokut Dimitrov, Kollarov etj., por edhe për një ndodhi tjetër që ngjau në gjirin e delegacionit shqiptar, pasi u kthyem nga darka.

Shkova të flija. Nuk më iknin nga sytë dhe nga mendja përshtypjet e mbrëmjes dhe fjalët e ngrohta të shokut Dimitrov. Sillja ndër mend gjithë jetën heroike të tij, luftën e papërkulur, përpjekjet dhe sakrificat për çështjen e popullit të tij dhe të gjithë proletaria-tit botëror.

Ç'shembull i shkëlqyer për ne të rinjtë! E gjithë jeta e tij ishte një libër i gjallë, ku mësonim, edukoheshim në shembullin e këtij bolsheviku, nxënës dhe bashkëpunëtor i udhëheqësit të lavdishëm, Stalinit të madh.

Gjumi më zuri në orët e vona të natës. Po në derë të dhomës sime trokasin. Ngrihem, e hap. Ishte Koçi Xoxe, të cilin s'e kishte zënë gjumi, por për një arësyje të kundërt nga ajo e imja. Ai s'mund të priste mëngjezin, aq shumë ishte i shqetësuar. E pyes se ç'kish-te ngjarë.

Koçi Xoxe, si agjent i Titos dhe i Rankoviçit që ishte, më thotë se ai nuk ishte aspak dakord me fjalimin tim që mbajta në darkë në lidhje me personin e Dimitrovit. «Dimitrovin — më thotë Koçi Xoxe — e ngrite në qiell, kurse Titon gati e harrove. Unë s'jam

dakord që Dimitrovi të errësojë madhështinë e Titos, zotësinë e tij dhe famën e tij si revolucionar i shquar, fytyrën më të madhe dhe më të shkëlqyer të popujve të Ballkanit. Përpara Titos nuk mund të qëndrojë personaliteti i Dimitrovit, vazhdon Koçi Xoxe, ti pate guxim të thoshje se «Dimitrovi është një figurë e shquar ndërkombëtare», kurse kjo duhet thënë për Titon, se Titua është i tillë dhe Jugosllavia e Titos duhet të bëhet sot epiqendra e popujve të Ballkanit».

E dëgjova me zemërim kur fliste në këtë mënyrë për shokun Dimitrov dhe më në fund i thashë: «Ju s'jeni dakord me mua, por edhe unë s'jam aspak dakord me ju, jam në kundërshtim të hapët me ju. Ato që thashë unë i mbroj dhe do t'i mbroj me gjithë shpirt. Unë i kërkoj ndjesë popullit tim dhe Partisë sime që nuk kam mundur t'i shprehja edhe më mirë ndjenjat e dashurisë dhe të mirënjohjes së popullit tonë dhe të komunistëve shqiptarë, ndaj të madhit Gjergj Dimitrov».

Koçi Xoxe më tha se shkoj në rrugë të gabuar dhe këtë çështje do ta shtronte në Byronë Politike, kur të ktheheshim në Tiranë. I përgjigjem: «Unë nuk kam gabuar, por po gaboni ju, ju jeni në rrugë të gabuar, unë jam i bindur se jam në rrugë të drejtë dhe s'ka kush të më lëvizë nga kjo rrugë. Jam gati ta shtrojmë këtë çështje në Byronë Politike, se është çështje me rëndësi të madhe parimore». Më pas do të zbulohej tradhëtia e këtyre banditëve titistë, Koçi Xoxe, Trajçe Kostov, që përpiqeshin të diskreditonin Gjergj Dimitrovin dhe ky i fundit përgatiste edhe zhdukjen fizike të Dimitrovit.

Qëndrimi i hapët armiqësor i Koçi Xoxes ndaj të madhit Dimitrov ma shqetësoi zemrën time. Mendoja atë natë të gjeja arësyeen e kësaj veprë të poshtër. Por arësyeen do të ma jepnin më vonë letrat historike të Partisë Bolshevike të lavdishme drejtuar ish-Partisë Komuniste Jugosllave. Këto letra, duke zbuluar tradhëtinë e grupit trockist të Titos, ndihmuan popujt dhe partitë tona komuniste për të shpëtuar nga një katastrofë e tmerrshme. Por një gjë shihja të qartë në ato momente kur Koçi Xoxe, si agjent titist sulmonte vijën e drejtë marksiste të Partisë sonë në drejtimin e personit të Dimitrovit dhe të miqësisë në mes të dy popujve tanë. Ç'ndryshim i madh në mes të qëndrimit të thjeshtë të Dimitrovit dhe të qëndrimit mendjemadh të Titos, ç'ndryshim në mes të ambientit të ngrohtë, të dashur, të sinqertë bullgar dhe ambientit të ftohtë të hipokriëve të maskuar të Beogradit!

Unë kisha qenë disa herë zyrtarisht në Beograd për nënshkrim akordesh dhe traktatesh me qeverinë jugosllave. Titua dhe grupi i tij na rezervoii kurdoherë një pritje të akullt, përbuzëse, ofenduese. Nacionalisti Tito me gishtërinjtë plot unaza xhevahiri, i rrethuar nga trockisti Kardel, nga aventurieri Gjilas dhe nga hijena Rankoviç, i cili kurdoherë i heshtur dhe me shikimin nën qepalla, thurte plane që të eliminonte Partinë tonë dhe udhëheqjen e saj të shëndoshë, na trajtonin nga lart në mënyrë të hapët ofenduese, si ata monarkët e urryer që silleshin brutalisht me njerëzit e popullit. Çdo herë që unë pata fatin e keq të takohem me ta, nuk gjeta veç përbuzje, urrejtje, ofendime të hapëta ndaj popullit dhe Partisë sonë. Zemra ma thosh-



te se ata s'ishin të pastër dhe zemra s'më gaboi. Por çdo gjë do të sqarohet për mua më vonë, kur Stalini ua çori maskat dhe zbuloi çfarë planesh djallëzore kurdisnin këta renegatë.

Në Sofje ne u gjendëm në një ambient krejt ndryshe, u gjendëm në gjirin e komunistëve të vërtetë, e miqve të dashur e të sinqertë, që na flisnin hapët, që na flisnin me aq dashuri për Bashkimin Sovjetik, për popullin dhe Partinë tonë. Takimet e vazhdueshme me Dimitrovin, me Kollarovin etj., ma qetësonin zemrën time të revoltuar nga intrigat e titistëve; nga këto takime unë merrja kurajë, mësoja se kisha nevojë për ndihmën dhe përkrahjen e tyre.

Ç'shembull i shkëlqyer për mua dhe shokët e mi, jeta dhe qëndrimet e shokut të madh Dimitrov! Thjeshtësia e shokut Dimitrov ishte e madhe. Ai ishte armik i protokollit borgjez, i luksit, i shpenzimeve të kota dhe të dëmshme. Ai mbante të panjolllosur thjeshtësinë e punëtorit bolshevik, që kurrë nuk dehej nga sukseset. Ai në çdo moment mendonte për popullin, çdo gjë e maste me interesin e popullit, çdo gjë ai ja destinonte popullit: Më kujtohet si sot, në drekën zyrtare, kur u ulëm në tryezë, ai m'u drejtua me të qeshur: «*Shih ç'pona bëjnë!*»! Dimitrovi kishte në duart e tija më tepër se një duzinë lugë e pirunë të ndryshëm që i kishin vënë përpara, sipas etiketës. Dhe pa ja vënë aspak veshin «të famshmit» protokoll i thotë garsonit: «*M'i pastro këtej, se na mjafton vetëm një lugë, një pirun dhe një thikë dhe jo njëzet copë.*»

Me sa gëzim shoku Dimitrov më prezantoi me stakanovistët bullgarë. «*Këta janë mburrja e popullit bull-*

gar, e klasës punëtore bullgare» — më tha Dimitrovi. Ata i mbajti vazhdimisht afër, i njihte një për një, me emër, bisedoi gjerë e gjatë me ta. I pyeste për punën e tyre, për normat, për jetën dhe për shëndetin e familjeve të tyre. S'kishte lumturi më të madhe për stakanovistët bullgarë kur bisedonin me udhëheqësin e tyre të dashur; fytyrat e tyre ndritnin nga gëzimi. «Hajde — u tha Dimitrovi — të heqim një valle popullore, për miqësinë e pavdekshme me popullin shqiptar». Dhe vallja filloi. Shoku Dimitrov, i gëzuar, i qeshur, këndonte, kërcente. U ndez e gjithë salla nga gëzimi.

Çlodhemi pak shoku Dimitrov? — i thashë i shqetësuar për shëndetin e tij. Ai m'u përgjegj: «S'jam aspak i lodhur sonte, shoku Enver, e ndjej veten sikur jam i ri, pse jam shumë i gëzuar për popullin shqiptar dhe për popullin tim që u lidhën për jetë në një miqësi kaq të ngushtë».

Kur mbaruam vallen, një diplomat i perëndimit i tha Dimitrovit: «Shumë i gëzuar jeni sonte zoti Dimitrov». Dimitrovi ju përgjegj zjarr për zjarr: «Jam i gëzuar për popullin shqiptar që shpëtoi përgjithmonë nga robëria dhe intrigat e armiqve të tij».

«E mori edhe ai përgjegjen — më tha Dimitrovi kur u larguam — e kërkoi si breshka te nallbani. Më ngrihen nervat — vazhdoi ai — kur dëgjoj të më thonë «zotni». E urrej këtë fjalë me të gjitha forcat e shpirtit tim».

Disa herë shoku Dimitrov na mori në shtëpinë e tij ku dukej një thjeshtësi shembullore. Mobiljet ishin të thjeshta dhe popullore bullgare. Në dhomën ku vamë.

të binin menjëherë në sy libra dhe libra, në mure portretet e Leninit e të Stalinit, fotografi të Stalinit tok me Dimitrovin në Moskë, në Kremlin, në Mauzoleumin e Leninit. Ai mori dy libra nga rafti dhe u ul në tryezën e tij të punës. Këto ishin botimet e fundit të veprave të zgjedhura të tija. Shkroi mbi to për mua dhe m'i dhuroi. Këto libra i ruaj si thesarë shumë të çmuar nga i shtrenjti Gjergj Dimitrov.

Gëzimi i popullit shqiptar ishte i papërshekruar kur mori dijeni për nënshkrimin e Traktatit të miqësisë, të bashkëpunimit dhe të ndihmës reciproke në mes të dy popujve tanë. Vendi ynë në ato ditë ishte në festë, populli brohoriste për Stalinin e madh, për Gjergj Dimitrovin, për popullin sovjetik dhe bullgar. Forcat, besimi, guximi në luftë për ndërtimin e vendit ju dhjetëfishuan popullit tonë. Ai e ndjente veten të sigurtë, ai s'mund të ishte ekonomikisht i izoluar as politikisht. Më kot çdo ditë monarko-fashistët, fashistët e Romës provokonin në kufitë tanë, më kot anglezët dhe amerikanët organizonin komplete dhe sabotazhe brenda vendit tonë dhe me karakter ndërkombëtar. Më kot grupi i Titos dhjetëfishonte përpjekjet e tija për të minuar Partinë dhe Republikën tonë Popullore. Partia dhe populli ynë qëndronin si një shkëmb graniti, luftonin kundër të gjithë këtyre ujqërve dhe fitonin, pse ata kishin mbrojtjen e fuqishme dhe fitimtare të Stalinit, pse ata kishin mik të shtrenjtë Gjergj Dimitrovin, gjithë popujt e vendeve të demokracisë popullore dhe njerëzit paqedashës e përparimtarë në botë. Populli ynë kishte dhe ka miq popujt vëllezër të Jugosllavisë, të Greqisë, të Italisë, që vuajnë nën thundrën e imperia-

listëve dhe agjentëve të tyre, por që luftojnë me heroizëm për çlirim.

Më 2 korrik 1949, një hidhërim i madh mbuloi zemrat tona: radio Moska lajmëronte vdekjen e të madhit Gjergj Dimitrov. Vdekja e Dimitrovit ishte një humbje e madhe për popullin bullgar, për klasën punëtore bullgare, për proletariatin e përbotshëm, i cili humbi një marksist-leninist të shquar. Populli shqiptar humbi mikun e dashur e të shquar të tij. Popullit dhe Partisë sonë u pikëlloi në zemër kur mësuan lajmin e hidhur të vdekjes së shokut Dimitrov. Për tri ditë rresht populli ynë mbajti zi, flamuret u ngritën në të katër anët e vendit në gjysmështize për të nderuar kujtimin e Gjergj Dimitrovit. Përfaqësuesit e klasës sonë punëtore e të masave punonjëse, të pikëlluar nga kjo humbje e madhe kalonin në Legatën Bullgare në Tiranë për të shprehur ngushëllimet. Partizanë të vjetër shqiptarë, të regjur në luftëra, kalonin përpara portretit të Dimitrovit të rrethuar me shirit të zi dhe qanin për mikun e tyre të madh, për nxënësin dhe shokun e Stalinit.

Dimitrovi nuk rron më. Por ai rron dhe do të rrojë i paharruar në shekuj në zemrat e njerëzve të thjeshtë të të gjithë botës. Dashuria e Dimitrovit, lufta e tij për klasën punëtore, për masat punonjëse të të gjithë botës, vendosmëria dhe heroizmat e tij për mbrojtjen e marksizëm-leninizmit, për mbrojtjen e socializmit dhe të komunizmit frymëzojnë sot dhe do të frymëzojnë në të ardhshmen me miliona e me miliona njerëz që luftojnë për paqen e socializmin, nën udhëheqjen e lavdishme të Stalinit.

Populli shqiptar dhe populli bullgar i shtërngojnë

çdo ditë e më fort radhët e tyre dhe krah për krah e të pandarë ata ecin në rrugën e lumturisë, në rrugën e socializmit. Ne, komunistët shqiptarë si dhe ata bullgarë, porosinë e Gjergj Dimitrovit, për të forcuar miqësinë dhe dashurinë në mes të popujve tanë, do ta zbatojmë në jetë dhe s'do të ketë forcë që të na pengojë në këtë rrugë. Në të dy vendet tona po ndërtohen me sukses bazat e socializmit, jeta lulëzon. Popujt çdo ditë që kalon shikojnë në jetë saktësinë dhe drejtësinë e ideve të pavdekshme të Leninit e të Stalinit, për të cilat luftoi deri në momentin e fundit të jetës së tij Gjergj Dimitrovi. Ne, nxënësit e tij, do të ndjekim me besnikërinë më të madhe rrugën dhe mësimet e tij.

Populli shqiptar dhe Partia e Punës, ndjekin me gëzim dhe admirim të madh përparimet dhe sukseset që korr populli vëlla bullgar në ndërtimin e socializmit, nën udhëheqjen e Partisë motër Komuniste Bullgare e të Komitetit Qendror të saj...

Partitë tona punëtore, popujt tanë vëllezër, duke mbajtur kurdoherë lart flamurin e internacionalizmit proletar, duke çelnikosur çdo ditë e më tepër dashurinë për mikun e lavdishëm të popujve tanë, për mësuesin dhe udhëheqësin tonë, Stalinin e madh, do të ecin përpara, kurdoherë përpara, në rrugën e socializmit dhe të paqes, ashtu si na ka mësuar e si na ka lënë porosi i shtrenjti dhe i pavdekshmi, Gjergj Dimitrovi.

*Botuar për herë të parë në librin  
«Gjergj Dimitrovi — personalitet i shquar i lëvizjes punëtore  
ndërkombëtare». Sofje, 1952*

*Botohet sipas origjinalit që  
gjendet në Arkivin Qendror  
të Partisë*

**MESAZH DREJTUAR SHOKUT KIM IR SEN  
KU SHPREHET SOLIDARITETI ME LUFTËN  
E POPULLIT KOREAN KUNDËR  
AGRESIONIT AMERIKAN**

**28 korrik 1950**

**SHOKUT KIM IR SEN  
KRYETAR I KABINETIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS  
DEMOKRATIKE POPULLORE TË KORESË**

*Ph e n i a n*

Qeveria e Republikës Popullore të Shqipërisë, që kam nderin të kryesoj, e indinjuar thellësisht për aktin barbar të ndërmarrë nga qeveria e Shteteve të Bashkuara kundër Republikës Demokratike Popullore të Koresë, duke u bërë interprete e ndjenjave të zjarra të dashurisë që ushqen populli shqiptar për popullin mik korean, shpreh simpatinë e thellë dhe solidaritetin e saj dhe të mbarë popullit shqiptar ndaj luftës heroike të popullit trim korean për çlirimin, bashkimin dhe pavarësinë e tij kombëtare.

Ndërhyrja brutale e Shteteve të Bashkuara kundër Republikës Demokratike Popullore të Koresë, nuk është vetëm goditja më e poshtër kundër popullit liri-dashës korean, por ajo shënon njëkohësisht një agresion të hapët kundër forcave progresiste të kampit të madh dhe të fuqishëm të paqes, ajo është krimi më i rëndë kundër paqes në botë. Qeveria e Shteteve të Bashkuara, duke ndërhyrë ushtarakisht me forcat e saja tokësore, detare dhe ajrore, është plotësisht përgjegjëse kundrejt mbarë njerëzimit për të gjitha pasojat e këtij akti të poshtër kriminal, që përbën një shkelje flagrante të parimeve themelore mbi të cilat bazohet Organizata e Kombeve të Bashkuara.

Sulmi tradhëtar i forcave të armatosura të Shteteve të Bashkuara në Kore, bombardimet e tyre kriminale kundër popullit të pafajshëm korean, kanë ngjallur urrejtje të thellë në gjithë popullin shqiptar, i cili bashkohet sot më tepër se kurrë me popullin liri-dashës korean në luftën e drejtë që ai bën për çlirimin e tij kombëtar. Populli shqiptar që ka vuajtur tmerret e luftës dhe një mirë imperializmin grabitqar amerikano-anglez dhe veglat e tija, çmon pa masë dhe ndjek me admirim të thellë e vëmendje të pandërprerë sukseset e mëdha që korr ushtria popullore koreane në luftën e saj heroike për çlirimin dhe bashkimin kombëtar, për fitoren e Republikës Demokratike Popullore të Koresë dhe për mbrojtjen e kauzës së shenjtë të paqes në botë.

Populli shqiptar së bashku me qindra miliona njerëz të kampit të madh të paqes, që ka në krye Bashkimin e lavdishëm Sovjetik dhe udhëhiqet nga Stalini i madh, qëndron krah për krah me popullin hero të Koresë. Ai,

nën udhëheqjen e Partisë së Punës të Shqipërisë dhe të qeverisë së tij, do të shumëfishojë përpjekjet e tija për mbrojtjen e paqes, për ndërtimin e bazave të socializmit në vendin e tij, për forcimin e kampit të paqes duke kontribuar kështu aktivisht në luftën për çlirimin kombëtar të popullit korean.

Qeveria e Republikës Popullore të Shqipërisë, njëzëri me popullin shqiptar, solidarizohet me protestat e mbarë popujve përparimtarë të botës kundër këtij akti barbar fashist të imperializmit amerikan dhe kërkon pushimin e ndërhyrjes së imperializmit dhe tërheqjen e menjëhershme të trupave skllavëruese amerikane.

Rroftë populli heroik demokratik i Koresë!

Kryetari i Këshillit të Ministrave të  
Republikës Popullore të Shqipërisë  
Gjeneral-Armate

*Enver Hoxha*

*Botuar për herë të parë në gazetën «Zëri i Popullit», Nr. 182 (571), 28 korrik 1950*

*Botohet sipas tekstit të gazetës «Zëri i Popullit», Nr. 182 (571), 28 korrik 1950*



# SUKSESET E REPUBLIKËS POPULLORE TË SHQIPËRISË<sup>1</sup>

11 gusht 1950

Republika Popullore e Shqipërisë i është mirënjohëse Bashkimit Sovjetik dhe Ushtrisë Sovjetike famëmadhe, sepse me luftën e tyre legjendare u bënë faktori vendimtar i jashtëm për çlirimin përgjithmonë të popullit shqiptar nga skllavërimi i rëndë shekullor i imperialistëve të ndryshëm dhe i shërbëtorëve të tyre, nga feudalët gjakpirës, si edhe nga skllavërimi i nazizmit gjerman dhe i fashizmit italian. Pa luftën heroike të popujve sovjetikë kundër ushtrisë hitleriane nuk mund të kishte liri të vërtetë e të sigurtë për popullin shqiptar dhe as që mund të bëhej fjalë për një regjim demokratik popullor në vendin tonë siç e kemi sot. Kjo vërtetohet nga e kaluara e trishtuar dhe nga e tanishmja e shkëlqyer e popullit shqiptar.

Ne, shqiptarët, jemi një popull i vogël i Gadishullit Ballkanik, një nga popujt më të vjetër të Evropës, por edhe një nga ata që kanë vuajtur më shumë. Vendi ynë

---

<sup>1</sup> Ky artikull i është dërguar redaksisë së gazetës «Për një paqe të qëndrueshme, për një demokraci popullore», e cila e ka botuar me të njëjtin titull.

është plot male të larta, që në dimër janë mbuluar me dëborë dhe në verë, në kullotat e tyre plot gjelbërim kullosin bagëtitë. Këto male të larta kanë shpëtuar popullin tonë nga shfarosja. Ato kanë qenë kështjella mbrojtjeje të përhershme të popullit tonë kundër invadorëve të panumërt dhe të egër. Në Shqipërinë tonë ne kemi gjithashtu fusha prej të cilave më të mëdhatë shtrihen gjatë bregdetit Adriatik. Prej andej, nga Perëndimi, gjatë shekujve më të largët deri në Luftën e dytë botërore kanë ardhur invadorët kryesorë që janë orvatur të skllavërojnë popullin tonë të vogël, ta shfarosin dhe ta pushtojnë atdheun e tij të shtrenjtë. Prej andej kanë ardhur legjionet e Romës<sup>1</sup>; përmes atdheut tonë kalonte rruga e quajtur Via Egnatia<sup>2</sup>; qytete bregdetare të vendit tonë kanë qenë pushtuar nga barbarët, nga venecianët dhe të tjerë. Por, as legjionet romake as sulmet e barbarëve dhe as piratët e Venedikut nuk e kanë mposhtur popullin tonë, ato nuk kanë mundur, as ta zhdukin dhe as ta asimilojnë. Ai i ka luftuar ato në malet e veta, duke e çuar luftën kundër tyre deri në strofkën e Romës dhe të Venedikut. Por fatkeqësitë e popullit tonë nuk mbaruan. Gjatë pesë shekujve me radhë ai është dërgjur nën thundrën e tmerrshme e të rëndë të sulltanëve të Stambollit. Populli shqiptar nuk i ka dorëzuar kurrë armët në luftën kundër këtij pushuesi gjakpirës. Gjatë 25 vjetëve me radhë ai luftoi

1 Në gjysmën e fundit të shekullit të parë para erës së re, 8-12 legjione romake sulmuan dhe shtrinë sundimin romak për një kohë të gjatë edhe në Iliri.

2 Rruga kryesore dhe më me rëndësi e Ilirisë së Jugut, që nisej nga Durrësi dhe Apollonia dhe arrinte deri në Bizant.

heroikisht me Skënderbeun në krye dhe mundi një rën pas tjetrës të gjitha ushtritë e sulltanëve. Ai u bë mbrojtësi i Evropës nga pushtimi otoman. Pas vdekjes së Heroit tonë Kombëtar, Skënderbeut, Perandoria Otomane sundoi në vendin tonë në mënyrën më mizore. Por fshatarësia jonë nuk ju nënshtrua shfrytëzimit dhe shtypjes. Në vitet 1500, 1538, 1580, në krahinat e Himarës<sup>1</sup>, të Mirditës dhe të Dukagjinit, fshatarët u ngritën kundër feudalëve dhe turqve. Në shekujt e mëvonshëm u ngritën fshatarët e Shqipërisë së Jugut kundër otomanëve dhe shërbëtorëve të tyre. Ata luftuan për tokën duke pasur në krye Zylyftar Podën, Zenel Aga Gjolekën, Rrapo Hekalin etj. Në fund të shekullit të 19-të dhe në fillim të shekullit të 20-të, fshatarësia e varfër u ngrit përsëri kundër feudalëve në Dibër dhe në Kosovë, në Tiranë dhe në Elbasan, kundër princit kukull gjerman, Vidit, feudalëve Esat Pashë Toptanit, Shefqet Bej Verlacid etj.

Populli shqiptar mori pjesë aktive në luftërat ballkanike, ai i bashkoi përpjekjet e veta me ato të popujve të tjerë të Ballkanit që luftonin për t'u çliruar nga zgjedha turke, ai i ndihmoi këta popuj, derdhi gjakun e vet, pësoi humbje në njerëz, u dogj, por nuk mundi ta fitojë lirinë e vet. Imperialistët gjermanë, francezë, anglezë e amerikanë, jo vetëm që nuk i njohën asnjë të drejtë, por edhe e copëtuan. Mjerimet e popullit tonë vazhduan gjatë dhe pas Luftës së parë botërore. Vendi ynë u pushtua përsëri nga austriakët, italianët, france-

---

<sup>1</sup> Në atë kohë krahina e Himarës përfshinte Himarën, Kurveleshin, Tepelenën dhe luginën e lumit të Vlorës.

zët, serbomëdhenjtë, grekët e «Megaliidhesë» (Idea e madhe helenike). Popullit shqiptar ju desh të luftonte kundër të gjithë këtyre ujqërve imperialistë që e kishin bërë një monedhë shkëmbimi. Ai luftoi kundër italianëve në Vlorë më 1920 dhe i hodhi në det, shporri ushtrinë greke që donte të pushtonte pjesën jugore të atdheut të tij, ai luftoi kundër francezëve që donin të mbanin Korçën, shpëtoi nga kthetrat e Karagjorgjeviçëve dhe nga intrigat e Austro-Hungarisë. Por Shqipëria, një i ashtuquajtur shtet i pavarur nuk mundi t'u shpëtojë fatkeqësive dhe intrigave të imperialistëve. Këta sollën në pushtet xhelatin e popullit shqiptar, feudalit Ahmet Zogu, i cili e shpalli veten mbret i Shqipërisë dhe për 15 vjet me radhë shtypi në mënyrë barbare popullin shqiptar në interes të imperialistëve anglezë, amerikanë dhe më në fund të Musolinit, padroni i tij i parafundit, të cilit i shiti krejt Shqipërinë duke përgatitur pushtimin më të egër që ka njohur vendi ynë, pushtimin e 7 prillit 1939 dhe të gjitha pasojat e tjera të Luftës së dytë botërore. Siç shihet, populli shqiptar nuk ka pasur kurrë fatin të buzëqeshë. Ai ka luftuar kurdoherë për lirinë dhe për pavarësinë, por gjithmonë ka humbur, sepse ishte pa mbrojtje, sepse ishte në mëshirën e imperialistëve, sepse popujt vuanin nën çizmen e imperialistëve. Revolucioni i madh i Tetorit çau errësirën që mbulonte botën. Në Rusi lindi dielli i ndritur për njerëzimin. Partia e bolshevikëve nën udhëheqjen gjeniale të Leninit krijoi shtetin e fuqishëm të punëtorëve dhe të fshatarëve të varfër dhe vendosi në një të gjashtën e botës pushtetin e sovjetëve. Vetëm pas këtij revolucioni u krijuan kushtet që populli shqiptar dhe të gjithë po-

pujt e botës të fitojnë lirinë, pavarësinë dhe të drejtat demokratike. Bashkimi Sovjetik dhe Stalini janë garancia, mbrojtësit dhe përkrahësit e mëdhenj të popullit tonë që ndërton bazat e socializmit në vendin e vet, që ecën me hapa të mëdhenj dhe të sigurtë në rrugën e ndritur të socializmit, të lumturisë dhe të begatisë.

Regjimi gjakpirës i Ahmet Zogut ishte regjimi i kapitullimit pa kushte ndaj ndërhyrjes së jashtme imperialiste, ai ishte sundimi i klasës feudalo-borgjeze të shtypësve, shfrytëzuesve, shërbëtorëve besnikë të imperialistëve. Shqipëria, nën këtë regjim barbar, ishte një fushë intrigash e imperialistëve të ndryshëm për shkak të pozitës strategjike në Adriatik dhe në kanalin e Otrantos, si dhe për qëllimet e shfrytëzimit ekonomik të pasurive të tokës dhe nëntokës së saj. Regjimi i Zogut ua shiti anglezëve dhe sidomos «Anglo-Persian Oil kompani» të gjithë monopolin e shfrytëzimit të naftës dhe ministri i Anglisë në Shqipëri, Sir Robert Hoxhson, bënte ligj në vendin tonë. Oficerë të lartë anglezë drejtonin dhe organizonin xhandarmërinë, duke mbajtur kështu në dorë kamxhikun, prangat e burgjeve dhe litarin për të shtypur popullin shqiptar. Më 1932, anglezët ua shitën koncesionet e tyre në Shqipëri fashistëve italianë dhe më 1939 Çambërlejni i la krejt dorë të lirë Musolinit për të bërë agresionin e armatosur të 7 prillit. Regjimi i Ahmet Zogut ua la derën të hapur në dy drejtime amerikanëve për të bërë ç'të donin në Shqipëri. Ai ua shiti shoqërive amerikane pasuritë e popullit tonë, i shiti «Standard Oil kompani of Nju Jork», 51 000 hektarë tokë për 30 000 dollarë. Zogu, gjithashtu, ua hapi portën agjentëve të spiunazhit ameri-

kan, të cilët erdhën në Shqipëri nën maskën e misio-  
narëve si Kenedi, të filantropëve dhe edukatorëve si  
Erikson, si Herri Fulc, kuadër i rëndësishëm i zbulimit  
amerikan e armik i betuar i popullit shqiptar dhe shumë  
të tjerëve, që luajtën një rol të ndyrë kundër pavarësisë  
dhe lirisë së popullit shqiptar deri kohët e fundit. Më  
vonë Ahmet Zogu u bë vasal dhe agjent i Musolinit.  
Brenda pak kohe, me anë të marrëveshjeve ekonomike  
dhe financiare dhe me traktate të ndryshme aleance,  
Italia fashiste hodhi dorë mbi të gjitha pasuritë e ve-  
ndit tonë, mbi të gjitha pozitat kyçe strategjike, mbi të  
gjitha postet e komandimit të shtetit, të ushtrisë, të po-  
licisë. Tregëtia, bujqësia, blegtoria, pyjet, minierat, fi-  
nancat, postat, komunikacionet, portet, aeroportet, gji-  
thshka u bënë pronë e fashistëve italianë, të cilët e  
mbushën vendin tonë me kolonë italianë dhe, më në fund,  
e pushtuan ushtarakisht Shqipërinë, më 7 prill 1939.

Mjerimi i popullit shqiptar ishte shumë i madh.  
Në regjimin e Zogut ekzistonin marrëdhënjet feudale  
në bujqësi, toka nuk i përkiste fshatarit punonjës, por  
beut, agait dhe pronarëve të tokave të mëdha. Bujku  
ishte, në tërë kuptimin e fjalës, një skllav bashkë me  
familjen e vet. Ai ishte në mëshirën e padronit, kasollja  
nuk ishte e tij, kafshët e punës i përkisnin beut, sikurse  
edhe prodhimet. Ai shtypej nga taksat më të rënda,  
vuante nga uria, nga sëmundjet, për atë nuk kishte  
shkolla dhe rronte në një padije të madhe. Punëtorët  
shqiptarë vuanin shumë nga shfrytëzimi i punëdhënës-  
ve dhe i koncesionarëve italianë. Industria pothuajse  
nuk ekzistonte fare. Shfrytëzimi i naftës dhe i disa mi-  
nierave bëhej nga italianët. Punëtorët shqiptarë punonin

si skillever 16 orë në ditë e më shumë për një pagë ditore që nuk mjaftonte t'u siguronte edhe ushqimin e përditshëm. Familjet e tyre vuanin nga uria dhe nga tuberkulozi. Mjerimi i popullit tonë arriti kulmin në kohën e pushtimit të vendit nga fashizmi italian.

Populli shqiptar, i cili nuk e kishte duruar kurrë zgjedhën dhe skllavërimin gjatë historisë së tij shekullore, edhe kësaj radhe rroku armët dhe filloi luftën më të ashpër që ka bërë, por në të njëjtën kohë, luftën më të lavdishme, që i solli lirinë e ëndërruar gjatë shekujve. Kësaj radhe, populli shqiptar ishte i sigurtë për fitoren e vet të plotë, sepse ai kishte përkrah Bashkimin e madh Sovjetik që drejtohej nga gjeniu më i madh i kohës, Stalini i madh. Populli shqiptar e filloi Luftën nacional-çlirimtare duke shikuar me besim të patundur drejt Lindjes, nga Kremlini. Andej pritej fitorja e madhe, andej do të vinte shpëtimi i gjithë njerëzimit nga hordhitë nazi-fashiste.

Fati i popullit tonë ishte në rrezik gjatë Luftës së dytë botërore, prandaj duhej organizuar mirë lufta dhe ky organizim duhej bërë nga Partia jonë Komuniste heroike, e cila u krijua në zjarrin e luftës dhe në bazë të mësimëve të mësuesve të mëdhenj të proletariatit Marksit-Engelsit-Leninit e Stalinit. Vetëm Partia Komuniste e Shqipërisë, pararojë e çelniqtë e klasës punëtore dhe e fshatarëve të varfër të vendit tonë, parti e tipit Lenin-Stalin, do të mobilizonte të gjithë popullin, siç e mobilizoi dhe e drejtoi në fitoren e plotë mbi fashistët italianë e gjermanë dhe mbi kuislingët të cilët grumbulluan rreth tyre klasat sunduese të vendit, të organizuara në organizatat reaksionare «Balli Kombë-

tar», «Legaliteti» zogist etj. Këto organizata, që u vunë krejt në shërbim të pushtesit, përfaqësonin reaksionin shqiptar, bejlerët, çifligarët e mëdhenj, agallarët, tregëtarët e mëdhenj dhe të gjithë spekulatorët dhe politikantët me njëqind flamurë në xhep, të cilët gjatë gjithë jetës së tyre kishin bërë pazarllëk me interesat e popullit dhe të atdheut.

Krahas fitoreve të lavdishme të Ushtrisë Sovjetike në Lindje, lëvizja nacional-çlirimtare në vendin tonë mori përpjesëtime të gjera. Ushtria jonë Nacional-Çlirimtare, e krijuar në zjarrin e luftës dhe e përbërë krejt nga bij të punëtorëve dhe të fshatarëve punonjës, e drejtuar dhe e komanduar nga ata, nën udhëheqjen e Partisë Komuniste, u bë një forcë e madhe, që mundi vazhdimisht forcat e pushtesve dhe të kuislingëve, që përballoi me sukses ofensivat e tyre të njëpasnjëshme dhe që doli ngadhnjimtare në çdo betejë, sado të përgjakshme. Krahina të tëra u çliruan. Armiku nën zjarrin e ushtrisë popullore, u tërhoq në qytete nga ku u dëbua më në fund pas luftimesh të përgjakshme. Shqipëria u çlirua më 29 Nëntor 1944. Në këtë kohë armatat sovjetike shpërthyen sulmin kundër gjermanëve në Ballkan dhe, megjithëse nuk erdhën në Shqipëri, ndihmuan në fitoren e popullit tonë mbi fashizmin.

Gjatë Luftës nacional-çlirimtare u hodhën themelet e pushtetit popullor, në formën e këshillave popullore, që u zgjodhën në mënyrë demokratike nga populli në krahinat e çliruara, si edhe në krahinat e pushtuara, të cilat u bënë, qysh atëhere, organe të pushtetit dhe ndihmëse të Luftës nacional-çlirimtare. Ato zëvendësuan pushtetin e vjetër që u shkatërrua prej theme-



lit në zonat e çliruara dhe në të gjithë Shqipërinë. Kështu, qysh me çlirimin e plotë të Shqipërisë, këshillat popullore ishin krijuar kudo, në qytete e në fshatra dhe u bënë organet drejtuese të pushtetit popullor.

Në Luftën nacional-çlirimtare populli shqiptar derdhi gjak dhe bëri sakrifica të mëdha, por ato s'i shkuan kot, liria ë kërkuar prej shekujsh u fitua. Populli e mori pushtetin në duart e veta dhe vendosi diktaturën e demokracisë popullore. Nën udhëheqjen e çelniktë të Partisë së tij Komuniste dhe i grumbulluar në Frontin Nacional-Çlirimtar, populli shqiptar, me luftën e vet dhe në saje të fitores së Bashkimit Sovjetik dhe të Ushtrisë Sovjetike të lavdishme mbi hitlerianët, mundi pushtuesit dhe reaksionin e brendshëm. Partia Komuniste e Shqipërisë, e udhëhequr nga eksperiencia e Partisë së lavdishme Bolshevike dhe nga mësimet e Leninit dhe të Stalinit, qëndroi gjithnjë vigjilente ndaj manevrave dhe makinacioneve të reaksionit të brendshëm dhe të imperialistëve anglo-amerikanë, të cilët qysh në kohën kur populli ynë derdhte gjakun e tij dhe kur bijtë e tij më të mirë sakrifikonin jetën e tyre në fushat e betejës, bënë intriga dhe organizonin reaksionin e brendshëm për t'i rrëmbyer nga duart popullit shqiptar fitoret e tija.

Misionet ushtarake angleze dhe amerikane, nën maskën e të ashtuquajturve aleatë, u përpoqën të shtypnin revolucionin popullor, të shkatërronin Ushtrinë Popullore, të pushtonin vendin nën pretekstin e bashkëpunimit kundër gjermanëve. Ata u bashkuan me kuislingët, i ndihmuan ata me armë, i ndërsyen kundër Ushtrisë Popullore, i nxitën të vrisnin njëz të popu-

llit dhe të digjnin vendin, bashkëpunuan me pushtuesit gjermanë dhe më në fund, në prakun e çlirimit të Shqipërisë, misionet angleze dhe amerikane, pasi dësh-tuan në synimet e tyre, morën nën mbrojtje të gjithë kriminelët gjakpirës të luftës dhe i çuan në Itali për t'i përdorur më vonë kundër Republikës Popullore të Shqipërisë. Partia jonë Komuniste dhe populli shqiptar i zhduku të gjitha planet djallëzore të imperialistëve amerikanë dhe anglezë. Por me gjithë disfatat që pë-suan gjatë luftës në Shqipëri, ata nuk i dorëzuan armët, përkundrazi, filluan të organizonin, më vonë, komplete që kishin për qëllim të përmbysnin pushtetin popullor në Shqipëri. Por edhe këto komplete dhe akte terroriste që ata ndërnuarën, u asgjësuan dhe dështuan me turp nën goditjet e pushtetit popullor.

Në prakun e çlirimit të Shqipërisë, Partia jonë Komuniste dhe pushteti popullor u ndodhën përballë detyrave të rëndësishme dhe të vështira, por që u kryen me sukses, me entuziazmin dhe me heroizmin e papërshkrueshëm të klasës sonë punëtore dhe të të gjitha masave punonjëse të vendit. Reforma të mëdha ekonomike, kulturele dhe shoqërore u bënë qysh në muajt e parë pas çlirimit të atdheut tonë. Organet administrative qendrore dhe lokale të pushtetit popullor u organizuan dhe u forcuan. U bë pastrimi rrënjësor i mbeturinave të fashizmit dhe të reaksionit. U gjykuan me rreptësinë që meritonin kriminelët e luftës dhe u konfiskuan e u shtetëzuan të gjitha pasuritë e tradhëtarëve e të kuislingëve, u konfiskuan pasuritë e panumërta të tregëtarëve të mëçhenj spekulatorë, të cilët u detyruan të pa-

guanin tatimet mbi fitimet e luftës<sup>1</sup> dhe u shtetëzuan të gjitha fabrikat e ndërmarrjet e tregëtarëve dhe të industrialistëve spekulatorë. U dëbuan nga tokat bejlerët dhe agallarët, të cilët gjatë shekujve kishin shtypur fshatarin punonjës dhe u zbatua reforma agrare. Pushteti popullor shtetëzoi të gjitha minierat dhe ndërmarrjet, që italianët dhe të huaj të tjerë kishin marrë në koncesion. Në këtë mënyrë u krijua sektori ekonomik shtetëror mbi të cilin u mbështet pushteti ynë për të rindërtuar vendin e shkatërruar. Krahina të tëra u dogjën, popullsia banonte jashtë pa strehë dhe nuk kishte asgjë për t'u mbuluar. Ushqimet mungonin, bujqësia ishte shkatërruar, urat ishin hedhur në erë, rrugët ishin shkatërruar, komunikacionet pothuajse nuk ekzistonin fare. Nën udhëheqjen e urtë dhe të vendosur të Partisë dhe të qeverisë, u rindërtua në një kohë shumë të shkurtër çdo gjë që ishte shkatërruar nga lufta. Përpjekje të jashtzakonshme u bënë nga populli ynë, i cili u mobilizua i tëri në veprën e rindërtimit dhe punoi me heroizëm të paparë në historinë e popullit tonë. Në pararojën e rindërtimit të atdheut ndodhej klasa jonë punëtore, rinia heroike e Shqipërisë, fshatarësia punonjëse, masat e gjera të grave dhe intelektualët patriotë.

---

<sup>1</sup> Më 13 janar 1945 kryesia e KANÇ-it aprovoi ligjin Nr. 37 «Mbi tatimet e jashtëzakonshme për fitimet e luftës» (Gazeta zyrtare Nr. 3, f. 5, viti 1945), sipas të cilit tatoheshin të gjithë tregëtarët dhe industrialët e vendit tonë, që gjatë kohës së pushtimit fashist kishin realizuar fitime përmbi 500 000 franga shqiptare. Tatimet ishin progresive prej 15-80 për qind të shumës së fituar përmbi 500 000 frangat.

Reforma agrare, rëndësia e së cilës ishte jashtëzakonisht e madhe për fshatarësinë tonë punonjëse, ishte një nga veprat e para të pushtetit popullor. Revolucioni popullor i dha fund mjerimit dhe varfërisë së fshatarëve. Me luftë u përmbys klasa feudalo-borgjeze. Qysh gjatë luftës, Partia shpalli me zërin e saj të fuqishëm, se regjimi shfrytëzues i bejlerëve dhe i agallarëve, ishte përmbysur, se ata nuk duhej të njiheshin më si pronarë të tokave dhe as t'u jepeshin më nga fshatarësia borxhet dhe tatimet. Fshatarësia punonjëse nën udhëheqjen e klasës punëtore dhe të pararojës së saj, Partisë së Punës, filloi menjëherë luftën për të drejtat e saja dhe triumfoi. Si pasojë e reformës agrare, 70 211 familje të varfëra dhe pa tokë muarën tokë. Pushteti popullor, në bazë të ligjit të reformës agrare ndau 320 000 hektarë tokë. Reforma agrare u realizua në një kohë shumë të shkurtër, gjë kjo që i habiti dhe i çoroditi armiqtë, të cilët përpiqeshin ta sabotonin këtë vepër të madhe të pushtetit popullor. Zbatimi i reformës agrare e zhduku feudalizmin, krijoi kushtet e kalimit më vonë nga ekonomitë e vogla individuale në ekonomitë kooperativiste, ajo krijoi në bujqësi kushtet për përmirësimin dhe modernizimin e saj, kushte të domosdoshme për zhvillimin e të gjithë ekonomisë sonë popullore.

\*

\* \*

Prej çlirimit të Shqipërisë deri më sot, Republika Popullore e Shqipërisë ka përparuar me hapa të mëdhenj e të sigurtë në ndërtimin e ekonomisë së saj so-

cialiste dhe në të gjithë sektorët e tjerë. Populli ynë po ndërton bazat e socializmit në vendin e tij dhe kjo është bërë e mundshme edhe në saje të ndihmës që populli shqiptar ka marrë dhe merr nga Bashkimi Sovjetik. Ndihma e Bashkimit Sovjetik ishte shpëtimtare për popullin shqiptar, sepse vendi ynë i varfër, i prapambetur, i djegur dhe i shkatërruar nga lufta ndodhej në një gjendje shumë të vështirë dhe në pamundësi që të rindërtohej dhe të ngrinte mirëqenjen e tij në një kohë kaq të shkurtër. Kjo ndihmë bujare dhe e gjithanshme, ekonomike, morale dhe politike, jo vetëm i dha popullit tonë mundësitë që të ngrinte ekonominë e vet dhe të përmirësonte në shkallë të konsiderueshme nivelin e jetesës së tij, por ajo pati për efekt forcimin e pushtetit popullor në vendin tonë, forcimin çdo ditë më shumë të aftësisë mbrojtëse të vendit tonë për të përballuar e shkatërruar komplotet e rrezikshme që kurdisnin imperialistët anglo-amerikanë dhe kukullat e tyre monarko-fashistët grekë, klika titiste e Beogradit dhe neofashistët e Romës. Ndihma e Bashkimit Sovjetik u muar nga populli shqiptar qysh në vitet e para të pasqllirimit, kur, përveç mjerimeve të mëdha të luftës, thatësira e madhe shkaktoi dëme në drithërat, muhësa e të cilave po bëhej serioze në disa kra-hina.

Disa shifra që përmenden më poshtë tregojnë qartë rezultatet e rëndësishme të arritura nga populli shqiptar në regjimin e demokracisë popullore, në sektorët më të rëndësishëm. Industria e trashëguar nga regjimet feudalo-borgjeze dhe nga pushtuesi përbëhej nga disa fabrika cigaresh, 13 centrale të vogla elektrike termike,

disa punishte të tjera pa rëndësi dhe me një kapacitet shumë të ulët. Italia e Musolinit, qoftë në kohën e regjimit të vasalit të tij Ahmet Zogut, qoftë në kohën e pushtimit, nuk lejoi kurrë zhvillimin e industrisë në vendin tonë, por e quante këtë si një shtojcë agrare të Italisë dhe si një koloni që furnizohej nga tregu italian. Edhe minierat shfrytëzoheshin nga regjimi fashist me mjete të vjetëruara dhe në mënyrë të ngutshme për shkak të nevojës së madhe që ndjente ai në fushën e lëndëve të para për të përgatitur Luftën e dytë botërore. Pas vendosjes së demokracisë popullore në vendin tonë pushteti popullor krijoi 46 ndërmarrje shtetërore me karakter të përgjithshëm, si edhe 13 ndërmarrje me karakter lokal, bëri racionalizimin e industrisë, grumbulloi njësitë e vogla në njësi të mëdha, përmirësoi këto fabrika, i zgjeroi ato duke bërë investime të mëdha.

Le të shqyrtojmë periudhën 1945—1949. Në krahasim me vitin 1945, industria tekstile e rriti prodhimin 1 994,3 për qind, industria e lëkurëve dhe e këpucëve — 2 295,7 për qind, industria e çimentos — 522,2 për qind, industria ushqimore — 186,1 për qind, industria kimike — 359,4 për qind, industria e duhanit — 234,4 për qind, industria e drurit — 962 për qind, industria elektrike — 434,7 për qind etj. Përveç këtyre, industria në Republikën tonë Popullore është duke u zmadhuar dhe për së shpejti ajo do të pajiset me kombinatë të mëdha moderne, që do të na vijnë nga Bashkimi Sovjetik. Këto kombinatë janë: Kombinati i madh i tekstileve «Stalin», që është duke u ndërtuar dhe do të vihet në funksionim aty nga mesi i vitit të ardhshëm. Ky kombinat tekstilësh

me 21 000 boshte do të ketë një kapacitet mbi 20 000 000 metra beze në vit. Ai është duke u mbaruar bashkë me qytetin punëtor, ku po ndërtohen shtëpi moderne, kopshte e klube për punonjësit, numri i të cilëve do të kalojë të 5 000 vetët. Një fabrikë sheqeri, që po ndërtohet në Maliq, është duke marrë fund dhe do të prodhojë 10 000 ton sheqer në vit. Qendra e Maliqit është duke u bërë një vendbanim industrial dhe bujqësor i rëndësishëm. Atje 3 vjet më parë shtrihej kënetat e Maliqit që u tha me punime bonifikimi të ndërmarrë nga pushteti popullor. Toka u lirua nga ujërat pas bonifikimeve të mëdha, sado që amerikanët u përpoqën të sabotonin nëpërmjet kryetarit të misionit amerikan në Tiranë, Herri Fulc, i cili organizonte dhe drejtonte drejtpërdrejt agjentë në shërbim të tyre. Me ndihmën teknike dhe materiale të Bashkimit Sovjetik po ndërtohet afër Tiranës hidrocentrali i Selitës, me një kapacitet të tillë që do të vërë në funksionim të gjithë industrinë e sotme të Tiranës dhe do t'i japë ujë dhe dritë kryeqytetit të Shqipërisë. Pranë kombinatit të tekstileve po ndërtohet një fabrikë tjetër e stofrave të leshta; po ndërtohet një fabrikë e re çimentoje, industria e konservave të mishit, të peshkut, të frutave, punishte qeramike, një fabrikë letre etj. Siç shihet nga këto pak të dhëna, industria, që në vendin tonë pothuajse nuk ekzistonte fare përpara regjimit demokratik popullor, tani është duke marrë një hov dhe populli shqiptar që priste të gjithë artikujt industrialë nga jashtë, shumë nga këto po i prodhon në vend. Kësaj industrie ju shtua edhe artizanati i organizuar në kooperativa, i cili ka marrë një zhvillim të gjerë. Artizanati në vendin

tonë ishte mbytur nga dumpingu<sup>1</sup> italian, kurse tani ai po lulëzon, po zmadhohet, po përmirësohet dhe po bëhet një ndihmës i efektshëm i industrisë sonë të lehtë.

Sektori i minierave që u dëmtua pothuajse krejt nga lufta, u rindërtua nga pushteti popullor dhe u vu në shfrytëzim e shkon duke u përsosur. Ai po zgjerohet e pajiset me mjete moderne që na kanë ardhur nga Bashkimi Sovjetik dhe nga vendet e demokracive popullore.

Le të marrim përsëri periudhën 1945—1949. Në krahasim me vitin 1945, në minierat tona kemi këtë rritje prodhimi: bitumi i pastruar 1 174 për qind, nafta bruto 406,4 për qind, qymyri 557 për qind, minerali i kromit në krahasim me vitin 1948, 287,8 për qind dhe bakri blister, në krahasim me vitin 1946, është rritur në 561 për qind. Megjithëse kemi një rritje të tillë dhe vendi ynë është shumë i pasur në minerale, këto nuk janë shfrytëzuar dhe nuk njihen. Pushteti popullor ka ndërmarrë zgjerimin e minierave, pajisjen e tyre me mjete moderne, zbulimin e pasurive të tjera të mëdha të nëntokës, të cilat do ta shpejtojnë ndërtimin e bazave të socializmit në vendin tonë dhe do të ngrenë mirëqenjen e popullit shqiptar. Klasa jonë punëtore, e cila luftoi me heroizëm dhe me Partinë e saj drejtoi luftën çlirimtare, po punon me vetëmohim të pashembullt për ndërtimin e bazave të socializmit. Klasa jonë punëtore, e paktë në numër, është duke u rritur krahas me zhvi-

---

<sup>1</sup> dumping — (term komercial anglez) praktikë kapitaliste e eksportimit të mallrave me çmime të ulëta që të thyhet konkurenti e të shtihet në dorë tregu i jashtëm.



Ilimin industrial të vendit. Ajo po forcohet, po farkëtohet, po edukohet dhe po fiton eksperiencën e klasës punëtore të Bashkimit Sovjetik. Ajo adopton dhe zbaton metodat sovjetike në punë, ndjek shembullin e lavdishëm të stakanovistëve sovjetikë. Klasa punëtore e Bashkimit Sovjetik e ndihmon klasën tonë punëtore të përvetësojë eksperiencën e lavdishme sovjetike në ndërtimin e socializmit. Na janë krijuar të gjitha mundësitë nga Bashkimi Sovjetik në këtë drejtim. Pas dy-tre vjetësh, qindra bij të punëtorëve dhe të fshatarëve shqiptarë do të kthehen në Shqipëri nga universitetet e Bashkimit Sovjetik. Inxhinierë, agronomë, veterinerë, mjekë, njerëz të diplomuar nga shkollat e larta sovjetike të arteve, të kulturës, të pedagogjisë, të filozofisë etj. do të vijnë për të vënë në shërbim të popullit të tyre dituritë e fituara, shkencën sovjetike të pararojës, të cilat do t'i japin një hov më të madh ndërtimit të bazave të socializmit në vendin tonë.

Krahas me industrinë, po zhvillohet dhe po modernizohet edhe bujqësia jonë. Ajo ka qenë e prapambetur dhe u shkatërrua nga lufta, por në regjimin popullor ajo ka hyrë në rrugën e përparimit. Fshatari ynë tani është bërë zot i tokës dhe është duke plotësuar planet dhe bile po i tejkalon ato. Fshatarët tanë përparimtarë adoptuan menjëherë metodat e reja agroteknike, ata janë pajisur me vegla të reja pune, i kanë zgjeruar tokat që u dha reforma agrare duke hapur toka të reja për drithëra buke, ata po mbjellin e prodhojnë bimë të reja industriale si pambuk, panxhar sheqeri, lule dielli etj.; kanë zhvilluar blegtorinë duke shtuar bagëtinë e trashë e të imtë dhe po luftojnë për përmirësimin e racës së

kafshëve. Pushteti popullor i ka kushtuar rëndësi të madhe zhvillimit të bujqësisë. Ai u ka hapur kredit agrar fshatarëve të varfër, ka krijuar stacione të maqinave dhe të traktorëve, të pajisura me traktorë modernë të ardhur nga Bashkimi Sovjetik, nga uzinat e Stalingradit heroik. Luftëtarët e lavdishëm të Stalingradit u kanë dërguar fshatarëve tanë mjete moderne për të punuar më mirë tokën dhe për të krijuar bollëkun në vendin e tyre. Shteti ka krijuar një sërë stacionesh eksperimentale të zoteknisë dhe shumë stacione riprodhimi në qendrat fshatare. Shteti u jep fshatarëve farëra të ndryshme të seleksionuara. Shteti ka krijuar një numër të madh fermash shtetërore që po bëhen model për fshatarësinë punonjëse, e cila ka krijuar kooperativa fshatare pune, që po zhvillohen e po forcohen dita-ditës. Fshati shqiptar, ku mbretëronte mjerimi, sëmundja, padija, kamxhiku i beut dhe i agait, sot e ka ndryshuar krejt pamjen e vet. Tani atje ka mirëqenje, atje punon traktori, atje ka shkolla, atje është zhdukur përgjithmonë shfrytëzimi, mjerimi, trishtimi. Tani atje mbretëron gëzimi, puna e frutshme, jeta e lumtur. Ja disa shifra që vënë në dukje përparimin në fshatrat tona. Në krahasim me vitin 1945, bonifikimet janë rritur në 168 për qind, sipërfaqja e tokave të punueshme, në krahasim me vitin 1948, është rritur në 148,7 për qind, ndërsa në krahasim me vitin 1947, sipërfaqja e sektorit kooperativist, është rritur 254,9 për qind, pyllëzimet — 6 807 për qind, sipërfaqja e kultivuar e bimëve industriale — 941 për qind dhe punimet me anë të SMT-ve — 519,6 për qind.

Zhvillimi i industrisë dhe i bujqësisë e ka përmirë-

suar shumë jetesën e popullit; kostoja e jetesës në vendin tonë është ulur dhe më 1949 shteti uli çmimet në një sërë artikujsh industrialë. Prodhime bujqësore hidhen në sasi të mëdha dhe me çmime të ulëta në tregun tonë kooperativist, shtetëror e privat. Po forcohet dhe po farkëtohet aleanca midis klasës punëtore dhe fshatarësisë sonë dhe çdo ditë e më tepër po ashpërsohet lufta klasore në fshat e në qytet.

Komunikacionet, në krahasim me gjendjen e mjeshtrësive në regjimet e kaluara kanë bërë përparime të mëdha. U rindërtuan të gjitha rrugët dhe urat, u ndërtuan rrugë të reja. U lidh me hekurudhë Durrësi me Tiranën, me Rogozhinën e me Peqinin dhe tani është duke marrë fund hekurudha që do të lidhë Durrësin me Elbasanin. Janë ndërtuar dhe po ndërtohen mjete të reja të transportit detar që do të shërbejnë në të gjitha portet e bregdetit tonë.

Pushteti popullor i ka kushtuar një rëndësi të madhe shëndetit të popullit, i cili nën regjimet e kaluara vuante nga sëmundje dhe epidemi shumë të rënda. Numri i mjekëve ishte shumë i vogël. Pothuajse nuk ekzistonin fare ndihmësmjekë dhe infermierë. Klasat e pasura ishin të privilegjuara dhe thuajse vetëm ato mjekoheshin nga mjekët. Spitalet ishin fare të paktë dhe me një kapacitet shumë të vogël. Në këto spitale mjekoheshin në radhë të parë e kryesisht të pasurit. Por pas vendosjes së demokracisë popullore çdo gjë ndryshoi në këtë sektor dhe gjatë periudhës 1945—1949 u arritën suksese të mëdha. Tani ka spitale të mëdha shtetërore në të gjitha qytetet kryesore, ambulanca dhe poliambulanca në qytete, spitale rurale në fshatra. Ka-

paciteti i spitaleve shtetërore më 1949 u rrit në 142 për qind në krahasim me vitin 1945. Numri i të sëmurëve, që janë vizituar u rrit në 211 për qind. Janë krijuar çerdhe për fëmijët e punëtorëve, klinika e spitale, ku janë vizituar më se 137 411 gra dhe fëmijë. Po bëhet në shkallë të gjerë një luftë kundër sëmundjeve të ndryshme si tuberkulozit, sifilisit, malarjes, që ishin një fatkeqësi për popullin tonë. Në krahasim me vitin 1938, kur nga malarja prekeshin 60 për qind e popullsisë, më 1949 kjo sëmundje u pakësua në 21,7 për qind.

Në vendin tonë, veçanërisht arësimi dhe kultura kanë arritur përparime të mëdha në krahasim me të kaluarën e errët. Shumica dërmuese e popullit tonë ishte analfabete; arësim fillor dhe arësim të mesëm kishte vetëm një pjesë e bijve të të pasurve. Universitarët në regjimin e Zogut ishin shumë të paktë dhe pothuajse të gjithë ishin të shtresave shoqërore të pasura. Regjimi popullor e bëri arësimin dhe kulturën me karakter masiv. Masat popullore, qysh gjatë luftës mësonin me etje të madhe shkrim e këndim. Pas çlirimit të Shqipërisë u zgjerua në mënyrë të jashtzakonshme rrjeti i shkollave në fshatrat e qytetet dhe në qendrat e punës; shkollat e mesme dhe shkollat shtatëvjeçare u shtuan. U bë reforma arësimore. Mijëra e mijëra bij dhe bija të punëtorëve dhe të fshatarëve ndjekin tani shkollat. Arësimi fillor është i detyrueshëm dhe është realizuar qind për qind. Numri i shkollave, vetëm gjatë periudhës 1948—1949, u rrit në 205 për qind, numri i shkollave shtatëvjeçare — 1 123 për qind, ai i shkollave të mesme — 153,8 për qind dhe ai i nxënësve në këto shkolla u rrit

në 264,2 për qind. Në Shqipëri, ku nuk kishte shkolla të larta, u hap më 1946 Instituti i lartë pedagogjik, të cilit do t'i shtohen, në një të ardhshme të afërme, fakultete të tjera. Shkolla të ndryshme financiare, tregëtare, shkolla për përgatitjen e ndihmësmjekëve, infermierëve, gjeometrave, politeknikume, shkolla bujqësore janë hapur në qendra të ndryshme të Shqipërisë. Qindra të rinj e të reja po mbarojnë universitetet në Bashkimin Sovjetik dhe në demokracitë popullore, qindra të tjerë pranohen çdo vit në këto universitete. Qindra punëtorë shkojnë në Bashkimin Sovjetik dhe në demokracitë popullore për t'u specializuar në degë të ndryshme të ofiçinave dhe të fabrikave. Në regjimet e kaluara, për artet, teatrin, muzikën, skulpturën, baletin, sportet etj. nuk tregohesh asnjë kujdes, ndërsa sot në regjimin e demokracisë popullore, në vendin tonë, ato janë duke lulëzuar dhe po dalin talente popullore të mrekullueshme. Në Shqipëri, tani ekziston Teatri popullor, kurse në qytete të ndryshme ka grupe amatorësh të teatrit. Nga Shkolla e arteve të bukura të Tiranës<sup>1</sup> dalin çdo vit artistë të rinj, muzikantë dhe skulptorë. Në Shqipëri, ku në të kaluarën nuk njihej emri i shtëpive të kulturës, tani janë krijuar 11 shtëpi kulture, 121 shtëpi leximi në fshatra, numri i bibliotekave është rritur në 366 për qind, numri i orkestrave — 377 për qind, ai i koreve — 383 për qind, ai i grupeve teatrale — 1 320 për qind, ai i ansambleve muzikore instrumentale — 133 për qind etj.

---

<sup>1</sup> Shkolla e mesme artistike «Jordan Misja», e cila u çel më 26 dhjetor 1946.

Armiqtë e popullit tonë, të socializmit dhe të paqes, imperialistët amerikanë dhe anglezë dhe banditët e Beogradit e të Athinës, janë përpjekur me të gjitha forcat e tyre për të penguar përparimin e Republikës Popullore të Shqipërisë, për ta luftuar dhe copëtuar atë. Puna e tyre armiqësore ka qenë e vazhdueshme dhe e organizuar. Amerikanët dhe anglezët, duke mos mundur të arrijnë qysh gjatë luftës qëllimin e tyre për të mbajtur dhe për të mbrojtur kuislingët, me anë të përfaqësuesve të tyre në Tiranë, organizuan grupe sabotatorësh, atentatorësh dhe terroristësh tradhëtarë. Por Republika Popullore e Shqipërisë drejtohej nga Partia jonë e çelniktë, e cila asgjësoi planet e rrezikshme të imperialistëve amerikanë dhe anglezë që synonin ta dëmtonin popullin dhe Republikën tonë. Njëra pas tjetrës dëshatuan të gjitha komplotet e tyre si edhe ato të tradhëtarëve shqiptarë që ndiqnin rrugën e tyre. Një sërë procesh gjyqësore u zhvilluan në vendin tonë kundër spiunëve dhe sabotatorëve në shërbim të drejtëpërdrejtë të anglezëve dhe të amerikanëve dhe grushtet e pamëshirshme të popullit tonë asgjësuan veprimtarinë sabotuese dhe diversioniste të anglo-amerikanëve dhe të agjentëve të tyre.

Një luftë e vazhdueshme dhe e poshtër u bë kundër vendit tonë në arenën ndërkombëtare nga ana e imperialistëve amerikanë dhe anglezë, por të drejtat e vendit tonë u mbrojtën me sukses të madh nga miku i madh i popullit tonë, Bashkimi Sovjetik e demokracitë popullore dhe pozita ndërkombëtare e popullit tonë u forcua. Një sërë provokimesh me karakter ndërkombëtar u bënë nga imperialistët amerikanë dhe anglezë kundër vendit

tonë, si incidenti i kanalit të Korfuzit, pregatitur nga anglezët për të paditur Shqipërinë se gjoja kishte vendosur mina në kanalin e Korfuzit. Ky ishte një provokacion i rëndë si të gjitha provokacionet e imperialistëve dhe të kukullave të tyre, provokacion që dështoi me turp dhe ku u demaskuan autorët e këtij komploti, imperialistët anglezë dhe shërbëtorët e tyre monarko-fashistët grekë e të tjerë. Kukullat e amerikanëve dhe të anglezëve, monarko-fashistët e Athinës me nxitjen e padronëve të tyre vite me radhë dhe në mënyrë të pandërprerë provokojnë vazhdimisht me armë në kufirin tonë të Jugut. Këto provokacione të panumërta, që kishin për qëllim të padisnin Shqipërinë në arenën ndërkombëtare, për të mbështetur shpifjet dhe shantazhet e imperialistëve anglo-amerikanë në planin ndërkombëtar kundër vendit tonë të vogël e paqedashës, bëheshin gjithashtu me qëllim që të përmbysesh pushteti ynë popullor, të pushtoheshin krahinat tona të Jugut, të krijoheshin kushtet për copëtimin e Shqipërisë midis klikës nacionaliste të Titos dhe Caldarisit dhe të inkurajohej reaksioni i brendshëm për të shkaktuar turbullira dhe për të përkrahur gjithë këtë komplot djallëzor të imperialistëve dhe të kukullave të tyre. Por populli shqiptar i ka nervat të fortë dhe ai nuk është tronditur kurrë. Ai ka përballuar me sukses të gjitha këto kërcënime dhe ka triumfuar. Armiqtë e popullit tonë dështuan. Por imperialistët amerikanë dhe anglezë nuk i kanë dorëzuar armët. E gjithë kjo veprimtari kundër vendit tonë zhvillohej me karta të hapura, por në dorë ata mbanin edhe një kartë tjetër, të cilën e hidhnin në lojë fshehtazi për të mbështetur gjithë veprimtarinë

e tyre kriminale. Kjo kartë e fshehtë ishte agjentura trockiste jugosllave. Grupi i Titos, nën maskën e miqësisë dhe të aleancës midis popullit tonë dhe popujve të Jugosllavisë, përpiquej, në mënyrë djallëzore dhe të fshehtë, ta merrte kështjellën nga brenda. Nacionalistët e Beogradit përpiquehin ta kolonizonin Shqipërinë, ta skllavëronin atë ekonomikisht dhe politikisht, ta bënin popullin tonë skllav në interes të imperialistëve dhe të klikës së tyre nacionaliste shoviniste. Ato u orvatën të asgjësonin thembret e regjimit tonë popullor dhe ta bënin Republikën tonë Popullore republikën e shtatë të Jugosllavisë.

Titua dhe grupi i tij, në bashkëpunim me agjentët trockistë shqiptarë, me Koçi Xoxen në krye, sulmuan në radhë të parë Partinë tonë, duke u përpjekur që ta shndërronin atë në një vegël të verbër të tyre, në një parti trockiste. Ata filluan të sabotonin kudo dhe të shkaktonin pasiguri dhe konfuzion në ekonominë tonë; ata plaçkitën ekonominë dhe Republikën tonë dhe e mbushën këtë dhe aparatën e shtetit me agjentë të regjur titistë jugosllavë, të cilët organizonin sabotime dhe dëmtime. Ata grumbullonin në grupe trockistët shqiptarë dhe të gjithë agjentët e tjerë në shërbim të të huajve, kulakët e spekulatorët për t'i hedhur më vonë në veprime të hapëta.

Ky sabotim në shkallë të gjerë nga ana e grupit të Titos dhe të agjentëve të tyre shqiptarë, shoqërohej me një propagandë të tërbuar antisovjetike, propagandë që zhvillohej në shumë sektorë të jetës së vendit nga trockistët jugosllavë dhe agjentët e tyre shqiptarë. Në këtë mënyrë, nacionalistët e Beogradit përpiquehin të



minonin miqësinë dhe dashurinë e madhe të popullit tonë për Bashkimin Sovjetik. Duke u përpjekur që të izolonin popullin tonë nga Bashkimi Sovjetik dhe nga demokracitë popullore, ata kishin ndër mend ta nënshtronin Republikën tonë Popullore dhe udhëheqjen e saj Partinë Komuniste të Shqipërisë, të likuidonin regjimin e demokracisë popullore në Shqipëri dhe, kështu të realizonin planet e imperializmit amerikano-anglez në këtë sektor të Ballkanit. Një rrezik jashtëzakonisht i madh kërcënonte Partinë dhe Republikën tonë Popullore nga ana e këtyre agjentëve të poshtër të Beogradit. Por Partia, populli dhe Republika jonë Popullore shpëtuan nga kthetrat e imperialistëve dhe të Titos, në saje të rezistencës së tyre, të luftës parimore për mbrojtjen e marksizëm-leninizmit dhe në saje të Partisë Bolshevike dhe të Byrosë Informative të partive komuniste dhe punëtore që me letrat e tyre, drejtuar ish-Partisë Komuniste Jugosllave, ja hoqën maskën trockistit Tito, zbuluan fytyrën e vërtetë të këtij grupi të rrezikshëm agjentësh të imperializmit që vepronin në Beograd. Letrat e Partisë Bolshevike, drejtuar Komitetit Qendror të Partisë Komuniste Jugosllave dhe Rezolucioni historik i Byrosë Informative u dhanë partive komuniste e punëtore të të gjithë botës një armë të fuqishme për të demaskuar pa mëshirë agjenturat e imperializmit, të cilat, të maskuara nën parulla false marksiste, kërkojnë të minojnë kampin e socializmit, të shkatërrojnë lëvizjen komuniste ndërkombëtare, të diskreditojnë dhe të dëmtojnë ndërtimin e socializmit dhe të rivendosin kapitalizmin në të gjitha vendet, ku kanë triumfuar idetë e Marksit, Engelsit, Leninit dhe Stalinit.

Jugosllavia, ku sundon grupi trockist i Titos, është bërë sot vatër e spiunazhit amerikan që kurdis plane djallëzore kundër Bashkimit Sovjetik dhe demokracive popullore dhe sidomos kundër vendit tonë. Banditët jugosllavë të UDB-së provokojnë vazhdimisht në kufitë tanë të Veriut, ata organizojnë grupe spiunazhi, diversioni, për t'i futur në vendin tonë me qëllim që të shkaktojnë turbullira; ata grumbullojnë dhe organizojnë kriminelët shqiptarë të luftës. Grupi i Titos është lidhur ngushtë me monarko-fashistët grekë dhe në bashkëpunim me ta dhe neofashistët e Romës, po thur komplete të poshtra kundër popullit tonë.

Por populli shqiptar, i cili i ka njohur mirë trockistët jugosllavë, që i njeh mirë monarko-fashistët dhe pasardhësit e Musolinit në Itali, është gjithnjë gati dhe vigjilent për të bërë që të dështojnë si gjithnjë orvatjet e imperialistëve dhe të shërbëtorëve të tyre. Uniteti i popullit shqiptar është kompakt si çeliku dhe kjo forcë e madhe e popullit shqiptar u provua edhe një herë tjetër në zgjedhjet e fundit për deputetët në Kuvendin Popullor, në të cilat Fronti Demokratik i Shqipërisë korri një fitore të shkëlqyer. Në zgjedhjet e fundit për deputetët populli mori pjesë në një përpjesëtim prej 99,43 për qind dhe ai votoi për Frontin në një përpjesëtim prej 98,18 për qind. Uniteti i popullit shqiptar u vërtetua nga sukseset e arritura në fushën ekonomike, ku plani dyvjeçar shtetëror është duke u realizuar me sukses. Populli shqiptar qëndron në këmbë duke i shtërnguar radhët rreth Partisë së tij të Punës, ai punon me heroizëm dhe ecën gjithnjë përpara me guxim e pa u trembur, me nerva të fortë dhe i sigurtë për të ardh-

shmen e tij. Populli shqiptar lufton për mbrojtjen e paqes me të gjitha forcat e veta, ai është i sigurtë për fitoren e tij.

Ka disa njerëz në botë që pyesin: «Si është e mundur që një popull i vogël, si populli shqiptar, i rrethuar nga të gjitha anët nga ujqër të tillë fashistë, që vërsulen kundër tij për ta copëtuar dhe për ta mbytur, ka mundur të rezistojë heroikisht, të luftojë në të gjitha frontet dhe të triumfojë?» Përgjegjja është e thjeshtë. Populli shqiptar ka rezistuar, ka luftuar dhe ka triumfuar dhe do të triumfojë gjithnjë mbi armiqtë e jashtëm e të brendshëm, sepse udhëhiqet nga Partia e Punës dhe ka miq të mëdhenj e të fuqishëm Bashkimin Sovjetik dhe Stalinin e madh. Populli ynë ka rilindur, ai rron dhe do të rrojë, ai lufton dhe triumfon, sepse rruga e tij është ndriçuar nga Revolucioni i madh i Tetorit, nga idetë e Marksit, Engelsit, Leninit dhe Stalinit, sepse Republika jonë Popullore lindi në saje të fitoreve të shkëlqyeshme të popujve sovjetikë mbi bishat fashiste dhe reaksionin ndërkombëtar. Republika jonë rron, forcohet e lulëzon, sepse atë e drejton Partia e Punës, sepse e mbron Ushtria jonë Popullore dhe gjithë populli.

*Botuar për herë të parë në gazetën «Për një paqe të qëndrueshme, për një demokraci popullore», Nr. 32 (92),*

*11 gusht 1950*

*Botohet sipas kopjes së origjinalit në frëngjisht që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë*

## **MBI FORCIMIN E ORGANIZATËS SË PARTISË DHE MBI LUFTËN E KLASAVE NË RRETHIN E KORÇËS**

*Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike  
të KQ të PPSH<sup>1</sup>*

**20 shtator 1950**

Direktivat e Komitetit Qendror të Partisë kanë qenë të qarta lidhur me identifikimin e kulakëve dhe me kufizimin e tyre. Gjithashtu e qartë ka qenë dhe vija se si duhet të veprohet në lidhje me ngritjen e kooperativave bujqësore dhe forcimin e tyre. Megjithkëtë, është ecur shumë ngadalë në ngritjen e kooperativave sa që ka kaluar një vit e gjysmë dhe nuk është ngritur asnjë kooperativë. Krijimi i kooperativave të reja dhe lufta kundër kulakëve duhet të shkojnë paralelisht.

Natyrisht, lufta kundër armiqve të klasës zhvillohet më parë në terrenin politik dhe pastaj në atë ekonomik. Por që të kryhet me sukses kjo luftë, në fillim duhet të pregatitet opinioni dhe pastaj të bëhet goditja. Partia në fshat duhet të përpiqet që gjithë fshatarët e

---

<sup>1</sup> Në këtë mbledhje u muar në analizë puna e organizatës së Partisë të rrethit të Korçës.

varfër dhe të mesëm t'i bëjë blok kundër armiqve. Kjo gjë nuk është bërë ashtu si duhet dhe ndodh si në Korçë, ku për disa raste është kaluar në masa ekstreme. Mund të themi se direktivat tona në lidhje me luftën kundër kulakëve mbeten në erë, në rast se nuk kuptohen dhe nuk mobilizohet populli. Lufta kundër kulakëve bëhet duke e demaskuar atë kur na lufton ose kur u reziston vendimeve tona. Ata duhen izoluar politikisht e kufizuar ekonomikisht dhe të mos ndodhë që atyre t'u jepen traktorë, që, kur prodhojnë shumë, të mos u vihet një tatim më i lartë, ose që anëtarit i Partisë të hajë e të pijë bashkë me ta, etj. Këto masa të merren dhe të vijnë duke u rritur, po jo deri në atë shkallë masash si është vepruar në Korçë. Partia sot duhet të mobilizojë të gjithë njerëzit, veçanërisht fshatarët e varfër që kulaku të izolohet. Tendenca e kulakëve për të shfrytëzuar duhet të luftohet me anë të kufizimit ekonomik.

Direktivat e Komitetit Qendror të Partisë duhet të zbatohen deri në fund dhe veprohet ndryshe vetëm atëhere kur ndryshojnë ato. Komiteti Qendror i Partisë ka lëshuar direktivën që nuk duhet të ngrihen kooperativa, pa punuar për forcimin e kooperativave ekzistuese. Që të zbatohet kjo direktivë duhej të ishin bërë përpjekje që atje ku janë krijuar kooperativat, të futeshin të gjithë fshatarët në to. Por që të ngrihet një kooperativë kjo punë duhet të bëhet me dashjen dhe vullnetin e fshatarëve. Ndryshe, po të mos punohet mirë dhe të ngrihet me shpejtësi një kooperativë pa u bindur fshatarët, atëhere një ditë ata të dalin andej.

Një politikë e drejtë për izolimin politik e kufizimin ekonomik të kulakëve tani do ta forconte më shu-

më gjendjen në rrethin e Korçës si dhe kudo. Nuk duhet me qenë të rrëmbyeshëm dhe gjaknxehtë, çdo shok partie të ketë mendjen, pse ka përgjegjësi të madhe për mbarëvajtjen e punëve.

Në Korçë, Partia është e organizuar mirë, ka pasur gjithë ato suksese. Atje punëtorët, që janë një bërthamë e shëndoshë e Partisë, dhe fshatarët janë të zhvilluar dhe shumica e tyre kanë luftuar. Prandaj atje ka kon-dita më të përshtatshme për izolimin politik të armiqve, kulakëve etj. Për gjykimin e çështjeve politike nuk duhet nxituar, por të mendohet qëllimi i çdo gjëje që bëhet dhe, pasi të mendohet mirë, atëhere të veprohet. Kur një çështje është mjaft delikate dhe ka rëndësi të madhe politike, duhet kërkuar ndihma e Komitetit Qendror të Partisë dhe nuk duhet shpejtuar. Duhet mbajtur parasysh se në qytetin e Korçës ka pasur një borgjezi pak a shumë të organizuar, që pjesërisht edhe sot mban lidhje me fshatarët, merr e jep me ta dhe ka një farë influence. Kjo borgjezi mundohet që këtë influencë ta shtrijë edhe në shokët e Partisë, të cilët pa menduar mirë, bien në oportunitizëm.

Çështja e atyre shokëve që trokasin dekoratat në tavolinë duhet parë mirë, pse mund të ketë edhe ndonjë që ka shumë pretendime. Këta njerëz nuk duhet të goditen me një gjykim të lehtë, as të mos përbuzen, po të punohet me ta, të luftohen me kujdes tendencat e tyre jo të drejta, që edhe këta të ndreqen e të ccin në rrugën e Partisë. Me ju dhënë ndihmë këtyre shokëve të vjetër të luftës, po edhe me i kritikue për gabimet e tyre. Ju duhet të dërgoni edhe në fshat njerëz të tillë për të punuar, nga të cilët kemi mjaft e që janë të njo-

hur. Kjo punë të bëhet në ato raste dhe në ato vende ku paraqitet nevoja. Ju duhet t'i shkundni pak më tepër shokët e vjetër që janë atje, me i ngarkue ata me detyra dhe me ju kërkue që t'i kryejnë ato. Nuk duhet të harrohen gjithashtu edhe njerëzit që kanë gabuar e janë goditur nga Partia, pse ata do të përpiqen të na dëmtojnë.

Ka një tendencë të theksuar në shokët e Korçës, siç është ajo e lokalizmit. Ka ndonjë shok të vjetër që nuk pranon të largohet nga Korça pse ka kondita të vështira në familje, prandaj kërkon të rrijë atje. Me këta duhet punuar me urtësi që ta kuptojnë drejt çështjen dhe të mos vënë interesin e ngushtë të tyre mbi atë të Partisë.

Siç e pamë, shokë, puna në Korçë shkon mirë. Ka disa gabime, po Komiteti Qendror ka besim se ato do të ndreqen, prandaj vihet detyra me forcue akoma më shumë situatën. Atje janë të gjitha mundësitë që Partia të forcohet më tepër pse ka edhe kuadro të mirë.

*Botohet për herë të parë sipas  
tekstit të nxjerrë nga proces-  
verbali i mbledhjes së Byrosë  
Politike të KQ të PPSH që  
gjendet në AQP*

# DISA DOBËSI QË VAZHDOJNË TË EKZISTOJNË NË PUNËN E ORGANIZATËS SË PARTISË TË LUSHNJËS

*Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike  
të KQ të PPSH<sup>1</sup>*

28 shtator 1950

Edhe unë jam në një mendje me shokët në lidhje me vlerësimin që ju bë punës së organizatës së Partisë në rrethin e Lushnjës. Shokët drejtues të këtij rrethi duhet t'u vënë rëndësi të gjitha problemeve, të jenë në krye të situatës dhe të përpiqen që komiteti i Partisë të ngrihet, të aktivizohen njerëzit, të thellohen në problemet, që të jenë në gjendje t'i zgjidhin vetë ato, pa qenë as sektarë as dorëlëshuar. Vërejtjet dhe kritikrat që ju bënë Komitetit të Partisë të Lushnjës në këtë mbledhje, të mos i dekurajojnë drejtuesit e tij, por t'i nxitin për të punuar më mirë.

Është e qartë se lufta e klasave në Lushnjë duhet

---

<sup>1</sup> Në këtë mbledhje u muar në analizë puna e Partisë në Lushnjë pas punimit të letrës së KQ të PPSH «Mbi gjendjen e sëmure në organizatën e Lushnjës».



të jetë më e ashpër nga çdo rreth tjetër, pse atje ka pasur bejlerë me çifliqe të mëdha. Prandaj këta jo vetëm me i goditë, po me i çpronësue dhe me i largue fare nga fshati. Të gjendet rasti dhe të merret kjo masë. Kurse përsa i përket kulakut, puna qëndron më ndryshe; me këta duhet të ndiqet vija e drejtë e Partisë, sipas së cilës në kohën e tanishme duhet me bë kufizimin ekonomik të kulakut, pra, me evitue likuidimin e tij si klasë. Po lufta kundër tyre duhet bërë me takt, me kujdes dhe në mënyrë konkrete që të kuptohet e të aprovohet nga fshatarësia punonjëse. Organizata bazë që lufton në fshat kundër elementit kapitalist duhet ta dijë se kush është kulaku, që të ketë mendjen nga një-rëz të tillë. Kulakut nuk është nevoja t'i thuhet natë e ditë se ti je i tillë e i këtillë, po atij t'i thuhet se «ti ke tokën më të mirë, prandaj duhet të paguash më tepër, ti prodhove më shumë, prandaj edhe shtetit duhet t'i japësh një pjesë, pse edhe ai ka nevojë». Në rast se një kulak nuk qëndron mirë politikisht, atëhere ai luftohet si kulak. Po rruga që keni ndjekur ju, shokë të Lushnjës, duke marrë masa administrative, nuk është e drejtë, sidomos në atë rreth, ku organizata e Partisë është akoma e dobët, ka tarafilëqe, familjaritet dhe, po të ecet kështu edhe në të ardhshmen, do të bëhen më shumë gabime dhe do të dëmtohet vija e Partisë.

Masat që ka marrë Lushnja të çojnë në likuidimin e kulakëve si klasë, prandaj këtu duhet të tregohet kujdes që të zbatohet drejt vija e Partisë. Por duhet pasur kujdes tani që të mos kaloni nga ana tjetër, në zbutjen e luftës së klasave. Në punë e sipër do të shihen edhe njerëzit që tërhiqen para vështirësive, do të ketë anëtarë

të Partisë që do të gabojnë, por në luftë e sipër do të shohiten njerëzit. Në këtë mënyrë do të dalin edhe njerëzit që nuk zbatojnë deri në fund vijën e Partisë. Kjo është një luftë e ashpër me mjete të tjera dhe jo me pushkë. Do të ketë dhe përjashtime nga Partia të elementëve të dobët, pse në organizatën e Lushnjës ka pasur sëmundje dhe njerëz të tillë dalin lehtë nga binarët. Me njerëzit që janë të butë kundër armikut, nuk duhet të bini në oportunizëm. Është e vërtetë se këta duhen edukuar, por kur shihet se nuk vijnë në rrugën e Partisë, atëhere të nxirren jashtë saj, pse po të pastrohet Partia nga njerëz si këta, do të forcohet edhe më shumë. Pra, lufta e klasave të mos dobësohet asnjëherë. Në këtë punë do të bëhen edhe gabime, po çështja është të mos shtrembërohet vija e Partisë. Kur keni ndonjë çështje të rëndësishme, përpara se të veproni kërkoni edhe ndihmën e Komitetit Qendror, pse kështu ka mundësi të bëni më pak gabime.

Në raportin e Komitetit të Partisë të Lushnjës, unë shoh një gjë: aty nuk bëhet fare fjalë për rininë, si punon dhe si lufton ajo. Kjo çështje ka një rëndësi të madhe, pse atje ku nuk ka organizatë bazë të Partisë, është rinia ajo që do ta bëjë punën e saj. Mua më duket se shokët e Lushnjës i kanë mbuluar problemet ekonomike dhe ata janë shmangur nga problemet e rëndësishme politike. Kam përshtypjen se ju shokë nuk e aktivizoni fare rininë, nuk e futni në luftë dhe nuk e ndihmoni atë sa duhet. Por rinia është forca më përparimtare në fshat, të rinjtë janë njerëz që kanë mësuar të shkruajnë dhe të lexojnë, që kanë vajtur vullnetarë në aksione, si në ndërtimin e hekurudhës etj. dhe që

janë më afër Partisë. Prandaj duhet treguar më tepër interesim për rininë.

Komiteti i Partisë i Lushnjës. duhet të shohë më mirë edhe disa probleme me rëndësi që dalin në atë rreth, si në Bubullimë ku vazhdon akoma të ketë koncepte të vjetra të ndarjes së njerëzve në muslimanë e të krishterë. Një gjë e tillë duhet ta preokupojë Partinë dhe të luftohet për zbatimin e vijës së drejtë të saj në këtë drejtim. Gjithashtu duhet ta preokupojë jashtëzakonisht edhe çështja e tendencave lokaliste që janë shfaqur. Këto gjëra nuk luftohen e nuk ndiqen me dekrete, po duke forcuar afrimin e drejtë dhe lidhjet me masat, me një qëndrim shembullor të udhëheqjes së re, që armiku në Lushnjë të mos guxojë më të thotë: «Pse të vijmë nga rrethe të tjera e të na qeverisin ne këtu». Me punën e Partisë populli do të shohë se këto janë parulla të armikut dhe do të mendojë se njeriu le të jetë nga të dojë, ai është shqiptar, komunist dhe si i tillë, kudo, bën detyrën që i ngarkohet nga Partia, nga populli.

Duhet t'ju preokupojë gjithashtu dhe çështja e sqarimit të situatës politike të brendshme dhe të jashtme në popull, pse në këtë mënyrë do të luftohen edhe parullat e reaksionit. Mundet që masat që keni marrë ju ndaj disa anëtarëve të Partisë janë të ekzagjeruara. Në qoftë se është kështu, kjo do të thotë se nuk është vepruar drejt. Por lidhur me këto masa duhet të mbahet parasysh edhe gjendja e sëmurë që ka qenë në atë organizatë, shtresat e njerëzve. Në rrethin tuaj tani për tani nuk ka asnjë fabrikë, prandaj ju mungon dhe elementi i shëndoshë punëtor.

Një kujdes tjetër duhet të tregoni për t'i mësuar njerëzit si të drejtojnë, mos me ua marrë p.sh. shokëve të pushtetit punën që u takon të bëjnë edhe sikur në fillim të jenë të dobët. Edhe komiteti i Partisë duhet të luajë rolin e tij e të aktivizohet mirë, përndryshe as sekretari i parë nuk do të ketë kohë të mendojë për të gjitha problemet që ka rrethi, siç janë problemet politike, ekonomike, arësimore, kulturele, shëndetësore etj. Duke e ndarë drejt punën dhe duke udhëhequr mirë do të keni më tepër kohë të mendoni dhe të drejtoni si përgjegjës kryesorë që jeni në rreth. Në rast se ju i futeni punës për të bërë vetë statistikat dhe korrigjimet e tyre, sigurisht që nuk do t'ju dalë koha të merreni me çështjet kryesore.

Në raport ju bëni një sërë propozimesh që ne duhet t'i studjojmë. Ju aty bëni fjalë për mundësinë e ngritjes së një qendre industriale, siç është ndërtimi i një fabrike për zhveshjen e pambukut ose i një fabrike për nxjerrjen e vajrave vegjetale. Kjo gjë duhet të shihet nga organet shtetërore. Edhe çështja e sipërfaqeve të tokave, që do të mbillen me bimë industriale, duhet të shihet mirë dhe sidomos çështja e rajonizimit. Një studim i ri duhet bërë edhe për çështjen e pambukut. Përsa i përket forcës motorike ajo duhet përdorur vetëm për bimët industriale. Propozimi që bëni për të ndihmuar kooperative bujqësore që të plotësojnë inventarin e tyre, është një gjë e zorshme, sidomos përse u përket traktorëve, po në vend të tyre mund t'u jepen që. Propozimi për të çelur shkollën bujqësore në Lushnjë në atë masë që thuhet aty, është i drejtë, prandaj duhet të studjohet. Në seksionin e bujqësisë të rrethit mund të shtohet

ndonjë njeri, por të gjithë nuk duhet të rrinë në zyrë, po të shkojnë në terren për të dhënë ndihmën e tyre. Edhe për rregullimin e qendrës së qytetit të Lushnjës kërkesa është e drejtë dhe duhet t'ju plotësohet për vitin 1951.

*Botohet për herë të parë sipas  
tekstit të nxjerrë nga proces-  
verbali i mbledhjes së Byrosë  
Politike të KQ të PPSH që  
gjendet në AQP*

TELEGRAM PËRSHËNDETJE DREJTUAR SHOKUT  
MAO CE DUN ME RASTIN E PËRVJETORIT TË PARË  
TË FORMIMIT TË REPUBLIKËS POPULLORE  
TË KINËS

1 tetor 1950

SHOKUT MAO CE DUN  
KRYETAR I QEVERISË POPULLORE QENDRORE TË  
REPUBLIKËS POPULLORE TË KINËS

*Pekin*

Me rastin e përvjetorit të parë të formimit të Republikës Popullore të Kinës më lejoni, shoku Kryetar, t'Ju shfaq urimet dhe përgëzimet më të nxehta të Qeverisë së RP të Shqipërisë, të popullit shqiptar dhe të miat personale.

Populli shqiptar ka ndjekur me simpati të madhe dhe admirim luftën heroike për çlirim të popullit të madh kinez kundër forcave të errësirës së Gomindanit dhe padronëve të tij, imperialistëve amerikanë. Në këtë ditë historike ai përshëndet me dashuri të thellë popullin e madh kinez, e përgëzon për sukseset që ka

realizuar dhe i uron suksese të reja në ndërtimin e bazave të socializmit dhe në forcimin e paqes në botë.

Fitoret historike të popullit kinez, të arritura në pushtetin popullor dhe nën udhëheqjen e Partisë së tij Komuniste, janë njëkohësisht dhe fitore për gjithë kampin e madh e të fuqishëm të paqes në botë.

Kryetari i Këshillit të Ministrave të  
Republikës Popullore të Shqipërisë  
Gjeneral-Armate

*Enver Hoxha*

*Botuar për herë të parë në  
gazetën «Zëri i Popullit»,  
Nr. 238 (627), 1 tetor 1950*

*Botohet sipas tekstit të gazetës  
«Zëri i Popullit», Nr. 238 (627),  
1 tetor 1950*

# PËRSHËNDETJA NË KONGRESIN E TRETË TË BASHKIMIT TË GRAVE TË SHQIPËRISË

1 tetor 1950

Shoqe delegate,

Në emër të Komitetit Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë, të Qeverisë së Republikës Popullore dhe timin personal, ju sjell përshëndetjet më të përzemërta dhe urime për suksese të mëdha në punën tuaj.

Kongresi që mbani sot ka një rëndësi të madhe për vendin, për arësye të situatës në të cilën e zhvilloni këtë kongres dhe për detyrat që do t'u caktoni masave të gjera të grave.

Vullneti i gruas shqiptare, aspiratat e saja për ndërtimin e një jete kurdoherë më të mirë, do të gjejnë shprehjen e plotë në këtë kongres dhe realizimi i tyre është plotësisht i mundshëm në saje të Partisë heroike të Punës të Shqipërisë, që udhëheq popullin tonë në rrugën e ndritur të socializmit dhe në saje të pushtetit tonë popullor.

Mëmat heroike të vendit tonë lindën dhe rritën trimat dhe trimëreshat që sakrifikuan, vuajtën dhe u



vranë për t'i dhënë vendit lirinë dhe pushtetin që gëzon populli sot. Të gjitha gratë e Shqipërisë, të çliruara përgjithmonë nga skllavëria dhe errësira mesjetare, tok me burrat, i vunë gjoksin punës, për të ndërtuar jetën e re, të lirë e të begatshme. Ato ju kanë dërguar në këtë kongres të shprehni me forcë atë çka zien në zemrën e çdo njeriu të thjeshtë të popullit: vullnetin për të mobilizuar të gjitha forcat në shërbim të ndërtimit të socializmit, për të mbrojtur atdheun e popullin nga çdo rrezik që mund ta kërcënojë, për të çelnikosur dashurinë e pakufishme që ushqen populli shqiptar për Bashkimin e lavdishëm Sovjetik dhe për Josif Stalinin, udhëheqësin e lavdishëm të të gjithë njerëzimit përparimtar si dhe për të shprehur urrejtjen kundër luftërave grabitqare, për të mbrojtur paqen në botë që kërcënohet seriozisht nga imperialistët barbarë amerikano-anglezë dhe shërbëtorët e tyre.

Rreth këtyre çështjeve jetike për popullin tonë duhet të lidhet çdo gjë, që nga veprimet individuale deri në aksionet masive. Po t'i kemi parasysh këto në çdo moment të jetës sonë dhe po të luftojmë me të gjitha forcat, pa u frikësuar, pa u epur as edhe një herë, kauza e shenjtë e popullit nuk do të errësohet, por do të ndritë me të gjithë shkëlqimin e saj.

Mbrojtja e paqes dhe ndalimi i shpërthimit të një lufte të re botërore, që pregatitet nga imperialistët barbarë amerikanë dhe shërbëtorët e tyre, është detyrë e të gjithë popujve. Ashtu është dhe për popullin tonë, i cili është ngritur i tëri në këmbë dhe ka bashkuar përpjekjet e tija në kampin e fuqishëm të paqes, që udhëhiqet nga popujt e lavdishëm sovjetikë dhe nga Stalini

i madh. Është në dorë të popujve, në organizimin e tyre, në luftën e tyre konsekuente dhe të guximshme që planet e luftëdashësve imperialistë amerikanë të shkatërrohen dhe paqja të triumfojë. Me qindra miliona njerëz kanë nënshkruar apelin e Stokholmit. Kampi i paqes i përbërë prej qindra miliona njerëz po bëhet dita-ditës më i fortë se kurrë dhe do të triumfojë. Mëmat, motrat dhe gjithë populli ynë, të kujtojnë tmerret e luftës, barbarizmat e hitlerianëve dhe të ballistëve që vrisnin dhe digjnin popullin tonë. Hitlerianët e rinj, imperialistët amerikanë dhe të gjithë shërbëtorët e tyre, po gjakosin popullin heroik të Koresë dhe po kërcënojnë jetën e popullit tonë dhe të popujve të tjerë të botës me një luftë të re botërore. Por popujt e botës janë të fuqishëm, me siguri do t'ua ndalin dorën këtyre kriminelëve që po armatosen deri në dhëmbë dhe po fabrikojnë bomba atomike për t'i hedhur mbi kokat e kalamanëve për t'i shfarosur ata në lulen e jetës së tyre. Prandaj lufta për mbrojtjen e paqes duhet të bëhet një çështje jetike për çdo njeri.

Gra të Shqipërisë, shumëfishoni aktivitetin tuaj dhe si një pjesë e madhe, e fuqishme, heroike e popullit tonë, luftoni me të gjitha forcat tuaja, tok me popullin shqiptar, tok me popujt e botës rreth popujve të Bashkimit Sovjetik, nën udhëheqjen e Stalinit të madh, luftoni për mbrojtjen e paqes. Godisni pa mëshirë armiqtë e brendshëm, agjentët dhe spiunët titistë dhe të gjithë këlyshët e tjerë të imperializmit që kemi rreth e rrotull. Trockistët jugosllavë, monarko-fashistët grekë dhe shokët e tyre, po bëjnë çmos të dëmtojnë Shqipërinë. Të forcojmë vigjilencën kundër tyre, pse kështu ata, me

siguri, do të dështojnë në veprat e tyre barbare dhe populli ynë kurdoherë do të fitojë.

Populli ynë do të fitojë kurdoherë mbi armiqtë e tij të jashtëm dhe të brendshëm, pse tani ai e ka gjetur rrugën e vërtetë të tij, rrugën e socializmit, të lirisë, të vetëqeverisjes. Populli ynë po ndërton bazat e socializmit me sukses, pse ai është mobilizuar i tëri si një blok graniti rreth Partisë së tij të dashur që e nxori në dritë dhe që e udhëheq me vendosmëri dhe e mbron nga çdo rrezik. Populli ynë ka çelnikosur bashkimin e tij dhe shpresat e armiqve të jashtëm dhe të brendshëm që të çajnë sado pak këtë unitet, janë të kota dhe pëlçasin si flluska sapuni. Uniteti është një fitore e madhe, që duhet ta ruajmë dhe ta forcojmë çdo ditë e më shumë. Vendi ynë po zbukurohet, ekonomia jonë socialiste ditë-ditës po forcohet dhe përparon me hapa të sigurtë. Suksese po korr populli ynë në të gjitha lëmet. Me mirënjohje të pakufishme populli shqiptar mendon në çdo moment për Bashkimin Sovjetik e Stalinin e madh, që e ndihmojnë bujarisht në ndërtimin e socializmit. Gratë e Shqipërisë duhet të hidhen me të gjitha forcat e tyre në punë dhe në luftë për ndërtimin e socializmit në Shqipëri. Nuk mundet vendi të përparojë, ekonomia të lulëzojë, jeta të zbukurohet në rast se gruaja qëndron pas dhe s'gjendet në ballë të luftës për ndërtimin e bazave të socializmit. Gruaja është faktor i dorës së parë në zhvillimin dhe përparimin e vendit. Kush e pengon gruan të marrë vendin që meriton në shoqërinë tonë të re, ai është një prapanik i neveritur, ai është një njeri që nuk ja do të mirën as popullit as familjes së tij, por ai dënon edhe veten. Partia dhe Lufta na-

cional-çlirimtare i këputën përgjithmonë zinxhirët e robërisë, që e bënë gruan skllave. Sot ajo është e lirë, asaj i janë hapur të gjitha portat dhe është bërë një luftëtare e vendosur, e guximshme dhe e paepur.

Prandaj gratë e Shqipërisë, të shumëfishojnë përpjekjet e tyre në të gjithë sektorët ku punojnë, në fabrika, në fshatra, në shkolla, në punët e tyre shtëpiake, të luftojnë për t'u kulturuar, të luftojnë kundër injorancës, errësirës, pikëpamjeve prapanike. Ato të jenë të forta, të guximshme, pse ato kanë Partinë dhe pushtetin e tyre, që me të gjitha forcat i ndihmojnë të shkojnë përpara. Gruaja shqiptare të bëhet një militante e shquar, të forcojë organizatën e saj dhe të luftojë politikisht kudo, si trimëreshë, për të mbrojtur interesat e popullit.

Mëma dhe motra të dashura, jemi një popull që kemi vuajtur shumë në të kaluarën, po kurrë nuk u mposhtëm, luftuam dhe më në fund fituam. Në të kaluarën jeta e popullit tonë ishte një varr. Sot vendi është shndërruar në një kopsht ku njerëzit punojnë të lirë dhe të gëzuar. Kalamanët mësojnë në shkolla me zemër të gëzuar. Ata rriten në frymën e një patriotizmi të lartë, të kulluar, për t'i shërbyer popullit me besnikëri. Në fabrika u zhduk skllavëria dhe shfrytëzimi, punëtorët janë të gëzuar, zotër të fabrikës, zotër të shtetit të tyre që ata drejtojnë. Në ara punon fshatari i lumtur në tokën e tij. Ai e mposhti skllavërinë e beut dhe të agait. S'mund të ketë zemër shqiptari të ndershëm dhe të thjeshtë që të mos rrahë me dashuri për Partinë e tij të Punës, për Bashkimin Sovjetik dhe për Stalinin. Populli shqiptar, kurrë nuk do të mposhtet, po kurdo-

herë do të fitojë, do të përparojë, pse ai e do me gjithë zemër Partinë e tij heroike të Punës, Bashkimin Sovjetik, Partinë Bolshevike dhe Josif Stalinin. Kjo është fitore e madhe për popullin tonë dhe këtë fitore duhet ta çelnikosim dhe ta mbrojmë me vendosmëri nga armiqtë, që kërkojnë dhe luftojnë me të gjitha mjetet ta errësojnë.

Nëna dhe motra, i edukoni fëmijët, vëllezërit dhe gjithë të afërmit tuaj ta duan dhe ta mbrojnë me gjithë shpirt Bashkimin Sovjetik dhe Partinë e Lenin-Stalinit, ashtu siç e duan dhe e mbrojnë me gjithë zemër atdheun, popullin dhe Partinë e tyre.

Përpara, pra, gra heroike të Shqipërisë!

Rroftë Kongresi i tretë i Bashkimit të Grave të Shqipërisë!

Rroftë populli shqiptar dhe Partia e Punës e Shqipërisë!

Rroftë dhe u forcoftë paqja në botë!

*Eotuar për herë të parë në gazetën «Zëri i Popullit», Nr. 239, (628), 3 tetor 1950*

*Botohet sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë*

**TELEGRAM PËRSHËNDETJE DREJTUAR POPULLIT  
TË MOKRËS ME RASTIN E PËRVJETORIT TË TETË  
TË ÇLIRIMIT TË KËSAJ KRAHINE**

**10 tetor 1950**

**KOMISIONIT INISIATOR PËR FESTËN E MOKRËS**

*P o g r a d e c*

Ju lutemi t'i transmetoni popullit trim dhe patriot të Mokrës përshëndetjet dhe urimet e përzemërta të Komitetit Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë, të qeverisë dhe të miat, me rastin e përvjetorit të tetë të çlirimit të krahinës së Mokrës prej pushtuesve fashistë dhe tradhëtarëve të vendit.

Populli i Mokrës, si gjithë populli shqiptar, luftoi me heroizëm dhe fitoi lirinë në saje të udhëheqjes së drejtë të Partisë sonë heroike dhe të luftës çlirimtare të Ushtrisë së lavdishme Sovjetike të komanduar nga i madhi Stalin.

Populli i Mokrës dhe i rrethit të Pogradecit, nën drejtimin e Partisë dhe të qeverisë, gjithmonë ka punuar dhe punon për të ruajtur dhe forcuar fitoret e Luftës

nacional-çlirimtare, për të ndërtuar një jetë më të mirë dhe të lumtur.

Festa juaj le të vlejë për t'u mobilizuar akoma më shumë në luftën ndërtimore që bën i gjithë populli shqiptar për mbrojtjen e paqes, të pavarësisë dhe për ndërtimin e themeleve të socializmit. Të vlejë për shtimin dhe forcimin e dashurisë dhe të miqësisë për Bashkimin Sovjetik dhe Stalinin e madh, për gjithë popujt liridashës në botë, për mbrojtjen e paqes.

Në këtë ditë të shënuar që ju festoni plot hare, ju urojmë nga zemra suksese të reja në të ardhshmen.

Sekretari i Përgjithshëm  
i KQ të PPSH

*Enver Hoxha*

*Botuar për herë të parë në  
gazetën «Zëri i Popullit».  
Nr. 246 (635). 11 tetor 1950*

*Botohet sipas tekstit të gazetës  
«Zëri i Popullit», Nr. 246 (635)  
11 tetor 1950*

## **MBI DISA ÇËSHTJE TË KOLEKTIVIZIMIT TË BUJQËSISË DHE MBI SHKURTIMIN E PLANIT TË IMPORTIT**

*Nga diskutimi në mbledhjen e Byrosë Politike  
të KQ të PPSH*

**27 tetor 1950**

Studimi që na është paraqitur<sup>1</sup> tregon se Ministria e Bujqësisë ka bërë kthesë nga mënyra e vjetër e punës në studimin e çështjeve. Ky studim është rezultati i një pune të mirë, po që duhet përmirësuar akoma më shumë në të ardhshmen. Ai ka një bazë reale dhe harta që është pregatitur ka një siguri dhe tregon se puna nuk është bërë keq. Çështja e rendimenteve dhe e klasifikimit të tokës, për shembull, për arsye të grumbullimit të fondit shtetëror të drithit, duhet të ndiqet në mënyrë shkencore, pse ne do ta përmirësojmë vazhdimisht bujqësinë. Si të kryhet plotësisht puna e kadastrës, fshatarët do të nxiten që të hapin, të shtojnë tokat dhe të

---

<sup>1</sup> Është fjala për një studim lidhur me rishqyrtimin e klasifikimit të tokave, në bazë të të cilit Byroja Politike e KQ të PPSH, aprovoi rendimentet dhe koeficientet e tatimit në natyrë të diferencuara sipas kategorive të tokave.



prodhojnë më shumë dhe në këtë mënyrë do të zhdukim edhe pakënaqësitë që ka në një pjesë të fshatarësisë nga gabimet që janë bërë lidhur me regjistrimin dhe klasifikimin e tokave. Këto studime shërbejnë dhe janë bazë edhe për tregëtimin e bukës që bën shteti, pse me përpjekjet e punonjësve të bujqësisë do të arrijmë të heqim triskat. Megjithatë nuk duhet të flemë mbi studime, këto janë bazë, por po nuk u vunë në jetë ato mbeten në letër, prandaj duhet të forcojmë më shumë punën për të zbatuar mirë detyrat që dalin nga studimi. Shokët e bazës duhet t'i kuptojnë mirë këto parime. Ata nuk duhet të punojnë me qëllim që të jenë «brenda», të zvogëlojnë shifrat e planit për ta realizuar lehtë atë, për të marrë flamurin nga shteti dhe lavdërime nga Partia, por duhet të orientohen mirë në këto çështje dhe të luftojnë që të përmirësohen fushat, të rritet rendimenti, të shtohet prodhimi, pse kështu shpejtojmë edhe heqjen e triskave.

Ajo që kemi thënë ne se duhet të ecim me shumë kujdes në formimin e kooperativave ka qenë dhe është kurdoherë e drejtë dhe aktuale, domethënë, në këtë çështje ne nuk duhet të shpejtohem, pse është një problem delikat dhe me rëndësi të madhe. Por megjithatë, nuk duhet të qëndrojmë edhe në vend, pse situata është e favorshme. Edhe unë jam i mendimit që të forcohen disa kooperativa. Për tabelën që na është paraqitur, në përgjithësi kisha dhe unë vërejtjet që u bënë këtu, domethënë që kooperativat ekzistuese nuk e kanë zgjeruar akoma sa duhet influencën e tyre. Pse ndodh kjo? Kjo ndodh sepse çështja e kooperativave si na mëson Lenini dhe Stalini, nuk kuptohet lehtë, dhe fshatarit nuk i

mbushet mendja me fjalë, po me rezultate konkrete. Në qoftë se fshatari shikon rezultate të mira, ai do të futet në to dhe do të bëhet një luftëtar kundër kulakut.

Partia duhet të interesohet veçanërisht për çështjen e kooperativave, pavarësisht nga orientimi që kishim dhënë ne, që të mos nxitohemi për një farë kohe. Por ne nuk kishim thënë që të mos flitej për to, të mos bëhej propagandë dhe sidomos që të mos forcoheshin kooperativat e vjetra e të bëheshin ato shembull dhe model. Edhe pjesëmarrja në kooperativat ekzistuese ka qëndruar pothuaj në vend. Përmirësime ka dhe këto kanë ndodhur për shkak të organizimit më të mirë të punës, si dhe nga ndihma që u ka dhënë atyre shteti, i cili do t'i ndihmojë edhe më shumë, por në bazë të kësaj ndihme nga ana e shtetit, të faktit që ato janë ngritur dhe të propagandës që është bërë, forcimi i tyre duhej të kishte shkuar akoma më përpara dhe rrethi i kooperativistëve duhej të ishte zgjeruar më shumë. Kështu, ato do të ishin bërë një nxitje më e madhe për fshatarët e tjerë. Praktika tregon se atje ku është punuar mirë, kooperativat ekzistuese janë bërë shembull. Le të marrim Maminasin, që është kooperativa më e mirë: dy fshatra afër Maminasit kanë kërkuar që edhe ato të ngrenë kooperativën e tyre. Kjo tregon se kur një kooperativë shkon mirë, ajo bëhet nxitje që të ngrenë kooperativa edhe fshatrat e tjera rrotull saj. Në Lushnjë kemi pak kooperativa, por tani ato janë më të mira, si nga përbërja ashtu edhe nga pjesëmarrja. Kjo është një shenjë shumë e mirë që tregon se atje është bërë punë, kurse në Korçë nuk ka ndodhur kështu, pse

janë kapur më tepër pas sasisë së kooperativave se sa pas forcimit të tyre. Në Korçë ne kemi sot 23 kooperativa, pra, kemi numrin më të madh dhe kërkojnë të ngrenë dhe 26 të tjera. Unë jam dakord që të ngrihen kooperativa dhe lista më duket se është e studjuar mirë, por mendoj që deri në fund të këtij viti të mos ngrihen më shumë se 25-30 kooperativa.

Vitin tjetër, kur të na paraqitet lista e formimit të kooperativave të reja, duhet të orientohemi nga shtimi i tyre, nga forcimi i punës politike dhe nga ngritja e rendimentit të prodhimit. Domethënë duhet të shkojmë përpara me hapa të matur. Ky duhet të jetë kriteri, pse në rast se ato do të qëndrojnë në vend, nuk kemi gjë në vijë. Kooperativat ekzistuese dhe ato që formohen sivjet duhet të luftojnë për ta bërë të gjithë fshatin me vete. Për ngritjen në masë të kooperativave, do të vijë koha, po këtë kohë duhet ta sjellim ne duke forcuar në çdo drejtim kooperativat ekzistuese; kjo kohë do të vijë dhe kur të forcohet ekonomikisht shteti ynë, i cili të jetë në gjendje të sjellë më shumë traktorë për bujqësinë etj. Në këtë drejtim duhet të ecim dhe ky është një problem i madh kyç.

Kurset e kualifikimit, për të cilat bëhet fjalë në relacion duhet të ngrihen dhe ndihmat nga shteti të jepen, por jo me afat prej 10-15 vjetësh. Krahas me kreditë që jep shteti duhet të llogaritim dhe dobitë e kooperativës, që fitimet e saj të mos jenë si rezultat vetëm i ndihmës së shtetit, po dhe i rendimentit më të madh në prodhim. Të punohet mirë se duhet arritur që kooperativat të mos kërkojnë bukë nga shteti.

Unë mendoj se në hartimin e planit të importit ne jemi mbështetur në ato që na janë dhënë nga ana e Këshillit të Ndihmës Ekonomike Reciproke. Ne kemi biseduar që të bëheshin shkurtime nga të gjitha dikasteret, por kjo porosi jo vetëm nuk u zbatua, po shokët ministri i shtuan edhe më shumë kërkesat për dikasteret e tyre. Është e ditur se po të kemi më shumë kamiona për shembull, puna do të vejë më mirë, po situata na shtërngon që të bëjmë shkurtime. Jam i mendimit që t'i pranojmë këto shkurtime që ka bërë Komisioni i Planit. Jam dakord gjithashtu që të mos i ulim normativat e sendeve, por unë them se duhen parë mirë edhe sendet e konsumit se mos bëhet ndonjë ndryshim sado i vogël, pse na vlen. Dhe këtë e them jo se ne kemi stoqe, por mendoj se çdo ministri, duke filluar që nga ajo e tregëtisë, e industrisë dhe e komunikacionit, ka mundësi të mos i kërkojnë disa gjëra dhe të bëjnë shkurtime. Për shembull në sektorin e tregëtisë na thonë se çorapet nuk i blen njeri. Kjo gjë tregon se ose ka shumë çorape, ose populli nuk blen se bën vetë çorape leshi. Pra, sipas kësaj gjendjeje kërkesat për çorape fare mirë mund të hiqen. Kështu mund të ketë edhe sende të tjera si p.sh. tuba, që ne i kemi dhe rrinë pa u përdorur, pse kanë ardhur para kohës. Unë mendoj se tani ka ardhur koha që shokët të jenë shumë të shtërnguar dhe të kujdesshëm me qëllim që të na vijnë ato sende pa të cilat nuk mund të bëjmë dot. Kështu ne do të shkurtojmë shumë materiale, mosardhja e të cilave nuk na dëmton as për realizimin e planit as për nevojat e konsumit të popullit. Edhe në ndërtimet mund të bëjmë kursime të mëdha si fjala vjen në çimento. Mund të

themi se të gjithë sektorët pa përjashtim mund të bëjnë shkurtime të arësyeshme. Prandaj të mendohet e të punohet në këtë drejtim.

*Botohet për herë të parë sipas  
tekstit të nxjerrë nga proces-  
verbali i mbledhjes së Byrosë  
Politike të KQ të PPSH që  
gjendet në AQP*

# KOMITETI I PARTISË NË RRETH TË PREOKUPOHET MË SHUMË PËR PËRMIRËSIMIN E MËTEJSHËM TË METODËS E TË STILIT NË PUNËN E TIJ

*Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike  
të KQ të PPSH<sup>1</sup>*

**3 nëntor 1950**

Në përgjithësi problemet që u rrahën këtu dhe kritikak që ju bënë Komitetit të Partisë të rrethit të Durrësit duhet t'i shërbejnë atij për të përmirësuar më tej punën.

Jam i mendimit që çështjen e paraqitjes së një raporti të tillë plot me të meta, ky komitet ta analizojë thellë dhe të nxjerrë mësimet e duhura. Një raport i përgjithshëm si ky, nuk të jep një ide të qartë e të plotë mbi punën, sukseset dhe të metat e organizatës së Partisë të këtij rrethi. Kemi thënë edhe herë të tjera se nuk duhet bërë raport për raport, po të bëhet një ra-

---

<sup>1</sup> Në këtë mbledhje Komiteti i Partisë i rrethit të Durrësit paraqiti raportin «Mbi gjendjen dhe aktivitetin e organizatës së Partisë të rrethit të Durrësit».

port i studjuar dhe me baza, prej të cilit edhe ne të fitojmë eksperiencë edhe juve t'ju ndihmojmë.

Për të bërë një raport, i cili zakonisht nuk duhet të jetë shumë i gjatë, punon çdo anëtar i byrosë për sektorin që drejton në rreth, pse ata i njohin më nga afër problemet dhe nëpërmjet kësaj pune do të dalë si përgjegjësia personale ashtu dhe ajo kolektive për të metat që ekzistojnë. Sekretari i parë mbi bazën e materialit që pregatit çdo anëtar i byrosë si dhe nga konstatimet e tij bën një raport përgjithësues, të cilin ja paraqit për shqyrtim dhe aprovim byrosë së komitetit të Partisë të rrethit. Rreth këtij raporti duhet të zhvillohet një diskutim i gjerë, një kritikë dhe autokritikë e shëndoshë me qëllim që të dalin më në pah të mirat dhe të metat si dhe masat që janë marrë e ato që duhet të merren, pastaj, si të plotësohet me vërejtjet e shokëve, raporti t'i dërgohet Byrosë Politike e cila, me siguri, po t'i paraqiten të tilla materiale të pregatitura seriozisht, do t'i ndihmojë më mirë komitetet e Partisë në punën e tyre. Pra, herë tjetër t'i bëni më të qarta raportet, sidomos të ndaleni në çështjet kyçe e kryesore, për shembull: si shkojnë forcimi i mëtejshëm i Partisë. çështjet ideo-politike, ekonomike, si shkojnë punët në fshat etj. Të flitet gjithashtu për problemet që nuk ecin mirë dhe të propozoni se çfarë masash duhen marrë nga Partia dhe pushteti.

Duhet të keni parasysh se Partia drejton të gjithë aktivitetin politik, ekonomik dhe kultural. Por, për këtë qëllim ka dhe organe të ndryshme, një nga të cilat është pushteti, që duhet të vihet mirë në lëvizje nga Partia. Partia duhet të drejtojë dhe të kontrollojë ve-

primtarinë e organeve të pushtetit, të jetë vigjilente dhe kundër atyre që nuk zbatojnë ligjet e direktivat shtetërore të marrë menjëherë masa. Ju vërtet nuk mund ta pushoni për shembull një kuadër që punon në një ndërmarrje nacionale<sup>1</sup>, por kur ky nuk i kryen mirë detyrat, të njoftoni menjëherë Komitetin Qendror. Kur kushtet e punëtorëve janë të këqia, përpiquni vetë të merrni masa, por kur shihni për shembull se Ministria e Industrisë nuk vepron nga ana e saj, na njoftoni ne që të marrim masa këto. Por të veproni kështu, pasi të keni bërë të gjitha përpjekjet tuaja. Raport mund të na bëhet neve qoftë edhe për një çështje të caktuar, edhe për një ndërmarrje nacionale, pse kontrolli i organizatave të Partisë duhet të jetë kudo. Partia në bazë të mbrojtë vijën e saj e të njoftojë, kur duhet Komitetin Qendror, pse ai nuk ka si ta shohë një punë jo të mirë që zhvillohet në Durrës a diku gjetkë. Partia ka atje sytë e saj, ajo shikon nëpërmjet organizatave të saja kudo që janë.

Duke kuptuar mirë këtë rol, ju nuk duhet të ktheheni në organe zbatuese të pushtetit. Zbatimin e urdhërave e bëjnë organet e tjera. Ju duhet të mobilizoni Partinë dhe të kontrolloni për shembull Portin e Durrësit, jo vetëm punën e organizatës, por edhe si shkon realizimi i planit në përgjithësi. Ju keni shumë për të bërë. Të gjithë, pra, të punojnë në vijën e Partisë. Nuk i lejohet askujt të punojë ndryshe. Duke punuar kështu

---

<sup>1</sup> Në atë kohë kuadrot drejtues të të gjitha ndërmarrjeve nacionale ishin në nomenklaturën e drejtëpërdrejtë të organeve përkatëse qendrore.



do të keni kohë të kontrolloni, të ndihmoni e të drejtoni si duhet, të bëni që të metat të zhduken dhe planet jo vetëm të realizohen, po edhe të tejkalohen.

Vërejtjet e shokut Hysni [Kapo] për nevojën e intensifikimit të punës politike me masat, janë shumë të drejta. Fushatat që shpallen nga Komiteti Qendror janë aksione të rëndësishme politike dhe duhen përfunduar me sukses. Para së gjithash, çdo anëtar partie, çdo i ri ose çdo anëtar i organizatave të tjera, duhet të jetë njeri politik dhe puna politike t'i bëhet atij si buka e përditshme. Kjo punë nuk duhet të kuptohet dhe të bëhet vetëm me rastë fushatash, por vazhdimisht dhe në çdo drejtim, në çdo fushë të jetës. Ju thoni se nuk keni ndjekur shpërndarjen e gazetës. Kjo s'është detyra juaj. Pushteti ka një sektor të posaçëm për këtë punë dhe ai duhet ta kryejë mirë detyrën, për të cilën duhet të mobilizohet edhe organizata e Partisë e atij sektori të pushtetit, që gazeta të shpërndahet në rregull. Pra, kjo nuk është punë e komitetit të Partisë, detyra e tij është të interesohet që gazeta të lexohet dhe, kur shihet se nuk lexohet, atëhere ngrihet e diskutohet dhe kjo çështje. Kështu mund të themi edhe për çështjet e tjera. Partia në rreth duhet me i dijtë mirë detyrat e njërës dhe të tjetrit, pse po të mos bëhet ky dallim, ajo s'ka si të kontrollojë zbatimin rigoroz të tyre.

Problemin e kulturës duhet ta shikoni mirë, pse edhe nëpërmjet saj bëhet puna politike dhe asnjëherë mos pandehni se ajo mbaron vetëm me një bandë ose me një kor, por të ketë sa më shumë grupe të tjera dhe pjesëmarrja në to të jetë sa më e madhe. Edhe lufta kundër analfabetizmit duhet të jetë në qendër të vë-

mendjes së Partisë duke e shikuar atë si një çështje me rëndësi politike. Pushteti, sidomos, duhet të preokupohet më tepër në këtë drejtim.

Për çështjen e fesë Partia e ka shtruar drejt se si duhet zhvilluar lufta kundër saj, pa goditur besimtarët, në radhë të parë me metoda bindëse, po njëkohësisht ka shtruar që në këtë fushë të mos jemi as oportunistë. Në një vend si Kavaja, ku ka njëqind e ca komunistë që mbajnë ramazan, nuk mund të luftohet në vijën e Partisë, pse shembulli i keq i tyre është i dëmshëm. Në rast se komunisti nuk bën një luftë të vërtetë në vijën e Partisë edhe për çështjen e fesë, ai nuk është për Partinë, por në kundërshtim me të. Gjendja tregon se në Kavajë dhe në Shijak nuk duhet të neglizhohet çështja e fesë, por të punohet vazhdimisht për bindjen e njerëzve mbi kotësinë e saj. Në Parti të ngrihet më mirë ky problem dhe t'u bëhet e kuptueshme anëtarëve të Partisë nga ana ideologjike se çfarë qëndrimi duhet të mbajnë ata kundër fesë.

Ju duhet të keni kujdes për të gjitha këto çështje. Pse Durrësi është një rreth industrial, bujqësor dhe tregëtar. Ju duhet të gjeni një mbështetje të fortë të punëtorët, prandaj t'i mbani ata afër, pse klasa punëtore atje përbën një bërthamë të shëndoshë. Herë pas here, nga punëtorët më të mirë, të dërgoni për të punuar edhe në fshat. Natyrisht, për këtë duhet të vepronë edhe organizatat profesionale e ato të rinisë, në të cilat ju duhet të mbështeteni. Të interesoheni më tepër për rininë, për organizimin dhe edukimin e saj, si në shkollë e në fabrika ashtu dhe në fshat. Në udhëheqje të saj të zgjidhen njerëz të mirë që i do rinia. Ajo është

një organizatë masash, prandaj të mos dërgohen atje njerëz sektarë ose që e marrin punën me rininë si një çështje të thjeshtë. Në qoftë se do t'i kërkohet ndihmë rinisë për luftën kundër fanatizmit, ajo do të bëhet flamurtare, pse i riu dhe e reja i kundërvihen më lehtë e më shpejt fanatizmit.

Kur shihni se shkelet vija e Partisë, se abuzohet dhe vidhet, të jeni të ashpër. Një njeri që vjedh, s'ka se si të mbahet në Parti, po ashtu edhe ai që është kundër kooperativave bujqësore. Një njeri i tillë, në qoftë se nuk kupton se kooperativa është forma më e lartë socialiste në bujqësi, ai s'ka kuptuar as interesin e tij dhe është në kundërshtim me programin e Partisë.

*Botohet për herë të parë sipas  
tekstit të nxjerrë nga proces-  
verbali i mbledhjes së Byrosë  
Politike të KQ të PPSH që  
gjendet në AQP*

## REVOLUCIONI I MADH I TETORIT DHE POPULLI SHQIPTAR <sup>1</sup>

10 nëntor 1950

Më 7 Nëntor 1917 triumfuan për herë të parë në botë, idetë e drejtësisë, të përparimit, të humanizmit dhe të demokracisë së vërtetë. U vërtetua shkëlqimisht në jetë forca e shkencës marksiste-leniniste. Revolucioni i madh i Tetorit që triumfoi në Rusinë cariste, shkaktoi një ndryshim të madh në historinë e botës dhe hapi për njerëzimin një epokë të re, të lavdishme. U këputën përgjithmonë, në një të gjashtën e botës, zinxhirët e robërisë kapitaliste, u dërmua që nga themelitetë ndarja e shoqërisë në shfrytëzues dhe të shfrytëzuar, lindi i pari shtet socialist në botë: Bashkimi Sovjetik. Revolucioni i madh i Tetorit ishte vepra e Partisë së lavdishme Bolshevike dhe e udhëheqësve të saj gjenialë, Leninit dhe Stalinit që e çuan, nëpërmjet luftërash dhe përpjekjesh vigane, proletariatin dhe fshatarësinë ruse në marrjen e pushtetit në duart e tyre, në vendosjen e

---

<sup>1</sup> Ky artikull i është dërguar gazetës «Për një paqe të qëndrueshme, për një demokraci popullore», e cila e ka botuar me shkurtime.

barazisë, të drejtësisë e të mirëqenjes së popujve — ligj i madh i kësaj shoqërie pa klasa dhe pa shfrytëzim të njeriut nga njeriu.

Me Revolucionin e madh të Tetorit fitoi kauza e pavdekshme e proletariatit, i cili vendosi ligjet e tij dhe zëvendësoi shtetin e kalbur të feudalëve dhe të kapitalistëve gjakpirës me shtetin socialist të punëtorëve dhe të fshatarëve, shtetin më të përparuar të botës.

Triumfi i Revolucionit të madh të Tetorit ngjalli shpresat e njerëzimit përparimtar në triumfin e kauzës së punonjësve, ngjalli energjitë e popujve dhe forcoi në ta besimin në forcat e tyre dhe në fitoren e ardhshme mbi gjakpirësit kapitalistë. Themelet e kapitalizmit u lëkundën seriozisht dhe kambana e vdekjes së sundimit të tij kishte rënë. Më kot imperialistët dhe shërbëtorët e tyre u përpoqën me të gjitha mjetet të rrëzonin regjimin socialist në Bashkimin Sovjetik, më kot ata ndërhyjnë me armë për të mbytur që në embrion veprën e madhe të Leninit dhe të Stalinit, më kot ata ndihmuan fuqimisht luftën civile dhe veprën tradhëtare e sabotuese të agjentëve të tyre trockistë, zinovievistë, buharinistë e të tjerë. Shteti i parë socialist në botë, shpresa e njerëzimit, u ngrit si një vigan i pamposhtur, ai u bë një blok i madh i çelniktë, ku u përplasën dhe u shkatërruan të gjitha furtunat e egra dhe tentativat e pashpresa të imperialistëve, u thyen bajonetat e tyre, u demaskuan njëra pas tjetrës demagogjitë e socialdemokratëve etj. Revolucionin e madh të proletariatit, i udhëhequr nga Partia Bolshevike e Lenin-Stalinit, bashkoi në një aleancë të pathyeshme punëtorët dhe fshatarët, shtetëzoi të gjitha pasuritë e kapitalistëve dhe të kon-

cesionarëve të huaj dhe i bëri ato pasuri të popullit, shtetëzoi tokat e latifondistëve dhe të feudalëve dhe këto ua dha fshatarëve në shfrytëzim të përhershëm, çliroi nga zgjedha e kapitalit dhe e parasë, intelektualët, shkencëtarët, artistët etj. dhe i hodhi këta në rrugën e vërtetë të shkencës dhe të kërkimeve në interes të popullit, zhduku ndarjet raciale dhe krijoi shtetin e parë shumëkombësh, ku më tepër se 60 kombësi të ndryshme rrojnë të lira, të vëllazëruara, me të drejta të barabarta, ku çdo kombësie i është siguruar zhvillimi nacional në baza marksiste-leniniste. Nga një vend i prapambetur, siç ishte Rusia cariste, Revolucioni i madh i Tetorit e shndërroi këtë në një vend të mrekullueshëm, ku industria u bë një faktor i dorës së parë. Bujqësia kolkoziane u zhvillua dhe mori një hov të madh. Industria dhe bujqësia u zhvilluan në një harmoni të tillë sa që Bashkimi Sovjetik është bërë një nga vendet e mëdha më të përparuara dhe më të begatshme në botë. Partia Bolshevike dhe udhëheqja gjeniale e Stalinit e bënë Bashkimin Sovjetik një kopsht të lulëzuar dhe farkëtuan, në luftëra të përgjakshme dhe me përpjekje shumë të mëdha, tipin e njeriut të ri sovjetik. Me njeriun sovjetik, të mburrur dhe të edukuar nga Partia Bolshevike e Lenin-Stalinit, janë lidhur realizimet e mrekullueshme të planeve pesëvjeçare staliniane dhe zbulimet e mrekullueshme në fushën e shkencës, të artit, të kulturës; me të është lidhur krijimi dhe çelnykosja e shtetit të fuqishëm sovjetik. Bashkimi Sovjetik shpëtoi njerëzimin nga skllavëria e rëndë që i përgatitnin hitlerianët dhe shërbëtorët e tij. Të ndihmuar nga lufta e popujve të Bashkimit Sovjetik vendet e demokracive popullore

u shkëputën nga zgjedha e kapitalit dhe e imperialistëve dhe sot popujt e këtyre vendeve po ndërtojnë socializmin. Bashkimi Sovjetik është bërë kështjella e pamposhtur e paqes në botë, kundër nxitësve të një lufte të re botërore — imperialistëve amerikano-anglezë dhe satelitëve të tyre.

Stalini ka thënë:

*«Tani masat punonjëse të botës nuk duhen shikuar më si një «turmë e verbër» që endet në errësirë dhe pa asnjë perspektivë...»<sup>1</sup>.*

Revolucioni i madh i Tetorit u ndriti rrugën elementëve të pararojës dhe masave punonjëse të botës, si të organizohen, si të luftojnë dhe të fitojnë mbi armiqtë e popullit, mbi imperialistët dhe shërbëtorët e tyre të çdo kallëpi; ai u dha provën evidente dhe konkrete të forcës së pamposhtur të popujve që marrin fuqinë në duart e tyre, u tregoi këtyre në mënyrë të qartë të mirat e regjimit socialist. Revolucioni i madh i Tetorit krijoi për mbarë njerëzimin, Bashkimin e lavdishëm Sovjetik që është mburoja e çelniktë e paqes, e interesave të gjithë popujve të mëdhenj e të vegjël, që është bërë përkrahësi kryesor i popujve që luftojnë për të fituar lirinë e tyre dhe për të shkuar triumfalisht në rrugën e ndritur të socializmit.

Populli shqiptar, që sot rron i lirë dhe i pavarur, në regjimin e demokracisë popullore, çlirimin dhe mi-

<sup>1</sup> J. V. Stalin. Veprat, vëll. 10, f. 239.

rëqenjen e tij ja detyron shumë dritës së Revolucionit të madh të Tetorit. Për popullin tonë, dita e Revolucionit të madh të Tetorit, është një datë e shënuar, se me Revolucionin e Tetorit u përcaktua dhe e ardhshmja e popullit tonë.

Në rrugën që hapi Revolucioni i Tetorit u siguroa çlirimi i popullit tonë, si dhe i shumë popujve të tjerë të Evropës dhe të Azisë. Po kështu do të ngjasë me siguri matematike e ashtu si e përcakton shkencë marksishte-leniniste edhe për të gjithë popujt e tjerë kolonialë dhe gjysmëkolonialë, që vuajnë dhe luftojnë për t'u çliruar nga zgjedha e imperialistëve dhe e shërbëtorëve të tyre. Instruktive është historia e një populli të vogël, siç është populli shqiptar, i cili duke ndjekur me besnikërinë më të madhe rrugën e Revolucionit të madh të Tetorit, mundi të realizojë me gjak dhe me përpjekje ëndrën shekullore të tij. Kjo ka qënë rruga e shpëtimit të popullit tonë. S'ka rrugë tjetër. Popujt që ecin në këtë rrugë, të caktuar nga Lenini dhe Stalini, mposhtin të gjitha vështirësitë që u dalin përpara, mposhtin të gjithë armiqtë që i pengojnë, qofshin këta shumë të mëdhenj, të egër dhe të armatosur deri në dhëmbë siç kanë qënë hitlerianët, fashistët italianë dhe siç janë sot pasardhësit e tyre imperialistët amerikanë, anglezë dhe shërbëtorët e tyre. A mund të imagjinohej çlirimi i popullit tonë kaq të vogël, pa fitoren e Bashkimit Sovjetik mbi nazizmin gjerman? A mund të imagjinohej më parë që një vend i vogël si Shqipëria të rrojë i lirë, i pavarur, të ndërtojë socializmin me një vrull dhe entuziazëm të papërshekruar, në një kohë kur ajo është e rrethuar në të katër anët nga armiq të tër-



buar siç janë agjentët e imperializmit amerikan, troc-kistët titistë, monarko-fashistët grekë, fashistët italianë, në një kohë kur imperialistët amerikanë, me urë në dorë, ashtu si bënin hitlerianët, po vërsulen t'i vënë zjarrin botës? Kjo ishte e zorshme të imagjinohej dhe s'mund të kishte kurrsesi mundësi një gjë e tillë. Por tani, në epokën e triumfit të socializmit kjo është e mundur, është fare e mundur dhe prova më e shkëlqyer është Republika Popullore e Shqipërisë, e cila rron dhe lulëzon nën udhëheqjen e PPSH.

Shumë e errët ka qenë e kaluara e popullit tonë. Kurdoherë vendi ynë ka qenë nën zgjedhën e kapitalistëve të ndryshëm, kurdoherë i copëtuar. Ai ka qenë fushë lufte, fushë intrigash dhe grabitej nga të katër anët nga të huajt dhe nga feudalët vendës. Për imperialistët e ndryshëm nuk ekzistonte as Shqipëri as popull shqiptar, por ekzistonin vetëm interesa të ndryshme të njërit e të tjetrit, interesa këto që i çonin ata në përleshje. Kështu vendi ynë kalonte nga një dorë hajduti në një dorë tjetër hajduti. Kush vinte në hesap se një popull i vogël dhe heroik, vuante tmerrësisht, vritej e copëtohej nga shkelësit e ndryshëm dhe shfrytëzohej deri në palcë. Errësira mesjetare mbretëronte në vendin tonë. Mbi popullin sundonin klikat feudale dhe borgjezia tregëtare që për një grosh shitnin Shqipërinë, pasuritë e saja të shumta që u sillnin fitime të mëdha të huajve imperialistë, të cilët i përgatitnin zinxhirë të rëndë popullit shqiptar. Në vendin tonë bujqësia ndodhej në kondita dhe raporte mesjetare, industria as që ekzistonte fare, injoranca e fanatizmi ishte i madh dhe ruheshin në një mënyrë të tillë që të mos

mundte populli të ngrinte krye. Por me gjithë këto mjerime dhe këtë situatë të vajtueshme, populli ynë nuk u mposht asnjëherë, por luftoi heroikisht për t'u çliruar. Ai mundej përpara forcës së madhe të armikut, por prapë çohëj, prapë luftonte, prapë mundej dhe prapë ringjallej. Populli shqiptar njohu dhe vuajti për pesëmbëdhjet vjet rresht regjimin tiranik të Ahmet Zogut dhe të klikës së tij feudale. Ai ishte regjimi tipik i shfrytëzimit në kulm të popullit, ishte regjimi i plumbit dhe i litarit, i shitur te imperialistët e ndryshëm, amerikanë, anglezë, italianë, vazhdimisht sipas interesave të këtyre fuqive të mëdha dhe interesave të Ahmet Zogut e të klikës së feudalëve. Por sa më e madhe dhe më e rëndë bëhej shtypja, aq më e fortë bëhej rezistenca e popullit tonë. Më kot Zogu dhe klika e tij mundoheshin t'i fshihnin popullit tonë të vërtetën mbi ngjarjet historike në Bashkimin Sovjetik. Asgjë s'e trembte popullin shqiptar dhe as pjesën pararojë të tij, t'i bënte të njohur popullit, qysh në atë kohe zije dhe errësire, të vërtetën mbi Bashkimin Sovjetik dhe ta drejtonte atë drejt asaj rruge që do ta nxirrte një ditë në dritë, që do t'i siguronte lirinë dhe pavarësinë, për të cilat kishte derdhur aq shumë gjak gjatë jetës së tij. Ndjenjave të pastra të dashurisë së popullit tonë për Bashkimin Sovjetik nuk mund t'u vinin fre dhe t'i pengonin as xhandarët e Zogut dhe as bajonetat e Musolinit, që okupuan Shqipërinë më 7 prill të vitit 1939. Ato shpërthyen si vullkan që në ditët e para të okupacionit të vendit tonë. Lufta jonë nacional-çlirimtare filloi dhe mbaroi e udhëhequr nga shkenca marksiste-leniniste, nga mësimet e pavdekshme të Revolucionit të madh të Tetorit, të Bashkimit të

lavdishëm Sovjetik dhe të strategëve gjenialë, Lenin e Stalin. Në këto kondita, fitorja e shkëlqyer e popullit tonë të vogël u sigurua dhe nuk mund të ndodhte ndryshe. Popullin shqiptar, në luftën e tij të vendosur për çlirim e udhëhoqën idetë e pavdekshme të Leninit dhe të Stalinit, eksperiencia e pakufishme dhe ngadhnjimtare e Partisë Bolshevike të Lenin-Stalinit, atë e frymëzoi dhe e ndihmoi heroizmi i Ushtrisë së lavdishme Sovjetike.

Populli ynë që në ditët e para të luftës kuptoi se fatet e tij duhej t'i drejtonte ai vetë dhe jo t'i linte më në duart e atyre pseudopatriotëve dhe pseudodemokratëve, që kurdoherë e kishin lënë në baltë e mjerim. Çlirimi nuk mund të fitohej duke i lënë këto në dorën e bejlerëve dhe të borgjezisë liberale, që shitnin çdo gjë për interesat e klasës së tyre. Duhej krijuar udhëheqja nga gjiri i popullit të vuajtur dhe kjo duhej të ishte Partia Komuniste e Shqipërisë, e ndërtuar në bazat e Partisë Bolshevike të Lenin-Stalinit, që të ndiqte me besnikërinë më të madhe gjurmat e kësaj, të përvetësonte eksperiencën e saj, të kalitej si ajo në luftëra të përgjakshme duke ndjekur rrugën e lavdishme të Revolucionit të madh të Tetorit. Dhe kështu u bë, prandaj fitoi populli ynë. Partia Komuniste e Shqipërisë, pararojë e klasës punëtore dhe e të gjitha masave punonjëse të vendit, u bë organizatorja dhe udhëheqësja e lavdishme e popullit tonë. Ajo ndoqi me besnikëri të madhe rrugën e Revolucionit të madh të Tetorit, të Partisë Bolshevike dhe kështu ajo nuk gaboi, por e kreu me nder barrën e rëndë që i ngarkoi populli në momentet më të vështira të historisë së tij. Partia Komuniste e

Shqipërisë u kalit në zjarr duke pasur në çdo moment si mësim eksperiencën e Partisë Bolshevike. Ajo grumbulloi rreth vetes gjithë punonjësit e vendit, gjithë patriotët, i organizoi këta në një front të madh dhe në një ushtri partizane të çelniktë, e cila u bë e aftë të përballojë sulmet e rrepta të ushtrisë fashiste italiane, gjermane dhe kuislinge, t'i sulmojë e t'i godasë këto vazhdimisht, të korrë suksese të shkëlqyera dhe më në fund të çlirojë atdheun e vet. Që në ditët e para të luftës Partia jonë çelnikosi radhët e saja, bashkoi në një aleancë të shëndoshë punëtorinë dhe fshatarësinë e vendit, e bëri këtë të fundit të ndergjegjshme për rolin udhëheqës të klasës punëtore dhe bëri kështu të dështojnë të gjitha përpjekjet e borgjezisë dhe të okupatorit për ta tërhequr fshatarësinë në rrugën e tyre. Në dritën dhe eksperiencën e Revolucionit të madh të Tetorit, Partia jonë, krijoi dhe forcoi pushtetin e popullit duke rrëzuar nga themelitë pushtetin e vjetër të borgjezisë. Partia jonë ruajti si sytë e ballit pastërtinë e radhëve të saja nga armiqtë e brendshëm. Njëra pas tjetrës dështuan të gjitha manevrat e pushtuesve dhe të kuislingëve. Tentativat e tyre djallëzore e demagogjike për të përçarë popullin dështuan sikurse edhe të gjitha përpjekjet e tyre me armë. Partia dhe populli ynë duke luftuar trimërisht ndoqën me besnikëri rrugën e aleancës antifashiste, por ishin kurdoherë vigjilentë dhe i goditën të gjitha manevrat e reaksionit anglo-amerikan, i cili nën maskën e kësaj aleance u përpoq në vendin tonë të shndërronte karakterin e Luftës sonë nacional-çlirimtare. Partisë sonë nuk i lejohej në asnjë moment të harronte luftën e egër që imperialistët e ndryshëm,

Çerçillët me shokë, i kishin bërë pushtetit të ri të sovjetëve, nuk mund të harronte intervencionin, luftën civile në Bashkimin Sovjetik, nuk mund të harronte gjithë politikën famëkeqe dhe manevrat e shteteve «të demokracive perëndimore» dhe të Shteteve të Bashkuara që suallën në fuqi Hitlerin, që bënë Mynihun, që i lanë dorë të lirë Musolinit të pushtonte Shqipërinë, me një fjalë, gjithë qëllimet dhe politikën e tyre imperialiste, antisovjetike, antipopullore.

Anglia dhe Amerika, me anë të agjentëve të tyre zyrtarë, nën maskën e miqësisë dhe të aleancës, tentuan të sabotonin luftën çlirimtare të popullit tonë dhe t'i rrëmbenin këtij fitoren nga dora. Ata e luftuan me të gjitha forcat Frontin Nacional-Çlirimtar të Shqipërisë dhe udhëheqësen e tij, Partinë Komuniste. Ata bashkëpunuan me pushtuesin gjerman, organizuan lidhje të shëndosha me kuislingët, i financuan këta me stërlina dhe me municion, i organizuan politikisht nën pushtetin e Gestapos, për të na luftuar me armë dhe me demagogji. Emisarët e Çerçillit, qëndronin krah për krah me oficerët gjermanë në shtabin kuisling të tradhëtarëve Abaz Kupi dhe Mithat Frashëri dhe drejtonin ofensivën e fundit gjermane kundër Ushtrisë Popullore Nacional-Çlirimtare. Kjo bëhej me qëllim që duke menduar se do të dërmonin Ushtrinë Popullore, dhe me tërheqjen e forcave gjermane nga vendi ynë, kuislingët dhe tradhëtarët të merrnin fuqinë dhe populli të futej nën një zgjedhë të re, nën zgjedhën e imperialistëve anglo-amerikanë. Po në këtë kohë anglezët u përpoqën të zbarkonin në vendin tonë nga ana e detit dhe të futnin në prapavijat e Ushtrisë sonë Popullore reparte parashu-

tistësh. Të gjitha këto bëheshin me qëllim që të mbytnin luftën e popullit tonë dhe t'i rrëmbenin fitoren nga duart. Por qëndrimi i vendosur dhe heroik i Partisë sonë i pengoi dhe i shpartalloi qëllimet dhe tentativat e tyre. Mësimet e pavdekshme të Revolucionit të Tetorit dhe eksperiencia e Partisë së lavdishme Bolshevike shpëtuan Partinë tonë dhe popullin shqiptar nga këto tentativa të tmerrshme të imperialistëve, si gjatë kohës së luftës ashtu edhe pas çlirimit. Edhe pas çlirimit dhe vazhdimisht, imperialistët amerikanë, anglezë, tentuan njëmijë herë të shkatërronin Republikën Popullore të Shqipërisë. Ata organizuan reaksionin e brendshëm dhe atë të jashtëm kundër Republikës sonë. Ata ishin në krye të sabotazheve, të atentateve e të provokacioneve me karakter ndërkombëtar që u kurdisën prej tyre kundër Shqipërisë, ata ishin padronët e trockistëve jugosllavë, që kërkonin të merrnin kalanë nga brenda dhe ta shndërronin Shqipërinë në një koloni të tyre, ata udhëheqin kuislingët e arratisur jashtë, i organizojnë, i hedhin me parashuta e me mjete të tjera në vendin tonë, për të krijuar turbullira, për të bërë atentate dhe sabotazhe, për të dëmtuar punën paqësore të popullit tonë. Por të gjitha përpjekjet e tyre dështuan dhe dështojnë njëra pas tjetrës, pse Republika Popullore e Shqipërisë udhëhiqet nga Partia e Punës e Shqipërisë, parti e tipit leninist, parti që udhëhiqet nga marksizëm-leninizmi, pse ka ndihmën e Bashkimit Sovjetik e të Stalinit, pse ka përkrahjen e gjithë kampit të socializmit dhe të paqes.

Sot Shqipëria e re demokratike popullore, pjella e ideve triumfuese të Marksit-Engelsit-Leninit-Stalinit,

rron dhe lulëzon, forcohet e çelnikoset. Në vendin tonë ndërtohet jeta e re, socializmi, pse Partia jonë, në krye të popullit shqiptar, diti të çelnikosë fitoret e mëdha të revolucionit tonë popullor, sipas mësimeve të Revolucionit të Tetorit. Qysh në ditët e para të çlirimit, pushteti ynë shtetëzoi të gjitha pasuritë e borgjezisë tregëtare, shtetëzoi të gjitha pasuritë e kapitalistëve koncesionarë të huaj, shtetëzoi pasuritë e nëntokës dhe të gjitha këto i bëri pronë të popullit. Shteti i ri shtetëzoi të gjitha tokat e bejlerëve latifondistë dhe u dha tokën fshatarëve në shfrytëzim të përbërshëm. Partia forcoi pushtetin popullor, e bëri këtë të masave, nga më demokratikët, në shembullin e pushtetit sovjetik, forcoi aleancën e punonjësve të qytetit dhe të fshatit, goditi pa mëshirë reaksionin, kuislingët, tradhëtarët, spekulatorët, krijoi dhe forcoi industrinë, bëri të përparojë bujqësia dhe kjo të modernizohet dhe të futen në të metodat e format socialiste të shfrytëzimit të tokës. Në Shqipërinë e re demokratike popullore, ku populli ka marrë fuqinë në duart e veta, me ndihmën e Bashkimit Sovjetik po ndërtohen fabrika dhe kombinatë madhështore, traktorë nga të Stalingradit heroik çajnë tokat e kooperativave tona bujqësore dhe të fshatarëve ku disa vjet më parë përdorej vetëm parmenda e drunjtë. Qytete të ndryshme janë duke u lidhur me hekurudhë. Po ndërtohen hidrocentrale, po thahen kënetat e po bëhen kanalizime të shumta, të gjitha këto për lumturinë e popullit tonë. Kultura dhe arësimi që po bëhen të masave të gjera, po përparojnë në rrugën e shkencës marksiste-leniniste. Demokracitë popullore e ndihmojnë popullin tonë në frymën dhe në rrugën që na ka hapur Revolucionin i

madh i Tetorit. Armiqtë e paqes, që janë armiqtë e Bashkimit Sovjetik, të demokracive popullore dhe të gjithë kampit demokratik në botë, e kanë halë në sy vendin tonë të vogël, por të fortë dhe të patundur. Imperialistët luftëdashës amerikanë, anglezë, agjentët e tyre titistë, monarko-fashistët grekë dhe neofashistët italianë, bëjnë çmos për ta dëmtuar Shqipërinë popullore. Por ata kanë hasur në një shkëmb që s'e përkul furtuna, pse Shqipëria është një shkëmb graniti, i mbujtur me idetë e lavdishme të Revolucionit të madh të Tetorit.

Në këtë ditë të shënuar për gjithë njerëzimin, që është përvjetori i 33-të i Revolucionit të madh të Tetorit, zemra e popullit tonë rreh me dashuri dhe mirënjohje për babanë e revolucionit, për Leninin gjenial. Populli ynë, i madh e i vogël, i udhëhequr nga Partia e tij e Punës ka shtërnguar radhët rreth Bashkimit Sovjetik dhe Stalinit të madh dhe me dashuri e mirënjohje të pakufishme u shpreh këtyre besnikërinë e tij, besën e tij legjendare të maleve. Populli shqiptar i siguron popujt vëllezër të Bashkimit Sovjetik se do të ecë kurdoherë në rrugën e lavdishme të Revolucionit të madh të Tetorit, do ta ruajë si dritën e syve lirinë dhe pavarësinë e tij, do të luftojë me të gjitha forcat për paqen, për socializmin.

*Botuar për herë të parë në gazetën «Për një paqe të qëndrueshme, për një demokraci popullore», Nr. 45 (105), 10 nëntor 1950*

*Botohet sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë*



## MBI MASAT PËR RUAJTJEN E PASURISË SË SHTETIT

*Diskutim në mbledhjen e Qeverisë së RPSH<sup>1</sup>*

23 nëntor 1950

Duke parë gjendjen e rëndë në lidhje me dëmtimin dhe ruajtjen e pasurisë së shtetit, Kryeministria ka ngarkuar Ministrinë e Kontrollit të na japë një raport për këtë çështje. Për ruajtjen e pasurisë së shtetit kemi marrë shumë vendime, kanë dalë dhe shumë ligje; në qeveri e në Komitetin Qendror është ngritur sa herë ky problem, por me keqardhje kostatojmë se jo vetëm që situata nuk ka ndryshuar e nuk tregohet kujdesi i duhur për ruajtjen e pasurisë së shtetit, por dëmtimet vazhdojnë çdo ditë e më shumë. Kjo ka ardhur pse dhe masat që janë marrë deri tani, kanë rënduar në të shumtën e rasteve mbi persona të një rangu të ulët. E dimë se dëmtimet, sabotimet apo vjedhjet bëhen atje ku mungon kontrolli e vigjilenca e Partisë, e pushtetit

---

<sup>1</sup> Diskutim rreth raportit «Mbi mbrojtjen e pasurisë së shtetit», paraqitur në mbledhjen e Qeverisë së RPSH nga Ministria e Kontrollit të Shtetit.

dhe e njerëzve tanë. Përgjegjësia më e rëndë qëndron në moszbatimin si duhet të ligjeve nga organet e pushtetit dhe në moskontrollin e zbatimit të këtyre ligjeve nga ana e Partisë. Fakti tregon se për këtë çështje nuk është bërë asgjë sado që është dhënë një orientim nga Byroja Politike që t'i jepet fund kësaj gjendjeje. Pushteti duhet t'i japë fund kësaj gjendjeje dhe ndaj atyre që nuk do ta zbatojnë këtë orientim në çfarëdo përgjegjësi që të jenë të merren masa të rrepta.

Ne duhet të preokupohemi pse ndodhin këto dëmtime, shpërdorime e vjedhje në shkallë kaq të gjerë. Një gjë e tillë ndodh vetëm atje ku punonjësi nuk është zot i pronës shoqërore. Por, te ne pse ndodhin këto gjëra? Faji mund të jetë te drejtuesit në bazë, të cilët nuk u vënë veshin vendimeve që merr qeveria. Por kjo s'duhet të jetë e tëra. Për të gjetur shkaqet e plota dhe për t'i dhënë fund kësaj gjendjeje, përveç intensifikimit të punës politike, ne propozojmë t'i futemi studimit të këtij problemi për të nxjerrë shkaqet e përgjegjësitë dhe të merren masat e nevojshme. Masat e marrura do t'i kontrollojmë me rigorozitetin më të madh. Ministria e Kontrollit do të kontrollojë në vend nëse janë marrë masa dhe nëse janë zbatuar ato. Në qoftë se nuk do të jenë marrë masa, atëherë të marrë ajo ndaj neglizhuesve.

Ne duam të dimë pse ndodh kjo, pse nuk janë zbatuar këto udhëzime? Kjo ka ndodhur ndofta ngaqë ndaj disa kuadrove në dikastere që kanë neglizhuar këtë çështje, nuk kemi marrë asnjë masë. Kështu nuk mundet të ecet edhe për një arësye tjetër, sepse te disa kuadro, duke u nisur nga mendimi i kalbur se «unë jam

drejtor ose ndihmësministër etj. dhe nuk merren masa për mua» formohet një farë imuniteti. Kjo gjendje duhet të mbarojë. Kush ka faj, të mbajë përgjegjësi, kushdo qoftë, pse shohim që po vazhdohet të mos kujdesen për pasurinë e shtetit. Kjo duhet të na preokupojë dhe atje ku nuk bëjnë efekt dënimet, konkluzioni duhet të jetë se mungon ndërgjegjja për zbatimin e vendimeve. Gjithashtu nga ministritë nuk janë bërë të qarta detyrat e drejtorëve, të cilët duhet të vijnë dhe të japin llogari përpara ministrit për gjëra të rëndësishme. Unë vura re se shokut të Komitetit ekzekutiv të Elbasanit, nuk i bëri përshtypje të madhe vërejtja që i bëme. Njerëz të tillë të thërriten shpesh në raport dhe të vihen përpara përgjegjësive dhe, po nuk u bënë efekt kritikata, më duket se ka ardhur koha që ata që s'e kryejnë detyrën të japin llogari.

Ne duhet t'u japim fund këtyre dëmtimeve e shpërdorimeve dhe të marrim masa; në radhë të parë të bëjmë inventarët duke e parë problemin nga ana ekonomike e financiare; të merren masa për të zhdukur pakujdesitë që shkaktojnë dëmtimin e materialit dhe të mos mbetemi në masa të përgjithshme. Këto masa duhet të jenë të vazhdueshme dhe duhet të kemi parasysh edhe një diçka tjetër, detyrat nuk mund t'i kryejnë vetëm ministrat, por duhet të sqarohet e të mobilizohet mirë i gjithë aparati vartës që secili të kontrollojë e të ndihmojë në zbatimin e urdhërave dhe secili ta njohë mirë sektorin e tij, secili duhet të bëjë që edhe ata që janë në vartësinë e tij, të punojnë si ai.

Edhe unë jam i atij mendimi që shprehën shokët e tjerë që këtë studim të Ministrisë së Kontrollit ta

marrin dhe ta studjojnë mirë e me seriozitetin e duhur të gjitha dikasteret dhe të dalin me konkluzione.

Dikasteret kanë plot të meta si këto, ka nga ato që tregojnë më shumë kujdes, po ka dhe të tjera që thonë «ku rafsha mos u vrafsha» dhe që në fund nuk dinë nga të dalin.

Dëmtimet, shpërdorimet e vjedhjet e pasurisë së shtetit, duhet t'i shikojmë seriozisht. Revizorët që nuk punojnë mirë duhet t'i mësojmë ta bëjnë më mirë punën në mënyrë që në fund të vitit të kenë përfunduar inventarët, regjistrimin e përgjithshëm të materialeve. Regjistrimi që ka filluar, të vazhdojë e të përfundojë deri në dhjetor të vitit 1950. Zvarritja tregon se çështja e inventarëve nuk njihet si duhet, prandaj të vendoset një herë e mirë kjo çështje. Për vitin 1951 të formohet një komision për të studjuar çështjen e inventarizimit dhe ky studim t'i paraqitet Kryesisë së Këshillit të Ministrave.

*Botohet për herë të parë sipas  
tekstit të nxjerrë nga proces-  
verbali i mbledhjes së Qeverisë  
së RPSH që gjendet në Arkivin  
e Këshillit të Ministrave të  
RPSH*

## SHQIPËRIA MBUSH SOT GJASHTË VJET QË RRON E LIRË DHE E PAVARUR<sup>1</sup>

29 Nëntor 1950

Shqipëria mbushi sot gjashtë vjet që rron e lirë dhe e pavarur. Populli shqiptar ka vuajtur shumë gjatë historisë së tij. Të gjithë armiqtë kanë dashur ta likuidonin, por s'kanë mundur, pse ai është mbrojtur duke luftuar me heroizëm. Mbi popullin tonë janë vërsulur me radhë invadorë të ndryshëm. Ai ka vuajtur tmerret e mesjetës nga imperialistët e rinj, nga mbretërit satrapë, nga fashistët barbarë, nga feudalët gjakpirës dhe të shitur te të huajt. Por kurdoherë populli shqiptar ka qëndruar më këmbë i papërkulur, u ka rezistuar furtunave dhe u është qepur maleve me armë në dorë duke i shndërruar këto në fortesa të pamposhtura nga armiku. Populli ynë i vogël u rezistoi kohërave dhe armiqve. Koha punoi për popullin tonë.

Kuptohet lehtë, pra, sa e çmon populli shqiptar lirinë dhe paqen dhe sa i urren imperialistët gjakatarë

”

---

<sup>1</sup> Ky artikull i është dërguar redaksisë së gazetës «Pravda», e cila e ka botuar me shkurtime dhe me titull «Në luftë për paqen dhe socializmin».

dhe luftënxitës, feudalët, mbretërit dhe borgjezinë tradhëtare, që kanë qenë kurdoherë shkaktarët e mjerimeve të tij të llahtarshme.

Kuptohet lehtë sa ngushtë është lidhur populli ynë dhe me sa zemër dhe besnikëri e do Bashkimin Sovjetik, Stalinin e madh dhe Partinë e lavdishme Bolshevike që janë ndër faktorët kryesorë të fitores së shkëlqyer të popullit shqiptar.

Populli shqiptar ishte i rrethuar me armiq që i kishin vënë pushkën në gjoks dhe i përgatitnin litarin për ta varur. Idetë e Leninit dhe të Stalinit, farkëtarët dhe udhëheqësit e Revolucionit të madh të Tetorit, lëshuan rrezet e ndritshme dhe jetëdhënëse në skajet më të largëta të vendit tonë ku lëngonte, i lidhur me zinxhirët e robërisë, populli ynë i mjeruar. Partia e Lenin-Stalinit e mësoi popullin tonë të luftonte dhe të organizonte Partinë e tij heroike Komuniste që do ta udhëhiqte në luftën dhe në fitoret vendimtare. Ushtria famëmadhe e Kuqe, duke zbatuar me heroizëm legjendar vullnetin e popujve të saj të shprehur nga goja e Stalinit, u bë flamurtare e lirisë së popujve. Populli ynë i vogël përqafoi me dashuri revolucionin që e nxori përgjithmonë nga errësira në dritë dhe i dha jetë e lumturi.

Dashuria për Bashkimin Sovjetik dhe për Stalinin nuk njih kufi në zemrën e njerëzve të thjeshtë. Popujt i duan këta njësoj si atdheun e tyre, pse fatet e atdheut të tyre janë të lidhura me atë të Bashkimit Sovjetik. Kurrë imperializmi që po kalbet nuk do të mundë ta tronditë këtë dashuri që kanë popujt ndaj Bashkimit Sovjetik dhe kurrë trafikantët e vdekjes nuk do të arrij-

në të errësojnë qoftë edhe pak dashurinë dhe besnikërinë e popujve për Bashkimin Sovjetik dhe për Stalinin. Popujt kurrë nuk mund të mposhten dhe as ndjenjat e tyre të pastra të lirisë, të paqes e të demokracisë.

Populli shqiptar dhe popujt e tjerë të demokracive popullore patën fatin e lumtur të çlirohen dhe të ndërtojnë socializmin me ndihmën e Bashkimit Sovjetik, më parë se shumë popuj të tjerë që lëngojnë akoma nën thundrën e imperialistëve dhe të shërbëtorëve të tyre. Por edhe për këta popuj drita e lirisë ka aguar me kohë. Çlirimi i tyre nuk është veçse çështje kohe. Rrota e historisë nuk mund të kthehet prapa dhe njerëzimi këtë ja detyron Revolucionit të madh të Tetorit.



Këtë ndjente dhe kështu mendonte populli shqiptar për Bashkimin Sovjetik dhe për të ardhshmen e atdheut të tij, kur ai filloi luftën e tij të çlirimit.

Me besim të patundur në fitoren e Ushtrisë së Kuqe luftoi populli ynë. Partizanët shqiptarë me emrin e Stalinit në gojë sulmonin armikun kudo dhe e thyenin. Njerëzit e thjeshtë të maleve dhe të fushave tona binin në fushën e nderit duke mbajtur në gji Historinë e Partisë Bolshevike të Stalinit, që i mësonte dhe i bënte heronj.

Fitoret legjendare të Ushtrisë Sovjetike frymëzuan e sollën fitoret e Ushtrisë sonë Popullore. Ne fituam në saje të luftës legjendare të popullit tonë të udhëhequr nga Partia, në saje të fitoreve mbi nazizmin

të Ushtrisë Sovjetike që e udhëhoqi strategu më i madh i kohës, Josif Visarionoviç Stalini.

Komiteti Qendror i Partisë Komuniste të Shqipërisë, në momentet e para të luftës u bënte thirrje anëtarëve të Partisë kështu:

*«Komunistë të Shqipërisë, Komiteti Qendror i Partisë Komuniste të Shqipërisë ju thërret që të mobilizoheni dhe të kryeni detyrën karshi popullit. Ju thërret të punoni pa u lodhur dhe pa pushim, të lidheni me shtresat më të gjera popullore, për t'u shpjeguar dhe për t'u treguar nevojën e Luftës nacional-çlirimtare, ju thërret të jeni luftëtarë të pafrikshëm për të drejtat e popullit. Me vetëmohimin tuaj jepni shembullin të tjerëve»<sup>1</sup>.*

*«Luftën tonë nacional-çlirimtare duhet ta lidhim ngushtë me luftën heroike të popujve të Unionit Sovjetik, që gjenden në ballë të luftës çlirimtare kundër fashizmit»<sup>2</sup>.*

*«Që të jeni të denjë për besimin që populli shqiptar ka vënë në ju, vazhdoni traditën e bolshevikëve të Leninit e Stalinit duke dhënë shembullin e vendosjes revolucionare, të sakrificës, të inisiativës dhe të organizimit. . . Të jeni përherë në vendet më të para të luftës, atje ku më i madh të jetë rreziku»<sup>3</sup>.*

<sup>1</sup> «Dokumenta Kryesore të PPSH». Vëll. I, f. 75.

<sup>2</sup> Po aty, f. 27.

<sup>3</sup> Po aty, f. 28.



Formimi i Partisë Komuniste të Shqipërisë në vitin 1941 ishte sukcesi më i madh dhe sigurimi i fitores së popullit tonë. Ajo u ndërtua në bazë të parimeve marksiste-leniniste dhe luftoi me burrëri për t'i mbajtur të pastra dhe të paprekshme këto parime që bënë forcën e pamposhtur të saj. Partia jonë luftoi dhe udhëhoqi me heroizëm popullin kundër pushtuesve, fashistëve italianë dhe gjermanë, që kërkonin me çdo kusht ta likuidonin. Ajo u bëri ballë me sukses luftës dhe intrigave të kuislingëve, të pseudodemokratëve nacionalistë të shitur te okupatorët, kundër borgjezisë dinake dhe feudalëve satrapë, kundër fraksionistëve, trockistëve dhe arqiomarksistëve. Partia jonë u kalit në luftëra të përgjakshme duke udhëhequr me sukses luftën e popullit shqiptar; ajo krijoi me luftë pushtetin popullor duke rrëzuar që nga themeli pushtetin e vjetër të borgjezisë; ajo zhvilloi luftën partizane duke mësuar nga luftërat heroike dhe taktika e partizanëve të Leninit dhe të Stalinit; ajo ngriti në këmbë një ushtri të tërë popullore dhe e çoi popullin në kryengritjen e përgjithshme të armatosur dhe në fitoren e plotë.

Kështu u çlirua përgjithmonë një popull i vogël i Ballkanit, që shekuj me radhë kishte vuajtur në robëri. Kështu për herë të parë, më 29 Nëntor 1944 valoi në gjithë Shqipërinë flamuri krenar dhe i papërkulur i stërgjyshërve tanë, të cilin në luftën më të përgjakshme dhe më të lavdishme që ka parë historia e popullit tonë, Partia Komuniste e Shqipërisë dhe gjithë patriotët shqiptarë e mbajtën kurdoherë lart dhe ngadhjimtari.

Popullit tonë të vogël prej një milion banorësh ju vranë në luftë 28 000 vetë, partizanë dhe civilë, ju do-

gjën 64 475 shtëpi, ju dëmtuan e ju therën qindra mijë kafshë, ju dogjën fshatra dhe qytete të tëra, ju shkatërrua bujqësia, ju hodhën krejtësisht në erë urat, ju shkatërruan rrugët, fabrikat, centralet e vogla elektrike, portet e Durrësit, të Vlorës, të Sarandës etj. Por haka nuk u la pa marrë. Ushtria jonë Popullore vrau 26 594 nazi-fashistë gjermanë dhe italianë, plagosi 21 245 vetë dhe zuri rob 20 800 të tjerë. Ushtria jonë luftoi me armët që u rrëmbeu pushtuesve në luftime dhe ajo u siguraa për shumë vjet me radhë me armët e zëna nga armiku.



Imperialistët anglo-amerikanë kanë luajtur njëmi-  
jë e një poshtërsi kundër popullit tonë. Në të kaluarën  
Shqipëria ishte vazhdimisht në mëshirën e imperialis-  
tëve. Zëri dhe pushka e popullit tonë as që dëgjohej prej  
tyre. Duke publikuar traktatet e fshehta të qeverisë ca-  
riste në mes të të cilave dhe traktatet që i bënë varrin  
popullit shqiptar, qeveria sovjetike ua çori maskën im-  
perialistëve. «Ujku ndërron qimen, por jo lëkurën» —  
thotë populli ynë. Kështu dhe imperialistët. Ata s'hoqën  
dorë nga Shqipëria, derisa ua premë dorën. Gjatë gjithë  
Luftës nacional-çlirimtare, populli shqiptar i qëndroi  
besnik aleancës së madhe antifashiste që udhëhiqej prej  
Bashkimit Sovjetik. Por imperialistët anglezë dhe ame-  
rikanë u përpoqën me të gjitha mjetet që të shpartallo-  
nin luftën e popullit shqiptar, ta mposhtnin me dinakëri  
qëndresën e tij heroike dhe t'i përgatitnin një skllavërim  
të ri. Kjo punë e poshtër u ishte besuar nga Çerçilli dhe

Trumani me shokë agjentëve të tyre ushtarakë, të cilët pa u ftuar e pa lajmëruar, u futën në Shqipëri, nëpërmjet Greqisë, gjoja për të ndihmuar luftën e popullit tonë me armë e me municione. Misioni i tyre ishte krejt ndryshe nga ç'pretendohej. Ata ishin armiq të betuar të popullit shqiptar. I pari nga këta armiq ishte agjenti i Inteligens Servis-it, koloneli Mak Lin. Ky hyri pa leje në territorin e çliruar nga partizanët shqiptarë dhe që ditën e parë filloi punën armiqësore.

Udhëheqja e luftës sonë dha urdhër kategorik të mbahej nën vërejtje ky intrigant dhe të ndalohej veprimtaria e tij. Koloneli anglez Mak Lin kujtonte se kishte të bënte me skllëvër, por u detyrua të qëndronte i mbyllur në një fshat të Lunxherisë derisa pranoi të zbatonte urdhërat e shtabeve partizane të Ushtrisë Nacional-Çlirimtare. Planet e kolonelit Mak Lin dhe të shokëve të tij të tjerë, që mundën të vinin më vonë, gjoja nën maskën e alcatëve dhe me pretekstin se do ta ndihmonin luftën e popullit shqiptar me armë, kishin për qëllim të frenonin luftën e popullit tonë, të shpartallonin udhëheqjen e saj, Partinë Komuniste, të organizonin reaksionin nën komandën e tyre dhe, në bashkëpunim me ushtrinë e okupatorit gjerman të shtypnin revolucionin popullor dhe të vendosnin, pas tërheqjes së gjermanëve, pushtetin e borgjezisë dhe të feudalëve nën urdhërat e tyre. Me një fjalë, të bënin në Shqipëri atë që bënë në Greqi në kohën e luftës dhe atë që përgatitën në Jugosllavi që në kohën e luftës e që u demaskua krejtësisht në kohën e pasluftës. Partia Komuniste e Shqipërisë, parti e tipit Lenin-Stalin, ua zbuloi planet që në fillim dhe ua shkatërroi. Rreth okupatorëve italia-

në dhe gjermanë ishte grumbulluar reaksioni me në ballë kuislingët, feudalët, kulakët, borgjezinë e qyteteve. Reaksioni shqiptar i inkuadruar në organizatat tradhëtare, si «Balli Kombëtar», «Legaliteti» i mbretit Zog e të tjera pseudoorganizata demokrate, ishte bërë dorë e djathtë e ushtrisë së okupatorëve dhe tok me këta, ai luftonte me armë në dorë, me intriga e me demagogji kundër popullit tonë dhe Partisë Komuniste. Por Fronti Nacional-Çlirimtar, i udhëhequr nga Partia Komuniste, ua shpartalloi të gjitha intrigat dhe demagogjitë e tyre, ua çori maskën, i izoloi nga populli. Ushtria Partizane Nacional-Çlirimtare i theu të gjitha ofensivat e okupatorëve dhe të kuislingëve, i goditi pa pushim forcat e tradhëtarëve, të cilëve s'u la kohë, as të grumbullohen, as të riorganizohen, deri në shpartallimin e plotë të tyre. Për t'i mëkëmbur këta tradhëtarë, patën ardhur emisarët e Çërçillit e të Uoll Strit-it.

Agjentët anglezë dhe amerikanë të ardhur në Shqipëri kishin qëllime të caktuara:

*Së pari*, ata donin të merrnin frenat e udhëheqjes së luftës së popullit shqiptar në duart e tyre. Duke hasur në një luftë të vendosur nga ana e Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë Nacional-Çlirimtare kundër qëllimeve djallëzore të tyre, Mak Lin kërkoi të kishte disa misione ushtarake në vende të ndryshme të Shqipërisë dhe, gjoja, për të zhdukur burokracinë, propozoi që kërkesat në armë e në municione që mund të bëheshin nga ana jonë, të mos bëheshin drejtpërdrejt nga Shtabi i Përgjithshëm i Ushtrisë Nacional-Çlirimtare, por nga zonat ushtarake, ku do të ishin këto misione. Këtë taktikë të anglezëve, për të eliminuar udhëheqjen e luftës së po-

pullit shqiptar dhe për të marrë me mënyra të tjera drejtimin e luftës në Shqipëri, ua shqelmoi Partia Komuniste dhe nuk i lejoi për asnjë minutë që ta vinin në zbatim këtë plan djallëzor. Jo vetëm kaq, por ajo nuk i lejoi në asnjë mënyrë oficerët anglezë, të ngrinin tendat e tyre në krahinat ku donin ata dhe pa qenë nën kontrollin direkt të komandave partizane.

*Së dyti*, ata kishin për qëllim të informoheshin mbi forcat e partizanëve, mbi organizimin e tyre, mbi të mirat dhe dobësitë, që kështu të na luftonin më mirë dhe më lehtë. Por Partia Komuniste i mësoi njerëzit të qepnin gojën dhe të ishin shumë vigjilentë.

*Së treti*, ata donin të frenonin lëvizjen nacional-çlirimtare me qëllim që të fitonin kohë derisa të arrinin të organizonin reaksionin, të krijonin bazat, të krijonin lidhjet me armiqtë e popullit tonë dhe atëhere ta kthenin karakterin e kësaj lëvizjeje në shërbim të tyre.

Partia heroike Komuniste e Shqipërisë ua shkatërroi të gjitha këto plane. Spiunët anglezë dhe amerikanë vunë në shërbim të kuislingëve dhe të organizatave tradhëtare të «Ballit Kombëtar» dhe të «Legalitetit», të gjitha mjetet e tyre deri te emisionet e radio Londrës, e cila përpiqej që luftën heroike të popullit shqiptar t'ua atribuonte atyre që ishin lidhur haptas me italianët dhe gjermanët dhe luftonin me armë në dorë kundër popullit tonë e aleatëve. Deri këtu kishte arritur cinizmi i tyre. Ky shërbeu edhe më tepër për shtimin e vigjilencës nga ana e partizanëve kundër qëllimeve të imperializmit anglo-amerikan. Sa për dërgimin e armëve, ky ishte një bluf i madh, që kurrë nuk e gëlltiti Partia jonë Komuniste. Edhe ato pak armë që na hodhën an-

glezët ishin qesharake dhe këtë e bënë vetëm nën presionin e vazhdueshëm të Komandës së Përgjithshme të Ushtrisë Nacional-Çlirimtare, e cila, më në fund, i paralajmëroi se, në rast se ata nuk do t'u përmbaheshin angazhimeve për fatkeqësitë që mund t'u ndodhnin reparteve partizane, të cilat ishin angazhuar në luftime të ashpra me gjermanët dhe me kuislingët, do të shpallte botërisht se përgjegjës direkt ishin kryetarët e misioneve angleze në Shqipëri.

Duke u dështuar planet e tyre, pjesa më e madhe e oficerëve anglezë kaloi nga zonat partizane në zonat e reaksionit, ku mori direkt kontakt me kuislingët, me kryetarët tradhëtarë të «Ballit Kombëtar» dhe të «Legalitetit», me oficerët e lartë të ushtrisë gjermane. Emisarët e Çerçillit dhe të Trumanit, tani, i ndanë hapët rolet e tyre. Një pjesë, nën komandën e kolonelit Mak Lin, të cilit ju bë jeta e pamundur në zonat e çliruara, kaloi në zonat e pushtuara, mori lidhje me okupatorët dhe me kuislingët dhe qëndroi në shtabin e tradhëtarit Abaz Kupi, njeriu i mbretit Zog, bashkëpunëtor i hapët i kryeministrave kuislingë Mehdi Frashërit dhe Rexhep Mitrovicës dhe komandantit nazist gjerman, gjeneralit Shmoll. Atje misionet angleze filluan haptas organizimin e forcave të reaksionit të shpartalluara nga ushtria partizane dhe, tok me ushtrinë gjermane, përgatitën ofensivën e fundit me të cilën kujtonin se do të shkatërronin definitivisht Ushtrinë Nacional-Çlirimtare. Puna armiqësore e këtyre agjentëve anglezë ishte aq e hapët sa që koloneli Mak Lin dhe shokët e tij ndodheshin me armë në dorë në luftimet që zhvillonin bandat e tradhëtarit Abaz Kupi kundër forcave partizane. Ky akt cinik

dhe i poshtër e detyroi Komandën e Përgjithshme të Ushtrisë Nacional-Çlirimtare Shqiptare t'i kërkojë Komandës aleate të Mesdheut të tërhiqte menjëherë nga Shqipëria kolonelin Mak Lin, dhe se hiqte çdo përgjegjësi në rast se në luftë vritej koloneli anglez në fjalë bashkë me shokët e tij. Në rast se ai kapej rob në luftime, do të kalonte përpara gjyqit të lartë ushtarak të partizanëve njësoj sikur të ishte nazist dhe kuisling. Kuptohet se Komanda aleate e Mesdheut bëri veshin e shurdhër dhe vazhdoi punën e saj. Në zonat e çliruara nga partizanët, Çerçilli dërgoi një mëngjez pa pyetur njëri një gjeneral me emrin Deiviz, i cili do të komandonte atë pjesë të oficerëve anglezë që ndodhej këtej dhe do të ndreqte, gjoja, gabimet që kishin bërë Mak Lin me shokë. Ishte afër mendsh që ky s'ishte përveçse një Mak Lin i dytë, i cili do të kryente ato veprime që do të bënte më vonë zëvendësi i tij Palmer, po të mos kishte rënë rob i gjermanëve. Ky farë gjenerali anglez me dy kobure në brez dhe me automatik «Tomson» në krahë, kërkonte të hiqej si luftëtar, për t'u hedhur hi syve partizanëve, por ai mori kontakt me krerët e tradhëtisë dhe u vu në dijeni për ofensivën e dimrit të përgatitur nga gjermanët, kuislingët dhe shokët e tij me Mak Linin në krye dhe e priste atë me padurim. Ai priste disfatën tonë për të marrë mbasandaj tërë drejtimin e lëvizjes tradhëtare, si famëkeqi gjeneral Skobi. Ofensiva e madhe gjermane shpërtheu me furi në një dimër të egër. Partizanët kudo u angazhuan në luftime të ashpra. Gjenerali anglez u gjend i rrethuar në malet e larta të Martaneshit tok me një pjesë të Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë Nacional-Çlirimtare. Gjenerali anglez dhe

oficerët e tij ushqeheshin me çokollata, kurse partizanët kishin tri ditë pa ngrënë. Ai kujtoi se i erdhi fundi ushtrisë sonë dhe me indinjacion u tha pjesëtarëve të Shtabit të Përgjithshëm se «e kanë kot që luftojnë, duhet të hedhin armët». Përgjegjen e mori përnjëherësh si një kamxhik në fytyrë: «Partizanët shqiptarë s'e kanë zakon t'i hedhin armët, por zakoni i tyre është të luftojnë deri në pikën e fundit të gjakut të tyre. Ne do të fitojmë dhe do t'i mundim gjermanët dhe kuislingët». Dhe partizanët shqiptarë s'i hodhën armët siç dëshironte gjenerali anglez Deviz. Ata luftuan kundër qindra gjermanëve dhe tradhëtarëve dhe vranë shumë prej tyre, e çanë rrethimin, kurse gjenerali anglez Deviz dhe oficerët e tij s'hodhën asnjë pushkë, por hodhën koburet e «Tomsonet» dhe ngritën duart e u dorëzuan te gjermanët. Ky ishte fundi «i denjë» i një gjenerali anglez frikacak, që s'kishte ardhur të luftonte gjermanët, por kishte ardhur t'i bënte varrin popullit tonë.

Ushtria Nacional-Çlirimtare Shqiptare e theu ofensivën gjermane dhe u hodh në kundërofensivë të ashpër që do ta çonte në fitoren e plotë. Gjermanët po thyheshin, kuislingët po dërmoheshin dhe vepra e agjentëve anglezë do të merrte fund një herë e përgjithmonë. Ushtria e lavdishme Sovjetike po vërsulej ngadhnjimtare drejt Ballkanit dhe po i sillte këtij lirinë. Ushtria jonë partizane me divizione dhe korparmata të tëra u hodh në ofensivë. Për agjentët e Çërçillit dhe të Trumanit në Shqipëri, ky ishte momenti vendimtar që do përcaktonte fatin e tyre në vendin tonë. Partia Komuniste e Shqipërisë ua shpartalloi krejtësisht planet e tyre edhe këtë herë. Në arkivat historike të vendit tonë



ndodhen letrat në formë ultimatumit të poshtër që kryekomandanti i Shtabit të Mesdheut feldmareshali Aleksandër dhe mareshali i ajrit Eliot, i dërguan Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë Nacional-Çlirimtare, ku e urdhëronin këtë, të ndalonte luftën e saj, të mos çlironte Shqipërinë e Veriut, të mos godiste kuislingët Abaz Kupi dhe të tjerë. Feldmareshali Aleksandër dhe shokët e tij muarën përgjegjen e merituar prej Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë Nacional-Çlirimtare, të ushtrisë së popullit shqiptar. Të gjithë kuislingët që kishte marrë në mbrojtje feldmareshali Aleksandër, duke pasur në krye agjentin e tij, kolonelin Mak Lin, në një natë të errët, si kusarë, ashtu si erdhën, shkuan me një varkë angleze në Itali për t'i shpëtuar dënimit të popullit shqiptar. Krahas me ultimatumet e përmendura më sipër, feldmareshali Aleksandër tentoi të hidhte me parashutë në vendin tonë forca angleze që të merrnin kalanë nga brennda. Por as kjo manevër nuk i shkoi, pse Partia Komuniste e Shqipërisë ruante dhe vigjilonte. Feldmareshali Aleksandër tentoi të mbante komandon e tij që u lejua të zbriste në Sarandë, gjoja për të luftuar së bashku gjermanët dhe ta kishte këtë si një bazë të saj në bregdetin dhe në tokën e Shqipërisë. Por Shtabi i Përgjithshëm i Ushtrisë Nacional-Çlirimtare, ja tha qartë feldmareshalit Aleksandër, se «në rast se komandoja angleze nuk tërhiqet nga Saranda në datën e caktuar, atëherë do të shpërthejë lufta në mes partizanëve dhe anglezëve». Anglezët u detyruan të tërhiqen. Këto janë në përgjithësi aktet e poshtra të imperialistëve anglezë dhe amerikanë gjatë luftës kundër vendit tonë. Por edhe mbas çlirimit ata s'i hodhën armët. Me forma të tjera

vazhdoi po ajo punë armiqësore. Misionet angleze, që ndodheshin në Shqipëri gjatë kohës së luftës e pas çlirimit, u thirrën nga Qeveria Demokratike e Shqipërisë të largoheshin nga vendi ynë, pse s'ekzistonte asnjë arësye që të qëndronin më. Të gjithë oficerët anglezë u detyruan të largohen, por jo pa të shtyra. I famshmi feldmareshal Aleksandër nuk mungoi përsëri t'i dërgonte ultimatumet qeverisë shqiptare duke i thënë se ai dëshironte të kishte një mision ushtarak në Tiranë, shumë të gjerë dhe po të mos pranohej kërkesa e tij, njohja e qeverisë shqiptare nga qeveria angleze, nuk do të bëhej. Ishte i qartë qëllimi i anglezëve, prandaj kërkesat dhe shantazhet e tyre nuk frikësuan njeri, por u kthyen andej nga erdhën dhe qeveria angleze u lejua të dërgojë në Tiranë vetëm një mision të vogël me një gjeneral në krye. Shqipëria tani ishte e lirë, e pavarur, ajo mbrohej fuqimisht si kurdoherë nga Bashkimi Sovjetik. Nazizmi gjerman u dërmua. Miqtë shqiptarë të anglezëve, një pjesë gjendej në Itali, dhe pjesa tjetër bashkë me disa kuislingë, miq të tyre, jepnin llogari përpara gjyqeve të popullit. Anglezëve dhe amerikanëve u duhej të rifillonin punën e tyre armiqësore kundër popullit tonë me mjete të reja dhe me njerëz të rinj që do të rekrutonin në radhët e borgjezisë dhe të mbeturinave të fashizmit. Misioni amerikan në Tiranë me në krye banditin amerikan Herri Fulc dhe ai anglez me në krye një bandit tjetër gjeneralin Hoxhson, u vunë në krye të një vargu komplotesh, aktesh sabotazhi, terrori dhe atentatesh për të rrëzuar pushtetin popullor dhe për t'i hedhur përsëri prangat Shqipërisë. Këta armiq nuk vunë mend nga disfatat që pësuan gjatë kohës

së luftës. Nën maskën e ndihmës së UNRRA-s anglezët dhe amerikanët u përpoqën të futnin hundët në organizmat e shtetit shqiptar, por Partia Komuniste e Shqipërisë dhe qeveria popullore, ua preu vendosmërisht rrugët. Me anën e një farë ndërmarrjeje ushtarake që kishte për initiale M.L., amerikanët dhe anglezët, gjoja për të ndihmuar popullin shqiptar me ushqime dhe me veshmbathje, tentonin të zbërkonin në Shqipëri forca të shumta për të rrëzuar pushtetin e popullit me armë. Por Partia jonë dhe qeveria popullore ua refuzuan këto kërkesa. Dokumentat që ndodhen në arkivat historike të Luftës sonë nacional-çlirimtare për të cilat bota ka marrë dijeni me kohë nga publikimi i tyre, vërtetojnë këto komplete të anglezëve dhe të amerikanëve. Përgatitjet e anglezëve dhe të amerikanëve për të sulmuar Shqipërinë e re edhe pas çlirimit, dështuan kryekëput. Atëhere banditët imperialistë amerikanë dhe anglezë, filluan të rigruponin mbeturinat e fashizmit brenda në Shqipëri, t'i organizonin këta të bënin atentate për të vrarë udhëheqësit e popullit shqiptar. Ata organizuan atentate, organizuan sabotazhe në fabrika që po ndërtoheshin, në ndërmarrje të mëdha me karakter nacional dhe kudo ku populli shqiptar, me duar e me thonj, rindërtonte atdheun e rrënuar nga lufta. Të gjitha këto u zbuluan me kohë, u shpartallua rigrupimi i reaksionit nën drejtimin e mister Fulcit e të Hoxhsonit dhe populli pa qartë se ç'ishin këta banditë që, nën maskën e aleatëve, kërkonin të spekulonin me gjakun dhe me djersën e një populli të vogël. Këto misione diplomatike amerikane dhe angleze, që qëndronin në Tiranë, gjoja për të rregulluar çështjen e njohjes së qeverisë shqiptare nga

Amerika dhe Anglia, s'ishin tjetër veçse një bandë agjentësh dhe sabotatorësh. Pas demaskimit të veprimtarisë së tyre të poshtër, këtyre misioneve s'u mbeti tjetër përveçse të qëroheshin, të largoheshin nga Shqipëria. Të diskredituar dhe të demaskuar ata u larguan, po jo pa e ngritur çështjen e Shqipërisë në planin ndërkombëtar duke trilluar të ashtuquajturin incident të kanalit të Korfuzit, një provokacion i madh dhe i denjë për Albionin<sup>1</sup>. Një propagandë e poshtër shpifjesh në shkallë ndërkombëtare që dihet prej gjithë botës u ngrit nga amerikanët dhe anglezët kundër vendit tonë heroik dhe paqedashës, gati në të gjitha konferencat ndërkombëtare. Por Shqipëria kishte përkrahës të lavdishëm Bashkimin Sovjetik, i cili mbrojti me heroizëm kudo dhe kundër çdo armiku kauzën e Shqipërisë. Bashkimi Sovjetik i demaskoi pa mëshirë orvatjet e poshtra të anglo-amerikanëve dhe forcoi jashtëzakonisht pozitat ndërkombëtare të Shqipërisë së vogël. Kishin vdekur përgjithmonë kohërat e kongreseve të Vienës<sup>2</sup> e të Berlinit<sup>3</sup>.

<sup>1</sup> Kështu quhej në kohët e vjetra Anglia.

<sup>2</sup> Kongresi i Vienës u mbledh prej tetorit 1814 deri në qershor 1815 për t'i diktuar Francës së mundur nga Rusia, Prusia, Anglia, Austro-Hungaria etj. kushtet e paqes dhe për të caktuar hartën e re të Evropës sipas interesave të tyre duke marrë nëpër këmbë interesat kombëtare të popujve.

<sup>3</sup> Kongresi i Berlinit që filloi punimet e tij më 13 qershor 1878, duke marrë nëpër këmbë parimin e vetëvendosjes së kombeve mori një varg vendimesh për rishikimin e paqes së Shën Stefanit, me të cilat ruajti sundimin otoman në një pjesë të Ballkanit. Fuqitë e mëdha që bënë pjesë në këtë kongres: Anglia, Austro-Hungaria, Franca, Italia, Gjermania dhe Rusia mohuan ekzistencën e Shqipërisë dhe e bënë atë objekt pazarllëqesh.

dhe e traktateve të fshehta në mes të imperialistëve për të bërë monedhë shkëmbimi shtetet e vegjël ose të mëdhenj. Për popujt e botës dhe për mbrojtjen e të drejtave të tyre qëndronte kolos Bashkimi Sovjetik.

Ndërhyrja e drejtëpërdrejtë e anglo-amerikanëve për të rrëzuar pushtetin popullor në Shqipëri, u bë e pamundshme. Imperializmi amerikano-anglez u përpoq ta merrte kalanë nga brenda dhe futi në lëvizje agjenturën e tij të vjetër, trockistët e Beogradit me Titon në krye. Veprimtaria e fshehtë dhe tradhëtare e grupit trockist të Beogradit përbënte një kërcënim shumë serioz për popullin tonë, pse nën maskën e një miqësie të ngushtë që ekzistonte në mes të popullit shqiptar dhe atij jugosllav, miqësi e farkëtuar në luftën e përgjakshme kundër fashizmit, grupi i Titos kishte mundur të ndërhynte thellë në çështjet e vendit tonë dhe të organizonte bandën e tradhëtarëve me Koçi Xoxen në krye.

Trockistët e Beogradit kishin në plan të realizonin atë që anglo-amerikanët nuk mundën dot ta realizonin me ndërhyrjet e drejtëpërdrejta të tyre. Por Partia e lavdishme Bolshevike dhe Stalini e zbuluan këtë tradhëti dhe e ndihmuan popullin, Partinë dhe Republikën tonë Popullore të ruajnë lirinë e pavarësinë e tyre. Klika e Beogradit kishte në plan të shkatërronte Partinë tonë të dashur, ta hidhte këtë në dorën e saj nëpërmjet bandës së Koçi Xoxes dhe të skllavëronte popullin tonë duke e kolonizuar Shqipërinë. Agjentët jugosllavë dhe bashkëpunëtorët e tyre shqiptarë, pregatitën dhe zhvilluan sabotime të mëdha në të gjitha degët e ekonomisë shqiptare, ata vodhën pasurinë e popullit, ata u përpoqën të demoralizonin dhe të poshtëronin ushtrinë tonë

heroike, ata tentuan të shndërronin karakterin demokratik të regjimit tonë me metoda terroriste dhe barbare, ata tentuan të dërmonin Partinë nga brenda, të shkatërronin principet e pavdekshme leniniste-staliniane të Partisë sonë që përbënin qenjen dhe forcën e saj, ata tentuan të shuanin dashurinë dhe besnikërinë e Partisë sonë dhe të popullit shqiptar ndaj Bashkimit Sovjetik dhe më në fund ata tentuan të na pushtonin duke sjellë divizione të tyre në Republikën Popullore të Shqipërisë. Partia jonë Komuniste që qëndronte e çelniktë si kurdoherë i dërmoi të gjitha orvatjet e trockisto-nacionalistëve jugosllavë, e qëroi këtë rrezik dhe këtë plagë të tmerrshme. Partia jonë u forcua dhe u kalit edhe më shumë, Republika jonë Popullore u bë edhe më e fortë. Tok me nacionalistët e Beogradit, imperialistët amerikano-anglezë futën në veprim dhe banditët monarko-fashistë grekë, të cilët përveç provokacioneve të panumërta dhe gati të përditshme për vite me radhë, sulmuan vitin e kaluar kufitë e shenjtë të atdheut tonë. Ushtria jonë Popullore që ruan me vigjilencë kufitë e atdheut të saj, ua dha përgjegjen banditëve të Caldarisit dhe të Venizelosit dhe këta e paguan shtrenjtë aventurën e tyre, sepse nuk mposhtet populli shqiptar që ka marrë fuqinë në duart e veta dhe që udhëhiqet nga një Parti heroike, që ka dalë nga shkolla e luftës dhe ecën në gjurmat plot lavdi të Partisë Bolshevike.

Tani të gjithë këta armiq të egër të popullit tonë në pamundësi t'i bëjnë gjë Shqipërisë nga brenda, lehin si qentë në hënëz jashtë kufive të atdheut tonë. Ata e kanë halë në sy vendin tonë, që u bëri ballë me sukses

intrigave të tyre dhe që ndërton në paqe socializmin. Armiqtë e vendit tonë, po bëjnë çdo ditë provokacione në kufi, përpiqen të futin te ne sabotatorë dhe diversantë, për të kryer akte të poshtra, për t'u dhënë ndopak kurajë disa elementëve të reaksionit që kanë mbetur të izoluar dhe të rraskapitur. Por populli shqiptar është më i fortë se kurrë, prandaj të gjitha tentativat e tyre dështojnë. Tani amerikanëve, anglezëve dhe shërbëtorëve të tyre, tradhëtarëve të Beogradit, fashistëve të Athinës dhe të Romës, s'u ka mbetur mjet tjetër përveçse të dërgojnë natën aeroplanët e tyre, të cilët duke shkelur integritetin e vendit tonë, hedhin trakte të komitetit «Shqipëria e lirë»; i krijuar prej tyre dhe i përbërë prej të gjithë kuislingëve, bashkëpunëtorë të nazistëve gjermanë dhe të fashistëve italianë që sot janë bërë aleatë më të ngushtë dhe identifikohen me imperialistët amerikano-anglezë. Kjo tregon nga ana e imperialistëve dobësinë e tyre të madhe. Ata i kanë humbur shpresat që të gjejnë një mbështetje të vogël në Shqipëri qoftë për t'u ndarë, të paktën, traktet. Ata shpejt do të binden se edhe kjo veprimtari e tyre do të marrë fund. Imperialistët dhe shërbëtorët e tyre, që vijnë natën dhe hedhin trakte, harrojnë se popullin shqiptar s'e kanë tundur akte të tjera më mizore të këtyre banditëve, jo ta tronditin fletushkat e tyre të ndyra.

\* . \*

Shqipëria demokratike popullore, me kryet lart po ecën me vendosmëri në rrugën e ndritur të socializmit, në atë rrugë të lumturisë që ja çeli Revolucioni i madh

i Tetorit, Lenini dhe Stalini, Partia Bolshevike dhe popujt e dashur dhe të shtrenjtë të Bashkimit Sovjetik. Kush e ka parë Shqipërinë në prakun e çlirimit, për të mos u ngjitur në kohën e regjimeve të errëta antipopullore dhe kush e shikon sot, nuk mund të mos habitet nga përparimet e mëdha që ka bërë vendi ynë në një kohë kaq të shkurtër në liri dhe në demokraci. Mbi rrënimet dhe gërmadhat e luftës u ngrit jeta e re në vendin tonë. Populli shqiptar zhdukuri rrënimet e luftës dhe ja ndërroi faqen Shqipërisë. Populli shqiptar nën udhëheqjen e Partisë së Punës dhe të qeverisë së tij ndërton me vrull dhe me hapa të sigurtë socializmin. Reforma të mëdha ekonomike, shoqërore dhe kulturore janë bërë në vendin tonë qëkurse populli mori në dorë fuqinë dhe spastroi vendin nga armiqtë dhe nga parazitët. Këto u bënë në saje të një pushteti të fortë të popullit nga më demokratikët që u ngrit në vendin tonë. Populli është kudo në fuqi dhe ai vetë drejton jetën e tij. Toka ju nda fshatarëve, të cilët punojnë me gëzim dhe prodhojnë çdo ditë më shumë. Arësimi, përparimi kanë hyrë në fshatrat tona ku mbretëronte zija, uria dhe errësira. Po luftohen me sukses të madh prapambetja, fanatizmi, padituria, analfabetizmi e sëmundjet. Në fshatin tonë tani ka shkolla, klube, biblioteka të vogla etj. Atje shkojnë bibliotekat ambulante, atje shkojnë kinematë shetitëse dhe shfaqen filma sovjetikë që mbushin me gëzim e me heroizëm zemrat e popullit tonë dhe që edukojnë njerëzit tanë me frymë të re. Shtëpitë e bujqve tanë janë të gëzuara, pse e gëzuar është jeta. Partia e Punës u hapi sytë, u forcoi zemrën dhe dorën për të luftuar armiqtë shekullorë, u tregoi rrugën e Leninit e të Stalinit, rru-



gën e kolektivizimit, ajo i ndihmon me të gjitha forcat që të lulëzojë jeta e tyre. Në tokat tona tani punojnë traktorët e Stalingradit. Bujqit tanë po zbatojnë në bujqësi metodat e reja agroteknike të shkencëtarëve të shquar sovjetikë. Gruri mbin i lartë dhe si flori në arat tona, pambuku lëshon gonxhe të bardha si bora. Fshatarët grumbullohen dhe bashkohen në kooperativa bujqësore, të cilat shtohen, forcohen, përparojnë për të mirën dhe begatinë e popullit tonë.

Në vendin tonë në kohërat e kaluara pothuaj nuk ekzistonte fare industria, vendi ynë ishte një treg kolonial, punëtorja jonë vuante në mjerim të madh. Ajo punonte si skllav i mesjetës në koncesionet e minierave të kapitaleve të huaja a të okupatorit, që e shfrytëzonin deri në palcë atë dhe popullin tonë. Por sot, në vendin tonë po ngrihet një industri e re. Ne sot kemi rindërtuar, shtuar e pajisur minierat tona të pasura që na i kishte shkatërruar lufta. Miniera të reja janë hapur dhe pasuria e nëntokës është bërë një burim i paçmuar për popullin tonë dhe faktor ekonomik i dorës së parë në ndërtimin e socializmit. Kombinete të mrekullueshme po ndërtohen në vendin tonë, si për punimin e pambukut, të sheqerit, të drurit, për çimenton, për naftën e për shumë sende të tjera. Centrale termike dhe hidrocentrale të mëdha po ndërtohen dhe janë në mbarim; vendi ynë po ndërton hekurudha e banesa të panumërta për punonjësit, po hap rrugë të reja, po hap kanale, po than kënetat dhe po bën pyllëzime. Këto e kanë bërë Republikën tonë Popullore një vend të fortë, kanë ngritur standardin e jetës së popullit tonë, kanë bërë të shtohet bollëku, populli të hajë dhe të vishet më mirë, të rrojë

i gëzuar dhe brezat e rinj të rriten dhe të edukohen të shëndetshëm dhe të sigurtë në të ardhshmen e tyre. Klasa jonë punëtore është shtuar dhe forcuar, ajo punon me vrull dhe me entuziazëm të papërshkruar, ajo është forca drejtuese e shtetit tonë, thelbi i çelniktë i Partisë sonë të Punës. Industria jonë është në zhvillim dhe dita-ditës po zgjerohet e forcohet. Po lidhet ngushtësisht qyteti me fshatin, po çelnikoset aleanca e punëtorit me fshatarin dhe kjo ka bërë që të përmirësohet jeta e punonjësve, të zhduket me kohë papunësia, të krijohet lirësia në treg. Një zhvillim i tillë i harmonishëm është bërë edhe në lëmin kultural dhe shoqëror. Rrjeti i shkollave tona, fillore e shtatëvjeçare, i shkollave të mesme dhe i instituteve të larta, po shtohet nga viti në vit. Me qindra mijë djem të popullit ndjekin këto shkolla, kurse të ndryshme e shkolla teknike. Arësimi është bërë me të vërtetë i masave dhe brezi i ri, i mësuar dhe i edukuar me patriotizmin e shëndoshë dhe me besnikërinë ndaj atdheut e socializmit, po rritet dhe ecën përpara.

Në universitetet e Bashkimit Sovjetik dhe të demokracive popullore mësojnë dhe dalin të diplomuar me qindra djem të popullit. Në vendin tonë është ndërtuar Teatri popullor, një rrjet i gjerë kinemash, kënde sportive, biblioteka të shumta, klube, salla leximi, shtëpi kulture, ku masat e gjera të popullit marrin pjesë, edukohen e zhvillohen. Spitale të reja dhe moderne janë ngritur ndër qytete, spitale rurale dhe ambulanca nëpër fshatra, ku luftohen me sukses sëmundjet që kishin sjellë mjerimin e popullit tonë dhe që shkaktonin vdekje të panumërta në popullsinë e varfër. Shqipëria e vogël është një kantier i madh pune ndërtimore dhe një shko-

llë ku me etje të papërshekrueshme mësojnë dhe edukohen njerëzit e thjeshtë të vendit tonë. Populli shqiptar ka vuajtur shumë, ka derdhur shumë gjak për lirinë e demokracinë dhe sot po derdh djersë për ndërtimin e socializmit. Populli shqiptar që e ka fituar tani e përgjithmonë lirinë, di ta ruajë dhe ta mbrojë atë. Populli shqiptar nuk do të lejojë kurrë të kthehen mjerimet e së kaluarës. E kaluara e hidhur dhe luftërat që ai ka bërë për të zhdukur këtë të kaluar, janë mësim të mëdha për të. Populli ynë e di se tmerret e së kaluarës kurrë nuk do të kthehen në qoftë se ai mobilizohet i tëri për të çelnikosur fitoret e tija duke ndërtuar me vrull të pandalshëm socializmin, duke mbrojtur me të gjitha forcat kauzën e paqes, që kërcënohet seriozisht nga imperialistët amerikano-anglezë dhe shërbëtorët e tyre, duke dashur dhe mbrojtur me të gjitha forcat e tija Bashkimin e lavdishëm Sovjetik. Amerikano-anglezët, me urë në dorë, po i vënë flakën botës. Ata po vrasin popullin vëlla heroik korean që lufton për çlirimin e tij. Barbarët amerikanë po vrasin gratë dhe kalamanët e Koresë heroike, ata po djegin që nga themelitet qytetet dhe fshatrat e saja, ata kërcënojnë integritetin e Kinës heroike dhe po përgatiten t'i vënë zjarrin botës. Por imperialistët do të dështojnë me siguri në veprën e tyre gjakatare dhe dora e tyre kriminale do t'u ndalet nga forca e pamposhtur e popujve, nga lëvizja e fuqishme e partizanëve të paqes, që përmbledh në gjirin e saj me qindra miliona njerëz dhe që udhëhiqet nga popujt e Bashkimit Sovjetik dhe nga politika paqësore e Stalinit. Paqja do të fitojë mbi luftën dhe luftënxitësit. Populli shqiptar është i bindur për këtë dhe është i tëri si një

trup i mobilizuar dhe lufton e vigjilon për të mbrojtur paqen.

Sot në këtë ditë të gëzuar feste, populli ynë me dashuri të thellë u drejton përshëndetjet e urimet më të mira popujve të Bashkimit Sovjetik dhe të madhit Stalin. Miqësia e popullit tonë të vogël me popujt e Bashkimit Sovjetik do të jetë e përjetshme.

*Botuar për herë të parë në gazetën «Pravda», Nr. 356(11828).  
22 dhjetor 1950*

*Botohet sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë.*

# TË RRITET KUJDESI I PARTISË PËR EDUKIMIN E GJITHANSHËM TË RINISË

*Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit  
të KQ të PPSH<sup>1</sup>*

8 dhjetor 1950

Rinia është një burim i rëndësishëm për Partinë tonë, është e ardhshmja e popullit tonë. Prandaj Partia kurdoherë ka treguar shumë kujdes dhe i ka vënë shumë rëndësi edukimit të rinisë. Ky kujdes duhet të shtohet akoma më shumë e të shprehet jo vetëm si dëshirë, po dhe me masa konkrete. Me këtë dua të them se, megjithëqë është thënë dhe dihet roli i rinisë si gjatë Luftës nacional-çlirimtare, dhe tani, në ndërtimin e socializmit, në praktikë, më duket se nuk tregohet interesimi i duhur dhe konkret nga ana e disa organizatave të Partisë përme i zgjidhë problemet e rinisë jo vetëm si një organizatë masash, po edhe si një faktor shumë i rëndësishëm

---

<sup>1</sup> Në këtë mbledhje u muar në shqyrtim raporti «Mbi përmirësimin e punës në organizatën e rinisë» paraqitur nga KQ i BRPSH.

për ndërtimin e socializmit në vendin tonë, pse ka të bëjë me të gjithë brezin e ri të atdheut tonë.

Nga ana materiale, ne duhet t'i plotësojmë mjaft nevoja rinisë dhe organizatës së saj, sigurisht jo pa kontroll dhe llogari, por nuk duhet me qenë aq dorështërnguar. Këtu nuk e kam fjalën lidhur me dërgimin e delegacioneve jashtë, kjo është gjëja më e vogël, megjithëse edhe për këtë, pavarësisht nga vështirësitë që kemi pasur për divizë, mund të kishim bërë më shumë. Fjalën e kam për këtu brenda pse ajo ka shumë nevoja, të cilat duhet t'i shohim më tepër në radhë të parë ne, si Parti. Në rast se drejtuesit e Partisë në bazë do ta shohin drejt këtë çështje, shumë gjëra do të zgjidhen atje dhe nga ata vetë. Për shembull është ngritur çështja e klubeve të rinisë, e vendeve ku ajo duhet të mblidhet, të dëfrojë, të çlodhet e të edukohet kolektivisht; po kështu për shtëpitë e pionierëve etj. Sot për sot ato lokale që kemi duhet të adaptohen ashtu si i do rinia. Këto gjëra duhen bërë medoemos, pse kundër rrezikut të vagabondazhit nuk mund të luftohet me fjalë. I riu nuk do ta kalojë kohën kot, por do të mblidhet në vende që e tërheqin, ku të dëgjojë një konferencë a bisedë, të shohë një film a një shfaqje artistike, të edukohet dhe të merret me një punë të dobishme. Këto qendra e ambiente duhet t'i sigurojmë. Në qoftë se rinisë i duhet një shtëpi e mirë, t'ja japim dhe të jetë në dispozicion të saj, t'u japim dhe materiale që mund të prishen duke ndejtur kot, por që për rininë janë të nevojshme. T'u sigurojmë radio, mjete e aparatura të tjera që i ndihmojnë pionierët e të rinjtë të njihen me mekanizma e të mësojnë nga teknika. Shokët e Partisë në qendrat e punës

veçanërisht ta shohin me kujdes këtë problem dhe t'u krijojnë mundësi të rinjve për edukimin dhe dëfrimin e tyre. Në qoftë se nuk ka fonde në buxhet, t'i kërkojmë këto në qeveri. Në këtë drejtim ne nuk duhet të kursejmë.

Por edhe shokët e KQ të Rinisë kanë përgjegjësi për edukimin e saj dhe ata duhet të dinë mirë se si të punojnë me rininë. Është e qartë se të gjithë shokët dëshirojnë që rinia ta kalojë kohën e lirë në mënyrë të kulturuar, po ku të çlodhet e të dëfrejë në qoftë se ne nuk i krijojmë asaj disa kushte? Këtë çështje e kemi thënë shumë herë, po akoma nuk është bërë gjë. Shokët e rinisë duhet t'i paraqesin sa më parë KQ të Partisë disa kërkesa ose propozime konkrete, të studjuara mirë, se çfarë ju duhen për edukimin dhe argëtimin e rinisë me qëllim që t'i shqyrtojmë e të japim urdhër për t'i plotësuar nevojat e ligjshme të rinisë.

Ne duhet t'u japim direktiva komiteteve të Partisë në rrethe që çështjen e rinisë ta shikojnë në mënyrë të veçantë, pse kam mendimin që disa sekretarë të Partisë nuk mbajnë lidhje të ngushta e të vazhdueshme me shokët e rinisë në rreth. Mund të ketë prej tyre që të mos dinë edhe se çfarë përmban statuti i rinisë. Dhe kjo ndodh sepse ata mendojnë se «ato janë probleme të rinisë», përveç kësaj i kanë mbytur edhe problemet e shumta dhe nuk dinë të manevrojnë dhe t'u japin rrugë të gjitha gjërave, sipas rëndësisë së tyre. Çështjet që ngre sekretari i rinisë në komitetin e Partisë kalojnë lehtë-lehtë. Prandaj edhe plotësimi i disa nevojave materiale për edukimin e rinisë nuk shkon mirë.

Unë mendoj se ne nuk duhet të jemi të ngurtë për

rininë, ta ndihmojmë sa të jetë e mundur më tepër atë. Të kemi parasysh se të rinjtë që po rriten do të marrin në dorë frenat e shtetit në të ardhshmen. Prandaj ka shumë rëndësi që këta njerëz të rriten dhe të edukohen mirë. Ne edhe shokët e KQ të Rinisë duhet që këtë vijë që cakton Partia ta vëmë në jetë me ndërgjegje dhe guxim. Partia drejtuesve të rinisë u ngarkon një detyrë shumë të rëndë dhe delikate. Prandaj duhet që ata ta bëjnë natën ditë për edukimin dhe drejtimin e mirë të rinisë. Ne tani shohim se shumica e sulmuesve janë të rinj dhe kështu duhet të jetë, prandaj interesimi për rininë duhet të jetë më i madh.

Përsa i përket punës vullnetare ne nuk kemi bërë keq që e kemi organizuar, pse në të tilla kondita kemi qenë; ishim të shkatërruar nga lufta, prandaj duhej vrulli i madh i rinisë që të kryheshin shumë aksione, pse po të rrinim vetëm me ato forca punëtore që nxirrnim nuk do t'ja delnim dot gjendjes. Kështu vullnetarët e rinisë i janë bërë krah Partisë edhe për plotësimin e nevojave për fuqi punëtore. Edhe unë jam i një mendimi me shokët që, entuziazmin rinisë t'ja ruajmë dhe t'ja shtojmë, po edhe anën financiare të saj ta shikojmë. Një gjë e tillë do të na ndihmojë ne, po dhe vetë të rinjtë. Ky organizim do t'u interesojë, pse kjo do t'i japë një hov më të madh vendosjes së përhershme të rinisë në punë.

Përsa u përket punëve të tjera vullnetare në fshat, ato duhet t'i vazhdojmë. Organizatës së rinisë t'i ngarkojmë punën e përparimit të fshatit. KQ i Rinisë nuk duhet të mbështetet vetëm në punën që do të bëjë organizata e rinisë në fshat, por duhet të organizojë ndih-



mën e rinisë së qytetit dhe të shkollave, me anë të patro-nazhit të fshatrave. Këta kur të venë në fshat ndihmën e tyre ta shoqërojnë edhe me punë politike e kulturale, duke organizuar sidomos në dimër shfaqje, konferenca etj. Kjo të jetë një mjet në duart e KQ të Rinisë për të forcur fshatin dhe për ta lidhur atë ngushtë me qytetin.

Për përhapjen e agroteknikës organizata e rinisë duhet të luajë një rol me rëndësi. Rinia ka bërë mjaft për këtë, po duhet të bëjë akoma më shumë. Gjatë verës ekipet për mbjellje e korrje kanë dhënë rezultate të mira. Kjo ka ndihmuar edhe kooperativat bujqësore. Në kooperativa bujqësore dhe në fshatra përgjithësisht grupet e të rinjve të ndihmojnë familjet e dëshmorëve, të atyre që i kanë djemtë ushtarë etj. Të inkurajohen të rinjtë për të mësuar traktorin; të përpiqen ata për të mësuar e punuar me metodat e reja agroteknike dhe t'i përhapin ato. Kjo kërkon që organizata e rinisë të forcohet nga ana politike dhe organizative e të ndihmojë për ngritjen ekonomike të fshatit.

Një rol të veçantë të luajë rinia për pyllëzimet dhe në nxjerrjen e fuqisë punëtore për qendrat e reja industriale që ngremë. Të gjitha këto duhet të bëhen me format e ndryshme të punës që përdor rinia dhe në asnjë mënyrë nuk duhet të përdoret forca për nxjerrjen e punëtorëve. Po të punohet me plan në këto çështje, të rinjve të fshatit nuk do t'u vijë keq kur t'u thuhet që të shkojnë në aksione, pse shteti ka nevojë për të ngritur fabrika, hekurudha etj.

Përsa u përket shkollave mbani format që keni përdorur dhe më parë në lidhje me studimin dhe mësimin nga ana e nxënësve. Po duhet të përdorni edhe mjete që

nxitin për të mësuar. Emulacioni në shkolla të jetë si dhe në fabrika.

Për organizatat e rinisë duhet të sigurohen kuadro dhe këtu nuk duhet me qenë sektarë. Edhe për pionierët duhet të sigurohen edukatorë dhe të gjithë këta nga radhët e rinisë sonë. Ju duhet të nxitni vetë njerëzit tuaj që të mësojnë nga eksperiencia sovjetike dhe të bëhen udhëheqës, edukatorë të rinisë. Duhet të caktojmë njerëz që të venë në Bashkimin Sovjetik, të studjojnë eksperiencën për edukimin e rinisë e të pionierëve. Më mirë të kemi dy-tre inxhinierë më pak, po të kemi dhe udhëheqës e edukatorë të ngritur nga pikëpamja ideologjike, pedagogjike dhe organizative. Ky është një problem i madh. Në shkolla njerëzit tanë duhet të mësojnë marksizëm-leninizmin dhe ky duhet të jetë një aksion i madh ideologjik për rininë. Të rinjtë tanë të mësojnë shkencën e Partisë, pse do të jenë ata që do të vijnë më vonë në Parti, po dhe në mos u bëmshin të gjithë anëtarë partie, do të bëhen njerëz të ndershëm, punëtorë, bolshevikë pa parti, si thotë populli. Edhe kurse duhet të çelen, veçse programet të përgatiten këtu dhe papritur që këto punë të bëhen kur të vijnë kuadro të mësuar. Nxënësit e klasave të larta të shkollave të mesme mund t'i përdorni fare mirë për edukimin e të rinjve dhe të pionierëve.

Ne duhet të luftojmë më mirë kundër ideologjisë borgjeze dhe të edukojmë njerëzit tanë me frymën e internacionalizmit. Përsa u përket marrëdhënjeve mësuës-nxënës nuk duhet të jemi oportunistë dhe të lihen pa goditur pikëpamjet e huaja që kanë disa mësuës, ndryshe nuk kemi luftuar ideologjinë borgjeze e cila ekziston akoma te disa. Kjo ideologji mund të ndrysho-

jë te ata, kur të kemi edhe kuadrot e rinj — dhe të tillë do të kemi — e atëhere do të vijë koha që ata vetë do të thonë se marksizëm-leninizmi i mposht të gjitha mbeturinat e ideologjisë së vjetër. Por tani ne ata kemi, prandaj t'i edukojmë, t'i ndihmojmë, të mbajmë marrëdhënje të drejta, pa qenë oportunistë me ta. Kjo nuk pengon që ata të respektohen siç duhet. Respekti të mbetet respekt.

· Rinia është e ardhshmeja e vendit tonë, prandaj më shumë kujdes për të.

*Botohet për herë të parë sipas  
tekstit të nxjerrë nga proces-  
verbali i mbledhjes së Sekre-  
tariatit të KQ të PPSH që  
gjendet në AQP.*

## MBI NEVOJËN E NJË STUDIMI SHKENCOR PËR GJENDJEN NË FSHAT

*Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike  
të KQ të PPSH*

**15 dhjetor 1950**

Ne shkojmë në socializëm, prandaj duhet ta kemi të qartë edhe evolucionin e fshatarësisë sonë gjatë gjithë zhvillimit të saj historik. Për të qartësuar procesin e zhvillimit dhe për të mos ja lënë spontaneitetit atë, është e nevojshme të ndërmerren studime<sup>1</sup>. Këto studime duhen bërë për probleme të ndryshme ekonomike të fshatit, për strukturën klasore, për forcimin e aleancës midis klasës punëtore dhe fshatarësisë, për problemet e familjes e për mjaft probleme të tjera shoqërore. Po të kemi studime me baza të shëndosha, do të kemi ku të mbështetemi më mirë në lidhje me vijën tonë në fshat.

---

<sup>1</sup> Me propozim të shokut Enver Hoxha, Byroja Politike ngarkoi një komision me shokun Mehmet Shehu në krye, i cili do të bënte një studim shkencor të gjendjes ekonomike, politike, shoqërore e kulturele të fshatit për periudhën para dhe pas çlirimit. Ky studim diktohej nga nevojat që kishte Partia për ndërtimin e punës së saj në fshat dhe do të kishte një rëndësi të madhe historike, teorike dhe praktike.

Studimi i këtyre problemeve ka rëndësi të madhe. Ne themi se na mungon fuqia punëtore. Po shumica e punëtorëve do të dalin nga fshati. Prandaj duhet të dimë arësyen pse këta punëtorë nuk dalin. Një ndër shkaqet kryesore është se në qendrat e punës për punëtorët që vijnë nga fshati, nuk janë krijuar akoma kushte të përshtatshme banimi, me qëllim që ata të stabilizohen. Po kështu duhet studjuar problemi i detyrimeve të fshatarësisë ndaj shtetit, sa e favorizojnë dhe e nxitin ato fshatarin për të rritur prodhimin. Natyrisht, mjaft shkaqe për këto çështje ne i dimë, por duhet ta njohim mirë këtë gjendje, sepse kështu do të dimë si të veprojmë në të ardhshmen. Këto studime do të lehtësojnë zbatimin e programit tonë.

Gjithashtu gjendjen shoqërore të fshatit nuk mund ta lëmë mbas dore. Atë duhet ta njohim mirë. Kështu ligjet dhe urdhëresat që nxjerr shteti do t'u përshtaten kushteve të fshatit dhe do të gjejnë mbështetje e zbatim nga ana e popullit.

Edhe çështja e përpjekjeve që ka bërë fshatarësia në të kaluarën, megjithëse është e vështirë, ka shumë rëndësi të studjohet. Po nuk njohëm të kaluarën, motivet që e kanë shtyrë fshatarësinë për të marrë pjesë në lëvizjet e ndryshme, shtresat e fshatarësisë që janë përfshirë në to, ndryshimet që ka bërë fshatarësia në procesin e zhvillimit të saj etj., studimet për problemet aktuale të fshatit nuk do të ishin të plota.

Veç problemeve të së kaluarës duhet t'u kushtojmë kujdes dhe problemeve shoqërore aktuale për studimin e të cilave kemi nevojë. Ne na preokupon për shembull çështja e kulakëve, çështja se kush mund të jetë fshatar

i mesëm etj. Përcaktime për përbërjen klasore të fshatarësisë janë bërë, por pa ndonjë studim të thelluar si duhet. Prandaj është e domosdoshme të studjohet përbërja e fshatarësisë. Në këtë studim duke u orientuar nga mësimet e Leninit dhe të Stalinit, të bëhet përcaktimi i drejtë i fshatarëve të varfër, të mesëm dhe të kulakëve në përputhje me kushtet tona konkrete. Këtë duhet ta bëjmë medoemos.

Në këtë kuadër të problemeve shoqërore, studime duhen bërë edhe për çështjen e familjes patriarkale. Çështjen e ndarjes së familjeve në fshat e kemi ngritur prej kohësh. Nga ana parimore këtë e dimë, por shkaqet që veprojnë në këtë drejtim akoma nuk i njohim thellë. Ne duhet të dimë se çfarë influence ushtron në familjen patriarkale kryetari i saj, si janë marrëdhënjet burrë-grua dhe prindër-fëmijë, pse nuk i dërgojnë djemtë dhe sidomos vajzat në shkollë. Kjo ka rëndësi të madhe për Partinë. Po t'i njohim mirë këto shkaqe, do të jemi në gjendje të japim direktiva të drejta dhe të drejtojmë mirë si procesin e zhvillimit të familjes ashtu dhe atë të ngritjes kulture e arësimore.

Një problem tjetër i madh është çështja e gruas. Kur në kryeqytet, ku zhvillimi është më i madh, gratë e vajzat nuk binden të shkojnë në kombinatin e tekstilëve dhe në Kavajë vazhdojnë të dalin akoma të mbuluara me çarçaf, në fshat, s'ka dyshim që ky problem paraqitet më i mprehtë. Të gjitha këto janë fenomene që ne duhet t'i zbërthejmë e t'i studjojmë dhe të çelim perspektiva për të ardhshmen. Prandaj duhet t'i futemi kësaj pune.

Këto janë, mendoj unë, arësyet që na shtojnë dhe

qëllimet që duam të arrijmë në përgjithësi me këtë studim, nga i cili do të nxjerrim konkluzione për të punuar më mirë në të ardhshmen.

Studimet mund të mos jenë të përsosura, s'ka gjë, do t'i përmirësojmë më vonë. Rëndësi ka të mobilizojmë mirë njerëzit për këtë detyrë në hapat e parë e të sigurtë që po bëjmë drejt një pune studimore më të plotë.

*Botohet për herë të parë sipas  
tekstit të nxjerrë nga proces-  
verbali i mbledhjes së Byrosë  
Politike të KQ të PPSH që  
gjendet në AQP*

**VENDIMI TË ZBËRTHEHET MIRË DHE TË  
KONTROLLOHET ME RIGORIZITET  
ZBATIMI I TIJ**

*Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike  
të KQ të PPSH<sup>1</sup>*

**26 dhjetor 1950**

Ne kemi bërë përparime në punën me plan e në hartimin e projektvendimeve dhe nuk mund të themi se s'kemi pasur rezultate. Megjithkëtë unë mendoj se ne jemi kënaqur me nxjerrjen e planeve dhe të vendimeve dhe nuk kemi ndjekur dhe kontrolluar sa duhet zbatimin e tyre.

Ne nuk kemi bërë që vendimet tona të përpunohen e të zbërthehen nga i gjithë aparati i Partisë sipas instancave që kur t'i dërgohen bazës për zbatim, të jenë sa më konkrete. Kështu puna do të mund të ndiqet e të kontrollohet më mirë e vazhdimisht edhe nga lart. Unë mendoj se të gjitha vendimet që kemi marrë ne këtu

---

<sup>1</sup> Në këtë mbledhje u muar në shqyrtim plani orientues i mbledhjeve të Byrosë Politike dhe të Sekretariatit të KQ të PPSH për vitin 1951.



kanë vajtur poshtë në bazë, ashtu si i kemi hartuar ne. Byroja Politike mund të marrë një vendim dhe ta përpilojë atë me tri fjali. Në qoftë se vendimi do të jetë për çështje të propagandës, atëhere sekretari i Komitetit Qendror që është ngarkuar me këtë sektor, duhet ta detajojë atë dhe ta bëjë sa më të qartë te vartësi i tij, te drejtori i Drejtorisë së agjitacionit e të propagandës, i cili duhet ta zërthejë më tej vendimin e ta zhvillojë problemin edhe më gjerë për shifat e seksioneve. Këta duhet ta punojnë në detaje dhe ta përgatitin për ta dërguar poshtë. Në këtë mënyrë rrethi a institucioni përkatës do t'i ketë gjërat të qarta. Po kështu rrethet, dikasteret ose organizatat e masave duhet të punojnë për t'ua sqaruar organizatave ose organeve bazë të tyre aspekte të veçanta të planeve e vendimeve. Mirëpo te ne nuk veprohet kështu. Le të marrim për shembull vendimin për kulturën. Ai është lënë ashtu si e ka marrë Byroja Politike dhe kështu nuk ka se si të organizohet dhe kontrolli i zbatimit.

Nuk është e drejtë që të marrim katër ose pesë çështje menjëherë dhe t'i kontrollojmë si kanë shkuar. Ky lloj kontrolli nuk do të jepte ndonjë rezultat.

Duke vazhduar punët kështu si deri tani, unë nuk jam aspak i kënaqur nga mbledhjet që ne bëjmë në Sekretariat. Mbledhjet e Sekretariatit po përdoren pothuajse vetëm për të shikuar disa propozime të drejtorive të aparatit të KQ të Partisë dhe veçanërisht për çështje kuadri. Edhe kjo gjë do të bëhet, po kryesore është që Sekretariati të ndjekë se si po zbatohen vendimet e Byrosë Politike dhe të plenumëve të Komitetit Qendror, para të cilëve ai duhet të japë llogari. Po të

jetë puna kështu unë jam dakord që Sekretariati të bëjë edhe çdo natë mbledhje, por me konditë që të marrë në shqyrtim çështje të rëndësishme. Sekretariati po dëgjon rrallë raporte se si po zbatohet ky ose ai vendim. Ne duhet t'i kontrollojmë vendimet që marrim. Kemi për shembull çështjen e grumbullimeve. Nga ana shtetërore na vjen informacioni se shumë prej anëtarëve të Partisë nuk i kanë shlyer detyrimet ndaj shtetit, ndërsa Drejtoria e bujqësisë nuk ka dijeni fare për këtë gjendje. Ajo nuk është në korrent se si punon Partia në bazë për zbatimin e këtij vendimi. Po përse nuk e bën këtë gjë Drejtoria e bujqësisë? Kjo vjen pse vendimi nuk detajohet dhe kështu sekretari i Partisë që ka këtë sektor nuk ka se si ta kontrollojë.

Drejtorët duhet të nxjerrin konkluzione nga raportet për punën e tyre në lidhje me zbatimin e vendimit dhe këto t'ja referojnë sekretarit përkatës. Atëhere sekretari do të vijë në Byro ose në Sekretariat me këtë material dhe do të raportojë se si shkon zbatimi i këtij ose i atij vendimi. Në qoftë se nuk do të bëjmë kështu, nuk do t'ja dalim dot në krye punës.

Shumë nga vendimet tona janë edhe për organet e shtetit, por shpeshherë ato mbeten vetëm këtu në Komitetin Qendror. Ne duhet të bëjmë që direktivat e Partisë t'u transmetohen edhe organeve shtetërore. Këtë gjë ne nuk po e bëjmë në mënyrë të rregullt. Në qoftë se ne marrim vendimin për shtypin, ka dhe detyra shtetërore për shpërndarjen e tij. Pra, në projektvendimet që hartojnë drejtoritë e Komitetit Qendror, të flasin edhe se çfarë masash do të merren dhe nga cilët sektorë. Kështu, kur të vijë koha, të dihet se kujt i mbetet për-

gjegjësia. Le të shohim vendimin që kemi marrë për arësimin. Sikur të thërresim ministrin përkatës ai do të vijë të na bëjë një raport në përgjithësi, pse ashtu e kemi bërë edhe ne vendimin. Ne kemi diskutuar mjaft gjëra për arësimin, po ato duhet t'i hedhim mirë në letër. Pra, megjithëse kemi përmirësime në këtë drejtim, duhet të ecim akoma përpara. Në mbledhjet e Sekretariatit ne nuk duhet të diskutojmë vijën dhe direktivat që kemi dhënë, por zbatimin e tyre.

Nuk kemi punuar si duhet për planet dhe për problemet që do të shqyrtojmë. Kështu ka ndodhur shpesh që problemet nuk kanë ardhur të studjuara mirë.

Në projektplanin ka edhe çështje organizative të Partisë, të cilat kanë një rëndësi të madhe dhe ne kemi marrë kaq vendime. Kur marrim një çështje në shqyrtim ne duhet të kemi parasysh edhe vendimet që kemi marrë më parë për të. Çështjet kryesore të Partisë ne duhet t'i shqyrtojmë në Byronë Politike.

Për çështjet e planit të shtetit janë në korrent Spiro Koleka dhe dy tre shokë të tjerë. Unë dhe këta shokë duhet t'i paraqesim herë pas here Byrosë Politike ose Sekretariatit një pasqyrë se si po realizohet plani në disa drejtime kryesore ose se si po shkojnë disa objekte të rëndësishme të planit, p.sh. ne nuk dimë me saktësi se kur do të mbarojë Kombinati i tekstileve «Stalin» dhe për këtë faji është yni. Po kështu mund të themi për fabrikën e sheqerit në Maliq dhe për rrugën Shë-mëri-Kolgecaj që janë nga objektet kryesore të planit dyvjeçar. Prandaj herë pas here ne duhet t'i paraqesim Byrosë Politike nga një raport të shkurtër për këto objekte të mëdha. Pra, po ta mbajmë në korrent të

vazhdueshëm për këto çështje Byronë Politike, puna do të jetë më e lehtë për ne, pse do të kemi ndihmën e herëpashershme të saj.

Në pasqyrat dyjavore që na vijnë mbi realizimin e planit, kam parë se plani i ullirit është realizuar vetëm 15 për qind ngaqë ai, siç justifikohen shokët e bujqësisë, nuk ka qenë real! Por, po t'u kërkojmë llogari njerëzve dhe t'i vëmë përpara përgjegjësisë e po të vëmë kurdoherë në korrent Byronë Politike për çështjet kryesore, ato do t'i kuptojmë më mirë, atëhere puna do të ecë më përpara. Mosvënja në korrent për zbatimin e detyrave nuk ndodh vetëm me Byronë Politike, por edhe me Komitetin Qendror.

Kështu, kur vjen koha të bëjmë mbledhjen e plenumit, vijmë rrotull se çfarë problemesh do të zgjedhim, kjo rrjedh jo pse nuk ka probleme, pse të tilla ka, siç është çështja e realizimit të planit, ajo e bashkimeve profesionale, probleme të propagandës e të tjera, por pse ne vetë nuk i kemi mirë të qarta se cilat janë më kryesoret, më të mirat dhe të metat e tyre.

Unë i pashë orientimet për radio Tiranën, po këtu duhet të ketë veç anëve organizative edhe çështje të tjera, pse propaganda jonë ka detyra të mëdha, veçanërisht shtypi dhe radioja. Ato duhet të nxjerrin në pah punën e njerëzve sidomos në raste fushatash. Le të marrim çështjen e grumbullimit të tepricave dhe të rezervave për të cilat ne kemi folur shumë herë, sa është propaganduar nga këto institucione për to? Peshkopia dhe Skrapari, p.sh. jo vetëm që e kanë realizuar planin e grumbullimit, po tani janë duke mbledhur edhe teprica. Mirëpo nga shtypi ynë dhe nga radioja nuk po

shkruhet e nuk po flitet për këto rrethe. Pikërisht për këto probleme duhet bërë një propagandë e vazhdueshme, duke vënë mirë në dukje patriotizmin e popullit të atyre krahinave, njerëzit e dalluar etj. Po të veprohet kështu dhe ata që nuk shkojnë mirë me grumbullimet do ta shohin se njerëzit Partia i mat me punën që bëjnë dhe jo me llafe dhe do t'i përvishen më me vrull punës. Këto probleme duhet të mbahen ngritur nga ana e propagandës dhe të mos mjaftohemi duke bërë artikuj në forma të përgjithshme, pse kështu nuk mund të bëhet propagandë e vërtetë siç e kërkon Partia.

*Botohet për herë të parë sipas  
tekstit të nxjerrë nga proces-  
verbali i mbledhjes së Byrosë  
Politike të KQ të PPSH që  
gjendet në AQP*

# MBI FORCIMIN E MËTEJSHËM TË PUNËS SË PARTISË NË RRETHIN E FIERIT DHE TË PESHKOPIË

*Nga diskutimi në mbledhjen e Byrosë Politike  
të KQ të PPSH<sup>1</sup>*

29 dhjetor 1950

Megjithëse shokët folën mbi gjendjen dhe punën e organizatave të Partisë në Fier e Peshkopi dhe rrahën të gjitha problemet që na dalin në ato organizata, dua edhe unë të vë në dukje disa çështje.

Simptomat për dasi krahinash që vihen re në Fier duhet t'i kemi parasysh vazhdimisht. Një gjë e tillë, që është shumë e dëmshme pse prish unitetin, ngjet atje ku lufta e klasave është e dobët. Është armiku i klasës ai që përpiqet të krijojë këto ndarje sipas krahinave ose sipas fesë dhe këtë e bën për të mbjellë armiqësi në popull. Prandaj lufta e Partisë duhet të drejtohet me forcë kundër armikut të klasës si në fshat ashtu edhe

---

<sup>1</sup> Ky diskutim u bë mbi bazën e raporteve mbi gjendjen politike, ekonomike dhe puna e Partisë në Fier e Peshkopi, paraqitur nga komitetet e Partisë të këtyre rretheve.

në qytet. Në fshat veprojnë kulakët, ndërsa në qytet borgjezët. Kudo Partia të mobilizohet për të luftuar veprimtarinë e tyre armiqësore ndaj popullit. Por, që ta bëjë këtë gjë Partia, duhet të jetë vetë e pastër, thelbi i saj të përbëhet nga punëtorë dhe pastaj edhe nga ishatarë të varfër. Po kjo nuk përjashton që në Parti të jenë edhe fshatarë të mesëm e intelektualë përparimtarë, të cilët japin prova besnikërie për Partinë. Duhet ta kemi të qartë se ashtu si po përpiqemi ne për të forcuar aleancën midis fshatarëve të varfër dhe të mesëm, ashtu përpiqet edhe reaksioni për të forcuar lidhjet e borgjezisë së qytetit me kulakët e fshatit. Prandaj për t'i bërë të dështojnë këta në përpjekjet e tyre, duhet të intensifikohet puna politike e Partisë sonë në masat dhe të mos neglizhohet kjo gjë në kurriz të problemeve të tjera, të cilat edhe ato janë të rëndësishme.

Unë jam i bindur se organizatës së Partisë të Fierit do t'i shërbejnë shumë këto kritika që ju bënë këtu për të çuar punën përpara.

Organizatat e Partisë në rrethe nuk duhet të lejojnë që çështjet e politikës së jashtme dhe të brendshme të merren të shkëputura, por të vihen herë pas here në rendin e ditës dhe jo sa për të shkuar radhën. Ato duhet të dinë përpjekjet që bëjnë armiqtë për të na luftuar. Po të mos e kuptojnë drejt këtë çështje vetë komitetet e Partisë as organizatat bazë nuk do të jenë në gjendje t'i ngrenë si duhet atij problemet për të njohur kulakët, veprimtarinë e tyre armiqësore politike dhe ekonomike. Ndryshe do të ndodhë po t'i raportohen këto gjëra komitetit të Partisë, i cili do të ketë mundësinë t'i shtrojë ato e të ndihmojë organizatat bazë, që të dinë se si të

luftojnë konkretisht kundër armiqve që përpiqen të na dëmtojnë dhe që hedhin parulla. Prandaj puna politike e Partisë duhet të mbahet kurdoherë e ngritur. Por që Partia ta bëjë këtë punë, anëtarët e saj duhet të jenë të ngritur politikisht e ideologjikisht. Edukimi marksist-leninist i komunistëve duhet të jetë një problem i dorës së parë për Partinë. Njerëzit e Partisë jo vetëm duhet të dinë të shkruajnë dhe të lexojnë, por të mësojnë mirë marksizëm-leninizmin, ndryshe nuk ka se si të kryhen punët me elementë që kanë nivel të ulët ideologjik. T'i bëhet luftë injorancës dhe analfabetizmit dhe të ngrihet kultura e përgjithshme në radhë të parë në anëtarët e Partisë.

Për të gjitha direktivat që dërgon Partia duhet që komitetet e Partisë të preokupohen shumë, që ato të zbatohen jo vetëm në rrugë shtetërore. Qeveria dhe organet e pushtetit duhet t'i zbatojnë vendimet e Partisë, kurse organet e Partisë të kontrollojnë se si po zbatohen këto vendime. Anëtari i Partisë duhet të japë vetë shembullin i pari në zbatimin e tyre. Kur një anëtar partie në fshat nuk ka shlyer vetë detyrimet ndaj shtetit s'ka se si t'u bëjë agjitacion e propagandë të tjerëve. Edhe po ta bëjë një propagandë të tillë, ajo nuk bëhet me gjithë zemër, pse vetë ai nuk i ka kryer ato detyra që të tjerëve ua kërkon t'i kryejnë. Po kështu, edhe në çështjet e arësimit nuk mund të bëjë efekt puna e anëtarit të Partisë për të luftuar analfabetizmin derisa ai vetë nuk bën përpjekje për ngritjen e tij kulture.

Bashkohem me mendimin e të gjithë shokëve që folën se në Fier duhet të bëhen më shumë përpjekje për çështjet që dalin atje. Tani problemet mendoj se



janë kuptuar më mirë nga shokët dhe nuk mund të thuhet se jemi kuadro të rinj, pra, si të tillë nuk na lejo-  
het të bëjmë shumë gabime. Kur ka mundësi që punët  
t'i kryhen mirë popullit dhe kjo nuk bëhet, s'ka falje,  
pse një gjë e tillë e pengon Partinë në rrugën e saj për  
në socializëm. Po Partia ecën përpara, prandaj punët  
nuk duhet t'ju marrin zvarrë. Çështjet që ju drejtoni  
janë të lidhura me njëra-tjetrën, por duhet të dini të  
punoni që secila çështje të gjejë vendin e vet e të zba-  
tohet. Të aktivizoni shokët duke u caktuar atyre detyra,  
t'i ndihmoni ata që të punojnë me mendjen e tyre. Ato  
detyra që ju dërgon Komiteti Qendror duhet t'i zbër-  
theni dhe t'i lidhni me situatën e terrenit tuaj, t'ua  
shpjegoni mirë shokëve që do t'i kryejnë dhe të organi-  
zoni kontrollin e zbatimit të tyre.

Peshkopia ka ecur më mirë, kontrollin e ka orga-  
nizuar më në rregull, ka treguar më shumë interesim  
për këshillat e pushtetit dhe në rast se kjo punë do të  
vazhdojë kështu, organizatat bazë do të forcohen më  
tepër dhe do të këtë kombativitet në punën e tyre e si  
rrjedhim edhe komiteti i Partisë do të forcohet  
më shumë.

Partia ka dhënë udhëzime e direktiva në lidhje me  
pushtetin, se si duhet të punojë komiteti ekzekutiv, si  
duhet të aktivizohen këshillat popullore, por për këtë  
problem kërkohet më shumë punë dhe të mos mjaftohet  
me një raport një herë në dy-tre muaj, po të krijohet  
bindja dhe të forcohet ndërgjegjja e njerëzve të zgje-  
dhur në pushtet, se ata janë të dërguarit e popullit për  
ta drejtuar mirë atë e për t'i shërbyer atij si duhet.  
Prandaj duhet t'i jepet ndihmë dhe të kontrollohet push-

teti. Komitetet ekzekutive kontrollohen prej këshillave popullore të rretheve, por që këto këshilla të ndihmohen më shumë në punën e tyre, duhet të formohen edhe disa komisione, të cilave do t'u jepen funksione të caktuara. Këto komisione në mbledhje do të kenë të drejtën të kritikojnë komitetin ekzekutiv dhe të bëjnë edhe propozime. Këto institucione demokratike nga më përparimtares që ne kemi nuk aktivizohen si duhet. Po të bëhet kjo gjë, po t'i mbledhim ato për probleme politike dhe t'u ngarkojmë detyra, puna do të ecë më përpara.

Për disa dobësi në organizatat e rinisë në rrethe sigurisht ka faj Komiteti Qendror i Rinisë, por kjo organizatë drejtohet nga Partia. Prandaj sektori i punës me rininë duhet të jetë një nga sektorët kryesorë të Partisë në rreth. Pse të mos ketë organizata rinie në 60 fshatra në Fier? Kush e ka fajin për këtë? Në radhë të parë këtu e ka fajin Partia, komiteti i rinisë atje dhe Komiteti Qendror i Rinisë. Nuk duhet shkuar me mendimin se «organizata e rinisë varet nga Komiteti Qendror i Rinisë». Ky e drejton vërtet rininë, por sipas mësimeve dhe nën udhëheqjen e drejtëpërdrejtë të Partisë. Prandaj komitetet e Partisë nuk duhet të lidhin duart për këtë problem kaq të madh.

Çështjet e bujqësisë kanë një rëndësi të madhe veçanërisht për Fierin. Ky rreth duhet të realizojë planin, jo vetëm në grurë dhe misër, po edhe në bimë industriale. Fieri është një qendër e madhe bujqësore për vendin tonë, prandaj problemit të bujqësisë komiteti i Partisë nuk duhet t'i ndahet, natyrisht, pa harruar edhe çështjet e tjera, të cilat do t'ju ndihmojnë për këtë problem. Në çështjet e bujqësisë të ecni me llogari. Kur

nxuarëm ligjin e ri mbi pambukun<sup>1</sup> na u tha se ka bërë mjaft përshtypje në popull dhe se të gjithë do të mbillin pambuk, kurse deri tani pambuku është grumbulluar vetëm 25 për qind. Kësaj çështjeje duhet t'i vëmë rëndësi të madhe, pse ne po ngremë fabrika dhe po lidhim kontrata me shtete të tjera. Ju duhet ta realizoni planin, të mblidhni edhe teprica, ashtu siç po bën Peshkopia. Vlerësimin e shokëve Partia e bën me metron e realizimit të detyrave që u ngarkohen, me realizimin e planeve. Ai që e realizon planin, ai është edhe komunisti më i mirë. Sektori i bujqësisë nga ana shtetërore duhet të ndihmojë më shumë në këtë drejtim. Zhvilloni si duhet luftën e klasës dhe mos bëni gabime. Nuk duhet ta lini në heshtje këtë çështje. Në Fier ka mjaft kulakë, prandaj të jeni të ashpër me ta, ashtu sikurse na mëson Partia.

Çështjes së edukimit, siç e ngritën edhe shokët, ne duhet t'i kushtojmë shumë kujdes. Në Peshkopi populli është patriot, me gjithë situatat e vështira që kanë qenë atje gjatë luftës. Në Peshkopi ka edhe elementë armiq që ne duhet të kemi kujdes të mos depërtojnë në Parti jo se jo, por as në organet e pushtetit. Por përse i përket brezit të ri duhet të tregohet shumë kujdes dhe të edukohet mirë. Në këtë rreth të dërgohen mësues nga më të mirët dhe të bëhen përpjekje për të ngritur kuadro nga vetë rrethi. Edhe dërgimi i më shumë filmave dhe

---

<sup>1</sup> Është fjala për ligjin nr. 769, datë 13 mars 1950 të Kuvendit Popullor, sipas të cilit përjashtoheshin nga tatimi mbi ekonominë bujqësore të ardhurat nga tokat që mbilleshin me pambuk për vitin 1950 e 1951.

grupeve teatrale në këtë zonë të thellë, është i domosdoshëm.

Në Peshkopi, si rreth kufitar, Partia duhet të ketë shumë kujdes dhe të mos e zërë gjumi, për të forcuar luftën kundër titizmit. Komiteti i Partisë të jetë një drejtues i mirë i Armës së Sigurimit dhe në këtë luftë të mobilizojë edhe të gjithë anëtarët e Partisë. Populli e ndjen dhe e kupton se titizmi është armik, por kjo nuk do të thotë të lejohet zhvillimi i ndjenjave antisllave. Populli ta kuptojë mirë se Titua është armik, si dhe kralët, por propaganda antisllave ka qenë një parullë e krerëve të shitur për të shtypur popullin tonë e për ta mbajtur larg nga solidariteti me popujt sllavë të Ballkanit, të Bashkimit Sovjetik etj. Kjo punë nuk duhet në asnjë mënyrë të pakësojë vigjilencën kundrejt përpjekjeve që bëjnë trockistët e Beogradit, trashëgimtarët e shovinistëve serbo-malazezë, për të futur hundët në punët tona, për të dëmtuar Partinë e punën ndërtimtare të popullit tonë. Prandaj kini kujdes, shokë, jini vigjilentë.

*Botohet për herë të parë sipas  
tekstit të nxjerrë nga proces-  
verbali i mbledhjes së Byrosë  
Politike të KQ të PPSH që  
gjendet në AQP*

## MBI KOMPETENCAT E PUSHTETIT LOKAL<sup>1</sup>

[1950]

Qëllimi i kësaj mbledhjeje, e cila ka më tepër karakter konsulte, është që të shtrojë e të diskutojë disa çështje që kanë të bëjnë me funksionimin e rregullt dhe me kompetencat e pushtetit lokal të marrëdhënjeve të komiteteve ekzekutive me dikasteret qendrore dhe me hartimin e planit nga baza. Për këto probleme kemi filluar dhe një studim të përgjithshëm, prandaj kemi thirrur në këtë mbledhje edhe shokë të sektorëve të ndryshëm, që kanë të bëjnë me këto probleme.

Në lidhje me kuptimin e drejtë të kompetencave të pushtetit lokal, punët nuk shkojnë aq mirë dhe në këtë gjë ndikojnë shumë faktorë. Është e vërtetë se dikasteret kanë rolin drejtues, por janë komitetet ekzekutive ato që do t'i zbatojnë urdhërat dhe udhëzimet e tyre. Duke mos i kuptuar mirë kompetencat e këshillave popullore dhe të komiteteve ekzekutive, vihet re një farë konfuzioni në kryerjen e detyrave që shtrohen. Në

---

<sup>1</sup> Diskutim në konsultën, organizuar në Kryeministri, me disa kuadro të Partisë dhe të pushtetit, ku u rrah problemi i njohjes dhe i zgjerimit të kompetencave të pushtetit lokal.

pushtetin lokal mungon organizimi i mirë; kështu, megjithëse pranë komiteteve ekzekutive të rretheve ekzistojnë seksionet e planit, ato nuk funksionojnë si duhet. Nga mungesa e organizimit në këto seksione vjen edhe mospërpilimi si duhet i planeve në bazë dhe moskontrolli i zbatimit të tyre. Po kjo gjë vihet re edhe në sektorë të tjerë.

Le të marrim bujqësinë. Në këtë sektor konstatohet se planet bëhen nga lart dhe në bazë dërgohen të pregatitura. Kjo vjen, nga njera anë se ministria nuk ka besim sa duhet në njerëzit që merren me këto probleme në bazë, gjë që duket në mosmarrjen në konsideratë të të dhënave dhe të mendimeve të tyre, dhe nga ana tjetër ngaqë në vetë komitetet ekzekutive, në aparatet e tyre, ka shumë burokratizëm. Këtë e tregon edhe fakti që teknikët e bujqësisë, në vend që të shkojnë në fushë e të ndihmojnë konkretisht për vënjen në jetë të formave socialiste të punës në bujqësi, qëndrojnë më shumë në zyrë.

E njëjta gjë vihet re edhe në sektorin e blegtorisë. Atje ka mjaft dëme, ka mungesë kullotash dhe mosinteresim për jetën dhe edukimin e barinjve. Fajin kryesor për këto e kanë komitetet ekzekutive, sepse po nuk u kujdesën në radhë të parë ato, Ministria e Bujqësisë nuk ka ç'bën; megjithatë as kjo dhe as komitetet e Partisë në rrethe nuk shfajësohen për këto të meta të theksuara në këta sektorë.

Ne konstatojmë se dikasteret nuk kanë kuptuar rolin e rëndësishëm të komiteteve ekzekutive. Këto i konsiderojnë organet e bazës si organet e tyre, të cilave mund t'u japin 30 urdhëra në ditë, sikur kuadrot e kë-

tyre komiteteve t'i kenë funksionarë të tyre. Ky është një kuptim jo i drejtë për instancat e pushtetit popullor në bazë.

Duke mos njohur rolin e komiteteve ekzekutive, dikasteret u imponojnë këtyre një korrespondencë të tillë që nuk u krijon mundësi teknikëve në komitetet ekzekutive të merren me punë konkrete, por i ngarkojnë këta me punë shkresash. Ka sektorë të tyre në bazë, për shembull ai i grumbullimit, i cili del se është krejtësisht i shkëputur nga komiteti ekzekutiv. Ne mendojmë se kompetencat nuk njihen mirë në sektorin e bujqësisë, të tregëtisë dhe në grumbullimet. Të tre këta sektorë kompetencat akoma nuk i kanë të qarta, prandaj duhen marrë masa në këtë drejtim. Ndryshe ndodh në financat. Në sektorin e financave kompetencat janë më të njohura.

Të dhënat për sipërfaqet e tokave duhej të ishin përmirësuar. Këto të dhëna i mban kadastra. Kadastra, për të bërë korigjimet e nevojshme duhej të punonte vazhdimisht në to. Seksionit të bujqësisë në bazë i del detyrë të kujdeset në mënyrë të veçantë për kadastrën; ai duhet të kontrollojë dhe të udhëzojë si duhen mbajtur këto nga nëpunësit që merren me kadastrën.

Kur bëhet plani, ku mbështeten këto seksione: në statistikat operative apo në ato shtetërore? Nga faktet del se nuk merren për bazë statistikat shtetërore, por ato operative, të cilat shpesh ndryshojnë e shumë herë nuk janë të vërteta. Nga të dhënat del se nga të dy anët nuk mbahen statistika të sakta. Seksioni i bujqësisë është transformuar në një aparat të Ministrisë së Bujqësisë dhe jo në aparat të komitetit ekzekutiv; duke

genë kështu aty nuk ka as kontroll plani nga ana e komiteteve dhe këshillave popullore. Në këtë mënyrë roli drejtues i komiteteve ekzekutive, përsa i përket bujqësisë është zvogëluar krejtësisht.

Ç'ne, ju, shokë të dikastereve, t'u shkruani komiteteve ekzekutive që të kërkojnë ndihmën e komiteteve të Partisë! Partia, natyrisht, do të ndihmojë, por ajo qëndron mbi të gjitha dhe detyra kryesore e saj është të kontrollojë, të ndjekë zbatimin e detyrave që u ngarkohen komiteteve ekzekutive. Shumë probleme kryesore duhet të transmetohen nga ana e qeverisë dhe e Komitetit Qendror.

Na ngjet që nga një anë nënvleftësojmë rolin e pushtetit dhe disa probleme që duhet t'i ekzekutojë seksioni i bujqësisë, për të cilat janë të interesuara dhe seksione të tjera, nga ana tjetër këto probleme i kërkojnë t'i zgjidhë komiteti ekzekutiv, i cili u jep pak rëndësi zbatimit të tyre. Le të marrim çështjen e shpërndarjes së farërave. Si mund t'i shpërndani këto në rrethe? Seksionet e bujqësisë duhet të interesohen që këto të shpërndahen në rregull e mirë, sepse ky është problemi i tyre. Për gjërat që nuk kryhen, kur vjen puna dikasteret ua hedhin fajin komiteteve ekzekutive, ndërsa për kompetencat e tyre nuk pyesin fare, si rrjedhim nuk zbatohen planet dhe urdhërat.

Konstatojmë se në zbatimin në praktikë të detyrave ka mjaft konfuzion. Planet e grumbullimit hartohen me shpejtësi të madhe, gjë që shkakton gabime të mëdha në fletëdetyrimet. Kjo vjen nga moskoordinimi si duhet i punës së të plotfuqishmit me komitetin ekzekutiv. Gjithashtu thuhet se të plotfuqishmit duhet të japin



llogari, por në praktikë nuk po ndodh kështu. Deri tani na ngjet që ata si dhe referentët në vend që të ndjekin realizimin e planeve në terren, bëjnë vetëm plane nga zyra.

Çështja kryesore është të vëmë drejt zbatimin e kompetencave të komiteteve ekzekutive. Gjithashtu seksionet e planit pranë komiteteve ekzekutive të mobilizohen më shumë për të dalë një plan jo nga lart, por nga baza, po ashtu çështja e kadastrës të merret më seriozisht, që ajo të mbarojë sa më parë.

*Botohet për herë të parë sipas  
tekstit të nxjerrë nga proces-  
verbali që gjendet në Arkivin  
e Këshillit të Ministrave të  
RPSH*



## L E N D A

PARATHËNJE PËR VËLLIMIN 7 .....	V—VIII
---------------------------------	--------

### 1950

FJALA PARA NXËNËSVE TË SHKOLLËS SË BASHKUAR «ENVER HOXHA» ME RASTIN E MBYLLJES SË KURSIT TË VITIT SHKOLLOR 1949 (9 janar 1950)	1—6
MBI ANALIZËN E PUNËS VJETORE TË ORGANIZATËS SË PARTISË TË TIRANËS — Nga diskutimi në mbledhjen e Sekretariatit të KQ të PPSH (9 janar 1950) .....	7—13
MBI RAJONIZIMIN E KULTURAVE BUJQËSORE — Nga diskutimi në mbledhjen e përbashkët të Byrosë Politike të KQ të PPSH dhe të Qeverisë së RPSH (2 shkurt 1950) .....	14—16
MBI FORCIMIN E MËTEJSHËM TË PARTISË DHE TË LIDHJEVE TË SAJA ME MASAT — Nga diskutimi në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të PPSH (13 shkurt 1950) .....	17—24

<b>FJALA NË PLENUMIN V TË KOMITETIT QENDROR TË PARTISË SË PUNËS TË SHQIPËRISË MBI DISA ÇËSHTJE ORGANIZATIVE TË PARTISË (20 shkurt 1950)</b> .....	25—60
— Mbi veprimtarinë e grupit antiparti .....	25
— Mbi punën e sëmurë të Nexhip Vinçanit ..	54
<b>FJALA E MBYLLJES NË PLENUMIN V TË KOMITETIT QENDROR TË PARTISË SË PUNËS TË SHQIPËRISË (22 shkurt 1950)</b> .....	61—92
<b>PËR NJË ORGANIZIM MË TË MIRË TË PUNËS NË INSTITUTIN E SHKENCAVE — Nga diskutimi në mbledhjen e Sekretariatit të KQ të PPSH (24 shkurt 1950)</b> .....	93—95
<b>MBI PËRMIRËSIMIN E PUNËS ME KUADRIN — Nga diskutimi në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të PPSH (27 shkurt 1950)</b> .....	96—97
<b>MBI FORCIMIN E MËTEJSHËM TË PUNËS ME RININË — Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të PPSH (1 mars 1950)</b> .....	98—105
<b>MBI REALIZIMIN E PLANIT TË GRUMBULLIMIT PËR DRITHËRAT E BUKËS — Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të PPSH (29 mars 1950)</b> ..	106—110
<b>TË FORCOJMË MË TEJ ORGANIZATËN E FRONTIT — Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të PPSH (5 prill 1950)</b> .....	111—113
<b>RAPORT «MBI SITUATËN POLITIKE DHE PROBLEMET EKONOMIKE» — Mbajtur në Konferencën II Nacionale të PPSH (10 prill 1950)</b> .....	114—284

## I

SITUATA POLITIKE E JASHTME DHE E BREND- SHME .....	115—155
---	---------

## II

MBI DISA PROBLEME EKONOMIKE NË VENDIN TONË .....	1 155—229
— Industria dhe minierat .....	158
— Ndërtimet .....	167
— Transporti .....	171
— Bujqësia .....	174
— Grumbullimi i prodhimeve bujqësore e bleg- torale .....	196
— Mbi përgatitjen e kuadrove për realizimin e detyrave të planit .....	205
— Sigurimi i fuqisë punëtore .....	207
— Lufta për uljen e kostos së prodhimit .....	210
— Të organizojmë kontroll të rreptë nga lart dhe nga poshtë .....	213

## III

LUFTA E PARTISË PËR FORCIMIN E SAJ ....	229—284
FJALA E MBYLLJES NË KONFERENCËN II NA- CIONALE TË PPSH (14 prill 1950) .....	285—291
FJALIM NË KONGRESIN E DYTË TË FRONTIT DEMOKRATIK TË SHQIPËRISË (7 maj 1950) ....	292—301
FJALA E MBAJTUR PARA ZGJEDHËSVE TË ZO- NËS ELEKTORALE NR. 108 TË QYTETIT TË TI- RANËS (25 maj 1950) .....	302—327

- DISA ÇESHTJE TË PUNËS SË PARTISË ME BASHKIMET PROFESIONALE — Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të PPSH (2 qershor 1950) . . . . 328—333
- FJALA NË TAKIMIN ME NJË GRUP NXËNËSISH TË DALLUAR NË MËSIME (19 qershor 1950) . . . . . 334—338
- FJALA E MBAJTUR NË SESIONIN I TË LEGJISLATURËS SË DYTË TË KUVENDIT POPULLOR KU PARAQET DORËHEQJEN E QEVERISË (4 korrik 1950) . . . . . 339—342
- FJALIM PROGRAMATIK NË SESIONIN I TË LEGJISLATURËS SË DYTË TË KUVENDIT POPULLOR (5 korrik 1950) . . . . . 343—355
- MBI PROJEKTPLANIN E VITIT 1951 — Diskutim në mbledhjen e përbashkët të Byrosë Politike të KQ të PPSH dhe të Qeverisë së RPSH (19 korrik 1950) . . 356—360
- PËRGJEGJE LETRËS SË SHOKUT VËLLKO ÇERVENKOV NË LIDHJE ME KËRKESËN PËR DËRGI-MIN E NJË ARTIKULLI MBI GJERGJ DIMITROVIN (21 korrik 1950) . . . . . 361—362
- GJERGJ DIMITROVI DHE MIQËSIA E PËRJETSHME NË MES POPULLIT SHQIPTAR DHE BULLGAR (korrik 1950) . . . . . 363—395
- MESAZH DREJTUAR SHOKUT KIM IR SEN KU SHPREHET SOLIDARITETI ME LUFTËN E POPULLIT KOREAN KUNDËR AGRESIONIT AMERIKAN (28 korrik 1950) . . . . . 396—398
- SUKSESET E REPUBLIKËS POPULLORE TË SHQIPËRISË (11 gusht 1950) . . . . . 399—425

- MBI FORCIMIN E ORGANIZATËS SË PARTISË  
DHE MBI LUFTËN E KLASAVE NË RRETHIN E  
KORÇËS — Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike  
të KQ të PPSH (20 shtator 1950) ..... 426—429
- DISA DOBËSI QË VAZHDOJNË TË EKZISTOJNË  
NË PUNËN E ORGANIZATËS SË PARTISË TË  
LUSHNJËS — Diskutim në mbledhjen e Byrosë Poli-  
tike të KQ të PPSH (28 shtator 1950) ..... 430—435
- TELEGRAM PËRSHËNDETJE DREJTUAR SHOKUT  
MAO CE DUN ME RASTIN E PËRVJETORIT TË  
PARË TË FORMIMIT TË REPUBLIKËS POPULLO-  
RE TË KINËS (1 tetor 1950) ..... 436—437
- PËRSHËNDETJA NË KONGRESIN E TRETË TË  
BASHKIMIT TË GRAVË TË SHQIPËRISË (1 tetor  
1950) ..... 438—443
- TELEGRAM PËRSHËNDETJE DREJTUAR POPU-  
LLIT TË MOKRËS ME RASTIN E PËRVJETORIT  
TË TETË TË ÇLIRIMIT TË KËSAJ KRAHINE  
(10 tetor 1950) ..... 444—445
- MBI DISA ÇËSHTJE TË KOLEKTIVIZIMIT TË BUJ-  
QËSISË DHE MBI SHKURTIMIN E PLANIT TË  
IMPORTIT — Nga diskutimi në mbledhjen e Byrosë  
Politike të KQ të PPSH (27 tetor 1950) ..... 446—451
- KOMITETI I PARTISË NË RRETH TË PREOKUPO-  
HET MË SHUMË PËR PËRMIRËSIMIN E MËTEJ-  
SHËM TË METODËS E TË STILIT NË PUNËN E  
TIJ — Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ  
të PPSH (3 nëntor 1950) ..... 452—457
- REVOLUCIONI I MADH I TETORIT DHE POPULLI  
SHQIPTAR (10 nëntor 1950) ..... 458—470

MBI MASAT PËR RUAJTJEN E PASURISË SË SHKETIT — Diskutim në mbledhjen e Qeverisë së RPSH (23 nëntor 1950) .....	471—474
SHQIPËRIA MBUSH SOT GJASHTË VJET QË RRON E LIRË DHE E PAVARUR (29 Nëntor 1950) .....	475—498
TË RRRITET KUJDESI I PARTISË PËR EDUKIMIN E GJITHANSHËM TË RINISË — Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit të KQ të PPSH (8 dhjetor 1950) .....	499—505
MBI NEVOJËN E NJË STUDIMI SHKENCOR PËR GJENDJEN NË FSHAT — Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të PPSH (15 dhjetor 1950) ..	506—509
VENDIMI TË ZBËRTHEHET MIRË DHE TË KONTROLLOHET ME RIGOROZITET ZBATIMI I TIJ — Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të PPSH (26 dhjetor 1950) .....	510—515
MBI FORCIMIN E MËTEJSHËM TË PUNËS SË PARTISË NË RRETHIN E FIERIT DHE TË PESHKOPIË — Nga diskutimi në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të PPSH (29 dhjetor 1950) .....	516—522
MBI KOMPETENCAT E PUSHTETIT LOKAL (1950)	523—527



